

ATENTATET

IBRAHIM KEMENDI



focus

ROMAN

IBRAHIM KELMENDI

ATENTATET

(ROMAN)

**FOCUS
PRISHTINË
2007**

Përpunimi grafik i tekstit dhe faqosja:

Ibrahim Kelmendi

E-mail: ibrahim_kelmendi@yhoo.de
i.kelmendi@gmx.de

Kopertina:

Ngadhujim Mehmeti (Shkup)

© Focus (janar - shkurt 2007 në Kosovë)

© Autori

Shtëpia Botuese Focus, Prishtinë, 2006

Shtypshkronja: Blini, Gjakovë

ISBN 978-9951-8583-9-7

*Gjatë formimit shoqëror e kombëtar,
kulturore e religjioz, shkencor e politik,
autori ka njohur shumë mite, kulte, idole e hyjni.
Përfundimisht kredoja e tij e ka përmbysur
hierarkinë e idiolatrisë duke ia shpëlarur surrogatët e tyre.
Ju mund ta akuzoni autorin për mungesë modestie,
gjatë gjithë kohës që ai njih, respektin,
i falet me përkuqe dhe devotshmëri vetëm të vërtetës.*

*Është krejt i ndërgjegjshëm se një ditë
të gjithë do t'ia kthejnë shpinën e do ta lënë.*

*Një ditë, është plotësisht i ndërgjegjshëm,
gjithçkaje të kësobotshme do t'ia kthejë shpinën e do ta lërë.*

*Edhe kur e lënë, edhe kur i lë,
në thelb nuk ndërron gjë.*

E vërteta do të qëndrojë e përjetshme në fronin e saj.

*Kjo vrvashkë s'ka të bëjë as me Dialogët
e Platonit, as me Mbrojtjen e Sokratit.*

*Ky shkrim s'është tjetër veçse një akt dëshmimi i autorit, blatur
ar hyjneshës së tij, të vetmës dhe të tërëkohshmes.*

Adem Gashi

(Në vend të parathënies)

Ngjarjet e romanit janë fragmente të jetës dhe veprimtarisë në ekzil, gjatë viteve 1979 – 1982, të personaliteteve tashmë historike, **Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka** dhe **Bardhosh Gërvalla** dhe të bashkëveprimtarëve e kundërshtarëve të tyre, si dhe rrethanat para atentateve, më 17 Janar 1982, në Untergruppenbach, afër Hajbronit (Heilbronn) të Gjermanisë dhe pas atentateve, deri më 17 janar 1985. Ato janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, pa pretendim për të qenë të vërteta historike. Mendimet dhe vlerësimet janë të kohës, kur kanë ndodhur ngjarjet.

Autori

KAPITULLI I

Buzëmbremje e vitit të plakur 1979. S'kishte veçse tetë ditë që të përmbushte veten për t'ia lënë radhën Vitit të Ri 1980. Ndërrimi i moteve rëndom shoqërohet me festime e shpresa të mëdha. Askush nuk mund ta dijë se sa dhe si janë përmbushur shpresat e planet, të bëra një vit më parë. Ai tani po ikte përgjithmonë. Dhe po ikte duke zhgënjyer shumëkënd, edhe këtu në Gjermani, në shtetin që ishte ndër më të zhvilluarit e globit. Tani s'ishte më kohë bilancesh e llogarish, por ishte vlugu i mendimit për kremte. Qytetarët gjermanë kanë traditë të lashtë krishtere dhe, pavarësisht se tani nuk janë gjithaq religjiozë, janë shumë të dhënë pas festimit të Krishtlindjes. Gjithandej qenë ndriçuar rrugët me laterne, reklama farfuritëse e kombinime nga më të bukurat.

Miranin kjo atmosferë festive e hutonte. Ndihej i mërziur, meqë jeta e detyruar e ekzilit ia mbante mendjen pezull në Kosovë. Përfytyronte shqiptarët e vet që kishin halle krejt të tjera me këto të gjermanëve. Atje po ndodhnin arrestime politike, përndjekje e trysni...

Në kuzhinën e përbashkët të konviktit të studentëve „Haus Mihael” në Bochum, kësaj buzëmbremjeje kishte qetësi më shumë se rëndom. Të pranishëm ishin vetëm Renata, Mihaeli, Mirani, Marta, Zdenko. Konvikti, pronë e Kishës katolike gjermane, kishte rregulla të tjera banimi nga ata shtetërorët. Këtu banonin vetëm studentë meshkuj, kurse në të tjerët, të përzier. Renata, studente gjermane e gjuhëve të huaja, ishte mysafire e Miranit, kurse Marta, polake e sapoardhur për studime në Bochum, ishte mysafire e Zdenkos, studentit nga Çekia. Kati i 2-të, sipas numërimit gjerman, i njërit nga blloqet e këtij konvikti, kishte gjith-

sej 24 dhoma, për po kaç studentë. Dhomat, të mëdha ose të vogla, me rreth 10 metra katrorë për person. Me lavaman brenda, kurse banjorja e dushi të përbashkëta për të gjithë studentët e katit. Kuzhina po ashtu. Secili me frigoriferin e tij dhe kjo kuzhinë ishte vetëm për rastet kur studentët përtonin të shkonin në mensë.

Në këto rrethana Miranit i bëhej sikur po banonte në hotel, në krahasim me jetën studentore trevjeçare që kishte bërë në Prishtinë. Vitin e parë të studimeve pat banuar ilegal, siç quheshin atje, te vëllai që ishte absolvent në juridik dhe kimi. Në dhomën nr. 5 të katit përdhes në konviktin nr. 1, banonin tre studentë legalë, dy nga të cilët ishin të detyruar të strehonin aty edhe dy ilegalë. Dhoma e atjeshme ishte po aq e vogël, sa kjo në Bochum. Atje banonin pesë studentë, ndërsa këtu Mirani banonte i vetëm. Mendohej të përfytyronte se si kishte mundur të flinte në krevatin e vogël bashkë me vëllanë gjatë gjithë vitit. Vitin e dytë të studimeve, kur vëllai kishte mbaruar tashmë, që vendosur ilegalisht të kushërinji në barakën nr. 2. Vitin e tretë kishte pasur fat të merrte shtrat të vetin në konviktin nr. 1, por tashti ndihej i detyruar të strehonte ilegalisht dajën e tij. Ai ishte tepër korpulent dhe edhe tani nuk e kuptonte se si kishte mundur të flinte me të në një krevat gjatë gjithë vitit.

Mirani, i regjistruar në semestrin e pestë në germanistikë e filozofi, ishte vendosur në këtë konvikt me ndihmën e albanologut kroat, Dr. Lazar D., nga Janjeva e Kosovës dhe të studentit kroat, Damir P., udhëheqës i Lëvizje studentore të vitit 1971 në Split të Kroacisë. Që të dy prej vitesh jetonin në ekzil në Gjermani, pa pasur mundësi të shkonin në vendlindjet e tyre. Dr. Lazar D., mbante lektoratin e albanologjisë në „Ruhr-Universität” në Bochum, kurse Damiri studionte historinë.

Rëndom, gjatë fundvitit dhe në prag të Krishtlindjeve, studentët gjermanë nuk qendronin në konvikt. Ata shkonin te prindërit e tyre ose në vende të preferuara për kremtime. Edhe këtë herë, kishin mbetur pothuajse vetëm studentët e huaj dhe ndonjë gjerman që, ose po për-

gatitej të shkonte ose kishte ndërprerë traditën e festimit të Krishtlindjeve në familje.

Po në këtë kat, si në të gjitha katet tjerë, pranë kuzhinës ishte kabina e vogël e telefonit. Telefonatat që vinin në konvikt, centralisti i përudhte kateve, varësisht nga numri i dhomës ose emri që kërkohet.

Ndoshta, ngaqë kishte qetësi, cingërima u dëgjua më shumë se herave të tjera. Mihaeli, fqinji i parë dhe miku shumë dashamirës i Miranit, shkoi të merrte vesh se kush po kërkohet në telefon. Duke dalë nga kabina, thirri me zë të lartë:

– Miran, telefonatë për ty!

– Gjerman apo shqiptar? – e pyeti tjetri.

– I huaj, por fliste mirë gjermanisht. – u përgjigj Mihaeli.

Mirani shkoi në kabinë.

– Alo, urdhëroni! – foli në gjuhën gjermane.

– Fol shqip të të marrë vesh edhe perëndia! – u përgjigj telefonuesi.

Mirani e njohu menjëherë zërin e Bardhit. Bardhosh Gërvallën tashmë të gjithë e thërrisnin shkurt, Bardh.

Sapo mbaruan pyetjet e përgjigjet e para për shëndetin, studimet, punën, Bardhi bëri njoftimin:

– Mezi ia doli të arratiset vëllai, Jusufi. Isha ta ndihmoja për të hyrë ilegalisht në Austri. Ai dëshiron të të takojë sa më parë.

Mirani u kthye në kuzhinë me një hare të papritur. Pak çaste më parë ishte fjalosur me miken Renatë. Ajo nuk pranonte të shkonte pa të për Krishtlindje në familjen e saj në Bielefeld. S'ishte ndonjë besimtare, por gjermanëve u ishte bërë traditë të mbledheshin me familje për Krishtlindje. Renata dhe familja e saj donin gjithsesi ta kishin edhe Miranin në gjirin e tyre për kremte. Ai s'e kishte për gjë bindjen fetare, por nuk e ndjente vetën pjesëtar familjeje. Më kot ishte munduar ta bindte Renata. I kishte thënë se as ajo nuk ishte besimtare, se edhe prindërit, duke qenë

të krahut evangelist, ishin shumë liberalë, ndaj Mirani, pavarësisht se i besimit mysliman, s'kishte pse të nguronte. Edhe po të ishte besimtar, siç i takonte sipas prejardhjes familjare, nuk do të hezitonte, – i kishte thënë ai. Shënimi i Ditëlindjes së Jezusit, siç e quajnë kristianët, dhe i Isait, siç e quajnë myslimanët, duhet të ishte i përbashkët. Për të dy besimet, Jezusi, gjegjësisht Isai, pranohej si profet. Megjithatë, Mirani nuk dinte t'ia shpjegonte asaj se përse myslimanët nuk e shënonin Ditëlindjen e Profetit të tyre, Pejgamberit Isa. Ndoshta, ngaqë ata nuk e festonin as Ditëlindjen e Pejgamberit Muhamed, themeluesit të fesë myslimane.

Renata i kishte thënë të atit dhe të ëmës që ta ftonin Miranin me telefon, me shpresën e fundit se mbase këtij do t'i vinte keq ta refuzonte ftesën e tyre. Edhe kjo nuk e kishte bindur atë. Pastaj Renata kishte qajtur me dënësë. As kjo nuk e kishte bindur Miranin të ndërronte vendimin. Thjesht, ai nuk donte të trajtohej si pjesë e Familjes Baumann. Kur të gjitha përpjekjet kishin deshtuar, Renata kishte vendosur që për Krishtlindje të rrinte me atë. Pak para bisedës telefonike me Bardhin, Mirani ishte munduar ta detyronte të shkonte, por Renata nuk kishte pranuar. Të dy ishin të mërzitur.

– More ndonjë lajm të mirë që u ktheve kaq i hareshëm? – e pyeti ajo. Renata u gëzohej si fëmijë gëzimeve të rralla të tij. Tani po shpreonte se mos ky disponim i papritur do t'ia ndryshonte vendimin atij, për të shkuar së bashku në Bielefeld, për të hapur gëzimin e gjithë familjes së saj.

– Bardhi më njoftoi se i kishte ardhur vëllai, – u përgjigj Mirani.

– Dhe, përse të gëzoi ardhja e vëllait të Bardhit? – pyeti ajo me kureshtje.

– Sepse vëllai i Bardhit, Jusufi, është shkrimtar, publicist, gazetar, këngëtar. Ai është detyruar të arratiset, meqë pushteti jugo-sllav do ta burgoste. – tha ai.

– Kësaj po i gëzohesh ti tani!? – pyeti e habitur Renata.

– Mos ma prish tani me këso pyetje sugjестive! – foli Mirani. – Ai vërtet ka pësuar fakeqësi, por njerëzit kanë unin e tyre. Sa herë të kam sqaruar, kur ma mësoje gjermanishten. Sidomos kur më qortoje për gabimet në drejtshkrim, se nuk e dija as drejtshkrimin e gjuhës shqipe. E mban mend?

– Po, më kujtohet, por ç’lidhje ka kjo që po më thua me ardhjen e vëllait të Bardhit, emrin e të cilit s’e mbajta mend? – pyeti Renata.

– Jusuf Gërvalla, i thonë. Tani do të më ndihmojë ta përsos drejtshkrimin e shqipes dhe do të m’i korrigojë shkrimet për gazetën *Bashkimi*. Shpresoj se do të pranojë edhe ta redaktojë gazetën. Do ta kem një shok intelektual, me të cilin do t’i diskutojmë punët tona. Dhe kjo është një arsye egoiste, por që më bën të gëzohem.

– E njeh ti atë? – ndërhyri Renata, duke humbur durimin nga përgjigja e stërzgatur.

– Nuk e njoh personalisht. Është vëllai i Bardhit, për të cilin të kam folur se e kam shok. Bardhi më ka treguar se ai i kërkonte që këtej literaturën që është e ndaluar në Kosovë.

– Tani po e kuptoj egon tënde. Jusufi është detyruar të arratiset. Tani ai do të angazhohet, mendon ti, bashkë me ju, kundër pushtetit komunist jugosllav?

– Dhe kundër pushtimit të Kosovës! – plotësoi Mirani.

– Po, vetëkuptohet! – u përgjigj Renata, duke u ndjerë pakësa e bezdisur, përse po i rrinte kaq gati Mirani, kur ajo harronte të saktësonte, se atij i interesonte po aq çlirimi i Kosovës sa edhe luftimi i diktaturës komuniste jugosllave.

Renata ngriti gotën me verë të kuqe, ia afroi gotës së Miranit dhe uroi:

– Për mirëseardhjen e Jusufit, për shëndetin e sukseset e tij dhe tuajat!

– Gëzuar! – ia ktheu Mirani, i kënaqur që nuk kishte nevojë për sqarime të tjera.

Mihaeli, që ishte ulur afër tyre dhe po ndiqte bisedën, cakëroi gotën duke thënë:

– Gëzuar!

Pas një heshtjeje të nderë, ishte Renata ajo që shpërtheu:

– Domëthënë, tani mund të shkojmë në Bielefeld? – foli me shpresë se gëzimi i papritur mund t’ia ndryshonte vendimin kokëfortë Miranit.

– Mos më terrorizo më me insistimin tënd për të shkuar te familja jote! Sikur nuk i di principet e mia. – u përgjigj tjetri me nervozizëm.

– Më fal! – ia bëri Renata. – Atëherë do të festojmë së bashku këtu nesër mbrëma Krishtlindjen, meqë edhe Mihaeli nuk po shkon te familja e tij. Këtu do të jenë edhe Marta, Zdenko e Detlefi.

– Megjithatë, unë të përgjerohem që ti të shkosh. Më vjen keq nga prindërit, vëllai e motra jote që të presin. – tha Mirani. – Unë nuk kam festë dhe nuk kam pse të shtirëm se do të festoj me ju edhe këtu.

– Edhe unë kam principe. Kam vendosur të jem me ty për Krishtlindje. Më me dëshirë do të isha bashkë me ty në gjirin e familjes, por edhe këtu, se bashku, do të ndihem e gëzuar. Asaj sa nuk i shpëtoi goja për të thënë “në gjirin e familjes sonë”, por u përmbajt.

2.

Renata e Mirani ishin njohur qysh në fillim të vitit 1977. Atëherë Mirani ndiqte kursin e gjuhës gjermane në Universitetin e Bochumit, ndërsa Renata ishte asistente e profesoreshës Hemermann. Meqë Mirani tregonte interesim të madh për të mësuar gjuhën gjermane, Renata kishte shprehur gatishmëri ta ndihmonte edhe jashtë orarit të mësimi. Ajo filloi t’i shkonte në banesë dhe ta ndihmonte atë sidomos në mësim të gramatikës. Njëherë Renata kishte shprehur dyshim nëse Mirani kishte mbaruar shkollë të mesme, sepse, kishte hetuar se nuk po e kup-

tonte mjaftueshëm gramatikën. Madje nuk kishte hezitur të shprehte dyshimin: meqë me kaq vështirësi po i kuptonte shpjegimet e gramatikës gjermane, atëherë patjetër që nuk e njihje as gramatikën e gjuhës shqipe! Ai i ishte përgjigjur se në shkollë fillore dhe të mesme i kishte rastisur të kishte mësues të dobët të gjuhës shqipe, sado që diplomën e gjimnazit e kishte me notë maksimale. Që atëherë kishte filluar afrimi i tyre, i cili ndërkohë që shndërruar në dashuri. Tani Miranit nuk po i kujtohet se kur, ku dhe si ia kishte shpallur ajo dashurinë konkretisht. Gjithëcka kishte rrjedhur spontanisht. Mirani dukej i përmbajtur. Kishte simpati të jashtëzakoshme ndaj saj, e donte dhe e respektonte shumë, por kish lidhur mendjen të mos binte në dashuri. Kjo e nxiste edhe më shumë Renatën ta dashuronte atë. Një herë, e dëshpëruar, e kishte pyetur: “Përse refuzon dashurinë time me kaq vendosmëri, madje edhe kundër vullnetit tënd?” Mirani ishte zënë ngusht. “Nuk po e refuzoj dashurinë tënde, por po e frenoj veten të të mos dashuroj. Frikësohem se dashuria do të më pengojë për angazhimin tim total për Kosovën. Dashuria jonë do të shndërrohet në martesë. Kur të çlirohet Kosova unë do të kthehem atje. Nuk dua të të shkaktoj ty mallëngjim e vuajtje, siç po i përjetoj unë tani, larg familjes e vendlindjes sime. E marr me mend se ti do të vije për të vazhduar bashkëjetesën tonë në Kosovë.” “Po unë do të vij me dëshirë.” – ishte përgjigjur ajo. “Thua kështu tani. Nuk mund ta marrësh me mend se sa e vështirë është të jetosh larg vendlindjes.” – kishte thënë Mirani. “Ndoshta do të kem pak mall, po vuajtje nuk do të ndiej fare, sepse unë nuk do ta kem të ndaluar të vij për vizitë sa herë të dua në Gjermani.” – ia kishte kthyer Renata. “Po pengesa që do të më shkaktohet tani për angazhimin tim ndaj Kosovës?” – e kishte pyetur ai, ngaqë i qe dukur se qëllimisht harroi t’i përgjigjej. “Se mos po të pengoj ndonjëherë. Sa herë po ke nevojë po angazhohem edhe unë, duke t’i korrigjuar letrat për gjermanët, duke t’i korrigjuar diskutimet, tekstet e trakteve dhe të informatave, e të tjera”, – i ishte

përgjigjur Renata. “I bënë këto tani nga dashuria, por thuhet se pas martesë ndryshon edhe dashuria, edhe përkushtimi”, – kishte vazhduar tjetri. “Këto nuk mund t’i parashikoj saktësisht që tani, por them se me bindjen që kam, nuk do të të pengoj as atëherë. Përkundrazi, ndoshta do të angazhohem edhe më shumë, meqë Kosova jote do të bëhej edhe imja.” Miranit po i mungonin kundërargumentet, pasi i vlerësonte arsyetimet e logjikshme të Renatës, ndaj e kishte mbylluar diskutimin me lutjen: “Për hirë të dashurisë që ke për mua, mos me maltreto më me biseda të këtilla?”.

Renata nuk e kishte vazhduar më bisedën. Kishte respektuar lutjen e Miranit dhe bashkëshoqërimi i tyre kishte vazhduar. Shpesh u kishte ndodhur të flinin në të njëjtën dhomë, por nuk kishin bërë seks. Ndonjëherë kur Mirani nuk i kishte frenuar epsheet e çastit, ajo kishte refuzuar. S’e donte seksin pa dashurinë brënda. Herë tjetër kishte ndodhur e kundërta. Renata ishte ajo që i futej nën jorgan, por ky e refuzonte. I bëhej se seksi e shëmtonte admirimin për qenien. Në ato momente Renata e akuzonte për kulturë konservative. Po, ç’kulturë ishte kur refuzonte ajo? – e ngacmonte Mirani.

3.

Në mëngjes Renata kishte nisur të përgatiste gatesat për darkën e Krishtlindjes. E ndihmonte edhe Mihaeli. Mirani tashmë kishte shkuar te vëllai në Mülheim a.d. Ruhr. Ai i kishte premtuar Renatës se do kthehej në darkë.

Darka u shtrua rreth orës 21.00. Në kuzhinë të përbashkët të katit kishin zënë vend vetëm Renata, Mirani dhe Mihaeli. Marta e Zdenko kishin ikur te bashkëvendësit e Zdenkos, ndërsa Detlef i familja e tij, sekush duke lënë një shënim të ngjitur në derë të kuzhinës, ku shpjegohet ndryshimi i planit.

Renata e Mihaeli kishin skuqur një rosë sipas traditës popullore,

kishin bërë ëmbëlsira, kishin blerë verë të kuqe, djathëra e gjëra të tjera. Filluan të pinin e të hanin duke uruar njëri-tjetrin.

– Mirë bërë që nuk shkove në Bielefeld, – iu drejtua Mihaeli Miranit.
– Atje nuk do të ndiheshe mirë, si këtu. As familja e Renatës nuk do të dëshironte të shkoje vetëm si shok i Renatës, por si dhëndër i familjes.

Renata po e shikonte me kureshtje, ndërsa Mirani vetëm sa miratoi me lëvizje koke.

– Traditë e keqe kjo jona, – vazhdoi të fliste Mihaeli, meqë nuk mori asnjë përgjigje. – Për Krishtlindje dëshirojnë të mblidhen vetëm pjesëtarët e familjes dhe të kremtojnë pa shokë e miq. Renata mund ta dëshmojë këtë.

Renata u përmbajt një çast.

Të dy po prisnin që ajo të fliste.

– Tashmë i di traditat tuaja, – ndërhyri më në fund Mirani. – Më duket se Renata po ndihet e mërziur që nuk është me familjen, ndaj nuk flet fare. Renata! – thirri befasi ai, por me një dhembshuri që s’e fshihte dot, – të lus të më falësh nëse të kam hidhëruar e mërziur!

– Jo, ndihem mirë. Sigurisht, më mirë do të ndihesha po të ishim së bashku në familje. Nuk desha të flisja, sepse nuk më pëlqeu si e nisi Mihaeli bisedën.

– Kot, – zuri të arsyetohej Mihaeli, – vetëm desha të shfaq kënaqësinë time për kremtimin tonë të përbashkët. Unë këtë traditë tonë as e pëlqej dhe as e respektoj më. Jam ateist. Përse, pra, duhet të dhunoj veten duke festuar Ditëlindjen e Jezusit, i cili, për mendimin tim, është më shumë mit se sa realitet?

– Të paktën për hirë të prindërve. – ia ktheu Mirani.

– Nëse vazhdojmë të festojmë për hirë të prindërve, atëherë feja do të vazhdojë të zvarritet si një formalitet edhe për disa mijëvjeçarë të tjerë, sado që një pjesë e madhe e klerikëve e kanë shndërruar në biznes dhe shumë qytetarë tashmë bëhen sikur besojnë për shkak të inercisë dhe të

imponimit.

Mihaeli u ndie i vetëkënaqur që po filozofonte, siç ia donte atij t'i vlerësonte pikëpamjet e veta ateiste, që kishte filluar t'i shndërronte ato në një lloj feje më vete.

– Përse mendon se qytetarëve u imponohet besimi fetar? – pyeti Mirani.

– Sepse secili qytetar, që nga lindja, është i privuar nga liria për të zgjedhur religjionin që dëshiron, ose për të mos besuar fare. Atij i imponohet feja që kanë prindërit. Po të kisha qenë unë fëmijë i prindërve myslimanë, do të më ishte imponuar ai besim, siç më është imponuar besimi katolik. Fatmirësisht, kur kam filluar studimet, jam çliruar nga feja që ma kanë imponuar prindërit. E njëjta do të kishte ndodhur edhe me ty po të kishe qenë fëmijë i prindërve katolikë. Dhe, po ta thelloj këtë mënyrë mendimi, më del se njeriu është i privuar edhe nga e drejta për të vendosur nëse dëshiron të lindë, të zgjedhë prindërit, të zgjedhë vendlindjen, madje të zgjedhë edhe emrin e tij. Të gjitha i imponohen nga prindërit. Dhe ç'faj ka fëmija i posalindur që vjen nga prindër të varfër ose të paarsimuar? Ai fëmijë duhet t'i përballojë pasojat derisa të arrijë që të ndërgjegjësohet dhe të pavarësohet...

– Sonte nuk është rendi të shpalosësh fenë tënde ateiste, meqë filozofimet e tua i kemi dëgjuar shumë herë, – e ndërpreu Renata.

– Ka të drejtë Renata, nuk ke përse të lodhesh se përsërituri, sepse ne nuk jemi aq besimtarë, pos që na ka mbetur diçka formale gjatë rritjes në ambientin familjar, – shtoi Mirani.

– Dakord, – mori sërish fjalën Mihaeli, – nuk po filozofoj, ama problemet e sajara përmes dallimeve në besimet fetare vazhdojnë të jenë evidente. Madje ato po shndërrohen në urrejtje, po shpërdoren drejt luftërave duke marrë haptas karkterin e përfitimit material. Çfarë ndiejnë tani shumë myslimanë, kur kristianët festojnë Krishtlindjen? Se mos ndihen mirë shumë kristianë, kur myslimanët agjerojnë ose gratë e tyre

mbajnë ferexhe. Për mua fetë kanë pasur rol historik kur njerëzit kanë qenë të prapambetur. Tani ato janë bërë të tepërta...

– Të lutem, na kurse nga gjëra të tilla! – iu drejtua Renata me një zë emocional.

– Më fal, nuk do të vazhdoj më, – u përgjigj tjetri.

Prapë ra heshtja. Mihaeli kishte prirje për të folur, ngaqë nuk e duronte heshtjen. Pas pak, ai duke ndërruar temë, iu kthye Miranit:

– Po ti përse e refuzon dashurinë e Renatës? Me refuzimin tënd kryeneq po e provokon atë të të dashurojë edhe më shumë. Nuk e she se ajo po vuan?

Mirani dhe Renata u shikuan. Asaj iu skuq fytyra. Ai u befasua. Asnjëri nuk po përgjigjej. Renatës i vinte vështirë të fliste, ndërsa Mirani nuk dëshironte të bisedohej për marrëdhëniet e tyre madje as nga Mihaeli, të cilin që të dy e kishin mik të ngushtë.

– Mihael, sado që të kemi mik të ngushtë, nuk të takon të diskutosh për marrëdhëniet tona. Pastaj, unë nuk po e refuzoj dashurinë e Renatës. Përkundrazi, po e respektoj. Unë po e frenoj dëshirën dhe dashurinë time. Arsyet i di Renata dhe nuk kemi nevojë t'i bëjmë publike, – shpjegoi Mirani.

Mirani shikoi Renatën, e cila vazhdonte të përskuqej.

– Edhe unë them se marrëdhëniet tona janë tepër personale dhe s'ka përse të merret me to i treti, qoftë ai edhe mik, siç të kemi ne ty, Mihael.

Mihaelit nuk i erdhi mirë nga reagimi i të dyve. Ndjeu keqardhje për këtë dhe mbeti një copë herë i heshtur.

Mirani, për ta thyer heshtjen që po zgjaste më tepër se sa ishte e përshtatshme, meqë druante mos heshtja po hapte hapësirën e mërzisë për Renatën, ngriti gotën me verë dhe tha me të qeshur të prajshëm:

– Të pimë këtë gjak të Krishtit dhe të urojmë begatinë e tavolinës me gjithë të mirat e Zotit!

– I kemi siguruar e përgatitur vetë dhe asgjë nuk na kanë dhuruar

Zoti dhe Djali i Tij, Jezusi. – u përgjigj Mihaeli me sarkazmë, por i gëzuar që Mirani ndërpreu heshtjen.

Heshtja megjithatë vazhdoi, derisa Mihaeli nuk duroi më.

– Nëse ju pengoj unë mund të iki?

– Jo, prania jote na ndihmon. – u përgjigj Mirani.

Renata nuk foli.

– E pra, s'po di ç'të flas.

– Nuk është e domosdoshme të flasim, – ndërhyri Renata. – Kjo natë të bën edhe të meditosh.

– Meditimin, pikërisht sonte, nuk e pëlqej. – tha Mihaeli. – Atëherë, propozoj që të marrësh flautën dhe të më shoqërosh mua.

– Se mos pengojmë njeri? – pyeti Mirani i merakosur.

Mihaeli zotëronte mrekullueshëm klarinetin, Renata flautën dhe shpesh ushtronin se bashku.

– Nuk pengojmë njeri, – u përgjigj Mihaeli, – sepse ne do të ekzekutojmë kompozime kishtare, nga ato që i shkojnë Krishtlindjes dhe konviktit ku në gjendemi.

– Në rregull, – u pajtua Renata, – por vetëm dy melodi.

Të dy u ngritën. Renata e kishte flautën në dhomë të Miranit. Dhomat ishin pranë njëra-tjetrës, përballë derës së kuzhinës. Luajtën prapshëm dy melodi, që Mirani, nuk e dinte se kush i kishte kompozuar dhe si quheshin, por i pëlqyen, sepse iu dukën tepër qetësuese dhe inspiruese për meditim. Pasi mbaruan melodinë e dytë, Renata dhe Mihaeli u shikuan nëse duhej të vazhdonin edhe më. Lanë instrumentët mbi tavolinën e gjatë. U ulën dhe morën gotat e verës.

Edhe Mirani mori të tijen dhe ngritën dolli, duke thënë që të tre në gjuhën shqipe formulën e urimit: „Gëzuar!”.

Për disa çaste mbretëroi heshtja meditative.

Miranit i iku mendja në Kosovë dhe po mendonte nëse shqiptarët katolikë atje kishin pasur mundësi të mbushnin tavolinat për këtë festë.

Renata kujtoi krenntimin që po bënte familja, për herë të parë pa praninë e saj. Ndërkohë ajo e kishte vënë dorën mbi dorë të Miranit.

Mihaeli po kërkonte me ngulm temën e radhës, meqë nuk i rrihej pa folur.

– Miran, nëse nuk më keqkupton, dëshiroj të të pyes diç, me që më ka mbetur edhe pak besim kristian, më shumë si shprehi se sa si besim fetar. Them që Renata është e informuar. Po edhe unë, si mik që jam, dëshiroj të di: Cilat janë motivet që të bëjnë kaq të përkushtuar dhe kaq energjik për Kosovën?

Renata i hapi më shumë se rëndom sytë e vockël të saj që u shfaqën nën vetullat e bukura dhe nën flokët e gështenjta, të prera drejt mbi vetulla. Më shumë ngjante me një franceze të ndjeshme, se sa me një gjermane, çfarë ishte në të vërtetë. Kjo pyetje e befasoi atë dhe iu shfaq kurshjtja për përgjigjen e Miranit. Asaj nuk i kishte shkuar ndërmend të bënte pyetje kaq të drejtpërdrejtë, ose më saktë, i kishte ardhur keq.

Mirani u zu ngusht, sepse ishte i bindur se miku Mihael nuk pyeti vetëm sa për të folur ose për ta provokuar, por sepse vërtet dëshironte të dinte më shumë për mikun e tij, të cilin e pyeste pothuajse çdo ditë për diçka të re dhe interesohej ta ndihmonte. Ai e kuptoi se ishte çasti të përgjigjej sinqerisht, duke e sqaruar atë, por njëkohësisht edhe Renatën.

– Janë shumë motive, Mihael, – nisi përgjigjen e mundimshme Mirani. – Ato janë të ndërlydhura, prandaj e kam të vështirë t'i zbërthej, që t'ju bëj të kuptueshme. Kryesorja, siç e dini, është se si pjesëtar i popullit të pushtuar, duhet të bëj diç. Secili pjesëtar i një populli të pushtuar, që ka qoftë edhe një grimcë të vetëdijes kombëtare e qytetare, duhet të përpiqet për çlirim nga pushtuesi. Këtë aktualisht nuk po e bëjnë shumica e pjesëtarëve të popullit tim. Ata po ndihen të pafuqishëm për të bërë luftën çlirimtare. Pushtuesi i ka frikësuar, lodhur e nënshtruar. Kjo, sigurisht, nuk e arsyeton mosangazhimin e atyre që kanë kurajo. Kështu

ka ndodhur në historitë e popujve të pushtur. Nismat e individëve shndërrohen në suksese, nëse ata angazhohen me përkushtim dhe nëse dinë t'i organizojnë aktivitetet e tyre. Nga dita në ditë ata do të gjejnë përkrahës, deri në kryengritjen çlirimtare. Siç e dini, për arsye ekonomike nuk jam arratisur, sado që jemi të varfër deri në skajshmëri. Ju nuk e merrni dot me mend. Isha disa muaj në Gjermani, në vitin 1972 të dajat në Erlangen. Bëra punë të rënda në ndërtimtari si gjashtëmbëdhjetëvjeçar dhe u ktheva. Atëherë m'u ofrua dokumentacioni i punësimit legal, si gastarbajter, për të qëndruar këtu. Pashë zhvillimin e këtushëm, shijova standardin dhe jetën e këtushme në liri. U ktheva, meqë doja të mbaroja shkollimin e mesëm dhe të vazhdoja studimet. Një motiv konkret është vetë jeta ime. Jemi njëmbëdhjetë vëllezër e motra. Këtë tashmë e dini. Nuk e dini se tre të mëdhenjtë i kam nga babai. Atyre u vdiq nëna pak muaj pasi lindi i treti, që tani është në Mülheim/Ruhr. Baba kishte mbi pesëdhjetë vjet kur u martua me nënën time pesëmbëdhjetëvjeçare. Ata nuk njiheshin. U bë martesë tradicionale, pa e pyetur nënën. Pesëmbëdhjetëvjeçarja e nusëruar duhej të rriste tre fëmijët e burrit, të punonte tokën, të gatonte me radhë me gra të tjera, sepse familja jonë e atëhershme kishte mbi pesëdhjetë anëtarë. Lindi fëmija i parë në moshën e saj gjashtëmbëdhjetëvjeçare, për të cilin dini se është jurist. Lindi pastaj binjakë, të cilët vdiqen nga sëmundja që nuk do të duhej të vdesin fëmijët, në mungesë të përkujdesjes së rëndomtë mjekësore. Më lindi mua të tretin, pa pasur mundësi të më pyeste nëse unë dëshiroja të lindja në ato rrethana, siç filozofove më parë ti, Mihael. Në dhjetor të vitit 1956, kur unë kisha gati një vit e gjysmë, policia serbe e arrestoi babanë. Më tregonin më vonë se e kishin lidhur për trup të kumbullës në oborr të stacionit të policisë. Në atë gjendje e kishin mbajtur dy ditë e net. Bënte acar i madh dhe ai pothuajse ishte ngrirë. Nuk e di si ka mundur ta mbijetojë atë torturë e tmerr. Duke qenë ai atje, unë kam rënë në zjarr, në oxhakun tonë të madh, ku gatuhet për rreth pesëdhjetë anëtarë. U

dogja i tëri, meqë në ato çaste nuk ishte askush në shtëpi. Më gjetën pastaj mish për hell. Çuditërisht e mbijetova atë tmerr. Nuk kishte mundësi mjekimi. Vite me radhë jam dergjur...

Mirani doli nga kuzhina dhe shkoi në dhomë. Atje qau me dënësë. Ishte vaji që vinte nga thellësia e kohërave si një lumë i nëndheshëm. Asnjëherë nuk u kishte folur për këto detaje. I vinte vështirë dhe druhej se nuk do ta besonin. Renata i shkoi prapa duke ia plasur vajit zëshëm. Në dhomë u mbërthyen ngrykas dhe po e shtrengoheshin duke u munduar ta qetësonin njëri-tjetrin. Kur u kthyen, gjetën Mihaelin me kokë mbi tavolinë. Edhe ai ishte mërziur.

Mirani mori gotën e verës, bëri një “Gëzuar!” dhe e piu me fund.

– E po, meqë e nisa, po e mbaroj me fund rrëfimin. Është një borxh imi. Të më falni për shpërthimin e pakontrollueshëm! – tha Mirani.

– Nuk ke përse kërkon falje, unë isha fajtori. – ndërhyri Mihaeli.

– ... në moshën katërmëdhjetëvjeçare isha pjesëmarrës në demonstratën që u bë në Pejë. Demonstrrohej për të drejtën e përdorimit të lirë të flamurit dhe të gjuhës kombëtare. Isha si ndihmës në organizim. Kur nisi demonstrata, klasa jonë kishte orën e fizikulturës dhe ishim në fushë të shkollës. Mësuesi ishte serb. Nxënësit e vitit të pestë ishin grumbulluar në oborr të shkollës dhe kishin nxjerrë flamurin e ndaluar për të demonstruar. Unë ika nga sporti, dhe u thashë shokëve të klasës të shkojmë klasë më klasë dhe të japin alarm të rrejshëm, kinse po digjej shkolla. Për pak minuta gjithë nxënësit, të alarmuar, dolën në oborr. Tashmë të gjithë nxënësit u nisëm drejt qendrës së qytetit. Ishte ditë e shtunë, ditë pazar. Qytetarët dhe fshatarët u bashkangjiten. U bëmë dhjetëra mijë demonstrues dhe policia nuk mund të shtypte demonstratën tonë. Ndodhën arrestime të mëdha. Meqë isha me moshë miturie dhe meqë nuk dinin kë të keqtrajtojnë më parë, shpëtova lehtë. Përfundova shkollën e mesme. Në vitin 1973 regjistrova studimet, degën e fizikës. Në nëntor të vitit 1975 bëmë një protestë spontane, trid-

hjetë studentë të grupit, kundër një profesori serb. Kishim bërë provim me shkrim tek ai profesor, bashkë me studentët serbë. Të gjithë kolegët serbë kishin kaluar, kurse mbi gjysma e shqiptarëve jo. Vërtetua se na kishte diskriminuar për shkak të urrejtjes se tij nacionaliste. Protesta spontane pastaj u quajt politike, nacionaliste. Në Fakultetin e Shkencave Natyrore u mbajtën një mori mbledhjesh të Lidhjes Komuniste dhe të Lidhjes së Rinisë Socialiste për të dënuar protestën. Ndërhynë edhe komitetet e partisë e të rinisë të Prishtinës e të Kosovës. Më akuzuan si organizator. Pas një akuze të tillë dihej se çfarë të priste. Para se të më burgosnin u arratisa.

Në gusht, siç e dini, isha ilegalisht në Kosovë. Rrezikova sepse, një mbesë imja, vajzë e re, më kishte shkruar një letër të shkurtër, në të cilën ishte edhe fjalja: “Eja se nuk po vdes dot pa të përqaftuar!”. E doja dhe më donte shumë. Ishte me leukimi. Vuajti disa vite dhe tani po priste vdekjen, por nuk vdiste dot, ngaqë dëshironte të më përqaftonte para vdekjes. Rrezikova t’ia plotësoja dëshirën. Shkova, e takova në Klinikën Universitare në Prishtinë. Aksidentalisht policia jugosllave mori vesh shkuarjen time. Munda t’i iki. Pasuan keqtrajtimet e dhuna ndaj familjes, madje në kundërshtim edhe me ligjet përkatëse në fuqi.

Ky është motivi dhe filli im i angazhimit për të nxitur kryengritjen çlirimtare. Ju tani mund të gjykoni për këto gjëra. Krahas vetëdijes politike dhe qytetare, sigurisht që ka ndikim edhe inati subjektiv për t’u hakmarrë. Tani nuk e di se kush me jep më shumë energji, ndërgjegjja për çlirim, apo inati për hakmarrje kundër pushtuesit që na e ka nxirë kaq shumë jetën.

Mirani mori frymë thellë. Kishte zbrazur emocionet dhe tani më shumë i interesonte reagimi i Renatës. Asaj ia kishte rezervuar qëkur këtë rrëfim dhe as vetë nuk po e dinte tani përse. Ajo vazhdonte t’i kishte sytë e skuqur dhe dukej e mbytur në dhëmbshuri. Edhe Mihaelit i

erdhi keq duke e pandehur veten fajtor që ishte bërë shkaktar i rrefimit emocional të Miranit. Pas situatës së nderë, ishte po Mihaeli që u hap duke ngritur doli për shëndetin e tij.

– Ne gjermanët e brezit të ri, që jetojmë në shoqëri të konsumit, – tha ai, – e kemi të vështirë të marrim me mend gjëra, gjendje dhe zhvillime të këtu. Ndaj nuk e përceptojmë as vullnetin dhe përkushtimin për t’u çliruar.

– Dhe jo vetëm kaq, – ndërhyri befas Renata duke iu drejtuar Miranit. – Ti sakrifikon vetën tënde përtej mundësive. Ndrydh dëshira e pasione, ndrydh egon deri në banalitet. Sa e sa herë kemi debatuar. E le prapa mësimin për kualifikimin dhe tërë ditën ndjek ligjerata në shumë fakultete që nuk kanë të bëjnë me orientimin tënd profesional. Këtu, siç e di, duhet diplomë për punësim dhe jo njohuri enciklopedike. Kohën tjetër e kalon në bibliotekë universitare duke lexuar për lëvizjet çlirimtare të popujve, për lëvizjen punëtore këtu e në shtete të tjera. Lexon histori të popujve, literaturë politike, sociologjike, filozofike. Pastaj shkon në bibliotekë të albanologjisë, lexon në gjuhën shqipe në kohën kur duhesh ta përsosësh gjermanishten. Mëson përmendësh vjersha e drama të Brecht, vjersha të Tucholsky, Erich Fried dhe i përkthen ato. Ti je tepër i shkapërderdhur si të të kishin rënë mbi supet e botës. Harron veten dhe refuzon kundër vullnetit dashurinë time. . .

– Unë po shkapërderdhem kaq shumë, siç thua ti, që t’i dal zot përcaktimit të këmbëngulës, ose siç thotë Mihaeli, me fanatizëm, meqë nuk mjafton vetëm të duash vendin dhe lirinë, por edhe të dish se si ta duash.

Renatën nuk e kënaqi përgjigja, ndaj sërish ia pati:

– ...dhe sikur nuk mjaftojnë të gjitha këto. Për çdo të premtë ti shkon në Dyzeldorf (Dyzeldorf), në Klub të bashkatdhetarëve dhe kthehesh të dielen pas mesnate. Sa herë hyp në tren pa biletë, të kapin konduktorët, sepse ke sedër të ndieshme për të më kërkuar të holla. Anga-

zhohesh në lëvizje politike të studentëve, këtu në universitet. Dhe, si të mos mjaftonin të gjitha këto, shpesh shpërndan natën reklama për të fituar pak para, financon vetë traktet, informatat deri edhe gazetën që keni filluar të nxirrni. Të vjen mëkat t'u kërkosh para bashkatdhetarëve, e të tjera. Këto janë fakte konkrete dhe mund të ndodh si në atë anekdotën që ma ke treguar sa herë, të rrëzohesh si deveja nga lëkura e lepurit.

– Njeriu nuk i ka dy kohë dhe dy jetë, – shtoi Miranin si në faj. – Unë kam zgjedhur përcaktimin tim dhe atij dua t'i shërbej me përkushtim. Mua më duhet t'ju informoj ju, gjermanëve, sepse qeveria juaj, edhe në emër tuajin, po përkrah qeverinë e Beogradit. Mua më duhet të merrem me bashkatdhetarët, sepse ata duhet të ndërgjegjësohen për luftën çlirimtare. Mua më duhet ta lexoj literaturën që përmende, sepse atë nuk e kisha në Kosovë. Mua më duhet të lexoj literaturën shqipe, sepse atë që e gjej në bibliotekë të albanologjisë këtu nuk e gjeja në Kosovë. Mua më duhet të përsos sidomos gjuhën shqipe, siç po mundohem ta përvetësoj gjermanishten, sepse më duhet që t'i përhap mendimet e mia e të tjera, e të tjera. Unë nuk mund t'u kërktoj para bashkatdhetarëve, sepse ata akoma nuk janë vetëdijësuar për t'i dhënë vetë për veprimtari çlirimtare. Ata vuajnë vetë, i fitojnë ato me vështirësi, i kursejnë me sakrificë për familjet e tyre në Kosovë. Unë nuk të kërktoj ty para për biletë e bukë, sepse... – përpak i ngeli fjala në fyt, – ...duhet të jem i pavarur dhe nuk dua lëmoshë. Më kupton!? Këto dhe të tjera janë edhe arsyet reale që më bëjnë ta frenoj dashurinë ndaj teje!? Mos po dyshon se unë jam aq naiv sa të mos i kuptoj këto gjëra?

– Të dy keni të drejtë, – ndërhyri Mihaeli, duke pasur durim të priste nëse Mirani do të vazhdonte. – Këto janë përmbajtje që nuk shtrrohen për një natë, qoftë kjo edhe nata e Krishtlindjes, kur thuhet se është bërë sakrifica deri në vetëmohim për t'i përhapur bindjet dhe idetë. Ju lutem, lini vend kohës t'i diskutoni pak e nga pak dhe mua më keni përherë në

dispozicion për bashkëbisedim, po patët nevojë!

– Të lumtë, Mihael! – iu drejtuar Mirani duke ngritur gotën me verë.

– Bëre propozim me vend, gëzuar, pra!

– Ndoshta e tepruam me hallet tona dhe të bezdisëm edhe ty, – ia ktheu Renata. Edhe ajo ndihej e lehtësuar se kishte shfaqur mendime që s’i kishte thënë herë tjetër. – Po afron koha për të fjetur, se mund të dehemi nga vera dhe pastaj do kemi dhimbje koke.

– Nuk prish punë. – tha Mirani. Na duhet ndonjëherë edhe dehja, nga se na i nxjerr ca gjëra që nuk i nxjerrim dot kur jemi esull. Për këtë ne kemi një proverb popullor: “Çfarë ruan stomaku, e nxjerrë bardaku”.

Të dy qeshen.

– Mirë, po vazhdojmë të pimë, por të mos harrojmë edhe të hamë se kemi bërë gjithë atë mund për t’i gatuar! – këshilloi Renata duke ngritur gotën dhe duke thënë në shqip “gëzuar”!

4.

Mirani e Bardhi ishin njohur në verën e vitit 1978, kur ky ishte për të punuar në qytetin e vogël gjerman, Plochingen. Ky qytet gjendej rreth 30 km. afër Shtutgartit. Mirani punonte në pushimet verore dhe dimërore semestrare, për të mbajtur vetën gjatë studimeve me bukë e libra. Qira nuk paguante, pasi kisha katolike ia kishte mundësuar banimin falas.

Asaj vere Mirani shkoi për punë në Plochingen, meqë atje ishte edhe dhëndri i tij. Puna ishte e rëndë. Sharritnin dhe përpunonin gurë mermeri për varre, po edhe për ndërtimtari.

Një të shtunë, kur mbaruan punën, dhëndri propozoi të vizitonin një bashkëatdhetar që banonte në periferi të asaj qyteze. Ai do ta kishte për vizitë punëtorin social, nga i cili mund të informoheshin për të drejtat e të huajve në Gjermani. Mirani shkoi me përtesë, meqë ishte i lodhur. Akoma nuk ishte ambientuar për punë të rënda fizike. Ai para-

pëlqeu të shtrihej pas pune në barakën e vogël, në oborrin e firmës, fshehur pas gurëve të mëdhenj të mermerit. Megjithatë, vendosi ta shoqëronte dhëndrin, të mos ia prishte qejfin.

Kur arritën, aty gjetën edhe një burrë të imët, por shumë të gjallë e simpatik, veshur shik. Gjatë përshëndetjes ai u prezentua: – Bardhosh Gërvalla. Mikpritësi qe kushëriri i tij.

Biseda e Bardhit i bëri përshtypje Miranit. Ishte bisedë e qartë, informative dhe dashamirëse. Në fillim Mirani kishte paragjykime për të, nga se dyshonte se mos ishte dërguar zyrtarisht nga Beogradi për shërbime spiunimi, kamufluar si punëtor social. Por, gjatë bisedës, iu daravitën mjegullat e dyshimit. Madje shumë shpejt Bardhi i hyri në zemër, gjë që nuk ishte në natyrën e Miranit.

Ndenjen rreth dy orë dhe në fund, kur po ndaheshin, ndërruan adresat. Bardhi propozoi që të shiheshin prapë para se Mirani të mbaronte pushimet, më saktësisht punën, sepse pastaj do të ishin larg që të takoheshin, kur Mirani do të kthehej në Bochum. Ai premtoi se do të vinte për vizitë në fundin e javës tjetër, në vendpunishte, meqë kishte makinë dhe i njihnte mirë ato anë. Madje u ngut të sqaronte se këtë do ta quante aktivitet social, në kuadër të punës për të cilën paguhej.

5.

Të premtën, rreth orës 17.00, siç kishte premtuar, Bardhi e gjeti Miranin mes gurëve të mermertë, duke u përgatitur të linte punën për atë ditë. Meqë baraka, siç i thonin, ishte e vogël sa një kotec pulash, pëlqyen të uleshin para hyrjes se saj. Nxoren përjashta tavolinën dhe karriget. Dhëndri i kishte treguar Miranit për Bardhin, para e pas takimit të parë se sa i sjellshëm dhe i përkushtueshëm ishte në informim e këshillime që bënte. Ngaqë e njihnte familjarisht, i kishte treguar se babanë e tij, po me emrin Bardhosh, ia kishin vrarë serbët, kur Bardhi ishte në bark të Nënës Ajshe. Për shkak të përndjekjeve dhe kushteve të këqija

për jetesë, ai, me nënë e vëllezër, ishin vendosur në Slloveni. Vetëm Jusufi kishte mbetur në Pejë, nën përkujdesje të dajave, meqë e donte shumë shkollimin.

Kur u rehatuan, dhëndri solli limonadë, pastaj kërkoi falje se do të shkonte në dyqan. Ky gjest fillimisht e befaso i Miranit, nga se një ditë përpara kishin bërë furnizimin me ushqim. Më vonë e kuptoi se dhëndri deshi t'i linte vetëm.

– Bërë mirë që nuk u prezantove zëshëm, kur ishim të kushëriri, – tha Bardhi, pas përshëndetjeve e pyetjeve të rëndomëta. – Atij nuk ia kam besën dhe mirë që nuk e diti tamam se cili je. U mjaftua me prezantimin që të bëri dhëndri, si mik i tij. Ndoshta mund ta kesh hetuar, unë nxitova të flisja që ai të mos kishte mundësi të të pyeste se nga je dhe i kujt je, siç pyesin rëndom shqiptarët në kurbet. Sapo dëgjova prezantimin tënd e mora me mend se cili je, ndaj nuk i lashë radhën e pyetjeve. Nga Jugosllavija na vjen buletini i brëndshëm informativ dhe aty kam gjetur të dhënat për ty.

– Vërtet qenke informuar! – ndërhyri Mirani pakësa me shpoti.

– Mos më keqkupto, informatat e tyre nuk i lexoj tekstualisht, – sqaroi Bardhi me qetësinë që e karakterizonte.

– Domethënë, siç na dilka, qenke nepunës zyrtar i Beogradit?! – vazhdoi tjetri, por me ironi.

– Unë jam punëtor social, ardhur këtu nga Sllovenia në mënyrë të rregullt, meqë plotësoja kushtet që kërkoheshin. Por, Beogradi, seç kishte një marrëveshje me punëdhënësin tim të këtushëm, të cilin e quajnë “Arbeiter Wohlfahrt”. Siç mund ta kuptosh, përfaqësohet do të thotë “mirëqenia e punëtorëve”. Në bazë të asaj marrëveshjeje unë, pos që kam status të punëtorit social këtu, jam njëkohësisht edhe punëtor social i Jugosllavisë, diçka ngjashëm me nepunësit e administratës së atjeshme shtetërore. Madje, edhe atje shteti jugosllav më jep një rrogë simbolike, pavarësisht se unë këtu paguhem nga gjermanët për të këshilluar emi-

grantët ekonomike nga Jugosllavija, të cilët në gjuhën zyrtare të atjeshme quhen “punëtorë të përkohshëm në botën e jashtme”.

– E përse gjithë ky informacion për statusin tënd? – pyeti Mirani pa të keq.

– Që ta kesh nga dorë e parë, pasi mund të ndodh të dëgjosh lloj–lloj llomotitjesh nga bashkatdhetarët. Ata me të drejtë dyshojnë ndaj çdo personi zyrtar nga Jugosllavia, sado që unë nuk jam tamam nëpunës i tyre dhe në varësi të tyre.

Bardhi fliste rrjedhshëm, sinqerisht dhe pa ndonjë ndruajtje e kompleks prej të dyshuari. Miranit po i vinte keq, meqë ngjante sikur Bardhi po i rrëfehej, prandaj ndërhyri që të mos vazhdonte me sqarime të tilla:

– Më vjen mirë që ra puna të njihemi dhe dëshiroj të mos përfundojë me kaq. Para meje nuk ke përse rrëfesh. Shumicën e nëpunësve shqiptarë në Kosovë e gjetiu në Jugosllavi i njoh si atdhetarë, sado që janë të indoktrinuar nga ideologjia komuniste jugosllave, e njohur si “titizëm”. Kështu na është sajuar një shtresë e privilegjuar, një Lidhje Komuniste e organizuar mirë, që ka bërë monopol vetëqeverisjen, ose vetadministrimin, siç i thonë në fjalorin ideologjik *a la titist*, por, në fakt, Lidhja e Komunistëve ushtron pushtet monist.

Në vazhdim Bardhi u interesua për studimet e Miranit, duke e uruar të kishte këmbë të mbarë, meqë, siç thoshte ai, nuk kishte dëgjuar të kishte ndonjë student tjetër shqiptar në Gjermani. Mirani e falënderoi duke i bërë me dije se kishte edhe një koleg nga Kosova që studionte mjekësi po në “Ruhr Universitet” në Bochum. Madje ai kishte ardhur në Gjermani si punëtor fizik, pa mbaruar as shkollë të mesme në Kosovë. Duke qenë minator, ai kishte mbaruar gjimnaz të natës dhe ishte regjistruar në studime. Tani po i përfundonte me sukses të shkëlqyeshëm.

Ndërkohë Bardhi hapi temën për literaturën në gjuhë shqipe, duke

bërë me dije se herëpashere merrte libra, të botuar në Tiranë, nga Hysni G., të cilin kolegët e thërrasin Vasil, meqë i përgjante shumë Vasil Shantos. Bile, Vasili i kishte dhënë edhe disa ekzemplarë të gazetës ilegale *Bashkimi*, të cilat i kishte përcjellë në Kosovë.

Me Vasilin, Mirani ishte njohur para disa javësh. Ai banonte në Esslingen, qytet buzë Shtutgartit, dhe njihej mirë me dhëndrin e Miranit. Vasili kishte shkuar disa herë për vizitë te Mirani në Plochingen. E kishte informuar për formimin e një grupimi ilegal, siç shpreheshin atëherë për organizime klandestine, të emërtuar *Grupi komunist Zëri i Kosovës* dhe se këtë Grup e drejtonte njëfarë Rezil Mejtepi. Vasili madje i kishte dhënë një trakt Miranit. I kishte kërkuar pastaj edhe disa ekzemplarë të gazetës „Bashkimi”, meqë ata të mëparshmit që i kishte marrë nga dhëndri i tij i kishte shpërndarë.

Edhe pse Bardhi informoi Miranin, se furnizohej nga Vasili me literaturë e materiale të ndaluara, ky nuk u ndje i provokuar. Bardhi mund ta dinte se ai së shpejti do të takohej me Vasilin.

– Do të komunikojmë dhe do të të dërgoj edhe ndonjë libër, që mund të mos e ketë pasur Vasili, – ia plotësoi kërkesën Mirani.

Ndërkohë u kthye dhëndri dhe ata ndërruan temën e bisedës, duke bërë sikur po flisnin për të drejtat si student dhe për të drejtat e „Gastarbeiter-ëve” (punëtorëve mysafirë), siç i quanin emigrantët ekonomikë në Gjermani, për të cilët Mirani thoshte se ata janë skllëvër të shoqërisë se industrializuar, të cilët shfrytëzohen nga shitësi, Jugosllavia, dhe blerësi, Gjermania.

Pas pak Bardhi kërkoi leje të shkonte se po i afrohej koha për të bërë muzikë në një lokal gjerman. Arsyetimi i erdhi i habitshëm Miranit, ndaj s’u durua:

– Për çfarë muzike e ke fjalën?

– Jam pjesëtar i një grupi muzikor gjerman, si kitarist dhe si këngëtar. Bëj muzikë që të fitoj të holla, pos pagës, sepse më duhet të ndihmoj nënën e vëllezërit.

Sapo shkoi ai, Mirani vazhdoi të rrinte ulur para derës se barakës duke biseduar me dhëndrin. Ai sërish po i fliste për Bardhin, për mirësjelljen dhe ndihmën që ai u ofronte Gastarbeiterve nga Kosova. Në barakë bënte shumë më nxehtë se përjashta kësaj buzëmbremjeje tashmë të freskët. Ndërkohë dhëndri shtroi darkën. Kishte blerë një pulë të pjekur në vetëshërbimin “Kaufhof”, ushqim shumë i preferuar nga Gastarbeiteret. Ndoshta pse ishte i gatshëm dhe në vendlindje nuk kishte pasur rast kurrë të hanin një gjysmë pule në një racion. Pa përfunduar së ngrëni erdhi Vasili.

– Ju bëfshin mirë ato që keni hëngër deri tani! – uroi ai me të qeshur, – ndërsa këto që nuk i keni hëngër hala, më takojnë mua.

Me të mbaruar se ngrëni, Vasili i propozoi Miranit që të merrte disa ekzemplarë të gazetës *Bashkimi* dhe të shkonin në disa *hajme*, siç u thonin konvikteve të punëtorëve edhe emigrantët shqiptarë. Atje do t’i shpërndajmë, – tha ai, dhe do kemi rast të bisedojmë me bashkatdhetarë.

– Vasil, – ndërhyri dhëndri, – shkoni në *hajme* ku nuk ju njohin, sepse kam frikë se do t’ju spiunojë ndonjëri dhe do ta pësoj edhe unë kur të shkoj për pushim në Kosovë. Dhëndri vazhdimisht ndihej i frikësuar për veprimtarinë e kumatit, Miranit dhe të Vasilit. Ai i këshillonte që të ruheshin, të mos e dinte njeri se Mirani punonte e banonte tek ai. Shpesh fliste për pësimet e bashkatdhetarëve nga UDB–ja, kur ata shkonin për pushime në Kosovë. Nga çafirat që po rrinë me ne, po informohen ata të UDB–së, – vazhdoi të arsyetonte frikën dhe këshillat e tij dhëndri. Sa bashkatdhetarë të mjerë kemi! Edhe pse janë rrogatarë dhe të shitur, nuk shikojnë hallet e tyre dhe, nëse nuk ua mban të punojnë për Kosovën, së paku të mos i spiunonin vëllezërit e tyre.

– Mos u merakos, ia kemi marrë dorën kësaj pune, – u mundua ta

qetësonte Vasili. Neve nuk na i dinë emrat e vërtetë dhe nuk na njohin.

6.

Vasili kishte një makinë tepër të vjetër. Ndonjëherë tallej: “Po më duket ky kerr si me qenë një gjallesë, sepse po i kupton hallet tona. Prandaj nuk po na le në rrugë edhe pse e ka hëngër të vetën.”

U nisën për qytezën e Siendelfingen-it, vendlindjen e “Mercedesit”, pasi i futën ekzemplarët e *Bashkimit* në makinë. Gjatë rrugës Vasili i shpjegonte Miranit se në fabrikën e Mercedesit në Siendelfingen punonin qindra bashkatdhetarë, banojnë në hajme, që ngjatin me konviktet e studentëve në Prishtinë, të ndërtuara në oborr të fabrikës enkas për punëtorë të huaj, të cilët nuk i kanë familjet me vete.

Kur po i afroreshin Siendelfingen-it, qytezë në periferi të Shtutgartit, Vasili i propozoi Miranit që të shkonte në konvikte për të shpërndarë *Bashkimin*, meqë atë e njihnin disa bashkatdhetarë. Ai i tregoi disa numra të dhomave dhe disa emra, duke sqaruar se ndonjëri nga ata do t’ia tregojë edhe dhomat e të tjerëve. Për sa kohë që Mirani do të shpërndante gazetën, Vasili do të priste në parking.

Gjatë shpërndarjes, ndoshta në dhomën 205, Mirani hasi në një qeros biond, sykaltër. Sy me maje iu dukën atij. Edhe pse ishin shumë veta, siç praktikonin shpesh të shkonin të njëri-tjetri, Nuriu, të cilit Mirani ia vuri nofken “qeros”, e mirëpriti gazetën me fjalë të bujshme:

– Ju lumtë patriotë, kështu duhet të veproni, se shpejt kemi për t’ia qi nanën Jugosllavisë! Këta të mjerë nuk guxojnë ta lexojnë, se duan t’i ruajnë pasaportat e kuqe që ua ka dhënë Tito.

Të pranishmit nuk bënë zë. Nuriu e mori Miranin në përqaqim, e shtrëngoi aq shumë sa gati ia zuri frymën, si të qenë shumë të dashur që s’ishin parë prej kohësh. I ofroi një karrige për t’u ulur. Nuriu nuk po pushonte së foluri. U prezantua me emrin Nuri Syleviqi, nga rrethi i Kumanovës. Pothuajse në formë urdhërese, kërkoi që herave të tjera t’ia

jepnin atij gazetën për ta shpërndarë. Po në mënyrë pompoze u interesua për t'u anëtarësuar në Organizatën ilegale – Fronit i Kuq Popullor, meqë gazetën *Bashkimi* e botonte kjo organizatë. Aty për aty ia zgjati Miranit një letërzë, të cilën sapo e grisi nga blloku që nxori prej xhepit, shënoi të gjitha të dhënat e tij personale, dhe tha:

– Ju lutem, më bëni librezën e anëtarësisë.

– Nuk e di kush e bën këtë punë, – u përgjigj Mirani duke refuzuar copëletren dhe duke sqaruar se gazeta atij i kishte shkuar me postë, pa adresë të dërguesit.

Nuriu u interesua ta njihnte Miranin, nga ishte, ku punonte. Ky nuk iu përgjigj saktë, meqë Nuriu iu bë i bezdisshëm. Mori leje të ikte, po ngjitas me të u nis edhe njëri nga më të rinjtë.

Kur Mirani po zbriste shkallëve, fare pranë dëgjoji të riun t'i fliste:

– Ju këshilloi të mos i dërgoni gazeta Nuriut, tullacit, siç e thërrasim ne këtu, sepse ai i hedh në plehëra dhe vetëm ndonjë ia jep atij që ia ka marrë inat personalisht, për ta denoncuar pastaj.

Zëri i djalit vinte gjithnjë me ndrojtje.

– Pse nuk i the këto sa ishim në dhomë, në prani të tij? – e pyeti Mirani pakësa i befusuar, meqë nuk i pëlqenin sjelljet e tilla.

– Nuk guxoj, më duhet ta ruaj edhe ca atë pasaportën e Titos, siç e quajti Nuriu. – u përgjigj i panjohuri dhe u nda nga Mirani pa ia treguar as emrin dhe pa u përshëndetur. Bëri sikur po futej në një dhomë tjetër në katin e radhës, me dro se mos po e shihte ndonjëri duke folur me gazetashpërndarësin.

Kur Mirani u kthye në parking, Vasilin e gjeti në gjumë, lodhur e këputur nga puna që bënte në fabrikën e montimit të televizorëve. Mirani i tregoi Vasilit për rastin e Nuriut. Edhe ai u pajtua që këtej e tutje ta quanin Qeros dhe jo Nuri. Vasili e njihnte prej kohësh dhe tha se nuk qe mirë që ai e paska parë.

– E pra nuk u deshka të shpërndajmë më gazeta e trakte në ato kon-

vikte, sepse rrezikojmë bashkatdhetarët!? – hamendësoi Mirani.

– T’i shpërndajmë na duhet gjithsesi, por duhet të gjejmë mënyrën që ai të mos na hetojë.

– Ai ma ofroi një si kërkesë për anëtarësim. – plotësoi Mirani.

– Spiuni, është anëtarësuar edhe në Grupin tonë. Vërtetë deshka dajak.

– Nuk kemi ndrequr gjë me dajak. Këtu jemi në dhe të huaj dhe na duhet të respektojmë rregullat e vendit ku jemi. Nuk duhet të komprometohemi si të dhunshëm. Pastaj, përse duhet ndëshkuar me dhunë një mjeranë të tillë, i cili, për shkak të vetëdijes se ulët sociale e kombëtare, spiunon kolegët e tij?

– Mirë pra, do të flas me bashkatdhetarë të tjerë aty, se si do të mund ta diskreditojmë e izolojmë këtë Nuriun, që të mos mund t’i spiunojë bashkëbanuesit e interesuar për materiale tona informative e propagandistike.

Gjatë rrugëtimit Vasili propozoi të shkonin në Shtutgart për ta takuar Bardhin. Ai e dinte ku bënte muzikë. Shkuan te një lokal buzë Sheshit qendror. Lokali kishte nxjerrë tavolinat përjashta. Aty gjeten Grupin e Bardhit. Ai i vuri re dhe iu dha një përshëndetje me buzëqeshje. Pas dy këngëve u paralajmërua pauza dhe Bardhi iu dëshiroi mirëseardhje. Vasili bëri ca shakara me të, meqë praktikonte të shgarej në gjermanishten që flisnin gastarbeiterët turq. Pas pak minutave Bardhit iu desh të ngrihej. Vasili ia zgjati një pako të mbështjellë me gazetë. Ai e mori dhe u përshëndet.

Duke u larguar, Martini e pyeti Vasilin se ç’kishte në atë pako?

– Pesë ekzemplarë të librit “Imperializmi dhe revolucioni” te Enver Hoxhës, të cilat i kam marrë në Ambasadën shqiptare në Vjenë, – u përgjigj tjetri, duke sqaruar se Bardhi ia kishte kërkuar për t’i dërguar në Kosovë. Bile, i kishte kërkuar më shumë, por Vasilin nuk i kishin ngelur

më. Pastaj tregoi se si kishte dërguar vetë libra e gazeta në Kosovë.

– Marrë televizorë të vjetër, ua heq të gjitha pjesët, ua thyej ekranin për të krijuar hapësirë, ngjyrosi gjamin e jashtëm me ngjyrë të përhimtë, i mbush me material me peshë të njëjtë që ka televizori dhe ashtu i dërgoj në Kosovë, duke i paraqitur në doganën jugosllave për t'i zhdoganuar si televizorë të vjetër.

– Nuk të zbulojnë?

– Zbulohen vetëm frikacakët, sepse i bëjnë të dyshojnë doganierët që t'i kontrollojnë detajisht. Frikacakët e shfaqin frikën në fytyrë dhe doganierët janë të stërvitur t'ua lexojnë atë.

Ora, thellë natës shënonte 23.00. Vasili e la Miranin te baraka e dhëndrit dhe iku.

7.

Të premten tjetër, rreth orës 17.30, Vasili shkoi prapë te Mirani. Si me tallje, në gjermanishten e tij me miksturë turke, shfaqti dyshimin se mos po bëhej i bezdisshëm. Mirani e këshilloi të mos kishte të tillë siklet, meqë Vasili i ishte bërë shumë i dashur dhe i admiruar si veprimtar të përkushtuar. Nuk ia pëlqente shakatë që bënte për veten e tij, prirë nga kompleksimi i inferioritetit se nuk ishte i shkolluar. Vasili e thoshte shpesh: “Kam kryer katër klasë fillore, plus katër vite bari delesh dhe, pos këtyre, edhe kollën e fruthin.” Ai vërtetë nuk ishte i shkolluar, por për të lexuar kishte lexuar dhe lexonte shumë. Më shumë se shumë të diplomuar në fakultete. Lexonte të paktën një libër në javë, sado që bënte punë të rëndë dhe punonte me orar të zgjatur. Sa herë takoheshin, ia shpjegonte këtij përmbajtjen e librit të fundit, gjatë e rrjedhshëm. Madje i fliste edhe për mesazhin, pasi, siç thoshte ai, librat nuk shkruhen vetëm sa për t'u shkruar, por kanë brënda mesazh përkatës dhe kryesisht nga ai varet edhe cilësia e librit.

Kësaj radhe shkuan në qytetin ku jetonte Vasili, dhe ai i kërkoi të falur

dhëndrit se sonte nuk do ta kthente për të fjetur aty.

Në qytetin e Esslingen-it, ata zunë vend në një ëmbëltore, porositën kafe dhe tortë. Mirani ia kishte kuptuar huqin e të nguruarit për të qarë ndonjë hall që e mundonte. Edhe kësaj radhe Vasili i la përshtypjen se kishte një hall. Për të heshtur, nuk i heshtte, meqë ishte gojëtar. Brënda ngurimit të tij hyri Mirani:

– Si i keni hallet në Grupin tuaj?

Vasili mezi kishte pritur këtë pyetje, pasi aty e kishte pasur hallin, por bëri një parahyrje.

– Do të të tregoj vetëm nëse nuk më ndërhyt. Po e bëjmë një bander unë, (kështu i thoshte ai shtyllës se telefonit), një ti, pasi ju të shkolluarit nuk keni durim të na dëgjoni në analfabetëve.

– Foll – ndërhyri padurueshëm Mirani.

– S’di nga t’ia filloj, meqë kam shumë për të qarë hall. Në Grupimin tonë nuk i kemi punët mirë. Të pata treguar se Kryetar Grupi kemi Rezil Mejtepin. Ai tani është i ballafaquar me vështirësi të mëdha. Gjermanët kanë ndërmend ta përzënë për shkak se ka hyrë në borxh të madh në bankë. Bile, ia kanë prishur pasaportën me një vulosje të madhe. Tani ka afat vetëm dy javë: o të paguajë dyzetë mijë marka të borxhit, o ikul.

Pushoi me ndjenjën e hallemadhit. Për momentin as ai dhe as shokët e Grupit nuk kishin mundësi t’ia paguanin atë borxh.

– Kaq ishte shtylla jote? Tani duhet ta ketë radhën shtylla ime, – tha Mirani me të qeshur të prajshëm.

– Po, po, urdhëro, më këshillo çfarë të bëjmë!?

– Përse i është dashur të huazojë dyzetë mijë marka, nëse vërtet i ka huazuar?

– Domethënë, ti nuk po më beson! – u habit Vasili.

– Ty po të besoj se po tregon çfarë të ka thënë Kryetari Rezil, por nuk po besoj për ato që ka thënë ai. E para, ti ke thënë se ai punon në fabrikë të “Coca-colas”; pastaj ke thënë se nuk është në punë; një herë

tjetër ke thënë se nuk e di nëse është ose nuk është në punë. Bile, për këtë dyshim, ke treguar se je munduar taurvejosh, por ke dështuar. Pra, ti tani tregon për ato që t'i ka thënë njeriu për të cilin ke filluar të dyshosh. Unë po t'i tregoj në konfidencë ca gjëra që i kam dëgjuar nga një student kroat: Rezilin e paskësh ther me thikë në shpatull një i ri kroat, pjesëtarë i lëvizjes se ustashëve, siç i thonë lëvizjes nacionale kroate në ekzil. Ka ndodhur kjo, pasi Rezili, duke qëndruar në oborr të një kishe gjermane në Shtutgart, ku i bëjnë meshat kroatët, i është qasur një kroat me gazetën "Nova Hrvatska" (Kroacia e re) në dorë dhe ia ka ofruar atij. Ky farë Rezili i është përgjigjur: "Ç'më duhet ajo paçavurë gënjeshtarë e armiqësore, kur unë lexoj këtë gazetë të vërtetë! Me atë rast Rezili ka ngritur gazetën e Beogradit "Novosti". Kroati i ofenduar ka nxjerrë thikën e ia ka futur në shpatull, meqë Rezili ka provuar të iki. Pastaj ka përfunduar në spital me ndihmë të shpejtë. Në spital i ka shkuar ditë për ditë konsulli jugosllav duke e përgëzuar për patriotizmin e tij jugo-sllav...

– A thua, të jenë të vërteta këto që po më dëgjojnë veshët? – pyeti Vasili i habitur dhe me një pamje tepër serioze.

– Pse duhet të ketë pasur arsye të më gënjejë studenti kroat? Më ka treguar fare spontanisht, me keqardhje, si ngjarje që kishte ndodhur para disa viteve. Kur ai më ka treguar, nuk ka pasur mundësi të parashikonte problemin dhe relatat që tani po i diskutojmë.

Mirani ia tha Vasilit këto me qetësi të madhe dhe me merak, se sqarimi i tij nuk duhej të nxiste ndonjë dyshim për xhelozin, garën e diç të ngjashme, por vetëm si merak, që ndaj Rezilit duhet shtuar kujdesi, meqë mund të dëmtonte bashkatdhetarët e interesuar për veprimtari kombëtare.

– Por, si t'ia bëjmë hallit tani për kërcënimin që i bëjnë gjermanët për shkak të borxhit ndaj bankës? – vazhdoi Vasili.

– Di ti përse duhet t'i ketë borxh bankës Rezili?

– I ka huazuar për veprimtari patriotike. Meqë ne që jemi të orgnizuar në këtë Grup, nuk kishim të holla të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet që kërkon veprimtaria jonë kombëtare. Ta zëmë, para disa ditësh, u dëshen tetëmijë marka për të shtypur traktin që kemi shpërndarë. Ne nuk i kishim, ndaj Rezili i huazoi në bankë.

– Tetë mijë marka për të shtypur një trakt?!

– Po, tetë mijë na ka kushtuar, – u përgjegj ai me sigurinë që e karakterizonte.

– Sa ekzemplarë i keni bërë, edhe pse ai nuk ishte i shumëzuar, por i fotokopjuar për ibret?

– Rezili na ka informuar se i ka bërë dhjetë mijë copë.

– E ka shoqëruar ndokush kur ka bërë shumëzimin dhe pagesën e tyre dhe, di ti, ku i ka shumëzuar?

– Nuk i di këto që po më pyet, por edhe të dyshosh në këtë farë soji nuk ke nevojë.

– Atëherë po të informojë, se për të shumëzuar dhjetë mijë trakte të atij niveli duhet paguar të shumtën 400–500 marka.

Vasilit nisi t'i ndërronte qehrja, sepse kishte krijuar aq shumë besim ndaj Rezilit, sa nuk linte hapësirë për të dyshuar në Kryetarin e tij. Nga kënaqësia se Rezili kishte marrë iniciativën për të formuar një grupim veprimtarësh patriotë, Vasili dukej se kishte formuar një besim naiv ndaj tij.

– Meqë janë shumëzuar dhjetë mijë copë, ku duhet t'i keni shpërndarë? – pyeti sa për të thyer heshtjen. Ai pati drojën se mos po keqkuptoj duke kaluar masën e shpjegimeve dhe të argumentimeve kundër këtyre sjelljeve të Rezilit.

– Tani po të përgjigjem: Nuk e di, por Rezili ashtu na ka informuar kur kemi mbajtur mbledhjen. Unë i kam shpërndarë vetëm 500 copë, Maksi 200 copë, për të tjerët nuk di gjë, pasi kemi formën e organizimit në 3–she.

– Domethënë, ai duhet të ketë bërë e shumta njëmijë copë, sepse po të kishin qenë dhjetë mijë, do të kishte rënë në sy shpërndarja e tyre. Në rrethin tonë, në krahinat e Rajnit dhe të Rurit, ku gjenden dhjetëra mijë bashkatdhetarë, nuk ka rënë fare në sy ky trakt.

Për një moment heshten të dy. Miranit po i dukej i mjaftueshëm shpjegimi dhe interesohej të mësonte nëse Vasili e kishte kuptuar siç ishte përpjekur ta sqaronte, apo ndoshta e kishte keqkuptuar. Ndërkohë, meqë heshtja u shtri ngeshëm ndërmjet tyre, Mirani e pa të arsyeshme ta pyeste:

– Kemi mundësi ta takojmë Rezilin dhe të bisedojmë me të?

– Sigurisht që kemi këtë mundësi, por mos do të keqkuptohem si dekonspirues!? – u përgjigj Vasili.

– Nëse do ta gjes, takohemi dhe unë po shtirem sikur nuk di gjë. Ti e hap bisedën, sikur të ishte bisedë e rastit.

– Çfarë mendon se duhet t'i them kur t'i propozoj për këtë takim? – pyeti Vasili.

– I thuaj, Mirani ka ardhur. E kam parë mbrëmë dhe dëshiron të takohet për të biseduar për bashkëpunim të organizimeve tona.

Vasili po shfaqte interesim të vëmendshëm, me pamje serioze, duke i lënë vetes kohë, pas dëgjimit të kujdesshëm, t'i pëshonte mendimet.

– Mirë, ashtu do të veprojmë dhe besoj se do të jetë takim sqarues me rëndësi.

Pas dakordimit ai i bëri shenjë kamerierit, duke i kërkuar mendimin Miranit për të pirë edhe diçka, apo për të paguar?

– Si të duash. – ia pati tjetri.

– Atëherë po marrim edhe nga një lëng portokalli

Me Vasilin Mirani nuk mërzitej të rrinte sado gjatë. Kishte krijuar admirim të madh për natyrshmërinë e gatishmërinë e tij për veprimtari të përkushtuar patriotike. Pos në Shtutgart, kishte dëgjuar edhe në Nürnberg e Mynhen/Mynih (Mynhen), që ai bashkë me Maksin, organi-

zonin shfaqje të filmave shqiptarë, shpërndanin literaturë e gazeta shqiptare. Filmat dhe literaturën i merrnin kryesisht nga Partia Komuniste Gjermane-Marksiste-Leniniste, e cila furnizohej me literaturë e filma nga Republika e Shqipërisë. Ndonjëherë Vasili e Maksi furnizoheshin edhe nga Ambasada Shqiptare në Vjenë.

Ndërkohë Vasili ndërroi temën e bisedës:

– A mund të di gjë për organizimin tuaj, nëse më lejohet të të pyes?

Pyetja e tij e befasoi Miranin, meqë mbante mend se Vasili disa herë i kishte folur për organizim klandestin, se kureshtja për të ditur çka nuk të takon për këtë organizim konspirativ, e dëmton atë, duke përdorur citate nga veprat e Enver Hoxhës, që ua dinte edhe faqen dhe numrin e veprës. Ndonjë libër tjetër politik dhe ideologjik të autorëve joshqiptarë nuk kishte lexuar dhe nuk lexonte, pos romaneve të shumta.

– Sigurisht mund të dish, pasi organizimi ynë nuk është aq konspirativ, sa të detyrohem të përmbahem pa të treguar. – tha Mirani, duke menduar se vazhdimi i bisedës ishte parapërgatitje e mirë për takimin e nesërm.

– Organizimi ynë fillimisht, në shtator të viti 1978, zuri fill si tepër konspirativ. Tubimin themelues e mbajtëm në dhomën time në konvikt. Ndërkohë e shndërruam në organizim popullor, siç do ta karakterizojë. Ishim katër veta kur themeluam Frontin e Kuq Popullor. Miratuam Program e Statut. Asnjëri nga ne nuk e njilhte anën teorike të këtij organizimi, prandaj unë e luta një profesor gjerman që të na ndihmonte për përpilimin e këtyre materialeve. Ai profesor ka bindje majtiste, për të mos thënë se e kamuflon përcaktimin e tij prej komunisti, por nuk është i organizuar, sepse ligji gjerman nuk lejon të japin mësim në shkolla e fakulte anëtarët e ndonjë partie komuniste. Profesori i përpunoi projektet, programin dhe statutin që i pata formuluar unë. Unë i përktheva dhe ato i miratuam. Emrat e bashkëthemeluesve mund të t'i tregoj, pasi më vonë vendosem të mos jemi konspirativë. Po t'i them emrat dhe

pseudonimet: Proletari, me pseudonim “Shpati”, që jeton në Velbert, Xhahili, me pseudonim “Xhavit”, thotë se jeton në Bielefeld, dhe Isa, pa pseudonim, i cili jeton në Bochum. Dy të parët kanë mbaruar shollë të mesme, siç kanë thënë, ndërsa Isa, vetëm shkollën 8-vjeçare. Proletarin e kam njohur në ligjërata të gjuhës shqipe, që në këtë universitet i mban albanologu markant kroat nga Janjeva e Kosovës, Prof. Dr. Lazar Dodiç. Proletari nuk kishte ditur për këto ligjërata, por e kishte informuar dhe marrë me vete, po një kroat me banim në Wuppertal. E quanin Vinko K., i njohur nga “Pranvera kroate” e vitit 1971. Kroati Vinko ishte komunist dhe ithtar i flaktë i Enver Hoxhës. Mu për këtë, ai kishte filluar të mësonte gjuhën shqipe te Prof. Dodiç. Për këtë mundësi ai i kishte treguar Proletarit, me të cilin shoqërohej, dhe e kishte marrë një ditë me vete për të na njoftuar. Kurse Proletari e kishte njohur Xhahilin në një tubim të PKGj/M-L dhe kështu ndodhi njohja midis nesh. Isën e kisha njohur vetë, meqë e kisha komshi.

Më vonë vendosëm për organizim legal, me bashkatdhetarë të tjerë, duke anashkaluar Xhavitin, meqë për te krijova përshtypje se ishte informator i UDB-së, i urdhëruar për t’u anëtarësuar në PKGj/M-L, që të informonte për veprimtarinë e kësaj partie komuniste sigurimet e fshehta jugoslave dhe gjermane. Kurse për Proletarin formova përshtypjen se ishte një dogmat primitiv. Ky nuk na linte të mbanim as mbledhje, meqë sajonte ca rregulla strikte “komuniste” dhe na bezdiste me citime të klasikëve të komunizmit, pa rend e pa vend, vetëm për të imponohej si teoricien i asaj doktrine. Isa ishte njeri i urtë.

Ndërkohë mbledhjet e përjavshme filluan të më bezdisin, meqë mblidheshim sa për t’i bërë qejfin vetes dhe për t’i shitur mend njëritjetrit. Pas dy-tre muajsh shpjegova se nuk kisha kohë të merrem më me këtë organizim dhe i luta të më lironin. Veprova kështu, kryesisht për faktin se Xhahili insistonte të shtininim anëtarësimin tonë sa më shpejt edhe në Kosovë. Për këtë propozonte të përgatitja formular për

anëtarësim. Pastaj, nuk dinte të përmbahej nga të pyeturit, se nga sa veta kishim anëtarësuar në Gjermani dhe cilët ishin ata. Për vete arsyetohej se nuk kishte anëtarësuar asnjë bashkatdhetarë, meqë ishte i zënë me angazhim të madh në kuadër të PKGj/M-L, për të bërë revolucionin proletar në Gjermani.

Pasi u ndava prej tyre, vazhdova veprimtarinë krejt ndryshe. U mbusha mend se për atë formë të organizimit nuk gjendeshin bashkatdhetarë të gatshëm dhe, edhe sikur të gjendeshin, mendova se do të rrezikoheshin kot se koti me anëtarësim formal, duke sajuar prova që do të mund t'i binin në dorë UDB-së dhe ata do ta pësonin pastaj me rend, kur në procese gjyqësore të tyre do të paraqitej, ta zëmë prova e anëtarësimit.

Meqë u përcaktova për organizim ndryshe, siç ta thashë, një si organizim popullor, u interesova të gjejë bashkatdhetarë patriotë, të cilët do të ndihmonin për nxjerrjen e gazetës *Bashkimi*. Këta të interesuar duhej se pari të mësonin që të lexonin, meqë ishin gjysmanalfabetë. Doemos duhej një ngritje për organizim më vonë.

Nëse nuk je mërziur, po të tregoj edhe gjëra të tjera.

– Të lutem, vazhdoje! – u përgjigj Vasili me një përqendrimin maksimal për të dëgjuar.

– ...sa për emërtimin, në tubimin themelues, unë pata propozuar ta quanim “Fronti Popullor Demokratik”, meqë më pëlqente emërtimi i përafërt i organizimit të masave në Republikën e Shqipërisë, i cili, siç e di edhe ti, quhet Fronti Demokratik. Unë i shtova “popullor” vetëm sa për të bërë dallim me atë emërtim. Xhahili propozoi ta emërtonim “Fronti i Kuq”, duke arsyetuar se duhet të ndjekim shembullin e organizatave çlirimtare “Brigada Rosa”, “Rote Army Fraktion”, etj. Proletari propozonte ta quanim “Partia Komuniste e Kosovës/Marksiste-Leniniste”, duke arsyetuar se vetëm komunistët mund të bëjnë revolucion të vërtetë proletar. Isa ishte çdo herë për ato që thosha unë, meqë thuaja

përditë, pas pune, vinte tek unë për të kaluar kohën e lirë. Kur votuam ishim dy me dy. Meqë Proletari hoqi dorë nga propozimi i tij dhe përkrahu propozimin e Xhahilit, duke ia shtuar atij mbiemrin “populor”.

Për të fituar varianti i tyre, Proletari përdori demagogjinë, duke thënë se ju intelektualët nënçmoni proletariatin. Them demagogjinë, sepse më drejtohej mua, e unë isha vetëm një student. Me këtë demagogji të Proletarit, ata dolën fitues, sado që edhe unë pavullnetshëm u dakordova me propozimin e tyre. Edhe tani mendoj se emri që kemi miratuar është tepër bombastik e provokues. Ishim vetëm katër veta që nuk njihim mirë njëri-tjetrin, që nuk na përputheshin idetë, të papërvojë dhe të padije për organizim të këtillë. Sigurisht, po kaq bombastik ishte edhe emërtimi që pata propozuar unë, por jo edhe aq provokues për organet përkatëse gjermane.

Tani nuk po anëtarësojmë bashkatdhetarë, por po merremi me takime të thjeshta informative, ku lexojmë bashkarisht artikuj, kryesisht nga revista “Ylli” dhe “Shqipëria e re”, ku jemi abonuar dhe vijmë nga Tirana. Pastaj ndonjë artikull interesant të “Rilindjes”. Bisedojmë për gjendjen në Kosovë dhe nevojën për një luftë çlirimtare kundër pushtimit jugosllav. Bisedojmë edhe për gjendjen mjeruese të emigracionit ekonomik dhe mundësitë e tij për të ndihmuar luftën çlirimtare, e të tjera. Dhe i gjithë ky aktivitet epiqendrën e ka në Dyzeldorf, meqë aty është emigracioni më i madh. Kjo mënyrë e angazhimit legal të bashkatdhetarëve duket se po jep rezultat më të mirë, se sa mënyra e organizimit konspirativ, të cilit njerëzit po i frikësohen shumë, sidomos kur kërkohet anëtarësimi i tyre. Ja kaq, mos e teprova gjë?

Vasili nuk bëzani. Dukej se po përpunonte ato që kishte dëgjuar. Pas disa çastesh shtoi:

– Po më habit. Unë kisha shpresën se organizimi juaj është shumë më i fortë se yni. Kur m’i ka dhënë dhëndri yt 50 ekzemplarë të gazetës

Bashkimi, unë kam shpresuar se ju jeni shumë të fuqishëm, pasi gazeta juaj ia kalonte shumë herë traktit tonë.

Habia e tij e bëri Miranin të mendohej se mos ndoshta pa dashur e kishte zhgënjyer Vasilin.

– Vasil, nuk kemi përse ta mashtrojmë veten dhe njëri–tjetrin. Sa herë e kemi përjetuar se sa frikë po kanë bashkatdhetarët të marrin gazeta e trakte nga ne. Pastaj, edhe kur i marrin ose kur ua japim, shumica nuk dinë t’i lexojnë. Besoj më kupton, nuk mund të korrim pa mbjellë. Duhet të bëhemi realist, t’i njohim mundësitë e aftësitë tona. Edhe Gazeta „Bashkimi”, që ti thua se të ka bërë përshtypje të madhe, ka nivel mesatar, është sajuar me shkrime të huazuara, pasi vetë nuk dimë të shkruajmë. Nga Kosova nuk kemi gjetur lidhje që të na dërgojnë shkrime. Numri i parë është shtypur në tre mijë ekzemplarë. Një mijë i kemi dërguar në Kosovë, dy mijë mezi i kemi shpërndarë në Gjermani, Belgjikë e Francë. Shtypshkronja na ka kërkuar vetëm 300 marka. Besoj, mjafton për fuqinë që kemi, të bëjmë të paktën një këso veprimtarie simbolike, që i shtyn bashkatdhetarët të mendojnë. Unë nuk besoj se ju keni nivel më serioz. Këtë po ta them në bazë të traktit që kam lexuar.

– Po më flet sikur të ishe i organizuar me ne, – ia ndërpreu bisedën Vasili, gjë që nuk e praktikonte. – Organizimi ynë ka filluar ndryshe. Para 5–6 muajve na ka thirrur Shoku Rezil Mejtepi mua dhe Maksin, na ka informuar për Grupin që kishte formuar. Vetën kishte caktuar për Kryetar, mua për Nënkyetar, kurse Maksin për Sekretar. Na ka bindur që të plotësojmë formularët që kishte përpiluar, (ai i quante formularë anëtarësimi) njëherit na ka dhënë edhe një si rregullore. Pastaj na ka bindur se ne nuk duhet ta pyesim për Grupin, meqë nuk lejon konspiracioni që zbatohet me rigorizitet gjatë organizimit ilegal. Pos këtyre, na ka caktuar anëtarësinë bazë prej njëqind markave në muaj. Të tjerat duhet t’i japim vullnetarisht, sipas nevojës së veprimtarisë. Thënë të drejtën, – vazhdoi Vasili, – po më detyron të mendohem mirë dhe sonte

nuk do të më marrë gjumi. Ne qemë gëzuar kur Rezili na organizoi dhe prej atëherë i përgjigjemi për çdo gjë që kërkon prej nesh. Madje, që atëherë nuk kemi dërguar të holla në familje. Të gjitha ia japim Rezilit, ngase na i kërkon, se ka udhëtime, se po e ndihmon organizimin ilegal në Kosovë...

– Besoj se biseduam mjaft për sonte. – E ndërpreu Mirani me ndjenjë keqardhjeje. Ai qëkur kishte dyshimin se Rezili ishte një xhahil. Ndoshta edhe më xhahil se Xhahili që kishte rastisur të bashkorganizohej në Front.

Pa as më të voglin kundërshtim, Vasili thirri kamarierin, pagoi dhe dolën nga lokali.

Mirani shkoi për të fjetur të Vasili dhe prapë rikujtuan taktikën që duhej të ndiqnin për takimin e nesërm me Rezilin. Ndenjen gjatë kohë zgjuar, të shtrirë duke biseduar pothuajse për të gjitha ngapak, duke pyetur herë pas here njëri-tjetrin: „A nuk po të merr gjumi?”. Dikur e kishte marrë gjumi Miranin. Gjithsesi shumë vonë, sado që Vasili po vazhdonte të fliste. Ishte pikërisht një natë e jermishme. Në mëngjes Vasili u kujtua se ishte kotur fare pak.

8.

Vonë pasditën e të nesërmës Vasili gjeti Rezilin. Ai la Miranin në një lokal afër banesës së Rezilit, jo shumë larg qendrës së Shtutgartit, dhe shkoi ta merrte atë. Pa vonesë të madhe erdhën të dy dhe u ulën në tavolinën ku kishte zënë vend Mirani.

Rezili ishte një mashkull i gjatë, paksa thatim, me frizurë të përafërt me atë të Hitlerit, megjithëse flokët vinin me ngjyrë pak më të hapur. Duhej të ishte rreth 27–28-vjeçar. Me pamje të rëndë, serioze, për të mos thënë fodulle.

– Unë kam ardhur që të njihemi dhe të bisedojmë për bashkëpunim, nëse kemi interesa dhe qëllime reciproke. – Filloi bisedën Mirani. – Ne

kemi një organizim të vogël dhe të thjeshtë, megjithatë jemi të interesuar të njihemi e të bashkëpunojmë...

– Mirë se keni ardhur dhe keni bërë mirë që keni ardhur, pasi njohja dhe bashkëpunimi ynë është i domosdoshëm për forcimit tonë për ta bërë revolucionin proletar sa më të shpejtë në Kosovë. – U ngut Rezili, pa ditur nëse Mirani kishte mbaruar. – Edhe ne kemi qenë të gëzuar kur kemi marrë vesh për organizimin tuaj. Vasili më ka folur shumë për ty, meqë të ka kontaktuar e njohur përmes një lidhjeje shoqërore, siç më ka informuar. Para se të fillojmë – vazhdoi Rezili duke pozuar si të ishte ndonjë funksionar, – do të propozoja të caktojmë rendin e ditës për takimin. Pastaj do të doja të dija nëse ke autorizim me shkrim për të biseduar dhe do të doja të dija se cilin pozicion e ke në organizatën Fronti i Kuq Popullor.

I tha këto dhe po priste përgjigje nga Mirani, por ky u kap keq nga mospërvoja për të biseduar me një rang të tillë, siç pretendonte Rezili. Nuk e kishte biseduar me askë këtë takim. Me Vasilin kishte planifikuar një takim spontan. Megjithatë, mori të përgjigjej sa për të bërë radhën.

– Ju falenderoj për gatishmërinë tuaj dhe për propozim e pyetje që bëtë. Meqë nuk e kemi parapërgatitur takimin, nuk kemi si t'i bëjmë formalitetet që kërkuat ju tani. Sigurisht që as ju nuk jeni konsultuar me strukturat tuaja organizative, ndaj nuk është e nevojshme të keni ndonjë autorizim për të biseduar në nivel zyrtar që në këtë takim, siç po ma kërkon mua. Unë nuk jua di dhe nuk kërkoj t'jua di pozitën udhëheqëse në Grupin tuaj. Mendoj se kësaj radhe më mirë është të përcaktohem për një takim parapërgatitor për takim zyrtar, ku do të përfaqësoheshim si delegacione, me rend pune që do ta propozonim që tani. Shpresoj të jeni dakort me propozimin tim?

Mirani u gëzua që bëri rendin, pa qenë krejt i sigurt se i kishte thënë ato që do të duhej t'i thoshte dhe pa ditur se çfarë përshtypje kishte krijuar te Rezili.

– Unë nuk kam nevojë për konsultime e për autorizim, – ia pati Rezili, – meqë kemi aso forme të organizimit që i përgjigjet centralizmit demokratik dhe organizimit në ilegalitet të thellë, me konspiracion rigoroz. Sa për anën tonë, jemi të gatshëm që tani për takim zyrtar në mes të dy organizatave tona. Këtu kam edhe Nënkrjetarin, Vasilin.

– Më vjen keq, por unë nuk jam i përgatitur për takim të tillë zyrtar. Ndaj propozoj që të bëjmë bisedë për një takim tjetër të mundshëm, në të cilin do të përfaqësoheshim me delegacione të autorizuara. Them, të bisedojmë për t'u njohur, sepse akoma nuk dimë mjaft për njëri-tjetrin, që është domosdoshmërisht e nevojshme për bashkëpunim në të ardhmen.

Miranit po i dukej vetja si një gjel që e nxjerrin në fushë të mejdanit, duke u krekosur për ta frikësuar kundërshtarin.

– Dakord, sado që nuk kam kohë për biseda të lira e shterpe. – tha Rezili.

Mirani vendosi të hapte qëllimin e takimit. Ai heshti për një çast, duke u shtirrur sikur po mendohej çfarë qëndrimi duhej të mbante, meqë tani ai e kishte radhën të pozicionohej ndaj propozimit të Rezilit. Sa për të plotësuar boshllëkun e heshtjes, Mirani nxori një bllok nga xhepi kinse aty e tutje do të mbante shënime.

Vasili e nuhati gjendjen, si i zgjuar që ishte, dhe e mori fjalën:

– Derisa të mendoheni ju, unë, Shoku Kryetar, mendoj të bisedojmë me Miranin për hallin urgjent që kemi, meqë ky studion këtu, i di më mirë se ne gjuhën dhe ligjet gjermane.

Vasili foli me zë të prajshëm dhe vazhdoi duke iu drejtuar Miranit, pa pritur miratimin e Kryetarit të tij:

– Shoku Miran, di gjë ti nëse organet gjermane mund të na e përzënë Kryetarin Rezil nga Gjermania, për shkak të një borxhi në bankë?

– Nuk është nevoja ta pyesësh shokun Miran, këto janë çështje tona të brendshme! – ndërhyri Rezili thuaja në formë urdhëruese.

– Shoku Kryetar, mendoj se me shokun Miran mund të bisedojmë. Ai nuk është përfaqësues i ndonjë shteti armik, por bashkëpatriot si ne. Pa e pritur përgjigjen e Rezilit, ai vazhdoi: – Shoku Miran, Kryetari ynë ka huazuar në bankë katërdhjetëmijë marka për të financuar veprimtarinë patriotike të Grupit tonë. Tani është i papunë dhe nuk është në gjendje t'i paguajë. As organizata nuk i paguan dot menjëherë, ndaj gjermanët e kanë kërcënuar: T'i paguanë ose ta lëshojë Gjermaninë. Bile, për këtë, ka një vulë në pasaportë. Ke ndonjë shpjegim për këtë vështirësi që na ka goditur?

Vasili mbaroi fjalën dhe u ndje i lehtësuar për rolin. Tutje i la radhën Miranit.

– Me kaq sa dëgjova, mendoj: E para, asnjë bankë gjermane nuk jep hua kaq të holla *lesh*, në dorë, siç themi ne, pa pasur një garancion; E dyta, asnjë organ gjerman nuk përzë ata që nuk ua paguajnë borxhet bankave, por gjen formën për të detyruar borxhliun që ta paguajë borxhin; E treta, nuk më është e njohur që gjermanët të vulosin pasaportë të ndonjë borxhliu dhe po më habit ky përjashtim. Ndosha ti Vasil nuk e ke kuptuar problemin, se të tilla gjëra janë të pamundura...

– Të thashë më parë, se nuk është ky problemi për të cilin jemi takuar. – ndërhyri Rezili i zënë ngusht.

– Po mirë de, Shoku Kryetar, ndoshta nuk dita të tregoj unë, siç na ke thënë ti. Urdhëro shpjegoja Shokut Miran. Ndoshta mund të na ndihmojë ky, meqë nuk i kemi gjithë ato të holla tani për të paguar borxhin dhe ti je i rrezikuar, sepse mezi pret UDB-ja të të kapë.

– Shoku Miran, sikur më bëtë mashtrues. Unë kam prova se kam huazuar në bankë, se ma kanë vulosur pasaportën, me kërcënim: të paguajë borxhin ose ta lëshoj Gjermaninë!

Kësaj radhe Rezili foli me zë më të lartë se më parë, me nuancime prej të mllefosuri e të ofenduari. Gjatë të folurit futi dorën në xhepin e brendshëm, nxori pasaportën jugosllave dhe e hapi në faqen ku kishte

një vulë dhe ia zgjati Miranit ta shihte, tashmë i sigurt se do ta bindte me një provë konkrete dhe do të dilte fitues, i pastruar nga dyshimet që shfaqti Mirani.

– Kjo vulë më duket e sajuar. – Reagoi Mirani pasi e pa shkurtas. – Vë bast se atë nuk e ka vënë asnjë organ gjerman, pasi edhe teksti gjuhësor në vulë ka gabime gjuhësore.

– Ti qenke element provokator! – thirri me tërbim Rezili në drejtim të Miranit.

– Mos ulërit kështu, Kryetar, – ndërhyri Vasili, – se po i habit njerëit në lokal. Ky tha një mendim dhe nuk ke pse ulërit, nëse nuk ia qëllon ose të duket se provokon!

Kësaj radhe Vasili shfaqti autoritet të vendosur. Pllakosi heshtja dhe humbi radhën e folësit.

Mirani mendoi se ishte pa takt shpjegimi i rastit. Ishte komprometues për Rezilin, ndaj kërkoi falje duke thënë se unë nuk përdor takt diplomatik ndaj bashkëpatriotëve. Siç mendoj, ashtu flas. Nuk bëj hipokrizi e clozhe. Siç m'u paraqit problemi, shpreha mendimin. Kështu si ju, Shoku Rezil, reagon vetëm ai që kapet në faj. Sidoqoftë, Shoku Vasil kërkoi nga unë vetëm këshillë.

Prapë heshtja e rëndë ra mbi të tri figurat e burrave.

– Ju qetë dakorduar për njoftim e informim të lirë reciprok, – ndërhyri mundimshëm Vasili. Mua, shoku Miran, do të më interesonte, në sa ekzemplarë e botoni gazetën *Bashkimi* dhe si po ia dilni ta financoni?

– Tirazhin e kemi tre mijë ekzemplarë. Siç më kanë thënë shokët, për shpënzimet e numrit të fundit, shtypshkronja ka kërkuar treqind marka.

– Vetëm treqind marka!? – reagoi Vasili, duke u bërë sikur ishte shumë i befasuar.

– Po, dhe shumë janë. Po të dinim të kërkonim shtypshkronjë tjetër, ndoshta do të kushtonte më lirë! – tha Mirani natyrshëm.

– Ti, shoku Kryetar, na ke raportuar se ke paguar nga arka e orga-

nizatës tetë mijë marka për traktin tonë. – iu drejtua Vasili habitshëm të tretit.

– Po ta them për herë të fundit, nuk jemi takuar për të biseduar për gjërat tona të brëndshme, aq më pak me përfaqësues të një organizate tjetër! – tha Rezili kërcënueshëm. – Po vazhdove me të tilla gjëra, t’i japësh shkas të na provokojë ky shoku, atëherë unë po largohem, me paraljmërimin se ndaj teje do të merren masa disiplinore.

Kësaj radhe Rezili e kishte tepër seriozisht dhe bëri të ngrihet. Mirani ia vendosi dorën mbi krah:

– Të bisedojmë për çka jemi takuar këtu. Kështu nuk ke arsye të ikësh. Këto gjëra janë cikërrima para përcaktimeve tona të mëdha patriotike e komuniste. Duam ta çlirojmë Kosovën, siç jemi përcaktuar ne, gjegjësisht të bëjmë revolucion proletar, siç jeni përcaktuar ju, prandaj këto cikërrime nuk duhet të bëhen shkasë për të na prishur. Këto duhet trajtuar si defekte e pengesa të vogla, që edhe ndodhin. Gjërat e tilla na kalisin për të bërë punë të mëdha.

Ai zgjodhi këtë metodë i bindur se do ta gëlltisë Rezili për të vazhduar bisedën, gjoja për përgatitjen e takimit tjetër zyrtar. Nuk e kishte merak ikjen e Rezilit dhe as i interesonte bashkëpunimi me të, (ishte i bindur tashmë se tjetri ishte i dërguar i UDB-së). Merakun e kishte te Vasili, Maksi dhe të tjerët që Rezili i kishte mashtruar e përvetësuar. Pastaj merakosej për veprimtarinë e tij të rrezikshme në Kosovë, përmes se cilës mund t’i vinte në kurth patriotët e interesuar për t’u organizuar kundër pushtuesit.

– Urdhëroni, çfarë keni për të thënë, jam i gatshëm t’ju dëgjoj, sado që ma provokuat vetëpërmbytjen me mendimet e mëhershme për ca probleme tona të brëndshme që i ngriti gabimisht këtu, Shoku Vasil. Mendoj se ne e kemi më të drejtë përcaktimin tonë për revolucion proletar, se sa ju për çlirim kombëtar. Nuk po e shihni, ka shumë shtete të çliuara kombëtarisht, ku po shfrytëzohet egërsisht klasa punëtore e

fshatarësia nga borgjezia. Edhe në Jugosllavi është krijuar e ashtuquajtura borgjezi e kuqe, nga e cila duhet të çlirohet proletariati jugosllav. Bile, kjo është bërë aq e dukshme, sa ndonjëherë këtë po e kritikojnë edhe vetë Tito e Kardeli, që janë në krye të kësaj borgjezie.

I tha këto Rezili, i shtrënguar nga rrethanat se nuk mund të ikte aq lehtë nga ai takim. Ai zgjodhi mënyrën për t'u inponuar më i ditur se të tjerët.

– Edhe mund të jetë ashtu, siç u shprehet, por në vende të pushtuara, së pari bëhet lufta nacional-çlirimtare, pastaj mendohet për të drejta sociale, – vazhdoi Mirani, – madje, ka nga ata klasikë të komunizmit që mendojnë se përpara duhet të bëhen luftërat çlirimtare dhe pastaj të bëhen revolucione të dhunshme të proletariatit kundër pakicës shfrytëzuese. Po t'i lëmë tashti teoritizimet se kush e ka më drejt. Propozoj të shkëmbejmë mendime me shkrim, t'i diskutojmë ato dhe pastaj të takohen të dy delegacionet për të marrë vendim. Pse jo, ndoshta mund të ndodh edhe bashkimi. Unë nuk shoh vështirësi që t'i dakordojmë mendimet dhe veprimtarinë patriotike.

Edhe përgjigja e Miranit, po të mos kishte taktikën brënda, i ngjasonte kësaj radhe stilit dhe paraqitjes se Rezilit, meqë nuk dëshironte ta ulte veten më poshtë se ai sa u përketë njohurive teorike për luftëra nacional-çlirimtare e për revolucione proletare.

– Dakord, le të mbetët që të shkëmbejmë mendime me shkrim. – u përgjigj Rezili, me dëshirën për të ikur sa më parë nga ky takim, aspak i këndshëm.

Vasili thirri kamarierin, bëri pagesën dhe që të tre dolën jashtë. Vasili i ftoi në makinën e tij dhe sqaroi, se së pari do linte Miranin në Bahnhof (stacion hekurudhor), siç i thoshin tashmë shqiptarët, prej ku ai gjoja do të shkonte për Bochum, e pastaj Rezilin do ta dërgonte në banesë.

Kur arritën te stacioni zbriti edhe Rezili, duke i thënë Vasilit që të shkonte, pasi ai do të blinte gazeta dhe do të takonte dike. Mirani shkoi

në biletari, preu biletën për në Plochingen. Tani ai e kishte merakun se mos po e vrojtonte Rezili, se në cilin drejtim do të udhëtonte. Dyshimin ia shtoi ndërrimi i mendimit të Rezilit, i cili u ndal në stacion. Lëvizja e njerëzve në stacion ishte e madhe dhe Mirani nuk e pati të vështirë t'i humbiste venerimit të Rezilit.

Në javët që vijuan ndodhën takime të shpeshta midis Miranit e Vasilit. Shumëherë biseduan rreth takimit me Rezilin, por Mirani vazhdoi të dyshonte, nëse e kishte bindur Vasilin për keqpërdorim e rrezikshmëri të Rezilit apo jo.

Në fund të shtatorit Mirani mbaroi punën në Plochingen dhe u kthye në Bochum.

9.

Të shtunën në mëngjes, Mirani hipi në trenin për Ludwigsburg, siç i kishte premtuar Bardhit. Deri atëherë ai nuk e kishte njohur fizikisht Jusufin. Ishte kureshtar të dinte se cili ishte dhe pse i ishte dashur të arratisej. Gjatë rrugëtimit, pos leximit në tren të rehashëm, ai meditonte, mendonte e shpresonte se Jusufi do të ishte intelektual i përcaktuar për angazhim konkret çlirimtar, që i duhej aq shumë organizimeve që sapo kishin filluar në mjediset e emigracionit shqiptar, sidomos të emigracionit ekonomik që ishte bërë i madh gjatë viteve të fundit. Këtë shpresë po ia përforconte detyrimi i Jusufit për t'u arratisur. Në fakt, Mirani e dinte se në Perëndim kishte organizime të kahershme të mërgatës politike shqiptare, që veten e quanin nacionaliste, demokratike, patriotike, djathtiste e antikomuniste, por ishin kryesisht organizime që merreshin vetëm me çlirimin ideologjik të Republikës së Shqipërisë nga diktatura e Enver Hoxhës. Atyre nuk u interesonte, pothuajse fare, të merreshin me organizim të çlirimit të territoreve të pushtuara shqiptare, rreth e rrotull Republikës së Shqipërisë. Këto organizime përbëheshin kryesisht

nga të arratisurit nga Republika e Shqipërisë që kishin nisur veprimtaritë e tyre në Perëndim, në fund të vitetve të 60-ta, kur në Jugosllavi ishte menjëherë ministri i brendshëm Aleksandër Rankoviç dhe klani i tij nacionalist serb. Prandaj, nga Jugosllavia ishin arratisur këta emigrantë politikë të Republikës së Shqipërisë, meqë, me rënien e Rankoviçit, shumica e tyre ndiheshin të rrezikuar të vazhdonin të qëndronin atje. Kishte edhe një organizim të vetëquajtur nacionalist e djathtist, me emigrantë nga Kosova me vise, që quhej Beslidhja Kombëtare Shqiptare, drejtuar nga Emir Fatahu, alias Emil Kastrioti, siç njoftonte ai publikisht. Edhe pamfleti i tyre “Besa Shqiptare” shkruante vetëm për diktaturën komuniste në RPS të Shqipërisë dhe rrallëherë për gjendjen e rëndë në Kosovë. Njëherit aty sulmoheshin kuqaloshët e Enverit, siç i quante ai pamflet rebeluesit në Kosovë që donin të çlironin Kosovën nga pushtimi jugosllav, gjegjësisht nga pushtimi serb, maqedonas e malazez. Mirani dyshonte të ishin ato organizime nacionaliste. Ato pos që u shërbenin shërbimeve të huaja, ishin të politizuara deri në skajshmëri vetëm për çlirim sistemor të Republikës së Shqipërisë dhe aspak për çlirim nacional të Kosovës. Madje në ndonjë takim me bashkëatdhetarët, Mirani shfaqte mendimin se po të kishin qenë ato organizime vërtetë nacionaliste, atëherë do t’ua kishte pirë ujin me të cilin do lanin këmbët krerët e tyre dhe aspak nuk do të kritikoheshin për përcaktime të tyre gjoja djathtiste. Ai tani po shpresonte shumë të Jusufi. Ai do të jetë një ideator e promotor për organizime të fuqishme.

Mirani kishte edhe një arsye më tepër për të shpresuar në kontributin patriotik të Jusufit. Pas informimit të Bardhit për arratisje të tij, përmes bisedave telefonike, kishte marrë vesh se cili ishte Jusufi në Kosovë dhe përse ishte arratisur.

Në Shtutgart ai ndërroi trenin, sepse tani i duhej të merrte një tren lokal për në Ludwigsburg, ku punonte Bardhi. E kishte paralajmëruar për nisje dhe orar të udhëtimit, prandaj e dinte se do ta priste në stacion.

Kështu edhe ndodhi. Bardhi kishte dalë bashkë me Vasilin, kurse Jusufin e kishin lënë në zyrë të Bardhit, në shërbimin social *Arbeiter Wohlfahrt*. Prej stacionit shkuan në zyrë në këmbë, meqë s'ishte larg. Aty gjeten Jusufin, me të cilin u përshëndetën vëllazërisht, si të qenë njohur prej kohësh dhe të mos ishin parë për goxha vite.

Mirani po e vështronte Jusufin me një simpati të veçantë. Pamja e tij, me flokët kaçurrela, me fytyrë simetrike që fshihte moshën, me shikim të mprehtë, bënte që tjetri të mendonte se sa ngjante me dukjen e vëllait të tij më të madh. Balli dhe vetullat i dikushin si të kopjuara. Parandjenja, se te Jusufi do të kishte jo vetëm një shok, por edhe një si vëlla më të moshuar që do ta këshillonte e ndihmonte në rritjen e formimin e tij, po e vetëknaqnin Miranin deri në hutim.

Mirani e pyeti i pari Jusufin për vështirësitë e arratisjes.

– Të kuptova, – nisi tjetri, – ty gjithsesi të intereson më shumë shkaku i marrjes së vendimit për arratisje, se sa vështirësitë. Në fakt vetë Jusufi i dha përparësi shpjegimit të vendimmarrjes për arratisje. – Shkaku definitiv për arratisjen time që tentimi, pothuajse njëhërash, për arrestim në banesë, në Prishtinë dhe në vendin e punës në ‘Rilindje’. Me gjasë sigurimi famëkeq jugosllav, që ende po e quajmë UDB, na kishte rënë në gjurmë të organizimit tonë ilegal. Shkas për të që ardhja e fshehtë e gazetës *Bashkimi*, shpërndarja gjithashtu e fshehtë dhe ideja që na lindi se mund e duhet të organizohemi për t'u çliruar nga pushtuesi. Për mënyrën teknike dhe vështirësitë gjatë arratisjes ndoshta do të kemi rast të bisedojmë, po që nevoja, meqë tani nuk është aq me rëndësi. Mjafton të sqaroj se arratisja që e suksesshme, sado me përipeci e rreziqe. Tani gjendem këtu.

Vendimi për t'u arratisur ka qenë i dhimbshëm, veç të tjerash, edhe për vështirësitë dhe dhëmbjen që u kam shkaktuar fëmijëve e nënës sime të shumëvujtur. Po më gëzon fakti se këtu, vëllai im Bardhi, paska zënë shokë të mirë dhe uroj që kjo shoqëri të thellohet. Për të tjerat do

të kemi rast të bisedojmë. Unë akoma nuk kam pushuar mjaft, sidomos shpirtërisht, nga arratisja dhe ti po ashtu je i lodhur nga udhëtimi i gjatë që ke bërë.

Ai po fliste me zë aq të ulët, sa mezi e dëgjonte Mirani, i interesuar jo vetëm të dëgjonte, por edhe të inçizonte secilën fjalë, po të ishte e mundur. Ai po e gjente kënaqësinë e munguar prej vitesh për të bërë bisedë me një intelektual të Kosovës, kaq modest.

Pas disa bisedave të rëndomta, siç praktikohet të thuhet, Bardhi shfaq një habi:

– Me gjasë Rezil Mejtepi është informuar për arratisje të Jusufit, para se Jusufi të arrinte këtu. Më telefonoi Vasili, sapo arriem në Ludwigsburg dhe më pyeti për të. E pyeta se prej nga qe informuar aq shpejt. M'u përgjigj se i kishte treguar Rezili. Po Rezili nga e kishte marrë vesh? Tani nuk e di, – më tha, por do ta pyes. E luta Vasilin të vinte për vizitë. Sigurisht, qeshë bërë merak se nga ishte informuar kaq shpejt Rezili.

– Mos e sforco kaq shumë këtë tematikë që e diskutuam para se të vinte Mirani, – ndërhyri Jusufi.

– Mirë, mirë, unë nuk po e sforcoj, por fakt është që Rezili duhet të jetë informuar nga dikush. – u përgjigj Bardhi.

Jusufi e Bardhi nuk dinin asgjë për dyshimet që kishin Mirani e Vasili ndaj Rezilit, dyshime që Mirani pothuajse i kishte kthyer në bindje, ndërsa Vasili vazhdonte t'i kishte dyshime fillestare. Në fytyrë të Miranin hetohet një shqetësim, prandaj hodhi vështrimin nga Vasili, të cilit nuk i foli, por tjetri e kuptoi se e kishte radhën për të shpjeguar sadopak.

– E pyeta Rezilin, pasi pata folur në telefon me Bardhin. Ai më tha se e kishte informuar *amnesty international*.

– Nga e kishte marrë vesh *amnesty international*, – ndërhyri Mirani, – mos e ke lajmëruar ti Bardh? Ndryshe ajo nuk ka asnjë mundësi të ishte kaq shpejt e informuar.

– Jo, ende nuk i kam telefonuar, – u përgjigj Bardhi.

– Atëherë t'i telefonojmë Zonjës Melani Andersen në Londër, meqë ajo është përgjegjëse e Sektorit për Jugosllavinë në *amnesty international*, – propozoi Mirani, tashmë i shqetësuar. Atë e njoh unë dhe këtu e kam edhe telefonin e saj.

– Do t'i telefonoj unë, meqë di kënaqshëm anglisht, – tha Bardhi.

– Zonja Andersen di mirë edhe serbisht, – shtoi Mirani.

– Atëherë, telefonoji ti, Miran, meqë e njihke! – ndërhyri Jusufi.

Nga telefoni i Zyrës Bardhi zgjodhi numrin që ia dha Mirani. Receptorin po e mbante në dorë Mirani. Pas tre-katër cingërrimave, u paraqit vetë Zonja Andersen. Pas prezantimit dhe përshendetjes Mirani e pyeti drejtpërdrejt:

– Dini gjë, Zonja Andersen, për arratisje të Jusuf Gërvallës nga Kosova?

– Jo, kush është ai?

– Mos di dikush tjetër në *amnesty international* për arratisje të tij? – nguli këmbë Mirani.

– S'është e mundur, meqë të gjitha informatat lidhur me Jugosllavinë së pari vijnë në tavolinën time, pastaj vendos unë nëse ato duhet të bëhen publike, – erdhi përgjigjja e Zonjës Andersen.

– Mos e njihni një shqiptar në Gjermani, me emrin Rezil Mejtepi? – bëri pyetjen e tretë Mirani.

– Jo. Përse më pyesni kaq shumë, çfarë ka ndodhur? – reagoi Z. Anderson, me ndjenjë nervozizmi.

– Nuk ka ndodhur shumëgjë, por vërtet është arratisur Jusuf Gërvalla dhe tani gjendet këtu në Gjermani. – shtoi Mirani. – Zotëria Rezil Mejtepi ishte informuar para se ai të arrinte në Gjermani dhe thotë se këtë informatë e ka nga *amnesty international*, ndaj ju telefonava, meqë kur isha për vizitë te Ju, më keni këshilluar që t'ju marrë në telefon në çdo kohë dhe për çdo informatë e shqetësim.

– Ashtu është. Tani keni ndonjë shqetësim lidhur me rastin?

– Shqetësimi i parë është se policia ka ndërmarrë aksion të madh për kapjen e Jusuf Gërvallës, duke krijuar shqetësime në familje dhe tek të afërmit e tij. Fatmirësisht Jusufi ka mundur të arratiset dhe tani është këtu në Germani. Shqetësimi tjetër ka të bëjë me informatën kaq të shpejtë të Zotëri Mejtepit.

– E po, ju e dini se sa e shtrirë dhe sa operative është UDB-ja, – po përpiqej të sqaronte Z. Andersen, lidhur me atë informacion. – Ndoshta ai farë Zotëria, të cilit nuk ia mbajta mend emrin, mund të jetë një bazë e UDB-së në Gjermani!

– Dakord, vetëm kaq kisha, dështa të di nëse ju dinit për arratisjen e Zotëri Gërvallës dhe a mund ta kishit informuar Zotëri Mejtepin për arratisje të tij. Ju falenderoj për gatishmërinë tuaj, Zonja Andersen, që ndani shqetësimet me ne dhe që angazhoheni edhe për të burgosurit shqiptarë. Ne do t'ju informojmë me shkrim për aksionet e fundit të UDB-së që çuan në arratisjen e Jusufit dhe në arrestime që duhet të kenë ndodhur atje.

– Gjithashtu edhe nga unë, ju falenderoj për telefonatën dhe mos ngurroni të më telefononi për çdo gjë, siç edhe jemi mirëkuptuar qysh kur ishit për vizitë te ne.

Parlofoni i telefonit ishte gjatë gjithë kohës i hapur. Biseda u bë në gjuhën serbokroatishte, siç i thuhej asaj zyrtarisht. Të gjithë e dëgjuan dhe e kuptuan atë. Mirani ndjeu një lehtësi që e gjeti këtë Zonjë në telefon dhe që pati rastin të demonstronte njëfarë shkathhtësie e lidhjeje të rëndësishme para Jusufit.

– Domethënë Rezili nuk na qenka informuar nga *ammesty international*, – theu heshtjen menduese pas telefonatës Bardhi. – Atëherë kush mund ta ketë informuar?

– Të lutem, ta lëmë me kaq kësaj radhe, – i tha Jusufi Bardhit. – Do të sqarohet ndonjëherë tjetër se kush mund ta ketë informuar.

Pas ndërhyrjes së Jusufit ra një heshtje në zyrën e mirërregulluar, që gjendej në çati të një ndërtese të vjetër tre katëshe. Vasili kishte ulur pakësa kokën me një ndjenjë faji për atë që kishte ndodhur lidhur me informimin e Rezilit. Mirani theu heshtjen e bezdisshme duke thënë se kishte sjellë ca libra për Jusufin, meqë te Bardhi do t'i mungonin librat për të mbushur ditët e para në ekzil, plot shqetësime e brenga. Tutje Jusufi tha të shkonin në banesë të Bardhit, meqë atje do të rrinin më rehat.

Bardhi deri atëherë kishte jetuar i vetëm, prandaj në banesën e tij nuk kishte rregull. Mobilimi ishte i vjetër, banesa e vogël, në katin përdhësë, madje pjesërisht nën tokë nga fundi i dritareve. Kjo thjeshtësi po e befasonte Miranin, pasi ai kishte menduar se Bardhi duhej të kishte banesë komode, duke qenë intelektual, nëpunës, me të ardhura të mira. Ndërkohë vetiu arsyetoi se ai të ardhurat duhet t'i ketë shpenzuar për të ndihmuar nënën e vëllezërit.

Sapo u rehatuan, Jusufi mori nëpër duar librat që ia kishte sjellë Mirani. E falenderoi duke i thënë se kishte filluar të mërzitej dhe tani i kishte ato për të spostuar vemendjen nga pasojat e arratisjes së tij dhe nga shqetësimet për familjen e të afërmit. Me librat në duar, të cilat tashmë po i vendoste me kujdes mbi dysheme, pranë kolltukut ku ishte ulur, iu drejtua Miranit:

– A mund të më tregoni si i keni hallet ju këtu, me çfarë po merreni? Por, më tregoni vetëm për ato që mendoni se duhet t'ia tregoni një bashkatdhetari që takoni për herë të parë. Pastaj, në bazë të besimit reciprok që do krijohet në të ardhmen, do bisedojmë edhe për organizime e aktivitete patriotike?

Vasili, sapo dëgjoi pyetjen, vështrimin e hodhi kah Mirani, që t'i jepte për të kuptuar se ai e kishte radhën. Këtë e kuptoi Mirani, ndaj po mendohej nga t'ia niste.

– Thënë shkoqur, – nisi përgjigjen Mirani, – ne nuk kemi pse të rez-

ervohemi, pasi këtu ambienti dhe rrethanat na krijojnë mundësi që ne të mos i kushtojmë rëndësi edhe aq shumë konspiracionit. Shumëçka e kemi biseduar edhe me Bardhin dhe prandaj, si vëlla i tij që je, na bën që të jemi të hapur, si të ishte shoku e bashkëveprimtari ynë prej kohësh. Meqë kemi këto relata dhe tashmë edhe besim, thjeshtë po të informoj se jemi në fillim të nismave organizative dhe fillimi, siç thuhet, është më i vështiri. Vuajmë nga mungesa e njerëzve të përgatitur intelektualist. Prandaj shumë veprimtari tonat janë aq të thjeshta dhe të cekëta, sa na e kanë mbushur mendjen edhe ne se janë paksa naive. Por, shpresojmë se do t'i avancojmë, meqë dëshirën dhe përkushtimin e kemi. Ardhja jote na ka dhënë kurajo, prandaj edhe një herë, meqë tani jemi në banesë të Bardhit, mirë se ke ardhur dhe të urojmë, para së gjithash, që të mos mërzitësh dhe të kesh shëndet e suksese.

Mirani u ndal paksa për të hetuar nëse Jusufi ishte i kënaqur me përgjigjen dhe nëse duhej të vazhdonte apo të priste pyetje konkrete.

– Unë mendoj se veprimtaria juaj nuk është naive dhe e parëndësishme. Vetë fakti se keni mundur të nxirrni një gazetë dhe atë të na e sillni edhe në Kosovë, pavarësisht nivelit të saj, ka qenë simbolikë domethënëse për ne atje, se dikush po punon dhe se mund të punohet. Shpërndarja e *Bashkimit* ka bërë jehonë të madhe, por njëherit i ka shkaktuar shqetësim të madh pushtetit. Prandaj ka urdhëruar fushatë të zgjeruar të bastisjeve dhe të arrestimeve. Për mua kjo gazetë, e shpërndarë në përmasa si asnjëherë tjetër deri tani, ka qenë motiv i fuqishëm që të ngazhohem konkretisht dhe të mos rri në pritje, siç është bërë shprehi e shumicës së intelektualëve, të cilët dëshirojnë të ndodhë diç, por hezitojnë të angazhohen vetë. Jam i bindur, se pas gazetës *Bashkimi* duhet të qëndroj një organizim i mirë.

Jusufi u ndal me kaq, meqë kishte virtyt të thekësuar për të mos folur gjatë, sidomos para njerëzve që mund të ndiheshin inferiorë. Mirani e kuptoi se ishte e nevojshme të jepte sqarime plotësuese.

– Organizimin e kemi të thjeshtë. Botimi i gazetës, siç është *Bashkimi*, këtu është tepër i kollajshëm, sepse kushtet janë shumë të favorshme. Këtu nuk të nget njeri për një veprimtari të tillë. Vështirësia kryesore që kemi pasur ka qenë mungesa e njerëzve që dinë e duan të shkruajnë. Për këtë arsye, pothuajse të gjitha shkrimet në këtë gazetë janë jo vetëm të huazuara nga shtypi i Republikës së Shqipërisë, por ato janë të fotokopjuara, meqë edhe kuadri për të bërë radhitje e faqosje të tyre na mungon. Për të mos e lënë për më vonë, meqë jemi të gazeta, – vazhdoi Mirani, – edhe përmbajtja e saj na është kontestuar nga njerëz me peshë domethënëse. Nëse nuk ju mërzis, mund t’ju tregoj konkretisht.

– Vetëm vazhdo, nëse e gjykon se duhet të na e thuash! – foli Jusufi, duke shfaqur gatishmëri për të dëgjuar vëmendshëm.

– Papritmas kisha një vizitë në Bochum. Ishte buzëmbremje, kur mora një telefonat nga recepcioni i konviktit. Zëri i panjohur, me një timbër që s’e kisha dëgjuar ndonjëherë, m’u lut që të zbrisja në holl të konviktit për të takuar një zotëri që po më kërkonte. Zbrita poshtë shumë kurioz kur pranë recepcionit pashë një burr të shkurtër, goxha të trashë, i veshur me kostum e kravatë. Hodha vështrimin rreth e rrotull nëse kishte tjetër njeri në holl, meqë vetëm të tillë vizitor nuk prisja. Kur nuk pashë njeri tjetër, iu drejtova atij, nëse po më kërkonte. M’u prezantua me emrin Simon Ç., nëpunës në Ambasadën Shqiptare në Vjenë. Sigurisht që më ngjalli habi. Ishte hera e parë që po takoja nëpunës të Ambasadës Shqiptare. E luta të shkonim në dhomë, por refuzoi, duke shpjeguar se e kishte një koleg përjashta. Dolëm dhe takuam edhe kolegun e tij, një njeri me trup sportiv, po ashtu me kostum e kravatë. Edhe ai u prezantua, por emri i tij nuk po më kujtohet tani. E po, nëse nuk gabohem, emrin duhet ta kishte SB. I luta sërish të shkonim në dhomë apo në bufe të konviktit, por Simoni tha se do të rrimë paksa përjashta dhe pastaj edhe mund të shkojmë për të pirë nga një kafe.

Simoni i ra llafit shkurt. Nuk i mbaj mend të gjitha, por po përpiqem t'i kujtoj ato që më kanë ngelur. Ai sqaroi se ishte në dijeni të themelimit të Frontit, se kishte marrë gazetën *Bashkimi*, (me atë rast ai nxori nga xhepi gazetën), por tani erdhëm edhe të njihemi dhe t'ju përgëzojmë për këtë nismë. Mua po më habiste, nga e kishin ata atë informacion aq konkret dhe menjëherë me shkoi mendja të njëfarë Xhahili, të cilin do të keni rast ta njihni. Ai mund të ketë informuar strukturat e Partisë Komuniste Gjermane dhe prej andej mund të jenë informuar edhe në Ambasadën Shqiptare. Pastaj Simoni nisi me kritika, se gazeta nuk është e qëlluar, meqë e keni kryesisht me artikuj të huazuar nga shtypi shqiptar. U arsyetua se atë shtyp po e shpërndanin vetë dhe ne nuk kishim arsye të lodheshim e të harxhoheshim për ta rishtypur e shpërndarë. Pastaj, fikësimi m'u përqëndrua të kritika që bëri në vazhdim Simoni, të cilën e shprehu me ton të ngritur, madje do të thosha edhe brutal. Po mundohem ta reprodukoj, sepse e pata shënuar pasi ikën vizituesit dhe besoj se mund ta sjell si citim të përafërt: "Ju nuk duhet të shkruani për Republikë të Shqipërisë, për Marksizëm-Leninizmin, për Enver Hoxhën. Këto i bëjmë vetë ne, kemi shtetin, kemi institute përkatëse, kemi propagandë të fuqishme dhe nuk ua ka njeri nevojën juve që të merreni me të tilla shkrime. Po deshët ta ndihmoni Kosovën, siç pretendoni, ju duhet të përqëndroheni vetëm brenda hapësirës së kushtetutës jugosllave, të kërkoni vetëm të drejta të barabarta nacionale në Jugosllavi dhe të mos merreni me gjëra që nuk ju takojnë?". Meqë e kuptova ose e keqkuptova si urdhër, iu përgjigja, por me zë paksa të ngritur: "Ne shkruajmë e bëjmë çfarë të na thotë mendja jonë! Edhe kur e kemi nisur, nuk ju kemi pyetur?". "Po xhanëm, ashtu është, por pa pasur nevojë të hidhëroheni, unë të bëra një këshillë shoqërore, meqë ky është mendim zyrtar i Partisë e Shtetit dhe ju nuk do keni përkrahjen tonë, po e vazhduat me këtë mënyrë!" – ma ktheu Simoni. "Përkrahjen e dëshirojmë, por jo të kushtëzuar. Pastaj, ne e kemi filluar me forcat tona dhe

nuk kemi nevojë për ndihma të kushtëzuara,” – vazhdova unë. “Atëherë, Ju dini punën tuaj dhe ne erdhëm vetëm t’ju përgëzojmë dhe t’ju japin ndonjë këshillë vëllazërore, nëse i pranoni,” – përmbylli Simoni tashmë me zë më të qetë.

Pastaj ai më foli gjatë për të më bindur për ato që më kishte thënë. Jugosllavia ka pozitë të favorshme ndërkombëtare. Me këto shkrime ju do të akuzoheni, etiketoheni e luftoheni më lehtë nga ajo. Për këtë luftë kundër jush Jugosllavia do të ketë përkrahje edhe të perëndimorëve. Shqipëria ka pozitë ndërkombëtare tepër të pafavorshme. Ne mund t’ju përkrahim vetëm kur kosovarët kërkojnë të drejta të barabarta nacionale e sociale brenda Jugosllavisë. Përndryshe, nuk kemi mundësi t’ju përkrahim, sepse po e ngritem zërin, ta zëmë në OKB, për të përkrahur Programin e kërkesat tuaja për bashkim me Shqipërinë, ju nuk do të fitoni gjë nga kjo dhe do ta pësojë edhe shteti ynë, e kështu me radhë.

Pas rreth një ore bisedë të kësaj natyre, duke ecur këmbë në rrugicat e kopshtit të madh të konviktit, shkuam në dhomë dhe ndenjëm edhe një orë. Sigurisht, edhe aty nuk munguan ca kritika e vlerësime të ngjashme, duke mos më kursyer edhe mua individualisht, se gjoja na qenkan indoktrinuar me anarkizëm të lëvizjes studentore gjermane, se qenkan nacionalist romantik, që nuk njihkam rrethanat politike dhe nuk ditkam se cili është interesi aktual i Kosovës, etj.

Po pushoj ca sepse, kur e kujtoj atë takim, sesi më lodh. Atëherë, ato kritika e mendime më patën munduar, për të mos thënë se më dëshpëruan thellësisht.

– Tepër interesante këto, edhe për mua që po i dëgjoj për herë të parë, – ndërhyri Vasili. Edhe mua më ka ndodhur përafërsisht kështu. Ndodhta edhe pak më ashpër se sa këto, por zemërplatur i kam ndryrë në vete deri tani. I njëjti Simon më ka takuar edhe mua, me gjasë në të njëjtën kohë, dhe ma ka kritikuar emrin e Grupit tonë. . .

– Po, sa s’harrova, – ndërhyri Mirani pa pasur durim që të presë deri-

sa ta mbaronte fjalën Vasili, – edhe për emrin u qortova. Gjoja kishim zgjedhur emër bombastik dhe tepër karakterizues e provokues, veti e adoleshentëve politikë anarkistë, siç më pat thënë ai.

– Tepër interesant! – tha edhe Jusufi pa pritur nëse do të vazhdonte Vasili. – Edhe përgjigja jote paska qenë e guximshme, për të mos thënë e nxituar. Rreth këtyre qëndrimeve na u dashka të mendojmë me qetësi në të ardhmën. Tani mendoj të bisedojmë nëse keni nevojë për përkrahjen time, më mirë të them për angazhim timin, sepse veprimtaria kombëtare është obligim për secilin dhe nuk kemi përse ta përkrahim njëri-tjetrin.

– Mua më vjen mirë që një njeri i letrave shqipe, siç je ti, do të angazhohet. Kjo do të ndihmojë shumë sepse, sa për veprimtarë krahu, jemi shtuar shumë. Ndërkaq, kemi pasur mungesë totale për veprimtarë të mendjes e të penës. Kjo nuk ka si të mos na e shtojë moralin dhe vullnetin për angazhim edhe më të madh. Tani, ta zëmë, kemi në përgatitje numrin e ri të *Bashkimit* dhe do të ndihemi të lumtur, sikur ti të angazhoheshe, që ai të dalë më origjinal, me sa më shumë shkrime autentike.

– Gjithsesi, me kënaqësi. Po e lë modestinë për një çast anash dhe po e them sinqerisht, se po ndihem i mbushur, duke gjetur të gatshme mundësinë për të bërë *Bashkimit* edhe më cilësor. Pa humbur kohë për muhabetë, mund të më sillni materialet që keni bërë gati, që unë ta redaktoj.

– Epo, ç'materiale kërkoke nga ne. Unë të ankoem se jemi hudum dhe ti pyet sa femijë kemi, nëse mund të shprehem kështu, – u përgjigj Mirani duke qeshur lehtas.

– Jo, ju duhet të shkruani siç dini dhe unë do t'i rishkruaj. Edhe aq keq nuk duhet të qëndroni, sepse për të folur po flisni që ç'ke me të. Shkruani siç flisni dhe kaq. Unë do t'jua redaktoj pastaj.

Jusufi foli me respekt dhe shumë hapur. – Nëse do të më lejohet, unë

dëshiroj të rishkruaj Programin e Statutin e Frontit, të cilin ma dha Bardhi që ta lexoj. Përmbajtja më pëlqeu, por ka shumë gabime gjuhësore.

– Do të ishte e mirëseardhur kjo që propozon. Programin e Statutin i pata hartuar me një profesor gjerman dhe unë i përktheva. Ai është niveli im i njohjes se gjuhës shqipe. Tamam, ish-student i fizikës, që shquhet për mosnjohje të gjuhës. Bile, që të ta them hapur, ca gjëra të gramatikës shqipe u detyrova t'i mësoj gjatë leksioneve të gjuhës gjermane. Fatkeqësisht, nuk më ka rastisur të kem mësues të përkushtuar të gjuhës në shkollë të mesme.

Mirani i tha këto pa asnjë stepje. Ai shquhej për modesti të tepruar dhe transparencë, ndonjëherë deri në naivitet. Kështu veproi edhe kësaj radhe, sikur me Jusufin të ishte shok prej vitesh.

– Mos u merakos, mund të kompensohet. Vetëm mos përto të shkruash ashtu siç mendon e flet, kurse unë do të të ndihmoj drejt përsosjes, – këshilloi me dashamirësi Jusufi.

– E po, Miran, dëshironi të na e merrni Bacën Jusuf vetëm ju të Frontit? Po ne të Grupit? – foli papritur Vasili, i cili, si duket nuk foli vetëm sa për ta bërë radhën, por pse u merakos se mos Grupi do të injorohej fare.

– Mos u merakos, Vasil. Nuk do të anëtarësohem në asnjë organizim, deri sa ju të mos bashkoheni dhe deri atëherë gjithandej do të angazhohem për të ndihmuar veprimtarinë patriotike, – tha Jusufi paksa i merakosur pse deri atëherë nuk ishin angazhuar më intensivisht në biseda Vasili e Bardhi.

Më në fund, sikur secili e vetëkuptoi se u bisedua mjaft. Bardhi që më konkret:

– Të dalim në qytet për të pirë diç, meqë këtu nuk kam bërë ndonjë furnizim të bollshëm?

Asnjëri nuk kundërshtoi. U ngritën njëri pas tjetrit, pikërisht sikur Bardhi të kishte dhënë urdhër e jo propozim.

Ecën në këmbë meqë lokali ishte afër. Një lokal i qetë, me orendi të vjetëruara për të ruajtur traditën. Sapo zunë vend dhe bënë porosinë, Jusufi vështrroi thjeshtësinë dhe vjetërsinë e lokalit. – Në Gjermaninë e zhvilluar dhe moderne, shoh lokal me orendi kaq të vjetra!

– Gjermanët janë ruajtës të traditës, bile kanë të miratuara ligje përkatëse. Shpesh iu nxjerrin telashe ndërtuesve kur dëshirojnë të ndërtojnë mbi të vjetrën diç të re, moderne, – shtoi Bardhi.

– Ashu, a, – tha ai, pastaj iu kthye Miranit: – Unë kam një shqetësim të madh: Këtu nuk bëkam dot pa fëmijët dhe gruan.

– Kaq shpejt u mërзите, – ia ktheu Vasili. – Ne emigrantët shqiptarë, që jemi me dhjetëra mijë nga Kosova, jetojmë që prej më shumë se dhjetë vite pa gra e fëmijë. I shohim vetëm nga njëherë në vit. Jetojmë tamam siç e thotë ndonjëherë Mirani, si skllëvër modernë.

– Mos ju paça borxh, si e përballokeni jetën pa familje, – tha Jusufi. Në zërin e tij u hetua keqardhja dhe dhimbja për emigrantët ekonomikë.

– Sa ta shohësh jetën tonë të përditshme, – vazhdoi Vasili, – dhe do të të vijë akoma më keq.

Ndeja dhe biseda zgjatën për rreth dy orë, meqë Jusufit i interesonte mënyra e jetesës dhe përjetimet e emigrantëve. Ai bisedonte kryesisht me Vasilin. Pastaj u bisedua për mundësitë se si Jusufit do të mund t'i vinte sa më parë familja. U bisedua për ligjet dhe si duhej ai të vepronte për të rregulluar strehimin politik. Më vonë dolën nga lokali dhe shkuan në banesë të Bardhit. Vasili kërkoi leje të shkonte në konviktin e tij, meqë qyteti i tij, Essling ishte vetëm rreth 30 km., larg nga Ludwigsburg-u, duke propozuar ta merrte edhe Miranin me vete për të fjetur. Jusufi këmbënguli ngaqë dëshironte ta kalonin natën së bashku, edhe pse Bardhi nuk i kishte kushtet aq komode. Edhe Bardhi shkoi për të bërë muzikë.

Në banesë mbetën vetëm Jusufi e Mirani.

– Meqë jemi vetëm dhe kemi nge, – tha Jusufi, – dhe nëse nuk je i lodhur nga udhëtimi i gjatë dhe nga bisedat që bëmë deri tani, do të kisha dëshiruar të njiheshim më mirë. Ta zëmë, kur dhe përse e ke lëshuar Kosovën. Në fakt më ka rastisur të lexoj ndogjë për ty në shtypin zyrtar dhe të dëgjoj nga të tjerët që kam pyetur, por tani po më jepet rasti të informohem nga ti, nëse nuk nguron të më informosh.

– Jo, nuk ndihem i lodhur. Të udhëtosh me trena të këtushëm është pothuajse njësoj si të qëndrosh në shtëpi ose në restorant. Gjithashtu nuk kam përse të nguroj të të informoj për ato që të interesojnë, sado që nuk janë gjithaq interesante. Arsye konkrete që të marr vendimin për arratisje, siç do ta quaj unë, edhe pse kam ikur me pasaportë jugosllave, ka qenë një ngjarje e rastit në fakultet. Në fund të majit të vitit 1976 u detyrova të arratisesha nga droja se do të arrestohesha në Kosovë. Ndoshta edhe nuk do të ndodhte arrestimi, por ç’i bësh frikës. Në fakultetin e shkencave të natyrës, ku po studioja në vitin e 3-të, në degën e Fizikës, pat ndodhur tepër spontanisht një grevë në prag të festave të nëntorit, në vitin 1975. Greva u bë kundër profesorëve serbë të Universitetit të Beogradit, që imponueshëm vinin për të na mbajtur ligjërata e provime në Prishtinë dhe njëherit na diskriminonin duke privilegjuar kolegët serbë. Ne kërkonim që të zbatohet Marrëveshja që kishin bërë Universiteti i Kosovës me atë të Tiranës, në kuadër të së cilës kishim të drejtë t’i kishim gjithë profesorët nga Tirana, për lëndët që mungonte kuadri i kualifikuar në Kosovë. Këtë grevë, strukturat partiake në fakultet dhe strukturat partiake e pushtetore në Prishtinë, e kategorizuan si grevë politike nacionaliste dhe mua e kolegun Armend M., nga Rrethi i Ulqinit, na fajësuan si organizatorë. Në fund, hetim pas hetimi, mbledhje pas mbledhjeje, të Lidhjes së Rinisë e Lidhjes së Komunistëve në fakultet, fajësimi u përqëndrua tek unë. Pritej vetëm vendimi definitiv përjashtues i këtyre strukturave, që të angazhohej pastaj policia. Rasti

ishite politizuar dhe kishte ndodhur edhe pozicionimi i profesorëve e studentëve, shumica në mbrojtjen time. Kishte edhe nga ata, që nuk dëshiroj t'ua përmend emrat, që kërkonin përjashtimin tim. Meqë po ngushtohet laku, falsifikova një vërtetim se gjoja do të bënim një ekskurSION shkencor në Poloni. Edhe vetë isha në Kryesi të Lidhjes së Studentëve, prandaj nuk e pata të vështirë të shfrytëzoj vulën e saj për të sajuar vërtetimin që më duhej për ta paraqitur para sektorit të APJ-së në Komunën e Pejës. Aty duhej ta merrja vërtetimin se mund të merrja pasaportë për të udhëtuar në Poloni në kuadër të ekskursionit shkencor. Fati e dëshi që brenda dy ditëve nxora pasaportën në SPB të Pejës, pa e biseduar këtë çështje me njeri të gjallë. Meqë kisha pasaportën në xhep, (Mirani asnjëherë nuk ishte dëgjuar të tregonte për arsyet e arratisjes së tij, ndaj ndjeu peshën e emocioneve) në mbledhjen e fundit në fakultet, që filloi në orën 17.00, pranova fajin dhe bëra autokritikë, sepse tani me këtë rast po merreshin komitetet e Lidhjes së Rinisë dhe të Lidhjes Komuniste të Kosovës, se gjoja në fakultetin tonë kishte lëshuar rrënjë organizimi nacionalist që po përkrahej edhe nga disa profesorë, anëtarë të LK së këtij fakulteti. Në mbledhje merrte pjesë edhe i deleguari i Komitetit, Dragan Cvijiqi. Pas fjalës sime filluan kritikën dhe pozicionimet e reja. Disa nga profesorët që më mbronin nga përjashtimi i kisha informuar për vendimet e mia. Ndaj ata menjëherë ndërruan pozicion, sipas marrëveshjes. Të tjerët, që nuk i kisha informuar, u zunë të befasuar. Ata që më sulmonin pa asnjë vetëpërmbytje, u gëzuan më në fund se doli e tyre. Edhe studentët Gani Jashari e Mahmut Alidemaj, mezi pritën të ulërinin se sa të drejtë kishin pasur në anatemimin me zell të tyre ndaj meje.

I lashë duke diskutuar dhe bëra sikur po shkoja në tualet. Tutje ika në banesë, mora plaçkat dhe drejt e në stacion të trenit në FushëKosovë. Në orën 23.30 erdhi treni drejt për në Mynhen.

Në fakt, nuk i droja gjithaq presekutimit, sepse kisha një eufori djalo-

share, por mendova: më mirë të arratisem. Së paku punoj për të ndihmuar familjen e varfër, në vend që t'i bëhem asaj edhe një barrë më shumë. Fati e deshi që të regjistrohem këtu për studime, pasi fillimisht me ndihmuan shumë vëllai dhe kunata, të cilët ishin emigrantë ekonomikë...

– Të lutem pusho pak! - ndërhyri Jusufi. Po më vjen mirë që këto që the përputhen me ato që kisha dëgjuar për ty në Kosovë.

Mirani u ndje i lehtësuar dhe i kënaqur nga vlerësimi që bëri Jusufi dhe për ta fshehur këtë gëzim ngazëllyes mori nga tavolina gotën me lëng, servuar qëkur nga Bardhi, dhe po e mbante më gjatë se sa i duhej kohë që ta pinte të tërën.

Pas një pauze të vogël, Jusufi sërish ndërroi temën e bisedës. Me gjasë ai e hetoi që Mirani nuk e rrëfente me dëshirë jetën e tij. Tani ai donte të informohej për jetën studentore në Gjermani.

Pas lodhjes, në orët e vona të natës, erdhi gjumi dhe i mori të dy në mbretërinë e tij.

KAPITULLI II

Të paktën dy herë në muaj Mirani udhëtonte për në Ludwigsburg, te Jusufi e Bardhi. Të shpesh të herave ndodhte që Vasili të shkonte te Mirani të premteve, vonë, meqë punonte deri në orën katërmëdhjetë. Ata flinin në Bochum dhe të shtunave, herët, niseshin me automobil të Vasilit për te Jusufi e Bardhi. Udhëtime këto me një distancë tutje 400 km.

Kësaj radhe, pasi arritën, kryen ritualin e rëndomtë të përshëndetjeve, pinë kafet e para për mirëseardhje. Pastaj Jusufi i njoftoi për të rejtat, duke iu drejtuar Miranit:

– Më ka telefonuar njëfarë Emir Fatahu, i cili më tha se e ka pseudonimin Emil Kastrioti. E njeh ti atë?

– E njoh, për aq sa mund të njihet njeriu në këto rrethana, – u përgjigj, duke mos treguar interesim për të biseduar për Emirin kësaj radhe.

– Bardhi më ka folur shumë pak për të, ndërsa Emiri më tha se dëshironte të njihet me mua dhe më luti që të angazhohesha për të shkruar për gazetën e tyre. Prandaj më intereson mendimi yt.

– Thënë të drejtën, nuk qeshë i interesuar të bisedojmë për të, meqë para ca kohësh jemi zënë, ndaj mund të keqkuptohem.

– Gjithsesi, dëshiroj të dëgjoj mendimin tënd, qoftë ai edhe subjektiv, edhe pse, siç të kam psikologjisur, nuk je nga ajo racë. Je tepër konkret dhe i sinqertë, ndonjëherë deri në naivitet.

– Meqë po insiston, Zotëri Emir Fatahun e kam takuar para një viti e gjysmë, për herë të parë. Ndoshta në tetor të vitit 1978. E kam takuar në një tubim të emigracionit kroat. Diskutimi i tij në atë tubim, thënë të

drejtën, nuk më pat pëlqyer, meqë përmbante vetëm slogane të radhitura pakuptim. Më erdhi keq, si shqiptar që ishte, meqë kroatët e pranishëm po e tallnin e injoronin. Megjithatë, patëm biseduar për mundësi të bashkëpunimit, për çka ai ka qenë tepër i gatshëm. Unë isha i rezervuar ndaj tij, ngase një mik kroat kishte dyshime për të. Së fundi kemi pasur një si incident të rëndë, nëse mund të thuhet kështu. Që atëherë nuk komunikojmë më.

– Sigurisht, ti mban ditar ose shënime dhe mund t'i kesh më vete kur mban këtë çantë kaq të madhe, – i foli Jusufi.

– As ditar dhe as shënime nuk mbaj. Në fillim të jetës në ekzil nisa të mbaja ditar, madje edhe për imtësitë më të vogla jetësore. Më bëhej se po më ndihmonte të zvogëloja mërzitë që ndieja për shkak të largimit nga Kosova. Pas 5–6 muajve e ndërpreva. Lodhesha duke shkruar dhe nuk më pëlqenin ato që shkruaja. Shpesh i rilexoja. Nuk më duke-shin të formuluar mirë, sepse ndonjëherë lexoja gjëra për të cilat bëhesha pishman pse i kisha shkruar. Mendoja se ndoshta ato do t'i lexonte edhe ndokush ndonjëherë. Grisja fletë dhe i rishkruaja. Shkaktuhej parregullësi në ditar, meqë ishin të radhitura ditët vijuese dhe kështu prishej renditja. Mundohesha të zbukuroja sjelljet e të zmadhoja aktivitetet e mia. Dikur m'u mbush mendja: Nuk u mbaka ditar objektiv, ndaj nuk ia vleka të harxhosh gjithë atë energji. I dogja ato që kisha shkruar dhe më kurrë nuk kam mbajtur ditar. Tani po përdor fletore kalendarike, nga ato që blehen të gatshme, sa për të shënuar terminet dhe ndonjë shënim shoqërues. Por edhe me këtë nuk jam i rregullt. Kalendar i termin-eve po më rikujton ato që kam për të bërë, meqë kujtesën nuk e kam të ushtruar për të mbajtur mend shumëçka. Këtë kalendar po e përdor që kur dëgjoja proverbin kinez: “Budallënjtë mbajn mend, të mençurit i shkruajn në letër ato që duhet të mbahen në mend.”

– Interessant, po më bën përshtypje me këto që the për ditarin. Sikur ma mbushe mendjen se vërtet ditarët janë subjektivë dhe kur i lexojmë

të botuar, ta zëmë ditarët e kujtimet të ndonjë personaliteti, u dashka pasur parasysh këtë fakt. Tani, po ma dhe kalendarin e termineve, ndoshta gjej ndonjë shënim për takimet që ke pasur me Emir Fatahun.

– Sigurisht që po ta jap. Por, meqë po këmbëngul të dish mendimin tim për atë Zotërinë, atëherë po ta jap ta lexosh një shkrim që e kam menduar si një ese politik. Duhet ta kem më vete, pasi gjerat që kam shkruar e shkruaj po i mbaj më vete, me shpresë se do të gjendet rasti për të t'i dhënë që t'i vlerësosh dhe, nëse meritojnë, t'i redaktosh. Këtë shkresurinë, që unë po e quaj ese, e kam titulluar “Kënetat e bretkocave”.

Derisa fliste Mirani po e kontrollonte çantën ku nxori që andej fletoren kalendarike dhe ia zgjati Jusufit. Pas pak e gjeti edhe shkrimin në fjalë. Për një çast u hamend: ta nxirrte apo të gënjente se nuk e kishte marrë me vete, meqë ndihej i zënë ngusht midis një ndjenje pasigurie. Ndoshta Jusufi do të zhgënjehej për nivelin e ulët të shkrimit. Ai kishte merakun e përsosmërisë së gjuhës pothuajse deri në fanatizëm. Dëshironte që gjuha të shkruhej e të flitej më bukur dhe shpesh bëhej nervoz kur haste në nivel të ulët të saj.

– Ma jep, se po më duket e gjete, – ia preu hamendësimet Jusufi.

– Menjëherë, vetëm shikova mos kam pështjellë ndonjë fletë, – provoi të arsyetonte ngurrimin e vetë tjetri.

Ia zgjati shkrimin duke mos qenë në gjendje ta fshihte merakun për reagimin që do të shfaqte Jusufi.

Sapo e mori shkrimin në dorë, ai sqaroi se do ta lexonte më vonë për të mos e prishur ndenjen dhe bisedën e lirë. Megjithatë, s'u durua pa ia hedhur një vështrim titullit pak pa e vënë mbi cep të tavolinës. Papritmas tha: – Do të më falni, titulli po më provokon, prandaj po ik në dhomën tjetër që ta lexoj dhe kur të kthehem e vazhdojmë bisedën.

2.

Në dhomën tjetër Jusufi nisi të lexonte shkrimin që Mirani e kishte

quajtur ese, pa qenë i sigurt nëse ishte i tillë.

“KËNETA E BRETOKOAVE

Në fund të qershorit të vitit 1979, rreth orës tre të mëngjesit, Mirani u tremb kur dëgjoi t'i thyhej furishëm dera e dhomës në konviktin. Në dhomën e tij të vogël rufeshëm hynë shumë policë të maskuar, me helmata dhe të armatosur më shumë se sa policët e rëndomtë. Pa i dhënë shans të zgjohej nga krevati, policët ia vunë tytat e armëve sipër. E urdhëruan që të mos lëvizte. Përdhunshëm e prangosen dhe nuk e lejuan as të ulej në shtrat. Njëri i rrinte sipër, me njërin gju mbi shpinë, duke ia mbajtur tytën e armës pas qafe. Në fillim u frikësua se mos ishin kidnapues nga Jugosllavia, që mund të ishin kamufluar si policë gjermanë. Por, kur i dëgjoi të jepnin urdhëra në gjuhën gjermane, atëherë u bind se ishin policë gjermanë. Ai u lehtësua pasi, sidoqoftë, policia gjermane do të zbatonte ligjet e rregulloret përkatëse.

Në këtë kohë Gjermania është në panik nga terrorizmi i organizatës RAF, Rote Army Fraktion. Kishin ndodhur atentate të sofistikuara ndaj personaliteteve e objekteve, të cilat i merite përsipër RAF-i. Parlamenti dhe qeveria kishin marrë vendime të veçanta. U formua një polici speciale antiterroriste e emërtuar GSG 9, të cilës i qenë dhënë kompetenca të jashtëzakonshme. Gjithandej në Gjermani ishin afishuar pllakate në kërkim të pjesëtarëve të RAF-it, duke iu orfuar qytetarëve shpërblime të mëdha për zbulim a kapje të anëtarëve të kësaj organizate terroriste.

Edhe lëvizja studentore ishte radikalizuar e politizuar deri në skajshmëri. Mirani, po ashtu, ishte i angazhuar në këtë lëvizje studentore. Ai tashmë ishte në Kryesi të Lidhjes së Studentëve në Universitetin e Bochumit. Afirmimi i tij kishte ndodhur rastësisht në një tubim të gjerë të studentëve me Ministrin e Arsimit. Ky tubim që bërë në fund të grevës dy-javore, gjithëpërfshirëse, të studentëve, të cilët kishin ngritur barrikada për të mos lejuar hyrjen e policisë në Universitet. Kërkesat ishin të shumta, po ndër më të rëndësishmet: kushte më të mira dhe buxhet më të madh për studime; gjelbrim të hapësirës së universitetit; ngjyrosje të godinave masive të universitetit e të tjera. Vërtet në këtë universitet të mbyste vrazhdësia e njëtrajtshme e ngjyrës gri të betonit. Opinioni publik e quante universitetin industrial, që ishte ndërtuar rishtas, me kapacitet për 150 mijë studentë. Tani studionin 60

mijë, për të pritur nga viti në vit, që të bëheshin 150 mijë. E gjithë kjo madhësi gri, thuhet se ishte bërë shkas që në këtë universitet të ndodhnin shumë vetëvrasje të studentëve, mesatarisht një në javë. Në atë tubim, në amfiteatrin me njëmijë e pesëqind ulëse, pamja e të cilit nga jashtë i ngjante kokës së Afroditit mitologjik, Mirani kishte marrë fjalën në debatin me Ministrin. Ndër të tjera ai kishte thënë: “Më mirë e kishim ne studentët nën ditaturën komuniste në Jugosllavi. Atje nuk kishim asnjë të drejtë për kurrëfarë proteste, kurse këtu kemi të drejtë të protestojmë, por nuk na plotësohen kërkesat. Pra, atje të paktën kurseheshim, që të mos protestonim kot, ndërsa këtu, na lejohet të lodhemi në protesta dhe kërkesat nuk na plotësohen. Ky, Zotëri Ministër, ndoshta duhet të jetë njëri nga dallimet midis të demokracisë tuaj këtu dhe diktaturës komuniste atje!” Ministri e hetoi ironinë e fjalës së Miranit, u ndie ngusht, ndërsa rreth dy mijë studentë pjesëmarrës që rinin edhe në këmbë, anash ulëseve, ia plasën duartrokitjes së gjatë. Kjo fjalë Mirani ia siguroi votat në zgjedhje për të qenë anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Studentëve të këtij Universiteti, të cilën të gjithë e thërrisnin shkurtimisht: ASIA.

Sapo Mirani u këndell nga trembja e parë, hetoi se uniformat që mbanin policët ishte uniforma të njësisë antiterror GSG 9. Ai e dinte se nuk kishte të bënte asgjë me RAF-in bile, kundër praktikës së kësaj organizate, kishte bërë kritikë në një mbledhje të Kryesisë së studentëve, kur po diskutoheshin nëse duhej ose jo të përkrahej politikisht RAF-i. Prandaj, atij menjëherë i shkoi mendja te një shkrim që kishte bërë Emir Fatahu, në gazetën “Hrvatska Drzava”, të cilën e nxirte në Mynhen një grupim i emigrantëve të djathtë kroatë. Në atë artikull Emiri kishte shpifur se gjoja Mirani është terrorist, hiç më pak se anëtar i RAF-it dhe shpifje të ngjashme. Këtë shkrim ai e kishte shkruar për t’u hakmarrë ndaj Miranit, i cili i kishte ndërhyrë në punët e brendshme të organizatës që drejtonte ai. Për këtë shkak Emiri i kishte shkruar edhe letër kërcënuese Miranit dhe e kishte kërcënuar edhe përmes bisedës telefonike.

Sapo i kishte rënë ndërmend ky shkrim, Mirani iu kishte drejtuar kryepolicit, i cili kishte filluar ta merrte në pyetje, se mos shkas për këtë sulm duhet të ishte dizinformata, e botuar në gazetën kroate “Hrvatska Drzava”. Në përgjigjen e komandantit, sado që e kërcënoi Miranin për të mos pyetur fare, u vetëkuptua se ai shkrim ishte shkaku për atë sulm.

Me të dëgjuar gjithë atë rrëmujë të zhumshme të policisë qenë zgjuar studentët e katit dhe pastaj edhe të gjithë konviktit. Ata bllokuan korridorët, hollin, hyrjen

kryesore, sa që policiët nuk mund të dilnin jashtë. Rasti u skandalizua, sa u detyruan të vijnë anëtarët dhe kryetari i Kryesisë së studentëve të Universitetit, rektori, politikanë nga Komuna e Bochumit dhe qeveritarë nga Bonni. Ky bllokim zgjati deri në orën 11.00 të asaj dite, sepse në ndihmë të studentëve të këtij konvikti kishin ardhur edhe qindra studentë të konvikteve të shumta, të ndërtuara në atë lagje. Studentët protestues po kërkonin sqarime për këtë sulm nga njësi policor antiterror GSG 9, se si kishin guxuar të cenonin sovranitetin e konviktit dhe të jetës së studentëve. Më vonë, institucionet përkatëse të Bonnit i kërkuan falje Miranit për gabimin që paskësh ndodhur në bazë të një dezinformate të bërë publike në një gazete estremiste të emigracionit kroat dhe në bazë të disa shpifjeve që kishin bërë individë të caktuar. Mirani kishte kërkuar përmes avokatit të tij që të tregoheshin emrat e shpifëve, por kishte marrë përgjigje mohuese, me arsyetimin juridik se iu përmbahen vendimeve të veçanta për të garantuar anonimitetin e informuesve që duan të ndihmojnë në zbulimin pjesëtarëve të RAF-it.

Emir Fatahu, i cili me foddullëkun që e karakterizonte po e quante veten Emil Kastrioti, sipas bindjes së Miranit, nuk kishte asnjë të dhënë për të shkruar ashtu në gazetën kroate dhe në pamfletin e tij "Besa Shqiptare", dhe as ta kërcënonte atë me telefon e letër. Ai dyshonte se këtë Emiri e kishte bërë vetëm me urdhër nga Beogradi, meqë kjo hakmarrje kishte lidhje me disa zhvillime që kishin ndodhur.

Në fillim të qershor të këtij viti Beslidhja Kombëtare Shqiptare kishte mbajtur kongres, siç i thoshin pjesëmarrësit një tubimi, në të cilin nuk ishin të pranishëm më shumë se pesëmbëdhjetë veta. Këta ishin edhe e gjithë anëtarësia e kësaj organizate. Pos krytarit, Emir Fatahu, në atë tubim kishin marrë pjesë një ish-nëpunës i Konsullatës jugosllave në Dortmund dhe disa persona të inkriminuar në veprimtari udbeske dhe kriminale, si Vebi Ibrahim i nga Brukseli, F.D., R.Z., dhe të tjerë të vetëquajtur patriotë. Pjesa më e madhe e tyre kanë gra ose dashnore serbe, të cilat ata mundohen t'i kamuflojnë si kroate ose si bosnjake.

Përplasjet e Miranit me Emirin kishin filluar më herët, gjatë bashkëpjesëmarrjes në tubime të ndryshme. Por, meqë Mirani po e riste dyshimin ndaj tij, kishte filluar të mbledhte informata për të mësuar se cili vërtetë ishte ky farë Emil Kastrioti! Pjesërisht, për vendlindjen dhe veprimtarinë e kishte informuar vetë Emiri. Ai kishte qenë mësues në një fshat të Rrethit të Mitrovicës. Prej andej ishte larguar pa e

ditur askush se ku kishte shkuar, ndërsa të njohurit i kishte dezinformuar, se studionte në Zagreb, madje hiç më pak se filozofinë. Mirani nuk i kishte besuar. Këtë mosbesim ai e mbështeste në paraqitjen e Emirit fodull e sharllatan, kohën më të madhe me llullë të madhe në gojë, për të pozuar filozofin. Mirani gjykonte se ky njeri vetëm filozof nuk mund të ishte. E shumta, mund të kishte vetëm diplomë të falsifikuar të mësuesit, nga ato diploma që i kishin shitur sekretari Musa Hoti dhe drejtori i Shkollës Normale në Mitrovicë. Këtë mendim ai e bazonte edhe në nivelin e ulët të shkrimeve të tij në pamfletin “Besa Shqiptare”, organi i Beslidhjes; në letra dhe në paraqitje gojore të tij. Mirani madje po dyshonte se mos Emiri kishte qenë në aftësimin përkatës, në bazat e UDB-së në një ishull në Bregdetin kroat. Për këtë i kishin folur disa miq kroatë. Meqë ai nuk i shndërronte lehtë dyshimet në konstatime, përqëndrohej në vlerësim të veprimeve konkrete të tij dhe mbi bazë të tyre formonte vlerësim. Pastaj miqtë kroatë e kishin informuar se Emiri atje ishte përgatitur konkretisht për t’u infiltruar në emigracionin politik kroat. Pikërisht për këtë qëllim ai paskësh sajuar një organizatë pseudonacionaliste shqiptare. Në kuadër të përpunimit të gjithë këtyre informatave e dyshimeve, Mirani pat shfrytëzuar edhe një profesor kroat, Dr. Petriqin, të Universitetit të Zagrebit, i cili ishte mysafir për një vit në Universitetin e Bochumit. Këtë profesor Mirani e pat lutur të informohej nëse Emir Fatahu, vërtet kishte studiuar filozofinë në Zagreb. Profesori, duke shfrytëzuar lidhjet e tij me rektorin, e informoi Miranin, se emri i Emir Fatahut nuk figuronte i regjistruar ndonjëherë në Universitet të Zagrebit. Kjo e dhënë ia përforcoi dyshimin se vërtet Emiri duhej të ishte dërguar në Gjermani nga UDB-ja, që ta informonte për emigracionin kroat, por tani, meqë kishte filluar organizimin edhe emigracioni i shqiptar, duhej të ishte urdhëruar të informonte edhe për të.

Mirani e njihje Fekir Dalenën, nga fshati Kodëmajë i Deçanit, qysh kur ishte në Kosovë. Deri në fund të viteve të 60-ta, formalisht ky ishte i punësuar në Postë të Pejës, por realisht punonte për UDB-në. Me rënien e Aleksandër Rankoviçit, Ministrit federativ të Punëve të Brendshme, edhe Fekirin e përjashtojnë nga puna në Postë, meqë po akuzohej si bashkëpunëtor i Vuj Radiçit, shef UDB-së në Pejë. Pastaj ai kishte shkuar në Vjenë. Mirani mendonte se atë e kishin dërguar në Vjenë, por tani jo UDB-ja e Kosovës, por organizimi paralel në Kosovë, në Serbi e më gjerë, nga bashkëpunëtorët e afërt të Rankoviçit të përmbysur. Ky farë Fekir Dalena, që kishte nivel më të ulët se një gjysmanalfabet, në pseudokongresin e

Emir Fatahut, ishte emëruar kryeredaktor i pamfletit “Besa Shqiptare”. Kjo po e iritonte së tepërmi Miranin, i cili, pos njohjes se mëhershme nga Kosova, tani ishte informuar edhe nga disa bashkatdhetarë se ai në Vjenë po merrej meurvejim të Ambasadës Shqiptare për të parë se kush nga emigrantët shqiptarë të Kosovës e frekuenton atë.

Të gjitha këto se bashku, bënë që Mirani të shkojë në Vjenë. Atje ai do të mësojë adresën e Fekirit dhe me eufori, ndoshta naive, siç dyshonte ndonjëherë për veten e tij, shkon për vizitë tek ai. Sapo i cingëron në zile, hap pakëz derën një mashkull thatim, që dukej se kishte hyrë në dekadën e 6-të të moshës. Atë pakhapje të derës e siguronte një zinxhir dhe Fekirit po i dikuj vetëm gjysmëfytyra. Miranit iu kujtua ajo fytyrë sado që kishin kaluar shumë vjet pa e parë.

– Çfarë dëshironi, – pyeti Fekiri në një gjermanishte të mjerë.

– Jam Mirani, Miran Bruçi. Nuk po më mbani mend, – i foli shqip ky duke u munduar të mos shfaqte as më të voglën ndjenjë urrejtje për të.

– Nuk ju njoh, ke kërkoni, – u përgjigj e pyeti tjetri, por tani shqip.

– Ju kërkoi juve, Zotëri Fekir Dalana, – iu përgjigj sërish me qetësi të madhe Mirani.

– Unë nuk jam Fekir Dalana dhe juve nuk po ju njoh fare! – foli ai pa mundur ta fshihte gënjeshtërinë e tij naive.

– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan. Tani sigurisht po të kujtohem. Sa herë ju kam bërë kafe kur vinit te gjyshi lbush dhe ju me lavdëronit për kafet e mira.

– O, po, më fal, urdhëro nipash, tani po më kujtohesh, – tha Fekiri duke hapur derën dhe duke u munduar të zgërdhihej sikur po i bëhej qejfi që po e vizitonte Mirani.

Mirani u fut brënda duke u bërë se ishte i gëzuar që po takonte pas shumë vjetëve kolegun e shokun e Dajës Ramadan. U përqaftuan dhe Mirani zuri vend aty ku e drejtoi mikpritësi. Ndërmuan fjalët përshëndetëse duke pyetur për hallet, jetën etj. Pastaj Mirani hapi bisedën për qëllimin e ardhjes.

– Zotëri Fekir Dalana, të përgëzoj që je zgjedhur kryeredaktor i Organit “Besa Shqiptare”. Më është bërë qejfi që jeni zgjedhur pikërisht Ju, meqë ju njoh që moti për patriot. Për ju më ka folur shumë Daja Ramadan dhe bile, kur fola para dy ditëve me të në telefon, më porositi t’ju përshëndes, meqë i tregova se do të vija në Vjenë. Ai më tregoi se Ju jeni këtu dhe më këshilloi për mundësinë e gjetjes se

adresës suaj të dajat në Nürnberg.

Mirani po e vështronte Fekirin për të mësuar se ç'efekt po i bënin këto lojëra atij.

– Faleminderit, sa po më bëhet qejfi që më keni ardhur për vizitë... – ndërhyri Fekiri, edhe pse Mirani nuk e kishte ndërmend ta ndërpriste lojën mashtruese, duke u kujdesur që ta bënte sa më tërheqëse. Megjithatë, edhe Mirani ia ndërpreu fjalën pa prituri:

– Më ka ardhur keq që nuk kam mundur të marrë pjesë në kongresin tuaj në Domsdorf. Isha i ftuar personalisht nga Zotëri Emil Kastrioti, por fatkeqësisht, nuk munda të vij, meqë isha i shtrirë në spital. Edhe për pamundësinë tuaj, që të mermi pjesë, më ka ardhur keq, pasi pjesëmarrja juaj do ta kishte ndëruar atë kongres. Më vonë u informova se kongresi juaj kishte qenë shumë i suksesshëm dhe veçanërisht m'u bë qejfi që kongresi ju emëroi kryeredaktor të organit tuaj, "Besa Shqiptare". Tani, pikërisht pse ju jeni kryeredaktor, jam i gatshëm të shkruaj për këtë organ, meqë dëshiroj një bashkëpunim sa më të ngushtë. Thënë të drejtën, po më lejuat, tani e tutje do t'ju thërras Dajë, meqë ke qenë mik e bashkëpunëtor i ngushtë me Dajën Ramadan.

Të gjitha këto ai po ia thoshte me një gjakftohësi që do karakterizonte një profesionist të sprovuar. Përbrenda i zienin dilemat: ta mbys këtë qelbësi që kishte shërbyer me zell aq primitiv në strukturat më të errëta të nacionalizmit serb, të komanduara prej Aleksandër Renkoviçit. Me vete nuk kishte asnjë lloj arme. Nuk kishte shkuar me atë qëllim, jo se i dhimbsej, apo se e pengonte ndonjë moral prej besimtari, por sepse nuk ishte në natyrën e tij të vriste qoftë edhe një kriminel, pavarësisht nga urrejtja e madhe.

– Mirë qenke informuar për kongresin tonë dhe akoma më gjerësisht do të lexosh në "Besën Shqiptare" që po e përgatis, – erdhi reagimin me një vetëkënaqësi fëmijërore i Fekirit. – Njëherit ju falenderoj për gatishmërinë që të bashkëpunoni me gazetën tonë. Vërtet të paskam nipash, meqë je nip i shokut tim të ngushtë, por tani më bëheni edhe më i afërt se një nip, meqë po bëheni bashkëpatriot dhe bashkëveprimtar imi. – Ti, - vazhdoi ai pasi ruffiti kafën, - mbase ke marrë vesh se në kongres themeluam ushtrinë, se zgjodhëm komandant të përgjithshëm një patriot e trim, më duket e ka emrin Vebi Ibrahim. Prandaj Jugosllavia i ka ditët e numëruara.

Kështu po dërdëlliste Fekiri, pa ditur se cilin kishte përballë dhe me cilin qëllim

i kishte shkuar ai në shtëpi. Të dy ishin ulur ballë për ballë buzë një tavoline të vogël. Dhomëza ishte një kthinë e vogël, që shërbënte si kuzhinë dhe njëherit edhe si dhomë ndenjeje. Gruaja e Fekirit po rrinte në këmbë duke përgatitur kafe, po edhe bukën. Mirani ishte në dilemë, si të vepronte, meqë prania e saj po e ngushtonte. Ndonjë informatë tjetër interesante nga Fekiri ai tashmë nuk priste, meqë nuk ishte ai nga ata që duhej të dinte shumëçka për organizatën Beslidhja Kombëtare Shqiptare, as për anëtarët, as për rolin e vërtetë të secilit prej tyre. Dhe, meqë ishin bërë publike të gjitha që kishin ndodhur në atë farë kongresi përmes përfoljes së pjesëmarrësve që ishin ngarkuar ta propagandonin, Mirani mendoi se nuk ia viente ta dëgjonte edhe Fekirin. Mori frymë me thellë dhe u drejtua.

– Dëgjo këtu, Fekir Dalana! Pa guxuar të lëvizësh nga vendi, do nxjerrësh menjëherë çfarë ke në xhepa! – urdhëroi Mirani të cilit, siç dukej, i kishte humbur durimi për të vazhduar çfarëdo bisede të kotë me atë spiun. – Ti duhet t'i jesh mirënjohës pranisë së gruas sate që po të jap shansin për kontrollim të padhushëm. Ti e di, rankovciqist i qelbur, se ç'krime ka bërë soji yt ndaj popullit tonë, se ma keni mbajtur babën të lidhur për kumbull për ditë e net të tëra në oborr të stacionit të policisë në Kličinë gjatë netëve të dimrit të rëndë, se keni qitur njerëz në pritë duke i mashtruar se po i ndihmoni për t'u arratisur në Shqipëri, se keni përzënë mijëra shqiptarë për në Turqi e çka nuk keni bërë ju! Tani ke ardhur të vazhdosh atë shërbim këtu në Vjenë, meqë në Kosovë je i diskredituar! Shpejt nxiri gjërat që ke në xhepa, nëse dëshiron të rrosh si qen i zgjebosur dhe mos më shiko i hutuar. Jam vetë Miran Bruçaj, nuk i ndërroj emrat si ti, qelbësirë, prandaj mos prit, nxiri të gjitha gjërat që ke në xhepa, pastaj do ta kontrolloj banesën!

Fekiri u mpi. Fytyra iu bë si fytyrë kufome. E kaploi një frikë e ankth sa nuk guxonte as të ulërinte. E shoqja, pasi nxori një klithmë, sikur u shndërru në statujë dhe po vështronte herë Miranin gjakftohtë, që nuk lëvizte fare, herë burrin e shastisur nga frika. Mirani e urdhëroi atë të shkonte në dhomën e gjumit, të cilës paraprakisht i hodhi një vështrim të shkurtër nëse kishte telefon. Me ngurrim të madh Fekiri futi dorën në xhep të brendshëm të setrës dhe nxori një pasaportë jugosllave, pas gjëpurave nga xhepat anësor, duke ua qitur edhe astarët përjashta. Ngadal e lëshoi mbi tavolinë pasaportën dhe priste reagimin e tjetrit. Pastaj, me zë që mezi po i dilte, si një kufome të gjallë, mundi të thoshte:

– Nuk kam gjë tjetër në xhepa.

Mirani u duk i befasuar. Nuk kishte pritur që aq shpejt e aq lehtë do ta detyronte Fekirin të dorëzohej. Se si iu kujtua një këshillë e babait: “Biro, shpiunat shqiptarë që punojnë për shpirt, nuk kanë kokërr trimnie. Mbaje mend, trimat nuk bahen kurrë shpiuna të pushtuesit!” Mirani po habitej se si ky farë mistreci kishte filluar të dridhej. Filloi ta shfletonte me kureshtje pasaportën e kuqe, të zhubravitur që dëshmonte se shpërdorohej intensivisht. Po e shfletonte atë pasaportë të falsifikuar. Lexoi emrin e sajuar, Ferid Nurković dhe pa fotografinë e mistrecit Fekir, e cila ia nxiste urrejtjen e sforcuar. Pa dhe faqet në vijim, përplot vula kufitare të vendkalimit jugosllav afër Suboticës. Ato dëshmonin se Fekiri kishte shkuar në Jugosllavi pothuajse një herë në javë, sado që në Vjenë kishte kërkuar strehim politik dhe publikisht merrej me veprimtari patriotike, madje edhe si redaktor i një pamfleti, në dukje tepër antijugosllav. Pasi e shfletoi deri në fund, e pyeti preraz:

– Kush ta ka dhënë këtë pasaportë?

– E kam blerë, – u përgjigj Fekiri me gjysmëzëri.

– Gënjen! Ta kanë dhënë eprorët e tu. Përse të është dashur, meqë këtu ke kërkuar strehim politik?

– Bëj tregti, çoj mall për të shitur në Jugosllavi.

– Edhe pse je arratisur dhe merresh publikisht me veprimtari patriotike kundër Jugosllavisë, siç shkruani ju vetë në pamfletin tuaj “Besa Shqiptare”!?

– Prandaj e kam blerë me emër tjetër, që të mos më njohin.

– Sigurisht, surratin tënd në Pejë e njohin të gjithë ata që do të duhej të të arrestonin.

– Nuk shkoj atje, meqë më njohin.

– Ku e shet mallin, meqë po gënjen se merresh me këtë punë?

– Në Novi Sad.

– Mos po të mbushet mendja se po më bind me këso gënjeshtërash, – e pyeti Mirani me merak, se ndoshta ai po formonte bindjen për mashtrim të suksesëshëm, dhe kjo shpesh e nervozonte atë, më shumë se sa vetë gënjeshtër që i bëhej.

– Unë po të përgjigjem saktë, – tha Fekiri duke bërë përpjekje që të nxirte zë sa më bindës.

– Sigurisht, – ia ktheu pakësa me ironi. – Tani mund të rish shpirtshëm, meqë nuk dëshiroj t’i fëlliq duart në ty, me kusht, të më tregosh se cilin ke epror nga këta të Beslidhjes suaj.

Mirani mori frymë thellë dhe po priste përgjigjen. Fekiri nuk po qetësohej dot.

– Ti dike për Beslidhjen tonë më shumë se sa unë. Po vetëkuptohet, shef e kam Emil Kastriotin.

– Po kur shkon në Jugosllavi, kujt ia përcjellë infomatat?

– Nuk jam spiun.

– Nuk të thashë se je spiun, por të pyeta kujt ia jep infomatat?

Fekiri heshti, me gjasë për të pritur reagimin e Miranit, nëse duhej të gënjente sërish edhe në këtë pyetje. Mirani e priti ca, derisa vendosi se si duhej të sillej ndaj tij. Nuk dëshironte të ndodhte ndonjë zhurmë për t'u alamuar fqinjët në ndërtesë.

– Përgjigju, mistrec! – e urdhëroi më zë të përmbajtur.

– Shkoj shpesh deri në Novi Sad, siç i pe edhe vetë vulat e kufirit. Atje, në UDB, më duhet të informoj një serb me emrin Radovan, – foli me zë të përhumbur sa mezi e dëgjoi Mirani. Kokën e mbante ulur, duart mbi tavolinë, siç e kishte urdhëruar Mirani.

– Pse thua, të duhet?

– Sepse në fillim më kanë rekrutuar me zor dhe kur një herë të rekrutojnë, nuk mund t'u dalësh i gjallë nga kthetrat e tyre.

– Si, as pas menjanimit të Rankoviçit dhe bashkëpunëtorëve të tij?

– Ata tani kanë bërë një riorganizim me ne, për të cilin nuk dinë organet në Kosovë. Mua më kanë detyruar të vij në Vjenë, duke improvizuar arratisjen për kërkim të azilit politik. Këtu më duhet ta survejoj Ambasadën e Shqipërisë, se kush hynë e del dhe të informoj. Njëherit duhet të informoj edhe për veprimtari të emigrantëve shqiptarë në Austri. Tjetër detyrë nuk më kanë dhënë.

Fekiri u ndal për një çast. Ngriti me drojë kokën për të vështruar Miranin nëse i mjaftonte kjo përgjigje. Tjetri dukej i vetëpërmbajtur në dukje, për të kamufluar kënaqësinë, meqë nuk e kishte parashikuar se do ta detyronte aq lehtë të rrëfente këtë spiun qelbanik.

– Në Austri ka jetuar disa vite Vehbi Ibrahim, i cili propagandonte se ka formuar ushtri shqiptare. Dij gjë t'i?

– As ti nuk beson në këtë gënjeshtëri të tij, prandaj po më pyet kot.

– Po të besoj, se ke filluar t'ju shërbësh serbomëdhenjëve nga frika, si shumë të tjerë, dhe frika është legjitime, prandaj pëmbahem të mos i ndot duart me gjakun tënd të fëlliqur. Por, trego nëse të kanë ngarkuar edhe me ndonjë punë tjetër?

– Për kokë të vajzës, kjo është e vetmja detyrë që kam tani.

Betimi në kokë të vajzës e neveriti Miranin, meqë kishte dëgjuar se ajo po ushtronte prostitucion në Vjenë. I kishin thënë se ishte e pashme e tërheqëse dhe se shqiptarët kurvarë në Vjenë garonin midis tyre që t'i jepnin asaj shilinga dhe të krekoseshin para njëri-tjetrit.

– Kush tjetër është i organizuar në këtë shërbim serbomadhi, paralel dhe gjysëmlegal, karshi strukturave legale, përkatëse, të Kosovës?

– Nuk e di, por mund t'i marrësh me mend vetë.

– T'i dija unë, nuk do të të pyesja.

– Jemi të gjithë që na kanë përzënë atëherë nga UDB-ja, që tani është riorganizuar si SDB. Janë disa burra me emër, si pleqnarë, në rrethinën e Pejës që mbajnë shalla të mëdhenjë rreth koke, nëse janë nga Rugova dhe shami të zeza, nëse janë nga Rrafshi i Dukagjinit. Takoheshim një herë në muaj në fshatin e banuar kryesisht me serb, që quhet Gorazhdë. Shef e kishim serbin VV, oficer i lartë, por i kamufluar si shitës i thjeshtë në shitore shtetërore në fshatit Zagaq.

– Cila ishte veprimtaria juaj?

– Të përcillnim intelektualët dhe funksionarët e rinj që janë zgjedhur e emërtuar pas rënies së Rankoviçit.

– Mjafton! – e ndërpreu Mirani duke gjykuar se nuk mund të zgjatej tepër me të.

Ra heshtja për disa çaste, meqë Miranit i duhej kohë për të menduar se çfarë të bënte, ndërsa Fekirin vazhdonte ta lodhte ankthi e frika për të papriturat që mundahej t'i merrte me mend.

Pas disa minutave Mirani e urdhëroi:

– Të gjitha këto që the dhe të tjerat që i di, por që harrove t'i thuash, do t'i shkruash dhe pastaj do të m'i postosh në adresë time që po ta jap! Nuk ke nevojë ta shkruash në letër emrin tënd të vërtetë!

– Si urdhëro nipalan, – u përgjigj, në dukje ca i lehtësuar.

– Meqë ua bënë këtë shërbim, përse nuk të japin më shumë para që të rrosh më mirë? E sheh se jetuake si kafshë, në këtë banesë të vjetër, me mobilie e kuzhinë të zgjebosur.

– Sepse iu dhimbsen paratë dhe ne, nga frika, shërbejmë edhe me pagesë simbolike.

– Mistreca të shkretë, punoni kaq shumë kundër popullit tuaj dhe nuk

paguheni mirë!

Këtë ia tha Mirani me sinqeritet, meqë besonte se Serbia nuk i paguante edhe aq shërbëtorët e saj shqiptarë.

– Pyetja e fundit: Përse pothuajse shumica e pjesëtarëve të organizatës suaj i kanë gratë ose dashnorët serbe, duke filluar nga Emil Kastrioti, Vehbi Ibrahim, e të tjerë si këta?

– Mendoj se ua kanë dhënë eprorët, për t'i mbajtur më mirë nën kontroll edhe jashtë. Po nga i di ti të gjitha këto, nëse më lejohet të të pyes?

– Të gjithë ata që i njohin, flasin për këtë dukuri, meqë jo të gjithë anëtarët i keni të rekrutuar nga kjo farë UDB-ja serbe. Disa i keni anëtarësuar, meqë i keni mashtruar sa për t'i përdorur për informatorë dhe për t'ua zhvatur ndonjë para në emër të anëtarësisë dhe të kontributit për veprimtari, në dukje patriotike. Ata të shkretë nuk ju njohin, por nuk durohen pa folur, meqë nuk u pëlqen pse i kanë gratë e dashnorët serbe.

– Edhe unë nuk ua kam begenshur atyre këtë përcudni. Ti e pe, unë e kam gruan shqiptare, atë që ma ka fejuar baba, sipas traditës.

Tashmë Fekiri dukej shumë më i çliruar, meqë po i ngjallej shpresa se nuk do t'i ndodhte ndogjë e tmerrshme, siç mund ta merrte me mend se e meritonte. Mirani vazhdonte të heshte, pa ditur se çfarë duhej të bënte. Pas pak iu drejtua:

– Dëgjo me vemendje Fekir Dalana. Po të jap vetëm një javë ditë afat që të ikësh nga Vjena dhe kurrë më të mos dukesh këtu dhe asgjëkundi në Perëndim! Pas një jave nuk ke besë më! Besoj më kuptove se e kam seriozisht! Mos harro të ma dërgosh letrën më informatat që t'i kërkova. Tani po ta jap adresën.

– Të jam mirënjohës, nipalan, meqë e di se si duhet gjykuar shërbëtorët e pushtuesit, por, për kokë të vajzës, unë nuk e bëjë këtë shërbim vullnetarisht. E bëjë nga frika...

– Mbaroi diskutimi! – e ndërpreu Mirani rrefimin e tij prej zuzari.

Në të ngritur për të dalë nga ajo kthinë e mykur ai ia hodhi mbi tavolinë një kartëvizitë. Doli pa ia zgjatur dorën dhe pa u përshëndetur, por i bindur se zuzari Ferik do të zbatonte urdhrin për të ikur nga Vjena.

Kur doli jashtë mori frymë thellë për të mbushur mushkëritë me ajër të freskët. Njëherë mendoi të shkonte në Ambasadën Shqiptare për të rrefyer se çfarë kishte bërë dhe sa lehtë e kishte detyruar Fekirin të rrefejej. Duke ecur drejt stacionit të

metrosë ndërroi mendim, meqë iu duk vetja se do të bënte po shërbim prej spiuni, sado që për shtetin e vetë, siç e përceptonte ai Republikën e Shqipërisë. Mori drejtimin për Ostbahnhof, me bindjen se atje do të takonte ndonjë bashkatdhetar, që do t'i bënte konak për atë natë në Vjenë. Gjatë gjithë rrugës po mendonte për ato që kishte përjetuar. Çuditërisht, më shumë ndjente keqardhje se sa urrejtje për Fekirin. Arsyetonte, si edhe herave të tjera: "Nuk janë krejt fajtorë këta mjeranë shpirtshitur. Po të kishim qenë të çliruar, nuk do ishin bërë shërbëtorë të pushtuesit...".

Kur arriti në Ostbahnhof u soll një copë herë vërdall dhe nuk takoi asnjë bashkatdhetarë. Mendoi se mund të ishte herët. Ata punojnë dhe duhet të pastrohen pasi të kthehen nga puna, të hanë dhe pastaj ndonjëri del për ta kaluar kohën në stacion, meqë nuk i rihet vetëm në banesë. U soll kështu rreth njëzetë minuta. U ul në një kafe dhe piu një çaj. Më shumë nga monotonia, vendosi t'i telefonojë Simon Ç. të Ambasadës Shqiptare, të cilin tashmë e njihnte. Vendosi kështu të mos i shkonte huç puna që kishte bërë. U fut në një kabinë telefoni, nga shumë kabina që ishin në këtë stacion hekurudhor, dhe solli numrin.

– Alo, Miran Bruçaj në telefon. Ka mundësi të flas me shokun Simon?

– Para një ore ka dalë. Ka mbaruar shërbimin, – dëgjoi përgjigjen e tjetrit nga Ambasada.

– Po, ka mundësi ta kontaktoni, t'i thoni se po pres në hyrje kryesore të Ostbahnhofit. Do ta pres 20 minuta.

– Nuk ta dëgjova qartë emrin!?! – foli tjetri.

– Miran Bruçaj, më njeh shoku Simon.

– Do përpiqem ta gjej.

Prapë brodhi disa herë poshtë e lart hollit të stacionit e disa herë doli edhe jashtë. Dhjetë minutat e fundit vendosi të rrinte jashtë, para hyrjes kryesore, duke shfletuar gazetën "Rilindja" që e bleu në kiosk. Dëshironte t'i binte në sy ndonjë bashkatdhetari që nuk e njihnte, duke u identifikuar përmes gazetës.

Ambasada Shqiptare ishte afër. Kaluan gjithsej pesëmbëdhjetë minuta dhe erdhi Simoni bashkë me një koleg të tij. Sapo i pa, mendoi me vete: "Edhe afër ambassade e praktikuakan të takojnë njerëz, duke qenë gjithnjë dy veta?". Katër-pesë hapa në të afruar, Simoni foli me të qeshur:

– Ku je or anarkist i papëmirësueshëm?

– Ku po më sheh, or komunist i devotshëm, – ia ktheu Mirani, po në të qeshur.

U përshëndetën ngrohtësisht, si të ishin vërtet shokë. Simoni propozoi të shkonin në një kafene të vogël në anën e majtë të stacionit, përtej rrugës që kalonte tangjent stacionit. Gjatë të ecurit krahas pyetën njëri-tjetrin për shëndetin e familjen. Zunë vend.

– Ke kohë që ke ardhur në Vjenë?

– Para katër–pesë orëve, – iu përgjigj Mirani.

– Përse nuk ke ardhur në Ambasadë për të pirë kafe?

– Nuk e di ku gjendet. Kam mbajtur mend se më ke thënë që është afër Ostbahnhofit.

– Ti e gjen edhe djallin kur të duhet. Paske edhe hartën e qytetit me vete.

– Ashtu mendon ti.

– Jo vetëm që mendoj, por ju anarkistët jeni të shkathët, – ia ktheu me ironi Simoni.

– Vërtet, u bë e dyta herë që po më ofendon. Mendon seriozisht se jam anarkist?

– Jo, more, po tallem. Nëse të mbetët hatri, nuk të thërras më kështu.

– Ti e di se mua nuk më mbetët hatëri as kur dëgjoj etiketime të tjera më fyese, prandaj nuk ke nevojë të kërkosh falje.

– Ke dalë për turizëm apo për veprimtari patriotike?

– Sikur po tallesh me mua, varfanjakun. Ku e kam hallin të bëjë unë turizëm?

– Të kuptoj, por m'u desh t'ia nis disi bisedës. Edhe pse nuk je i përshtatshëm për bisedë nuk ke nevojë të peshosh me peshore ari çdo fjalë, meqë jemi miq dhe bisedojmë si miq.

– Në rregull, sado s'më vjen mirë që më konsideroni të papërshtatshëm.

– Domethënë, e ke ndërmend ta peshosh çdo fjalë, që të mos mund të bisedojmë si miq?

– Sigurisht, dëshiroj bisedimin, por jo të më pyesni sikur jam në shërbim tuajin.

Simoni nuk foli. Bëri sikur e ka radhën porosia për të pirë, ndaj thiri kamarierin. Mirani e kuptoi se biseda rëshqiti drejt keqkuptimeve, prandaj u mendua se si ta normalizonte.

– Dola me pak punë në Vjenë dhe dëshirova të pimë nga një kafe së bashku.

– Atëherë mirë se ke ardhur dhe shumë mirë bërë që na telefonove, – foli me dashamirësi të hapur Simoni. Tjetri, Kujtimi, siç u prezantua, nuk fliste.

– Sapo bëra një sherr të vogël, – bëri tutje Mirani. – Isha për vizitë te spiuni Fekir Dalana...

– Ti ishe të Fekir Dalana? – e ndërpreu Simoni i befashuar. – E njihke edhe Fekirin?

– Po, ka qenë shok e koleg i dajës tim. E kam takur shpesh në Kosovë.

– Interessant, bota është e vogël dhe njëzëzit njihen midis tyre, edhe atëherë kur mendon se nuk njihen.

– Nuk isha për ta vizituar si shok të dajës. Ramdan e quajnë dajën tim. Isha për t'u kusuritur me të, si spiun i UDB-së rankoviçiane që është.

– Vërtetë, spiun është?

– Tallësh më mua?

– Më fal që të ndërpreva, na trego si shkoi puna, po deshe.

– Ai prej vitesh nuk është i UDB-së legale që tani quhet SDB, por i UDB-së se vjetër, që vazhdon të funksionojë paralalelisht me këtë SDB-në zyrtare, në gjysmlegalitet. Mendoni ju se vërtet Titoja e ka gozhduar Rankoviçin, siç po besojnë shqiptarët naivë?

– Nuk e dimë, ti mund ta dish më mirë, meqë ke jetuar në Kosovë.

Mirani tregoi në mënyrë të përmbledhur ato që kishte përjetuar. Në fund Simoni e pyeti:

– Je i sigurt se Fekiri do të iki nga Vjena?

– Siç e psikologjisa, jam i bindur.

– Na e paske bërë një nder, nëse ai ikën, se vërtet kosovarët frikësoheshin shumë nga ai, siç na tregojnë kur i takojmë në qytet, meqë dëshirojnë të vijnë në Ambasadë që të marrin literaturë, gazeta e revista.

– E keni fjalën për shqiptarët, emigrantë ekonomikë nga Kosova?

– Natyrisht, – u përgjigj Simoni, pa ditur se përse e pyeti kështu Mirani.

– Nuk është gjithaq e natyrshme. Ne jemi shqiptarë dhe jo kosovarë. Titistët po mundohen të sajojnë nga ne një komb kosovar, prandaj të lutem të paktën në bisedë më mua mos e përdomi shprehjen kosovar.

– Ke të drejtë, më fal, por se si na është bërë shprehi, meqë na duket më lehtë të themi kosovarë se sa shqiptarë të Kosovës.

– Dhe kjo shprehi jo qëllimkeq, mund të bëhet një ditë realitet i hidhur.

– Prapë ke të drejtë.

Simoni dëshironte t'i ikte polemikës me Miranin rreth kësaj shprehjeje.

– Ke rezervuar hotel? – pyeti.

– Kështu pyetet mysafirin? – u përgjigj më të pyetur Mirani, sado e dinte se ai e kishte të ndaluar të priste mysafirë në shtëpi, e aq më pak t'u ofronte konak.

– E po, këtu nuk jemi në Shqipëri. Pastaj, unë mendoj se ti nuk ke ardhur në Vjenë si mysafir imi.

– Mos thuaj Shqipëri, por Republikë e Shqipërisë, sepse Shqipëria përfshin gjitha territoret etnike rrethrotull Republikës së Shqipërisë, që akoma vazhdojnë të jenë të pushtuara.

– Ta kam thënë edhe në Bochum, mor shejtan, se je kapërdisur në patriotizëm romantik dhe jo real, për të mos thënë se je infektuar edhe nga demokracia borgjeze.

– Do të fle te një i njohur që banon afër Westbahnhofit, nëse nuk takoj tani ndonjë bashkatdhetar në Ostbahnhof. Mbase e dini se unë nuk e bëj asnjëherë natën në hotele.

– Te Petrit Shala do të shkosh?

– Edhe atë e njihke!

– T'i njoh të gjithë shokët në Vjenë, – ia ktheu pa hezitim Simoni.

– Dhe thua se je Atashe për Kulturë!

– No coment, thonë anglezët, – u përgjigj Simoni.

Mirani e kuptoi se nuk duhej të vazhdonte më tutje në këtë drejtim ndaj tha:

– In Ordnung (në rregull), thonë gjermanët.

– Atëherë po të çojmë me makinë deri para derës së pallatit të tij.

– Dakord, faleminderit! – shtoi tjetri pa më të voglin ngurim.

Kujtimi thirri kamerierin dhe bëri pagesën. Ai nuk kish folur fare, pos që kishte mbajtur herë pas here ndonjë shënim në bllokun e tij, duke u munduar të mos linte përshtypje te Mirani sikur po ia regjistronte gjithë bisedën.

Pas dy ditësh Ermirë Fatahu i telefonoi Miranit në konvikt në Bochum, meqë ai ia kishte dhënë numrin dhe adresën në një takim të mëhershëm.

– Alo, Emil Kastrioti në telefon!

– Ju njoha nga zëri, zotëri Kastrioti, mirëmbërëma!

– Do t'i bie trup kësaj radhe, – sqaroi ai me zë të mllëfosur.

– Vetëm urdhëroni, – ia ktheu me qetësi Mirani.

– Ti ke shkuar te një mik imi në Vjenë. Më mirë të them te një ushtar imi. E ke

kërcënuar dhe tani ai ka ikur në Kosovë. Është e vërtetë?

– Për cilin mik e keni fjalën, zotëri Fatahu?

Mirani u bë i gëzuar për informimin se Fekir Dalana kishte ikur në Kosovë para afatit prej një jave që i kishte dhënë.

– Mos u shtir sikur nuk di gjë! Ke qenë te patrioti e intelektual i shquar Fekir Dalana dhe e ke kërcënuar, apo jo?

– Kam qenë për vizitë, sepse është shoku dhe kolegu i dajës tim. Daja më kishte porositur që ta vizitoja...

– Tallësh më mua? – e ndërpreu tjetri. – Ai më ka treguar se ti e ke kërcënuar, pasi e ke detyruar të të informojë për organizatën e veprimtarinë tonë. Pastaj e ke urdhëruar që ta lëshojë Vjenën brënda javës, përndryshe...

– Lerë, mos ulërisni kot, se ju paska dezinformuar. Me gjasë ai nuk ka ditur se si të iki nga ju, prandaj ju ka dezinformuar kinse e kam kërcënuar.

– Stil udbesk, dëshiron edhe të na përçash, – ia ktheu Emiri.

– Nuk varet nga unë e as nga ju se kur ju do të përçaheni e kur do të mirë-kuptoheni, – iu përgjigj Mirani flakë për flakë, por me merak se trashamani Emir Fatau nuk do ta kuptonte ndaj vazhdoi pa i lënë shans të ndërhynte. – Mund të m'i shkruani në letër ato që keni për të thënë dhe mos ma shurdhoni më veshin në telefon!

Deshi ta mbyllte menjëherë, por priti sa ta dëgjonte kërcënimin e ri të Emirit.

– Ke për të parë se kush jam unë...

– Ikni nga telefoni se ju nuk jeni gjë tjetër pos kënetë bretkosash! – ia preu ky kërcënimin duke lëshuar me pezmi receptorin mbi aparatit e telefonit.

Emir Fatahun e roku pezmi i madh. “Si guxoi ky minuk të më ofendojë kështu, mua Kastriotin e madh?!” – i doli nëpër dhëmbë të shtrënguar kërcënimin dhe menjëherë u ul t'i shkruante letër. Këtë letër ai e postoi të nesërmën, meqë tashmë posta ishte mbyllur. Ca ditë më vonë bëri edhe shkrimin shpifës në gazetën kroate “Hrvatska Drzava”, i cili, si duket shkaktoi ndërhyrjen e policisë speciale. “Se mos ka ky farë Emir Fatahu edhe ndonjë mundësi tjetër për të shpifur, më drejtpërdrejt, te strukturat përkatëse gjermane...”, – po mendonte me vete Mirani. Kishte dëgjuar nga një gjerman me kompetencë, se Gjermania nuk është në gjendje ta ndalojë veprimtarinë e sigurimeve sekrete të Jugosllavisë. Kjo vinte si pasojë e kapitullimit pas Luftës së Dytë Botërore, ku ishte detyruar të lejonte veprimtarinë edhe të strukturave policore të Jugosllavisë, si të ShBA-ve, Anglisë, Francës e Bashkimit

Sovjetik, në emër të ndjekjes e të arrestimit të kriminelëve të luftës. Këtë vazh-donte të shfrytëzonte Jugosllavia, duke atashuar legalisht agjentët e vet në Gjermani, për të përndjekur jo vetëm kriminelë të luftës, siç i quante ajo kroatët e arratisur, por tashmë edhe azilantët politikë. Përndryshe, vetëm një shkrim në atë gazetë, një letër dhe një bisedë telefonike, ndoshta nuk do të kishin bindur gjermanët për këtë ndërhyrje në mënyrë kaq skandaloze.

Bochum, dhjetor 1979

Martin Gucia”

3.

– Pa, pa, pa, çfarë lexova! – po thoshte Jusufi duke dalë nga dhoma tjetër në dhomë të ndenjes ku ishin Bardhi, Vasili e Mirani. Sikur po fliste me vete. – Me atë bërlllok s’u takoka, tha pastaj duke u ulur. Tani e kam mjaft të qartë, për të mos pasur punë me atë vërtet kënetë bretkosash. Për titull do të mendoj gjatë redaktimit.

– Kur sqaron diç Mirani, – foli Vasili, – e bënë shumë bindshëm.

– Mua më mjaftoi, prandaj do ta refuzoj takimin, – u pozicionua Jusufi.

– Unë mendoj se ti duhet të takohesh dhe bëj kinse nuk di gjë pasi më shumë na levërdis që të mos hapim front me ta. Do të harxhojmë energji kot se koti, – përmbylli Mirani.

– Si, thua të mos hapim front me shërbëtorë të UDB-së!? E ke me gjithë mend!? – shfaqti habi Jusufi sidomos pas asaj që kishte lexuar.

– Emiri duhet të jetë kuadër me grada dhe jo informator i thjeshtë. Shumë varet nga raportimet dhe propozimet që do t’i bëjë ai, për të marrë vendim pastaj eprorët e tij. Ata e kanë përgatitur atë për këtë hapësirë duke i dhënë kompetenca serioze, – vazhdoi të sqaronte Mirani. – Ne duhet të taktizojmë me të, ndërsa unë jam djegur nga aksidenti që kam bërë. Përpara taktizoj shumë mirë dhe më linte rehat. Pastaj... Tani, ti Jusuf, në takimin që do të bësh, siç po propozoj unë, mund të

përdorësh taktikë manipuluese ndaj tij, sikur nuk je i informuar për të. Nëse bie fjala për mua, pasi mund të ta kërkojë mendimin, ti mund t'i thuash se nuk më njeh gjithaq, por që ke dëgjuar vlerësime se jam aventurier, pa ndikim në emigracion.

– Të tillë përvojë nuk kam dhe nuk mund të luaj rol kaq të ngatërruar, – u shpreh Jusufi preras.

Jusufi nuk është edhe aq elastik për të ndryshuar kollaj mendimin e tij.

– Na duhet të mësohemi edhe me taktizime kundër armiqve, meqë kemi filluar të merremi me veprimtari të organizuar çlirimtare. Lufta e hapur e frontale bëhet vetëm kur do të forcohemi për ta përballuar ballafaqimin. Me këtë strukturë udbeske, siç më duket mua, duhet tani të tallemi, duke iu bërë elozhe të stisura, sikur është organizim nacionalist me të cilin e kemi për nder të bashkëpunojmë. Ata do të na vlerësojnë për naivë dhe si të tillë gëzohen se po na fusin nën kontroll. Kështu nuk do të na luftojnë me gjithë forcën e mundësitë që kanë.

Pasi shprehu mendimin Mirani nuk foli njeri, meqë dukej se po e peshonin arsyetimin e tij. Pas disa çasteve Jusufi e mori shtruar.

– Miran, arsyetimet që paraqite kanë filluar të më bindin ta ndërroj mendimin fillestar, këmbëngulës, pasi u ndikova nga leximi i shkrimit tënd.

– Ne nuk kemi pse të nxitohemi që të vendosim tani. Kemi kohë të mendojmë, pasi telefonatën e paske pasnesër, për përgjigjen nëse do të takohesh me të. Gjermanët, kur janë para marrjes së një vendimi dhe nuk janë të sigurt se për cilin variant duhet të vendosin, thonë: “Më duhet të fle mbi të”, që do të thotë se duhet të kem një natë në dispozicion dhe nesër të vendos. Por, sa të mos më dalë nga mendja, t'i them edhe ca mendime që kanë të bëjnë me çështjen për të cilën po bisedojmë. Unë mendoj se strukturat përkatëse jugsllave do ta sforcojnë veprimtarinë e tyre pas arratisjes sate, për të luftuar këtë hovzim të

vetëdijësimit patriotik dhe të lëvizjes sonë çlirimtare. Rëndon, duket e vështirë për t'u identifikuar veprimtaria speciale policeske, sepse ajo kamuflohet në mënyra më të nduarnduarshme. Shumë njerëz presin që t'ua shohin brirët pjestarëve të UDB-së dhe tek pastaj të binden e të ruhen prej tyre. Unë mendoj se kam krijuar një intuitë autentike për të identifikuar këta spiunë të kamufluar. Mua më është mbushur mendja se, ta zëmë, Emir Fatahu dhe njerëzit që komandon ai, janë organizimi më i sofistikuar i luftës speciale jugosllave kundër organizimit tonë këndej. Këtë gjykim e mbështes në biografinë e këtyre njerëzve, në propagandën e tyre, në aktivitetet e tyre. Argumentimin më të thjeshtë, i cili mund të duket primitiv, ma jep fakti se përse këta njerëz janë të martuar me gra serbe ose bashëjetojnë me dashnore serbe, përderisa dërdëllisin se janë nacionalistë shqiptarë? Argumentimi tjetër: Përse propaganda e tyre e shkruar dhe gojore flet kryesisht për llogoret në Republikën e Shqipërisë, për diktaturën e atjeshme komuniste dhe për nevojën kryesore për ta çliruar Republikën e Shqipërisë nga ajo diktaturë, kurse pak, për të mos thënë aspak, flasin për territorët e pushtuara shqiptare dhe nevojën për t'i çliruar ato, siç do të duhej të ishte e logjikshme për nacionalistë të mirëfillët; Çlirimi kombëtar dhe jo lufta ideo-politike do të duhej të ishte shtylla vertebrale e programeve të nacionalistëve që vijnë nga territorët tona të pushtuara. Pastaj ky soj i nacionalistëve luftën e kanë përqëndruar kundër veprimtarëve të lëvizjes nacional-çlirimtarëve të Kosovës dhe jo kundër pushtuesve të Kosovës, sikur të parët të jenë fajtorë pse Kosova mbahet e pushtuar dhe jo këta të dytët. Djathtizmi i tyre më duket farsë dhe jo përmbajtje, meqë djathtistëve nacionalistë do t'u shkonte më se paku të bashkëjetonin me femra serbe, të cilat gjithsesi ua ka servuar UDB-ja...

– Mirë e pate kur propozove që të diskutonim më vonë, – ndërhyri Jusufi i shtyrë nga mendimi se kjo bisedë do vazhdonte gjatë. – Të hamë njëherë darkë, pastaj mund të bisedojmë, bile mund ta shtyjmë për

nesër. Mendimet e fundit meritojnë diskutim më të përkushtuar, sepse janë me përmbajtje që nuk mund t'iu qasemi në mënyrë tangente. Prandaj, po e lëmë të bisedojmë pas darke ose nesër. Para se të harroj, po them ca mendime për shkrimin që lexova. Do redaktim serioz letrar, meqë ti nuk i njeh rregullat që ka eseu. Materien është shumë interesante, por e ke tepruar me sinqeritet të përimitësua dhe mund të keqkuptohet si naiv. Takimi me shokë të Ambasadës Shqiptare duhet të hiqet, sepse lë hapësirë për të dyshuar që ti je spiun i Sigurimit. Unë do të përpigem, por jo tani, ta përpunoj me përkushtim dhe besoj se do të dalë esë politik interesant dhe informativ.

– Të falenderoj për vlerësim e kritikë. Sa për sqarim, nuk kam menduar të botohet, ose së paku jo tani, pos nëse kemi fat të krijohen rrethanat për t'u botuar, vetëm atëherë kur nuk do të dëmtohet veprimtaria çlirimtare. Në ato rrethana, besoj, nuk do të më dëmtojë sinqeriteti deri në naivitet, siç e vlerësove. Me rëndësi është, a do të kesh mundësi ta përpunosh, që të bëhet esë, pasi mendoj, më lehtë do ta kishe të shkruaje një të re, se sa ta redaktoje këtë. Orientimi për të ruajtur sado-pak origjinalitetin do të të nxjerrë shumë punë.

Mirani i tha këto mendime, edhe pse më me dëshirë nuk do të fliste fare, por nuk i dukej shoqërore, të paktën pa e falenderuar për mendimet që shprehu dhe për gatishmërinë që shfaqti.

– Të shohim kur do të kemi kohë për ta përpunuar. Tani nuk kemi nevojë të lëshohemi në diskutime teorike se çfarë është eseu dhe si duhet të shkruhet ai, meqë nuk është zanat që mësohet brënda një diskutimi. Unë do ta lexoj edhe një herë sa për informim dhe mendoj që ta marrësh me vete. Ndoshta, ndërkohë, do përpigesh ta rishkruash. Do të tregoj kur do të kem kohë për ta redaktuar.

– Dakord, ashtu do të bëj.

– Për Fekir Dalanën kam dëgjuar edhe unë, pasi ai është i anës sonë. Por ti qenke më mirë i informuar dhe mirë ia paske punuar atij rankovi-

çisti.

– Mirë thua ti, por unë kam dyshim. E kam përzënë nga Vjena dhe tani ai bën dëme në Pejë e rrethinë. Kur ka shkuar në Pejë, ka takuar rastësisht djalin e axhës, Imerin, për të cilin ti mund të kesh dëgjuar se survejohet e përndiqet për shumë vjet nga policia jugosllave. I ka thënë atij: “Ke të fala nga kushëriri yt, Miran Bruçaj.” Imeri ia ka prerë: “Ma hangsh mutin ti këtu e ai atje!” dhe nuk ka ndërruar asnjë fjalë tjetër me të. Imeri e ka njohur Fekirin më mirë se sa unë. Pas disa javësh, me urdhër të shefit të policisë së Kosovës, Fekiri është kthyer në punë në postë të Pejës. Bile, posta është urdhëruar t’ia paguajë rrogat e gjithë atyre viteve, që kur është përzënë nga puna, me shpjegim se është përzënë padrejtësisht. Pra, siç po dëgjon, unë duhet t’i kem bërë mirë atij mistreci.

– Miran, më kupto, ti ke bërë mirë që e ke përzënë atë farë çafiri, këto të tjerat kanë më pak rëndësi! – konkludoi Jusufi.

Pas darkës u diskutuan shkrimet që ishin përgatitur dhe duhej të përgatiteshin për gazetën *Bashkimi*. Njëherit u dakorduan që Jusufi të takohet me Emir Fatahun. Biseduan për taktikën që duhej të ndiqnin ndaj tij dhe organizatës që ai komandonte, që në të ardhmen të kishin sa më pak konfrontime, në mos fare. Vendosën që në gazetë të mos shkruanin asgjë për ta dhe për organizimet e tjera politike në emigracion, sepse këtë dëshironin ato; të kishin shkak konkret që të merreshin më intensivisht me polemika, kritika, diformime, shpifje e sharje kundër organizimeve të Jusufit, Bardhit, Vasilit e Miranit.

4.

Kur u kthye Mirani në Bochum gjeti Renatën duke e pritur në dhomën e tij, meqë ai ia kishte dhënë një kopje të çelësit. Sapo hapi derën e gjeti në tavolinë të punës duke bërë një punim seminarik që ia kishin caktuar në fakultet. Pas përshëndetjes Mirani e ngacmoi:

– Të duket këtu atmosferë më tërheqëse për të studiuar?
 – Është më qetësi se në konviktin tonë shtetëror, – u përgjigj Renata, sa për të bërë radhën.
 – Atëherë, punë të mbarë. Unë po bëj çaj dhe po pushoj në kuzhinë, që mos të të pengoj.
 – Jo, rri këtu! Nuk është arsyeja e vetme qetësia që kam ardhur, – iu drejtua Renata në kohën kur nga çanta po nxirrte një pusullë. – Urdhëro, lexoje, që ta shohesh se sa i ndershëm je.
 Mirani zgjati dorën i befasuar nga fjalët që ia tha Renata, e cila mezi po e përmbante shpërthimin e mllëfit. Zuri ta lexojë:

*“Miran i admiruar,
 të prita më se një orë para derës se banesës, në kuzhinë, por ti nuk erdhe. Të lutëm, sapo të vish, eja tek unë se nuk po e përballoj dot pa bërë seks dhe para nuk po kam që të paguaj tipat që na bëjnë me pagesë grave këtë shërbim. Më duhet ta plotësoj këtë nevojë të domosdoshme fiziologjike që kam për momentin, prandaj edhe një herë po të lutem që të vish. Do të të pres gjithë natën...
 Mirardbësb!
 Marta”*

– Ç’është kjo pusullë, ku e gjetë? – pyeti i habitur Mirani.
 – E gjeta sot, në mëngjes, poshtë derës sate kur kalova këndeje për kaftjall. Ç’i thua ti kësaj?
 – Ta lëmë që ta bisedojmë kur të dalim shëtitje, sepse këtu ti do ngrisësh zërin dhe kjo nuk më pëlqen. Do ta shqetësojmë komshiun Mihael dhe studentët e tjerë.
 – Nuk më shëtitet, dua menjëherë shpjegim.
 – Qetësohu. Kush je ti që të më kërkosh llogari në këtë mënyrë?
 – Jam mikja jote.
 – E çka, nëse je mikja ime? Mos jam i detyruar të të jap ty llogari për

jetën time private?

– Do të thotë, ti e pranon se bëke marrëdhënie seksuale me atë kurvën polake!?

– Këtë nuk e thashë, por të thashë që nuk jam i detyruar të të jap llogari. Tani mos ndërhyt që të shpreh mendimin tim. E para; nuk ke nevojë të përdorësh shprehje fyese ndaj zonjës Marta, sado e paska shfaqur kaq drejtpërdrejt dhe në mënyrë kaq skandaloze nevojën e saj fiziologjike për marrëdhënie seksuale. E dyta; unë nuk kam pse të jem fajtor për këtë, pasi unë nuk iu kam drejtuar asaj, por ajo mua. E treta; unë nuk kam si t'ia ndaloj asaj që të fusë këso pusulle nën derën e dhomës sime.

– Ma thuaj shkurt, bëni marrëdhënie seksuale? Nuk kam durim të dëgjoj arsyetime që vijnë vërdallë.

– Mos po insiston që ne ta prishim miqësinë, pa dashur që të bisedojmë rastin më qetësisht e më arsyeshëm?

Renata e ndjeu kushtëzimin dhe u ndal për të menduar se si duhej të përgjigjej, por hidhërimi e mbisundoi.

– Dua një përgjigje konkrete, me po ose jo, keni bërë marrëdhënie seksuale?

– Pa çka nëse përgjigjem me po dhe çka me jo?

Ai nuk e kishte njohur këtë segment të karakterit të Renatës. Megjithatë vazhdoi:

– Që të mos e pres përgjigjen tënde, po të siguroj, se unë nuk kam pasur asnjëherë marrëdhënie seksuale me zonjen Marta dhe se kjo mënyrë që paska përdorur ajo, po më skandalizon. Por, unë jam i prirur ta ruaj qetësinë edhe kur skandalizohem.

Renata iu hodh në qafë Miranit duke e shtrënguar fortë. Ajo ishte e bindur në sinqeritetin e Miranit.

– Më liro, të lutem, se ma zure frymën, – iu drejtue Mirani, duke bërë një qeshje të lehtë, nga gëzimi se Renatës po i kalonte hidhërimi. Tash-

më ia kishte mësuar mënyrën e sjelljes se saj.

– Po bëj një çaj, siç e kishe në plan ti në fillim, – u përgjigj Renata duke e lëshuar Miranin nga përçafimi i shtrëngueshëm. – Çajin do ta shoqërojmë me kekun që pata sjellë për kaftjall dhe me bashkëbisedim të qetë.

Ajo u drejtua për në kuzhinë dhe vuri ujin mbi furnelë. Mirani mbeti i ulur në shtrat me mendime të përziera: “Si nuk paskam qëlluar mbrëmë këtu, çfarë shansi më paska ikur. Jo mor, nuk zhburrërohem unë, as në këtë mënyrë, sado që po më vjen keq për të. Ajo nuk paska para të paguajë dike tjetër për të mbuluar nevojat e veta fiziologjike dhe më pandehka mua për dash kopeje. Si ta kuptoj këtë përvojë kaq skandaloze...”. Pa mbaruar këto mendime të përziera, u shtri përmbys në shtrat. Renata u kthye nga kuzhina me tasat në duar. I lëshoi mbi tavolinë dhe iu hodh sipër Miranit me dhelatime.

– Miran, të lutem mos m’u hidhëro! U çmenda nga frika se po të humbisja, se nuk po gjeja metodë të të përvetësoj, siç kishte vepruar Marta e gjorë.

– E bëre çajin?

– Ende nuk vloi uji. Ja, po shkoj ta sjell.

Pas pak solli tabakanë me kek, sheqer e xhygym porcelani me ujin e valuar dhe çajin. I vuri mbi tavolinë duke i folur Miranit:

– Ti akoma nuk qenke ngritur, e paske pasë vetëm sa të më largosh mua.

– Mendova se është më mirë të pres i shtrirë duke pushuar nga udhëtimi. Në tren kam ndenjur ulur shumë orë. Unë po mendoja për këtë sjellje të Martës, por nuk po e kuptoj. Me të, siç e di, njihem gati një vit. Ajo ka ardhur për specializim, meqë në Varshavë ka studiuar gjermanistikën. Ka treguar se është e martuar, se ka një gocë dhe se është shumë e lumtur në jetën bashkëshortore. Pastaj, ajo është intelektuale e përkushtuar, tip shkencëtareje. Është besimtare e përkushtuar katolike dhe,

për aq sa e njoh unë besimin tuaj, feja denon tradhtinë ndaj bashkëshortit. Se si po më vjen keq që qenka katandisur në atë gjendje. Më drejtohet duke më poshtëruar, se dashka të bëka seks më mua, meqë nuk paska të holla për të paguar mëshkull kurvar, nga ata që e kanë si marrëdhënie pune dhe paguhen nga femrat për të dëfryer ato kur kanë deficit seksual. Edhe ato fatura të pagesës përmbajnë tatimin e vlerës së shtuar, që duhet t'ia paguajnë shtetit, njësoj si edhe prostitutat e legalizuara që paguajnë të gjitha sigurimet sociale dhe tatimin vjetor mbi fitimin.

– As unë nuk po e kuptoj, – filloi të fliste Renata. – E dija për zonjë të sjellshme e të ndershme. Them se ka dashur të të keqpërdor, me pretekstin e mungesës të të hollave. Ajo ndjen simpati për ty dhe ka menduar se në këtë mënyrë mund të të përvetësojë. Aq të holla sa për të paguar një mashkull duhet të ketë, sepse asaj shteti gjerman i jep bursë të lartë. Pastaj, me bukurinë e sharmin që ka, do të mund të gjente student sa për marrëdhënie seksuale të çastit, pa pasur nevojë të paguajë. Kurse sa i përketë besimit katolik të saj, ti po e sheh se shumica e studentëve dhe e intelektualëve, po besojnë për aq sa u ka tepëruar nga edukata imponuese e prindërve. Se mos e kam lexuar unë ndonjëherë Biblën për të mësuar se çfarë kërkohet nga besimtarët, siç e ke lexuar ti, pos Kuranit që duhet ta kesh lexuar kur ke qenë në Kosovë.

– Në Kosovë nuk e kam lexuar Kuranin. Ndoshta për shkak të përktimit të dobët nuk më ka tërhequr ta lexoj. E kam lexuar këtu, të përktit në gjuhën gjermane. Sa ngjashmëri që kanë me Biblën!

– Po të jetë e vërtetë se të është lutur ty për mungesë të të hollave, atëherë do të t'i jepja ty njëqind marka t'ia falësh asaj për të paguar këtë shërbim. Por, frikësohem se e ka taktikë të të fusë brenda. Jo vetëm Marta. Ty po të vardisen edhe shumë të tjera, si afganistanja Parvin, japonezja Yoriko, jordanezja Jaklin, francezja Rice dhe të tjera. Me ato po rrimë shpesh në kafeteri të fakultetit. Ta kanë mësuar orarin dhe vijën

të rrinë me ty, me shpresë të të përvetësojnë.

– Kurse ti vijke që të më ruash mua nga ato. Se mos është ky një solidaritet midis ne të huajve këtu, pasi ju jeni popull i mbyllur që nuk e akceptoni lehtë integrimin tonë.

– Pse, e mbyllur po të dukem unë? Po çmendem pas teje dhe nuk po di se si të të integroj.

– Ndoshta, pikërisht kjo vetëpërmbajtje imja po ju bën të më vardiseni. Në momentin që unë të vendos të dashuroj njëren nga ju, të tjerat nuk do të më vardisen më.

– Mendon se unë po të vardisem?

– E po, tani nuk ke arsye të fyhesh. Nuk mendova tamam ashtu. Ne po bisedojmë shlrshëm, pa protokoll, dhe unë nuk po ndihem i detyruar të përzgjedh shprehjet e qëlluara.

– Më fal, për momentin gjykova gabim, se ti po e merr dashurinë e përkushtimin tim si vardisje.

– Mos qoftë thënë nga goja ime! Të çmoj shumë, – iu përgjigj Mirani duke ia vënë dorën rreth qafe.

Pas pak ajo iu drejtua:

– Si do t'ia bësh kur do ta takosh Martën, çfarë do t'i thuash?

– Se mos duhet të mendoj që tani se si do t'i përgjigjem e si do të arsyetohem për mosshkuarje tek ajo për t'ia bërë qefin. Do flas çfarë të më duket e arsyeshme për momentin kur do ta takoj. Nuk jam i detyruar të parapërgatitem qysh tani.

– Për momentin sikur po ndiej keqardhje për nevojën e saj fiziologjike dhe për mënyrën se si ka menduar ta ekuilibrojë!

– Mos do të thuash se unë duhet të sakrifkohem për keqardhjen tënde? – iu pati me humor tjetri. – Tani po më kujtohet një bisedë që patëm me Martën pas një ligjerate, kur po pinim kafe në kantinë. Folëm për katolicizmin në Poloni, se ishte shumë i shtrirë e me ndikim konservativ. Ajo po më shpjegonte se i tillë është, por në disa segmente është

ekstrem. Mori shembull vetën e saj dhe unë po përpiqem t'i reprodukoj fjalët e saj: "Jam këtu për specializim gati që një vit. Më duhet të rri edhe një vit. Dy vjet duhet të rri pa bërë marrëdhënie të rregullt seksuale, pasi feja e quan këtë tradhti në jetën bashkëshortore, përkatësisht na e ndalon. Nuk u përballuaka, sado bashkëshortin tim e dua dhe e dashuroj shumë. Të shkoj në Varshavë, sa herë që ndiej nevojë të papërballueshme për seks, nuk mundem, pasi dua të kursej para nga bursa që të blej mobilie kur të kthehem. Nuk e besoj që Jezusi ka menduar tamam ashtu, siç thuhet në Bibël, shkruar më vonë nga apostujt, sipas mbamendjes. Edhe kleri, që është i dominuar nga burrat, ka marrë herë pas here vendime jonjerëzore, se si gjoja marrëdhëniet thjesht seksuale gjatë jetës bashkëshortore na qenkan tradhti ndaj bashkëshortit. Këto pikëpamje janë nga koha kur njerëzit nuk kanë shkuar më larg se sa kanë mundur të ecin këmbë, me gomar ose me kalë. Ata nuk kanë shkuar në specializime dy-vjeçare, larg bashkëshortit. Prandaj duhen bërë reformime njerëzore në religjionin tonë. Një marrëdhënie thjeshtë fiziologjike seksuale në gjendje të domosdoshme, siç po ndihem unë tani, nuk do të thotë tradhti ndaj bashkëshortit. Unë do të vazhdoja edhe pastaj ta dua e ta dashuroj njësoj bashkëshortin tim, si para kësaj marrëdhënieje. Duke e dënuar si tradhti seksin e rastit do të rriten divorcet, do të shpërbëhen familjet. Kjo po na ndodh me të madhe.

Kurse unë, si torollak që isha, vetëm tani po e kuptoj se si e ku e kishte hallin. I pata thënë: "Kujdes që të mos takosh ndonjërin, që do të jetë më seksi se bashkëshorti ytë, se ndodh ta harrosh bashkëshortin, duke u çmendur pas tipit me potencë më të madhe seksuale!" Ajo m'u përgjigj: "Asnjëherë nuk do të ndahesha nga bashkëshorti im derisa ta kem këtë mirëkuptim që e kemi tani. Jeta bashkëshortore është më shumë mirëkuptim e përgjegjësi reciproke, se sa dashuri e seks." Prandaj them të mos i gjykojmë sjelljet, ndjesitë e nevojat e njerëzve në momente të caktuara, meqë nuk jemi në gjendje ta vëmë veten në pozitë të tyre.

Ndoshta mund të gjykonim, se do ishte njerëzore, të paktën të mos e keqkuptonim ndjesitë e saj...

– Mos u tall më mua dhe as me Martën, meqë njerëz jemi dhe në momente na shfaqen edhe të tilla nevoja dhe dëshirojmë t'i përballojmë me marrëdhënie seksuale. Pse, ti nuk ndjen nevoja të tilla dhe si ia bën që t'i përballosh?

– E po, tani po e tepron. Ku ishim dhe ku dole! Do që të shpjegoj ndjesitë e mia. E para, nuk shpjegohen dot ashtu siç i ndjen njeriu. E dyta, mirë që nuk bisedohet për gjithçka. Disa gjëra i mban brenda vetes njeriu.

– Dalim të shëtisim! Ti ke nevojë të lëvizësh pas udhëtimit të gjatë, ndërhyri Ranata me mendim se kishte prekur një temë tabu për Miranin. Ajo po mendonte se Mirani ngurron të bisedojë për tema të tilla, meqë vjen nga një kulturë ku nevojat fiziologjike për seks nuk diskutohen.

Mirani e mirëpriti propozimin, me shpresë se do ndërrohej tema e bisedës.

5.

Renata dhe Mirani përtuan të shkonin në pyllin e madh buzë kopshtit botanik të universitetit. Vendosen të shëtisnin në pyllin përballë lagjes së re, Querenburhöhe, e ndërtuar rishtazi karshi universitetit. Në këtë lagje janë ndërtuar pallate të larta e të mesme për nevoja banimi për profesorë e studentë dhe për të punësuar në metro, dyqane e restorante të reja. Në anën e mbapme, në drejtim të konvikteve ku banonin ata ishte edhe pishina e mbuluar, ndërtuar gjithashtu rishtazi dhe moderne, ku pothuajse çdo mëngjes, duke shkuar në fakultet ose në bibliotekë, Mirani lahej nga gjysmë ore. Studentët e kishin falas hyrjen. Ngjitur me pishinën ishte mali me rrugica të rregulluara për këmbësorë. Në këtë ambient të mrekullueshëm, kësaj nate të ngrohtë shëtisnin Renata e Mirani.

- Harrova të të pyesja si ishte shoku yt, Jusufi dhe si ia kalove tek ai?
- Mirë ishte dhe mirë ia kalova. Po ty, nga të erdhi kaq papritmas kjo pyetje?
- Se si më erdhi tek mendoja, si nuk po përton të shkosh tek ai kaq shpesh, kur duhet bërë goxha rrugë.
- E me kë kam mundësi të këmbëj mendime për veprimtarinë tonë këtu? Pastaj ai po më ndihmon shumë me këshilla, sesi duhet të shkruaj, duke m'i korrigjuar me dashamirësi ato që po përpiqem t'i hedh në letër.
- Pse, kaq i ngritur e i mirësjellshëm është?
- Nuk e ke idenë. Mbi të gjitha e ka mirësinë e modestinë. Nuk të imponohet fare me gjithë atë bagazh intelektual që ka. Ta dëgjoje se si luante me kitarë, me çfarë zëri melodik, do të thosha romantik, këndon këngët që vetë i kompozon. Kënaqem duke e dëgjuar. Ai këndon ngjashëm me serenadat korçare, të cilat ti i dëgjon më ëndje nga kasetat që ta kam dhuruar. Një gjë nuk po e kuptoj: luan aq mrekullueshëm me kitare dhe është goxha konservativ në familje.
- Edhe mua po më habitka ky krahasim që bërë! – ndërhyri Renata.
- Ndoshta ti nuk durohesh pa e qortuar për këtë, siç të njoh unë.
- E qortoj që ç'ke me të. Ndonjëherë me zemërohet, por ti e di se mua nuk më bën shumë përshtypje, pasi më mungon takti dhe gjentilesa. Pse jo, ndonjëherë debatojmë vullshëm edhe për pikëpamjet tona dhe rastis të zihemi, pasi ne jemi rritur e edukuar në një sistem monist dhe në shoqëri patriarkale. Konfrontimi me këtë shoqëri demokratike dhe jetesa e këtushme po na bëjnë mirë që ne t'i demokratizojmë mendësitë tona dhe ta emancipojmë mënyrën e të jetuarit. Këto procese ecin ngadalë e nuk ndërrojnë në mënyrë mekanike. Ai shpesh më lutet që t'i flasë për jetën studentore dhe për demokracinë e këtushme që ne po e quajmë demokraci borgjeze. Pastaj, Jusufi vërtet shkruan bukur, sidomos poezi. Ka një stil modern dhe ndonjëherë i them me të qeshur, që

t'm'i përkthejë poezitë e tij. Më dëshirë i lexon dhe i korrigjon poezitë e Heines, Brechtit, Tucholskit, Eri Fried, kur unë përpiqem t'i përkthej. Ai i ka lexuara ato kryesisht në gjuhën serbe e slovene, pasi pak nga ato janë të përkthyer në gjuhën shqipe.

– Vërtet ia vлека që shkon kaq shpesh tek ai, por po më mungon mua në fundjavë. Do dëshiroja t'i kalonim së bashku. Pastaj, kur nuk shkon te Jusufi, ti shkon në Klubin tuaj në Dyzeldorf dhe kështu unë duhet të jem vetëm, pothuajse çdo fundjavë.

– Më vjen keq, por ti tashmë e di se prioritet imi kryesor është çlirimi nga pushtuesit serbë.

– Vërtet, i urren kaq shumë serbët? Urrejtja është motiv i fortë për të të bërë kaq të përkushtuar deri në fanatizëm sflitës.

– Gabim e ke, më paske keqkuptuar. A nuk po rrimë shpesh me atë filozofin Popoviq, një malazez vërtet demokrat, me të cilin ia vlen të bisedosh? Pastaj, në universitet takoj shpesh sudentë serbë dhe kënaqemi duke bërë humor. Ata tregojnë batuta politike nga jeta në Beograd. Që ta dish, komshitë e parë i kam serbë e malazez. Një pjesë e tyre janë serbë etnikë, që jetojnë aty prej shekujsh dhe me ta shkojmë shumë mirë. Ata nuk mund t'i dallosh prej nesh nga sjelljet. Kurse disa të tjerë i kanë sjellë pushtuesit serbë si kolonë në vitet e 30-ta, në tokat e shqiptarëve që i kanë përzënë në Shqipëri e Turqi. Edhe me ata shkojmë mirë, por ata e pranojnë se kanë ardhur padrejtësisht në ato troje, duke u arsyetuar se mbretëria e atëhershme i ka detyruar me dhunë. Me këta fqinjë shkojmë më mirë se sa me disa fqinjë shqiptarë. Besoj të sqarova.

– Pjesërisht. Që kur jam njohur me ty po lexoj literaturë të shumë të për Kosovën dhe pjesa më e madhe flet për Kosovën serbe, për ardhje të mëvonshme të shqiptarëve, sidomos pas dyndjes së madhe të serbëve në Austri në shekullin e 17-të..

– Mos e zgjat! – ndërhyri Mirani me durim të humbur. – Sa herë kemi diskutuar se autorët e atyre librave o janë nacionalistë serbë, o miq të

tyre. Ne nuk e kemi pasur hallin të shkruajmë e përkthejmë kaq shumë libra dhe nuk kemi pasur kaq shumë miq, edhe për shkak të përkatësisë fetare, sa kanë pasur e kanë serbët. Edhe tani, vetëm ta dish se çfarë miqësish kanë pushtetarët e Bonnit me pushtetarët e Beogradi dhe çfarë marifetesh përdor Beogradi për të thelluar këtë miqësi. Janë të shumtë pushtetarët e nëpunësit e lartë shtetërorë gjermanë që bëjnë pushime si mysafirë pa pagesë në Beograd e në bregdetin jugo-sllav. Atyre u vihen në dispozicion edhe serbe të bukura, që të shfryjnë epshet e streset e tyre seksuale.

– Nuk ke nevojë të më shpjegosh me këtë eufori hidhëruese, sepse shpjegimet tua historike i di...

– Por, po ndikohesh nga ato libra dhe po dyshon në shpjegimet e mia.

– Sigurisht që librat bëjnë ndikim.

– E po, të shohim kujt do t'i japë të drejtë e ardhmja, meqë ne kemi vendosur, o të çlirohemi, o të vdesim!

– Ta njoh karakterin, por dëshiroj të çliroheni dhe të mos vdisni, sepse duhet t'u njihet e drejta të jetoni të lirë, në Kosovën tuaj.

– E thua këtë sa për të ma bërë qejfin, meqë nuk dëshiron të vazhdojmë polemikën, apo e ke seriozisht?

– E po, tashmë e njeh edhe ti karakterin dhe përcaktimin tim dhe më vjen vërtet keq nëse kemi pushtetarë të tillë gjermanë.

– Mos e diskuto, keni që ç'ke me të. Të tillët, sidomos ata që janë në struktura të specializuara të shërbimeve informative, i gëlltitin të gatshme dezinformatat e akuzat nga sikologët e tyre në Beograd. Sa për konkretizim, ta zëmë, ata në kuadër të bashkëpunimit, më shabllonizojnë mua si ekstremist e nacionalist dhe japin urdhëra të më survejojnë e të më shqetësojnë edhe këtu. Kjo nuk e nderon shtetin gjerman, pavarësisht se pushtetarët e tillë i kanë interesat të tyre egoiste. Korrupsion nuk është vetëm kur paguhen para, por edhe pushimet pa pagesë,

trajtimet speciale me femra të stërvitura për këtë qëllim e të tjera. Për këtë lloj korrupsioni të pushtetarëve, serbët janë ustallarë dhe njihen historikisht, se me ç'mjeshtëri i kanë shfrytëzuar bukuroshet e tyre për pashallarët turq.

– Edhe ky qëndrim do të ndryshojë, nëse ju do të dini të ushtroni veprimtarinë tuaj çlirimtare dhe nëse do të forcoheni për t'u bërë faktorë.

– Kjo ka për të ndodhur dhe që të dy do të jemi dëshmitarë, – miratoi Mirani.

– Nga gojët tona e në vesh të Zotit, siç thua ti ndonjëherë.

Midis tyre hyri heshtja dhe spontanisht vendosën të ecnin në drejtim të konvikteve.

KAPITULLI III

Rreth katër muaj pas arratisjes së Jusufit, ditën e premte, në Bochum arriti Vasili. Kësaj radhe, për dallim nga herat e tjerë, ai arriti më herët, rreth orës 15.00. Kishte planifikuar të udhëtonte me Miranin për në Pragë, meqë mendonte se kishte gjetur një lidhje për të blerë armë në një fabrikë të armatimit në Çeki. Vasili kishte pasion armën, tek e cila kishte besimin kryesor për të çliruar Kosovën nga pushtimi jugosllav. Pas një pushimi të shkurtër rrëfeu për planin e tij për të shkuar në Pragë, për të parë nëse lidhja që i kishin premtuar ishte funksionale. Vasili e bëri Miranin kurioz për këtë lloj veprimtarie të re, të shoqëruar me rreziqe, e cila se si i përvetësonte dhe i bënte euforikë. Ky përshkallëzim nga veprimtaria informative e propaganduese drejt veprimtarisë së armatosur çlirimtare, u dukej atyre më tërheqës. Por, vështirësia për të siguruar të hollat për blerje të armëve, nëse vërtetë do të funksiononte lidhja, i detyronte ata të ndiheshin të vetëpërmbytur. Vasili kishte biseduar me disa bashkëveprimtarë të tij, se si e sa të holla do të mund të grumbullonin për blerje të armëve. Tani u shtrëngua edhe Mirani të mendonte për të gjetur të holla në rrethin ku ai zhvillonte veprimtarinë. Por, një merak e shtyri atë ta pyeste Vasilin:

– Di gjë Rezili për shkuarjen tonë në Pragë?

– Asgjë. Kam menduar që së pari ta vërtetoj nëse do të funksionojë lidhja që më është premtuar, pastaj më do të informoj atë. Nuk dua të dalë i dështuar, sepse ai është tepër serioz, i disiplinuar e rigoroz.

Mirani mendoi me vete: Vasili vazhduaka t'i besoka Rezilit edhe pas

bisedave dhe pas takimit që kishin pasur me të. Me gjasë, Rezili duhet të ketë ndërruar taktikën e sjelljes ndaj Vasilit. Tani po i kujtoheshin disa rrëfime të mëpastajmë të Vasilit, se Rezili i kishte folur atij në superlativ për Miranin. Madje e kishte informuar se i kishte shkruar Miranit letër për domosdoshmërinë e bashkëpunimit që do të çonte drejt bashkimit. Këto dhe të tjera si këto Vasili ia kishte treguar Miranit, por atij nuk i kishin bërë përshtypje sa tani.

Ndërkohë Vasili e pyeti Miranin duke ia ndërprerë fillin e mendimeve:

– Vërtet, je i sigurt se Jusufi është patriot dhe nuk është dërguar nga UDB-ja për të na sabotuar e përçarë?

Kjo pyetje e habiti Miranin me një parandjenjë se mos shoqërohej me ndonjë prapaskenë. Ai tashmë e kishte piketuar Rezilin si kuadër me rëndësi të luftës speciale policore jugosllave. Ai mendonte se veprimtaria e Rezil Mejtepit, edhe pse në dukje komuniste, dogmatike, ishte e inskenuar nga specialistë të UDB-së. Ky farë Rezili ishte angazhuar me të madhe që të komprometonte sidomos Jusufin me një propagandë të sforcuar gojore. Pothuajse gjithë kohën e kalonte në stacion të trenit në Shtutgart duke kontaktuar bashkatdhetarët dhe duke u munduar t'i bindë ata se Jusufin e kishte dërguar UDB-ja për të identifikuar veprimtarët patriotë dhe për të shpartalluar *Grupin Komunist Zëri i Kosovës*. Pastaj, po ai Rezil, frekuentonte lokalet ku mbledheshin shqiptarët, shtëpitë ku ata banonin për t'i sqaruar se cili rrezik e priste emigracionin revolucionar nga i dërguari i UDB-së, Jusuf Gërvalla. Miranin e shqetësonte sidomos ky njeri. Ai kishte përvetësuar emigrantë me vetëdijësim të lartë patriotik, përkushtim energjik dhe vendosmëri të theksuar. Dhe tani, kur Vasili i bëri këtë pyetje për Jusufin, shqetësimi i Miranit u konkretizua: Rezili ia paska arritur ta lëkundë edhe Vasilin. Një mendje i thoshte ta përzinte menjëherë nga banesa. Mendja tjetër i thoshte se duhej të përpiquej ta shpëtonte atë nga kthetrat e Rezilit. Vendosi për variantin e dytë,

meqë për Vasilin kishte simpati e debulesë të dallueshme nga bashkatdhetarët që kishte njohur deri atëherë.

– Vasil, bërë këtë pyetje i shtyrë nga dyshimi yt, apo për të më provokuar mua?

– Nuk kam asnjë arsye të të provokoj. Duhet ta dish se të çmoj e të dua më shumë se sa vëllezërit! Nëse mendon se të pyeta për të provokuar më mbetet hatri.

Vasili po shfaqte një shqetësim të cilin Mirani nuk ia kishte vërejtur ndonjëherë, ndaj vendosi ta sqaronte këtë shqetësim të tij deri në fund, ndoshta me rrjedhoja të pandreqshme.

– Domethënë, e bërë se ke filluar të dyshosh vetë ndaj Jusufit edhe pse ai të ka afruar dhe të do si të të kishte vëlla?

– Përse u arratis pikërisht tani, kur filloi të hovëzohej veprimtaria dhe organizimi ynë!? – pyeti Vasili me një logjikë që Miranit iu duk se ishte manipulim i Rezilit.

– Kur është arratisur Jusufi ne ishim në nivelin fillestar.

– Jusufi po angazhohet për të përvetësuar bashkatdhetarët e rrethinës se Shtutgartit.

– Shoku Vasil, ti po flet me mendime të huaja. Vetë ke qenë i prani-shëm kur kemi folur për ndarje të punëve, se ai me ndihmën tënde duhet të njoftohet me bashkatdhetarët e kësaj rrethine dhe të punoni me ta për t'i ndihmuar në rritje të ndërgjegjësimit të tyre patriotik. Bile, ishim marrë vesh që në vizitat që do t'u bënte ai bashkatdhetarëve, duhej të ishte edhe ti me të. Të kujtohet kjo?

– Më kujtohet, por ti ke dëgjuar se çfarë mendon Rezili për Jusufin?

– Domethënë, ti fliske i manipuluar nga ai!? Siç duket të paska influencuar tepër!

– E kam kryetar dhe ai tani nuk i ka mendimet për ty siç i kishte dikur. Të kam treguar, ai vazhdimisht po flet në supërlativ për ty.

– Ai ka ndërruar taktikën dhe jo mendimet e qëndrimet, meqë e ka

gjetur si metodë të përshtatshme përvetësimin e keqpërdorimit tënd.

– Mua të më keqpërdor ai? Kurrën e kurrës. As ai, as ti e askush tjetër!

– Të mos bëjmë pa nevojë shamatë. T’i kthehemi dyshimit tënd ndaj Jusufit, nga se i manipuluari nuk ka mundësi të dijë se po manipulohet. Vërtet, dyshimin e ke autentik, sepse ke hetuar gjë, apo e ke të imponuar nga Rezili?

– Mua nuk mund të m’i imponojë asnjëri mendimet e tjaja, kam kokën time!

– Imponimi bëhet në mënyra të ndryshme. Nuk është gjësend që të lëshohet në dorë dhe ti nuk e pranon. Ai ndodh në mënyrë të pahetueshme, varësisht nga shkathësia e imponuesit.

– Domëthënë, ti je i bindur se Jusufin nuk e ka dërguar UDB-ja?

– Si mendon, po të kisha ndonjë dyshim, do të kisha bashkëpunuar me të kaq ngushtë? Pothuajse çdo herë ke qenë edhe ti i pranishëm. Pastaj, ti ke shkuar shpesh herë me të për të vizituar bashkatdhetarët.

– Ku e mbështet ti këtë bindje tëndën? Përpara nuk e ke njohur?

– E kemi njohur Bardhin si shok të mirë dhe vazhdojmë ta kemi shok. Kam pyetur shokë në Kosovë pasi u arratis Jusufi, i kam lexuar sytë e tij që reflektojnë shpirtmirësi, bujari, njerëzi, patriotizëm, intelektualizëm. Të mjafton përgjigja ime?

– Të lutem, mos u hidhëro!

– Nuk ka vend për këso lutjesh. Nuk është njerëzore e shoqërore të diskutohet kështu për një shok që po na do kaq shumë, sikur të na kishte lindur e njëjta nënë, që ka durim për të na këshilluar urtësisht, që ka pranuar të nivelizohet me ne për hirë të çështjes sonë kombëtare. Na ka pranuar sinqerisht për bashkëveprimtarë. Ai nuk po e shpërdoron për asnjë rast epërsinë e tij intelektuale, po angazhohet me tërë qenien për çlirimin e Kosovës. Kështu mund të vazhdoj shumë gjatë, po të mund t’i gjeja fjalët që shprehin gjithë admirimin e respektin e madh që kam për

të. Por nuk po e zgjas më, meqë, me gjasë, ty po të bezdis. Papritmas na qenke tjetërsuar. Mos të të vijë keq, ngase gjithnjë të kam folur hapur. Mendoj se të paska tjetërsuar e irituar një hiç, një Rezil Mejtep me dy klasë të Medresesë se Prishtinës, i dresuar pastaj mirë nga specialistët e UDB-së për veprimtari në emigracion.

– Mjaft se me çmendel!

– Nuk ke nevojë të thërrasësh. I çmendur je nëse lejon të influencohesh nga shpifjet mashtruese e manipuluese të Rezilit. Kurse unë po përpiqem të të këndell që të mos bëhesh viktimë e tij. Paska qenë e kotë përpjekja ime e përparme që të të ndihmoj të kuptosh se cili është ai gjarpër. Ti qenke tjetërsuar prandaj e ke toleruar Rezilin që të bëjë gjithë atë propagandë shpifëse e kompromentuese kundër Jusufit dhe kushe-di ku do të përfundojë kjo çmenduri jotja, po vazhdove. Unë nuk do të lodhem më në këtë drejtim, meqë nuk je në gjendje të më kuptosh, ose ndoshta unë nuk po di të të sqaroj. Tani po më detyron që të mendoj edhe për marrëshëniet tona.

– Të lutëm, mos më fol më, se vërtetë po më bën të çmendem!

– Nuk do të flas, do të të le të pushosh, sepse ke udhëtuar gjatë dhe kemi rrugë të gjatë deri në Pragë. Unë po dal të blej ca gjëra për rrugë, kurse ti shtrihu.

Mirani doli duke lënë Vasilin në dhomë, tashmë me kokë në mes të dy duarve, sikur donte ta mbronte nga çfarëdo lloj dyshimi që e kishte mbërthyer. Pas një ore Mirani u kthye. E gjeti Vasilin të shtrirë, por me sy të skuqur. I erdhi keq për të, meqë si duket kishte qarë. Mirani kishte krijuar bindje se Vasili ishte nga ata burra që nuk qanin në asnjë situatë. Kurse tani po i dukej se ai ishte zvogëluar. Vendosi të mos i fliste tjetër, pos ta pyeste nëse kishte pushuar dhe nëse ishte i gatshëm për t'u nisur për rrugëtim.

– Po më pyet kot, meqë po më sheh se në ç'gjendje jam katandisur,

gati sa nuk më ka pëlçitur shpirti.

– He mor burrë i dheut, ç’hall ke? Nuk bëhet kiameti edhe sikur Jusufi të jetë dërguar nga UDB-ja. Një më shumë dhe ne duhet të kalitemi ta përballojmë, – tha tjetri duke menduar se duhej ta qetësonte derisa të niseshin për të vazhduar bisedën gjatë rruge.

– Nuk bëhet kiameti, thua ti, por kiameti në fakt ka ndodhur, – foli Vasili me zë tërë drithërima.

– Për cilin kiamet e ke fjalën, fol se tani po më çmend ti mua!?

– Nuk e thëmë dot, jo pse e kam të ndaluar, por nuk e di se si po ndihem.

– Atëherë do ma thuash gjatë rrugëtimit. Të nisemi tani?

– Prit edhe pak. Nuk ndihem mirë për të vozitur, kurse ti nuk ke leje.

– Në rregull, po rrimë. Nëse mendon, mund të mos shkojmë fare.

Mirani u nis drejt kuzhinës përballë. Mendoj t’i bënte një kafe, sado që vetë as e mbante as e pinte. Vendosi të kërkonte kafe në dollapët e studentëve të tjerë. Pas katër-pesë minutash u kthye me kafe në dorë dhe ia dha Vasilit. Tashmë heshtja kishte rënë midis tyre. Mirani kishte merakun për hallin e Vasilit, kurse Vasili po mendonte me kokë varur, pa qenë në gjendje ta ngriste për ta parë në sy tjetrin.

– Nëse ma jep fjalën se ti nuk do t’i tregosh askujt, do të ta rrëfej hallin e madh që kam, – theu heshtjen Vasili.

– Varësisht nga përmbajtja. Ka gjëra për të cilat nuk mund të jepet fjala. Megjithatë, ti e di se unë nuk e keqpërdori besimin tënd.

– Atëherë po ta them troç. Mua më ka urdhëruar organizata që të bëj atentat ndaj Jusufit. . .

– Deri këtu paska shkuar puna!? – pyeti tjetri pas një çasti. Ai ishte në dymendje se çfarë duhej të fliste pas një shoku aq të madh, të cilën e ndjeu si një goditje të rëndë.

– Deri këtu ka shkuar dhe përfundimin mund ta marrësh me mend.

– Të falenderoj për besimin që shfaqë ndaj meje, sepse vërtet e paske

pas të vështirë të dekonspirosh një vendim kaq serioz!

Mirani u ndal për të menduar se çfarë duhej të thoshte në vazhdim, kurse Vasili dukej i nemitur. I pari mendonte se paskan qenë para një kobi, meqë kishte krijuar bindjen se Vasili ishte trim, i vendosur, për të cilin mjaftonte vendimarrja dhe, o kryhej puna, o nuk rronte më. Njëherit u ndi i lehtësuar që tani e dinte dhe duhej të bënte çmos për ta riparuar këtë kob. Ishte momenti për të vendosur për mënyrën e vazhdimit të bisedës.

– Të betohem, nuk është vendim i organizatës, por i Rezil Mejtepit, – foli Mirani prapshëm duke menduar se nuk kishte kohë t’i çonte deri në fund mendimet e vetëmevetme.

– Vendimi është i organizatës, – u përgjigj tjetri.

– Ke qenë ti i pranishëm kur është diskutuar dhe kur është marrë vendimi?

– Jo, nuk kam qenë.

– Ka qenë i pranishëm Maks.

– Jo nuk ka qenë, nuk e di askush pos Rezilit, meje dhe ti tani je i treti.

– Domethënë ta ka shqiptuar Rezili si vendim të Grupit?

– Po, ai është kryetar dhe është kompetent të marrë vendime e të japë urdhëra.

– Kësaj nuk i thonë organizatë dhe këtij vendimi të kobshëm nuk mund t’i thuhet vendim organizate. Ti je Nënkyetar i Grupit dhe duhet të jesh pjesëmarrës në vendimarrjet kapitale të tij. Ka marrë vendim vetëm Rezili, nëse e ka marrë me të vërtetë ai, për çka unë nuk besoj dhe të ka urdhëruar ty në emër të Grupit. Kësaj nuk di t’i vë emër.

– Pse, mendon ti, se nuk ka të drejtë të marrë këso vendimi kryetari? – pyeti me habi Vasili.

– Vetëm në organizata mafioze e kriminale, por jo një organizatë politike e patriotike.

– Rezili ka thënë se në emër të centralizmit demokratik dhe të kon-

spiracionit, ka të drejtë të marrë vendime, pa pyetur askënd dhe ne nuk guxojmë të kundërshtojmë e të pyesim për vendimmarrjen e tij.

– Domethënë, nëse ai është udbash, siç mendoj unë, atëherë ju qorrazi duhet të vëheni në shërbim të tij, gjegjësisht të UDB-së, për të zbatuar vendime, gjegjësisht për të vrarë patriotë, siç është rasti konkret?

– Po e tepron, po na akuzon tepër rëndë, – u përgjigj Vasili.

– Pse, si mendon ti, të vritet shoku ynë Jusufi, ndërshmërinë e të cilit nuk e kam vënë në dyshim në asnjë çast, që kur e kam njohur dhe po bashkëpunojmë si të ishim shokë të të njëjtës organizatë prej vitesh. Nuk do të thotë se ky vendim është marrë nga UDB-ja dhe ajo gjithashtu ka urdhëruar Rezilin, që të të urdhërojë ty për ta ekzekutuar!?

– Unë kam bindjen se nuk është vendim UDB-je.

– Sipas teje, nga i merr ai kompetencat dhe të drejtën për të marrë vendim për këtë atentat kaq të kobshëm!?

– Nga të qenit Kryetar i Organizatës sonë të fshehtë.

– Cila, kur dhe si e ka marrë këtë vendim kjo farë i thënçin organizatë, kur e dimë, se ti je nënkryetar i saj? – pyeti me ze të rrufeshëm Mirani. – Pastaj edhe e fshehtë nuk është, sepse Rezil katili po bredh me formularë anëtarësimi në stacion, në hajme, në lokale duke i lutur hapur për anëtarësim bashkatdhetarët.

– Nuk e di, nuk më ka treguar.

– Organizatën nuk e përbën vetëm emri, por anëtarët dhe strukturat e saj drejtuese. Siç po përgjigjesh tij, po provohet ajo që thashë, se kësaj farë organizatës suaj vetëm organizatë politike patriotike nuk mund t'i thuhet.

– Cilit organizim mund t'i thuhet organizatë, sipas teje?

– Kur është fjala për organizata politike, të karakterit patriotik, por edhe të karakterit komunist, si në rastin tuaj, që Rezili e ka zgjedhur si maskim pikant për disa që e simpatizojnë komunizmin për hatër të Enver Hoxhës, duhet të kenë struktura drejtuese, në të cilat diskutohet dhe

merren vendime dhe assesi nuk mund të quhet organizatë pa pasur statut a rregullore që normon mënyrën e drejtimit, të vendimmarrjes dhe të funksionimit të saj.

– Ne kemi rregullore.

– Nuk besoj se në të shkruan që kryetari ka të drejtë të marrë individualisht vendime kapitale.

– Nuk shkruan, e di përmendsh.

– Atëherë?

– Nuk di çfarë të them, – u përgjigj Vasili duke rrudhur krahët.

– Kur ta ka komunikuar këtë vendim?

– Të dielën e kaluar, rreth orës 21.30, kur po bëhesha gati të flija. Erdhi në hajm, ma komunikoi urdhërin dhe doli. Më caktoi takim për të nesërmën, në orën 18.00, në parkun e qytetit në Shtuttgart. Më duhej të punoja, përndryshe do të kisha ardhur, pasi ai urdhër më pat shokuar. Të nesërmen dola në takim. Më foli shumë për domosdoshmërinë e kryerjes se atentatit, sepse ishte në interes të pashmangshëm të revolucionit.

– E ke pasur ndërmend ta zbatosh? – ndërhyri Mirani.

– Jo, pa marrë tërthorazi mendimin tënd.

– Atëherë pse ngurove të më tregojë?

– Sepse doja të ta merrja mendim tërthorazi, pa të treguar për urdhërin që ma ka dhënë Rezili.

– Vetëm deri në këtë pikë zgjaste besimi yt ndaj meje?

– Besimin e kam të qindpërqindtë, por Rezili më urdhëroi të mos i tregoja askujt në botë.

– Po sikur Rezili të të urdhëronte që ti të më vrisje mua?

– Po tallesh më mua? – u përgjigj tjetri i zënë ngusht.

– Nuk po tallem, por bëra një pyetje hipotetike, pasi ai, sipas mendjes sate të manipuluar, paskësh pasur të drejtë të marrë vendim. Të të urdhëronte të më vrisje edhe mua.

– Atëherë do ta kisha vrarë unë atë.

– Domethënë ti ke dyshuar vetë në ndershmërinë e Jusufit?

– Nuk kam dyshuar, por atë nuk e kam njohur, siç të njoh ty.

– Po tregohesh naiv dhe nuk po të ka hije.

– Më ke kapur në faj, prandaj thuaj çfarë të duash.

– Sigurisht që është faj, i bazuar në keqpërdorim të gatishmërisë sate, i disiplinës sate naive organizative. A nuk është ky naivitet primitiv!? Vërtet, si mund t'i shkohet pas atij çafiri!?

– Të shohim si do të zhvillohen ngjarjet.

– Domethënë, vazhdon të kesh dilema!?

– Nuk jam robot.

– E di çka, bisedimi i mëtejshëm është bërë i pakuptimtë. Të nisemi, por tani jo për Pragë, por te Jusufi.

– Kurrsesi, nuk vjen në shprehje! – tha ai me zë të prerë.

– Pse jo, ende vazhdon të dyshosh se Jusufi është dërguar nga UDB-ja, siç të ka mashtruar ai gjarpër?

– Nuk po dyshoj dhe këtë mosdyshim e kisha që në fillim, por ç'ti bëja Rezilit që më urdhëroi pa pyetur për mendimin tim.

– Ec, të shkojmë, mos u mundo të luash rolin e budallait, se nuk po të shkon!

– Nuk pranoj urdhëra!

– Ti ke pranuar urdhër për të bërë atentat në shokun tonë dhe tani nuk pranon lutjen time, – ia ktheu me nervozizëm Mirani.

– Atë e kam kryetar, me ty jemi shokë të ngushtë dhe bashkëveprimtarë.

– Atëherë të nisemi, se kemi kohë për të biseduar e vendosur gjatë rrugës.

Vasili u ngrit pa kundërshtuar më. Duke qenë në ashensor Mirani kishte bindjen se do ta kishte të vështirë të voziste Vasili pas gjithë atij shqetësimi shpirtëror. Kur u nisen, Mirani e këshilloi të voziste ngadalë

dhe të ndaleshin për pushim, sa herë që nuk do të ndihej mirë.

Bënë ca kilometra rrugë dhe asnjëri nuk po fliste. Mirani shtriu karrikën dhe po pushonte. Ndihej i dërmuar. Pas rreth njëzetë minutash rrugetim, ai e theu heshtjen:

– Shoku Vasil, unë prapë jam i mendimit se duhet të shkojmë te Jusufi e Bardhi. Atyre do t'u tregojmë për urdhërin që të është dhënë, ndërsa Rezilit nuk do t'i tregojmë për aq kohë sa të kemi vendosur se si do ta përmbyllim këtë kriminalitet të tij. Do të vendosim bashkërisht se si duhet të sillësh ti ndaj tij.

– Më vjen vështirë nga Baci Jusuf, do të zhgënjehet në mua, meqë e ndjeja se më donte njësoj si Bardhin.

– Më mirë është që ty të të vijë keq e ai të zhgënjehet, se sa, larg qoftë, ai të vritej. Pastaj, mund të ndodhë e kundërta. Ai është aq i kuptueshëm, sa që të të mos bëj ty fare fajtor, por vetëm Rezilin dhe eprorët e tij. Ai tashmë e di cili është Rezili. Që ditën e parë i ra të konfrontohej me veprimtari të këtij çafiri, i cili as një ditë nuk ka pushuar duke shpifur e dezinformuar se gjoja Jusufin e ka dërguar UDB-ja.

– Për Flamur, më vjen vështirë!

– Të kuptoj, por do ta përballojmë së bashku. Pastaj do të bisedojmë për rrolin tënd në të ardhmen. Ai mund të urdhërojë dikë tjetër kur të shohë se ti nuk po ia zbaton urdhërin.

– Ka për të ma paguar shtrenjtë Rezili!

– Për këtë do të vendosim bashkërisht.

Heshtën edhe një copë herë.

– U dakortuam që të shkojmë përpara të Jusufi e Bardhi? – foli Mirani.

– Më ke mbështetur për muri.

– Nëse nuk je bindur, nuk po shkojmë. Kemi kohë. Por unë mendoj se duhet të shkojmë që sonte.

– Atëherë po të dëgjoj, edhe pse nuk mund ta marrësh me mend se

si po ndihem, i zënë ngusht tej mase.

– Në rastin e parë del të pushojmë dhe do të të qeras me kafe, – propozoi me dashamirësi tjetri, i lehtësuar që Vasili pranoi të shkonin së pari të Jusufi e t'i tregonin për të gjitha dhe ta bisedonin se ç'duhej bërë në të ardhmen.

Vasili ia hodhi dorën rreth qafës Miranit dhe e mbajti aty për disa çaste. Mirani e shikoi me dhembshuri e keqardhje. Ai zuri të mendonte me vete për tragjedinë që mund të ndodhte, sikur Vasili të mos i besonte, duke ia hapur zemrën për të bashkëbiseduar për diç që pak më parë mendonte se duhej të mbahej në konspiracion edhe pas zbatimit të urdhërit të kobshëm. Ç'goditje të rëndë që do të pësonin nismat filizore patriotike, zot ruajna, po të ndodhte ky atentat! Boshllëku i pastajmë që do të vinte për Miranin e ambientuar tani me një bashkëpunim tepër të ngushtë e tepër shoqëror me Jusufin, ishin mendime të llahtarshme. Miranit zunë t'i rridhnin lotët. Ai ktheu kokën në anën e djathët të mos e shihte Vasili dhe bëri sikur po flinte. Sa s'po i pëlciste lukthi nga ca ngërqe ngashëruese.

2.

Rreth orës 21.30 Vasili dhe Mirani arritën te Jusufi. Edhe këtë herë, si gjithnjë, u gëzuan të gjithë. Fëmijët e Jusufit, sidomos me Miranin, kishin krijuar afërsi të madhe dhe mezi e prisnin. Mikpritësit as mund ta merrnin me mend se ç'tragjedi kishte mundur të ndodhte nga Vasili që aq shumë e donin. Mirani vështronte përçafimin e Jusufit me Vasilin, ngurrimin e tjetrit. Dëgjonte qortimin që Jusufi i bëri Vasilit, përse ai nuk kishte shkuar fundjavën e kaluar dhe prapë mendimet i shkonin terrinave të mendjes së keqe të njeriut.

– Nuk kishit paralajmëruar se do të vinit, – foli Jusufi.

– Nuk e kemi të domosdoshme, – u përgjigj Mirani, por pa harenë e herave të tjera. – Na ke thënë se na trajton si pjesëtarë të familjes dhe

pjesëtarët nuk e kanë të domosdosëem paralajmërimin për ardhje në shtëpi.

– Përgjigjet e qëlluara i ke në majë të gjuhës, – ia ktheu Jusufi. – Vërtet si vëllezër ju kam. Stërpërsëritja se mund të vini në çdo kohë, mu si në shtëpitë tuaja, mund të duket tani bajate.

Shihej se kësaj radhe atmosfera nuk ishte aq e hareshme dhe e ngrohtë dhe për këtë nuk ishin fajtorë shtëpiakët, që veçsa e kishin shtuar mirëpritjen, nga malli që nuk ishin parë për dy javë. Fajtorë ishin të saporardhurit, Vasili dhe Mirani. Ata tani rrinin tepër të vetëpërmbajtur e të ndrojtur, ndryshe nga herat e tjera.

– Ka ndodhur gjë? Sesi me dukeni, sikur nuk jeni me humor të mirë si herave të tjera? – pyeti Jusufi.

– Jo, jo, asgjë me rëndësi, – tha Mirani me gjysmë zëri. Ai s’e kishte ndër mend të fliste gjë në prani të familjes. Këtë kërkesë, pothuajse në formë urdhëri, ia kishte bërë që në fillim Jusufi dhe tani ai duhej t’i përmbahej.

Jusufi e hetoi se përgjigja e tjetrit nuk qe aq bindëse. Vështroi të dy pastaj iu drejtua Miranit:

– Kam për të biseduar diç me ty në dhomën tjetër. Shkojmë se nuk po më pritët derisa të shtrohet darka për ju, mëqë ne kemi ngrënë.

– Nuk keni nevojë të shtroni sonte darkë për ne, sapo hëngrëm rru-gës, – tha Mirani duke u ngritur me dorën e Jusufit mbi supë.

– E paske prishur rregullin. Herave të tjera, sapo hyje në shtëpi, tregojë se je i unitur.

– Nuk thuhet kot se rregullat kanë përjashtime.

Kur dolën në dhomën tjetër, akoma pa u ulur, Jusufi s’u durua:

– Më dukeni tepër të shqetësuar e të ndrojtur. Më trego çfarë ka ngjarë?

– Them të vijnë edhe Bardhi e Vasili që të bisedojmë.

– Mirë, – tha, – Vasil e Bardh, ejani që t’i pimë kafet këtu, meqë kemi

më shumë qetësi.

Bardhi mori tabakanë me kafe e gota të lëngjeve që ishin vënë në tavolinë dhe u nis drejt dhomës. Vasili i shkoi prapa duke zhagitur këmbët si të kishte një peshë të rëndë mbi supa sa mezi po e mbante. Kokën gjatë gjithë kohës e mbante poshtë dhe kjo secilit mund t'i kishte rënë në sy. Fëmijëve të Jusufit u erdhi shumë keq që Mirani e Vasili nuk po rrinin më gjatë aty, meqë ata e dinin se nuk kishin të drejtë të hynin në dhomë të punës, kur bëheshin biseda. Ata dëshironin të çmallëshin me Miranin e Vasilin si edhe herave të tjera.

Për disa çaste në dhomën e punës zotëroi heshtja. Askush nuk dinte si ta fillonte bisedën. Jusufi e Mirani u panë edhe njëherë ndërmjet. Mirani e kuptoi se ishte ai që duhej të fillonte.

– Që të mos i bie rrotull dhe të mos bëj ndonjë parahyrje, po i bie shkurt: Shokut tonë Vasil i është dhënë urdhëri për atentat ndaj teje. Këtë urdhër ia ka dhënë çafiri Rezil Mejtepi. Urdhëri Vasilit i është komunikuar të dielen dhe sot Vasili erdhi të unë për të kërkuar mendimin, sado, sipas tij, ia ndalonte disiplina organizative e Grupit të tyre.

Mirani u ndal pak për të parë të tjerët nëse duhej të vazhdonte apo të priste ndonjë ndërhyrje. Jusufi e Bardhi nuk kishin lëvizur e ndërruar qehre. Dukeshin sikur nuk e dëgjuan njoftimin për atentat ndaj Jusufit.

– Të flasë vetë Vasili, them unë, – shtoi Bardhi.

– Jo, le të vazhdojë Mirani, sepse Vasili duhet ta ketë përjetuar rënd këtë urdhërim, – ndërhyri Jusufi me qetësinë fisnike që e karakterizonte.

– Për Rezil Mejtepin kemi biseduar herë pas here, pasi na hidhëronte veprimtaria e tij shpifëse kundër teje, – vazhdoi Mirani duke shikuar drejt Jusufit, – se gjoja të ka dërguar UDB-ja. Por, ti nuk hidhërohesh, sa hidhëroheshim ne dhe nuk na le të vepronim për ta detyruar Rezilin të ndërpriste atë fushatë shpifësh e denigrimesh. Mua nuk më ka befatur një vendim kaq i kobshëm, sepse për Rezilin vazhdimisht kam thënë se duhet të jetë i rekrutuar nga UDB-ja. Por, që Rezili ta urdhërojë

Vasilin për atentat, kjo ishte tepër befasuese e shokuese për mua dhe ne duhet ta diskutojmë këtë urdhërdhënie të tij me urti.

Prap ra heshtja dhe asnjëri nuk dëshironte të fliste. Pas disa çasteve ia krisi Jusufi:

– Për hajr na qoftë. Nuk e paskam ditur se kam bërë kaq shumë për kombin tim, sa të merret vendim për të më vrarë. Kjo duhet të na e shtojë moralin për veprimtari më të madhe, meqë urdhërdhënia për atentat është tregues domethënës se veprimtaria jonë paska peshë.

Për një çast ai u ndal, sikur deshi të mësonte nëse dikush nga të pranishmit priste radhën për të folur. Kur nuk foli njeri ai iu drejtua Vasilit:

– Të, shoku Vasil, nuk ke përse e mban kokën varur. Nuk ke arsye të ndihesh fajtor. Madje, do të thosha se paskam qenë me fat kësaj radhe, meqë ai ka mundur ta urdhërojë ndonjë tjetër, i cili nuk do të na tregonte, por do ta zbatonte urdhërin. Tani kërkoj nga ti që të inkuadrohesh në bisedë si të gjithë ne, me kokën lart. Të njohim për shokë të mirë dhe këtë vlerësim nuk e lëkund kjo që ka ndodhur. Përkundrazi, vetëm se t'i ka shtuar vlerat me kurajon burrërore që shfaq duke i treguar se pari Miranit e tani edhe neve.

– Unë mendoj, – ndërhyri Mirani, – të bëjmë një skenar të sjelljes sonë, tani e tutje karshi Rezilit, për të zbuluar nëse është urdhër-vendim i tij, se ashtu ia ka thënë koka, gjë që nuk besoj, apo është transmentues i një urdhëri që është marrë në ndonjë shtab përkatës në Beograd. Them kështu, meqë edhe ti Jusuf kundërshtojë përpara, se Rezili nuk duhet të jetë i rekrutuar nga UDB-ja, por se shpif kundër teje nga xhelozia.

– Për asnjë lloj skenari nuk kemi nevojë, – ndërhyri Bardhi. – Është dashur më herët t'ia tregojmë vendin e merituar atij gjarpri, sepse vërtet që moti e ka tepruar.

– Mos u nxito dhe mos u nxej! – urdhëroi Jusufi. Ne këtë rrugë e kemi zgjedhur me dëshirë. Nuk kemi qenë aq naivë sa të hamendëso-

hemi se UDB-ja dhe strukturat e tjera përkatëse të pushtuesit do të na tolerojnë dhe do të na lehtësojnë. Ka qenë e ditur se, herët a vonë, do të merren vendime të ngjashme, por nuk e kam menduar se e paskam merituar kaq shpejt. Kësaj radhe kemi pasur fat se urdhëri i është dhënë shokut tonë, por si t'i ruhemi rasteve të tjera. Që të jem më konkret, propozimin e Miranit e përkrah, por kjo varet nga Vasili, nëse do të pranojë të luajë rolin, siç do ta mendojmë.

Të tre njëherësh drejtuan vështrimin nga Vasili për të dëgjuar përgjigjen dhe paraqitjen e tij, meqë ai, sipas këshillës së Jusufit, tashmë e kishte ngritur kokën dhe po përcillte diskutimet e shokëve.

– Së pari dua t'ju kërkoj falje, – e nisi prajshëm Vasili, – pse më është dhënë urdhëri pikërisht mua. Pastaj, po jua jap besën se po vendoset që ta dënojmë me vdekje atë qen, brenda javës kam për ta vvarë. Madje unë parapëlqej ta vras në vend publik, sepse mediat gjermane do të shkruajnë ato që do t'i them unë me atë rast edhe para gjyqit, dhe assesi tinëzisht.

– Vasil, – foli Jusufi ëngjëllor, – nuk ke përse kërkon falje. Ti nuk je pjesëmarrës në vendimmarrje të atentatit. E dyta, nuk kemi arsye të nxitohemi. Duhet të jemi të vetëdijshtë se nuk jemi kompetent për vendim kapital për t'ia marrë jetën qoftë edhe shërbëtorit të pushtuesit. Unë parapëlqej propozimin e Miranit. Ai tani do të na tregojë se si e ka menduar skenarin, meqë ka pasur kohë më shumë të mendoj për të.

– Unë jam për gjykimin që meriton ai kriminel, ndërsa nga ti Vasil do doja të dija mendimin tënd, se përse ai shpirtkatil të ka urdhëruar pikërisht ty? – tha Bardhi.

– Po mundohem të përgjigjem unë, – s'u durua Mirani, meqë nuk e shihte të arsyeshme të përgjigjej në këtë pyetje Vasili. – Them që Vasili fillimisht ka qenë viktimë e dëshirës se papërmbajtur për të qenë i organizuar. Meqë Rezili e ka hetuar veprimtarinë e Vasilit, Maksit dhe ndonjë bashkatdhetari tjetër, atëherë ka vendosur të themelojë organizatë. Më

saktësisht është urdhëruar të themelojë organizatë për të hetuar dhe për të futur nën kontroll këtë rreth bashkatdhetarësh patriotë e të angazhuar. Këtë sajësë udhësoi Rezili e kanë formuar për t'i identifikuar e kontrolluar patriotët e interesuar për kryengritje çlirimtare. Rezili i ka hetuar patriotët më të angazhuar dhe i ka anëtarësuar në këtë organizim të shpifur, por që, për momentin, është emërtuar me emër tërheqës: *Grupi Komunist Zëri i Kosovës*. Bile, për ta bërë më të sofistikuar hilen e tij, Rezili i ka kooptuar Vasilin si nënkryetar dhe Maksin si sekretar të Grupit. Këta nuk e kanë njohur teorinë e organizimit, as atë të tipit të ashtuquajtur centralizëm demokratik, as atë të organizimit klandestin. Rezili i ka keqpërdorur e komanduar sipas interesit të tij, duke i keqpërdorur edhe për interesa individuale. Për keqpërdorimet financiare të Rezilit kemi folur herë pas here, siç kemi folur edhe për fushatën e tij kundër teje, Jusuf, po edhe për gjera të tjera. Unë jam përpjekur t'i sqaroj, sidomos Vasilin dhe Maksin më herët, por edhe ty më vonë, se Rezili është i rekrutuar nga UDB-ja, por ju nuk më dëgjoni. Tani, besoj, ai gjarpër ka dhënë provë kokëfortë, që dëshmon se cili është. Pa e zgatur, mendoj se Vasili nuk duhet të shfaqë asnjë dyshim karshi tij. Duhet t'i kërkojë armë të sofistikuar për kryerje atentati, ta zëmë revole me zhurmëshues; t'i kërkojë të holla, me arsyetim se duhet t'i kenë bashkëshortja e fëmijët, në rast se do të bjerë në burg, e të ngjashme si këto. Kështu do të mund të zbulojmë me prova, nëse i qëndron prapa UDB-ja. Pastaj, për sa kohë që ai nuk do të dyshojë ndaj Vasilit, nuk do ta urdhërojë dike tjetër për të bërë atentat. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet ta rrisim vigjilencën. Këtë skenar do ta luajmë deri sa të na duket i mjaftueshëm për të marrë pastaj një vendim konkret.

– Jam dakort me propozimin e Miranit, – tha Jusufi, – por secili duhet të tregohet i përmbytur. Përndryshe, rrolet mund të përfundojnë si të dështuara.

– Thënë të drejtën, – ia pati Bardhi me zë prej të hidhëruari, – nuk

kemi pse të humbasim kohë, pasi ai çafir e ka mbushur kupën.

– Megjithatë, jam për propozimin e Miranit, – preu Jusufi, – sepse duhet të hulumtojmë, nëse ai vërtet ka përcjellë vendim të padronëve të tij, apo e ka vendim autentik. Pastaj, duhet ta kemi një gjë të qartë se ne nuk jemi institucion që kemi të drejtë të marrim vendim kapital, siç mund t'i shkojë nëpër kokë ndonjërit në këtë situatë të nxehtë. Unë s'e kam krejt të qartë. se përse e ka urdhëruar shokun tonë Vasil, kur dihet se UDB-ja i ka vrasësit e vet profesionistë?

– Nga bisedat që kemi bërë me Miranin në Bochum dhe gjatë rru-gës, – mori fjalën Vasili, – kam krijuar një version: UDB-ja ka dashur të të zhdukë ty fizikisht dhe të fusë grindje pastaj midis nesh. Jam më se i bindur se urdhërdhënësi do të më kishte dekonspiruar në ndonjë mënyrë përfide mua si vrasës. Pastaj mediat këtu do të flisnin për qënim hesapësh midis grupacioneve shqiptare dhe ne do të vazhdonim të vriteshim në emër të hakmarrjes.

– Duhet të ketë të drejtë Vasili, – shtoi Mirani. UDB-së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara, sepse atëherë mediat do t'ia mvishnin asaj. Pra, asaj më shumë i intereson të organizojë vrasje që do të zbuloheshin dhe pastaj do të komentoheshin si vrasje ndërmjet grupacioneve shqiptare, në mënyrë që dëmtimet dhe përçarjet të ishin të mëdha dhe të vazhdonin për shumë kohë. Vetëm në rastet kur nuk mund të kurdisin vrasje me ekzekutues shqiptar, siç kanë planifikuar në këtë rast, atëherë do të bëjnë edhe atentate me specialistë tyre, që do të mbeteshin të pazbuluara, derisa të hapeshin arkivat përkatëse.

– Ta mbyllim këtë bisedë, – tha Jusufi, – pasi mund të flasim gjatë dhe të mos ia qëllojmë tamam, nga se shoku dhe afekti, sado të përmbajtura në dukje, bëjnë ndikimin e tyre. Nësër, besoj, jemi më të qetë dhe mund të vazhdojmë.

Asnjëri nuk u prononcua zëshëm dhe secili e kuptoi se nuk kishte kuptim të shtonte gjë pas mendimit e kërkesës se urtë të Jusufit.

Biseda e ngarkuar me emocione, hidhërimi, urrejtje, kaloi natyrshëm në ndejë të rëndomtë. Jusufi shquhej për ustallëk të kalimit të bisedave serioze, ndonjëherë të tensinuara, në ndenja të shlrshme. Edhe kësaj radhë mori kitarën dhe shkoi në dhomë të ndenjës që edhe të tjerët të kalonin andej. Filloi të këndonte këngën për tradhtinë e Moisi Golemit, sipas vjershës se Kadaresë, të cilës ia kishte gjetur një melodi që i shkonte shumë përmbajtjes. Fëmijët dhe gratë nuk dinin se çfarë kishte ndodhur, se cila tragjedi mund t'u kishte plasur. Pas këngës për Moisiun, ai ia mori të preferuarës për Nënë. Mirani po mendonte se sa botë të largët kishin përmbajtjet e këtyre dy këngëve dhe sa afër ishin për momentin. Atentati i kobshëm si tradhti, me dhëmbjen e pastajme të Nënës. E po, nuk thonë kot, *se vaji i burrit është kënga*, vazhdonte të mendonte ai. Pakontrollueshëm mendja po i prodhonte shumë pamje: Sa e rëndë do të kishte qenë goditja, sikur atentati i kobshëm të ndodhte; se si do t'i mungonte zëri kaq melodik, i embël i Jusufit, këshillat e tij, përkujdesja si e vëllait më të madh. Padashur humbi vetëpërmbajtjen dhe e vërshuan lotët që nuk dëshironte t'ia shihte njeri. Rrëbimthi shkoi në tualet. Atje ndenji gjatë, qau me dënësë, lau disa herë fytyrën. Jusufi e hetoi gjendjen e tij shpirtërore dhe propozoi që Vasili e Mirani të shkonin të flinin, me shpjegim se kishin udhëtuar gjatë dhe ishin të lodhur. Meqë banesa ishte e vogël, Vasilit iu duk më e arsyeshme të kërkonte leje, që bashkë me Miranin, të shkonin për të fjetur në banesën e tij në konvikt. Jusufi nuk kundërshtoi si herave të tjera.

3.

Gjatë rrugës Vasili dhe Mirani zgjodhen heshtjen medituese, sado herave të tjera u ishte bërë shprehi, sidomos Vasilit, që të bisedonin pikërisht si llafazanë të babëzitur. Mirani nuk po shkëputej dot nga mendimet për Jusufin dhe Bardhin. Mendohej të futej sa më thellë në botën e tyre shpirtërore, në mundësinë e përshkallëzimit të gjendjes nëse Jusufi

do t'i tregonte bashkëshortës! Sado që, për të tilla gjera, për diskutimet që bënin e vendimet që merrnin, ishte tepër i rezervuar ndaj saj...

– Të falënderoj për gjithë kontributin që dhe, – e shkëputi Vasili. – Nuk mund ta marr me mend, se si do të rridhnin ngjarjet, po të mos më sqaroje e ndihmoje ti. . .

– Na lër rehat me këto lavdërime! Po të ishim aq të zotët sa lavdërojmë njëri-tjetrin do të ndreqnim shumëçka në mënyrë preventive dhe nuk do të katandiseshim në këtë gjendje.

– Mirë e ke, ndoshta nuk qe momenti të flas fare, por meqë mendimet më shkuan pakontrollueshëm te tragjedia që do të mund të ndodhte, desha t'ua pres turrin me bisedë. Po frikësohem se mund të përplasem me makinë. Do të më falësh që po të bezdis!

– Nuk ke nevojë të kërkosh falje. Jemi shokë. Pastaj, mua më takon të falënderoj ty për besimin e arsyen që tregove, sado që e kishe të vështirë. Të ishte ngulitur në kokë si e drejtë një formë e organizimit që vetëm djalli dhe Rezili mund të sajojnë. Të kishte përfshirë deliri i madhështisë, se do të bënit mrekullira me veprimtari të organizuar çlirimtare. Në rrethana të tilla e ke pasur të vështirë t'i thërrasësh arsyen për të biseduar edhe me një shok të ngushtë, siç më di ti mua, por që nuk i takon të njëjtës organizatë, që të dekonspiroje një vendim kaq të kobshëm. Mund ta marrësh me mend se një ditë Rezili, kryetari yt, do të të gjykojë edhe ty për tradhti kombëtare, kur do të marrë vesh se ti, jo vetëm nuk po zbaton urdhërin e tij, gjegjësisht të eprorëve të tij, por e ke dekonspiruar atë...

– U pa kjo punë. Tani do t'i shkojmë deri në fund... – e këputi Vasili me vendosmëri e inat, pa qenë i vëmendshëm, nëse Mirani e kishte mbaruar fjalën.

– Sigurisht, do t'i shkojmë, por si do t'i shkojmë? Mos të na ndodhë që duke u munduar të vëmë vetullat, të nxjerrim sy, siç na mëson fillozofia e urtë popullore.

– Që të hënën do të marr pushim mjekësor dhe do t'i përkushtohem survejimit të atij qeni.

– Do vetëpërmbytje dhe mjeshtëri të madhe kjo punë, meqë Rezili duket shumë i shkathët. Ai ka natyrë të dukshme prej kriminelit profesionist. Nuk besoj ta ketë të lindur. Duket që është stërvitur nga specialistë të zotë, – e këshilloi Mirani.

– Gjithsesi, tani kam rast të dëshmojem, edhe pse ju intelektualët na injoroni ne punëtorëve.

– Vasil, sa herë të kam thënë që ta heqësh një herë e përgjithmonë këtë paragjykim prej inferiori. Ndoshta nuk po e hetoj, por Jusufi, Bardhi, unë, ti, Maksi dhe shumë bashkëveprimtarë të tjerë po sillemi tepër shoqërisht. Asnjë keqpërdorim të epërsisë intelektuale nuk po e hetoj midis nesh. Nëse ti ke vënë re ndonjëherë diçka, atëherë mos ngurro, thuaje! Madje, Jusufi po sillet ndaj nesh me aq modesti, sa po le hapësirë të keqkuptohet për modesti të tepruar e naive.

– Vërtet, kot e thashë. Si duket më është bërë shprehi. Pse më ndodh kështu nuk e shpjegoj dot.

– Sado që na bëjnë mirë bisedat, mendoj se nuk kemi nevojë të zgjatemi. Kemi kaluar gjendje tepër të tensionuar.

– Mirë, mirë, por po dëshiroj ta spostoj vemendjen nga ca mendime të pasistemuara, që po më përdridhen pakontrollueshëm si në një ekran televizori të prishur.

Mirani nuk bëri tutje, por parapëlqeu heshtjen. Pa orën në makinë. Kishte ikur mesnate. Sapo arritën në konviktin ku banonte Vasili ra në krevat dhe menjëherë e mori gjumi. Vasili vazhdoi të rrinte zgjuar, ulur në karrigen pranë tavoline, e cila gjendej midis dy krevateve. Mendohej të lexonte libërthin e Enver Hoxhës, “Vetadministrimi jugosllav – teori dhe praktikë revizioniste”, por ecte. Atë ai e kishte mësuar pothuajse përmendsh.

4.

Në mëngjes, në orën nëntë, Mirani u zgjua. Ai pa të shtrirë Vasilin e pazhveshur dhe të pambuluar në krevat dhe i erdhi keq për të. Vendosi ta linte të flinte, por duke e mbuluar atij i doli gjumi.

– Mirëmëngjes! – tha Vasili. – Sa shpejt të zuri gjumi mbrëmë, tamam si të ishte radio që fiket me të prekur të sustës përkatëse!

– Nuk të paskam treguar ndonjëherë për këtë afinitet. Atëherë po të tregoj pasi të kesh larë fytyrën. Vitin e kaluar isha i sëmurë nga lukthi. U detyrova të shtrihesha në spital. Më vizitoi një mjek që ishte profesor i shquar. Në fund të vizitës më tha t'i shkoja në zyrë. Shkova. Bëmë një bashkëbisedim të gjatë. Më përvetësoi që t'i tregoja pa rezervë për mallin për nënën, vëllezërit, motrat, farefisnin, shokët, vendlindjen; për vuajtjet emocionale, për gjendjen e Kosovës, për keqardhjet që nuk po realizojnë ato që kisha dëshirë. Pastaj ai zuri të më këshillojë: “Sëmundja që keni ju është karakteristike pothuajse e të gjithë azilantëve politikë. Por, sado që të keni mall e të vuani për Kosovën, sado që t’ju vijë keq për pafuqinë që të bëni më shumë për të, nuk ju ndihmon gjë. Përkundrazi, ju dëmton juve dhe Kosovën. Tani, si i sëmurë që jeni dhe që mund të sëmurëni edhe më shumë, do të keni nevojë edhe për një tjetër që të kujdeset për ju. Kështu, Kosova iu ka humbur juve dhe dike që duhet të kujdeset për ju. Ju, për shkak të sëmundjes, do të detyrohëni ta tkurrni veprimtarinë, ose ta ndërprisni fare. Psiqikisht do t’ju duket e vetëmjaftueshme, meqë vuani dhe kështu krijoni një si sadisfaksion, por realisht keni bërë shumë më pak se sa mund të bëni kur jeni i shëndetshëm. Prandaj ju këshilloj që t’i disiplinoni sa më shumë ndjenjat. Binduni se mund të gjykoni më qetë, më realisht dhe gjithsesi mund të kontribuoni më shumë për të çliruar Kosovën”.

– Shumë interesant. Pa më shpjego si po të merr gjumi kështu?

– Pastaj e dëgjova me vëmendje, fillova t’i zbatoja këshillat e tij. Sigurisht që nuk u sëmura më dhe nuk do ta kem ndërmend të sëmurem.

Që atëherë më merr gjumi kur unë dëshiroj. Si të të them, e kam nën komandë. Në fakt, profesori më pat folur më gjatë dhe më bindshëm, por unë kam krijuar bindje se më ka folur siç të tregova dhe po ndihem mirë. Edhe ndjenjat po i kontrolloj më lehtë.

– Sa po ta kam lakmi!

– E kam nga këshillat e profesorit dhe nga përvoja e pastajme dhe nuk të bën keq të përvetësosh edhe ti diç nga këshillat e tij. Kështu do të mbrohesh më lehtë nga shqetësimet që t'i shkaktojnë të tjerët dhe do të mund të rezonosh më mirë e të kontribuosh më shumë.

– Ke të drejtë.

– Falemnderit që më jep të drejtë. Ustallaku qëndron në faktin nëse do të bëhesh i zoti për të përvetësuar e praktikuar diçka nga këshillat e profesorit që i dëgjove dhe që mund të t'i përsëris sa herë të duash.

– Do të përpiqem së paku gjatë bisedës së rrugëtimit, meqë unë nuk jam manjetofon t'i incizoj të gjitha këto.

– Pse jo? Të tëra këto mund të përmbledhen në një fjali të shkurtër: Më shumë mund të bësh për Kosovën duke qenë i shëndetshëm dhe i qetë sesa duke qenë i sëmurë dhe i shqetësuar.

– Kjo dihet, është shumë e thjeshtë.

– Si kjo, po kaq i thjeshtë është edhe fakti se shumica e sëmundjeve vijnë kryesisht nga tensionimi i sistemit nervor, nga shqetësimet, nga vuajtjet, nga urrejtja. Meqë nuk di mirë të të këshilloj teoritikisht, po marrë shëmbull konkretizues: Ç'faj ka, ta zëmë rastin konkret, pse Rezil Mejtepi ka lindur në robëri, ka qenë fëmijë i varfër, ka shkuar në medrese për t'u bërë hoxhë. Gjykoj se në medrese duhet të ketë qëlluar ndonjë mësimitdhënës që punon për UDB-në, pasi serbët i kanë dhënë rëndësi përvetësimit të hoxhallarëve. Mësimitdhënësi, sipas angazhimit, ka informuar UDB-në për Rezilin si i zgjuar, por i varfër dhe me karakter të lëkundur, ta zëmë për shkak të varfërisë dhe të vetëdijes së ulët kombëtare. Pastaj UDB-ja e ka rekrutuar. Deri këtu gjithëçka mund të quhet

normale, sepse edhe sistemi policor është një lloj hallke, ta zëmë, si sistemi arsimor dhe të njëjtin pushtet i shërbejnë. Do të thotë, është pothuajse njësoj të jesh mësues ose pjesëtar i strukturave policore dhe shërbimeve sekrete. Mësuesi u mëson fëmijëve, ta zëmë këngën për Titon ose për Enverin, polici kujdeset të kontrollojë fëmijët kur të rriten, nëse mësuesit nuk i kanë edukuar në frymë të sistemit përkatës. Në rastin konkret, të mos u kundërvihen Titos ose Enverit. Nëse është kështu, përse duhet urrejtur Rezilin, po që se është pjesëtar i mekanizmave të të njëjtit pushtet si edhe mësuesit që na kanë mësuar ty dhe mua. Në rastin e Rezilit kriminal mund të jetë fakti nëse kemi të bëjmë me dikë që është spiun jashtë strukturave legale të Kosovës, që nuk respekton ligjet, miratuar nga i njëjti parlament, si për udbashin, ashtu edhe për mësuesit tanë. Ai jep urdhër për atentat, i cili nuk parashihet as në ligjet jugosllave dhe të Kosovës. Ai duhet të jetë nga ata të rekrutuarit e të përgatitur që komandohen ilegalisht nga strukturat e organizimit gjysmlegal të nacionalistëve serbë, për t'i shërbyer politikës hegjemoniste e unitariste serbomadhe. Pra, ai mund që komandohet nga struktura të jashtëligjime, të cilat e kanë kokën në Beogradin serbomadh dhe jo në Beogradin jugosllav. Varësisht se cili nga këta të dy ushtron pushtet ndaj tjetrit, atëherë kemi gjendje përkatëse. Kur forcohet Beogradi jugosllav, edhe Kosova merr më lirshëm frymë. Kurse kur ushtron pushtet Beogradi serbomadh, atëherë Kosovës i shtrëngohet laku. Deri në vitin 1966, kur ishte ministër i brendshëm serbomadh Rankoviç, përkatësisht kur sundonte Beogradi serbomadh, Kosova përjetonte robëri të tmerrshme. Pastaj fitoi Beogradi jugosllav, që do të thotë klani më liberal serbo-kroato-sllloven, dhe Kosovës filloi t'i zbutej robëria. Madje deri aty sa në sofër të pushtetit qendror, që ne e quajmë titist, mundi të merrte hise edhe Kosova.

Që të mos vazhdoj më gjatë me gjëra të këtilla, po merrem me Rezilin. Mendoj se nuk duhet t'i vihet njëanshmërisht gjithë fajit. Edhe ai

është viktimë. Po të kishim qenë të çliruar, ai nuk do të ishte i tillë. Kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet të mbrohemi ndaj veprimeve të jashtëligjshme e kriminale të tij, gjegjësisht ndaj strukturave që e komandojnë atë. Mbaj mend se edhe Jusufi na dha këshillën kapitale që të gjykojmë urtësisht, edhe përkundër faktit se urdhëri ishte për ta vrarë pikërisht atë.

– E di çka, m'u bë tepër dhe nuk po të përcjell dot, – ndërhyri Vasili.

– Nga të gjitha që the, nuk më pëlqeu që i rendite Titon dhe Enverin.

– Ke të drejtë, – tumiri Mirani, meqë e dinte se ashtu siç e bëri renditjen, do ta hidhëronte Vasilin, i cili Enverin e njihnte për idhull e profet.

Ata u pajtuan të niseshin për rrugë. Fillimisht kishin planifikuar të ndaleshin shkurtimisht të Jusufi e Bardhi, pastaj do të vazhdonin për në Pragë.

Jusufi e Bardhi i mirëpritën si rëndom. Nuk hetuan ndonjë sjellje të veçantë të tyre.

– Do të rrimë fare shkurt, meqë jemi për rrugë, – sqaroi Mirani.

– Dalim në dhomën e punës, – tha Jusufi.

Sapo zunë vend, ai e pyeti Miranin:

– Përse nxitoheni, ku keni ndërmend të shkoni?

– Them të mbarojmë bisedën lidhur me skenarin që do ta përdorim karshi Rezilit, nëse jemi dakortuar mbrëmë plotësisht. – Tha Mirani.

– Miran, është meritë jotja e madhe që i ke dalë para këtij atentati. Ti ke ditur të fitosh besimin e Vasilit. Mua nuk më takon të ndërftuem shumë në këtë skenar. Prandaj ju mbetet juve ta mendoni dhe të veproni. Unë do të pranojë rrolin që do të ma caktoni.

– Duhet t'i përjashtojmë dramatizimet e sforcuara, – vazhdoi Mirani, – qëllimi është të hulumtojmë nëse Rezili ka përcjellë urdhër të eprorëve, siç mendoj unë, apo ia ka thënë truri i tij i sëmurë, siç ka hapësirë për të dyshuar. Secili nga variantët përmban kriminalitetin makabër. Vasili, në dukje, do të vazhdojë t'i ruajë marrëdhëniet me Rezilin, njësoj si deri tani, por duke bërëurvejim sa më serioz ndaj tij. Njëherit ai, pa rënë në

sy, herë pas here do tli kërkojë kushte që iu dashkan për të bërë atentatin, sepse kjo është mënyrë për të hetuar nëse Rezilit i qëndron dikush prapa. Kur ta kemi shterruar këtë skenar, atëherë do të vendosim se çfarë të bëjmë tutje. Besoj do të na marrë rreth dy muaj ky skenar. Kjo kohë ndihmon të dimë nëse Rezilit po e humb durimin dhe po angazhon dikë tjetër. Gjatë gjithë kohës duhet ta rrisim vigjilencën.

– Them të mos merremi me detaje, – ndërhyri Jusufi. – Gatishmërinë për bashkëpunim do ta gjeni, siç thashë më parë, vetëm nëse vepron brenda konturave njerëzore.

Për disa momente nuk foli njeri. Bardhi doli për të porositur piçe.

– Baca Jusuf, – i thirri Vasili, siç bënte zakonisht, – ne do të shkojmë deri në Pragë. Një i njohur më ka folur për një lidhje atje për furnizim me armatim. Ai do të na duhet në Kosovë. Mendova ta marrë shokun Miran me vete, sepse ky është me gojëtar dhe më i shkathët për të vlerësuar nëse ka gjë nga ky premtim.

Vasili foli qetësisht. Me gjasë kishin ndikuar këshillat e qortimet e bëra nga Mirani në mëngjes, sado që gjatë rrugëtimit të shkurtër, ishte hamendur, nëse ato këshilla ishin vërtet të profesorit apo i kishte sajuar Mirani.

– Miran, vërtet për këtë do të shkoni në Pragë!? – pyeti Jusufi i befapsuar.

– Mendoj se duhet të shkojmë, pasi duhet të fillojmë të bëjmë përvojë edhe në këtë fushë. Lufta çlirimtare për të cilën jemi angazhuar, nuk bëhet pa armë.

Mirani nuk e zgjati arsyetim, u ndal për të pritur pyetjet e tjera konkrete që, sipas mendimit të tij, duhej të vinin.

– Unë mendoj, – tha i pari, – se kjo punë është e hershme dhe meqë është e hershme, e konsideroj si aventurë. Ne ende nuk kemi afruar një grusht njerëzish, vërtet të ndërgjegjësuar për lufën e armatosur çlirimtare. Them një grush njerëzish, pasi na duhen shumë. Akoma nuk po

kemi mundësi e të holla ta nxjerrim gazetën *Bashkimi*, më shpesh e më cilësore dhe tani na u dashka të merremi edhe me gjetje të armëve, për çka nuk është koha dhe nuk i kemi mundësitë, me sa di unë.

– Them se nuk prish punë nëse do të shkojnë dhe të provojnë nëse ka mundësi për blerjen e tyre, sepse do të krijohet një përvojë që na duhet për të ardhmen, – ndërhyri Bardhi përkundër natyrës së tij.

Jusufin e befaso i ndërhyrja ndaj nuk e vazhdoi mendimin e tij. Si duket nuk i erdhi mirë. Mirani nuk la të zgjaste heshtja.

– Të gjithë kemi të drejtë të shprehim mendime. Tani nuk do të na kushtojë shumë energji e shpenzime nëse shkojmë deri në Pragë. Nga këtu nuk është edhe aq larg. Sigurisht që druaj mos po na kurdiset ndonjë kurth. Nuk përjashtohet mundësia e bashkëpunimit midis struktura policore sekrete jugo-sllave dhe çeko-sllloake. Përkundër drojës, unë them që të shkojmë. Nuk bëhet nami nëse na ndodh gjë. Prova nuk do të kenë dhe, në fund të fundit, do të na lirojnë. Nuk përjashtohet edhe mundësia tjetër që të na arrestojnë ose kidnepojnë dhe të përfundojmë në Jugosllavi, siç ka ndodhur në disa raste me të ekziluuar të tjerë politikë antijugosllavë.

– Kësaj i thonë aventurë anarkiste dhe papërgjegjësi, – reagoi me zë të sforcuar Jusufi. – Miran, kush do ta nxjerrë *Bashkimin* nëse do t'ju ndodh gjë juve?

– Mirë që e shtrove këtë pyetje. Besoj është bërë më se e vetëkuptueshme, se përkujdesja pothuajse e gjithëmbarshme për *Bashkimin* ka mbetur në duart e tua. Edhe tani je duke i bërë punët kryesore për përgatitje të tij. Sa për financim, bashkatdhetarët në Dyzeldorf e rrethinë do të grumbullojnë të hollat e nevojshme për shtypshkronjë.

– Nuk pajtohem! – tha preraz Jusufi. – Kur njeriu organizohet nuk ka të drejtë të marrë vendime kokë më vete, qoftë edhe për vetën e tij. Po ju vlerësoj për trimëri, për gatishmëri, por kjo nuk ju jep të drejtë të hidheni në aventura. Unë që tani do të mendohem nëse duhet të anga-

zhohem në të ardhmen për botimin e *Bashkimit*, nëse ju tregoheni kokëfortë për të shkuar në Pragë.

Pasi Jusufi shfaqti këto mendime, pa ekuivoke, tepër të prera, pse jo edhe kushtëzuese, doli nga dhoma duke shkaktuar heshtje e habi tek Mirani, Bardhi e Vasili. Mirani po fërkonte shtrëngueshëm duart, kërciste gishtërinjtë. Ai tani po mendonte jermoshëm nëse ishte koha për të vazhduar bisedën derisa ta bindte atë për këtë veprimtari të re, kur gjendja ishte shumë e rënduar. E gjykonte të papërshtatshme koincidencën e njëkohshme të urdhërit për atentat dhe shkuarjes në Pragë. Ndoshta Jusufi ishte përmbajtur kur u informua për urdhërin për atentat ndaj tij për të shpërthyer tani vrullshëm, kur nuk mund të fajësohej për subjektivizëm. Sa të komplikuar janë qeniet njerëzore!

Vasili e kishte mbështetur kokën mes dy duarve. Atij nuk i shihej fytyra sa të hetohej reagimi ndaj mendimit të kushtëzuar të Jusufit, ndaj qortimeve të rrepta. Bardhi po e ruante mrekullisht qetësinë.

– Mos u merakosni, tani do të kthehet, – tha më në fund ai. – Nuk e kam parë kaq të rreptë dhe kaq të nxehur. Mbase mund ta kuptojmë.

Ai doli duke e lënë derën hapur.

– Dardanë! – u dëgjua duke thirrur vajzën e Jusufit. – Ku shkoi babi?

Dardana, një vajzë 9-vjeçare, simpatike, e urtë, e dëgjueshme dhe jashtëzakonisht e zgjuar, mendonte si të ishte e rritur. Fytyra e saj gjasonte me fytyrën e të atit si një kopje besnike. Ajo kishte krijuar afërsi me Miranin, vetëm të cilit shpesh ia lexonte shënimet nga ditari i saj, gjë që nuk e bënte ndaj të tjerëve. Ia rrëfente përjetimet si ato që kishin të bënin me mallin për vendlindje e për shoqërinë në Prishtinë, për vështirësitë në mësimin e gjuhës gjermane. Kjo afri ndodhte sepse ai i donte shumë fëmijët, u përkushtohej atyre. Mendonte se ata e kishin më së vështiri për ta përballuar jetën dhe zhvillimin e tyre në emigracion, midis dy kulturave: asaj familjare në shtëpi dhe asaj gjermane, jashtë shtëpisë.

– Babi hyri në dhomë të gjumit dhe mund të jetë shtrirë në krevat.

Ai është zgjuar shumë i lodhur dhe i shqetësuar, – u përgjigj Dardana me zërin e saj të embël. Ajo e kishte kuptuar se diç e rëndë kishte ndodhur, por përmbahej për të pyetur. E dinte se do ta gjente rastin për të biseduar vetëm me Miranin.

– Shko thuaji se po e presin shokët! – e luti me urtësi Bardhi.

– Si urdhëron, xhaxhi Bardh, po shkoj! – u përgjigj, duke shfaqur ndrojtje, se mos do t'i hidhërohej Jusufi. Ata kishin afërsi më të madhe ndërmjet tyre sesa ndodh rëndom midis babait e vajzës. Ndërsa ndaj çunave, Premtimit dhe Egzimit, Jusufi mbante çuditërisht qëndrim tepër patriarkal. Për këtë madje ishte fjalosur me Miranin.

– Vasil, je dakort ta anulojmë shkuarjen kësaj radhe, sepse siç po e sheh nuk janë rrethanat e përshtatshme? – tha Mirani kur mbetën vetëm ata dy në dhomën e punës se Jusufit.

– Po, por më duhet t'i telefonoj ndërlihdhësit. Po sajoj ndonjë pengesë sa për të lënë mundësinë e hapur për një herë tjetër.

Prapë ra heshtja midis tyre. Ndërkohë hynë brenda Jusufi e Bardhi.

– Më falni, ndihesha i lodhur, kisha një shtrëngim në gjoks dhe mendova të shtrihem për pak çaste, – shpjegoi Jusufi me zë të qetë e keqardhës.

– Të kuptojmë, – po e shfajësonte Mirani, – na fal ti neve se të kemi shqetësuar. Siç kishim menduar e planifikuar, deshëm të vepronim. Tani kemi ndërruar mendje, meqë shpjegimet e tua ishin bindëse. Them se është koha të hamë drekë, pastaj Vasili do të më çojë në stacion të trenit në Shtutgart.

Të gjithë dolën në dhomë të ndenjës dhe po prisnin të shtrohej dreka. Secili mendohej ta pezullonte shqetësimin e hidhërimin. Hëngrën e bënë muhabet, pothuajse ngjashëm si herave të tjera dhe po si herave të tjerave, u ulen vetëm burrat në tavolinë. Jusufi nuk pranonte të uleshin grua ja dhe fëmijët për të ngrënë se bashku. Edhe kur nuk kishin mysafirë, ai nuk pranonte të hante në një tavolinë me gruan e fëmijët.

5.

Një javë më vonë Mirani udhëtoi sërish për në Esslingen, meqë i kishte telefonuar Vasili. Ata ishin marrë vesh të përdornin gjuhë ezopike, meqë dronin nga përgjimet e bisedave telefonike.

– Kam pasur një bisedë me Rezilin, – po e informonte Vasili Miranin pasi u takuan. E kam survejuar gjatë gjithë këtyre ditëve. Në takim i kam folur keq për Jusufin, se gjoja isha informuar nga bisedat telefonike me shokë të organizatës në Kosovë. Pastaj i kam kërkuar revole të mirë, me zhurmëshues, me arsytim se nuk ma ka sjellë një shok që më kishte premtuar. Gjithashtu i kam thënë se organizata do të duhej t'i siguronte njëqindmijë marka dhe ato të lihen te Maksi. Po u kapa gjatë kryerjes së atentatit, t'i dërgohen familjes për t'u ushqyer gjatë viteve të para të qëndrimit tim në burg, derisa të bëhen fëmijët të zotë për punë. Po nuk u kapa do t'i mbeten Grupit. Këtë ia kam thënë duke simuluar keqardhje të madhe. E kam siguruar se as Maksi dhe askush tjetër nuk di gjë, por se Maksit do t'i themi kur t'ia japim paratë për t'i mbajtur, se gjoja unë do të shkoj për një punë në Kosovë.

– Cili ishte reagimi i tij, – e pyeti Mirani, pa pritur nëse kishte ndërmend të vazhdonte Vasili.

– Ishte tepër i qetë dhe nuk më ra në sy ndonjë reagim i veçantë. Ai ka afinitet ta ruajë qetësinë si një statujë. Desha të të informoj edhe për survejimin, por më ndërpreve. Unë kam marrë pushim mjekësor që të kem kohë për këtë gjë. Bëra ca maskime të lehta, vendosa mustaqe dhe syze, përdora automobilin e dhëndërit tënd. Rezultati i survejimit: Rezili nuk ka shkuar asnjë ditë në punë. Dilte në stacion të trenit dhe rrinte atje me orë të tëra në lokalin e madh përballë peronit 13-të. Prej andej ndërronte lokalin dhe ikte ku grumbulloheshin bashkëatdhetarët. Si nuk u mërzitke! Bisedat nuk kam mundur t'i dëgjoj, pasi po t'i afrohesha, do të më hetonte, sado që e kisha edhe planin për arsytim.

Tani dëgjo me vëmendje se ç'kam parë. Thënë të drejtën jam skandalizuar. Në katin e tretë ky ai banon, në të njëjtën hyrje të banesës se tij është edhe një grua. Ajo kishte një djalë 4–5-vjeçar që i ngjante shumë Rezilit. Isha dy kate më lart, në shkallë, para derës se banesës se një bashkëvendësi. Ai shkon me punë në terren dhe aty kthehet vetëm për fundjavë. Ma ka dhënë çelësin, meqë ia kam kërkuar. I dëgjova kur dolën së bashku Rezili me atë gruan. Ata flisnin midis tyre serbisht, mbase kroatisht apo boshnjakisht, gjuhë që unë nuk i dalloj. Djalin e mbante ngrykë Rezili. Para se të dilnin përjashta shtëpisë, ndaheshin, si të mos njiheshin. Kjo ndodhi disa herë. Më është mbushur mendja se ata bashkëjetojnë në të njëjtën banesë. Banesa është e vogël, ka plan të ngjashëm me atë të bashkëvendësit.

– Ndalo se po më luan mendsh! – ndërhyri Mirani, – Mos ndoshta të është dukur nga inati që ke krijuar ndaj tij?

– Mos më hidhëro, sepse nuk e kam pasur të lehtë taurvejtoj dhe sidomos të përmbahem pa e vrarë në shkallë kur e shihja të bisedonte e të tallej me atë shkinulë.

– Atëherë qenka puna thellë. Nuk doka kallauz për të konstatuar se ai është kuadër i UDB-së. Edhe individë të tjerë, për të cilët unë kam formuar bindje se janë udbashë, i kanë gratë serbe. Ata, si nacionalistë e patriotë që reklamohen, për gratë dhe dashnorët e tyre serbe, gënjejnë se i kanë bosnjake ose kroate. Meqë qenka kështu, të shkojmë te Jusufi e Bardhi

– Po shkojmë, – miratoi Vasili.

Para se të niseshin Mirani i tha Vasilit t'i telefononte Maksit dhe t'i thoshte të vinte në Shtuttgart, më së voni deri në orën 21.00. Maksi banonte në Nürnberg, rreth dyqind kilometra larg Shtuttgartit dhe meqë nuk e kishte autostradë, i duheshin rreth tri orë rrugë për të arritur. U futën në makinë dhe morën drejtimin për Ludwigsburg.

– Vasil, sonte rreth orës 21.30 do t’i shkojmë në banesë Rezilit. Rreth orës 21.00 do t’i telefonosh dhe do ta njoftosh se do të takohemi. Arsyetimi i takimit të papritur duhet të jetë se Mirani po shkon ilegalisht në Kosovë dhe dëshiron të marrë ndonjë këshillë a porosi. I thuaj të dalë para dere fiks në orën 21.30 dhe do të shkojmë në ndonjë lokal afër shtëpisë se tij. Ne do t’i shkojmë në derë të banesës në orën 21.25 dhe do të hyjmë brenda tek ai, me shpjegimin se nuk dëshironim ta mundonim, të dilte jashtë në atë kohë. Çelësin e hyrjes kryesore e ke?

– Duhet t’i tregojmë Jusufit e Bardhit për këtë plan? – pyeti tjetri.

– Nuk është e nevojshme, mund të alarmohen.

– Po Maksi përse na u dashka?

– Sepse e kemi shok të mirë dhe meqë nuk di asgjë, do të na dalë vizita tepër origjinale.

– Përse duhet të shkojmë?

– Të shohim nëse vërtet Rezili jeton me atë gruan, për të cilën ti po dyshon që është serbe.

– Na duhet armë me vete?

– Po pate revole të vogël merre të të gjendet për çdo të papritur.

– E kam në banesë të bashkëvendësit.

6.

Ishte pasdite e vonë kur arritën te banesa e Jusufit. Ai i mirëpriti. Bardhi nuk ndodhej aty, meqë kishte shkuar për të bërë muzikë në një lokal në Shtutgart. Vasili e informoi gjerësisht Jusufin për survejimin dhe inskenimet që kishte bërë. Jusufi nuk pati nevojë të ndërhynte me ndonjë pyetje a kërkesë për sqarim më të detajuar, meqë Vasili ishte rrëfimtari i shkathët dhe tani po i binte të përsëriste ato që i kishte treguar para dy orëve Miranit.

– Paskeni bërë punë të mëdha, – tha në fund të rrëfimit. – Kisha dile-

ma, se mos atë vendim për atentat ndaj meje ia kishte thënë truri i tij pervers egoman, meqë mund të kishte hetuar se do t'i bëja konkurrencë patriotike në të njëjtin rreth të bashkatdhetarëve. Tani po del se ti, Miran, paske pasur shumë të drejtë.

Darkuan dhe u kthyen në Shtutgart me arsyetimin se kishin një punë në kuadër të skenarit.

Në Shtutgart ata u takuan me Maksin rreth orës 20.50. Ndenjën në një lokal afër banesës së Rezilit, biseduan për aktivitetet në Nürnberg dhe për aktivitete të tjera. Pikërisht në orën 21.25, sipas planit, shkuan para derës së banesës së Rezilit. U përballën me të, pasi ai ishte duke dalë në takim.

– Mirëbrëma! – iu drejtua Mirani. – Na fal, nuk deshëm të të mundonim e rrezikonim, prandaj erdhëm që të takohemi në banesën tënde. Pa prituri përgjigje, Mirani hyri në korridor të banesës së Rezilit. Rezili po i vështronte i hutuar.

– Mos rrini para dere! – iu drejtua qortueshëm Mirani atyre. – Nuk ka kuptim dhe do të biem në sy. Gjermanët që banojnë në këtë pallat mund ta informojnë policinë. Pastaj shqiptari e ka derën gjithmonë të hapur për mysafirë.

Rezili ngeli pa tekst, nuk kishte mundësi të kundërshtonte. I mbeti vetëm të shtirej, sikur po i bëhej qejfi dhe u dëshiroi mirëseardhje.

Banesa kishte korridor të ngushtë, rreth tri metra të gjatë dhe diç më shumë se një metër të gjerë. Në fund, përballë hyrjes kryesore, gjendej dera e banjës. Sapo hapej dera kryesore e banesës, në krahun e majtë, ishte dera e kuzhinës. Një kuzhinë e ngushtë dhe e gjatë si tunel. Në anën e djathtë gjendej dera e dhomës së ndenjës, e cila dukej se ishte rreth 20 metra katrorë. Në anën e majtë, përballë, dera tjetër që të çonte në dhomën përballë asaj të ndenjës. Ajo nuk kishte si të ishte banesë e

veçantë, pos derë e dhomës se gjumit. Në dhomën e ndenjës ishte një kauç treshevëndësh, i vjetruar, nga ata që nuk shtrihen. Përpara tij një tavolinë e vogël dhe dy fotele anash. Përballë shtratit të dhomës ishte vitrina, kryesisht qelqore. Sipër vitrinës disa vepra të Enver Hoxhës dhe të tjera, gjithsej rreth 20 copë. Mirani vështroi gjithandej dhomën e ndenjës, nëse po shihte orendi kuzhine. Asnjë nga ato, meqë kuzhina që pa duke hyrë ishte kuzhinë e përbashkët familjare. Mirani vështroi vëmendshëm si të ishte blerës. Ai konstatoi: Kjo ishte vetëm dhomë e ndenjës, pasi nuk pa gjëkund jorgan, çarçafë e të tjera. Dhoma e gjumit duhej të ishte përballë, por nuk e dinte nëse në atë kohë ishte aty gruaja dhe djali. Ai po mendonte se serbja dhe fëmija duhej të ishin në dhomë të gjumit, meqë takimi ishte planifikuar në lokal.

Vasili u mundua të bëjë arsyetimin për shkuarjen duke e ruajtur qetësinë dhe natyrshmërinë e tij si të mos kishte ndodhur asgjë e veçantë.

– Shoku Kryetar, Mirani më telefonoi para gjysmë ore nga bahnhofti (stacioni i trenit). Shkova dhe e mora. Më tha se dëshironte një takim të menjëhershëm, mundësisht natën, që të mos binte në sy. Ky e ka bërë shprehi të mos i paralajmërojë ardhjet, me gjasë nga frika se mund t'i vihen prita. Më ka dalë pak hujt për këtë të metë. Ne kemi filluar organizimet tona patriotike, sepse së pari kemi vrarë frikën tonë, mendoj unë. Më fal për pengesën dhe shqetësimin që mund të të kem shkaktuar, sepse të kemi kryetar dhe ke shumë angazhime.

– Vasil, them ta lëmë së pari mysafirin të flasë, – ndërhyri Rezili me një qetësi të shtirur.

– Si urdhëron, kryetar!

– Në rregull, – ndërhyri sërish Rezili, – të thashë se radhën e ka mysafiri dhe meqë është duke shkuar ilegalisht në Kosovë, siç më informove në telefon, duhet të bisedojmë për misionin e tij atje.

– Unë kam ndërmend të shkoj ilegalisht në Kosovë, – ndërhyri Mirani, – siç isha para disa muajve. S'm'u duk e arsyeshme të shkoj pa u

takuar me ju. Ndoshta keni ndonjë porosi a udhëzim, sepse letra që më keni dërguar para një jave më ka fascinuar. Jam i interesuar të diskutojmë edhe për letrën. Besoj ta keni një kopje të saj këtu, meqë e paskam harruar, edhe pse e kisha ndërmend ta merrja me vete deri këtu.

Ai letrën e kishte në çantë dhe mendonte të diskutonte rreth saj për të parë nivelin intelektual të Rezilit. Dyshonte se atë nuk e kishte shkruar ai vetë, siç kishte dyshuar edhe për traktet që i shpërndante Grupi i tyre. Vasili mendonte ndryshe. Dyshimi i Miranit bridhte ndërmjet përgatitjes intelektuale të nivelit të trakteve dhe letrës, meqë Rezili kishte ndërprerë mësimet pas vitit të dytë të shkollës së mesme të medresesë. Nisur nga vetja për të bërë këtë vlerësim: kishte mbaruar gjimnazin me diplomë të shkëlqyeshme, kishte studiuar tri vjet në Prishtinë, sado që fizikë kishte studjuar, dhe ndihej si handikapat pse nuk dinte të shkruante në nivel as të përafërt me ato që mendohej se po i shkruante Rezili.

– Nuk e kam dokumentacionin këtu, – tha Rezili, – e ruaj në një vend konspirativ, por mund të bisedojmë për aq sa e mbaj mend. Mendoj se është më me rëndësi të bisedojmë për shkuarjen tënde ilegale në Kosovë, se sa të diskutojmë për letrën, përmbajtja e së cilën nuk më kujtohet gjithaq.

– Dakord, por t’ju shkojmë gjerave me radhë, sepse ajo letër më ka shtyrë që të kthehem kënde, përkundër rrugës më të gjatë, – tha tjetri.

– Mos u shtyni për gjera formale, sepse po humbni kohë kot, – ndërhyri Maksi.

– Në letër më kishe shkruar se Fronti është organizatë kaotike, pa organizim e disiplinë të mirëfilltë revolucionare e komuniste, marksiste-leniniste, por nuk i kishe arsyetuar këto vlerësime. Pastaj kishe propozuar që Fronti të shkrihet në Grupin tuaj, meqë do të menjanoheshin të metat që kishe përmendur.

– Nuk është e vërtetë, – ndërhyri Rezili.

– Më le ta mbaroj mendimin, pastaj merre fjalën. Ju rrahni gjoks se

jeni komunistë të disiplinuar...

– Pikërisht, prandaj i gjykojmë rrebtë shpifjet.

– Më akuzon për shpifje, sado që e the se nuk të kujtohet përmbajtja e letrës, – u përgjigj me qetësi Mirani. – Nuk prish punë. Ju komunistët jeni të drejtpërdrejtë dhe prandaj ju admiroj. Meqë nuk po të kujtohet përmbajtja e letrës, nuk është me rëndësi, po diskutojmë për shkuarjen time të fshehtë në Kosovë. Unë atje kam ndër mend të shkoj për t’u informuar, se sa na janë goditur radhët. Atje kanë ndodhur bugosje të shumta. Flitet se disave u është dëshmuar anëtarësimi në Grupin tuaj. Keni mendim për këtë?

Mirani e dinte se e kishte letrën në çantë, por donte ta demaskonte “ndershmërinë” e tij. Meqë iu duk se foli mjaft për letrën, bëri sikur po ndërronte temën për të gjetur një shkak që ta hapte çantën. Njëkohësisht ai synonte të debatonte edhe për arrestimet në Kosovë, meqë kishte ca informata se gjatë hetimeve, të arrestuarëve u ishin vënë përpara si dëshmi formularë origjinal të anëtarësimit, që i kishin nënshkruar vetë kur i kishin plotësuar.

– Edhe kjo është shpifje, – u përgjigj Rezili.

– Sigurisht, unë vetëm shpifkam! – u përgjigj Mirani.

– Prova dhe jo lojë fjalësh, sepse këto janë akuza të rënda! – ndërhyri Vasili.

– Ka të drejtë Vasili, – shtoi edhe Maksi midis atij tensionimi, – duhet të ofrosh prova, Miran, përndryshe...

– Çfarë, përndryshe? Unë po diskutoj siç po mendoj, hapur. Mund të mos ia qëlloj, por meqë kryetari Rezil në letrën, përmbajtja e se cilës nuk po i kujtohet, kërkon, për të mos thënë urdhëron që Fronti të shkrihet në Grupin tuaj, atëherë unë dëshiroj të sqaroj paqartësitë para se të vendosim për bashkim ose shkrirje. Meqë dëshironi prova, unë kam me vete një formular tuajin që përdorni për të anëtarësuar bashkatdhetarë këtu dhe në Kosovë. Këta formularë Rezili po ua shpërndan bashkat-

dhetarëve në bahnhof, në hajme, në lokale. Të shoh nëse e kam me vete një ekzemplar në çantë.

Mirani nisi hallakatjen e çantës për të gjetur formularin e anëtarësimit të *Grupit Komunist Zëri i Kosovës*.

– Ja formulari, heëëm, ja edhe letra që më keni dërguar ju shoku Rezil. Unë mendoja se e kisha harruar, – tha Mirani duke i vendosur ato mbi tavolinë.

Maksi u zgjat për t'i parë. Rezili e Vasili nuk lëvizën vendit. Vasili po shtrej se ishte hidhëruar nga akuzat që i kishte bërë Mirani për arrestimet në Kosovë. Maksi u kujtua se formularë të tillë kishte dërguar vetë në Kosovë dhe disa nga ata, të plotësuar e të nënshkruar, i kishte sjellë me vete për t'ia dorëzuar kryetarit Rezil. Bile një të tillë e kishte plotësuar edhe bashkëshortja e Maksit në Kosovë dhe ajo kohëve të fundit ishte arrestuar. Atë formular, në origjinal, Maksi ia kishte dorëzuar kryetarit Rezil. Kjo e bëri Maksin të zgurdullonte sytë, meqë po priste që të zbuloheshin shkaqet e arrestimeve. Më herët kishte shfaqur vetë dyshimin, gjatë një bisede me Miranin, se në Kosovë ishin arrestuar patriotë që ishin treguar të gatshëm të anëtarësoheshin në *Grupin Komunist Zëri i Kosovës*, se ai vetë ua kishte dorëzuar formularët për anëtarësim dhe pas-taj i kishte sjellë me vete për t'ia dorëzuar Rezilit. Në fillim, kur i kishte anëtarësuar, kishte përjetuar gëzim euforik. Tani, kur ata ishin arrestuar, kishte filluar të mërzhitej dhe të dyshonte se mos e kishte ai vetë një pjesë të fajit apo dikush tjetër që mund t'ua kishte përcjellë kopjet e formularëve të plotësuar. Ky dikush mund të ishte vetëm kryetari i tij, Rezil Mejtepi. Vasili e kishte informuar se edhe disa nga ata që njihnte Mirani kishin plotësuar formularët për anëtarësim në Grupin e tyre. Tani Mirani dëshironte të sqaronte se mos arrestimet në Kosovë shkaktarin konkret e kishin këtu.

– Dini gjë, shoku Rezil, si kanë mundur t'i bien në dorë UDB-së formularët e anëtarësimit? Ju thatë se dokumentacionin e ruani në një vend

të sigurt, – pyeti Mirani.

– Këto akuza nuk mund t'i duroj, janë udbeske! – ulëriti tjetri, por me zë të përmbajtur dhe hidhërim të shpifur.

– Ç'Ëi bëjmë traditës shqiptare për respektim të mysafirit, përndryshe ti meriton të të hedhim për dritare! – thirri me zemërim të shtirur Vasili.

– Nuk kemi nevojë t'i respektojmë ato tradita, ne jemi komunistë! – ulëriti Maksi. Ai i shkonte prapa Vasilit, me të cilin njiheshin prej vitësh, por që tani nuk e dinte se Vasili po e simulonte zemërimin.

– Mbylle, Maks! Edhe pse jemi komunistë, duhet të respektojmë traditat e mira të populli! Kështu na porosit Shoku Enver, – ia ktheu Vasili.

– Mirë që tani po e shihni vetë se çfarë provokatori është Mirani, – shtoi Rezili.

– Nuk keni nevojë të eksitoheni, – tha me qetësi Mirani. – Thuhet se akuza që nuk të ngjitet, nuk ka pse të të eksitojë. Ne jemi shokë dhe mund të bisedojmë për çdo gjë me qetësi, edhe kur diskutojmë për çështje që nuk na pëlqejnë. Mendoj se është goditur Grupi juaj, por edhe Fronti ynë. Të analizojmë me qetësi se ku mund të na kenë shpëtuar gabimet që ia mundësojnë UDB-së zbulimin e anëtarëve të organizimeve tona.

Për një moment gjendja u bë e qetë. Veç Maksit gjithë të tjerët taktizonin.

– Meqë e gjeta letrën, – mori fjalën Mirani, – mendoj të mos e diskutojmë në këtë atmosferë. Pasi të kthehem nga Kosova do të diskutojmë për shkrirje të Frontit në Grupin tuaj, siç ka urdhëruar Rezili në letër. Edhe në Kosovë do të marrë miratimin për këtë shkrirje. Tani, ju shoku Rezil, po bindeni se keni shkruar ato që thashë në fillim?

– Thatë vetë, do ta diskutojmë letrën pasi të jeni kthyer nga Kosova, – u përgjigj i zënë ngusht tjetri me shpresë se edhe Mirani, kur do të arri në Kosovë, do të përfundonte në burg dhe nuk do të kishte më mundësi t'i nxirrte kaq shumë shqetësime atij.

– Dakord, por ju më akuzuat se po shpifja për përmbajtjen kur e citoja. Tani po jua lexoj ato që citova, meqë i kam nënvizuar, që të bindeni se shpifësi dhe gënjeshtari jeni ju. Njëherit do të provoj të argumentoj se ju nuk e keni shkruar këtë letër vetë. Ju nuk keni kaq kulturë e inteligjencë për të shkruar me këtë stil të rrjedhshëm, – e ngacmoi Mirani.

– Ku do të dalësh më këtë akuzë të re? Mendon se vërtet nuk e kam shkruar unë letrën?

– Po të mos e mendoja, nuk do të ta thosha në fytyrë, Shoku Rezil. Nxori fletoren nga çanta dhe ia vuri përpara.

– Urdhëro, shkruaj dy–tre fjali që do të t'i diktoj nga kjo letër! Të provojmë nëse di të shkruash pa gabime drejtshkrimore, siç është niveli i kësaj letre që më ke dërguar.

Rezilit po shikonte si i nemitur. Tani ndihej i zënë ngusht në mënyrë skandaloze. Nuk e mori. E la Miranin për disa çaste me dorë të zgjatur drejt tij

– Nuk e merr lapsin meqë nuk do të diskreditoresh në prani të nënkryetarit e sekretarit, se nuk i shkruan vetë traktet e letrat. E si t'i shkruash ti, kur pas mbarimit të vitit të dytë të medresesë, në moshë 17-vjeçare ke ndërprerë shkollimin, ke humbur për disa kohë për t'u shfaqur pastaj në Shtutgart.

– Të tani po më akuzon për udbash! – thirri Rezili.

– Jo, mos qoftë e thënë nga gojë ime. Unë fola për nivelin tënd tepër të ulët intelektual. Sigurisht që ty t'i shkruan ndonjë specialist, por që ti na e mban konspirativ. Të paktën mua që nuk jam anëtar në Grupin tuaj.

– Mjaft! Nuk i duroj më këto fyrye që më bëhen në banesën time!

– Pusho, sa nuk më ka humbur vetëpërmbajtja siç më porositi Vasili!
– thirri edhe Maksi.

– Nuk kemi nevojë të sillemi brutalisht këtu. E kemi mysafir. Do gjejmë rastin diku tjetër të merremi vesh me ty, Miran, – iu drejtua Vasili. –

Por, megjithatë, mendoj se mund të bisedoni për shkuarjen tënde në Kosovë, apo ndoshta dëshironi t'ju lëmë vetëm që të bisedoni pa praninë tonë?

– Unë jam i intersuar që këtë njeri të ma nxirrni sa më parë nga banesa, – foli preraz Rezili.

– Po shkoj, por më falni, po shkoj se pari deri në tualet, – u përgjigjetas Mirani.

– E ke në të djathtë, – murmuriti nëpër dhëmbë Rezili.

Mirani bëri sikur nuk e dëgjoi. Doli dhe hapi derën përballë, atë që ai dinte se është dera e dhomës së gjumit. Tutje erdhi një klithmë të thellë:

– Kuku mene (kuku për mua)! – ulëriti në gjuhën serbe një zë femre. Ajo kishte vëzhguar të thirrurat e Rezilit gjatë atij takimi të papritur në banesën e tyre dhe gjatë gjithë kohës e kishte përfshirë ankthi e frika se mos po i ndodhte gjë atij. Fëmija në gjumë u tremb nga klithma e së ëmës dhe lëshoi një piskamë të tillë sa që Miranit i erdhi keq. Mbylli derën menjëherë duke kërkuar falje po në gjuhën serbe dhe hapi derën e banjës e u fut brenda.

Sapo dëgjoi britmat, Rezili brofi në këmbë, por u ndal sërish kur pa se Mirani mbylli derën e dhomës së gjumit dhe u fut në banjo. Vasili pahetueshëm kishte vënë dorën në brez dhe kishte prekur armë e mbuluar nga këmisha. Ftohtësia e armës e drithëroi, por nuk ia ndërroi mendimin se duhej ta kishte të gatshme për çfarëdo të papriture. Maksi kishte mbetur i nemitur nga se nuk priste që aty përballë po flinte një serbe me një djalë. Rezili mbeti në këmbë duke u sjellë vërdall derisa të kthehej tjetri. Mirani bëri sikur kreu nevojën dhe hapi rezervorin shpëlarës të ujit sa për zhurmë. U kthye në dhomë dhe mori çantën në dorë. Bëri sikur po dilte jashtë, por në atë moment iu drejtua Rezilit me zë që tingëlonte vendosmëri e qetësi:

– Zotëri Rezil, kjo është banesë e përbashkët jotja me atë serben. Pas-

keni edhe një djalë, siç m'u nga hapja të paqëllimshme të derës se dhomës së gjumit. Tani, po të mos isha i vetëm përballë ju të treve do ta kisha bastisur banesën dhe jam i bindur se do të dilnin në dritë të gjithë dokumentët e organizatës. Mbase shumica në fotokopje, diku në dhomë të gjumit, nën përkudesje të gruas sate.

– Përrjashta! – ulëriti Rezili tashmë i tërbuar fare. Nuk të duhet gjë ty, është jetë private kjo!

– Mos ulërit se nuk ta kam frikën. Mos më bëj të të hedh nga dritarja! – ia ktheu Mirani. – Ti do të duhet të shpjegosh se përse bashkëjeton me një serbe në një banesë? Përse e ke mbajtur deri tani këtë të fshehtë ndaj këtyre, nënkryetarit e sekretarit të Grupit? Duhet t'u tregosh këtyre se në çfarë vendi të sigurt, nën përkujdesjen e një serbeje, ruake gjithë dokumentacionin e Grupit!

Mirani fliste drejtuar nga Rezili, por po vështronte herë pas here Maksin, se mos ai bënte ndonjë lëvizje. Tjetri nuk lëvizte vendit, por dukej se ishte shokuar nga shpërthimet e Rezilit, të bashkëjetesës së tij me serbe, siç e mori vesh më në fund. Mirani ishte i shkathhtë fizikisht. I kishte hyrë në kokë se duhej të ishte i tillë për të qenë më i kompletuar në vepërimtarinë që kishte zgjedhur. Kishte bindjen se do t'ia dilte në krye me Rezilin, por edhe me Maksin, meqë ai nuk i dinte rrolet e Miranit dhe të Vasilit në ato momente dramatike.

– Miran, mjaft, se e teprove! – thirri me zë paksa kërcënues Vasili. – Po të ishim në ndonjë vend tjetër, të betohem, nuk do të të kisha duruar kaq gjatë! U qofsh fal traditave!

Vasili u ngrit, por nuk po ngrihej Maksi. Mirani kishte mbetur në këmbë me çantën në dorë dhe tani kishte ndërmend të dilte nga dhoma. Rezili iu kishte afruar dritarës dhe mbante kokën me të dy duart, duke mermëritur nëpër dhëmbë, por që nuk kuptohej se ç'thoshte. Ndërkohe Maksi foli me zë të theksuar:

– Vasil, ku po do? Ndal të bisedojmë pse ky qen bashkëjetoka me

një shkinulë këtu, kurse gruaja ime dhe shokët tanë janë në burg në Kosovë për tradhtinë që na e paska bërë ky pis.

– Çohu more ahmak ta çojmë deri në stacion këtë provokator! – iu drejtua në mënyrë urdhëruese Vasili. – Ky vazhdimisht është përpjekur të fusë huti, dyshime e përçarje në Grupin tonë vetëm nga xhelozia se jemi më të fortë se organizata e tyre. Ne kemi kur i bisedojmë çështjet tona të brendshme dhe jo në prani të këtij provokatori. Nuk të intereson ty, por as mua, se çfarë jete private bën kryetari ynë. Me rëndësi është se atë e kemi të zotën, safi komunist. Nga momenti kur ta kemi lënë në stacion këtë do të shohë ky pastaj se kush jemi ne.

Vasili tashmë doli në korridor dhe po mbathte këpucët. Edhe Maksi iu vu pas. Mirani shkeli këpucët dhe i futi në këmbë, pasi shpesh e praktikonte t'i mbathte e t'i lidhte në shkallë. Dolën jashtë pa folur gjë me njëri-tjetrin dhe shkuan me automobil në një lokal buzë rrugës në drejtim të Esslingenit. Aty zunë vend dhe po analizonin ato që kishin biseduar e përjetuar.

– Maks, ç'kishe ti që në fillim i dilje në mbrojtje atij gjarpëri, – iu drejtua me zë cinik Mirani.

– E kisha kryetar... – u përgjigj tjetri.

– ...Dhe e ke, – ndërhyri me ironi Vasili.

– Ta kesh me shëndet ti, po deshe, se me sonten ai nuk është më kryetar imi dhe unë nuk jam më në këtë Grup që e drejtoka në këtë formë ky udbash, – ia preu Maksi.

– Nuk duhet të alarmohemi. Tani duhet me qetësi të mendojmë për fatin e dokumentacionit të Grupit dhe të izolimit të Rezilit, – tha Mirani.

– Rëndom, pasoja të mëdha kanë ndodhur që kur Rezili ka sajuar Grupin, për çka mbani hise të bashkëfajësisë. Faji juaj është shkaktuar nga dëshira dhe vullneti i mirë për t'u angazhuar në mënyrë të organizuar për çlirimin e Kosovës dhe nga mungesa e informatave për Rezilin. Natyrisht, gjithë kohën ka ndikuar edhe mungesa e njohurive tuaja për

mënyrën e rregullt të themelimit, organizimit dhe funksionimit të një organizate, qoftë edhe të fshehtë. Këtë e ka keqpërdorur maksimalisht Rezili. Thuhet, ç'është bërë nuk zhbëhet, por ne duhet të përqëndrohemi në riparim të të gjitha këtyre dëmeve që të mos kemi pasoja më të rënda.

– Jemi të vonuar, – u inkuadrua në bisedë Vasili, – sepse dokumentacioni origjinal i Grupit ka rënë në dorë të UDB-së dhe tani ne do të merremi vetëm me kopje.

– Atëherë duke u marrë me kopje, do të shohim se çfarë dokumentacioni ka kapur UDB-ja dhe njëherit duhet të përqëndrohemi rreth izolimit të Rezilit, – protozoi Mirani.

– Çfarë po flisni kështu, ai duhet vvarë, – foli Maksi i përndezur. – I kam dorëzuar në origjinal formularët e anëtarësimit të plotësuar e të nënshkruar në Kosovë, pa ditur se ai jeton në të njëjtën banesë me një shkinë, me të cilën paska edhe djalë. Tani ata formularë Rezili duhet të m'i kthejë në origjinal. Po nuk i pati nuk do të pyes për mendimin tuaj. Do të hakmerrem vetë, siç ma thotë mend!

– Maks, ti duhet të qetësohesh, sepse me Vasilin jemi duke hulumtuar edhe një veprim tjetër kriminal të Rezilit, – e luti Mirani.

– A mund ta di për çka është fjala? – pyeti Maksi me sy më të hapur se rëndom.

– Momentalisht nuk duhet, por do të inkuadrohesh në momentin e duhur edhe në shqyrtim të atij veprimi, – tha Mirani.

– Domëthënë Grupit tonë i erdhi një fund i keq, për të mos thënë i turpshëm.

– Nuk ka më hapësirë për dilema, – e preu Vasili dhe u drejtua nga kamarieri për të bërë pagesën.

– Po shkojmë të dhëndri i Miranit për të fjetur, sepse në barakën e tij ka krevate boshe, – tha Vasili. Gjatë ditëve në vijim nuk do të flemë në banesën time, sepse nuk ia kam besën Rezilit.

7.

Të dielen paradite, Vasili, Mirani e Maksit shkuan te Jusufi. Mirëprerja ishte më e zbehtë. Për shkak të pranisë së Maksit, vetëm Jusufi e Mirani shkuan në dhomën tjetër, biseduan për ato që kishin përjetuar mbrëmë.

– Domëthënë, kështu qenka puna me këtë farë Rezilin!? – shprehu habinë Jusufi.

– Fatkeqësisht!

– Si do të veprojmë në të ardhmën?

– Them ta përshpejtojmë dhe ta mbyllim skenarin e investigimit. Tani varet vetëm nga gjeturia e Vasilit se si dhe kur do të takohen me Rezilin. Pastaj do ta dëgjojmë Vasilin dhe do të marrim vendim. Njëherit kemi vendosur ta shpërbëjmë *Grupin Komunist Zëri i Kosovës*. Ky ka qenë propozimi i Maksit e i Vasilit, të cilët më në fund u bindet se cili është Rezili. Të shkretët, nuk e kanë të lehtë, janë duke e përjetuar tepër rënd.

– Le të mbetet të presim kur do të na telefojë Vasili që të takohemi. Tani nuk po e zgjasim më shumë se mund të keqkuptohemi nga Vasili, Maksit e Bardhi.

Në dhomë të ndenjës muhabeti dhe shakatë që rëndom ishin të zëshme, të shoqëruara me të qeshura, mungonin. Po flitej sa për të mos thënë se po heshte fare. Asnjëri nuk ishte me qejf, si herave të tjera. Jusufi, para se të ulej, mori kitarën. Mirani e vështroi, por nuk dinte nëse donte të këndonte për ta mbushur hapësirën e heshtur, apo për të ekuilibruar vetën. Kjo u pëlqeu të gjithëve, sepse ndonjëherë e lusnin të këndonte, po atij nuk i këndohej. Edhe kësaj radhe ai zgjodhi “Ikjen e Mosi Golemit”, ndërsa herave të tjera niste me këngë zbavitëse. “Edhe përzgjedhja e këngës i përgjigjet gjendjes”, – mendoi Mirani.

Gjatë kohës që po këndohej prajshëm u shtrua tryeza për të ngrënë drekë. Sapo përfundoi këngën, Jusufi mbështeti kitarën në fotelë dhe i ftoi mysafirët për drekë. Të pestët u ulën e hëngrën pa bërë bisedë e ga-

llatë si herave të tjera. Mbaruan drekën e pinë kafe. Vasili e Maksii kërkuan leje të shkonin. Mirani ndenji aty.

8.

Vasili u takua me Rezilin të nesërmën pasdite. I kishte kërkuar të falur atij për ato që kishin ndodhur mbrëmë dhe, për ta përvetësuar, i premtoi se pas Jusufit do ta kishte në radhë Miranin, gjithnjë me lejen e tij. Rezili nuk i kishte siguruar akoma armën e atentatit që ia kishte kërkuar tjetri, po as të hollat. Tashmë as Vasili nuk po ia kërkonte. Bëhej sikur nuk ishin me rëndësi sepse ngjarjet morën zhvillim skandaloz.

Një javë më vonë, të premten, Vasili i telefonoi Jusufit e Miranit për t'i informuar se të pasnesërmën, të dielën, do të dëshironte të pinte birrë me ta. Po patën kohë mund të pinin edhe kafe qysh të nesërmën, të shtunën, meqë ishte i lirë. Kështu ishin marrë vesh, që të informonte nëse do të takohej me Rezilin, që t'i ftonte ata për të pirë birrë, ndërsa nëse mendonte të takohej paraprakisht për konsultime duhej t'i ftonte për të pirë kafe.

Mirani udhëtoi të premten pasdite me tren nga Bochumi. Natën e kaloi të Jusufi. Donte të ishte afër për takimet e të nesërmes dhe të pasnesërmes. Atë mbrëmje Jusufi dhe Mirani biseduan për përgatitjen e gazetës *Bashkimi*. Kushtet i kishin shumë të vështira. Mungonte teknika minimale e nevojshme, mungonin gazetarët, mungonin financat dhe të gjitha këto duhej të kompensoheshin vetëm me punën e tyre përkushtuese dhe të lodhshme. Pastaj Jusufi pyeti:

– Ke ndonjë lidhje në Turqi se ende nuk kam vënë kontakt me Sabitin, me Sabit Katunriun, i cili në ilegalitet e ka pasur pseudonimin “Rrobaqepësi”? Ai është arratisur atje, por nuk po më paraqitet edhe pse e ka pasur numrin e telefonit zyrtar të Bardhit.

– Më ke pyetur edhe më herët. Mbase ke harruar. Kam angazhuar

ca të njohur atje, të cilët nëse e gjejnë t'i thonë se po e kërkon. Më kanë informuar se ai i është kthyer me përkushtim vetëm shërbimeve fetare dhe nuk do t'ia di më për çështje kombëtare. Më ka ardhur keq, prandaj nuk të kam informuar, – tha Mirani pa ia treguar të tëra.

– Paskë gabuar, – ia ktheu i qetë Jusufi.

– Më fal, por vërtet më erdhi keq. Ti më kishe thënë se ai është njeri i madh, udhëheqës i organizatës suaj, Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Visive të tjera Shqiptare në Jugosllavi, se ai të kishte anëtarësuar në atë organizatë.

– I tillë ka qenë dhe nuk më mbushet mendja se mund të ketë ndryshuar, – tha Jusufi me një zë që nuk tingëllonte edhe aq bindës. Dukej i dëshpëruar për faktin se edhe pas pesë muajve nuk i ishte lajmëruar dhe vetë nuk kishte numër telefoni e adresë që ta kontaktonte. Por dëshpërimin vazhdonte ta fshihte para Miranit.

– Nuk e di, porosinë ta kam përcjellë. Ndoshta do të të lajmërohet. Po deshe mund të të siguroj adresë dhe telefon të tij.

– Do të më bëje nder, meqë dëshiroj të kontaktoj drejtpërdrejt dhe të dëgjoj nga goja e tij, se cilin qëndrim mban.

– Punë fare e lehtë, – u përgjigj Mirani, duke u munduar ta marrë me mend se sa do të ndihej i zhgënjyer Jusufi. Ai po rezervohej t'ia thoshte të gjitha që kishte dëgjuar, për zhgënjimin që kishin pësuar bashkatdhetarët, që e kishin mirëpritur Sabitin në Turqi. Dikur kishin pasur respekt të madh për të. Kishte qenë shpesh atje, ishte marrë me organizime e lidhëmbajtje patriotike. Pastaj kishte rënë në burg për qepje të flamujve, që qenë ngritur guximshëm nëpër Kosovë. Mirani nuk e merrte me mend, sesi një rrobaqepës mund të bëhej udhëheqës i Jusufit, këtij intelektual poliedrik...

– Kësaj radhe nuk më ke sjellë libra, apo nuk ke më?

– Nga fusha e letërsisë nuk kam të tjera pos atyre që t'i kam sjellë. Kam kompletin e veprave të Leninit, të Stalinit, të Enverit. Po të intere-

suan të sjell nga ato. Këtu e kam edhe një listë të librave që kam, meqë më kërkojnë bashkatdhetarët dhe mbaj evidencë.

– Të atyre dy komunistëve sllavë nuk i dua, të Shokut Enver po.

– Nuk të shkon të bësh shabllonizim të këtillë, – ia ktheu Mirani i befasuar, meqë nuk e priste këtë nga Jusufi. – Po të Tolstojit, të Dostojevskit, të Gorkit dhe të shkrimtarëve të tjerë të mëdhenj sllavë, të pëlqejnë?

– Ma bërë shah–mat, – tha ai duke qeshur.

– Më ka ndodhur të dëgjoj vlerësime të tilla të disa shqiptarëve, se urrejnë Leninin e Stalinin vetëm për shkak se na qenkan sllavë, Marksini për shkak se ka qenë çifut, e kështu me radhë. Sa për informim, Stalini nuk ka qenë as rus dhe as sllav. Sado që nuk ishte rus u tregua më rusomadh se vetë rusët, sa që edhe vajzës i ka vënë emër karakteristik rus: Svetlana. Njësoj veprojnë edhe ca politikanë shqiptarë në Kosovë, si përshëmbull ai farë funksionari Sinan Hasani. Ata martohen me serbe për të përfituar besimin e serbomëdhenjve dhe fëmijëve u vënë emra karakteristik serbë. Kam dëgjuar të thuhet se po të kishte qenë çifuti Marks i mirë do ta mbanin gjermanët për vete. Naivët, nuk dinë se gjermanët nuk e mbajnë dhe as nuk e hedhin për shkak të përjardhjes se tij, por për shkak të pikëpamjeve ideologjike. Bile, që ta dish, edhe pse gjermanët e Perëndimit nuk i akceptojnë pikëpamjet e Marksit, Bundestagu gjerman, siç i thonë këtu parlamentit, ndanë nga buxheti i vet dyzetëmi-jë marka në vit, vetëm për mirëmbajtje të varrit të Marksit në Londër. Kësaj i thonë kulturë. Respektojnë personalitetët e tyre historike edhe kur nuk ua pëlqejnë mendimet. Prandaj, mendoj, as Enveri nuk duhet admiruar vetëm pse është shqiptar. . .

– Për Shokun Enver mos më fol keq, sepse e kam idhull! Edhe he-rave të tjera të kam dëgjuar se bënë ca ironira të tërthorta për Shokun Enver, por, që të mbetemi shokë duhet të përmbahesh, të mos e kritikosh dhe aq më pak ta ironizosh Shokun Enver!

Mirani nuk iu përgjigj sepse e kishte vërejtur që Jusufi e adhuronte Enverin dhe idhulli tjetrit nuk i ironizohet, nëse dëshiron të mos ia cenosh ndjenjat. Idhulli është si profeti për besimtarët.

– Meqë përmendëm Stalinin, po të informoj se kam dëgjuar nga albanologu Lazar D., me origjinë kroate nga Janjeva e Prishtinës, tani me shtetësi gjermane dhe i anëtarësuar në Partinë Socialdemokrate Gjermane, të thotë se Stalini e ka shpërtuar Republikën e Shqipërisë nga pushtimi jugosllav. Nëse kjo është e vërtetë, nuk është argument që ne shqiptarët duhet t'ia lëxojmë librat e tij vetëm për këtë meritë. E kishim fjalën për libra dhe ato janë të pëlqyeshme ose jo për t'u lexuar, kanë ose nuk kanë vlerë...

– Nuk më paske kuptuar, – reagoi Jusufi pa pritur nëse Mirani do të vazhdonte të fliste, – kur të thashë se më zure shah–mat.

– Edhe mundet, por gjithësesi nuk të kam keqkuptuar.

– Atëherë po të sqaroj, unë nuk i dua komunistët, për të mos thënë jam kundërkomunist, por Shokun Enver e idhulloj, siç po shprehesh ti, për shkak se është udhëheqës i shtetit tonë amë. Për të mos e zgjatur, meqë po kalojmë në debat, po të mundësh më sill të gjithë librat që nuk m'i ke sjellë gjer tani. Duke i shfletuar do të shoh nëse do të më pëlqejnë t'i lexoj. Mjafton të jenë në shqip ose në gjuhët që i kuptoj unë.

Mirani e kuptoi se edhe kjo temë u konsumua. U ndal të mendonte se çfarë duhej të fliste dhe nëse duhej të fliste! Jusufi nuk u mendua gjatë.

– Si ju shkojnë punët me anëtarësim në Front, i keni zgjeruar ndopak radhët?

– Më duket se na ka rënë të bisedojmë më herët, apo ndoshta vetëm kam menduar. Fronti nuk praktikon anëtarësim klasik. Edhe pse kemi Program e Statut, të cilat ndërkohë ti i ke korrigjuar. Statutit nuk i përmbahemi sepse nuk na eci me anëtarësim. Po frikësohen bashkatdhetarët për t'u anëtarësuar. Tashmë e ke kuptuar edhe nga veprimtaria praktike, se do kohë që të ngriten e të ndërgjegjësohen për t'u bërë të gatshëm

për anëtarësim. Derisa ata e lexojnë me vështirësi statutin dhe nuk mund ta kuptojnë, atëherë nuk mund të funksionojë anëtarësimi i tyre. Jemi përcaktuar për mënyrën popullore të organizimit e të veprimtarisë, nëse mund të thuhet kështu.

Mirani ishte në dijeni se Proletari, Xhahili, Qerozi dhe ndonjë tjetër po e dezinformonin Jusufin dhe po habitej se përse ai nuk po merrej me sqarimin e atyre dezinformimeve duke e pyetur konkretisht Miranin. Vetë nuk e gjykonte të arsyeshme të sqarohet që tani me Jusufin për ato që ata i thoshin ose që mund t'i thoshin. Ai e kishte të qartë se UDB-ja nuk do të merrej vetëm me atentate, por së pari do të përpiqej t'i hutonte e përçante ata midis tyre duke përhapur thashetheme, dezinformata, shpifje. Jusufi ende nuk kishte informata të mjaftueshme sesi bëhet lufta speciale e shërbimeve sekrete dhe nuk kishte bërë as përvojë praktike sesi duhet mbrojtur nga ato.

– Po atëherë, si mund të funksionojë organizata pa anëtarësim, pa struktura drejtuese? – pyeti Jusufi.

– Veprimtaria jonë nuk i përgjigjet veprimtarisë së organizatës. Më shumë i shkon një lëvizjeje patriotike të mërgimtarëve.

– E kam vërejtur kur u kemi bërë vizita mërgimtarëve në Shtutgart me rrethinë. Më duket më shumë na duhet të merremi me shpjegime e propagandë gojore sesa me shkrime e gazeta. Shumica mezi lexonin. Do ta kemi të vështirë të gjejmë një formë të përshtatshme të organizimit, kur vetëm disa po guxojnë të takohen me ne publikisht. Tani më intereson të di, nëse më lejohet, se a të ka dhënë emigracioni reaksionar kroat të holla për të blerë armë. Kështu kam dëgjuar të përflitet dhe insistimi yt e i Vasilit që të shkonit në Pragë më shtyrë t'ju besoj pakëz këtyre përvojimeve.

Mirani u gëzua që Jusufi e hapi këtë tematikë i pari.

– Mendoj se ne duhet të flasim hapur, – nisi Mirani duke marrë

frymë thellë, – po të mos përdorim “kam dëgjuar të përflitet”, por t’ua themi emrin dezinformuesve e diversantëve. Unë nuk të kam mbajtur gjë të fshehur, pos atyre që kam gjykuar se nuk të hyjnë fare në punë. Sa herë më ke pyetur të jam përgjigjur. Asnjëherë nuk të kam thënë se këshu ose ashtu përflitet për ty, por i kam konkretizuar me emër e mbiemër përfolësit, shpifësit e dezinformuesit. Vërtet jam më i ri dhe nuk e kam nivelin tënd intelektual, por, meqë më ke pranuar për bashkëveprimtar, nuk ke të drejtë të sillesh joshoqërisht ndaj meje në këtë drejtim.

Sa për të hollat e kroatëve, për të cilat po përflasin Xhahili, Proletari, Qerozi, e ndonjë tjetër, nuk të kam treguar se më ka ardhur keq. Bile disa po shpifin, sikur unë me ato të holla kam ndërtuar vilë me pishinë në Kosovë. Në të vërtetë, unë pata përjetuar një fatkeqësi dhe vazhdoj ta vuaj, jo pse e si përflitet, por pse më ndodhi fatkeqësia që më ka turpëruar. Fjala është për pesëdhjetë mijë marka. Një mashtrues me emrin Hysen Muhaxheri nga rrethi i Ferizajit kërkoi ndihmë. Ka qenë në punë si inxhinier në Termoelektrocentrale të Obiliqit. E kanë dërguar këtu për specializim në makinë të rëndë. Pas specializimit nuk u kthye, sepse donte të doktoronte. E punësuan gjermanët si asistent në fakultetin teknik në Duisburg Ai, i shkreti, në ndërkohë filloi të merret me bixhoz, me ëndërralla se do të bëhet i pasur. Huazon të holla nga shumë bashkatdhetarë të njohur të tij, me mashtrimin se i duhen për të mbrojtur doktoratën. Dajat e tij që jetojnë në Dyzeldorf, e që ti i njeh, Hajzeri me të vëllanë, donin ta ndihmonin përtej mundësive të tyre, pa ditur se Hyseni ishte bërë bixhozxhi. M’u drejtuan edhe mua për ndihmë. E dinin se unë nuk kisha mjaft as për bukë e libra, por e dinin se njihja shumë kroatë të pasur. Besova dhe desha ta ndihmoja që Kosovës t’i kthehet një kuadër i zotë. Shkova te një kroat në Essen. Ishte vëllai i mi-kut tim Vinko K. I tregova se një bashkatdhetari i duhen për eksprime-nte shkencore për doktoranturë të holla për t’i paguar si garanci. Nëse

nuk do të dëmtoheshin makinat, ku do të bëhej eksperimenti, ato do t'i ktheheshin. Kështu më kishte dezinformuar Hyseni kur m'u lut ta ndihmoja në prani të dajave të tij. Kroati u mjaftua me kaq sqarime. Tha të shkonim pas një ore që t'i merrnim pesëdhjetë mijë markat. Ai shtoi, se po ia mbajtën gjermanët për kaucion, Hyseni nuk kishte nevojë t'i kthehte asnjëherë, meqë dëshironte ta ndihmonte Kosovën me doktorin që do t'i kthehej. Ky farë Hyseni mori të hollat dhe na humbi. Më vonë mora vesh se këto dhe rreth treqindmijë të tjera që i kishte huazuar të kolegët e tij gjermanë, me mashtrime tjetërfare, i kishte humbur në bixhoz. Jam ndier shumë keq karshi mikut kroat. E kam sqaruar siç ka qenë e vërteta dhe më ka thënë të mos ngushtohem, meqë kishim përjetuar mashtrim e fatkeqësi të përbashkët.

Kjo është historia konkrete e të hollave për të cilat përflitet e shpifet.

Tani, nëse ke durim të më dëgjosh, kam edhe disa sqarime të tjera.

– Vetëm urdhëro, por më vjen keq nëse ndihesh i detyruar për t'u mbrojtur, pasi unë dëshirova të sqarohem dhe jo të të sulmoj, – u përgjigj Jusufi me keqardhje.

– E para, unë sugjeroj që të mos e përdorësh shprehjen reaksioni kroat, sepse është prodhim titist. Reaksion nuk mund t'i thuhet organizimit për t'u çliruar nga robëria. Ai është emigracion patriotik me rrymim e gupime politike nga e djathta dhe e majta. Nuk di të ketë në radhët e këtij emigracioni të djathtë dhe as të majtë ekstremë. Është emigracion për admirim dhe jo si yni për faqe të zezë. Kam pasur fat të njoh shumë kroatë. Më kanë ndihmuar për regjistrim në universitet, në strehim. Personalisht njoh Kushanin, Markusin, Bilanxhiqin, Knezoviqin, Shtambukun, albanologun e shquar Lazar D. dhe shumë të tjerë. Madje edhe të atillë që ndiqen si atentatorë ndaj përfaqësive diplomatike jugosllave. Kam strehuar të ashtuquajtur terroristë kroatë nga se i kërkonte Beogradi për ekstradim, kam marrë pjesë në shumë aktivitete të tyre. Jam bindur se edhe ata, pothuajse sa ne, kanë të drejtë të luftojnë kundër

pushtuesve serbë dhe titistëve jugosllavë.

E dyta, nëse ata do të më jepnin të holla pa kushtëzime, si ndihmë për të luftuar pushtuesin e përbashkët, unë do t'i pranoja pa pyetur pseudokomunistët e udbashët, siç janë Proletari, Xhahili, Rezili, Qerosi e ndonjë tjetër. Nëse nuk të mbetet hatëri për këtë nuk do të të pyes as ty, po pata këtë mendje kur të më ofrohet një shans i tillë.

E treta, përgojimet nga të apostrofuarit janë shumë të ngjashme me shpifjet e Rezilit për ty. Në rastin tim tani ata nuk janë aq brutal sa në rastin tënd, sepse nuk jam intelektual i nivelit tënd. Për Xhahilin e Qerosin mendoj se janë si Rezili, por aktualisht me rrole të tjera. Proletari, që mban publikisht pseudonimin e Enver Hoxhës, Shpati, është një demagog maniak. Ti mund të dëgjosh shpifjet që përhapin ata, por nuk të ka hije që të ndikohesh nga ato. Ne do të duhej t'i diskutonim shpifjet e tyre menjëherë dhe të gjenim metodat praktike, sesi t'i përballojmë ato dhe si t'i izolojmë ata. Besoj nuk të mbetet hatëri që fola pak me emociione.

Mirani sa nuk e kishte humbur durimin, duke pritur rastin që t'i diskutonte këto gjëra me Jusufin. Në fytyrë i shkëlqente një djersitje e lehtë. Jusufi nuk foli menjëherë. Po mendohej. Dukej i befasuar nga ky shpërthim i tjetrit. Ndërkohë kishte filluar të mbante shënime.

– Këto që i ngritem do t'i bisedojmë herë pas here, në të ardhmën, pa i lënë të grumbullohen, ngase edhe mund të na iritojnë. Tani më intereson të di përse e zezove emigracionin tonë dhe e lavdërove atë kroat?

– Sepse i tillë është. Dhe që ta dish, unë nuk stepem t'i kritikoj, për të mos thënë edhe t'i shajë, të metat e kombit tim. Të tjerët le t'i kritikojnë e le t'i shajnë të metat e kombeve të tyre. Nëse e vështrojmë nga prizmi i angazhimit çlirimtar, emigracioni ynë vërtet është për faqe të zezë. Emigracioni ekonomik është bërë i madh numerikisht, por atij nuk i intereson veprimtaria patriotike dhe aq më pak veprimtaria çlirimtare.

Ata janë dhënë pas ngritjeve të shtëpive të mëdha në Kosovë, pas blerjes së tokave. Sikur janë në garë midis tyre. Për këto unë nuk i fajësoj. Atë nivel të vetëdijes se ulët sociale e kombëtare kanë. Po t'ua analizosh prejardhjen, sheh se janë individët më të varfër në Kosovë, gjysmanalfabetë e analfabetë. Vetëm në këtu, deri në fund të 1974-tës, kur Gjermania ndërpreu importin e gastarbajterëve, kanë ardhur mbi shtatëdhjetë mijë punëtorë shqiptarë, siç e tha një ditë shifrën një propagandues i BANKKOS-it. Me atë u fjalosa në një takim, në prani të bashkatdhetarëve. Ai po propagandonte që edhe ato pak kursime që kanë kurbetçarët, t'i deponojnë në atë bankë. Unë u mundova të sqaroj kurbetçarët se devizat e kursyera edhe në BANKKOS përfundojnë në Beograd dhe se mund që një ditë t'i humbin fare. Ata nuk dëshironin të më kuptonin, sepse i joshite vetëm kamata e lartë që ua premtonte mashtruesi. Megjithatë, këta kurbetçarë të mjerë, janë të mirë shpirtërisht. Punojnë e kursejnë shumë për të mbajtur familjet në Kosovë. Vetëm t'i shohësh se sa mjerueshëm hanë e vishen, që të mund të kursejnë edhe nga kafshata, siç thuhet. Ndhimojnë materialisht shkollimin e fëmijëve, vëllezërve e motrave, nipave e mbesave. Kjo është, si të thuash, një ego biologjike pozitive për të ndihmuar të vetët. Më larg nuk shkojnë. Për ilustrim konkret po të them se sado që jam student i varfër, nuk u shkon ndonjëherë ndërmend të më ndihmojnë. Më ndihmojnë vetëm vëllai e kunata, por ata i kanë mundësitë e vogla sepse kanë shumë fëmijë. Më ndodh të udhëtoj me tren nga Bochumi në Dyzeldorf, një distancë prej rreth shtatëdhjetë kilometrash, pa pasur të holla për biletë. Kur vjen konduktori, unë fshihem në wc derisa të kalojë. Akoma më keq. Më ndodh të shkoj i uritur dhe të pres në Klub mos ndoshta ndonjëri do të blejë diç për të ngrënë aty dhe unë t'i ulëm gjoja rastësisht në tavolinë. Po të jap shans të më keqkuptosh sikur unë po nxiros emigacionin nisur nga mllefi subjektiv. Kjo nuk qëndron. Unë jam shumë i gëzuar që ata kanë pasur guximin të më lënë të hyj në Klub, meqë konsullata jugo-

sllave i ka kërcënuar ata për t'i detyruar ta ma ndalojnë frekuentimin. Në klubet e tjerë të emigrantëve tanë, që quhen klube jugosllave, nuk më lënë të hyj, ngase frikësohen. Për këtë guxim të tyre vitin që shkoi, kur shkuan për pushim në Kosovë, organet përkatëse atje kanë arrestuar Kryetarin dhe Sekretarin dhe disa nëtarë të Klubit, pikërisht për guximin të tyre për të bashkorganizuar klub vërtet shqiptar.

Mirani hetoi që Jusufit po i mbusheshin sytë lot, ndoshta nga zëri ngashërues i tij derisa rrëfente më emocione të papërmbajtura.

– Më fal, po vazhdoj!

Priti reagimin e Jusufit, por ai miratoi vetëm me një lëvizje koke.

– Nuk e quaj për turp edhe nëse derdhim lot për këtë gjendje. Nuk zhburrërohem. Është e natyrshme dhe e shëndetshme të përlothen ndonjëherë edhe burrat. Harrova ku e ndërpreva? – u hutua Mirani. – A po, nuk do ta zgjas më përshkrime dhe përjetime, por kisha ndërmend të flisja edhe për një shqetësim konkret. Kam dëgjuar fajësime në Klub, se gjoja unë jam fajtor për arrestimin e Kryetarit, Sekretarit dhe anëtarëve të tjerë, se do duhej të mos shkoja më aty, meqë do i rrezikoj edhe të tjerët. Ndërgjegja më ka sugjeruar të mos tërhiqem para të tilla sakrificave. Arsyetimi i ndërgjegjës sime ishte se, meqë unë nuk po e ndërprisja angazhimin çlirimtar, edhe kur UDB-ja, duke dashur të më shantazhojë, torturonte barbarisht nënën dhe vëllezërit në Kosovë dhe ua thoshte atyre shkoqur arsyen e torturimit. Pra, siç e dimë, veprimtaria çlirimtare ka koston e saj, ka sakrificën brenda dhe ne këtë e kemi ditur që kur jemi përcaktuar për të. Harrova të them se akoma më keq e ka pësuar edhe Arkatari, një malësor i mrekullueshëm nga Malësia e Tetovës. Jam i vetëdijshëm se do ta pësojnë edhe shumë të tjerë, meqë organet jugosllave janë koncentruar ta shpërbëjnë këtë Klub. Me bashkëveprimtarë atje kemi diskutuar dhe kemi vendosur që të mos dorëzohemi, të rezistojmë duke i shtuar aktivitetet kulturore. Edhe ti je befasuar dhe kënaqur sa herë e ke vizituar këtë Klub të mrekullueshëm.

Sigurisht e mban mend. U ke folur bashkatdhetarëve gjatë vizitave në Klub, se presioni i përqëndruar i organeve jugosllave ndaj këtij Klubi do të zvogëlohet duke hapur edhe shumë klube si ky në qytete të tjera. Megjithatë, ende nuk po ia dalim të hapim të tjera klube, siç dëshirojmë. Jemi në fazë të mirë të themelojmë të këtilla klube në Bruksel e Bielefeld. Po përpiqemi ta çlirojmë Klubin jugosllav “Rilindja” në Mynhen.

Po vazhdoj me argumente të tjera. Po e ilustruj këtë me një ndodhi simbolike. Në shtëpi të malësorit nga Tetova, e njeh edhe ti Saimir Përcën, po palosnim *Bashkëimin*, për të kursyer që të mos e paguanim shtypshkronjën për këtë. Ishte babai dhe bashkëshortja e Saimirit. Ajo sapo kishte ardhur nga vendlindja. Ishin edhe gjashtë bashkëveprimtarë të tjerë. Në një çast të papritur, bashkëshortja e Saimirit vuri mbi tavolinë bizhuteritë e saj duke thënë: “Urdhëroni, shfrytëzoni këto për të financuar daljen sa më të shpeshtë të gazetës. Duhet t’ju vijë keq që nuk po e ndihmoni financiarisht. Mirani po detyrohet të jap të hollat e veta që po i fiton duke shpërndarë natën pamflete e reklama...”

Babai i Saimirit, vjehri i saj, i bërtiti: “Nuse, të ka lënë mendja, si po na turpëron kështu!”

Ajo ia ktheu: “Jo baba, por këto m’i keni blerë mua, janë të miat dhe unë po vendos t’i jap për botim të gazetës. Po më vret ndërgjegjja t’i mbaj për vete, sidomos kur po shoh se ju nuk po e kuptoni që duhet të ndihmoni më shumë se sa ndihmat simbolike. Ju dëgjova kur u paraqit raporti i ndihmave që kishit grumbulluar. Më erdhi keq...” “Pusho më!” – e pat ndërprerë vjehri.

Pllakosi heshtja dhe çfarë heshtje se! I befasoi shpërthimi i papritur i asaj malësoreje, deri atëherë tepër e heshtur, e cila po na shërbente pa pra me çaj, si të ishte kameriere. Me këtë ndërgjegjësim të ulët patriotik që kanë tani do të na duhet kohë dhe angazhim i madh që t’i ndërgjegjësojmë politikisht. Tani për tani merakun kryesor e kanë, si ta ruajnë këtë status prej emigrantëve ekonomikë, sepse pushteti jugosllav ua ka futur

lepurin në bark. Nuk mund të angazhohen se duan t'i ruajnë pasaportat e kuqe jugo-sllave.

Emigracioni politik shqiptar është edhe më për faqe të zezë. Për bandën rreth të vetëquajturit Emil Kastrioti, të kam informuar. Emigracion tjetër politik është ai që përbëhet nga të arratisurit nga Republika e Shqipërisë. Ata janë të përqëndruar në Bruksel dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga njohuritë që kam për ta, të mbledhura gjatë këtyre katër viteve që gjendem këtej, ata janë të organizuar në disa grupime të vogla e qesharake. Kryesisht merren me propagandë kundër pushtetit të Republikës të Shqipërisë dhe me sharje të njëri-tjetrit. Ata as formalisht nuk flasin për çlirimin e trojeve tona të pushtuara. Shumica e udhëheqësëve të këtyre organizimeve pseudonacionaliste dhe pseudopatriotike kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në shërbim të Beogradit. Ta zëmë drejtuesi e Partisë Legaliteti, (C)Nderim Kupi, shumë vite ka jetuar në hotel "Sllavija" në Beograd, hotel ky e rezervuar vetëm për bosët e kuq dhe delegacionet e huaja, për kontributin që i kishte bërë Beogradit. Në Bruksel, ta zëmë, ke nga ata që publikisht koketojnë e bashkëpunojnë me përfaqësitë diplomatike jugosllave. Emigracion politik të të arratisurve politikë nga Kosova pothuajse nuk kemi. Tani ne kemi filluar të bëjmë diç, por po e sheh se ç'po heqim. Qindra veta janë ndërgjegësuar, por nuk kanë fuqi mendore e financiare që të bëjnë diç me rëndësi. Emigracioni politik kroat po i nxjerrë disa gazeta e revista të nivelit shumë cilësor.

Enver Hadri, të cilin ti e njihje personalisht nga koha e shkollimit në gjimnaz të Pejës, në Bruksel është në krye të një organizimi mjeran që nuk i ka as dy-tre veta afër vetës. Ti vetë nuk pranove ta kontaktoje kur ta solla numrin e telefonit dhe adresën e tij. Kjo ndodhi me gjasë për shkak se u skandalizove kur e pe pamfletin që nxjerr ai.

Tani UDB-ja duket se ka parashikuar, ta thëm pa modesti, për shkak të angazhimt tonë, se emigracioni ynë shpejt mund të ndërgjegësohet.

Prandaj po ndërmer masa preventive duke organizuar rrjet të dendur të udbashëve dhe informatorëve të tyre. Shumë nga këta janë të kamufluar si mësues, si diplomatë, si gazetarë dhe si kategoria e Rezilit, Xhahilit, Nuriut, gjegjësisht Qerosit.

Sa për ilustrim po sjell shëmbullin e korrespondentit të gazetës “Rilindja”. Ky farë korrespondenti qe më brutal se ata të përfaqësisë diplomatike gjatë konfrontimeve që ka pasur ky Klub me përfaqësuesit jugosllavë. Konkretisht, ai këmbëngulte që në emërtim të Klubit të mos përmendej cilësimi punëtorë “shqiptarë”, por “jugosllavë”. Kërkonte që Klubi atje të quhej “Klub i punëtorëve jugosllavë”, siç po quhet Klubi “Rilindja” në Mynhen, “Përparimi” në Bruksel dhe ndonjë klub i ngjashëm. Në këtë Klub në Dyzeldorf, ku e skëterroste ky farë korrespondenti, tani mblidhen qindra bashkatdhetarë. Lexojnë bashkërisht gazetatat dhe libra, diskutojnë për gjendjen e tyre dhe gjendjen në Kosovë, bejnë aktivitete kulturore, mbrëmje latrare. Ndihejnë simbolikisht shtypjen e *Bashkimit*, etj. Po e stërpërsëris, me shpresë se nuk po ta keqpërdor durimin, se me këtë përvojë po mundohemi të organizojmë bashkatdhetarët në metropole të tjera, në Bruksel, Zürich, Gjenevë, Mynich, Hamurg, Kopenhagen e gjetiu. Nuk e përmenda Shtutgartin se tani ti je më i informuar. Kam frikë se mos aty imponohet si udhëheqës Qerosi dhe ne nuk do të kemi sukses.

Mirani pushoi. Dukej se ishte lodhur, jo pse kishte folur, meqë këtë lloj llafazanërie ndërkohë e kishte ushtruar, por sepse kishte folur i ngarkuar me emocione, por edhe me hidhërime për dizionformatat e shpifjet që po bënin tre–katër veta ndaj tij, që ta hutonin Jusufin.

Pas një pauze të vogël Jusufi theu heshtjen:

– Të kam admiruar dhe të admiroj, sidomos për faktin që je i hapur karshi meje dhe flet pa vetëcensurë. Në dukje i rreptë, por pikërisht kështu të dua unë. Ke të drejtë, kam hezituat t’i diskutoj menjëherë përfoljet që i kam dëgjuar, pikërisht nga individët që përmende. Përmba-

hesha sepse më dukej se ca nga këto sikur të shkonin. Kisha përshtypjen se ti nuk je revolucionar, i dicitinuar në nivelin që unë e dëshiroja.

Meqë po bisedojmë hapur, të ka rastisur të thuash ndokund se unë po i përvetësoj simpatizantët e Frontit në rrethin e Shtutgartit për t'i anëtarësuar ata në Organizatën që i përkas unë?

– Vetë ky dyshim që po shfaq, – filloi të përgjigjet Mirani paksa shpërthyeshem, – tregon se krimbat që po veprojnë për të turbulluar marrëdhëniet tona kanë gjetur njeriun e papërvojë në luftën mbrojtëse kundër luftës speciale të UDB-së. Kjo ka bërë që ti të harrosh se unë kam propozuar që ti, bashkë me Vasilin, duhet të merreni me bashkatdhetarët e kësaj ane. Sigurisht edhe me ata që janë simpatizantë të Frontit, që të mos kemi nevojë të harxhojmë kohë, energji dhe financa duke ardhur veprimtarë prej rrethinës së Dyzeldorfit deri në këto anë...

– Nuk ke nevojë ta zgjasësh, u sqarova. Atëherë po pushojmë pak dhe nëse na duket e arsyeshme, e vazhdojmë këtë diskutim tepër interesant. Them që për mënyrën më të përshtatshme të organizimit të kurbetçarëve do të duhej të organizonim diskutime më të shpeshta dhe në rreth më të gjerë, me pjesëmarrës të parapërgatitur me analiza e ide konkrete. Tani, para se të dalim për pushim në dhomë të ndenjës, kam nevojë të më thuash diç akoma më të drejtpërdrejtë që ke menduar ta thuash, por je vetëpërmbytur, siç thua ti...

Mirani nuk i dha kohë tjetrit ta bëjë pyetjen, meqë iu shfaq një dëshirë të shprehej për ndrojtjen, vetëpërmbytjen.

– Rëndom, siç mund ta kesh vënë re, unë nuk ndruhem të flas për ato që mendoj e ndiej. Unë vetëpërmbahem t'i them të gjitha përnjëherësh. Gjërat nuk thuhën vetëm sa për t'i thënë, por thuhën për të arritur qëllimin. Nëse i thua të gjitha pa metodikë e takt, papërshtatshëm në hapësirë e kohë, mund të arrish të kundërtën e asaj që synon. Duhet vlerësuar gjendjen e disponimin e atij që dëshiron t'i flasësh. Sa për ilustrim konkret, meqë nuk po i gjej shprehjet dhe mënyrën për t'i shpjeguar

këto që po mundohem t'i shpjegoj, po sjell vetëpërmbajtjen time për të t'i thënë të gjitha për Sabitin, alias Rrobaqepësin. Të folta shumë shkurt për të. U frikësova se do të të hidhëroja po t'i thosha të gjitha njëherësh. Që të mos e zgjas deri në monotoni e bezdi, po shtoj konkretisht edhe ca shpjegime për udhëheqësin tënd. Për të bashkatdhetarët në Stamboll më kanë folur shumë keq. Më kanë folur ata që nuk merren me thashetheme, me përfolje. Janë emigrantë pothuajse të natyralizuar në Turqi dhe do t'ua thosha emrat sikur ti t'i njihje. Ata ishin zhgënjyer dëshpërueshëm. Ndërkaq ti më ke folur për të si për një idhull. Sa keq më erdhi kur i dëgjova gjithë ato gjëra. Pata menduar se si mundet që një intelektual i kalibrit tënd, të udhëhiqet nga një diletant, me paraqitje skizofrenike. Akoma më keq do të më vinte po qe se ti do të prisje edhe më gjatë që ai të të lajmërohet për të të udhëhequr. Parandiej se do të zhgënjehesh një ditë, siç janë zhgënjyer bashkatdhetarët tanë në Turqi. Për këto zhgënjime të tyre më konkretisht do të flasim ca bashëveprimtarë tanë të mrekullueshëm në Bruksel, të cilët vijnë nga Turqia. Ata do të kesh rastin t'i takosh së shpejti. Nga ato që më ke treguar se të ka anëtarësuar Rrobaqepësi dhe se ai të ka bindur se Lëvizja është organizatë e madhe, për këtë të dytën nuk më është mbushur mendja. Për këtë organizatë ende nuk dihet gjë në Kosovë dhe nuk mendoj se është themeluar për ta mbajtur konspirativ emrin dhe veprimtarinë, por për të bërë punën që do të duhej të ndihej nga të tjerët. Nuk besoj se një organizatë e madhe duhet dhe mund ta fsheh emrin e saj. Po t'i them këto, meqë në emër të ilegalitetit dhe konspiracionit disa kretenë mund të bëjnë shumë shpërdorime. Ja, a nuk e kemi shëmbull konkret *Grupin Komunist Zëri i Kosovës* dhe sidomos kryetarin e tij, Rezilin, i cili në emër të konspiracionit, të centralizmit demokratik, i dha urdhër të kobshëm Vasilit.

– Unë mbajta ca shënime sepse ke ngritur tema interesante për të diskutuar në të ardhmen. Jo të gjitha mendimet më pëlqyen, por mirë

bëre që i shprehe. Po e përserisë edhe një herë: Mendoj se do të na duhet të organizojmë takime për të trajtuar tema të llojllojshme. Ne akoma nuk e ditkemi se cila formë e organizimit është më e përshtatshme, sado që angazhohemi shumë për të ndërgjegjësuar bashkatdhetarët dhe për t'i afruar ata.

Të dy dolën në dhomë të ndenjës me një lehtësim të këndshëm. Askush deri atëherë nuk i kishte penguar, as edhe duke hapur derën e dhomës se punës për të pyetur nëse kishin nevojë për të pirë gjë, siç bënte ndonjëherë bashkëshortja e Jusufit.

9.

Sot (e shtunë), Jusufi, Bardhi e Mirani u takuan me Vasilin në një lokal në periferi të Shtutgartit, buzë rrugës që vinte nga Ludwigsburgu. Vasili i informoi se të nesërmen, në orën 16.00, Rezili e kishte urdhëruar ta priste në banesë. Vasili ishte i mendimit që skenari ndaj Rezilit duhej të përfundonte nesër. Më nuk kishin çfarë të hulumtonin. Tashmë mendimet e secilit anonin nga vlerësimi se Rezili është udbash dhe jo se vepron siç ia thotë mendja e tij.

– Edhe unë jam i një mendjeje me Vasilin. Nuk kemi pse ta hetojmë tutje. Nesër duhet të marrim qëndrim, – tha Mirani.

– Unë, – tha qetas Jusufi, – nuk do të jap mendim, sepse mund të më keqkuptohet si subjektive. Në këtë ngjarje jam viktimë. Por, gjithsesi ju duhet të gjykoni me urtësi.

Jusufi po reflektonte me qetësi e urtësi sepse, siç e thoshte ndonjëherë, rruga e zgjedhur ishte me rreziqe dhe se vendimin për të bërë atentat, nëse e kishte marrë UDB-ja, e bënte krenar. Ishte edhe një dëshmi se punonte mirë e shumë për popullin e tij të robëruar.

– Tani është në dorën tuaj se si do ta mbyllni këtë episod të shëmtuar, por po vetëkuptohet se çfarë meriton ky qelbanik shqipfolës! – përfundoi Bardhi.

– Unë them që nesër të shkojmë në takim, – tha prapë Mirani. – Ai nuk duhet ta dijë derisa të ballafaqohemi aty për aty, se ne do të jemi të pranishëm. Ne do ta presim Rezilin në dhomë dhe do ta detyrojmë të flasë se kush ia ka dhënë urdhërin, cilët janë kolegët e tij të tjerë në shtetet perëndimore etj. Në takim them të jetë i pranishëm edhe Maksi. Ti, – iu drejtua Jusufit, – do të kesh rastin ta shohësh, madje edhe të flasësh me kriminelin që është hallkë urdhëruese për vrasjen tënde. Prania jote do të ndihmojë të gjykojmë me urtësi, siç po na këshillon. Unë, në fakt, jam për përzënie të tij që këtej, siç veprova me Fekir Dalanën., sepse nuk na ka hije dhe nuk kemi të drejtë ta vrasim këtu. Ky shtet ka ofruar punësim për mbi shtatëdhjetë mijë punëtorë nga Kosova dhe nga viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, po na strehon e toleron edhe ne.

– Se mos ka hetuar gjë Rezili dhe po na përgatit ndonjë kurth! – shprehu dyshimin Bardhi.

– Ju siguroj, – e mori fjalën Vasili, – se nuk ka asnjë dyshim. Pas takimit që kishim në banesën e tij para dy javësh unë taktizova me të duke e kërcënuar se do të marrë hak edhe ndaj Miranit, pasi ta kem kryer me Jusufin, pavarësisht nëse do të më jepte leje ai. Rezilit iu bë qejfi dhe këto ditë e ka rritur besimin dhe simpatinë ndaj meje.

– Mirë, ta lëmë të takohemi nesër në banesën e Vasilit, – shtoi Jusufi me një qetësi të ekuilibruar, – dhe aty pastaj, duke parë e duke bërë, siç i thonë një fjale.

– Jam dakord, – miratoi Bardhi.

– E lamë pra të takohemi nesër në orën 14.30 tek unë? – pyeti edhe një herë Vasili.

Të gjithë miratuan takimin dhe planin përkatës.

– Unë dhe Vasili po shkojmë në Nürnberg. Sonte do ta kalojmë natën të Maksi. Nesër bashkë do të kthehemi, – shpjegoi Mirani duke lënë të vetëkuptohet se nuk kishin pse të humbnin më kohë në atë lokal.

10.

Para orës 14.30 në dhomën e Vasilit në konviktin për punëtorë të huaj të firmës IIT në Esslingen, ishin të pranishëm Jusufi, Mirani, Bardhi, Vasili dhe Maksi. Diskutuan planin teknik të takimit.

Pikërisht në orën 14.24 Mirani e Bardhi, të fshehur në dhomën e du-shëve, pranë hyrjes kryesore të katit, dëgjuan hapat e Rezilit duke u ngji-tur shkallëve. Nuk kishin pse të dyshonin se mund të ishte dikush tjetër, meqë dita ishte me diell dhe pothuajse të gjithë gastarbajterët ishin në qytet. Rezili hyri në korridorin e katit të dytë, u kthye në të djathtë drejt dhomës. Parakaloi dhomën me dusha, dera e se cilës ishte lënë gjysmë e hapur. Po ecte përgjatë dhomës ngjitur që ishte para asaj të Vasilit. Në atë dhomë banonin dy punëtorë italianë, të cilët në ato çaste nuk ishin të pranishëm. Rezili trokiti sinjalizueshëm në derën e dhomës së Vasilit. Nga brenda u dëgjua zëri i lartë i Vasilit: “Hyri!”. Ai hapi derën dhe sapo pa të tjerë në dhomë ulëriti me tërbim: “Tradhti!” Përplasi derën që të ikte, por prapa hasi në Miranin e Bardhin. Mirani i thirri: “Përpara! Hyr në dhomë!” Dorën e mbante në xhep të xhupit drejtuar Rezilit si të kishte revole në dorë. Pastaj iu drejtua Bardhit: “Kontrolloje!” Bardhi nuk i gjeti gjë dhe ia dha të shtymën. E detyruan të ulej.

Rreth tavolinës, që ishte midis të dy shtretërve, ishte ulur Jusufi, në të majtë, afër tij duhej të ulej Mirani, në të djathtë ishte ulur Maksi dhe pranë tij duhej të ulej Bardhi. Në krye të tavolinës ia kishin lënë vendin Rezi-lit, të cilin tashmë e urdhëruan të ulej. Në fund të tavolinës, përballë Rezilit ishte caktuar vendi për Vasilin, i cili u ul i fundit.

Sapo u ul Vasili nxori nga brezi revolen, një collt të bardhë dhe e vuri atë para vetes mbi tavolinë, duke folur:

– Njëri nga ju të dy, Rezil e Jusuf, jeni të UDB-së! Ne do të dëgjo-jmë ballafaqimin tuaj dhe në fund do të marrim vendim!

Vasili i dha peshë zërit duke ruajtur qetësinë, siç e karakterizonte, pa e ngritur zërin, edhe pse e dinte se nuk kishte njeri në atë kat të konvi-

ktit. Jusufi u befasua kur Vasili vendosi mbi tavolinë revolën. Edhe më shumë u befasua se si e nisi ballafaqimin. Rezili thatim, turimprehtë, ishte zverdhur i tëri, dridhej si pulë e lagur. Mirani, Bardhi e Maksë kishin drejtuar shikimin drejt Rezilit për ta parë syrratin e tij.

– Ju betohem në flamur e në ideale, – filloi të përgjigjet Rezili duke u dridhur si shevari në ujë dhe me zë pothuajse të përvajshëm, – unë nuk jam udbash...

– Në cilin flamur dhe në cilat ideale na betohesh, kriminel!? – ia ndërpreu fjalën Mirani me zë të prerë. – Këtu je për t’u rrefyer dhe jo që të betohesh. Nuk na bindin betimet e tua të rrejshme!

– Atëherë po mbetet të jem unë udbash, – zuri të flasë Jusufi me qetësi paksa të humbur. – Ti Rezil nuk më njihje përpara. U informova para se u arratisa nga Kosova, pothuajse para meje. Akoma pa më njohur dhe pa filluar unë ndonjë veprimtari, ti fillove të shpifje te bashkatdhetarët: *UDB-ja ka dërguar Jusuf Gërvallën, një udbash të rrezikshëm, për të survejuar shqiptarët patriotë dhe për të përçarë Grupin Komunist Zëri i Kosovës*. Këto shpifje i bëje publikisht, kryesisht në stacion të trenit në Shtutgart, që kur u arratisa. Sado që asgjekundi nuk isha përzier në punët e Grupit tuaj. Së fundi ti i dhe urdhër Vasilit të bëjë atentat ndaj meje...

Meqë Jusufi u ndal, Mirani nuk e kuptoi nëse e kishte mbaruar fjalën. Megjithatë, iu drejtua Rezilit:

– Si i komenton ti këto që tha Jusufi?

– Për zotin nuk jam udbash! – tha Rezili më zë të përvajshëm. – Në besën tuaj, mos më vrisni!...

– I thua vetes komunist dhe betohesh në zot!? – e ndërpreu Mirani.

– Përgjigju në këto që tha Jusufi dhe mos humb kohë me betime e lutje përgjëruese!

– Të gjitha i kam bërë kokë në vete, se ashtu ma ka thënë truri im i sëmurë, – u përgjigj Rezili bëlbëzueshëm e përvajshëm. – Ju lutem të ma falni jetën!

– Si qe në gjendje të dinte truri yt i sëmurë se Jusufi u arratis në Gjermani akoma pa hyrë ky tamam në Gjermani? – e pyeti Mirani.

– Më kanë informuar shokët, – mezi foli ai.

– Si i kanë emrat? – pyeti prapë Mirani.

– Nuk ua di emrat. Më kanë telefonuar nga Kosova dhe më kanë treguar, por janë frikësuar të m’i tregojnë emrat në telefon.

– Në çka u mbështet truri yt i sëmurë kur mori vendim ta urdhëronte Vasilin për të bërë atentat në Jusufin? – qe Mirani tashmë në rrol hetuesi.

– Vetvetiu gjykova, meqë mendova se erdhi në rrethin tonë për të penguar veprimtarinë tonë revolucionare dhe për t’i identifikuar anëtarët e Grupit tonë, – tha tjetri.

Mirani shikoi të gjithë me radhë nëse donte ta merrte ndonjëri fjalën. Meqë të gjithë po prisnin të vazhdonte ai ta merrte në pyetje, vazhdoi:

– Përse ta tha truri yt i sëmurë që ta shash para shumë viteve revistën kroate “Nova Hrvatska”, duke lavdëruar gazetën e Beogradit “Novosti” dhe për këtë të hash thikë nga kroati që u ofendua? Truri yt që në gjendje të komandojë konsullin jugosllav që të të vinte përditë për vizitë në spital? Truri yt dirigjoi shtypin jugosllav të shkruante me pompozitet për patriotizmin tënd jugosllav pas atij rasti? Truri yt organizoi tubimet me emigrantë, kur shkonin për pushime në Kosovë dhe në ato tubime titistët pushtetarë të Kosovës flisnin për heroizmin tënd? Truri yt ta tha të bashkëjetosh me serbe, duke u reklamuar publikisht si antiserb? Truri yt ta tha të themelosh organizatë të shpifur, gjoja ilegale, marksiste-leniniste? Truri yt i sëmurë diti të mashtrrojë e manipulojë këta dy patriotë të ndershëm dhe shumë të tjerë deri në atë shkallë, sa t’i japësh urdhër Vasilit për atentat?...

– Ju lutëm, ma falni jetën! – mezi e shqiptoi lutjen Rezili nga vaji e ngashërimi, duke vendosur kokën mbi tavolinë dhe duke i rënë me grushta herë kokës e herë tavolinës.

Për habi të të gjithëve Jusufit filluan t'i mbushen sytë me lot. Tek tani po e shihnin se sa i brishtë e sentimental ishte. Ai rrëmbeu fjalën edhe pse Mirani e kishte ndërmend ta vazhdonte serinë e pyetjeve.

– Ju lutem, ma falni mua jetën e tij dhe lëreni të zhduket prej këtej këtë udbash frikacak!

– Mos, Baca Jusuf, të lutem mos na kërko kaq shumë! – shpërtheu befas Vasili, pa e mbaruar tjetri fjalën.

– Si t'i nxjerr goja këto fjalë, Jusuf Gërvalla? – pyeti Maksi. – Ai dha urdhër të të merret jeta, ti tani na lute që t'ia falim këtij udbashi kriminel jetën!

– Nuk dua ta argumentoj lutjen time, – foli Jusufi. – Kështu po ma thonë ndjenjat, ngase po më vjen gjynah si po qan ky zuzar. Ky frikacak është viktimë e zuzarisë së tij. Ka pranuar t'i shërbëjë UDB-së, por jo asaj të Kosovës, por UDB-së serbomadhe të Serbisë, si shumë shqiptarë të mjerë, frikacakë e interesxhinj dhe tani i duhet të punojë sipas urdhrave të eprorëve serbomëdhenj. Prandaj të ma falni jetën e tij që t'i jepet shans të dezertojë nga ajo strukturë antishqiptare.

– Ke të drejtë të shprehesh mendime, – iu drejtua Mirani, – siç ke të drejtë të na lutesh t'ia falim jetën, por mos insisto të ta miratojmë, siç ta thonë ndjenjat e tua sentimentale të momentit.

– Atëherë, po vendoset ta vrisni atë, duhet të më vrisni edhe mua! – kundërshtoi kushtëzueshëm Jusufi, tashmë me zë më të qartë e më të fuqishëm. Ai e parandjeu rrezikun se aty, para syve të tij, mund të ndodhte ekzekutimi i Rezilit.

– Shkove larg, Baca Jusuf, më more në qafë, – iu drejtua Vasili i egërsuar përbrenda, por duke ruajtur vendosmërinë e qetësinë e jashtme.

– Dëgjoni këtu, shokë, – ndërhyri Mirani, – edhe unë jam me Jusufin sepse, në fund të fundit, ky ishte viktimë e mundshme që tani po shfaq kaq zemërgjerësi. Për këtë ky ka më se shumti të drejtë morale në marrje të vendimit kolektiv. Por, ky zuzar, – mirë ia gjeti cilësimin Jusufi, –

që frikësohet kaq shumë nga gjykimi ynë, duhet të plotësojë kushtet që po i formuloj: Ta ndërpresë veprimtarinë udhëuese ose të iki nga Gjermania, ta dorëzojë gjithë dokumentacionin e *Grupit Komunist Zëri i Kosovës*, të mos provojë më të bëjë krime të tjera! Jeni dakort me propozimet e mia?

Të gjithë po shikonin njëri-tjetrin. Hezitonin sekush të përgjigjej i pari. Pas pak çastësh Vasili tha:

– Unë po pajtohem me të dy, sado që po detyrohem të shkel mbi vetën time.

– Do t'i plotësosh kushtet që t'i caktuam? – iu drejtua Mirani Rezilit, pa pritur mendimin e Bardhit e të Maksit.

– Po ju betohem se i pranoj, janë kushte tepër simbolike në krahasim me faljen e jetës që po më bëni dhe për këtë do t'ju jem mirënjohës, për jetë të jetëve, – u përgjigj me zë përvajtës Rezili.

– Tani na u shporr nga sytë dhe më telefono sa më shpejt kur t'i kesh grumbulluar të gjitha dokumentet që t'i zhdukim! – e urdhëroi Mirani.

Rezilit mezi po i bënin këmbët të ngritej. Nisi të zgjas dorën për t'u përshëndetur, por asnjëri nuk ia pranoi. Uli kokën si i dhier dhe doli përjashta pa thënë më asnjë fjalë.

Në dhomë ra heshtja. Vasili mori revolen nga tavolina dhe e vendosi në dollap. Pas disa çastësh heshtjeje u ndie Jusufi:

– Jua paça për borxh që më dëgjuat.

Atij tashmë i ishte kthyer dukshëm qetësia dhe po fliste me zërin e natyrashëm.

– Sa burrë i dhëmbshëm e sensibil që qenke! – iu drejtua Mirani. – Të kam ditur për pak, por jo për kaq shumë. Përcaktimin tënd që të merrsh me organizim të veprimtarisë çlirimtare kjo natyrë do ta pengojë. Pastaj, ne qemë marrë vesh se nuk do ta gjykonim me vrasje dhe as që do ta vrisnim, donim vetëm t'i bënim presion që ta tregonte të vërtetën...

– Më tmerroi revolja që nxori mbi tavolinë Vasili. Më preku vaji i atij zuzari mjeran. Sesi m’i preku emocionet dhe më bëri të më vinte gjynah, – u përgjigj Jusufi.

– Unë nuk do ta kisha lëshuar kaq lehtë, siç vepruat ju, – u shpreh Bardhi i cili kishte heshtur gjatë gjithë kohës.

– As unë, – miratoi Maksi. – Ai kriminel e ka pasur plumbin hak!

– Edhe unë, – e mori fjalën Vasili tashmë bukur i natyralizuar, – e pata të vështirë të shkel mbi veten time. Pothuajse e kisha vendosur të mos i përmbahem vendimit që kishim marrë përpara. Por, shpirti i butë i dhe lutjet e tua, Baca Jusuf, më detyruan të heq dorë nga dënimi kapital.

– Ne e falem, – mori fjalën Mirani, – por parashikoj se ai nuk do t’ju përmbahet kushteve që i vumë dhe ai formalisht i pranoi. Ai zuzar kriminel sigurisht u frikësua, por më shumë u frikësohet eprorëve të tij, sepse ata nuk janë njerëzorë si ne. Kjo varët nga komandimi i eprorëve të tij. Ne duhet t’i ruhem. Ai mund të bëhet edhe më i rrezikshëm dhe më finok. UDB-ja nuk e ka të vështirë të bëjë atentat në çdo kohë, ndaj kujdoqoftë, por ajo preferon të gjejë ekzekutorë shqiptarë, si në këtë rast që e përjetuam. Përmes atentateve, UDB-ja synon të fusë përçarje midis nesh, të na komprometojë para opinionit gjerman. Ne duhet të diskutojmë në mënyrë të shtruar për t’u aftësuar që të identifikojmë paraprakisht udhëbërës dhe informatorët e tyre, para se ata të depërtojnë në radhët tona. Mënyra të tjera të sofistikuar, siç janë informatorët nga radhët e brendshme të UDB-së, që do të na informonin për të tillët, nuk kemi. Na mbetet të jem vigjilentë ndaj mënyrave të sjelljes e të veprim-it të individëve që të gjykojmë nëse janë shërbëtorë të UDB-së të cilët mundohen të penetrojnë në radhët tona. Kështu do të përsosim vetëmbrojtjen nga sulmet e tyre, jo vetëm fizike, por edhe dezinformuese, përçarëse e diversioniste. UDB-ja e Beogradit, pos UDB-së së Kosovës, do të dyndë që tani në rrethet tona njerëz të saj dhe ne duhet të aftësohemi t’i identifikojmë, izolojmë e bllokojmë.

– Shpërndahemi dhe këto tema i diskutojmë në të ardhmen! – tha Bardhi. Atij akoma nuk i kishte dalë gjithë inati për vendimin që morën.

Ditëve në vazhdim, Rezili, Vasili, Maksi dhe të tjerë anëtarë të Grupit Komunist po grumbullonin dokumentacionin. Pas dy javësh u mbledhen Jusufi, Mirani, Bardhi, Vasili, Maksi, Rezili dhe disa anëtarë të Grupit, që të shihnin dokumentacionin e grumbulluar. Aty u vërtetua se shumica e dokumentacionit ishte fotokopjuar. U bë debat i rrebtë për vendndodhjen e dokumentacionit origjinal, u akuzua Rezili se atë dokumentacion ia kishte dorëzuar eprorëve të tij, u fjalosen dhe në fund u vendos të digjeshin ato që u grumbulluan në prani të tre vetave: Bardhit, Maksit dhe Rifatit, në banesën e të cilit bëhej kjo mbledhje. Gjatë dje-gies iu dha e drejta për të asistuar edhe Rezilit. Ata gjeten një vend të përshtatshëm në natyrë dhe i dogjën. Bardhi, Maksi dhe Rifati u kthyen për të treguar se dokumentacionin e dogjën, ndërsa Rezili kishte ikur që andej, sepse u bind se nuk ishte më i dëshirueshëm të kthehej.

KAPITULLI IV

Në shtator që caktuar të mbahej kuvendi vjetor i “Klubit të punëtorëve jugosllavë “Rilindja”” në Mynhen. Mirani bashkë me tre aktivistë të Klubit të punëtorëve shqiptarë “Emin Duraku” të Dyzeldorfit shkuan në atë Kuvend për të përkrahur aktivistët patriotë të Klubit “Rilindja”. Ata kishin punuar me anëtarët, që të zgjidhnin një kryesi, e cila këtë Klub do ta pavarësonte nga tutela e konsullatës jugosllave. Ekspertët e konsullatës dhe ata jashtë saj kishin sajuar skenarë të sofistikuar. Ata udhëzonin një treshë shqiptare, informatorë të konsullatës, rrjedhimisht të UDB-së, që të ricikloheshin si kryetarë të këtij Klubi. Treshja përbëhej nga Garipi, Rrahmani dhe Bedriu. Meqë konsullata kishte paracaktuar që kryetar të radhës ta bënin Garipin, i kishin dhënë të drejtë këtij të bënte fushatë zgjedhore për vete, duke sharë dy partnerët e tjerë. Garipi, sipas atij skenari, pos të tjerash, propagandonte për vete:

– Me votoni mua se unë jam bërë patriot, jam vetëdijësuar se nuk duhet të rrimë më nën tutelën e konsullatës jugosllave. Rrahmani dhe Bedriu janë shërbëtorë të konsullatës dhe të UDB-së. Po qetë patriotë duhet t’i urrenti, të mos i votoni, madje edhe t’i përzini nga Klubi.

Aktivistët patriotë bënin fushatë kundër të treve, duke shpjeguar se që të tre janë të të njëjtës hordë, që dirigjohen nga konsulli, por që tani kanë zgjedhur këtë metodë mashtruese.

Në kuvend asistonte edhe Mirani me të tre aktivistët e Klubit të Dyzeldorfit. Kjo prani e tyre shqetësoi treshën që kishin vendosur ta bënin kryetar Garipin. Mirani nuk duhej të ekspozohej me marrje të fjalës sepse ishte i anatemuar si armik i Jugosllavisë. Ai ishte i pranishëm,

por duhej të mos hetohej që ishte aty. Përfundimisht fitoi Garipi duke mbajtur një fjalim të zjarrtë patriotik, kryesisht kundër dy gjoja ish-bashkëpunëtorëve të tij, mënyrë kjo tepër sugjестive për t'i përfituar votat. Në mbarim të Kuvendit Mirani kritikoi aktivistët që humbën votimin, ngaqë nuk kishin ditur të bënin fushatë efektive. I njohuri i Miranit, Bardhec R., që banonte në Mynhen, e ftoi atë me shokët të flinin tek ai. Sapo shkuan para pallatit (rreth orës 23.00), gjatë parkimit u gjenden rastësisht pranë makinës së Bardh Gërvallës. Nga makina e Bardhit doli Jusufi. Kur i pa u përshëndet tepër formalisht dhe e shkëputi Miranin anash. Tjetri mendoi se Jusufi kishte t'i thoshte diç me rëndësi.

– Mirëmbërma! Nuk thuhet kot se rasti është mbret i botës. Ja ku u takuam. A kemi ndonjë të re? Mos edhe ju jeni mysafirë te Bardheci?

– Nuk e njoh këtë farë Bardhecin, – tha Jusufi i nevrikosur, – paskan të drejtë ata që më kanë thënë se ti po më survejon intensivisht. Edhe këtu më paske ardhur prapa. Që sonte do t'i ndërpresim marrëdhëniet derisa të sqarohen arsyet se përse po më survejon me kaq përkushtim.

– Mos ia fut si kau pelës! – foli hidhërueshëm Mirani. – Të gënjejnë ata maskarenj. Ne na mori nga Klubi “Rilindja” Bardheci, i cili e paska banesën këtu. Nga ta dinim ne që në të njëjtën kohë do vinit edhe ju? Survejuesi do ta kishte mënjënuar ballafaqimin fizik...

– Ne jemi mysafirë të Minush M. dhe jo të Bardhecit. Ta thashë mendimin tim dhe nuk do të diskutojmë më këtu. Nuk po e duroj gjendshmërinë tënde për t'u nxjerrë edhe nga kjo situatë tepër flagrante.

– Prit të sqarohemi se ky vërtet është një keqkuptim! – e luti Mirani, por tjetri u largua duke i thënë ftohtësisht: – Mirupjekshim!

Miranin e hidhëroi kjo sjellje dhe ky fajësim që i bëri Jusufi:

– E ke gabim dhe nuk po të ka aspak hije të sillesh kështu përçudshëm, duke më provokuar të humb durimin. Po më fajëson pa asnjë arsye. Natyrisht që edhe unë do ta respektoj vendimin që ma komu-

nikove...

Mirani pa se Jusufi kishte përshpejtuar hapin dhe kot do t'i fliste më shumë. Tjetri nuk po e dëgjonte më. U ndal dhe bëri sikur po rregullonte pantallonat, që të tjerët të mos e hetonin se Jusufi po largohej nxitueshëm prej tij.

Bashkatdhetarët e tjerë bashkë me Bardhin kishin arritur para derës se hyrjes në pallat dhe po e prisnin Jusufin e Miranin. U bënë të gjithë së bashku dhe filluan t'i ngjithnin të njëjtat shkallë. U ndanë duke u përshëndetur, meqë Bardheci e kishte banesën në katin e 2-të, ndërsa Minushi në të 3-tin. Asnjëri nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur pak më parë midis Jusufit dhe Miranit.

Sapo hynë në dhomë të Bardhecit filluan analizat për humbje të zgjedhjeve, ndërkoh që Mirani po rrinte i heshtur, duke analizuar përplasjen me Jusufin: “Edhe sa kohë do t'i duhet të mësojë se si duhet të mbrohet nga dezinformuesit përçarës? Vërtet, duhet ta pranoj unë akuzën që më bëri në mënyrë tepër naive dhe çfarë qëndrimi duhet të mbaj karshi kësaj? Po Minushin, këtë lahper, pse e vizituakan Jusufi e Bardhi!? Mbase nuk e njohin. Po si qenka sajuar kontakti i tyre me të ...!?”

– Miran! – i thirri Kuneja, bashkëshortja e Bardhecit, e cila e njihnte dhe e respektonte Miranin, meqë ishte shoqe me kunatën e tij, Sabrushin. – Mirë se të ka pru Zoti dhe mos u mërzi për humbjen në Klub se këtu nuk janë shqiptarët e mirë si në Dyzeldorf. Atje m'u ka rritur ymri sa herë kemi ardhur. Këtu fare nuk i lënë gratë të hyjnë në këtë të shkretë klub të pijanecëve, delenxhinjve e udbashëve.

– Jo Kune, jo, nuk janë këtu shqiptarët më të këqij se në Dyzeldorf. Mynheni nuk ka shpallur konkurs që këtu të vijnë vetëm shqiptarët e këqij. Këtu po mungojnë të mirët e guximshëm për të bërë punë patriotike. Këtu, meqë është më afër Kosovës, për çdo fundjavë po vijnë udbashë prej andej dhe po i manipulojnë e frikësojnë shqiptarët. Ka ardhur koha që të angazhoheni ju gratë, sepse burrat i keni frikacakë dhe

ranë në provim edhe sonte.

Plasi e qeshura duke ia ndërprerë përgjigjen Miranit.

– Mos na poshtëro kaq rënd në sy të gruas! Nuk po mundemi më mirë dhe më shumë sepse, e the edhe ti, këtu janë të angazhuar shumë udbashë dhe atë treshen e kemi shumë të stërvitur, – u mbrojti Bardheci.

Në dhomën e Minushit nuk kishte gjallëri, meqë Jusufi ishte i vrënjtur. Fodullëku i mujshëm i Minushit nuk po e nxiste Jusufin të fliste. Ai njihej me Bardhecin, si fqinjë që ishin, por nuk kishin hyrje-dalje te njëritjetri, meqë Minushit i kishte dalë nami për qejflin femrash, pas të cilave harxhonte fitimet që i kishte nga kontrabanda. Madje flitej se kohëve të fundit po shkonte me një serbe të bukur. Ai tani po u krekosej Jusufit e Bardhit si patriot i madh dhe këta po i besonin, me bindjen se atë duhej ta ngarkonin t'i koordinonte aktivistët patriotë në Mynhen. Po i besonin, meqë nuk e njihnin.

Edhe Bardhi po habitej me qëndrimin e heshtur të Jusufit sa që, kur Minushi shkoi në kuzhinë, nuk u përmbajt pa e pyetur. Tjetri nuk dënjojti të përgjigjej.

2.

Pas dy ditësh Jusufi i shkroi letër Miranit ku i komunikonte ndërprejen e bashkëpunimit. Ndër arsyet kryesore përmendteurvejimin dhe aventurat e pëpjekjes për blerje të armëve. Mirani iu përgjigj me një letër të gjatë në të cilën ia demantonte arsyetimet po, megjithatë, nuk mori përgjigje. Në këtë gjendje Jusufi nisi botimin e revistës *Lajmëtar i lirisë*. Mirani i shkroi sërish duke ia rikujtuar se ai ishte i interesuar të rivendosej bashkëpunimi. Prapë nuk mori përgjigje.

Kjo gjendje vazhdoi derisa Jusufi e Mirani u takuan në festën e 28 Nëntorit, në Nürnberg. Në manifestim Jusufi bëri një diskutim, jo fjalim, por shumë përmbajtësor. Që të dy kishin presion nga Vasili e Maksi

për të rivendosur bashkëpunimin. Ata me të dy mbanin lidhje dhe iu bënë përherë lutje që të pajtoheshin e të bashkëvepronin. Jusufi e kishte porositur Vasilin që të bënte shpërndarjen e *Lajmëtarit të lirisë*, por të mos i tregonte Miranit se kush po e botonte.

Gjatë festës Jusufi e Mirani u pajtuan dhe u morën vesh që të botonin numrin tjetër të *Bashkimit*. Gjatë dhjetorit e përgatitën bashkërisht dhe e dorëzuan në shtyp, duke i vënë në ballinë njoftimin: “Viti i 3-të i botimit, nr. 1, janar 1981”

3.

Në prag të Vitit të Ri 1981 Vasili i telefonoi Miranit që të shkonte tek ai në Esslingen. Nuk ia tregoi arsyen konkrete, por i tha se e pret te Nazimi. Vasili kishte vendosur të shkonte në Kosovë. Para se të nisej donte të takohej me Miranin.

Të premten pasdite, sapo Mirani arriti në Esslingen, shkoi në banesë të Nazim Ramazanit, që vinte nga rrethi i Tetovës. Aty Mirani, pos mikpritësve, gjeti Sadi Bakajn. Përballimi fizik me të e hutoi, sepse vazhdimisht e kishte refuzuar kërkesën e njerëzve për ta takuar.

Mirani e mbante mend vëllanë e Sadiut, Ramën, si patriot të devotshëm. Ai ishte njëri nga bashkorganizatorët kryesorë të demonstratës në Pejë, në nëntor të vitit 1968. Atëherë Mirani ishte katërmbëdhjetë vjeçar dhe dallimi në moshë nuk e kishte penguar të njihet mirë me Ramën. Në vitet e pastajme edhe Sadi Bakaj kishte bërë emër si student i mirë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, në drejtimin për gjuhë dhe letërsi shqipe. Njëherit përfliet si për një qejflinj. Pastaj ishte hedhur edhe në aventura të tjera, në bixhoz, degjenerim e pija, që rëndom çonin drejt koketitimit me struktura të UDB-së. Edhe të afërmit kishin filluar ta përfllisnin.

Para daljes se Sadiut në Perëndim ishte sajuar një arratisje e tij nga burgu i Gjilanit. Patrioti veteran Nesim Guri, nga fshati Gërkoc i Pejës,

i cili ishte në farefisni me Miranin, ishte informuar për daljen e tij nga burgu i Gjilanit dhe prej andej në Perëndim. Këtë informim Nesimi e kishte nga Rama, me të cilin ruante marrëdhënie e miqësi prej vitesh. Ata të dy ishin veprimtarë të angazhuar dhe kishin vujtur për këtë në burgjet jugosllave. Nesimi menjëherë ishte shqetësuar se mos Sadiu po dërgohej nga UDB-ja për t'i bërë ndonjë paudhësi Miranit. Ai dinte për veprimtarinë e Mirani, sepse mbante lidhje të fshehta me te. Por, më përifer ishte informuar nga një vizitë befasuese që Mirani ia kishte bërë atij në fshat, në vitin 1979, shoqëruar nga Vasili. Të dy së bashku kishin shkuar fshehurazi, natën, që të mos u binin në sy fqinjve të Nesimit. Ajo vizitë nuk ishte paralajmëruar dhe Nesimi e përjetoi si një surprizë të këndshme. Sapo ishin takuar, pas shtrëngimeve përqafuese, Nesimi kishte urdhëruar të vëllanë, Remën, që të merrte armën dhe të bënte roje përjashta. Në këtë vizitë Vasili kishte sjellë me vete edhe material propagandistik. Ai ishte i përcaktuar që në çdo kohë e lëvizje të shpërndante materialin, i cili shtypej në Perëndim, por që e fuste në Kosovë fshehurazi, me mjeshtëri që vetëm atij i shkonin përdore.

Kur Nesimi mori vesh për dalje të Sadiut në Perëndim, u angazhua të gjente mundësinë sa më të shpejtë për ta informuar Miranin. Në këtë përpjekje ai gjeti Zymerin, një farefis i tij dhe i Miranit. Meqë kishte besim tek ai, e porositi të shkonte urgjentisht te Mirani.

Kur Zymeri e gjeti Miranin në banesën e tij në Bochum, e bëri me dije se e kishte dërguar Nesim Guri me një porosi konkrete: “Andej do dalë Sadi Bakaj. Ruaju nga ai! Kam frikë mos po të shkakton ndonjë të keqe. Mos u tako me të! Kam dro që UDB-ja po e dërgon me mision konkret...”. Zymeri nuk e njihte personalisht Sadiun. Ai, në fakt, kishte mbajtur mend vetëm porosinë që i kishte dhënë Nesimi. Mirani e kishte marrë seriozisht këtë porosi. Nuk kishte pranuar ta takonte, sado që Sadiu një herë i kishte shkuar te banesa, por nuk e kishte gjetur aty. Dhe mirë që nuk e kishte gjetur sepse do të ziheshin fizikisht. Pastaj ai i çonte

fjalë përmes bashkatdhetarëve se dëshironte ta takonte, të rrëfehej dhe të bëhej bashkëveprimtar.

Vasili ishte takuar me Sadiun para disa muajve, përkundër porosisë se Miranit. Për këtë i kishte treguar më vonë Miranit, me arsyetim se nuk i përballonte lutjet e Demushit, bashkëveprimtarit të tij të ngushtë. Mirani ishte hidhëruar dhe e kishte qortuar. Vasili i kishte kërkuar të falur.

Meqë të gjitha përpjekjet për t'u futur në rrethin e bashkëveprimtarëve në Gjermani i kishin dështuar, Sadiu ishte vendosur përkohësisht në qytetin e Sant Gallen-it të Zvicrës. Atje jetonte, punonte dhe vepronte Kadri Zeka, si i strehuar politik. Sadiu kishte shkuar atje me detyrë, ta survejonte Kadriun, siç do ta merrte vesh më vonë Mirani. Herë pas here, ai shkonte edhe në Bruksel, në Paris e gjetiu. Ishte usta i falsifikimit të dokumenteve për udhëtime. Megjithatë, ai nuk po i shpëtonte syrit të mprehtë të emigrantëve, të cilët i kishte porositur Mirani.

Sa e pa Sadiun në banesë të Nazimit, ia njohu surratin, sado që kishte më shumë se dhjetë vjet që nuk e ishin takuar. Nazimi ia prezantoi Sadiun me emrin Rrustem. Me këtë emër kamuflues e kishte prezantuar Vasili kur e kishte sjellë aty Sadiun, për ta vënë në konak. As prezantimi kamuflues nuk e bëri Miranin të dyshonte. Vasili nuk gjendej në banesë të Nazimit. Ai ishte në qytet për të bërë blerjet e fundit para se të nisej për në Kosovë. U përshëndetën tepër ftohtë e tepër formalisht. Mirani shtirej sikur nuk po e njihnte. Zuri vend në në kanape dhe po mendonte rreth të papriturës. Po i vinte keq nga familja e Nazimit që i kishte rënë hise ta kishte brenda një imoral dhe spiun të UDB-së. Pas pak Mirani mori vesh se Sadiu kishte me vete edhe dashnoren e tij, kur ajo hyri në dhomë të ndenjës nga dhoma tjetër. Ai ishte informuar më herët nga bashkatdhetarët e Malënjës se Gjilanit, ku Sadiu kishte punuar si mësues në shkollën 8-vjeçare. Aty ai e kishte mashtruar atë minorene që t'i bëhej gruaja e tij e dytë, duke e pasur nxënëse. Për këtë ishte përja-

shtuar nga mësimdhënia dhe ishte burgosur e dënuar. Po bashkatdhetarët e asaj ane i kishin thënë Miranit se UDB-ja e kishte rekrutuar Sadiun gjatë vuajtjes së dënimit dhe pastaj e kishin përdorur atë për t'i hetuar të burgosurit për veprimtari patriotike. Për këtë qëllim UDB-ja e kishte transferuar nga qelia në qeli, ku mbaheshin të mbyllur patriotët. E kishin lënë me secilin nga disa ditë që t'ua nxirrte informatat për veprimtarinë e tyre të fshehtë. UDB-ja, e kishte hetuar talentin e tij prej aktori. Ai i mrekullonte dëgjuesit kur recitonte poezitë e rilindësve. Tani ky Sadi po e mbante pas vetes atë minorene të mashtruar dhe dënjonte ta sillte edhe në familjen atdhetare të Nazimit.

Brenda atyre çasteve Mirani po i sillte nëpër kokë të gjitha njohuritë për Sadiun. Ishte në dilemë të vazhdonte të rrinte sa të vinte Vasili, apo të ikte. Mjaftonte vetëm krimi që ai kishte bërë ndaj nxënëses se tij katërmbëdhjetë vjeçare që ta urrente skajshmërisht.

Gjatë përpunimit të të dhënave për Sadiun, sado që s'e kishte të nevojshme, Miranit iu kujtua takimi i paradokohshëm i këtij Sadiut me Jusufin.

Jusufi, përkundër paralajmërimit që i kishte bërë Mirani, kishte pranuar të takohej me të në prani të dy bashkatdhetarëve të tjerë. Njëri nga ata kishte qenë Fahriu, që e thërrisnin Taksisti. Ai bënte taksistin pas orarit të punës në fabrikë. Kur ishin takuar më vonë Jusufi e Mirani, i pari kishte shprehur mëdyshjen: "Mos po i hyjmë në hak Sadi Bakajt që nuk po e qasim në radhët tona? E takova përkundër rekomandimit tënd. Gjatë bisedës atij i rrodhën lotët nga keqardhja që nuk po e qasim. Bile më recitoi poezi aq mrekullueshëm, sa që më emocionoi me zërin dhe talentin e tij brilant." Mirani nuk kishte ndryshuar mendje. I kishte thënë Jusufit se nuk kishte bërë mirë që e kishte takuar dhe i kishte thënë se vetë nuk do ta ndërronte qëndrimin ndaj Sadiut..

Në fund gjykoi me vete: "Po rri, nuk duhet të iki. Të paktën jo derisa të vijë Vasili, meqë shoku shokut i duhet sidomos në çastet kur gabon".

Për shkak të konspiracionit të shtirur, as Sadiu nuk po i prezantohej Miranit me emër të vërtetë, se mos e merrte vesh Nazimi se nuk ishte Rrustemi. Nazimin e kishte zënë halli, meqë po i ndodhte për herë të parë që Mirani të mos bisedonte gjallërisht me një shok të ngushtë të Vasilit, siç bisedonte përhërë. Nuk vonoi shumë dhe erdhi Vasili. Sa e pa që kishte arritur Mirani ai u step. Kishte menduar se do ta takonte përpara që ta sqaronte si qe puna. Tani Vasilit po i dukej si një pabesi. Pas disa çasteve Vasili e luti Miranin të shkonin për një punë deri të një bashkatdhetar. Pasi dolën nga banesa, Vasili shpjegoi se nuk do të shkonte gjëkund, por kishte nevojë të bisedonte pa prani të Sadiut. Mirani po mundohej ta përmbante hidhërimin, ndërkohë që Vasili ndihej i zënë ngusht.

– Miran, më fal që të krijova situatë të papërshtatshme!

– Domethënë paske harruar se të kam paralajmëruar për rrezikshmërinë e atij kriminelit dhe kujdesin që duhet të kemi ndaj tij!?

– Nuk kam harruar, por gjërat kanë ndryshuar. Unë kam vendosur të shkoj me Sadiun në Kosovë dhe atje ta vë para sprovave nëse është patriot, siç po pretendon tani.

– Vasil, më në fund ai ia paska arritur të të mashtrojë. Dhe ti tani do që të viktimizohesh për ta sprovuar një udbash, në është apo jo patriot. Kjo është mendjelehtësi e shoqëruar me rrezikim të jetës sate.

– Më lejo njëherë të të sqaroj se si e kam marrë këtë vendim. Isha para dy javësh te Demushi, i cili më thirri urgjentisht. Baca Nesim i kishte telefonuar nga Kosova dhe e kishte urdhëruar të më gjente mua se pas pesë orësh do të më telefononte. Shkova për telefonatën. Ti e di se sa e çmoj unë Bacën Nesim. Dhe vërtet erdhi telefonata. Ai më foli shkurt: ‘Pas dy ditëve do të vijë shoku për të cilin dikur ju kemi informuar se është i rrezikshëm. Duhet ta mirëpritni dhe ta angazhoni pasi është i aftë dhe i besueshëm. Kemi qenë të dezinformuar kur ju kemi çuar fjalë që të ruheni nga ai. Kaq. Mirupafshim!’ Ma mbylli telefonin

pa pasur mundësi t'i bëja ndonjë pyetje.

– E paske hëngër, more pus. Nuk ke biseduar me Nesimin, por me Sadiun. Ai të ka telefonuar nga Brukseli, ku gjendet për momentin, siç na kanë informuar shokët atje. Meqë i shkon aktrimi dhe e njeh mirë Nesimin, të ka folur duke e interpretuar atë.

– Nuk është e mundur, unë ia njoh zërin Bacës Nesim. Të kujtohet kur ishim fshehurazi tek ai vitin e kaluar?

– Të betohem se e paske hëngër tunxh. Qind për qind të ka folur Sadiu. Prandaj nuk e ka zgjatur se mos rrezikonte të identifikojë. Vetë fakti që të ka thënë Demushi se do të të telefonojë Nesimi nga Kosova ty të ka sugjestionuar. Pastaj të ka telefonuar Sadiu pa të dhënë shans për bashkëbisedim. Ai mjeshtërisht t'u ka imponuar nisur nga informimi se të tilla biseda nga Kosova na qenkan me rrezik po që se zgjaten. Përmes këtij mashtrimi vërtet mjeshtëror, ti ke rënë brenda...

– Tani mos u lodh kot, – e ndërpreu Vasili, – unë jam i bindur se kam biseduar me të madhin, Bacën Nesim.

Vasili dukej më tepër se i bindur. Mirani ia njihje tashmë karakterin dhe nuk e vazhdoi bisedën rreth telefonatës së improvizuar. Po mendonte me vete: “Sa lehtë mashtrohen njerëzit nga ata që i madhërojnë! Kjo po i ndodh edhe këtij të shkretit. E ka madhëruar deri në idhull Nesimin, ka ndjerë lumturi që ai po i telefononte dhe s'kishte si t'i shkronte ndërmend të dyshonte në ishte vërtet zëri i tij.

– Pse nuk po flet? – ia ndërpreu Vasili mendimet.

– Po atëherë çfarë ndodhi?

– Vërtet, Sadiu erdhi pas dy ditëve. Ndenjëm ca ditë bashkë te Demushi në Nagold. Atje u fascinova nga shkathësitë dhe patriotizmi i tij. Kishte shkathësi të falsifikonte dokumente të të gjitha llojeve. Madje edhe bileta të trenit. Kishte shkathësi për të qenë gueril i përkryer...

– A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri, sepse kohën më të madhe e kalon me to?

– Më le të të informoj unë, pastaj më kundërshto e qorto sa të duash,
– foli Vasili me ndjenjë fyerjeje.

– Fol de se po të dëgjoj. Thuaji ato që janë me rëndësi se si more vendimin për të shkuar me të në Kosovë?

– Njëherë u fjalosa me të duke i thënë se vazhdojmë të kemi dyshim ndaj tij. Ai emocionalisht dhe bindshëm me tha: “Urdhëroni, më sprovoni!”. Unë, i zënë ngusht, ia ktheva me inat: “Po, do të të sprovuj duke shkuar së bashku në Kosovë për aksione!”. Ai më tha: “Mate veten se mua nuk më mat dot!” Ia ktheva: “Nuk jam nga ata burra që frikësohen, prandaj sa të bëhem gati, për pak ditë, para Vitit të Ri do të shkojmë!”. Dhe kështu me vrull e me inat mora vendimin për të shkuar me të në Kosovë.

– Tani mendon se po të cenohet burrëria ndaj atij udbashi nëse bëhesh pishman?

– Nuk është udbash. Më ka siguruar Baca Nesim, – u përgjigj me kryeneqësi Vasili.

– Prapë e riktheve arsyetimin? Atëherë, meqë atë telefonatë e ke argument kryesor, them ta shtysh shkuarjen në Kosovë. Ndërkohë do ta marrim vesh të vërtetën e telefonatës së Nesimit.

– Gjërat i kam paketuar Nëser në mëngjes do të nisemi, – tha pre-
ras Vasili.

– Domethënë, shkon për të rënë në kurthin e UDB-së? Shkon si
cjapi të kasapi, siç thotë populli?

– Unë nuk bie në kurth, e shpaguaj veten. Sadiun e kam peng gara-
ntues. Pastaj, më mirë të dëmtohem unë se sa ti dhe Baca Jusuf. Kështu
do të bindeni nëse ai vërtet është njeri i UDB-së...

– Mos vazhdo me të tillë naivitete! Ky që është në gjendje të të mash-
trojë këtu, është edhe më në gjendje të ta bëjë kurthin atje. Pastaj ne ish-
im bindur se atë e ka dërguar UDB-ja dhe se duhet t’i ruhem.

– Jo të gjithë. Ai vinte herë pas here te Demushi. Takohej me shokët

tanë. Madje, siç e di, është takuar edhe me Bacën Jusuf.

– Domethënë, edhe ti ke ndërruar qëndrimin dhe tani ke vendosur të rrezikosh për ta sprovuar?

– Po bëhem kurban, – ndërhyri Vasili. – Më mirë unë se ti dhe Baca Jusuf.

– Çfarë rëndësie ka kjo sprovë naive e shoqëruar me rrezik të qind për qindtë!? Në fakt, përse po na duhet ky farë Sadiu!? Ti vetë duhej të ishe bindur të paktën se ai është kurvarë, bixhozxhinj, rrugaç! – i foli rrebtë Mirani.

– Nuk jam edhe unë aq me vlerë. Përse të vazhdoj të rri këtu pa dhënë pothuajse kurrëfarë kontributi. Tani njerëzit na janë shtuar sa për të shpërndarë material informativ e propagandistik. Më shumë peshë ka një aksion në Kosovë, sado i vogël e simbolik, sesa shpërndarja natë e ditë e materialeve këtu. Në fund të fundit, të thashë se veten do ta shpaguej sapo të hetoj se Sadiu ka ndërmend të më tradhtojë.

Kur tjetri e pa se nuk i mbushte mendjen shokut vendosi të përqëndrohej në këshilla. I tha se duhej të përpiqej të kontaktonte vetë Nesimin sapo të arrinte në Kosovë. Nga ai të informohej nëse i kishte telefonuar. Ta pyeste çka duhej të bënte. Pastaj biseduan se cilat aksione do të ishin më domethënëse. Në fund të kësaj bisede të gjatë, Mirani e pyeti:

– A je konsultuar me Jusufin për këtë vendim?

– Jo. Pashë Flamurin mos i tregoj!

– Përse?

– Sepse edhe ai do të mundohet të ma thyejë mendjen dhe nuk kam dëshirë të shkoj me brengën se nuk e kam dëgjuar edhe atë. Ty po të kërkoj falje që nuk po të dëgjoj kësaj radhe. E kam më të lehtë të të mos dëgjoj ty se sa Bacën Jusuf.

– Mirë, të daltë për mbarë dhe u kthefsh faqebardhë!, – i tha në fund Mirani.

Gjatë kthimit në banesë të Nazimit, Mirani po mendonte me vete:

“Përse është katandisur në këtë gjendje Vasili? Sa po më vjen keq për të! Ka pësuar demoralizime të rënda muajve e fundit, që kur u zbulua se kush ishte Rezil Mejtepi dhe që kur u shpërbë *Grupi Komunist Zëri i Kosovës*. Po ndihet i detyruar që të bëjë diç të madhe për të shpague goditjet. Nuk ka përse ta ndiejë veten fajtor. Mos tani ka ndikuar edhe roli i Nuriut. Ai po imponohet si udhëheqës i bashkatdhetarëve në rreth të Shtutgartit, duke e spostuar Vasilin në plan të dytë. Kështu ndoshta po hatërohet se përse Jusufi po e afirmonte gjithnjë e më shumë Nuriun në rolin që e kishte Vasili deri kur i ndodhën gjithë ato paudhësi! Prandaj Vasili duhet të jetë katandisur në këtë gjendje pa rrugëdalje sa të pranojë edhe mashtrimin e Sadi Bakajt. Ai sigurisht ka në plan t’i bëjë kurth këtij veprimtari të palodhshëm, ka në plan të hakmerret për moszbatim të urdhrit për atentat ndaj Jusufit...”

– Hë, në cilin livadh i ke lëshuar delet? – ia ndërpreu fillin e mendimeve Vasili.

Pasi u kthye në banesë, siç u mor vesh me Vasilin, Mirani u soll pothuajse normalish ndaj Sadiut.

Të nesërmën në mëngjes ata u nisën. Me vete po merrnin materiale të shumta: ekzemplarë të Programit e të Statutit të Frontit të Kuq Popullor, të *Bashkimit* e të *Lajmëtarit të lirisë*, etiketa të vogla vetëngjitëse për t’u afishuar më lehtë në Kosovë, të shtypura nga Fronti e të tjera materiale të ngjashme. Për shkuarjen e tyre dinin edhe Fahriu, Demushi e Nazimi. Bile ata i kishin ndihmuar financiarisht.

Transportues i tyre ishte Babai i Nazimit, Ramadani. Ai nuk e dinte se kë dhe pse po voziste. Njihte vetëm Vasilin, por as qëllimin e shkuarjes se tij nuk e dinte. Ai nuk e dinte se kishte material të ndaluar, të fshehur mirë në furgon. Kështu Ramadani po rrezikohej të arrestohej e dënohej me shumë vite burg në Jugosllavi. Ai e dinte vetëm se po i bënte një nder Vasilit dhe shokut të tij. Ishte vendosur që të mos i tregohej

derisa të kthehej për të zvogëluar kështu rrezikshmërinë. Arsyetimi: Meqë nuk po i tregonin, ai do të bënte paraqitje normale në kontrollet kufitare dhe gjatë rrugës deri në Kosovë, pa hetuar gjë policia.

4.

Kur u ndanë, Mirani shkoi te Jusufi e Bardhi. Ata ndërkohë ishin vendosur me banim në Untergruppenbach, një fshat i madh në afërsi të Hajlbronit dhe Shtutgartit. Aty kishin zënë me qira një shtëpi të re, dy katshe e gjysmë, përkatësisht dy kate dhe çati. Shtëpia e sapondërtuar po pranonte banuesit e parë. Në katin e dytë, të cilit gjermanët i thonë kat i parë, përballë përfundimit të shkallëve, ishte një dhomë e vogël rreth dhjetë metra katrore. Këtë dhomë Jusufi e kishte caktuar vetëm për Miranin. Fëmijët kishin filluar të parët t'i thoshin dhoma e Axhit Miran. Pastaj kështu kishin filluar t'i thoshin të gjithë anëtarët e Familjes Gërvalla. Kur Mirani nuk ishte aty nuk hynte njeri, meqë kështu kishte urdhëruar Jusufi. Përgjithësisht shtëpia ishte e mobiluar në mënyrë modeste. Shumë gjëra ishin të përdorura, nga ato që rëndom gjermanët i falin.

Mirani tani po shkonte i gëzuar te Jusufi e Bardhi. Kishin pasur shkëputje të bashkëpunimit e shoqërimit të tyre, por ishin pajtuar në festat e nëntorit. Jusufi kishte dyshuar se mos Mirani po eurvejonte. Për këtë e kishin dezinformuar ca pseudopatriotë dhe informatorë të UDB-së. Si më të dalluar në këto shpifje ishin shquar Nuriu, Xhahili, Proletari e ndonjë tjetër, që Mirani nuk e dinte ende. Kishin ndodhur edhe keqkuptime si ajo lidhur me shkuarjen në Pragë. Veçmas, në përkeqësim të marrëdhënieve të tyre, kishte ndikuar Minushi, i cili ishte në farefisni me familjen që e kishte rritur bashkëshortën e Jusufit, Dritën. Ajo ishte vajzë e falur në familjen Shoshjani. Përmes kësaj lidhjeje farefisnore u bë kontaktimi i Jusufit me Minushin. Familja e Miranit me familjen e Minushit kishin pasur ngatërresa para shumë vitesh në Kosovë. Mirani e kishte qortuar Jusufin se nuk i kishte hije ta afronte Minushin, duke e

sqaruar se nuk ishte kundër për shkak të hasmërisë familjare në të kaluarën, por për shkak të paburrërisë së tij të tanishme.

Ishte mbushur viti dhe tani Jusufi dëshironte ta konkretizonte veprimtarinë e tij të organizuar politike në kuadër të Lëvizjen Nacional-Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi, por ja që udhëheqësi, Sabiti, i cili ishte arratisur në Turqi, ende nuk po e kontaktonte. As nga Kosova nuk po i paraqitej askush në emër të kësaj Lëvizjeje. Megjithatë kishte vendosur ta nxirrte revistën *Lajmëtari i lirisë*, e cila ishte e padefinuar dhe e paidentifikuar. Nuk kishte të evidentuar botuesin, qoftë ai subjekt, qoftë ndonjë individ. Kështu kishte vepruar ai për shkak të shikimit se çdo lidhjeje me organizatën në të cilën ishte anëtarësuar në Kosovë dhe për shkak se kishte vendosur të mos kontribuonte për në nxjerrjen e gazetës *Bashkimi*. Edhe Mirani nuk ishte përpjekur ta nxirrte *Bashimin*, derisa të sqarohet me Jusufin dhe t'i rikthenin marrëdhëniet e mëparme.

U deshën dy-tre muaj që gjithëçka të sqarohet dhe të riktheheshin marrëdhëniet e mëparme ndërmjet Jusufit e Miranit. Jusufi kërkoi nga Mirani shkrimet e grumbulluara për *Bashkimin*. Bëri vetë disa shkrime për të dhe arritën ta përgatisnin në nivel më cilësor, më të mirë se gjithë numrat e mëparshëm, siç i dukej Miranit. Shënimi në ballinë: "Organ i Frontit të Kuq Popullor, Viti i 3-të i botimit, Nr. 1. Janar 1981". U ngutën ta nxirrin në dhjetor kur do shkonin shumë kurbetçarë dhe do ta dërgonin fshehurazi në Kosovë. Atje do të shpërndahej në prag të Vitit të Ri 1981 dhe gjatë janarit 1982.

– Miran, kryeartikullin e këtij *Bashkimi* e kishte shkruar në nivel të shkëlqyeshëm. Më ka pëlqyer jashtë mase, – kishte nisur bisedën e punës Jusufi. – Nuk e kisha të vështirë ta redaktoja si herave të tjera.

– Po ma bënë qejfin? – pyeti tjetri.

– Jo, ti e di se nuk është në natyrën time të ta bëj qejfin. Vërtet më

ka pëlqyer. Ke bërë përparime të mëdha.

– Domëthënë nuk të ka shkuar krejt munda huç! Me përkushtim më ke mësuar se si duhet të shkruaj, – u shpreh ai, duke mos qenë në gjendje ta fshihte vetëkënaqësinë për lavdërimin e sinqertë të Jusufit, – por e kam pasur të vështirë ta kompensoj deficitin e njohjes se gjuhës e stilit, meqë mësuesit në Kosovë i kam pasur të pakualifikuar. Këtë herë kam pasur kohë të mjaftueshëm për ta rishkruar disa herë, sepse hidhërimi yt ndaj meje zgjati shumë dhe gazeta nuk vazhdoi daljen. Sigurisht, meritë të madhe ka redaktimi yt. Po ta kisha botuar siç kam ditur ta shkruaj unë, cilësinë do ta kishte të paktën 50 përqind më të ulët, po të shprehemi me gjuhë matematikore. Gjuha, drejtshkrimi, rrjedhshmëria e qartësia kanë shumë rëndësi dhe këto ti i ke bërë me përkushtim. Unë nuk mund t'i vlerësoj, por më ka pëlqyer shumë sesi e ke redaktuar. Pastaj ke përmirësuar edhe përmbajtjen, sepse kishim të bënim me një si platformë ideore, politike e organizative të organizimit tonë.

– Mos ma rikujto kohën keqkuptimeve ndaj teje! – i tha Jusufi, me ndjenjë keqardhjeje. – Ti u bërë burrë dhe nuk shfaqe hidhërimin të pakontrolluar. Kjo quhet vlerë njerëzore, sepse shoku shokun duhet ta ruaj edhe në kohë keqkuptimesh e hidhërimesh.

– Nuk prish punë, ishte një përvojë e mirë drejt përsosjes së veprimtarisë sonë. Ne nuk kemi pse hezitojmë të bisedojmë për gjithëçka dhe është në natyrën e njerëzve që ndonjëherë të keqkuptohen, të hidhërohen e të prishen. Këto nuk guxojnë të ndodhin në shoqëritë ku mbisundon mendësia moniste se të pret burgu. Në ato shoqëri mbisundon sistemi njëpartiak, prandaj divergjencat e keqkuptimet çmohen si tepër tragjike dhe kanë pasoja të rënda. Edhe ne në atë sistem jemi rritur e edukuar, prandaj divergjencat e keqkuptimet i përjetojmë rënd. Gjykojmë se duhet të mendojmë e të sillemi njësoj. Keqkuptime e zënka ndodhin shpesh edhe në familje, por familjet nuk shpërbëhen aq kollaj për shkak të hidhërimeve e zënkave të çastit. Gjykohet se më i madh është intere-

si që të vazhdohet bashkëjetesa familjare. Edhe në organizimet tona kanë ndodhur dhe do të ndodhin keqkuptime, hidhërimi e zënka. Njerëz jemi dhe jo krijesa ideale. Rëndësi ka mënyra sesi do t'i zgjidhim. Aq më tepër kur dihet se sa do të jenë të interesuara shërbimet sekrete për të penguar punën tonë. Prandaj është e nevojshme, për të mos thënë e domosdoshme, të diskutojmë pa drojë për këtë dukuri që mund ta dëmtojë rënd veprimtarinë tonë...

– Qenke i disponuar për të folur për gjera që i kemi diskutuar për-
cipitazi dikur, por që unë më me ëndja nuk do t'i kisha diskutuar tani! –
ndërhyri Jusufi, pa pritur përfundimin e Miranit.

– Nuk është se jam i disponuar, por është fundi i vitit dhe ne, në një-
farë mënyre, duhet të bëjmë një si bilanc dhe duhet të mendojmë se si
duhet të punojmë vitin e ardhshëm.

– Atëherë po të dëgjoj, ndoshta ma mbush mendjen, se të tilla gjëra
u diskutuakan në kuadër të bilancit vjetor. Mund që pastaj do të inspiro-
hem edhe unë të shfaq mendimet.

– Ta zëmë, ti lavdërove kryeartikullin që kemi shkruar për *Bashkimin*.
Simon Ç., ai i Ambasadës Shqiptare, nëse të kujtohet, më ka thënë se
përmbajtja e *Bashkimit* është tepër ideologjike, se nuk i kemi pasur
parasysh kritikën e tij të mëhershme për të cilat të kam folur. Ai vazhdon
të këmbëngulë, se ne nuk kemi pse të shkruajmë për Enver Hoxhën
dhe ta citojmë aq shpesh atë, as për PPSH–në, për marksizëm-lenin-
nizmin, se nuk duhet të kërkojmë bashkimin e Kosovës me Republikën
e Shqipërisë, meqë dëmtuakemi luftën tonë, se u dashka kufizuar vetëm
në kuadër të kërkesave për barazi nacionale në kuadër të Jugosllavisë e
të tjera. Besoj po më kupton se çfarë po mundohem të të sqaroj.

Mirani u ndal për një çast për të hetuar përshtypjet e Jusufit. Vazhdo-
nte të kishte drojë të thoshte gjithçka që ia diktonte truri. Vazhdonte të
frikësohej se mos po keqkuptohej dhe pastaj do të hidhërohej tjetri. Pri-
shjen me Jusufin e kishte përjetuar shumë rënd.

– Thënë të drejtën, edhe kur më ke treguar herën e kaluar, më pate krijuar dilema e intime, – ia pati Jusufi. – Edhe atëherë kam menduar se kritikata e Simonit duhet të jenë personale dhe jo të Shokut Enver dhe të PPSH-së. Bile, gati i pata shkruar letër Shokut Enver për ato kritika, që ta informoja se çfarë na thoshte një diplomat i shtetit tonë dhe ta pyesja se çfarë do të na këshillonte ai.

– Paska bërë mirë që nuk i ke shkruar. E para, do të dilnim tepër naivë; e dyta, nuk do të merrje përgjigje; e treta, mund që do t'i krijoje shqetësime Simonit, meqë s'do të ishte në gjendje t'ia përcillje informatat siç qenë në të vërtetë kritikata e Simonit. Meqë nuk e kemi regjistruar Simonin, informimi do të merrej si i pasaktë. Ne e idealizojmë në mënyrën tonë Shokun Enver dhe PPSH-në, pa qenë në gjendje ta kuptojmë politikën dhe taktikën e tyre shtetërore dhe kombëtare që t'ia përshtatim ato veprimtarisë sonë. Në vitin 1977 i pata shkruar unë një letër Shokut Enver, por kurrë nuk mora përgjigje.

– Ti vazhdon të dyshosh se ne nuk jemi të përcaktuar si duhet ideopolitikisht dhe se nuk jemi në gjendje t'i zbërthejmë mësimet e Shokut Enver për çështjen tonë? – pyeti me habi Jusufi.

– Sigurisht që kam dilema. E si duhet t'i kuptoj unë kritikata, ndonjëherë fare pa takt, të Simonit, i cili duket se ka autorizim prej Enverit. Përndryshe, nuk do ta linin në atë funksion. Pastaj, më kupto, unë po e kam të vështirë ta përballoj sarkazmën e kolegëve gjermanë kur po u them se ideologjia dhe politika e Enver Hoxhës është e drejtë, se ai është klasiku i 6-të i marksizëm-leninizmit. Sikur t'i kisha sjellë të gjitha variantët që kam shkruar gjatë përpunimit të kryeartikullit të këtij *Bashkimi* do t'i kishe konstatuar dilemat dhe vështirësitë që kisha për këto çështje. Sa i përket mënyrës së organizimit tonë, në këtë kryeartikull nuk kemi pothuajse asgjë origjinale, të përshtatur për rrethanat konkrete, por duket se është vetëm një si kopjim i mënyrës së organizimit në Republikën e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Edhe pluralizmi orga-

nizativ që e kemi trajtuar në kryeartikull ngjanë me pluralizmin e viteve të pasluftës, por të cilin, ku e di unë përse, e shndërrovan në pluralizëm formal. Masat e gjera u organizuan në Front, rinia në organizatë të tyre, gratë gjithashtu në të tyren, punëtorët në sindikata, komunistët në Parti Komuniste, përkatësisht në Parti të Punës. Kjo e fundit u bë kapuç mbi të gjitha. Dhe pikërisht ky lloj kopjimi po e shqetëson Simonin. Ndonjëherë po na kritikon me nervozizëm, meqë ne nuk po dimë t'i zbërthojmë kritikën e tij. Ai po mendon se ne nuk po duam dhe nuk po ia varim. Po s'më besove do t'i them që të bisedojë me ty.

– Na u dashka të mendojmë më me përkushtim për këtë, sidomos tani kur kanë dalë në skenë edhe shokët e Organizatës së Marksistë-Leninistëve të Kosovës, ose siç po i thonë shkurtimisht: OMLK. Ata po mendojnë pothuajse njësoj si ne. Sapo të marrim kontakt me ta do t'i diskutojmë këto çështje bashkërisht. Ata duket se janë shumë herë më të përgatitur se sa ne. Ta lëmë tashti këtë temë për një herë tjetër.

– Mendon, pra, se duhet të bisedojmë për gjendjen organizative dhe veprimtarinë tonë? – pyeti Mirani.

– E po kjo është temë më konkrete për të cilën ia vlen të bisedojmë, – tha Jusufi.

– Cili po e fillojmë raportimin se si e kemi gjendjen organizative dhe të veprimtarisë?

– Po filloi unë edhe pse nuk jam i informuar sa ti. Ti po merresh më intensivisht me veprimtri praktike, kurse unë nuk po mund të dal shumë nëpër bashkatdhetarë dhe ende nuk kam udhëzime të Organizatës për strukturim konkret.

Në Shtutgart me rrethinë kemi krijuar një bërthamë të bashkatdhetarëve që e përbëjnë Nuriu, që ti po i thua Qeros, Fahriu, Vasili, Nazimi, Sheremeti dhe disa të tjerë rreth tyre. Nuriu po tregohet më superior, prandaj po mendojmë ta bëjmë atë udhëheqës të kësaj bërthame. Në Nürnberg kemi Maksin dhe Bacën Çelik, atë plakun e mrekullueshëm

nga rrethi i Dibrës. Në Mynhen po mundohemi të depërtojmë përmes Minushit. Interesimi është rritur, por ende nuk kemi filluar të anëtarësojmë. Një pjesë e tyre janë simpatizantë të Frontit, kurse për mua e dinë se nuk jam i organizuar në Front. Në pjesën Perëndimore, atje ku je ti, po bashkëpunoj me Proletarin e Xhahilin, të cilët po më shkruajnë e po më vizitojnë. Nxorëm dy numra të *Lajmëtarit të lirisë*, të cilët janë shpërndarë e mirëpritur. Ne fillim u fol se ti po e sabotoje shpërndarjen, por Vasili, Fahriu e Maksi më kanë sqaruar se janë vetëm shpifje dashakeqe. Tani, meqë po e nxjerrim *Bashkimin* në dhjetë mijë ekzemplarë, duhet të fillojmë shpërndarjen e tij. Natyrisht, vetëm pasi të jetë shpërndarë në Kosovë, siç u morëm vesh. Po ta shpërndajmë përpara këtej, UDB-ja do të marrë masa shtuese për pengim të futjes dhe shpërndarjes së fshehtë në Kosovë.

Mirani gjithë kohën dëgjoji me vemendje dhe po priste të dëgjonte edhe më, por meqë Jusufi mbaroi raportimin, ai filloi: – Edhe ne kemi përparuar shumë. Epiqendrën e veprimtarisë patriotike e kemi në Dyzeldorf. Aty klubi “Emin Duraku” është forcuar shumë. Numri i anëtarësisë ka shkuar mbi treqind veta, kurse frekuentimet nga bashkatdhetarët e rretheve të tjera janë rritur shumë. Aktivitetet kulturore janë të shumta. Shumica e tyre janë simpatizantë të organizimeve tona. *Bashkimi* dhe *Lajmëtarit i lirisë* janë shpërndarë hapur në Klub dhe artikujt e tyre janë lexuar e diskutuar publikisht. Kjo formë e organizimit legal po tregohet shumë e suksesshme dhe aty janë vetëdijësuar shumë patriotë, të urtë, modestë dhe shumë të angazhuar. Momentalisht jemi të ballafaquar me vështirësi. UDB-ja ka arrestuar në Kosovë disa veprimtarë të Klubit kur ata shkuan për pushime në Kosovë. Momentalisht disa veta janë frikësuar dhe nuk po e frekuentojnë Klubin. Në kryesi po diskutohet se si duhet ta përballojmë këtë situatë, sepse konsullata jugosllave dhe adashi yt, i atashur këtu si korrespondent i gazetës “Rilindja”, kanë shtuar presionin dhe shantazhimin ndaj Klubit.

Pastaj, pengesa serioze kemi nga Proletari, Xhahili dhe ndonjë i ngjashëm me ta. Ata po na kritikojnë nga bazat dogmatike, sikur ne jemi revizionistë e etiketime të ngjashme sikur ne nuk po i zbatuakemi mësimet e Shokut Enver e të PPSH-së, sado për gjëra të tilla ata nuk kanë as edhe një lugë tru.

Edhe në Bielefeld është duke u organizuar një rreth, ku fatkeqësisht po dominon Xhahili, por jemi duke u munduar ta anashkalojmë.

Në Mynhen jemi duke u përpjekur të marrim Klubin "Rilindja". Ai vazhdon të jetë nën tutelën e konsullatës jugosllave. Aty ka qëlluar djali i Dajës Ramadan, Garipi, kryetar, për të cilin ke dëgjuar. Janë edhe dy të tjerë si ai që bëjnë çfarë u thotë konsulli dhe drejtori i përfaqësisë së Eximkos-it, një malazez që po keqpërdor pasurinë e Kosovës për interesa të tij personale, për dëgjenerim dhe politikë serbomadhe. Aty është një treshe që i merr udhëzimet nga konsullata, ndërsa kur janë në Klubin "Rilindja" shajnë njëri-tjetrin për udbashë, që t'i iritojnë e dezorientojnë anëtarët e Klubit. Këtë taktikë të tyre bashkatdhetarët nuk po e kuptojnë, prandaj vazhdojnë të votojnë njërin nga këta të tre, që do thotë se ata po e riciklojnë njëri-tjetrin. Atje po na prish punë ai farë aventurieri, Minushi. Unë nuk kuptoj se përse ti po e afron këtë farë Minushi, i cili po të komprementon. Nuk po të kuptoj përse po e afron Proletarin e Xhahilin, kur ata jetonë në rrethin tonë dhe ne jemi gëzuar që i kemi izoluar. E njëjat vlenë edhe për Nuriun.

Në Berlin e Hamburg kemi gjetur bashkatdhetarë të gatshëm për t'u angazhuar dhe kemi filluar ta organizojmë bërthamën patriotike.

Në Bruksel kemi kontaktuar shumë bashkatdhetarë, prej të cilëve shumica janë të shpërngulur nga Kosova në Turqi dhe prej andej kanë ardhur si emigrantë ekonomikë. Kjo po na ndihmon shumë, sepse ata nuk po frikësohen, meqë kanë shtetësi turke dhe nuk shkojnë në Kosovë. Atje po ngrihet një vatër e fortë patriotike. Emrat e veprimtarëve të bërthamës së tanishme patriotike do t'i mësoh vetë kur do të kemi

rast të shkojmë për vizitë. Do të befasohesh sidomos për burrërinë, patriotizmin e angazhimin e dy veteranëve të Luftës së Dytë Botërore në Maqedoni, të cilët kanë qenë të shquar në luftimin e pushtuesve partizanë, maqedonas e serbë. Ata pastaj kanë qenë të angazhuar përkohësisht në Lidhjen e Dytë të Prizrenti, të udhëhequr nga kolaboracionisti i nazistëve gjermanë, Xhafer Deva. Bile vëllai i madh, Xhelë Kalishti, ka qenë kryetar i kësaj organizate në Bruksel, derisa ia ka kuptuar hilet Xhafer Devës dhe sejmënëve të tij. Tani kanë kaluar në anën tonë dhe po angazhohen me përkushtim. Baca Hysen shquhet për trimëri, prandaj reaksioni që kontrollohet nga UDB-ja po ia ka frikën. Por edhe atje po sabotojnë. Enver Hadri, për të cilin me ke folur se nuk duhet të jetë shqiptar i mirë, Musa Hoti, Vebi Ibrahimimi e të tjerë, sigurisht edhe njerëz të “Mërgatës së qyqeve”, meqë e ke lexuar romanin e Nasho Jorgaqit.

Në Kopenhagen e në Malme jemi duke vënë bazat fillestare. Në Kopenhagen mërgata përbëhet kryesisht nga tetovarët dhe nuk e beson se sa patriotë dhe të ngritur që janë.

Në Zvicër kemi qenë shumë herë me Vasilin. Atje kemi krijuar bërthamat e para patriotike në Zürich, Gjenevë e Luzanë. Patriotë si Rexhep Halimi, i cili njihet me emrin Rexha në Zürich, Shyqa në Gjenevë dhe të tjerë janë angazhuar me energji të madhe patriotike. Mendoj se atje kanë grupim të simpatizantëve shokët e OMLK-së, por ata janë në ilegalitet aq të thellë sa asnjëri nuk di për veprimtari të tyre dhe nuk e ndjen drejtpërsëdrejti.

Edhe në Austri e Francë kemi qenë dhe po krijojmë bërthama patriotike.

Ju në rrethin e Shtutgartit nuk do të mund të përparoni derisa t’ju imponohet Nuriu si udhëheqës i rrethit. Ai është element trubullues dhe për mendim timin është informator i UDB-së.

Nëse nuk e teprava me këtë paraqitje telegrafike, po vazhdoj për të shtuar edhe ca gjëra.

– Vetëm vazhdo. Po më duket interesant informimi yt dhe disa vlerësime, – u përgjigj Jusufi, i cili tashti kishte marrë pamje serioze dhe po dëgjonte me vemendje të përqëndruar duke mbajtur edhe shënime të shkurtëra.

– Me gjermanë ende nuk kemi kontakte që do të na hynin në punë për të na kuptuar e për ta ndihmuar lëvizjen tonë. Këta të Partisë Komuniste Gjermane po interesohen të marrin kontakt me ne, por kam krijuar përshtypjen se janë të interesuar vetëm për anëtarësim të aktivistëve tanë në Parti të tyre sa për t’ua zhvatur kuotën e anëtarësisë që është goxha e lartë. Pastaj, ata po mendojnë sipas motos marksiste, “proletarët nuk kanë atdhe” dhe na thonë: si proletarë që qenkemi, duhet të inkuadrohemi në revolucionin e këtushëm socialist. Angazhimi ynë për të çliruar Kosovën nga pushtimi serb atyre u duket i pavend, romatizëm nacional dhe në interes të borgjezisë ndërkombëtare. Në disa takime që kemi pasur nuk jemi marrë vesh pothuajse për asgjë dhe kanë filluar të na urrejnë. Sidoqoftë, ata nuk kanë ndonjë ndikim në politikën gjermane që të na ndihmojnë në luftën tonë çlirimtare. Në radhët e kësaj Partie janë aktiv Xhahili e Proletari dhe jemi dakord që t’ua falim për fare.

Me pozicionin që kam në Kryesinë e Lidhjes së Studentëve, që këtu shkurt e quajnë AStA, po përpiqem t’i informojë dhe t’i bind për përkrahje. Kjo është me perspektivë. Ndonjë student i tanishëm mund të bëhet personalitet në të ardhmën. Traktin e 1 Majit, që e patëm shkruar bashkarisht në gjuhën gjermane, e kemi shumëzuar në tridhjetë mijë copë dhe e kemi e shpërndarë në demonstrata, marshe e protesta, pothuajse në të gjitha metropolët e Evropës Perëndimore. Të njëjtin e patëm përkthyer edhe frëngjisht e anglisht. Kështu bëmë edhe me traktin që e shpërndamë në demonstratën e tetorit për paqen, në Bonn, ku ishin të pranishëm mbi 300 mijë veta.

Unë do të them edhe dy-tri fjalë për të ardhmen. Tani ne gjendemi para një paqartësie se si duhet të organizohemi konkretisht. Kanë fillu-

ar zërat se këta e ata janë të Frontit ose të Lëvizjes. Fronti pati ndërprerë që në fillim anëtarësimin klasik. Ne po ia grahim popullorçe, ndërsa disa, si Proletari e Xhahili, po na thonë se po veprojmë bashibuzukçe. Ju të Lëvizjes ende nuk keni vendosur asgjë konkrete. Po më habit duri mi yt për të pritur kontaktimin me Sabitin dhe udhëzimet nga ai për të cilin më the me nënkuptim prej të pakënaquri se ende nuk të ka kontaktuar. Mua po më duket se diç nuk është në rregull me qëndrimin e tij, por as tëndin. Kam filluar të dyshoj se ai të ka manipuluar ty edhe në Kosovë. Atje asgjëkundi nuk duken gjurmët e veprimtarisë së Organizatës suaj. Besoj është koha që të vendosësh diç konkretisht, sepse bashkatdhetarët e angazhuar po fillojnë të flasin për njëfarë konkurrence midis nesh. Kjo ka ndodhur sidomos kur ju nxoret *Lajmëtarin e lirisë*. Edhe pse revista ose buletini, nuk e di si duhet t'i them konkretisht, u ka pëlqyer shumë, nuk kanë hezitur të pyesin me habi se a duhet të shkojnë pas *Bashkimit* apo pas *Lajmëtarit të lirisë*. Kanë shkuar aq larg, sa disa bashkatdhetarë që janë të lidhur ngusht me botimin e *Bashkimit*, kanë propozuar që të ndalet botimi i tij, derisa të merremi vesh për një gazetë të vetme. Prandaj, me gjasë, ky do jetë numri i fundit që botuam, për të pritur bashkimin e organizimeve tona dhe botimin e një gazetë të vetme, që të mos krijohen këto hutë.

Miranit u ndal dhe po mendonte nëse kishte folur tepër. Po i përzi-heshin kureshtja dhe droja se çfarë do të thoshte Jusufi për disa vlerësi-me të tij. Por Jusufi vazhdonte të heshtte. Pas disa çasteve nisi ngadalë.

– Miran, me gjasë të lazdroma në fillim kur ta lavdërova kryeartikullin e *Bashkimit*. Pastaj fole me një kompetencë që nuk e ke. Shumë informime e vlerësime ishin të mira, por përdore edhe përgojime ndaj disa bashkatdhetarëve. Më bëri përshtypje të keqe përgojimi i Nuriut, Xhahilit, Proletarit e Minushit. Sidomos përgojimin ndaj Nuriut e kontestoj vendosmërisht. Atë po e përgatisim për përgjegjës të rrethit të Shtutgartit. Edhe ai të ka përfolur ty, se je një ekstravagant, me xhinse e

flokë të gjata, i padisciplinuar, anarkistë e etkitime të ngjashme. Bile më pat thënë se ti kishe sabotuar shpërndarjen e *Lajmëtarit të lirisë* në Dyzeldorf. Për këtë të fundit jam sqaruar se kishte qenë shpifje. Dhe kur e qortova Nuriun pse kishte shpifur ai u arsyetua se ashtu i kishin thënë disa bashkatdhetarë që gravitojnë në Klubin “Emin Duraku”. Atë e kam qortuar edhe ty po të qortoj dhe po të këshilloj që ta ndërpresësh këtë praktikë, sepse nuk na ndihmon dhe nuk të nderon. Për Shokun Sabit, pavarësisht se jam i pakënaqur që nuk po më kontakton, nuk dëshiroj të më flasësh keq. Edhe pseudonimin “Rrobaqepës” po e përdor në mënyrë denigruese, nga bazat e mendjemadhësisë intelektuale. Edhe ato që the për organizatën tonë, shpresoj të mos i kesh thënë ndokujt dhe të mos flasësh në të ardhmen gjëra të ngjashme. Në Kosovë organizatën e kemi në ilegalitet të thellë, por e ka ndikimin e madh. Kështu më ka thënë Shoku Sabit dhe unë i besoj atij. Dilemat për mënyrën e organizimit tonë në të ardhmen janë të arsyeshme, sepse mënyra që po praktikojmë tani këtu nuk është e njohur në histori të lëvizjeve çlirimtare. Jemi të organizatave të ndryshme dhe bashëveprojmë si të ishim të njëjtës organizatë. Sa u përketë komunistëve gjermanë nuk di çfarë të them, meqë ende nuk kam kontakte. Një komunist gjerman në Shtuttgart, që e di shumë mirë gjuhën shqipe, mezi pranoi të na e korigjonte përkthimin e traktit për demonstratën paqësore që u mbajt në Bonn. Na prit shumë ftohtë. Prit, po më kujtohet se të ai ishim së bashku me ty e me Bardhin. Bile pati vërejtje për përmbajtje të traktit, ngaqë iu duk tepër kombëtar.

Të shoh për çfarë pike tjetër kam mbajtur shënim. A po, për Klubin “Emin Duraku”. Për të meriton të flitet edhe më gjatë, por mos rrah gjoks se është meritë vetëm jotja. Aty kam takuar patriotë shumë të zgjuar. Fatkeqësisht, në rrethin tonë nuk po mund të bëjmë një klub as të përfaqëtojmë, sepse disa individë kanë fërkime midis tyre. Për rrethe e shtete të tjera nuk nuk jam i informuar, por posa të marr dokument

udhëtimi, do t'i vizitojmë.

Për bashkëpunim me emigracion politik shqiptar, kryesisht reaksionar, nuk fole gjë. Ndoshta vazhdon t'i kesh mendimet e mëhershme se ai emigracion kontrollohet nga shërbimet e ndryshme sekrete dhe kryesisht nga ato jugosllave. Edhe për bashkëpunim me emigracionin kroat nuk thë gjë. Unë kam dëgjuar se po bashkëpunon shumë ngjeshur.

– Më jep pak leje të përgjigjem. Unë kisha idenë të bisedonim shtruar për gjendjen dhe për të ardhmen. Mendoja se ishim duke folur në nivel tjetër nga ai çfarë ti flet me Nuriun, Xhahilin, Proletarin. Tashma duhet të kesh konstatuar se nuk rezervohem në bisedat me ty. T'i them gjërat si i mendoj dhe si i ndiej. Nuk ndruhem më se do të prishemi prapë, po nuk ia qëllova ose po gabova. Ty të mungon përvoja që t'i njohësh njerëzit, meqë nuk i ke kontaktuar aq dendur dhe përgjithësisht i idealizon si punëtorë që janë. Unë kontaktoj me mijëra dhe vazhdimisht jam në lëvizje. Në mungesë të strukturave dhe aftësive për të bërë survejime, gjë që duhet bërë në mënyrë profesionale në të ardhmen, më është zhvilluar intuita për t'i lexuar tipat që nuk bëjnë. Nuriu e ka hetuar se unë e kam zbrërthyer se cili është, prandaj më përgojon. Unë thjesht po bëj vlerësim për të. Dhe kjo ka dallim. Ai është pësjtjellaçi kryesor që po pengon themelimin e një klubi në Shtutgart ose Sindelfingen. Nga ai po largohen patriotët e interesuar që të na qasen, sepse ia kanë frikën. Për Xhahilin dhe Proletarin të kam folur më herët. Unë nuk kam ndonjë arsye personale për mëri ndaj tyre, por i kam dëshifruar se janë elementë që bëjnë dëm. Kur bëjmë analiza, ne duhet të mos rezervohemi ta themi mendimin për secilin që pengon mbarëvajtjen e veprimtarisë sonë. E dëgjove, nuk e kurseva as djalin e dajës në Mynhen.

Pastaj, me takimin që ke pasur me Sadi Balajn, ia ke hapur derën të na futet. Atij i është mundësuar të vizitojë shokët tanë. Ai po i përvetëson e manipulon ata çdo herë e më shumë. Bredh gjithandej, luan bixhoz e kapërdiset, pastaj na shfaqet si një patriot i kulluar. Sigurisht që ai

do të na shkaktojë ndonjë fatkeqësi, sapo të jetë infiltruar në rrethet tona thellë e më thellë...

Këtu Mirani Mori frymë, meqë pati dilema nëse duhej t'i tregonte Jusufit se Sadi Balaj tashmë e kishte mashtruar Vasilin dhe ish-in në rrugëtim për në Kosovë. Megjithatë vendosi të mos i tregonte, meqë i ishte përbetuar Vasili.

Për Sabitin nuk do të flas më, por vetëm të kisha lutur të shkundesh nga adhurimi për të. Nuk të shkon, të pengon të gjykosh e të vendosësh drejt lidhur me moskontaktimin e tij. Ai po të mban peng tash një vit.

Emigracioni i ashtuquajtur reaksionar shqiptar vazhdon të jetë po ai. Sikur të ishte vërtet emigracion reaksionar vetëm në aspektin ideologjik, por i përcaktuar vërtet kombëtarisht, do të qe me dobi. Shumicën sy-rësh i kanë kaparisur shërbimet sekrete, për të rekrutuar diversantë që t'i fusin në Republikën e Shqipërisë. Për Kosovën atyre as që u bie ndër mend. E përmendin ndonjëherë vetëm sa për të bërë radhën kur takohen me njerëzit nga Kosova. Sa për konkretizim, kam takuar edhe Muharrem Bajraktarin, komanduesin e vrasësve të Bajram Currit. Nuk të besohet po ai ndihej krenar për atë krim. Kur i thashë se për këtë është paguar nga Mbretëria jugosllave, u arsyetua: "Mbretëria jugosllave është demokratike, kurse Bajram Curri ishte komunist dhe e meritonte plumin!" U egërsova sado që isha në klubin që frekuentohej nga ajo sortë. I shava me nënë e babë. Ia përplasa tavolinën në gjoks atij kriminel, siç qemë ulur ballë për ballë. Nuk ia vlen të merremi fare me mërgatën e ashtuquajtur reaksionare, sepse as në Belgjikë nuk kanë më ndikim. Janë disa plakushë të shkretë, të cilëve as fëmijët e tyre s'u venë mbrapa.

Sa i përketë emigracionit kroat besoj kemi biseduar, nëse të kujtohet. Ai është emigracion me spektër të gjërë. Nuk kam hetuar të kenë organizim ekstremistë, të majtë ose të djathtë. Janë patriotë të angazhuar maksimalisht. Ata kanë përvetësuar pluralizmin e demokracive perëndimore. Megjithatë, Perëndimi nuk po i përkrah, meqë qeveritë perëndi-

more përkrahin vetëm pushtetin jugosllav. Dihet përse. Vetëm naivet mendojnë se Perëndimi të përkrah nëse je demokrat. Qeveritë e Perëndimit dhe gjetiu përcaktim parësor kanë interesin e tyre shtetëror. Bie fjala ato më shumë e përkrahin Jugosllavinë, që ka sistem monist, se Turqinë që ka sistem pluralist. Unë kam shkuar në tubime e në demonstrata të kroatëve, sepse shumë studentë kroatë i kam kolegë e miq dhe, përpos që kam shkuar për hatër të tyre, kam shkuar që të mësoj se si duhet të organizohet emigracioni ynë dhe të krijojë urëlidhjeje ndërmjet nesh.

Tani, po pate durim të më dëgjosh, po t'i shpaloj ca vlerësime të nxira.

Ai priti reagimin e Jusufit dhe meqë tjetri vazhdonte të mbante qëndrim të të interesuarit vazhdoi:

– Unë nuk jam në gjendje t'i shpreh mendimet e sistemuara. Tani me ra ndërmend se duhet të bëj edhe ca vlerësime që dukje janë të errëta, dëshpruese, por ne duhet të jemi realistë. Për gjithë sa diskutuam, na del se deri tani nuk i kemi as pesëqindë aktivistë e simpatizantë në gjithë Perëndimin. Ndërkaq emigrantë ekonomikë në shtetet perëndimore dhe në Zvicër duhet të kemi mbi njëqind e pesëdhjetë mijë veta. Nga këta pesëqindë, të interesuar për t'u angazhuar me ndërgjegje të lartë patriotike e çlirimtare nuk i kemi as dyqindë veta. Të informova se Klubi "Emin Duraku" ka mbi treqindë anëtarë, por, do ti që as dhjetë vetave nuk u shkon ndër mend të ndihmojnë financiarisht, qoftë edhe vetëm me nga dhjetë marka në muaj, për *Bashkimin* dhe të për materiale të tjera propagandistike. Unë përdor një si kriter vlerësimi nivelin e vetëdijes dhe të ndërgjegjësimit të tyre për aq sa e kanë gatishmërinë për të dhënë ndihma financiare...

– Vërtet vlerësime dëshpëruese e të errëta... – ndërhyri tjetri.

– Mos po mendon se po e nxiros më shumë se sa është në të vërtetë? Po, ti vetë, a nuk po i jep ndihmat e socialit, që t'i jep shteti për ushqim

të familjes, për të paguar shtypin e *Lajmëtarit të lirisë*? Po ia merr edhe Bardhit të gjitha të hollat për të financuar veprimtarinë tonë patriotike. Sa herë më ka rastisur të hamë këtu gjellë pa mish nga që nuk iu dalin të hollat. Këto nuk kemi pse t'ia fshehim vetës. Sa herë më ka rastisur të mos kem as bukë dhe jam mjaftuar me lëmoshat e kolegëve gjermanë. Unë nuk jam i dëshpëruar dhe as i hidhëruar, por ky është realiteti dhe duke e ditur këtë mund të bëjmë planifikime më realiste. Duhet të mos rrëzohemi si devja e anekdotës nga mbingarkimi me një lëkurë lepuri. Unë e di se bashkatdhetarët i fitojnë të hollat me djersë e vuajtje. I kursejnë me sakrificë dhe i shpenzojnë edhe për të ndërtuar shtëpi në Kosovë, më të mëdha sesa nevojat e mundësitë. Për inat të fqinjit blejnë toka me çmime të fryra, të cilat pastaj nuk i punon njeri. Shëmbull tipik për këtë e kemi këtu, çunakun, pothuajse adoleshent, Hafif Gagajn, i cili e ka babanë në Ludwigsburg. Hafifi erdhi te babai i tij dhe tani po hyn në vitin e nëntëmbëdhjetë të moshës. Si shumë fëmijë të emigrantëve, ai erdhi i llastuar nga Kosova. Babai ka bërë punë të rënda, i ka kursyer të hollat me sakrificë, për t'ia dërguar gruas dhe fëmijëve në Kosovë. Meqë Hafifi është djali më i madh i ka bërë rrush e kumbulla të hollat e babai. Vetë Hafifi, me lazdrimllëk e krenari sharlatane, na ka treguar shumë herë se po të mos ishin markat e babait nuk do të merrte nota kaluese në shkollë. “Me marka kam blerë mësuesit për të më dhënë nota kaluese.” – na thoshte. Kështu e ka mbaruar shkollën e mesme në Gjilan. Tani Babai i tij lut Bardhin që të përkujdeset për të birin, që mundësisht të vazhdojë shkollimin në Gjermani. Hafifit nuk i intereson shkollimi, por sorollatje dhe ju tani lodheni kot me atë dështak...

– Më fal për ndërhyrje, por po flet për gjera të imta, – ndërhyri Jusufi. Veprimtaria jonë është e madhe, është e suksesshme. Gjithandej në Kosovë po flitet për veprimtarinë tonë, e cila atje ka ngjallur shpresa. Këtë ndikim e sukses e dëshmon më se miri tërbimi i armikut. Ai po arreston në Kosovë kuturu vetëm për të përhapur frikë dhe për të gjetur kanalet

e fshehta të shkuarjes se materialeve tona propagandistike. Armiku po e sforcon luftën kundër nesh edhe këtej. Vërtet ne nuk jemi shumë të fuqishëm sot, por nësër do të bëhemi, prandaj armiku shpenzon kaq shumë për të na luftuar. Atij po i humb kontrolli mbi punëtorët tanë. Vërtet punëtorët nuk po e ndihmojnë tani veprimtarinë tonë patriotike, por do ta ndihmojnë nesër. Ne po heqim keq për të financuar veprimtarinë tonë, por nesër ky ndërgjegjësim i tyre, tani në embrion, do të jetë më i madh dhe kështu do të rritet vetëdija e tyre edhe për sakrificë financiare dhe fizike. Sakrificat që po bëjmë ne është madhështia jonë. Aty ku fitohet, janë titistët dhe udbashët. Sa për informim, unë pata huazuar të holla nga ca shokë për të blerë makinë radhitëse për faqosje më të mirë të shtypit tonë. Kjo ka ndodhur tani dhe do të ndryshojë për mirë nesër. Kjo bindje na jep forcë se përkushtimi e sakrificat nuk do të na shkojnë huç. Rëndësi ka tani që ta organizojmë futjen e *Bashkimit* dhe të *Lajmetarit të lirisë* në Kosovë, sepse Kosova po zien. Kjo është puna konkrete që duhet të bëjmë.

Jusufi mendoi se e tha fjalën përmbyllëse të kësaj bisede, ndaj palosi fletën e shënimeve. Ndoshta ishte edhe sinjal për Miranin se biseda ishte mbyllur.

Mirani bëri sikur nuk po kuptonte ndaj mori fjalën:

– Unë mbajta mend dy pika dhe dua të ta them pikëpamjen time. The se armiku po e sforcon luftën kundër nesh. Si dhe ku? Si po mbrohemi ne? Nuk na ka ndodhur dhe nuk do të ndodhë të dalë ndonjëri të na thotë: “Ruhuni nga unë se jam në shërbim të UDB-së, po shpif e përflas sepse jam udbash”, etj. Ne zbuluam veprimtarinë e Rezil Mejtëpit, e demaskuam dhe e diskredituam atë. Tani ai nuk shihet gjëkund dhe mendojmë se e kemi izoluar ose se e kemi frikësuar sa ai të mos merret më me veprimtari kundër nesh. Por, unë mendoj se ai ka ndërruar vetëm metodën dhe mund të jetë bërë edhe më i rrezikshëm. Pastaj kemi raste të vështira si ai i Sadi Blakajt, i Nuriut e i Xhahilit. Ne jemi

përpjekur t'i demaskojmë e izolojmë ata, kurse ata vijmë dhe lidhen me ty, meqë kanë gjetur një intelektual që nuk ka përvojë t'i dëshifrojë. Ndonjëherë më të dëmshëm sesa udbashët e kamufluar janë disa ahmakë e degjenerikë si Proletari, Minushi, Hafifi e të ngjashëm. Përshtypje të hidhur më ka lënë edhe ai studenti që po e prezantoni me emrin *Skënderi*. Nuk e kuptova se si ka ardhur të punojë këtu për pushime verore dhe ka vënë kontakt të ngushtë me ju, pa e pas njohur ju atë përpara? Tani ai ka shkuar në Kosovë dhe nuk i ka ndodhur gjë, edhe pse takimet me të i kishim gjysëmpublike dhe në prani të shumë vetave. Dytë takime që kishim me ata studentë që patën ardhur për punë gjatë pushimeve verore, meqë Bardhi ua kishte gjetur punën, ma tërhoqi vemendjen pikërisht surrati i Skënderit, për të cilin ti po shpreson, se do të bëhet kuadër i mirë i lëvizjes sonë çlirimtare. Pika tjetër është situata në Kosovë. Shtrohet pyetja: Mos po shpërthen pakënaqësia dhe po na gjen të papërgatitur? Ne kemi shkruar në kryeartikull të *Bashkimit* se organizata që do ta udhëheq revoltën duhet të jetë e formuar përpara se të ndodh shpërthimi i saj. Pas shpërthimit të revoltës do të jetë e pamundur për të formuar një organizim të suksesshëm që do ta udhëhiqte popullin. Në këtë drejtim jemi mbrapa. Atje patriotët e organizuar duhet të veprojnë në ilegalitet të thellë dhe e kanë të vështirë të njihen, të lidhen e të bashkohen. Mundësitë më të mira i kemi ne kënde, por nuk po na ecën puna. Para sa kohe ishte për një blic-vizitë tek unë në Bochum një ilegal, siç po u thuhet, një thatim që me tangarllëk më kritikoi se nuk qenkam komunist, se Fronti nuk ka organizim të rrebtë revolucionar, nuk është konspirativ e të tjera. Nuk më tregoi se cili ishte, sado thoshte se më njihje, m'i njihje vëllezërit e shokët në Kosovë. Në fund më tha: "Po të vrojtojmë për të ndikuar që të bëhesh komunist i disiplinuar. Pastaj do të të pranojmë në radhët e organizimit tonë". Pandeha se mos ishte i OMLK-së. Ia thashë edhe unë ca llafe, se nuk po më pëlqente mënyra e vizitës se tij, mosprezantimi dhe kërkesat e tij

që unë të disiplinohesha sipas arshinit të tyre. Më foli shumë mirë edhe për ty dhe më tha se edhe ti po u vrojtuaqe prej tyre, por po të vlerësonin vetëm për enverist dhe jo edhe për marksist-leninist. Në fund më bëri me dije se do të na kontaktonin e vizitonin për të biseduar rreth riorganizimit të mirëfilltë. Vizita e tij më bëri kureshtar, më dëshpëroi dhe më gëzoi njëkohësisht. Ne këndej i kemi kushtet më të mira që të ndihmojmë lidhjet dhe bashkimin e të organizuarve në Kosovë. Por, ne jemi bllokuar, sepse ti po vazhdon të mbahesh peng nga udhëheqësi yt, Sabiti. Unë mendoj se ti nuk duhet të vazhdosh kështu. Në këtë gjendje e kemi të vështirë zgjerimin e radhëve. Sa i përketë angazhimit të aktivistëve tanë për t'ua prishur koncertët që po i organizon shteti jugosllav me këngëtarë e valltarë, kam harruar të ta tregoj një letër që m'u dha kur u ndërpre koncerti në Hilden, qytezë në afërsi të Dyzeldorfit. Duhet ta kem në çantë. Them ta lexosh pastaj.

Tani Miranit iu duke se kishte folur mjaft, madje tepër. Edhe këtë herë po e mundonte dyshimi për metodën e bisedimit, të shfaqjes së mendimit dhe të argumentimit. Atij iu duk se Jusufi ishte thelluar në mendime ndaj do t'i duhej ta priste më gjatë. Letrën e palosur ia la mbi tavolinë.

– Besoj, – nisi tjetri, – kësaj radhe biseduam mjaft. Nuk kemi nevojë të ngutemi. Kemi bërë punë të mirë që i kemi shtruar gjërat në krye-artikull dhe tani duhet të mendojmë për anën praktike. Sigurisht, shokët e *Lirisë*, (kështu i quajti aianëtarët e OMLK-së), do ta lexojnë dhe do të na paraqiten. Të shpresojmë se mendimet tona do t'u pëlqejnë edhe atyre. Nuk kemi kohë që të presim, sepse mund të shndërrohemi në spektatorë të ngjarjeve. Ato mund të bëhen tepër dinamike për të qenë ne në gjendje t'i përcjellim e lëre më t'i kanalizojmë e udhëheqim.

Pasi mbaruan bisedën dolën së bashku në dhomë të ndenjës. Dardana i kërkoi Jusufit të këndonte. Ai e kishte pikë të dobët atë dhe,

edhe po të mos i këndohej fare, nuk ia prishte.

5.

Pas një pushimi Jusufi Gërvalla shkoi në dhomën e punës dhe zuri të lexonte letrën që ia dha Mirani.

“Shumë i respektuari dhe i nderuari, Shoku Miran!

Kur më caktuan të merrja pjesë në grupin që vinte të jepte koncerte në Gjermani u gëzova shumë. Më beso, më shumë u gëzova për mundësinë të të takoja ty, sesa për mundësinë që po më jepej për të vizituar Gjermaninë. Për ty po flitet shumë në Kosovë. Mua konkretisht më ka folur një i afërm imi që gjendet si emigrant ekonomik në Dyzeldorf, i cili shpresoj të ta japë këtë letër.

Ky gëzim që kisha para ardhjes këtu më është shkatërruar barbarisht. Para nisjes pata shpresuar se do të bëhesha shoqja jote duke e bashkuar jetën me ty, për të të ndihmuar në veprimtarinë patriotike dhe për të krijuar familje të lumtur. Por, kur erdha në Gjermani më ndodhi tragjedia. Do të ta rrëfej duke vlerësuar arsyeshmërinë tënde. Nuk frikësohem se do ta shpërdorosh singjeritetin tim.

Grupin tonë po e shoqëronte një burrë i pashëm, i veshur me kostum e kollaro. Asnjëri nga anëtarët e grupit nuk e njihnte, prandaj i frikësoheshim se mos na e kishte dhënë UDB-ja për mbikëqyrje që të mos kontaktonim me radhët tuaja. Parëmbërme nisi filli i tragjedisë sime. Ishim në hotel. Ai më thirri të ngitesha lart në dhomën e tij, duke më thënë se kishte një bisedë të shkurtër më mua. Këtë ma tha me kulturë mirësjelljeje. Por, kur unë refuzova ai më urdhëroi. Unë u frikësova dhe shkova, me bindjen se vërtet donte vetëm të bisedonte më mua për sjelljet e mia apo të ndonjë anëtari të grupit. Këto ditë po shoqërohesha shumë me të afërmin tim dhe me gruan e tij. Kjo, mendova, dubet ta ketë shtyrë atë që të më detyrojë të bisedoj me të. Kur shkova në dhomë më ofroi viski. Nuk e pranova me arsyetimin se nuk pi alkool. Ai e kishte frigoriferin plot dhe jo si ne. Më dha një fanta, kurse ai mori për vete viski.

Filloi të më pyeste pa u prezantuar se cili ishte në të vërtetë. Më pyeti për të afër-

min tim, për lidhjet e tij me ty, për veprimtarinë tuaj, me mendimin se i afërmi kishte bërë lidhje të fshehta prej kohësh midis meje dhe radhëve tuaja. Unë nuk tregova gjë duke i thënë se kishim vetëm lidhje familjare. Nuk më bëri shumë presion që të flas detyrueshëm, por më propozoi të bëja seks me të, sepse unë paskëshin fryrë b... gjatë këtyre ditëve. Menjëherë u tërbova duke i thënë pusht, kurvar e të ngjashme. Bëra të iki, por ai e kishte mbylluar derën dhe çelësin e kishte futur në xhep. E kërcënova se do të ulërija, po nuk ma hapi. Ai më kapri për flokëve duke më kërcënuar që ta mbyll gojën, sepse do ta pësojnë keq njerëzit e familjes në Kosovë. E luta përgjyeshëm që të më lironte dhe vërtet më lroi.

Dje, pasdite, më telefonoi nëna. Sa nuk më çmendti. Më tha se kishin shkruar dy njerëz të UDB-së në shtëpi bashkë me pesë policë. Kishin bastisur shtëpinë dhe kishin gjetur një gazetë "Bashkimi". Nana me çortoi pse e kisha fshehur atë gazetë në dhomën time. I thashë asaj dhe po të tregoj edhe ty se gazetën "Bashkimi" e kam lexuar kur ma ka dhënë në besë një shoqe, por nuk kisha si ta fshihja, pasi ajo një ditë më vonë ma mori. Do të isha e lumtur sikur ajo të ma kishte lënë që ta mbaja të fshehur, me kënaqësinë që do ndjeja, kur t'ua jepja shoqëve e shokëve për ta lexuar. Pra, ata që kishin bastisur shtëpinë, e kanë sjellë me vete "Bashkimin", duke gënjyer se e kanë gjetur nën dymbek të shtratit tim. Në fund nënës i kishin thënë se shkak për bastisje jam unë, meqë gjatë turneut po kontaktoj armiq të Jugosllavisë. E kishin kërcënuar se po nuk bëra si do më thotë mbikëqyrësi i grupit muzikor, do ta arrestonin gjithë familjen. Dhe nëna më luti: "Vajza e nënës, dëgjoje atë mbikëqyrësin që të mos na shkaktosh tragjedi më të madhe!"

Sapo mbarova telefonatën ia plasa vajit, duke mallkuar veten. Vazhdova të qaja me dënësë e shtrirë në shtrat: "Çfarë pushti e kriminelit na qenka ky mbikëqyrësi!? Paska pozita të larta në UDB, prandaj paska urdhëruar menjëherë të më bastiset familja dhe të më shantazhojë në këtë mënyrë..." Ndërkohë hyri shoqja e dhomës dhe u lemerit kur më pa se po qaja me dënësë. Më pyeti çfarë kisha, duke ma fshurë fytyrën me peshqir të lagur, por nuk i tregova. Mbeta e shtrirë në krevat për të pushuar dhe për të menduar, se si duhej të veproja. Një mendje më thoshte, të shkoja tek i afërmi për të kërkuar ndihmë, duke e lutur të më kontak-

tonte me ty. Tjetra më thoshte, nuk dubet, për hirë të egoizmit tim, ta dëmtojë familjen, pasi isha e bindur se UDB-ja do të hakmerrej. Pas një ore pushim, zbrita poshtë për të pirë një çaj. E pashë atë pushtin. Kaloi pranë meje, duke më thënë me inat: "Nuk dukesh se ndihesh mirë. Të pres në dhomë në ora 20.00, sepse sonte nuk do të ketë koncert." M'i tha këto dhe u ul vetëm në anën tjetër të restorantit të hotelit. I vetëm dhe në skaje të hotelit ulej përberë dhe na vështronte.

U ngrita për të shkuar sërish në dhomë, pasi edhe çajin ma zuri në fyt. Prapë po mendohesha se si duhej të veproja. Kishta vetëm dy alternativa. Vendosa për alternativën e poshtërimit, pasi më mungonte kurajojia qytetare për të përballuar torturat që do të pësonin prindërit dhe sidomos vëllai i hasretit, të cilin unë e dua tej mase. Të lutem, mos më keqkupto për zgjedhjen e poshtërimit, pasi më dubet të sakrifikohem për prindërit dhe sidomos për vëllain!

Meqë vendosa të jem e sinqertë ndaj teje, kur vendosa të të shkruaj këtë letër, po të informoj se në orën 20.00 i shkova në dhomë fshehurazi të mos më betonin shoqja e dhomës dhe pjestarët e tjerë të grupit. Sapo hyra, duke u zgërdhirë dhe me paraqitje prej fitimtari cinik e sadist, më tha: "Po më gëzon fakti që je e zgjuar dhe pranon të kooperojmë." Në kohën kur po më thoshte këto, filloi të më zhvishte. Unë po rrija si statujë, por si ato që dridhen kur bie tërmeti dhe rrezikohen të thyhen në copa kur do rrëzohen. Pastaj më shtriu në shtrat dhe më përdhuroi. Ndjeja dhimbje të mëdha, sepse në këtë mënyrë kaq kriminale, po humbja edhe virgërinë time, të cilën kishta dëshirë të ta dhuroja ty. Nuk di se çka krejt ka bërë më mua, pasi pas pak çastësh, meqë po qaja me dënësë, humba vetëdijen. U këndella nga të lagurat me ujë që po më bënte ai sadist. Pashë se shtrati ishte përgjakur dhe sërish shpërtheva në vaj. Më ofroi të pija, por ia refuzova. Po rrija përmbys në shtrat duke qarë dhe ai po kënaqej duke ma ledhatuar kurriçin.

Pasi u lodha se qari, u ngrita dhe bëra një dush. Kur e krevia, ai më foli: "U kënaqem. Ti mos u frikëso, se ngjashëm u ndodh të gjitha femrave kur bëjnë seks për herë të parë. Ti, tani e tutje, e di se dubet të veprosh si të them unë." Unë heshta. Ai prapë më pyeti në formë urdhëruese: "A do respektosh urdhërat e mia!?" Iu përgjigja me zë të ndrydhur: "Nuk kam tjetër zgjedhje".

Në vazhdim më tregoi: ‘Jam oficer i lartë në UDB dhe në Sekretariatën Krabinor të Brendshme kam pozitë udhëbëqese për gjithë Kosovën. Emrin e vërtetë e kam Josip Karaxha dhe jo si në pasaportë të falsifikuar, enkas për këtë udhëtim. Jam i ngarkua me një mision të rëndësishëm dhe më duhet angazhimi yt. Ti tani duhet të bëhesh e vetëdijshme se po i tregove ndokujt gjë, jo vetëm që rrezikon prindërit dhe vëllanë, por rrezikon edhe jetën tënde fizike. Nësër mbrëma kemi koncert në Hilden. Aty, sipas informatave që kam, do vijë edhe Miran Bruçaj, me shumë bashkëveprimtarë të tij. Shpreso se nuk do të na e prishin koncertin, si në qytetet e tjera. Por kjo ka pak rëndësi për misionin tim. Ti, në fund të koncertit, duhet t’i afrosh Miranit dhe t’i thuash se e pret në hotel, duke i dhënë të kuptojë se e pëlqen dhe se do bësh seks me të. Pastaj do ta takoj unë në hotel, pasi dy udhëbëqesit kryesor të Kosovës më kanë ngarkuar që ta bind Miranin për ta pushuar përkohësisht veprimtarinë e tyre patriotike, sepse druajmë se nacionalizmi serb, i cili është konsoliduar tani, do ta shfrytëzojë angazhimin e tyre dhe shpërthimin e mundshëm të revoltës sociale në Kosovë, që të ndërhyjë brutalisht në Kosovë, duke na i shkatërruar të arriturat e mëdha politike gjatë kësaj deкаде. Ky, mendoj unë, do të jetë kontribut patriotik imi dhe jti, në mënyrën tonë.’

Duke e dëgjuar atë, u gëzoja që po më jepte mundësinë të të takoja fizikisht, qoftë vetëm një herë. Po mendohesha që ta shfrytëzoja rastin për t’u njoftuar me ty dhe për të ofruar dashurinë time, duke ta fshehur përdhunimin që më kishte ndodhur. Por, për shkak të adhurimit të madh që ndiej për ty, hoqa dorë nga kjo taktikë. Fatkeqësisht, jam e detyruar të veproj siç po më urdhëron ky farë Josipi.

Siç mund të më kuptosh, fatkeqësisht, jeta ime është shkatërruar dhe nuk dihet se kur do të marr guxim të bëjë vetërrasje, pasi edhe për këtë akt u dashka trimëri përkatëse.

Unë këtë letër do ta jap që në takim të parë, që ti të informohesh se për ç’arsye po të lutem të vish në hotel. Për të tjera do të bisedojmë nëse më jepet rasti. Unë po filloj të lutem për ty që të dalësh faqebardhë në këtë sprovë të rëndë.

Së fundi, po të lutem për mirëkuptim minimal njerëzor për fatkeqësinë time të rëndë. Edhe nga kjo gjendje poshtëruese, por rrezikoj jetën për të të informuar për

planin e këtij krimineli sadist dhe kam besim se ti nuk do të ma rrezikosh jetën fizike, pasi tani po e vë në lojë për ty dhe për hirë të popullit tim.

*Nëse e pranon, nga kjo pozitë imja poshtëruese,
Të përqafoj gjithsesi miqësisht
Fatkeqja Jetëmbanuar”*

Jusufit po i rrokulliseshin lotët njëri pas tjetrit dhe po pengohej të lexonte, sado ishte dorëshkrim shumë i lexueshëm.

Pas një pushimi hapi pakëz derën dhe i tha Miranit të shkonte tek ai.

– Kjo letër më ka shokuar. Përse nuk ma ke dhënë më përpara dhe si të ra në dorë e çfarë ndodhi në koncert dhe pas tij?

– Unë shkova në koncert. Bile, paraprakisht porosita aktivistët që të shkonin sa më shumë veta. U thashë gjithashtu se koncertin nuk do ta prishim, meqë fjalime jugo-sllave nuk po mbahen dhe kështu koncerti do të ndihmojë për ndërgjegjësimit patriotik të pjesëmarrësve. Ishte paralajmëruar se do të vinte edhe këngëtarja e afirmuar, Shkurte Fejza, e cila me këngët e saj me përmbajtje patriotike dhe me stil autentik të interpretimit, po frymëzon shumë njerëz. Në moment të fundit pushtetarët në Prishtinë ia kishin ndaluar asaj që të vinte. Megjithatë edhe këngëtarët dhe valltarët që erdhën, ishin të afirmuar dhe ia vliente të shkonim në koncert të tyre. Meqë nuk po vinte Shkurta, për inat të atyre që ia kishin ndaluar ardhjen, unë vendosa të blej një buqetë me lule. Shkova në koncert. Nga fundi, meqë koncerti u pëlqente bashkatdhetarëve, kur mbaroi së kënduari një këngëtare, emri i së cilës nuk po më kujtohet për momentin, dola në skenë me buqetë të luleve në dorë. Spontanisht thashë: “Këtë buqetë e kam menduar për këngëtares e madhe, Shkurte Fejza. Prandaj nuk po ia jap sonte askujt, por vetëm po protestoj kundër ndërhyrjes së pushtetarëve titistë që na mashtruan se ajo do të vinte. Për këtë mashtrim turpi u takon atyre, kurse juve që na kënaqet sonte, ju uroj suksese!” Duartrokitjet më ndërpren të flisja më gjatë. Të gjithë u ngri-

ten në këmbë dhe filluan të shpërndahen pa e pritur përfundimin e koncertit. Unë ngrita lartë buqetën për të përgëzuar pjesëmarrësit për atë reagim dhe zbrita me lulet në dorë. Shumë aktivistë më rrethuan që të më nxirrën nga salla shëndosh e mirë, meqë u frikësoheshin udbashëve të shumtë që ishin shpërndarë në sallë, në mes të publikut. Prej aty shkua në restorant të sallës që të pimë dhe të diskutojmë për koncertin dhe ato që ndodhen. Aty erdhi Nesimi dhe ma dha këtë letër. Meqë ishte e futur në zarf të hotelit, e futa në xhep. Nesimi m'u afrua te veshi: "Kam porosi ta lexosh menjëherë!" E hapa. Kur e pashë, u thashë aktivistëve në tavolinë: "Vazhdoni ju bisedat, kurse mua do të më falni se po ulem në këtë tavolinën e afër që ta lexoj këtë letër. Kur i shkova deri aty ku po fillonte tragjedia, filluan të më rrokullisen lotët, ngjashëm si ty. Ndërrova të ulurit që të mos më shihin aktivistët, të cilët ishin dall-disur duke diskutuar rrjedhën e koncertit dhe gjestin tim. Pasi e mbarova, shkova në tualet për të larë fytyrën. Po mendoja se çfarë qëndrimi të mbaja. Të shkoja në hotel apo të lajmëroja policinë. Gjykova se të dy variantet do ta rrezikonin Fatkeqën, ndaj ju thashë aktivistëve që të ecnim menjëherë. Nesimin e pyeta se cila ishte ajo që ia dha letrën. Më tha se e kishte mbesë dhe se ishte më e bukura në grup. Vetëmevete mallkova edhe fatin tim, sepse kisha shansin të më binte hise një zogëz e bukur, siç i rasis hutit, por më iku ai rast i mrekullueshëm...

Mirani u ndal të pushonte. Ndihej i rënduar nga emocionet, kurse Jusufi harroi për pyetjen se përse nuk ia kishte treguar këtë letër më përpara, po ndërkohë u kujtua:

– Harrove të më thoshe se përse nuk ma ke treguar më përpara këtë letër, meqë paska qenë tragjedi e rëndë, tepër e veçantë? Pastaj paska pasur edhe një kumt brenda.

– Më ndërpreve kur u ndala të merrja frymë. E para, sa për tragjedi, unë përditë po dëgjoj për tragjedi që po përjeton nëna ime, vëllezërit dhe motrat. Çfarë terrori patën pësuar vjet kur isha fshehurazi në Kosovë

dhe UDB-ja aksidentalisht e zbuloi. Isha për vizitë në Kryegur të Ferizajt, bashkë me Malën që jeton në Vupertal (Wuppertal), i cili tani është burgosur në Kosovë. Shokëve të atjeshëm u vdiq babai. Më detyruan të mbaja fjalë mortore te varri. Kështu u zbulova. Policia ngriti prita. Një mësues imi i dikurshëm, Saud Gorani, që tani është oficer i policisë kriminalistike në Pejë, informoi për pritat e policisë djalit e axhës, Imerin. Menjëherë u alarmuam. Më ndihmuam të arratisem dhe ia dola. Pasi dështuan të më kapnin, terrorizuan sidomos vëllanë më të vogël se unë, Demushin. E patën bërë për gjips e lëkurë të dashit. Patën terrorizuar jo vetëm familjen time, por edhe dajat e farefisit. Sivjet kanë arrestuar pos Malës, edhe Sylmirin, që më pat dërguar me makinë të tij në Kosovë. Të gjitha i kam përjetuar si tragjedi të veçanta, meqë ndihesha shkakhtar. Kur mësova rastin e kësaj fatkeqëje, siç e kishte quajtur veten, ti i kishe prerë njëanshmërisht marrëdhëniet me mua. Tani që u pajtuam, nuk dija çfarë të të tregoja më parë dhe ishim të zënë me përgatitje të *Bashkimit*. As që më ra më në mend, veç kur sot e pashë rastësisht në çantë.

– Po njoftimin, që ai farë Josipi ishte dërguar me atë misionin, si e komenton?

– Ku di t'i komentoj unë të tilla makinacione të UDB-së dhe të titistëve. Sigurisht ti i komenton më mirë se unë. Ndonjë informatë tjetër konkrete rreth atij misioni të Josipit nuk kam, pos atyre që lexove në letër.

– Rëndom, – nisi të komentojë Jusufi, – kam dëgjuar se pushtetarët titistë të Kosovës po e parandjejnë rënien e tyre nga pushteti. Pakënaqësitë sociale të shqiptarëve janë bërë të mëdha. Zhvillimi ekonomik, vetëkuptohet, po edhe rritja e papunësisë në krahasim me republikat e tjera sa vete e rritet. Kjo po i shqetëson pushtetarët, jo pse po u dhimbset populli i Kosovës, por humbja e privilegjeve të tyre. Prandaj ata duan të luajnë me kartën e kërcënimit nga revanshizmi serbomadhi që ta frikë-

sojnë popullin për të mos u ngritur në protesta e revolta. Dhe, po që e vërtetë që serbomëdhenjtë po organizohen që të rikthehen në pushtet, siç edhe po pritet, ata do ta bëjnë këtë sido që të jetë. Kjo taktikë e titistëve në Kosovë nuk funksionon. Serbomëdhenjtë sajojnë pretekse kur të duan e si të duan. E shumta, ata llogarisin të shpërblehen nga serbomëdhenjtë, nëse e dorëzojnë popullin tonë pa asnjë rezistencë. Këta titistë nuk e kanë për turp që t'i shërbëjnë pushtuesve të llojllojshëm, vetëm të shpërblehen me çfarëdo pushteti, si kockë që i hudhet qenit. Them se ne nuk duhet të mashtrohemi me këto truke të tyre. Është urgjente, që ne të organizohemi dhe ta kanalizojmë e udhëheqim pakënaqësinë e popullit tonë. Ato nuk janë vetëm pakënaqësi sociale, por tashmë edhe më shumë nacionale. Shumica e shqiptarëve e kanë kuptuar se prapambetja e Kosovës është në radhë të parë pasojë e përbërjes së saj etnike.

Po të mos ishte në pyetje fati i asaj goce fatkeqe, do të duhej ta informoje policinë. Mirë që ke mbajtur qëndrim njerëzor. Ndoshta do të duhej ta mendoje mundësinë e kapërdirjes së fatkeqësisë se saj dhe të martohesh me të. Kjo do të ishte tepër njerëzor. Si thua, mos po kërkojë të pamundshmën nga ti?

– Kam menduar edhe unë për këtë dhe më vjen mirë që edhe ti gjykon njësoj si unë. Sinqerisht, mua nuk do të më pengonte fare përdhunimi që i ka bërë ai kriminel. Madje ky do të ishte një argument më shumë që ta respektoja posaçërisht. Sa i përketë ndjenjave të dashurisë, thonë se ato nuk mund të kanalizohen e komandohen. Ato rrjedhin sipas rregullit të tyre që ne nuk e definojmë dot.

– E di çka, ta ndërpresim këtë bisedë se nuk dihet ku do të përfundojmë! – ndërhyri Jusufi.

– Edhe ti, mirë që pushove nga ai hidhërim egërsues që kishe, nga se kjo lufta jonë do të ketë shumë viktima të llojllojshme, por ato do të bëhen gurë në kalanë tonë çlirimtare.

– Hajde, hajde! Fute në lojë edhe figura poetike. Ec more të pushojmë se na u tha fyti pa pirë gjë.

Që andej dolën në dhomën e ndenjës.

6.

Fundit të vitit po i numëroheshin orët dhe minuatat në gjithë sahatët e mëdhenj elektronikë, të varur në mure, në sheshet kryesore e kudo. Ishte dita e parafundit. Mirani dhe Renata kishin dalë për të shëtitur në malin e madh rreth universitetit të Bochumit. Ata e kishin bërë ritual daljen për çdo natë rreth orës 22.00, kur ishin që të dy në Bochum. Ndonjëherë dilnin edhe më vonë, kur kishin për të studiuar. Daljen e tyre e arsyetonin me nevojë për pastrim të mushkërive me ajër të pastër dhe të lëvizjeve fizike që t'i merrte gjumi më mirë. Njëherit ndinin kënaqësinë për të biseduar të papenguar. Rrugët e malit ishin të ndriçuara. Fillimisht Renata ishte frikësuar të bënte kaq vonë shëtitje, por më vonë ishte ambientuar dhe mezi priste të dilnin së bashku. Andejpari nuk banohte njeri dhe në këtë kohë pothuajse nuk lëvizte njeri. Shëtitja e tyre zgjaste të paktën një orë. Ndonjëherë ulëshin në bangot e vendosura ndanë rrugicave të malit. Tutje malit vinte kopshti i madh botanik i universitetit. I ndante një përrockë që gurgullonte prajshëm e ritmikisht, nga se ia kishin bërë me mjeshtëri rëniet e vogla dhe dukeshin si rënie të natyrshme. Kjo përrockë dhe gurgullimat e ujit e bënë romantik dhe magjepsës gjithë ambientin përreth. Në këtë mal, pothuajse gjatë gjithë ditës, deri vonë në mbrëmje, shëtisnin vetëm studentët, sepse universiteti ishte tetë kilometra jashtë qytetit dhe qytetarët nuk vinin dot. Edhe kur ata vinin, vizitonin vetëm kopshtin botanik, me një hapësirë prej rreth pesëmbëdhjetë hektarësh, me shumë sera të larta, me bimë e drunjtropikalë. Në hyrje të kopshtit ishin informatat mbi speciet bimore ku gjendeshin mbi dyzetepesë mijë lloje bimesh nga e gjithë bota. Ky numër shtohet vazhdimisht. Kopshti botanik mbyllet në orën 19.00 në

sezonin veror dhe në 17.00 gjatë atij dimëror. Pas këtij orari vizitorët ktheheshin në qytet me tramvajin që qarkullonte për çdo pesë minuta ose me makinat e tyre. Kopshti, pos universitetit grandioz, ishte një mrekulli për të cilën flitej gjithandej dhe shpesh vinin vizitorë edhe nga qytetet përreth. E në krahinën të Ruhrit qytetet ishin aq të dëndura sa vërshtirë mund të diheshin kufijtë midis tyre se ku përfundonte njëri e ku niste tjetri.

Kishin kaluar shumë kohë duke ecur rrugicave të malit dhe Mirani e Renata nuk po flisnin. Rëndom, kur Mirani kishte ndonjë shqetësim, hall ose preokupim konkret nuk parapëlqente të fliste. Ai dëshironte vetëm të ecte dhe të mendonte. Renata ia njihte këtë shprehje dhe nuk e bezdiste me llafe koti.

– Po të kishte mundësi ta bartja gjithë këtë kompleks, universitetin, kopshtin botanik dhe malin përreth dhe ta çoja në Kosovë! – ia futi me dëshirore Mirani, duke dashur që njëkohësisht ta prishte heshtjen dhe ta ruante durimin e Renatës. I kishte ndodhur shpesh në të tilla raste kur ajo ia plaste vajit dhe merrte vrapin për t'u kthyer në konvikt.

– Merri pra! – ia bëri Renata e cila e hetoi se tjetri foli vetëm sa për të thënë. – Sa herë e ke shfaqur këtë dëshirë! Unë do të ta falja me gjithë qejf, sepse Gjermania nuk do të varfërohej, kurse Kosovës do t'i duhej shumë. Pastaj, do të kishim mundësi të shëtitnim edhe atje si këtu, kur të shkonim në Kosovën e çliruar.

– Le të bëhet një herë çlirimi, pastaj edhe atje do të ndërtojmë gjëra kaq të mira, – ia ktheu Mirani duke dëshiruar ta bllokonte prirjen e Renatës për të diskutuar për jetën e tyre të përbashkët në Kosovë. Edhe Renata e hetoi se Mirani nuk dëshironte as kësaj radhe të bisedonte për këtë temë.

– Miran, u bënë disa ditë që nuk ishe këtu. Kur shkove, nuk më tregove fare, – foli tjetra duke zhvendosur bisedën.

– Tashmë thëm se je mësuar më shprehite e mia...

– Të mos i tregosh askujt se kur e ku shkon dhe kur kthehesh, madje as vëllait, pos kumatës Sabrush, – e ndërpreu ajo.

– Sa mirë e ke mbajtur mend, po përse u habite pra kësaj radhe?

– Sepse vazhdimisht përpiqem të ndikoj që të ndryshosh ca shprehi që nuk më pëlqejnë.

– Vazhdo të përpiqesh... – ia ktheu Mirani dhe sa nuk i tha kot e ke, por e frenoi veten që të mos ia prishte asaj.

– Po të më besoje vetëm një të qindtën pjesë sa i beson Sabrushit, do të isha edhe më e lumtur.

– Nuk është çështje besimi, sepse besim kam edhe te vëllai, edhe te ti, edhe te disa shokë të tjerë. Është puna e shprehisë së saj praktike. Ajo nuk flet me askë për udhëtimet e mia dhe nuk ka forcë që mund ta detyrojë të tregojë gjë. Këtu është e veçanta e besimit ndaj saj.

– Sa zemërmadhe që është! Kujdeset për ty e të do më shumë se sa të të kishte vëlla.

– Edhe unë e kam në vend të motrës në këtë të mallkuar ekzil.

– Sa keq për ne gjermanët që i kemi industrializuar marrëdhëniet tona ndërnjerezore edhe në familje. Ti ke vërejtur që me vëllanë tim nuk kam as raporte të përafërta çfarë i ke ti me Sabrushin. Kjo afërsi juaja po më përvetëson çdo herë e më shumë, por ju po më mbani në distancë. Kur vij në kunata e vëllai për vizitë dhe më gjejnë mua tek ti, ti ndihesh keq...

– Sepse ata mund të mendojnë se jemi të dashuruar dhe pastaj frikësohen se më humbasin, – e ndërpreu Mirani.

– Po Shabushi qenka i humbur pse është martuar me Margotën? Sa harmoni të lakmushme që kanë!

Mirani nuk deshi ta komentonte martesën e Shabushit, studentit të shkëlqyeshëm të fakultetit të mjekësisë, nga Stralli i Deçanit. Renata mendoj se ai nuk e kishte kuptuar pse ia solli këtë shëmbull dhe vazhdoi konkretizimin:

– Të kujtohet kur i takuam, pasi ata ishin kthyer nga Kosova? Ti e

pyete Shabushin për gjendjen atje dhe ai nuk dëshoi të tregojë asgjë, sepse është frikacak i madh. Sa për ta bërë radhën të tha se gjendja në Kosovë është e mirë. Kurse Margoti i tha : “Pse po e mashtron kolegun, gjendja atje është e rëndë, varfëria po rritet, pakënaqësia gjithashtu.” Pastaj na tregoi se si i kishte ndihmuar vjehrrit për të lëruar arën, duke i tërhequr qetë për litari.

Renata po priste përgjigjen e Miranit, kurse ai nuk dëshoi ta komentonte. Për të mos u keqkuptuar se po e injoronte tha:

– Vërtet ata kanë harmoni, por Shabushi po paraqitet sikur nuk është më shqiptar. Ai nuk i viziton më ish-kolegët e tij minatorë nga Kosova dhe as me ne nuk dëshiron të takohet. Margota nuk i ka komplekset e tij. Ajo me dhëmbshuri fliste për gjendjen në Kosovë, për varfërinë edhe për vjehrrin, i cili në pleqëri të thellë lëron arën.

– Këtu ke të drejtë. Sa herë e takoj Shabushin në universitet, me paraqitet më gjerman se sa vetë Bizmarku.

– Ku ma kujtove tani Bizmarkun? Historiografët serbë na kishin gënjyer për një shekull se gjoja ai paskësh thënë në Kongres të Berlinit se “shqiptarët nuk janë komb, por vetëm shprehje gjeografike”. I kam gjetur procesverbalet e atij Kongresi në arktivin shtetëror në Belinin Lindor dhe nuk figuronte kjo shpifje serbe. Kjo shpifje ka dekurajuar e dëmtuar shumë shqiptarët.

– Ku nuk të shkon mendja edhe ty, nga këtu e te procesverbalet e Kongresit të Berlinit. Si shpesh po më shkon atje dhe flitet se atje kurvarët mund të gjejnë femra sa të duan për pak deviza...

– Edhe ty nuk të shkoj mendja aq afër dhe aq qëllueshëm. Unë të fola për lisa, kurse ti më flet për fshesa, siç shprehet populli ynë. A nuk e kisha Martën këtu, e cila më përgjerohej, pa pagesë. Atëherë, përse u dashka të shkoj deri në Berlin për kurvërim? E di ti sa janë shpenzimet e udhëtimit deri atje dhe si keqtrajtohesh kur kalon transit nëpër Gjermaninë Lindore? Pastaj, po të kisha kurvërimin si qëllim, a nuk të kam

ty këtu më afër?

– Stop! Stop! Mua kurrësesi për kurvërim. More vesh!?

– Stop! Stop! Ti e nise e para dhe më ofendove.

– Po atëherë, përse shkon aq shpesh atje?

– Se mos po dyshon që shkoj për spiunim? Sa herë e kemi biseduar që shkoj për të takuar bashkatdhetarë në Berlinin Perëndimor, kurse matan Murit, në Berlinin Lindor, për të blerë libra, meqë janë më lirë. A e di sa libra ke porositur ti. Më porosisin edhe shumë kolegë, meqë kemi profesorë që na sugjerojnë edhe libra të autorëve të Gjermanisë Lindore. Gjermanistika nuk është e ideologjizuar. Unë, me pasaportë jugosllave shkoj pa vizë, kurse juve nuk ju lënë. Blej libra atje dhe i shes këtu. Më del rruga dhe ndonjë fitim i vogël. Do të kisha bërë biznes me libra, por policët e kuq në kufij më kërkojnë llogari se ku i kam ndërruar devizat. Një herë, nëse nuk ke harruar, më patën arrestuar. Kisha blerë kompletin e veprave të Marksit e të Engelsit, që peshonin mbi pesëdhjetë kilogramë. Në Bibliotekën Popullore të Berlinit Lindor luta një punonjëse të ma firmoste një deklaratë, sikur ajo m’i ka dhuruar. Kur erdha te kufiri në Friederichstraße, kufitarët lindorë, se perëndimorë aty nuk ka, më pyeten nëse i kisha ndërruar deviza në treg të zi. Ç’është e vërteta, vetëm duke i këmbyer në treg të zi kishte levërdi, pasi kursi zyrtar ishte një me një, kurse kursi në të zezë, një me gjashtë marka. U përgjigja se i kisha dhuratë. Ma kërkoi dëshminë e dhuratës. Ia dhashë atë deklaratën e asaj bibliotekistës. Sapo e lexoi më pyeti si e ka emrin dhuruesja. Unë e kisha harruar. Ai u tall. Paske mike që të dhuron libra që kushtojnë sa dy rroga të saj dhe ti nuk ia ditke emrin! Më arrestuan. I doli telashe edhe asaj nepunëses së shkretë. Kur më mori në pyetje një oficer i Stasi-t, sigurimit të DDR-it, më tha se fajësohem për ndërrim të devizave në treg ilegal. Iu përgjigja se e bëra këtë meqë jam student dhe doja të blija veprat e Marksit dhe të Engelsit për t’i propaganduar ato në kapitalizëm. Këto libra ju duhet të m’i falnit, u thashë, sepse po propa-

gandoj socializmin në kapitalizëm. Ne na duhen devizat, që përgjigjur ai. Atëherë, i thashë, kapni kurvarët që jua bënë shoshë gratë e vajzat, duke i paguar devizat që ndërrojnë në treg të zi. Ai u inatos dhe ma futi një flakresh të rrebtë. Më kërcënoi se do të më mbanin për shumë vite në burg. Iu përgjigja, mirë bëni, se dëshiroj ta njoh nga brenda sistemin tuaj socialist. Dhe vërtetë më dërgoi në çeli. Në mëngjes erdhi dhe më mori në pyetje në tjetër oficer, ndoshta më madhor. Më akuzoi se kisha ofenduar kombin e ri socialist gjerman, se kisha ironizuar sistemin socialist. Iu përgjigja se nuk kisha menduar ashtu, por se doja t'ju thosha t'i pengoni kurvarët që po vijnë, po bëjnë kontrabandë dhe po jua provokojnë gratë e vajzat me para. Sa për sistemin socialist, po të kisha ndërmend ta ironizoja, nuk do të rrezikojta të blija veprat e Marksit e Engelsit dhe t'i çoja ato në Perëndim. Do të thotë, të duket i drejtë sistemi ynë, më pyeti sugjestionueshëm ai. Paj, jo edhe aq. Pa ma thuaj, çfarë vërejtje ke? Më kusht që ju të mos më hidhëroheni dhe të mos e protokolloni. Ma thuaj një herë, pastaj do të shoh! Erdha sot që në orën katër të mëngjesit. Në orën pesë u mbushën rrugët me punëtorë që shkonin këmbë, me autobusë, me metro, me tramvaj në punë për të filluar turnin e parë të orës gjashtë. Asnjë makinë nuk qarkullonte. Rreth orës shtatë u mbushën rrugët me makina, pasi nga gjumi u zgjua borgjezia e kuqe. Dhe ato sa vinin e shtoheshin, secilën herë makina më të mira. Pastaj, në çdo hap pashë vetëm posterë të Brezhnjevës, si të ishte këtu Bashkimi Sovjetik dhe jo Gjermania e kombit të famshëm gjerman. Mjaft! – më urdhëroi, – se po rrezikon tepër. Mendoj disa sekonda dhe më pyeti: Të paskemi vëlla jugosllav. Jo, iu përgjigja, jam shqiptar. U habit duke thënë se si qenka e mundur të jem shqiptar me pasaportë jugosllave. Më shumë ka shqiptarë në Jugosllavi, – i thashë, – sesa në Shqipëri të Enver Hoxhës. E njëhki ju edhe Enver Hoxhën? – më pyeti. Po, i thashë, nga se e çmojmë si kryetar të shtetit. Atëherë, urdhëroi pasaportën e ik që këtej, sepse e adhuroj Shokun Enver Hoxha për tri-

mërinë që pati për t'u çliruar nga rusët, kurse ne jo. Kjo vërtet më pat habitur.

– Sa aventurier e kokëkrisur që je! Çfarë nuk përjeton. Kështu e mbush kohën dhe të duket atraktive, kurse unë, vetëm duke studiuar, po më bëhet jeta monotone. Mirë që të kam ty dhe së paku po shpresoj për një jetë të përbashkët dhe të lumtur.

Për disa minuta ra heshtja midis tyre. Po ecnin krahas, të kapur dorë për dore. Ishte një formë e veçantë e shoqërimit të tyre. Ecnin doradoras, natën nëpër mal dhe nuk puthëshin. Kushedi sa të vështirë e kishin të ruanin këtë nivel shoqërimi. Renatës i bëhej t'i hedhej në qafë, ta puthte deri në shkrirje, por Mirani nuk i jepte shans. Edhe atij ia donte shpirti ta përqafonte e puthte me afsh, dhe jo vetëm kaq, por ruhej si nga një rrezik i madh.

– Renata, sa interesant më pat ardhur kur para dy javësh erdhën prindërit e tu për vizitë! – theu heshtjen Mirani. – Sa njerëz të mirë e të dashur i ke prindërit!

– Edhe ata u kënaqën me ty. Të admirojnë e të duan shumë, por po i brengos mosshkurja jote për vizitë, – tha ajo.

– As vetë nuk di ta shpjegoj se përse nuk më shkohet. Se si ndihem keq për pamundësinë që t'ua plotësoj dëshirën...

– Vazhdojnë të shpresojnë se do të ndryshosh. Edhe ata, si mue, po i provokon edhe më shumë ky qëndrim përmbajtës që ke, prandaj dëshirojnë gjithsesi të të bëjnë dhëndër.

– Nuk i dihet së ardhmes. Ndoshta po torturohemi kot, sepse kam një si parandjenjë se mund të më bëjë ndonjë kurth UDB-ja. Konfrontimet po ashpërsohen...

– Mjaft me parandjenja ogurzeza! – tha ajo dhe u ul në karrigën buzë rruge, e pafuqishme për të qëndruar në këmbë.

– Nuk po t'i shfaq aq shpesh, prandaj mos thirrë kot se nuk bëhet kiameti edhe sikur të të realizohet parandjenja! – bërtiti Mirani ngase e

kishte bezdi ligështimin dhe alarmimin e saj. – Unë, pos gjërave që ti tashmë i di, nuk dua të të lë vejushë. . .

– Të lutem, mos vazhdo me këso bisedash! – u përgjërua ajo.

– Më fal, – i tha me keqardhje e pendesë Mirani. E mori ngrykë dhe e mbështeti për gjoksi duke ia ledhatuar flokët.

Prapë ra heshtja. Ata po vazhdonin të qëndronin të bashkëdyzuar, si të ishin shndërruar në një statujë të vetme. Pas disa çasteve Mirani lëvizi i pari. Ai e donte ecjen rrugicave të atij mali me lisa të lartë. Krejt kjo ia kujtonte fëmijërinë në Rugovë. Renata e kuptoi dhe u shkëput nga gjoksi tij. Filluan të ecnin pa folur.

– Të kujtohet vizita e para dy viteve në Bielefeld? – e pyeti më në fund ai, duke menduar se e kishte gjetur temën për ta shpenguar. Kishte menduar shpesh që të diskutonte për atë vizitë, por nuk e dinte as vetë se për ç'arsye ishte përmbajtur.

– Më kujtohet, – ia ktheu ajo me zë të ulët.

– Atë vizitë e kishit kurdisur ti me Xhabilin, atë bashkatdhetarin tim, që thoshte se banon në Bielefeld, por që në të vërtetë banonte në Gytersloh (Gütersloch). Atëherë ai vinte shpesh në Bochum. Ti kishe menduar se e kam shok të mirë. Kur të tha se jeton në Bielefeld duhet t'i jesh lutur të të ndihmonte për të ma mbushur mendjen të pranoja martesën tonë. Sipas marrëveshjes me ty, Xhabili më pat telefonuar që t'i shkoja për vizitë në fundjavë. Shkova në Bielefeld me bindjen se ishte fjala për ndonjë punë tonën. Atje Xhabili më tha se do të bënim vizitë në familje tënde. Qeshë habitur për atë propozim të tij. Edhe më shumë u habita se si ta kishte mësuar adresën. Nuk pranova. Ai m'u lut aq shumë, sa u ndjeva i detyruar. Më sollti deri para shtëpisë suaj. Ishte pasdite. Takova për herë të parë prindërit e tu në oborr. Ata na luten që të hynim brenda se kishin bërë gati kafën. Prindërit dhe ti e dinit se do vinim, kurse unë nuk e dija se ju e kishit paraplanifikuar vizitën. Më shumë nga inati nuk pranova të hyja brenda. U mundova të arsyetohe-

sha se nuk e kisha planifikuar atë vizitë, se nuk kisha qenë ndonjëherë për vizitë në familje gjermane, sado që, në fakt kisha shkuar dhe shkoj shpesh, ta zëmë te profesori i famshëm JL dhe te gjermanë të tjerë. Ata u mërzitën dhe ti edhe më shumë. Ti fillove të qaje dhe u krijua një gjendje e pakëndshme. Babai propozoi që ne të shëtisnim ca në parkun prapa shtëpisë dhe të ktheheshim pastaj, po të donim. Ti mezi pranove. Shëtitem rreth 20 minuta. Xhahili ecte përpara. Dikur u afrua dhe mundohet të më bindte që të fejojeshim që atë ditë. Tani po të tregoj, sado që nuk është fer, se çfarë më tha ai për të ma mbushur mendjen: “Budalla, është gocë fabrikanti. Po u martove me të do t’i biesh shqelm varfërisë sate. Një pjesë të pasurisë së madhe të babait do ta trashëgosh edhe ti, duke u bërë dhëndër i prindërve tu. Pastaj, po nuk dëshirove të vazhdosh bashkëshortësinë, mund të ndahesh dhe gjysma e pasurisë të takon ty.” Më beso, më pat hidhëruar shumë. Me Xhahilin, e mban mend edhe ti, u fjalosëm gjatë shëtitjes në park, por ti, pos zërit të ngritur nuk merrje vesh përmbajtjen, sepse flisnim shqip. Aty konstatova edhe karakterin e keq të tij, sado që më shitej komunist dhe anëtar i Partisë Komuniste Gjermane, sikur gjoja ata janë idealistë. Pas disa ditëve jemi ndarë për të mos qenë më shokë, por jo vetëm për këtë shkak.

– Më beso, – filloi ajo, – unë nuk kam kurdisur asgjë të keqe me të. Unë e njoha atë në banesën tënde. Prindërit kishin dëshirë të të njihnin. Ti nuk pranoje të vije për vizitë. Atëherë e luta atë të të bindte të vije në shtëpi të prindërve. Mendova se do ta dëgjoje si bashkëpatriot që e kisha. Kur u nise ti me tren, na telefonoi se po vinit se bashku, diku rreth orës 14.00. Prindërit, motra dhe vëllai qenë gëzuar. Enkas po të prisnim të gjithë se bashku, sepse u kisha folur shpesh e me pasion për ty. Kjo ka qenë e tëra. Ai paska qenë i poshtër. Unë nuk i kam ditur të gjitha këto. Më fal pse të kam hidhëruar dhe gjithashtu më fal për gjendjen që paskam krijuar. Unë mendoja se të kishte bindur që përpara të vije për vizitë te ne dhe nuk e pata kuptuar arsyen e vërtetë se përse refuzojte të

hyje në shtëpinë tonë.

– U sqarova. Edhe unë të paskam keqkuptuar kot! Më fal tani për hidhërimin që jua pata shkaktuar atëherë.

Pas një heshtjeje ajo pyeti:

– Miran, për Krishtlindje më ike, po Vitin e Ri ku do ta kalojmë?

– Më vjen keq, unë nuk të kam ikur, por shkova me punë te Jusufi e Vasili, kurse për festën e Vitit të Ri jam i rezervuar.

– Si, kush të ka rezervuar? – pyeti me habi keqardhëse Renata.

– Do ta festoj me bashkatdhetarët në Dyzeldorf.

– Mund të vij edhe unë me ty?

– Jo, – tha shkurt Mirani.

– Përse?

– Do të më keqkuptojnë. Ata do të mendojnë se ne jemi miq intimë që do të martohemi. Këtë nuk e dëshirojnë.

– Përse?

– Sepse nuk i pëlqejnë martesat e përziera me të huajt.

– Edhe një herë: përse?

– Sepse nuk i pëlqejnë martesat e përziera me të huajt, thash. Ky është qëndrim i të robëruarve. Frikësohen se mos po pakësohen e asimilohen përmes martesave të përziera.

– Po nëse ndodh e kundërta, që të shtohen përmes martesave të përziera?

– Rëndom, kur të pushtuarit martohen me të çliruar, atëherë shkrihen të pushtuarit ose integrohen në kolektivitetin e çliruar.

– Dukuri interesante dhe e papërceptueshme për mua.

– Dëshiron ta konkretizoj?

– Të lutem!

– Sikur unë, pjesëtar i popullit të pushtuar, të martohem me ty, do të gjermanizohem tok me fëmijët që do të lindim, sepse ti je pjesëtare e popullit të lirë. Pak më herët folëm për Shabushin e Margotin. Fëmijët

e tyre nuk dinë fare shqip. Shabushi, e the edhe ti më herët, bëhet më gjerman se Bizmarku.

– Tani po të kuptoj përse u përmbake që të mos martohesh më mua. Por, ti je racë e fortë dhe nuk asimilohesh dot.

– Rasti ynë ndryshon. Unë sqarova opinionin e të pushtuarve, ndërsa arsyet e mia t'i kam treguar. Edhe kjo mund të jetë një tjetër më shumë. Edhe fëmijët e imigrantëve shqiptarë i janë nënshtruar procesit të integrimit, gjegjësisht të asimilimit...

– Në fund të fundit, të gjithë njerëz jemi...

– Sigurisht që njerëz jemi, por fatkeqësisht ose fatmirësisht, dallimet ekzistojnë, – zuri të filozofonte Mirani, me mendimin se Renata nuk po i kuptonte dallimet e njerëzve. – Për shkak se unë, si njeri që jam, pjesëtar i popullit të pushtuar, jam përndjekur nga pushtuesi. Duke qenë njeri i pushtuar, detyrimsht jam i varfër. Përfundimisht nga ky rregull bëjnë shërbëtorët e pushtuesit. Kurse ti, njeri gjithashtu, pjesëtarë e popullit të lirë, nuk je e detyruar të arratisesh as të emigrosh. Të është dhënë mundësia të jesh e pasur. Sa shumë dallojnë konceptet dhe jetesa ndërmjet pjesëtarëve të çliruar dhe të robëruar, të pasurve dhe të varfërve, gjegjësisht ndërmjet nesh, pavarësisht se jemi miq. Ju gjermanët, nuk i kuptoni hallët tona, prandaj habiteni pse ne kërkojmë të çlirohemi. Edhe brenda vetë gjermanëve të lirë kombëtarisht, ka dallime. Gjermanët e varfër, të papunë, sigurisht edhe ata njerëz, kërkojnë jetë më të begatë, kërkojnë punë. Ju të pasurit, sigurisht edhe ju njerëz, nuk i keni të njëjtat halle dhe habiteni kur të varfërit dhe të papunët kanë zili ndaj jush, ju fajësojnë se u bëni padrejtësi, se vetëm dëshironi të pasuroheni sa më shumë e të tjera.

– Kështu flasin komunistët, – ndërhyri Renata, e pakënaqur me shpjegimet e tij.

– Edhe ata njerëz janë, gjermanë janë, siç ishin Marksi dhe Engelsi, siç ishte Rosa Luxemburgu, të cilën gjermanët e pushkatuan, vetëm se-

pse u solidarizua me punëtorët e papunë kur protestuan për të drejtën e tyre. E kupton, të gjithë njerëz jemi, por secili ka halle të veçanta, rrjedhimisht edhe botëkuptime të veçanta, të kushtëzuar kryesisht nga gjendja, nga edukata e nga ndërgjegjja sociale. Dallimet e mëdha sociale, ju pjesëtarët e shtresës së pasur dhe strukturat intelektuale që ju shërbejnë, i vlerësoni si të natyrshme, njerëzore, kurse ne të varfërit jo. Prandaj angazhohemi për t'u korrigjuar njeriu, që ai të bëhet sa më njëri, që do të thotë të mos ketë të robëruar dhe pushtues, të shfrytëzuar e shfrytëzues, por të gjithë të jetojmë sa më njerëzisht.

– Luftë klasash do të bëjmë ne tani? – pyeti Renata me të qeshur. – Ta thashë, kështu flasim komunistët.

– E keni gjetur një gogol për t'ua mbyllur gojën atyre që ndihen të shfrytëzuar nga të pasurit dhe pushteti që u shërben kryesisht të pasurve, për t'ua mbyllur gojën të varfërve. Sa për gjuhën e komunistëve, sikur kemi biseduar dhe jemi dakorduar se nuk jam i tillë. Nuk kam premisa të jem idealist utopist. Si intelektuale që je, mund të mendosh më diferencueshëm, të mos identifikosh socializmin teorik me pseudosocializmin e shteteve pseudosocialiste, gjegjësisht me sistemin diktatorial monist. Socialiste mund ta quajmë Suedinë me sistemin social që ka, me të drejtat tepër të avancuara të punëtorëve. Kurse socializmi në shtetet që e quajnë veten të tilla është një diktaturë e përafërt me nacional-fashizmin e Hitlerit.

Në sistemin monist, ta zëmë në Jugosllavi, që ju e shabllonizoni si komunist, qytetarët, po edhe punëtorët dhe të papunët as që guxojnë të ankohen e të protestojnë kundër papunësisë e varfërisë së tyre. Shefat e kuq, që atje u thonë drejtorë, keqmenaxhojnë e shpërdorojnë firmat shtetërore, por kundër tyre nuk guxojnë të ankohen të punësuarit, e lëre më të protestojnë. Varfëria dhe papunësia në këto shtete janë të mëdha, sepse borgjezia e kuqe e drejtuesve komunistë dhe e pushtetarëve, po ashtu komunistë, nuk di të menaxhojë prodhimin, ta bëjnë atë më cilë-

sor. Shefat e kuq të firmave janë komunistë të dëgjueshëm, ndaj janë kaq të prapambetur.

Mirani pushoi sepse kishte filluar të bëhej emocional. Këto shpjegime nuk i ndjente si teoretizim të thatë, por si përjetime. Renata mendoi se ai nuk e kishte ndërmend të fliste më.

– Sikur po më bënë edhe mua bashkëfajtorë pse në Afrikë vdesin fëmijët nga uria. Sa e sa herë kam dhënë ndihma humanitare për të varfërit e Afrikës.

– E di, e di. Nuk i thashë këto për të të bërë bashkëfajtorë, por meqë the se jemi të gjithë njerëz. Shpesh thuhet se jemi njerëz duke nënkuptuar se secili duhet të pajtohet me gjendjen që ka dhe ta akceptojë atë si të mirëqenë.

– Unë nuk po e shpërdoroj qenien time si pjesëtare të shtresës së pasur, – ndërhyri Renata.

– Sigurisht, prandaj është domethënës njerëzillëku yt. Shumë njerëz të pasur kanë evoluuar, janë ndërgjegjësuar, janë bërë më socialë e më humanë; janë bërë më të përgjegjshëm për zhvillim të gjithëmbarshtëm të njerëzimit, prandaj njerëzimi po zhvillohet e po socializohet me dinamikë të madhe. Ky zhvillim, sidomos teknik e informativ, që po shkon drejt globalizimit, do të evoluojë deri atje sa të zhduken vetvetiu dallimet. Se mos kanë qenë Engelsi e Rosa Luxemburgu varfanjakë? Jo, ata i përkisnin shtresave shumë të pasura, por u përcaktuan për të drejtat e punëtorëve e të varfërve. Edhe Krishti u angazhua për të varfërit, prandaj u kryqëzua. Historia e zhvillimit njerëzor, fatkeqësisht, është përplot me shëmbuj të tillë. Edhe ti, edhe prindërit e tu, për shkak të zhvillimeve pozitive dhe evoluimit shoqëror, nuk dukeni se jeni shumë të pasur. Silleni tepër njerëzisht, bëni jetë modeste dhe jo siç dinë të bëjnë jetë të shfrenuar ca të pasur që kushedi si e kanë krijuar pasurinë dhe tani na thonë se e drejta e pronës private është e shenjtë. Ky proces, deri këtu, ka zgjatur me miliona vjet. Sigurisht do të zgjasë shumë derisa të zhdu-

ken dallimet, por ja që ne të pushtuarve, të shfrytëzuarve, të varfërve nuk po na pritet. Në kuadër të gjithë këtij kompleksiteti duhet parë edhe marrëdhëniet tona. Po të jetonim pas njëqind vjetëve nuk do të diskutim se kush ku do të rronte, kush me kë do të martohej, sepse bota do të shndërrohej në një fshat të vogël dhe njerëzit në këtë fshat do të krijojnë vërtet marrëdhënie njerëzore midis tyre, ndoshta si në komunitetin primitiv, por në nivel tjetër zhvillimi.

– Kaq ngatërrueshëm e ndërlikueshëm po i trajton ti edhe marrëdhëniet e ndjesitë tonal! – ndërhyri me habi Renata.

– Janë akoma më të ngatërruara e më të ndërlikueshura dhe duhet më shumë kohë e më shumë aftësi për t'i zbërthyer e shpjeguar kuptueshëm. Them, sikur mos të ishte çështja e këtij kompleksiteti, sikur unë të zgjidhja vetëm përcaktimin tim sipas egos, ngjashëm me atë të Xhahilit, atëherë dashuria dhe martesë me ty do të më sillte shumë privilegje individuale.

– E di çfarë, ta lëmë këtu për sonte këtë lloj diskutimimi! – ndërhyri Renata, duke shfrytëzuar pushimin e vogël të Miranit dhe duke njohur babëzinë e tij për të spekuluar me mendime, si dikur sofistët grekë. Renata zotëronte mirë greqishtën e vjetër dhe greqishtën e re, lexonte në origjinal filozofët grekë të antikës, zotëronte mirë edhe frëngjishten, spanjollishten dhe anglishten dhe lexonte shumë. Njohuritë enciklopedike të saj i shfrytëzonte me zell Mirani, duke e lutur atë t'ia shpjegonte përmbajtjet e librave që lexonte. Ajo ishte e ndikuar edhe nga rrymat e reja sociologjike e filozofike, të cilat shpjegonin evoluimin e përshpejtuar të marrëdhënive sociologjike, varësisht nga dinamika e lartë e zhvillimit teknik për superprodhimtari, për komunikim e informim të shpejtë, duke bërë që njeriu të socializohet përshpejtueshëm si njeri i globit. Ajo i kishte shpjeguar atij gjatë shëtitjeve dhe në raste të tjera se bota po zhvillohej me dinamikë aq të shpejtë sa shumë shpejt do të humbet kuptimi i pronësisë dhe shfrytëzimit të njeriut nga njeriu.

Mirani e kuptoi se ajo mbaroi radhën.

Për momentin heshtën, por heshtja nuk zgjati shumë. Renata, duke parë se kishin arritur para konviktit të saj, nuk harroi të pyeste:

– Domethënë ne do të detyrohemi ta festojmë Vitin e Ri ndaras?

– Fatkeqësisht... – iu përgjegy tjetri me keqardhe e dhimbshuri.

– Përse thua, fatkeqësisht?

– Sepse vërtet kisha dëshirë ta prisja një vit të ri me ty.

– Cila pra është arsyeja aq madhore që as kësaj radhe nuk po feston më mua?

– Unë u përpoqa ta organizoj festimin sa më të mirë të Vitit të Ri në Klubin tonë. U desh të bind bashkatdhetarët të festojmë familjarisht, të festojnë edhe gratë e fëmijët së bashku. Ti e di se si e sa janë të privuar emigrantët nga jeta e këtushme kulturore. Nuk shkojnë në kinema, në teatër, në koncerte. Nuk i ndalon njeri, por ata e privojnë vetën e tyre duke mos njohur jetën e kulturuar e të emancipuar. Akoma më keq e kanë gjendjen gratë emigrante. Ato nuk punojnë dhe rrojnë të izoluara. Pra, nuk e kanë as mundësinë që të kontaktojnë me njerëzit e këtushëm, siç bëjnë burrat e tyre, ta zëmë në orar të punës. Nuk mund ta marrësh me mend se në ç'gjendje të rënduar sociale po jetojnë ato. Edhe fëmijët e emigrantëve e kanë të vështirë me jetën e tyre midis dy kulturave. Kur organizojmë aktivitete kulturore ata kënaqen dhe ndihen krenarë se janë dikush.

– Uroj të kënaqeni gjatë festimit, të keni shëndet e suksese në Vitin e Ri! – Uroi sinqerisht e me mirëkuptim Renata.

– Po ti ku do ta kalosh festën? – pyeti Mirani.

– Më mbetet të vendos nesër, ndoshta do t'i bashkangjitem motrës dhe shoqërisë së saj, pasi prindërit shkuan dje në Majorkë, – tha ajo zvarrë e zvarrë.

– Atëherë, uroj që edhe ju ta kaloni mirë, të keni shëndet në Vitin e Ri 1981 dhe mirësi e mbarësi gjatë gjithë jetës satel!

Miranit sa nuk iu mbushën sytë me lot. Duroi që të qante pas ndarjes, meqë në këtë gjendje nuk do t'i festohej.

Uruan në të ndarë njëri-tjetrit duke u përçafur shoqërisht, meqë nuk do të shiheshin më gjatë këtij viti.

Mirani iku vetëtimthi drejt konviktit të tij duke qarë me ngashërim...

KAPITULLI V

Ditën e parë të Vitit të Ri 1981 Jusufin mori lajmin për arrestimin e Vasilit. Ky lajm e mërzi atë tej mase. Redaktimin e *Lajmëtarit të lirisë* e kishte mbyllur. Arrestimin e Vasilit e përjetoi aq rënd, sa që vendosi ta rifaqoste *Lajmëtarin* dhe pothuajse gjithë faqen e parë t'ia kushtonte arrestimit të tij, duke e vënë midis faqes portretin e tij.

Ditë më parë Jusufi ishte informuar për arrestimin e disa patriotëve në Kosovë, ndër të cilët ishte edhe magister Hasan Ukhaxha, mësimdhënës i gjuhës shqipe në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan, Ibish Neziri, student i letërsisë e të tjerë, emrat e të cilëve vendosi t'i botonte në një fletë të titulluar *Shtojcë e Lajmëtarit*. Për këdo do të ishte e rendit që arrestimet në Kosovë të radhiteshin para arrestimit të Vasilit, qoftë duke marrë për bazë arrestimin më të hershëm të tyre, qoftë për shkak të përmbajtjes. Arrestimi i Mr. Hasan Ukhaxhës, i cili ishte i organizuar në Kosovës, ishte goditje shumë më e rëndë për radhët e organizuara dhe për Kosovën, se sa arrestimi i mërgimtarit Vasil. Kjo s'v- lente për Jusufin, sepse ai e njihnte Vasilin personalisht. Me të kishte lidhje të veçanta shpirtërore. Ishte mërgimtari i parë, pas Bardhit, që e kishte takur, sapo kishte arritur në Gjermani. Kishin ndenjtur pothuajse ditë për ditë në fillim. Pastaj, Vasili kishte meritën e veçantë, atë të refuzimit e zbatimit të urdhërit për ta vrarë Jusufin, urdhër ky i dhënë nga kryetari i tij, Rezil Mejtepi. Jusufi kishte bashkëvepruar me Vasilin derisa ai ishte nisur për në Kosovë. Dhe, pos gjitha këtyre, ishte edhe hidhërimi ndaj shokëve që nuk e kishin informuar se Vasili po shkonte në Kosovë për të bërë aksione. Për këtë Jusufi qe hidhëruar më se shu-

mti në Miranin, sado që për shkuarje të Vasilit kishin ditur para Miranit tre bashkatdhetarë të tjerë, të cilët bashkëvepronin në të njëjtin rreth me Jusufin. Pra, Jusufi nuk u hidhërua ndaj të treve së bashku, Fahriut, Demushit e Nazimit, sa ndaj Miranit.

Goditja që ndjeu për këtë arrestim e shtyri atë t'i telefononte Miranit që të shkonte tek ai sa më parë. Mirani ishte informuar për arrestimin e Vasilit, por nuk mundi ta merrte me mend se Jusufi po i telefononte të shkonte pikërisht për këtë ndodhi. U merakos, sepse telefonata e Jusufit i tingëlloi alarmante. Për shkak të ruajtjes nga përgjimi i telefonit, Jusufi nuk i kishte treguar përse duhej të shkonte sa më parë.

Posa arriti Mirani në shtëpi të Jusufit, ai e drejtoi menjëherë në dhomën e punës, pa i lënë kohë të pinte gjë dhe të përshëndetej me familjarët e tjerë.

– Përse nuk më ke treguar para shkuarjes dhe për shkuarjen e Vasilit në Kosovë?

– Sepse Vasili e kishte bërë fakt të kryer shkuarjen kur unë u njoftova. Pastaj ai m'u lut me betim: "Pashë Flamurin nuk i tregon Bacit Jusuf!" Janë tre bashkëveprimtarë të rrethit tuaj që e kanë ditur para meje, që e kanë ndihmuar edhe me financa dhe ata duhet të kenë qenë njësoj të detyruar të të tregojnë. Mbase ata nuk i ka përbe si mua!

– Megjithatë, ti është dashur të më tregosh, – tha preraz Jusufi.

– Ja që s'e kam gjykuar se jam i detyruar.

– Them se ke bërë faj, madje faj të rëndë.

– Atëherë, të thërrasim Fahriun, Demushin dhe Nazimin dhe të gjykojmë rastin. Të shohim se sa faj ka secili nga ne.

– Mirë, edhe ashtu mund të bëjmë, por tani desha ta shfaq hidhërimin tim ndaj teje, – zbuti pakëz qëndrimin Jusufi dhe vazhdoi: – Pa më thuaj mendimin tënd se kush është fajtor për shkuarjen e Vasilit me Sadi Bakajn?

– Fajtori kryesor është organizimi ynë, jemi vetë ne, sepse u kemi

lënë mundësi e hapësirë udbashëve që të depërtojnë në radhët tona, të na i hutojnë, manipulojnë e mashtrojnë shokët. Kjo ngjarje ka ndodhur në rrethin tuaj dhe unë nuk kam përse ta kem përgjegjësinë kryesore. Po të ishte rrethi juaj i organizuar më mirë, po të bashkëpunonit më në nivel, sigurisht që udbashi Sadi Bakaj nuk do të mund të depërtonte deri në këtë nivel, sa të mund të mashtronte shokun tonë më të mirë në këto anë. Gjatë gjithë parapërgatitjes, vetë Vasili, por edhe Fahriu, Demushi e Nazimi kanë pasur takime me ty dhe nuk të kanë treguar. Them se kanë menduar që do t'ua prishje planin, prandaj nuk të kanë konsultuar. Demushi duhet të ketë luajtur rol më të drejtpërdrejtë, sepse ai e ka njohur familjarisht Sadiun dhe jua ka sjellë juve në këtë rreth. Ai ia ka krijuar, them me qëllim të mirë mundësitë që Sadiu të bie në kontakt me Vasilin. Kurse Fahriu e Nazimi nuk kanë pasur ndonjë ndikim në vendimmarrje të Vasilit, pos që e kanë ndihmuar më të gjitha mjetet e mundësitë financiare. Bile, Nazimi ka rrezikuar edhe babanë e tij, Ramadanin. Ai e ka bindur atë që ta vozis Vasilin bashkë me Sadiun dhe me materialet e rrezikshme propagandistike, me bindjen se do të dukej si udhëtim i rregullt i kurbetçarëve për pushime në Kosovë.

Pas një heshtjeje të shkurtër Jusufi e mori fjalën:

– Sidoqoftë, në momentin kur ti je informuar, ke mundur ta urdhërosh Vasilin që ta anulojë shkuarjen e tij në Kosovë.

– Ti mendon kështu, por ja që ne nuk e kemi për natyrë dhe shprehi as të urdhërojmë dhe as të zbatojmë urdhëra. Ndonjë hiarki organizative e disiplinë përkatëse nuk e kemi krijuar, – u përgjigj tjetri.

– Pavarësisht, Vasili të ka dëgjuar gjithnjë dhe do të të dëgjonte edhe kësaj radhe.

– Kësaj radhe ai e kishte bërë fakt të kryer dhe nuk e kishte ndër mend të më dëgjonte. Në fund të fundit, siç e tha, kishte vendosur të bëhej kurban, që ne të dinim se kush ishte në të vërtetë Sadi Bakaj, që ai të mos na rrezikonte ty dhe mua. Edhe këtë arsyetim e dha Vasili kur

u përpoqa ta bindi që të mos udhëtonte me të. I pata thënë se nuk kishte përse të rrezikonte, meqë unë dija se kush ishte Sadiu.

Këtë sqarim me nënkuptim e bëri që t'ia rikujtonte Jusufit se ishte ai që kishte shfaqur dilema për Sadiun pas takimit me të. Këto ishin diskutuar disa herë në këtë rreth, madje ndonjëherë duke marrë akuzën e ndonjërit se Mirani i ka kriteret e rrehta, se është ekstremist, se i bën njerëzit udbashë ku janë e ku nuk janë.

– Janë aventura të papërgjegjshme, – konkludoi Jusufi.

– Rrjedhojë kryesore e gjendjes sonë organizative, – ndërhyri Mirani pa pritur të vazhdonte tjetri.

– Domethënë, ti nuk ke ndërmend të pranosh se ke ndonjë faj?

– Sigurisht, unë do të pranoj hisën time, por jo gjithë fajin. Secili nga ne duhet të pranojë hisën e vetë të fajit pas të dhënave nga shokët e tjerë dhe nga Kosova. Unë kam angazhuar kunatën Sabrush që të informohet, meqë shkoi në Kosovë, se si kanë rrjedhur ngjarjet atje dhe si ka ndodhur që Vasili të arrestohet e Sadiu jo, qoftë edhe për kamuflim të veprimit të tij.

– Atëherë po e lëmë ta shqyrojmë më vonë.

2.

Nga mesi i janarit në Gjermani u kthye Sadi Bakaj. Po atë ditë në banesë të Fahriut takohen Jusufi, Demushi e Sadiu për të diskutuar se si kishte ndodhur arrestimi i Vasilit. Në fund të kuvendimit që kishin zgjatur rreth tetë orë, deri në ora tre të mëngjesit, Jusufin e kthejnë në shtëpi me automobil Demushi e Sadiu.

Sadiu u mbrojt gjatë marrjes në pyetje duke fajësuar vetëm Vasilin, se gjoja ishte i pakujdesshëm, i padisiplinuar dhe i papërvojë. Sadiun e mori në pyetje kryesisht Jusufi.

Mirani nuk pranoi të takohej me Sadiun, përkundër faktit se këtë ia kërkonin shokët. Ai vendosi t'i shkruante letër Fahriut për t'i kërkuar

Sadiut që të jepte llogari me shkrim. Ndërkohë Mirani kishte marrë informata nga Kosova se Nesim Guri ishte takuar me Vasilin, e kishte informuar se nuk i kishte telefonuar asnjëherë. Bile, e kishte qortuar, duke e këshilluar që gjithsesi të gjente mënyrën për t'u shkëputur nga Sadiu, sa nuk i kishte ndodhur më e keqja.

Takimi për të gjykuar rastin nuk u mbajt gjatë ditëve të pastajme, edhe pse u grumbulluan informata të bollshme. Mirani, Fahriu e Nazimi ishin të bindur se Sadiu e kishte tradhtuar Vasilin, kurse Jusufi kishte dilema. Demushi vazhdonte të jepte garanci për Sadiun se ishte patriot. Sadiu kishte arritur të shfajësohej përmes aktrimit të tij. Davaritje e dyshimit të Jusufit bëri që ai të mos ketë frikë më nga Sadiu, prandaj pikërisht Demushi me Sadiun po e vozisnin Jusufin mbi njëqind kilometra rrugë, sa ishin larg Nagoldi me Untergruppenbahun, pas orës tre të mesnatës, duke ia mësuar kështu vendbanimin e Jusufit edhe Sadi Bakajt. Mirani nuk këmbënguli që të mbahej takimi ku do të sqarohet arrestimi i Vasilit dhe të ndaheshin fajet, sepse gjykoi që në ato rrethana nuk ishte momenti. Sadiu ia kishte arritur që në vend se të jepte llogari për atë tradhti ndaj Vasilit, t'i bënte të mendonin të tjerët për te se ishte patriot.

Pavarësisht kësaj rrjedhe, ditëve në vijim, sipas rastit e konjunkturave, po shfaqeshin gjykime që e fajësonin Miranin më shumë sesa vetë Sadiun për arrestimin e Vasilit..

3.

E merkurë, më 11 Mars 1981. Ora: 20.30. Në Prishtinë, në mensë të studentëve ndodh shpërthimi i hapur i revoltës sociale të studentëve. Kjo do ta gjejë të befashuar gjithë mërgatën, madje edhe ata që ishin të angazhuar politikisht. Askush nuk kishte pasur parashikim konkret, e lëre më informim se mund të ndodhte kaq shpejt e kaq papritmas shpërthimi i revoltës se hapur të studentëve. Askush nuk dinte se çfarë

duhej bërë në ato çaste, pos informimit të opinionit publik të shteteve ku ata gjendeshin, duke jetuar në një gjendje ankthi se ç'mund të sillte dita tjetër.

Kosova u mbyll hermetikisht dhe informatat që dilnin jashtë ishin të pakta dhe të pasakta. Kjo ishte edhe një dëshmi kokëfortë se as ata që propagandonin se kishin organizatat e tyre të forta në Kosovë nuk merrnin informata konkrete.

Jusufi e Mirani u takuar menjëherë pas kësaj ngjarjeje historike për të biseduar se çfarë duhej e mund të bënin.

– Nuk do të bëjmë asgjë pa marrë kontakt me shokët e *Lirisë*, – shfaqti pozicionim Jusufi. Kështu e kishte më të përzemërt t'i quante ai njerëzit e OMLK-së, meqë qysh në tetor të vitit paraprak ata kishin nxjerrë numrin e parë të këtij Organi. Atij i kishte pëlqyer shumë përmbajtja, por jo forma, faqosja, letra e shtypja.

– Mirë, po ku t'i kontaktojmë? – pyeti Mirani.

– Më është dhënë një adresë kontaktuese në një librari në Zvicër.

– Atëherë po shkoj që sot në Zvicër, meqë ty akoma nuk të kanë dhënë dokument udhëtimi jashtë shtetit, – tha tjetri.

– Edhe unë them ashtu, por po presim mos po më paraqitet në telefon te Bardhi ndonjëri nga shokët e *Lirisë*, meqë numrin ia dhashë atij që ma solli adresën.

Jusufin po hezitonte të merrte vendime, meqë vazhdonte ta ndiente vetën peng të Sabit Katunriut, kurse ky ende nuk e kishte kontaktuar për t'i dhënë udhëzime, siç po priste me padurim deri në naivitet i pari.

– Jusuf, tani u pa puna. Ne vendosëm të mos e botojmë më *Bashkëtimin* pa e bashkuar organizimin tonë. Arsyetua se nuk kishte më kuptim që ta botojmë, meqë tani po botohen *Lajmëtari i lirisë* dhe *Liria* dhe nuk kemi nevojë e energji për tri botime. Duke dalë tri botime, pothuajse në të njëjtën frymë, nuk po e shtojmë ndikimin, por po i iritojmë mërgimtarët për të diskutuar e përfolur se kush mbas cilës gazetë qën-

dron.

Jusufi e Mirani pritën kot telefonatën nga Zvicëra. Meqë shokët e *Lirisë* nuk po paraqitehin vendosen që të merreshin me informim të opinionit publik gjerman. Mediat gjermane jepnin vetëm ndonjë lajm telegrafik me sqarimin se në Kosovë është shpallur gjendja e jashtëzakonshme, prandaj nuk kishin më shumë informata.

Jusufi u përpoq të arsyetonte se ndoshta shokët e *Lirisë* janë shumë të zënë, kurse Mirani e kundërshtoi, duke thënë se ata ishin futur shtatë pashë nën tokë në ilegalitet dhe vonojnë derisa të dalin në sipërfaqe për të bërë ndonjë veprimtari të dukshme, kaq të nevojshme për momentin.

Deri në demonstratën tjetër të përgjakshme të 25 Marsit, aktivitetet e veprimtarëve patriotë u përqëndruan, pos informimit të opinionit publik gjerman, në pengimin e dërgimit të telegrameve që dërgoheshin në Prishtinë e Beograd, në emër të “punëtorëve të përkohshëm”, për dënimin e demonstratave të studentëve. Këtë veprimtari të dënimin të demonstratave e drejtonin pjesëtarët e trupit diplomatik jugosllav dhe emisarët e tyre në mesin e emigracionit.

4.

Prishtinë, e martë, 25 mars 1981. Demonstrata e studentëve në lagjen e konvikteve të tyre. Për herë të parë paraqitet kërkesa politike: Kosova–Republikë! Masakrat që u bënë aty ngriten gjakërat e gjithë atyre që mendonin shqiptarisht.

Mirani, tepër i revoltuar, sërisht udhëtoi te Jusufi për të biseduar se çfarë duhej të bënin konkretisht, pas gjithë asaj përgjakjeje në Prishtinë. Ai kishte presion edhe nga aktivistët në Dyseldorf. Flitej se udhëheqja politike titiste e Kosovës kishte thirrur në ndihmë Beogradin për të dërguar forca speciale policore në Kosovë. Serbia kishte dërguar tashmë njësitë më barbare të policisë së saj.

– Miran, shokët e *Lirisë* nuk na kontaktuan ende, prandaj ti do të

shkosh në Zvicër, – tha Jusufi. – Diskuto me ta se çfarë duhet të bëjmë, meqë ata janë më të ngritur e më të organizuar se ne.

– Derisa t’i kontaktojmë ata duhet t’i udhëzojmë bashkatdhetarët që të mos na plasim grindje vrastare këndeje, – shtoi Mirani. – Diplomacia jugosllave dhe individë të UDB-së, të infiltruar në radhët e emigracionit po organizojnë tubime dezinformuese për të dërguar telegrame dënimi kundër demonstratave. Në shumë këso tubimesh, si në Bruksel, Zürich e gjetiu gati sa nuk janë vrarë mes tyre mërgimtarët tanë. Ata janë ndarë në dy grupime të mëdha: në ata që pranojnë urdhërat e këtyre strukturave që t’i dënojnë demonstratat dhe në grupimin patriotik që të mos dënohen demonstratat. Flitet se në Bruksel, njëfarë Musa Hoti ka nxjerrë revolen në tubim dhe ka kërcënuar: “Kush guxon të dalë kundër Jugosllavisë se Titos do të marrë plumb në ballë nga kjo allti!” Kështu kanë informuar shokët tanë që kanë marrë pjesë në tubim dhe që kanë guxuar të kundërshtojnë. Edhe pse shumica e mërgimtarëve nuk po pranojnë t’i dënojnë demonstratat, përfaqësitë diplomatike jugosllave dhe strukturat UDB-eske po sajojnë telegrame dënimi në emër të mërgimtarëve. Kjo është duke i revoltuar shumë patriotët. Ne duhet që me guxim ta pengojmë mbajtjen e këtyre tubimeve. Tani kanë ardhur këndeje edhe delegacione të politikanëve titistë nga Kosova. Ata po dezinformojnë mërgimtarët për karakterin e këtyre demonstratave. Kështu, në Klubin tonë në Dyzeldorf, ka ndodhur konfrontimi i hapur dhe delegacioni i konsullatës dhe i titistëve nga Kosova është detyruar të iki me bisht nën shalë, madje edhe në praninë e policëve gjermanë që kishin ardhur për t’i mbrojtur. Fatmirësisht policët e kuptuan hilen e dhënies se alarmit të rrejshëm të delegacionit dhe u thanë të pafuarëve se Klubi ka sovranitetin e tij dhe ata nuk mund t’i detyrojnë anëtarët që t’i mirëpresin ata që nuk i ftojnë dhe nuk i dëshirojnë. Kështu delegacioni u detyrua të iki nga lokalet e Klubit, i mundur e me turp.

– Në rregull, do të shpërndajmë udhëzime gojore se çfarë qëndrimi

duhet të mbajnë shokët, kurse ti shko në Zvicër. Besoj se i kontakton shokët e *Lirisë* dhe bisedo se çfarë do të bëjmë.

Mirani e miratoi udhëzimin e Jusufit.

5.

Ditën e ejte të 26 marsit, Mirani udhëtoi në qytetin Bil/Bien (Biel-Bienne) të Zvicrës. Duhej të gjente adresën kontaktuese të OMLK-së, të cilën ia dha Jusufi. Shkoi tek ajo adresë dhe gjeti vetëm një librari, në të cilën shiteshin libra edhe në gjuhën shqipe. Në kutinë postare, pos emrit të pronarit zviceran të librarisë, ishte edhe shënimi: *Liria*. Ai u fut në librari, u soll vërdallë për të parë se çfarë librash të rinj kishin ardhur. Shitësin e njëjtte që më herët, sepse atje e kishin dërguar bashkatdhetarët kur i kishin treguar se aty shiten edhe libra nga Republika e Shqipërisë. Pronarit po i kujtohej Mirani, por nuk e dinte me tamam se cili ishte. Aty shkonin bashkatdhetarë të shumtë për të blerë libra.

– Urdhëroni, keni nevojë për ndihmë? – pyeti pronari që njëherit ishte edhe shitës.

– Falemnderit, he për he nuk kam nevojë, pasi po i shikoj titujt e rinj, – tha i ardhuri.

– Ju keni qenë edhe përpara këtu, nëse nuk gabohem?

– Po, kam qenë disa herë, por ju e keni të vështirë të na mbani mend, sepse këtu vijnë shumë shqiptarë.

– Keni të drejtë, – tha dhe u tërhoq pas banakut.

Mirani vazhdoi të shikonte titujt. Pas disa minutave ai iu afrua banakut dhe u prezantua:

– Jam Miran Bruçaj, jetoj në Bohum (Bochum) të Gjermanisë.

– Benedikt Shafner, – tha shitësi duke ia zgatur dorën. – Kaq larg keni udhëtuar për të blerë libra?

– Nuk kam ardhur kësaj radhe për libra, kam një hall tjetër. Besoj mund të më ndihmoni, – tha qetësisht ardhësi.

– Urdhëroni, si mund t’ju ndihmoj!

– Jam një aktivist i lëvizjes çlirimtare në Gjermani. U takoj radhëve që nxjerrin gazetën *Bashkimi*, të cilën ju e paskeni këtu për lexim dhe për shitje, sado që ne e shpërndajmë falas. Kam biseduar edhe me shokët që e nxjerrin *Lajmëtarin e Lirisë*, që gjithashtu e paskeni këtu. Erdha të takoj shokët e *Lirisë*.

Mirani i kishte marrë në dorë nga tavolina të tri gazetatat, që të konkretizonte më lehtë hallin që kishte. Benedikti e shikoi me vëmendje dhe i tha:

– Të ulemi në dhomën tjetër të pimë nga një kafe, pastaj do të bisedojmë.

– Ju falemnderit, – ia ktheu me dashamirësi Mirani, i cili kishte parasysh se duhej të mbante takt mirësjelljeje. I njihnte disa komunistë gjermanë. Ata përdornin konspiracion të thellë dhe ruheshin nga survejimi i policisë, e cila i shërbente borgjezisë, – sië thoshin ata. Ndaj atyre që nuk i njihnin, mbanin qëndrim të përhershëm të rezervuar e dyshues. “Edhe Benedikti duhej të jetë si ata”, - mendoi me vete Mirani.

– Ju në Gjermani botoni gazeta të mira, – tha Benedikti pasi i kreu bisedat për informim personal. – Por *Liria* ka linjë më të qartë marksiste-leniniste.

– Sepse është Organizatë marksiste-leniniste, kurse ne nuk jemi.

– Keni kontakt me Partinë Komuniste Gjermane?

– I takoj ndonjëherë të enjteve në foajeun e mensës së studentëve. Aty nxjerrin një tavolinë me literaturë e material propagandistik, si shumë grupime të tjera të studentëve të universitetit.

– Domethënë nuk qenkeni bërë anëtar?

– Jo.

– Pyeta sa për informim, por nuk prish punë, shokë jemi derisa edhe ju jeni revolucionar, sipas përmbajtjes së gazetës suaj *Bashkimi*.

– Keni mundësi të më kontaktoni me shokët e *Lirisë*? – pyeti Mirani

pas një heshtjeje të shkurtër.

– Duhet të presim kur të vijmë për të marrë postën. Tjetër mundësi kontaktuese nuk kam. Ata përdorin konspiracion rigoroz.

– Po kur vijmë, zakonisht?

– Të shtunave ose të dielave.

– Po sot është e ejte, – sqaroi Mirani.

– Do të presësh këtu po dëshje t'i kontaktosh. Mbrapa kam arkivin. Aty do të të sjell një shtrat portabël.

– Nuk kam nevojë, mund të shkoj për të fjetur te ndonjë bashk-atdhetar.

– Mund të ndodh që ata të vijmë më përpara dhe do të duhej të të gjenin këtu.

– Jam dhe i pakohë që të pres aq gjatë. Ngjarjet në Kosovë po precipitojnë shumë shpejt dhe ne duhet të bisedojmë për aktivitetet e përbashkëta këtu.

– Vërtet, ju jeni të vonuar dhe nuk po e kuptoj pse keni ilegalitet kaq të thellë? Edhe ne komunistët e revolucionarët zviceranë jemi të interesuar të bisedojmë se si mund t'ju përkrahim.

– Do të dal për pak kohë t'i telefonoj një shoku, nëse mund të pres deri të shtunën ose të dielen, – tha ai dhe bëri të ngrihej.

– Nuk ke nevojë, mund të telefonosh nga telefoni im, – tha Benedikti duke sjellë aparatën mbi tavolinë.

Mirani formoi numrin e Bardhit në zyrë, meqë akoma nuk kishin vënë telefon në shtëpi. E njoftoi atë për kontaktin që ishte i mundur vetëm nëse do të priste deri në fundjavë. Folën në gjuhë gjermanishte që të kuptonte edhe Benedikti. Në fund të bisedës, kur i tha Bardhi se do ta pyeste Jusufin dhe përgjigjen do ta kthente nesër, ia kaloi receptorin Benedicktin me shpjegimin se edhe miku zviceran, ku jam mysafir, dëshiron të të përshëndesë. Mirani kishte merakun t'ia hiqte çdo dyshim atij, duke menduar se ai i kishte mundësitë t'i kontaktonte sho-

kët e *Lirisë* përmes telefoni, por akoma nuk e kishte fituar besimin. Benedikti po ashtu e sqaroi Bardhin se si ishte gjendja. Në fund të bisedës ai ia dha Bardhit numrin e telefonit të librarisë që të mund të mbante lidhje me Miranin.

Benedikti mbylli librarinë sipas orarit, solli shtratin portativ, solli edhe ushqim për Miranin dhe u ulën të hanë darkë së bashku, pa u bërë akoma terr. Ai i kishte thënë se gjermanët në Zvicër, sipas traditës e hanë darkën herët dhe të lehtë që të mund të flinin më mirë. Duke ndenjtur e duke biseduar cingërroi telefoni. Benedikti mendoi se mund të ishin shokët e *Lirisë*, por në telefon ishte Bardhi. Sapo u përshëndetën, receptorin ia kaloi Miranit. Bardhi e informoi Miranin: “Jusufi thotë se ti duhet të presësh deri sa t’i kontaktosh shokët?”.

Atë natë Benedikti e Mirani ndenjën rreth tri orë duke biseduar. Pastaj Benedikti shkoi duke i thënë ardhësit se po nuk pati gjumë mund të shikonte në arkiv të tij. Mirani u gëzua për besimin. I interesonte të dinte se si organizohet mini-arkiva personale. E fascinuan skedat e shumta me emërtime karakteristike dhe pastaj artikujt përkatës të shtypit dhe të revistave. Derisa po agonte dita nuk fjeti duke shfletuar materiale të ndryshme për lëvizjet çlirimtare në shumë vende të botës.

Të shtunën pasdite, më në fund, erdhi një burrë për të marrë postën. Benedikti e njoftoi se po e priste që nga e enjtja. Kadriut iu kujtua menjëherë emri i Miranit. Ai ishte shumë simpatik dhe linte përshtypje se ishte i moshuar. Sapo u informua nga Benedikti gëzimi iu shfaq në fytyrë dhe menjëherë u drejtua ta përshëndeste Miranin. U prezantua me emrin “Zeqa” dhe u përqaftuan sikur të ishin shokë prej kohësh, por që nuk ishin parë qëkur. Vetëm në minutat e parë Benedikti zuri vend në tavolinë, sa për të zbratur kafet nga termosi. U ngrit me shpjegimin se dëshironte t’i linte të bisedonin shqip.

– Kam ardhur të enjtën. – filloi Mirani. – Biseduam me Jusufin se çfarë duhet të bëjmë në këtë situatë kaq dramatike e alarmante. Ai më

tha se duhet të bisedojmë me shokët e *Lirisë*, që të koordinohen aktivitetet në të gjitha shtetet ku gjendet emigracioni ynë. Erdha t'ju kontaktoj dhe të bisedojmë se cili është mendimi juaj?

– Unë t'u prezantova në prani të Benediktit me emrin Zeqë, por unë në të vërtetë e kam emrin e mbiemrin Kadri Zeka. Jam nga Gjiçani, i strehuar politik këtu në Zvicër. Je ndër pak veta që po ta tregoj emrin e vërtetë, por të lutem mos më dekonspiro!

Në fillim Kadriu paraqiti gjendjen në Kosovë, siç e kishin informuar shokët e organizatës se tij, pastaj bëri një analizë të përmbledhur:

– Ne duhet të fillojmë me demonstrata. Të parën duhet ta bëjmë pas nja dy javësh, meqë më një prill planifikohen demonstrata të mëdha në Prishtinë...

– Domethënë për ditën e rrenëve... – ndërhyri me shaka Mirani.

– Qenkan të vërteta ato që kam dëgjuar për ty, se nuk je komunist i disiplinuar, – tha Kadriu, i pakënaqur me këtë shaka të Miranit. – Tani jemi duke biseduar gjëra serioze...

– Më fal! Vërtet nuk jam komunist dhe aq më pak komunist i disiplinuar, siç kërkoni ju komunistët, sepse atë lloj discipline nuk e pëlqej dhe nuk mund t'i pëmbahem. Këtë përcaktim, siç e kam, e kam me qejf dhe prandaj me qejf i shoqëroj bisedat ndonjëherë me shaka. Them se edhe në front përballë armikut luftëtarët bëjnë ndonjë shaka, prandaj jeta nuk duhet të jetë kaq serioze sa e merrni ju marksistë-leninistët...

– Në rregull, po vazhdoj aty ku më ndërhyre. Shokët po merren me organizim të demonstratës që duhet të shpërthejë më një prill dhe duhet të presim se çfarë do të ndodhë. Populli është revoltuar shumë nga masakrat e 25 marsit. Them që të organizojmë pastaj demonstrata edhe ne në Perëndim. Propozoj që Jusufi të merret me hartimin e fjalimeve, kurse ti merru me hartim të trakteve për të huaj dhe fol gjatë demonstratave në gjuhën gjermane, nëse nuk gjejmë gjermanfolës. Unë do të flas në shqip, meqë kam zë të fuqishëm. Të parën demonstratë mendoj ta orga-

nizojmë në Bern, meqë në Zvicër janë mërgimtarët më të rinj dhe më të arsimuar. Për datë konkrete mund të vendosim pastaj, por që tani propozoj të shtunën, më 11 prill. Kështu do t'i planifikojmë demonstratat vijuese: nga një çdo të shtunë, në kryeqytetet e metropolet evropiane. Duhet t'i bëjmë të shtunave, meqë mërgimtarët nuk punojnë. Thirrjet për demonstratë do të lëshohen në emër të tri organizatave tona, ose për secilën demonstratë thirrja do të lëshohet vetëm në emër të një organizate, duke u ndërruar me radhë. Varet se cilin variant e dëshiron Shoku Jusuf. Shokët në Kosovë udhëzojnë që ne të dalim vetëm me kërkesën: *Kosova-Republikë!* Je dakort me propozimet e mia?

– Si, nuk do të vazhdojmë të kërkojmë çlirimin e Kosovës me visë dhe bashkimin me Republikën e Shqipërisë, – pyeti i habitur Mirani.

– Jo, kërkesat tona të mëparme do t'i tkurrim vetëm në kërkesën: Statut Republike për Kosovën dhe barazi nacionale në kuadër të Jugosllavisë. Nuk kemi fuqi për më shumë sepse Jugosllavija është e fortë ushtarakisht. Pastaj bashkësia ndërkombëtare po mban anën e Beogradit. Perëndimi dhe Lindja janë në garë se kush ta përkrahë më shumë Jugosllavinë. Ne duhet t'u përmbahemi kërkesave të forcave tona dhe të popullit në Kosovë.

– Domethënë na u dashka të bisedojmë për këtë ndryshim kaq të madh, që t'i bindim bashkatdhetarët. Njëherit duhet të bisedojmë edhe për formën e organizimit tonë jashtë, – shtoi tjetri.

– Do t'i bëjmë në të ardhmën e afërt, por tani duhet t'i përcjellim ngjarjet brenda dhe të shpresojmë se forcat e organizuara atje do të bashkohen për t'i dalë zot revoltës së popullit.

– Se mos është vonë...

– Nuk kemi kohë të mendojmë ne tani, – ndërhyri Kadriu. – Me rëndësi është që të merremi me veprimtari konkrete, atë që propozova. Shpresoj se je i pajtimit.

– Unë për vete po. Besoj se edhe Jusufi pajtohet, meqë më ka autor-

izuar ta përfaqësoj edhe atë. Ne të Frontit kemi vendosur të ndërpresim botimin e *Bashkimit* pasi ju keni filluar ta nxirrni *Lirinë*, kurse Jusufi *Lajmëtarin* qysh vitin e kaluar. Duke shpërndarë tri gazeta në të njëjtat mjedise vetëm sa po i iritojmë bashkatdhetarët. Njëherit edhe organizimin e Frontit do ta ngrijmë, meqë mendojmë se është koha e fundit që ne të bashkohemi në një organizatë. Prandaj duhet të vendosni ti dhe Jusufi nëse do t'i thërrisni demonstratat në emër të organizatave tuaja përkatëse. Ne do të heqim dorë që të lëshojmë thirrje në emër të Frontit.

– Cilat janë arsytet e tjera pse nuk doni të lëshoni thirrje për demonstrata në emër të Frontit? – u bë kurioz Kadriu.

– Sepse demonstratat do t'i bëjmë në Perëndim dhe emri i Frontit provokon asociacione të të qenit ekstremistë, bile edhe terroristë dhe kështu, në vend që të ndihmojmë Kosovën, do ta dëmtojmë atë.

– Arsyetim interesant, u dashka të mendojmë edhe ne për taktikën që duhet të ndjekim këtu, por për këtë do të bisedojmë e do të vendosim kur do të takohemi. Mendoj se u sqaruam, sepse nuk kemi kohë për të humbur.

– Dakord! Së fundi më intereson të di nëse ishte i radhëve tuaja njëri që më vizitoi në tetor të vitit 1979. Ishte thatim dhe me mustaqe të holla.

– Po, e kemi udhëheqës idopolitik. Më vonë do të dëgjosh më shumë për të dhe ndoshta do të kesh rast ta takosh.

– Sa shumë ndryshoni! Ai kishte natyrë fodulle dhe gati sa nuk e pata përzënë nga banesa. Nga ai qenke informuar se unë nuk jam komunist dhe i disiplinuar.

Miranit kishte merakun të dinte se cili ishte ai njeri që i kishte folur me kompetenca të mëdha, por me fodullëk edhe më të madh, duke pozuar klasikun e marksizëm-leninizmit.

– Nuk kemi kohë të merremi me të tilla sqarime. Tani po na presin punë të mëdha, – ndërhyri Kadriu, përkundër faktit se tjetri deshi të zbrazte inatin e paharruar për kaq kohë ndaj vizitorit të dikurshëm.

– Atëherë unë po shkoj dhe po e informoj Jusufin për bisedën tonë. Ja ku po ta shënoj numrin e telefonit të punës të Bardhit. Mund t’i telefonosh pasdite dhe të lidheni me Jusufin. Kurse këtu e ke numrin tim në konvikt. Kur të lajmërohet centralisti, do kërkosh dhomën numër 205. Po ta jap edhe numrin e familjes së vëllait, meqë tani rrallë jam në banesë dhe që andej do të informohem për porosinë tënde.

6.

Mirani gjeti lidhjen e parë të trenit dhe u kthye në Shtutgart. Aty po e prisnin Fahriu e Nazimi. Bashkë shkuan te Jusufi. Ai informoi për bisedat me Kadriun. Jusufi u pajtua duke saktësuar se demonstratat do t’i thërrasin në emër të organizatave sipas radhës. E para le të thirret në emër të OMLK-së, pastaj në emër të Frontit dhe e treta në emër të Lëvizjes. Mirani i tregoi se të Frontit nuk do të lëshojnë thirrje dhe e arsyetoi këtë vendim.

– Miran, ti tani do të shkosh në Vjenë t’i takosh shokët në Ambasadën Shqiptare, – tha Jusufi. – Ata do t’i pyesësh çfarë mendojnë, nëse e kemi mirë me këto që kemi planifikuar. Mbase mund të gabojmë dhe në vend që të ngjesim vetulla, nxjerrim sy, siç thotë proverbi popullor.

– Unë mendoj se nuk është e nevojshme. Edhe po të shkoj nuk do të marrë përgjigje konkrete, sepse do të thonë se nuk na përzihen në punët tona dhe se çfarëdo që bëjmë ne, atyre nuk ju intereson...

– Patjetër do të shkosh, pasi unë nuk pranoj të fillojmë demonstratat pa e ditur mendimin e tyre! – këmbënguli Jusufi.

– Ja që ata nuk do të japin mendim dhe bile mund të keqkuptohemi se mos po i provokojmë. Kushedi se çfarë hallesh kanë në Republikë të Shqipërisë. Ende nuk po dalin me asnjë qëndrim për ato që po ndodhin në Kosovë, pos me lajme telegrafike...

– Nuk ke përse merakosësh ti për politikën e Partisë së Punës në krye me Shokun Enver! – e preu Jusufi.

– Por, mua nuk po më pëlqen heshtja e tyre...

– Do të shkosh në Vjenë apo ta dërgojmë dikë tjetër meqë unë nuk kam dokument udhëtimi? – pyeti kushtëzueshëm Jusufi duke mos dëshiruar të bisedohet më për qëndrimin politik të shtetit shqiptar lidhur me protestat e demonstratat në Kosovë.

– Nuk po përtoj të shkoj, por kam parandjenjë se mund të keqkuptohemi. Dhe, meqë po shkoj, do të them se më ka dërguar Jusufi.

– Në rregull, ti do t'i informosh sakësisht dhe do të kërkosh mendimin e tyre.

– Po nuk më besove se do t'i paraqes saktësisht tezat e tua, atëherë m'i shkruaj që t'ua dorëzoj!

7.

Të hënën Mirani u paraqit në Ambasadën Shqiptare në Vjenë. Derën e gjeti të mbyllur. I ra zilës dhe nuk po i përgjigjej njeri. Priti disa çaste dhe i ra zilës prapë. Pas një pritjeje u paraqit një zë burri:

– Urdhëroni, kush jeni?

– Jam Miran Bruçaj, vij nga Gjermania.

– Kë kërkoni?

– Shokun Simon.

– Nuk është këtu, ka ikur në Tiranë.

– Atëherë ambasadorin.

– Nuk është këtu për momentin.

– Ma hapni derën, dua t'ju takoj juve.

– Unë nuk ju njoh.

– Do të njoftohemi. Kështu i prisni vëllezërit ju?

– Urdhëroni, urdhëroni, por mendova se dëshironi takim konkret me ndonjërin nga personeli i ambasadës.

Çelësi elektrik zhurmoi. Mirani shtyu derën dhe u fut brenda. Në krye të shkallëve e priste një burrë thatim, pothuajse qeros. U përshën-

detën dhe hynë në një dhomë të vogël të pritjes së parë, në krye të shkallëve. Mirani nisi t'i rrëfente se përse kishte shkuar.

– Më ka dërguar Shoku Jusuf Gërvalla t'ju infomoj se kemi ndër mend të fillojmë demonstrata që nga e shtuna e ardhme. Do ta thërrasim mërgatën tonë që t'i përkrahim demonstratat dhe kërkesat e studentëve të Kosovës dhe të protestojmë kundër dhunës policore jugosllave. Shokut Jusuf i interson mendimi juaj...

– Mendimet tona, Partia jonë e Punës dhe Shoku Enver i shprehin publikisht, prandaj nuk keni pasur nevojë të vini që andej që të dini mendimin tonë, – ndërhyri brutalisht diplomati, të cilin Mirani nuk e njohte dhe ai nuk u prezentua.

– Sigurisht që Qeveria Shqiptare i shpall publikisht qëndrimet e veta, por ne na intereson të dimë, nëse bëjmë mirë të fillojmë me demonstrata? – u mundua të sqaronte sa më konkretisht e qetësisht Mirani.

– Punët tuaja nuk na interesojnë. Qëndrimet tona i kemi të hapura dhe prandaj nuk kemi përse të bisedojmë më!

Mirani u irritua nga prononcimi i diplomatit që s'kisht aspak takt diplomatik.

– Ju kuptoj, edhe shteti shqiptar po hesht për ato që po ndodhin në Kosovë, sado që shumë shtete të botës po i dënojnë rapresaljet policore ndaj demonstratave të studentëve në Prishtinë.

– Ju thashë, biseda mbaroi dhe tani duhet të ikni! – urdhëroi diplomati.

– Më falni, jam në Ambasadën Shqiptare apo në shtëpinë tuaj private?

– Si, doni edhe të më provokoni!

– Nëse nuk e kuptuat pyetjen, atëherë dëshiroj ta di, jeni apo jo shqiptar, pasi shqiptari nuk sillet kështu ndaj vëllait kur është në hall. Kurse sa i përket urdhërit për të dalë nga Ambasada, zotëri, nuk më përzini dot se nuk e keni shtëpi private. Kjo Ambasada, aq sa është e

juaja është edhe imja. Ju vetëm paguheni për të shërbyer, por për të shërbyer njerëzisht dhe jo kështu me këtë arrogancë...

– Përrjashta! Ju doni të më tregoni mua...

Diplomati nuk arriti ta shqiptonte kërcënimin, meqë Mirani kërcëu me vrull mbi tavolinë, si sportist që ishte dhe e mbërtheu për zverku.

– Kujt i hakërrehesh kështu, mor maskara? Mos po mendon se Republikën e Shqipërisë e ke pashallëk, të trashëguar nga babai? – thirri me zë të lartë Mirani, i hidhëruar deri në egërsim.

Diplomati ulëriti: – Ndihmë! Ndihmë!... – por zëri iu ndal, pasi tjetri ia shtrëngoi zverkun.

Menjëherë në dhomë hyri një nëpunës dhe pas tij edhe ambasadori, I.B. Sapo e pa ambasadorin, Mirani e lëshoi diplomatin. Ai e kishte takuar ambasadorin në Zvicër gjatë pranisë së tij në një koncert që shfaqte Ansambli Shtetëror. Aty kishin biseduar vëllazërisht. Kishin dalë shumë veta për ta përcjellë pas koncertit. Kur Ambasadori bëri të hipte në makinën zyrtare, priti t'ia hapte shoferi derën e pasme në krahun e djathtë. Mirani i qe afuar: “Ti na qenke komunist e jo mahi, pret si pasha të ta hapin derën”. Ambasadori ishte arsyetuar: “Kështu e kërkon protokollin” dhe ishte futur me shpejtësi në automobil. Disa të pranishëm i thanë Miranit: “Mirë ia punove, se ishte veprim i shëmtuar!”.

– Miran, ke luajtur mendsh!? – thirri ambasadori duke ia hedhur dorën rreth qafe.

– Unë nuk kam luajtur mendsh, por ky farë maskarai, që paguhet të përfaqësojë shetit tonë. Me gjasë nuk qenka shqiptar! – tha ai duke u dridhur nga inati e egërsimi.

– Po pse nuk erdhe tek unë? – pyeti me takt ambasadori.

– Më gënjeu ky pra. Tha se nuk ishit këtu.

– Eja të pimë nga një kafe në zyrën time!

Mirani e kapi për qafe dhe e përshëndeti me dashamirësi të madhe. Pastaj që të dy u ngjiten shkallëve. Ambasadori vazhdonte t'ia mbante

dorën rreth qafës. Atij tashmë iu kishte zbutur egërsimi i pakontrolluar.

Ambasadori nxori nga një gotë raki mbi tavolinë, porositi t'i sillnin edhe kafe.

– Miran, më trego tashti se përse u zutë? – tha urtësisht ambasadori.

– U soll harbutçe, – ia ktheu tjetri.

– Si qe puna, ma trego më gjerësisht! – e luti sërish ambasadori.

Mirani ia tregoi gjithë rrjedhën duke mos shfaqur asnjë pendim.

– Miran, më dëgjo tani mua se të kam si çun. Ai ka ardhur rishtas, nuk ju njeh dhe nuk di gjë për angazhimin tuaj patriotik. Jusufit do të m'i bësh shumë të fala. Sa për mendimin tonë, nuk dimë çfarë t'ju këshillojmë, pasi akoma Udhëheqja jonë nuk ka dalë me qëndrime. Mendimi im personal, si patriot, është që ju bëkeni mirë që do të demonstroni.

– Përse sillni njerëz të painformuar dhe që nuk dinë të mirëpresin qoftë edhe provokatorët? Diplomati duhet të mos provokohet, – shprehu habinë protestuese Mirani, i kënaqur me përgjigjen që mori nga ambasadori, duke pandehur se ai ishte qëndrim edhe i shtetit, por që me marifet ambasadori ia tha si “mendim personal”.

– Herë pas here bëhen ndërrime, sipas konventës përkatëse. Personelin e cakton sektori përkatës në Ministrinë e Jashtme dhe unë nuk mund të kërkoj ke dëshiroj, – tha prajshëm ambasadori.

8.

I mërziur për ato që përjetoi, Mirani mori taksinë për në Vestbahnhof, prej ku udhëtohej për në Gjermani. Mori trenin e parë në drejtim të Shtutgartit. Telfonoi që ta prisnin në stacion duke treguar orën e arritjes. Prej andej me makinë shkuan te Jusufi.

– Besoj të kesh qenë, sado që u ktheve shumë shpejt! – shprehu dyshimin në fillim të bisedës Jusufi.

– Nuk jemi këtu në Kosovës. Ti ende nuk ke udhëtuar me tren.

Mbrëmë u nisa, sot në mëngjes isha në ambasadë dhe u ktheva. Lidhjet ishin të mira dhe të shpejta. Mos mat me kut të Kosovës! – tha tjetri.

– Kot thashë, sepse pate kundërshtuar që të shkoje. Po si të pritën dhe çfarë të thanë?

Mirani po mendohej nëse duhej t'ia thoshte gjithë të vërtetën. Edhe gjatë udhëtimit me tren e kishte menduar këtë dilemë. Një mendje i thoshte se duhej t'i tregonte të gjitha, ashtu siç i kishte ndodhur dhe çfarë i kishin thënë. Tjetra ishte kundër, pasi Jusufi do t'i hidhërohej. Gjatë rrugëtimit me tren ishte ndier i mërzitur për sjelljen e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë, për heshtjen e Qeverisë Shqiptare, për shumë gjera që kishin të bënin me këto...

– Trego, përse po hesht!? – ia preu fillin Jusufi.

– Po mendoja gjëra koti dhe harrova që më pyete. Pastaj, nata është e jona, dita e zotërisë, thotë populli. Nuk kemi përse të ngutemi.

– Mirë, mirë, por mua po më intereson mendimi i shtetit shqiptar për demonstratat që kemi në plan të bëjmë, – insistoi Jusufi.

– Mendim zyrtar nuk m'u tha, – u përgjigj Mirani. – Ambasadori I.B. të përshëndeti. Ai tha se Qeveria e Partia ende nuk kanë dalë me qëndrime, por mendimi i tij personal ishte që ne bëjmë mirë me thirrje e organizim të demonstratave...

– Kaq na mjafton, sepse ai nuk thotë mendime personale, por qëndrime të Partisë e të Shokut Enver dhe i kamuflon ato si mendime personale.

– Ashtu mendon ti, por nuk duhet të jetë krejt ashtu. Personeli i Ambasadës dukej i irrituar. Me njërin nga ata, që nuk e njihja, ndërrova ca llafe të rrebta...

– Se mos je fjalosur!? – shprehu habinë pytëse Jusufi.

– Jo more, nuk u fjalosa, por bëmë debat.

– Miran, kështu po ia prish vendin vetës. Edhe para pesë muajve kur u takuam me Simonin e Engjëllin, e kapërceve kufirin. Shpesh po të

ndodh të bësh biseda pa takt. Më dike na duhet ta kemi mirë.

– Më ke qortuar dy-tre herë për atë takim dhe tani, meqë kemi distancë të bollshme kohore, jam i interesuar ta diskutojmë, që të mos ma rikujtosh edhe ndonjëherë.

– Jo more, nuk kemi nevojë, kemi për të biseduar mjaft për punë më konkrete.

– Kohë kemi për të biseduar sa të kemi nevojë, meqë aktualisht nuk po i ndjek ligjëratat në universitet.

– E përse dëshiron të bisedosh për atë takim tani? – pyeti Jusufi.

– Sepse herë pas here me ke bërë fajtor dhe kjo ndodhi edhe sot.

– Arsyetohu se nuk ishe fajtor që ta ndryshoj edhe unë mendimin.

– Të kujtohet, ti i kërkove takim Simonit. Ai erdhi me Engjëllin dhe u takuam në pushimore të autobanit. Takimin e kishe kërkuar ti për t'i lutur për vizë që të vizitoje Republikën e Shqipërisë. Para takimit unë thashë se do t'i shpreh ca mendime kritike ndaj tyre. Të bëra me dije se ata shtirën sikur hidhërohen kur nuk ju pëlqejnë kritikrat dhe ndërpresin takimin. Të pata propozuar që ti të ndërhyje, po hetove se mund ta ndërprisnin takimin. Bile të pata propozuar që në rast të tillë, ti të më bërtasësh që ta mbyll gojën dhe pastaj të vazhdoje bisedën me ata. Ti u pajtove sepse unë të tregova se përse nuk na lejojnë ta vizitojmë Republikën e Shqipërisë. U takuam. Ti ua shfaqe dëshirën dhe lutjen për ta vizituar Republikën e Shqipërisë. Ata të thanë se do të ta plotësonin dëshirën kur të marrësh dokument udhëtimi. Unë nuk u durova. Të thashë mos ju beso, sepse unë kisha pasaportë, kisha kërkuar disa herë vizë dhe nuk ma jepnin. Më bënë demagogji se gjoja është me rrezik për të hetuar jugosllavët dhe pastaj do të më akuzonin se jam agjent i Sigurimit. Ua thashë se e vërteta është se nuk dëshironi të na mundësoni ta vizitojmë Republikën e Shqipërisë të cilën ne e idealizojmë, meqë do të zhgënjeheshim. Pastaj nuk u përmbajta dhe vazhdova edhe me mendime të tjera. Në fund u hidhëruan kur u thashë me ironi se Shqi-

përia e Ahmet Zogut ka bërë më shumë për çlirimin e Kosovës se sa Shqipëria e Enver Hoxhës. Kërkuan argumente. U thashë se atëherë, të paktën që toleruar Komiteti për Kosovën me seli në Shkodër, që drejtohej nga Hoxhë Kadriu... Kjo është paraqitja telegrafike e bisedës sime të atëhershme. E paraqita besnikërisht?

– Korrekt, por ne qemë marrë vesh që ti të shfaqje mendimin kritik vetëm sa i përket vizës, – saktësoi Jusufi.

– E vërtetë, por ja që unë nuk u durova pa i thënë edhe të tjerat. Ta zëmë se shfaqja mendime të gabuara, përse kishin nevojë të hidhëroheshin dhe ta ndërprisnin takimin?

– Sepse ti shprehe mendime kritike për të cilat ata e kanë të ndaluar të debatojnë.

– Domethënë, ata nuk kanë liri as për të menduar?

– Prandaj i thonë diktaturë e proletariatit.

– E cilit proletariat more? Mos u tall se nuk jemi nën komandë të asaj farë diktature që vetëm e proletariatit nuk është. Po të ishim atje, për këto biseda do të përfundonim në burg.

Mirani nuk e kishte liruuar plotësisht mllëfi nga ambasada dhe nga heshtja e Tiranës, ndaj e humbi taktin edhe karshi Jusufit.

– Nuk kemi nevojë të debatojmë tani për atë sistem dhe qëndrimin politik të Tiranës, sepse se shpejti do të dalin publikisht, por janë duke e pëshuar mirë. Unë e kisha hallin se ti nuk po tregon takt dhe nuk po le hapësirë ta kemi mirë me ata të cilat i kanë gjërat në dorë sa i përket çlirimit e bashkimit të Kosovës.

– Për aq sa i kanë në dorë.

– Në kohë e hapësirë dominon politika përkatëse dhe ne duhet t'i përmbahemi. Le ta përfundojmë këtë bisedë, sepse kemi punë të tjera.

– Nuk ke të drejtë, në kohë e hapësirë dominon edhe politika pushuese ndaj nesh, por ne po rrezikojmë edhe jetën tonë që ta ndryshojmë, – këmbënguli Mirani duke mos përfillur propozimin e Jusufit për

të ndërprerë këtë bisedë. – Ta zëmë, ti rezervohesh për të treguar se Simoni të ka kritikuar për përmbajtje të *Lajmëtarit*, e sidomos të botimit të posterit me portretin e Enver Hoxhës. Edhe pse dukesh i dëgjueshëm ndaj tyre, vazhdon të mos iu përmbahesh udhëzimeve e kritikave që të bëjnë.

– Vërtet do të na fusësh në debat pa fund. Ne na duhet të vazhdojmë veprimtarinë tonë, siç mendojmë ne.

– OK! – bëri Mirani.

– Thuaj “në rregull”, pasi e kam bezdi të përdorën fjalë të huaja në gjuhën tonë të mirë e të pasur shqipe! – këshilloi Jusufi. – Tani, mendoj që ti të hartosh traktin në gjuhën gjermane, që ta diskutojmë bashkarisht pasi ta kesh formuluar, unë po përgatis fjalimin për demonstratë. Thirrjen e kam bërë gati, siç u morëm vesh në telefon me Zeqën. Për thirrje kësaj radhe kemi përdorur ballinën e gazetës *Liria*. Që nesër e deri ditën e demonstratës duhet të dalim për të takuar bashkatdhetarë që t’i bindim të dalin sa më masivisht. Ti e di se sa frikësohen ata që të dalin hapur kundër pushtuesit.

9.

Në demonstratë të Bernit dolën vetëm rreth katërqind demonstrues. Gjatë rrugës brohoritnin parulla. Gjermanisht foli miku zvicëran Misheli, kurse fjalimin qëndror në shqip e mbajti Kadriu. Pjesëmarrësit i mbanin ison Mishelit që brohoriste me megafon të instaluar mbi automobil. Demonstratën e kishte paraqitur tek organet policore po Misheli. Zvicëranët, në dy anët e rrugës, shihnin me kureshtje, se paska në Zvicër edhe shqiptarë, meqë deri atëherë kishin menduar se nga Jugosllavija ishin aty vetëm jugosllavët. Një pjesë e madhe e demonstruesve ishin të maskuar, kishin vënë syze, mustaqe e ndonjëri edhe mjekër, që të mos mund të identifikoheshin. Kishin frikë se do ta humbisnin pasaportën jugosllave dhe statusin e të qëndruarit në shtetet përkatëse të Evropës

Perëndimore. Kishte nga ata që nuk e kishin as idenë se çfarë do të thotë demonstratë. Miranit i kishte rastisur të dëgjonte: “Duhet të marrim armë me vete, sepse në demonstratë do të ballafaqohemi me serbë dhe të tjerë që janë kundër demonstratave në Kosovë?”

Pas kësaj demonstrate, tjetra në vijim u vendos të bëhej në Zürich, më 18 prill, në Shtutgart, më 25 prill, në Dyzeldorf, më 9 maj, në Mynhen, më 16 maj, në Gjenevë, më 30 maj, në Frankfurt, më 7 qershor dhe në Bruksel, më 13 qershor. Për këtë renditje ndikuan kërkesat e bashkatdhetarëve në qytetet përkatëse, të cilat i miratuan Jusufi, Kadriu e Mirani. Kjo bashkëveprimtari konkrete po zhvillohej si të ishte e organizuar vetëm nga një organizatë dhe jo nga tri, meqë mirëkuptimi midis tyre ishte në nivelin më të lartë të mundshëm.

Në demonstratën e Shtutgartit plasi sherri. “Diplomatë” të konsullatës jugosllave dhe informatorë të tyre të kamufluar si “punëtorë të përkohshëm” kishin zënë pozicion në një banesë në qendër të Shtutgartit ku dinin se do të kalonte demonstrata. Prej aty ata donin të fotografonin për të identifikuar demonstruesit. Bardhi me disa kujdestarë të tjerë i heton dhe ua thyen aparatët e kamerat duke e goditur edhe me grushta ndonjërin prej atyre që kishte guxuar të rezistonte. Në mesin eurvejuesve ishte gjendur edhe “diplomat” B.H. Policia gjermane ndërhyri në përleshjen e tyre, i identifikoi pjesëmarrësit, por jo të gjithë, sepse disa mundën të iknin.

Pas demonstratës disa aktivistë të rrethit të Shtutgartit ishin mbledhur për të analizuar rrjedhën e demonstratës. Kishte nga ata, si Nuriu e Xhafari, që kishin shprehur pakënaqësi nxitëse, se vetëm ai i *Lirisë* po afirmohej me fjalimet që mbante, kurse Jusufi po vazhdonte të mbetej anonim. Kadriut nuk kishin denjuar t’ia përmendnin as emrin, por thoshin: “ai i Lirisë”. Vetë Jusufi ishte detyruar të ndërhynte që të ndalonte pëshpërimat e tilla, duke sqaruar se në ndarje të punëve ishte ai që kishte bashkëvendosur.

Më 9 maj u bë demonstrata në Dyseldorf, por askush nuk pati vërejtje, meqë aktivistët e këtij rrethi ishin përkujdesur që gjithçka të shkonte mbarë. Edhe policia e këtij qyteti kishte më shumë kujdes që kur në Klub kishin ndodhur një mori ndërhyrjesh e presionesh nga konsullata, nga korrespondenti i “Rilindjes”, nga delegacioni i Prishtinës. Për këto policia ishte informuar dhe po përkujdesej me përkushtim të mbronte Klubin dhe shqiptarët në këtë qytet. Për këtë kishte garantuar edhe vetë Ministri i Brendshëm i kësaj Republike, në përgjigjen e letrës që ia kishte dërguar Klubi.

Më 16 maj u zhvillua demonstratë në Mynih pa asnjë incident, por gjatë diskutimit të mbarëvajtjes së kësaj demonstrate Jusufit, Kadriut e Miranit iu doli një pikëpyetje enigmatike: Nga i kishte siguruar televizioni i Beogradit incizimet e demonstratës, të cilat i paraqiste në edicionin e lajmeve!? Ishin shfaqur edhe incizime të bëra në afërsi, kurse ata e dinin se nuk kishin lënë të regjistronte asnjë qendër televizione të huaj për shkak të sigurisë së pjesëmarrësve. Në fund ishte konstatuar se kujdestarët e demonstratës e kishin lejuar vetëm Xhahilin dhe ato duhej të ruheshin për arkivin kombëtar. Tani vinte dyshimi se mos Xhahili i kishte dërguar kopje e regjistrimeve, prandaj u mor vendimi të hulumtohej. U krahasuan ato me regjistrimet r emetuara nga televizioni i Beogradit. Meqë u konstatua se ishin identike, u vendos që atij t’i ndalohej incizimi i demonstratave të tjera. Ai kot u mundua t’i bindte se origjinalet i kishte dorëzuar të organizatorët një javë më vonë.

Edhe demonstrata e 30 majit në Gjenevë, e cila nisi në qendër dhe përfundoi para Selisë së OKB-së, kaloi pa incidente. Demonstruesit u gëzuan kur në OKB u pranua një delegacion për të dorëzuar peticionin e demonstratës. Në këtë demonstratë nuk mundi të marrë pjesë Jusufi për shkak të mungesës së dokumentit të udhëtimit.

Për demonstratën që duhej të mbahej në Frankfurt të shtunën, më 7 qershor, Jusufi, Mirani e Bardhi shkuan dy net përpara tek Ahmad

Sadeku për të parë se si kishin vajtur parapërgatitjet. Ata shkuan te adresa e Ahmadit që ai ia kishte dhënë Bardhit. Doli se ishte adresë falso. Pastaj shkuan te barakat e ca emigrantëve duke shfrytëzuar adresat që i kishte Mirani. Aty u informuan se ata nuk dinin gjë për mbajtje të demonstratës. Pyetën nëse e njihnin Ahmadin, se ai e kishte marrë për-sipër informimin e emigrantëve të Frankfurtit me rrethinë. Ata thanë se e njihnin, por nuk donin të kishin punë me të, meqë e pandehnin informator të konsullatës jugosllave në Frankfurt dhe mashtrues e gënjeshtar. Madje gënjente pa pikë turpi kinse ishte student në universitetin e qytetit. Këto informata e zhgënjyen Jusufin, Miranin e Bardhin. Edhe vetë Ahmadit dukej se i ishte mbushur mendja në gënjeshtrenë që kishte sajuar e përhapur vetë, prandaj sorollatej shpesh në mensë të studentëve.

Me ndihmën e emigrantëve, Jusufi, Mirani e Bardhi, gjeten adresa të reja, të cilat ai i kishte shpërndarë, por të gjitha dolën falso. Vizituan dhe informuan edhe shumë emigrantë të tjerë. I bindën të dilnin sa më shumë veta në demonstratë, duke iu dhënë zemër se do të bëheshin shumë, meqë do të vinin nga të gjitha anët e Evropës Perëndimore dhe kështu nuk do mund të identifikoheshin nga survejuesit dhe spiunët. Gjykuan se nuk kishte kuptim të bënin vizita të tjera, ngase ishte bërë vonë dhe emigrantët duhej të dilnin herët në punë të rënda. Mendonin të ktheheshin në Untergruppenbah për të fjetur dhe prej andej të ktheheshin sërish të nesërmën që të gjenin Ahmadin dhe të informonin të tjerë bashkatdhetarë. Më në fund vendosën të flinin në Frankfurt, në makinë, ca orë nate që kishin mbetur derisa të agonte dhe kështu kursenin karburantin. U skajuan në një vend të përshtatshëm, me bindjen se aty nuk do t'i trazonte policia. Aty zunë të diskutonin me shqetësim se mos Ahmadi nuk e kishte paraqitur demonstratën! Liria e demonstrimit në Gjermani ishte e garantuar dhe procedura ishte thjeshtësuar. Mjaftonte vetëm lajmërimi dhe të dhënat se kush dhe përse do të demonstronte dhe kush do ishte personi përgjegjës dhe kontaktues.

Këtë e diskutuan një copë here në makinë dhe pastaj bënë një sy gjumë. Në mëngjes herët e diskutuan mundësinë e lëvizjes për ta gjetur Ahmadin. Fillimisht shkuan në ca adresa të reja që t'i informonin bashk-atdhetarët, por nuk i gjetën aty, meqë banuesit kishin ikur në punë. Nëndyerve të tyre dhe në kutitë postale futën nga disa kopje të njoftimit për demonstratën, me shpresë se ata kur do ktheheshin nga puna do t'i shpërndanin në adresat që dinin. Në mesdite shkuan në mensë të studentëve, meqë as me telefon nuk e kapnin dot Ahmadin. Në mensën gjigante po drektonin mijëra studentë. U endën një copë herë nëpër foajeun e mensës, pa shpresë se në gjithë atë mori mund ta gjenin atë. Foajeu ishte përplot me tavolina, me materiale informative e propagandistike. Tavolinat shtriheshin në dy rreshta të gjatë, që nga hyrjet kryesore, duke krijuar një si rrugë në mes, në mënyrë që studentët të merrnin materialet që u interesonin. Studentët që qëndronin prapa tavolinave ishin aktivistë të grupimeve të ndryshme, që nga djathtuzmi ekstrem, të cilët nga majtistët quheshin neofashistë e deri të ekstremi i majtë, komunistë/marksistë-leninistë, simpatizantë të Fraksionit të Kuq Ushtarak, i cili në opinion njihet si RAF. Organet e shtetit e kishin ndaluar dhe e ndiqnin si organizatë terroriste. Midis këtyre dy spektreve ideopolitike ishin studentët demokristianë, socialdemokratë, liberalë, ekologjistë, të lëvizjes për paqe e të tjera. Dominonin grupimet komuniste me orientim maoistë, pro Bashkimit Sovjetik e Gjermanisë Lindore, me idhujt e tyre Marks, Engels, Lenin e Brezhnjev. Pastaj vini ata pro Stalinit e Enver Hoxhës, trockistë, buharinistë, përkatësisht anarkistë e të tjerë. Edhe të huajt, sidomos studentët nga Irani e Turqia, kishin tavolinat e tyre me literaturë në gjuhën amtare dhe në gjuhën gjermane, por ata vinin me grupime të vogla, me përcaktime ideologjike pothuajse ngjashëm me grupimet e studentëve gjermanë.

E gjithë kjo Miranit nuk po i bënte përshtypje, meqë e kishte përditshmëri në mensën e studentëve në Bohum. Jusufi e Bardhi po habi-

teshin nga anagzhimi kaq i madh dhe kaq i politizuar dhe i ideologjizuar i studentëve gjermanë dhe i studentëve të huaj. Mirani identifikoi tavolinën e grupimit të studentëve simpatizantë të PKGJ/m-l, që kishin udhërrëfyes pos Marksist, Engelsit e Leninit edhe Stalinin, Mao Ce Dumin dhe Enverin. Ai informoi Jusufin e Bardhin që ishin përqëndruar të shfletonin sa më shumë materiale, pothuajse në çdo tavolinë. U tregoi se në atë tavolinë po ekspozoheshin e shiteshin edhe vepra të Enver Hoxhës, të përkthyer në gjermanisht, anglisht e frëngjisht. Kjo i bëri përshtypje Jusufit dhe nuk nguroi pa shfaqur mburrjen. Rreth asaj tryeze ishin tetë studentë gjermanë që ftonin edhe gojarisht studentët t'u qaseshin për të parë se çfarë materiali kishte aty. Ata u ndjenë të befasisuar nga kjo vizitë, pasi i njihnin simpatizantët e tyre që u qaseshin çdo ditë, jo vetëm për të marrë informata të reja dhe për të blerë Organin e Partisë, gazetën javore "Roter Morgen" ("Mëngjesi i kuq"), por edhe për të bërë numër sa më të madh, si taktikë për të tërhequr vëmendjen dhe interesimin e ndonjë studenti që ende nuk dinte për atë grupim. Mirani pyeti njërin nga studentët e atij grupimi:

– E njihni Ahmad Sadekun?

– Po, këtu është. Për pak çaste do të kthehet. Kush jeni Ju që e kërkoni? – pyeti i befasisuar njëri nga studentët.

– Jemi bashkëvendës të tij dhe jemi të interesuar ta takojmë?

– Edhe ju qenkeni nga Kosova!? Duhet t'ju drejtohem me "shokë" apo me "zotëri"?

– Nuk na prish punë, si të dëshironi, – tha Mirani.

– Atëherë po ju thërrasim shokë, meqë e kërkuaqeni Shokun Ahmad. Atë e kemi shok të ngushtë. Është pothuajse i përditshëm këtu, e kemi proletar me vetëdije të lartë klasore. Është komunist i devotshëm.

Mirani po mendonte me vete: "Edhe ky na qenka si Xhahili ose si Proletari!"

– E njohim, prandaj kursehuni nga reklamimi se nuk kemi ardhur

t'jua blejmë! – ironizoi tjetri.

Bashkëbiseduesit nuk i erdhi mirë. Jusufi pyeti Bardhin se çfarë i tha Mirani, meqë hetoi se ai studenti u ngry. Bardhi ia përktheu, meqë Jusufi ende nuk e zotëronte gjermanishtën sa ta ndiqte komunikimin e shpejtë. Ai iu drejtue me zë të ulët Miranit:

– Si nuk u mbushe mend, more ahmak? Edhe këtu nuk po durohesh pa bërë provokimet e ironizime...

Bardhi e ndërpreu me shqetësim se mos do të fjaloseshin me Miranin para gjermanëve. Pastaj iu drejtua studentëve gjermanë:

– Vëllai ka ardhur tani nga Kosova dhe po ju kërkon falje për humorin e zi të Miranit. Ç'f'i bëjmë, e ka ves.

– Në rregull, mirë që na sqarove, sepse ndiheshim të lënduar, meqë me Ahmadin jemi krenar. Ai është bir i klasës punëtore të Kosovës.

– Ne e dinim që është student! – ndërhyri sërish Mirani, pa dashur të respektojë qortimin e Jusufit dhe sqarimet e gjermanit. Në këto momente po i bëhej sikur Ahmadi gjasonte me Proletarin, i cili shpesh takonte studentët komunistë gjermanë kur i vinte për vizitë Miranit në Bohum. Proletari i gënjente ata duke ua kripur me slogane komuniste gënjeshttrat se gjoja kishte mbaruar studimet në Kosovë, por kishte vendosur të bëhej pjesëtar i klasës punëtore, meqë intelektualët për nga natyra janë të prirur të jenë borgjezë; se ishte i përcaktuar vendosmërisht për të bërë revolucion proletar e socialist në gjithë botën...

– Miran, – e ndërpreu Jusufi, – mos hyr lakërave se nuk kemi ardhur për të tilla rrokopendla.

– Them që i kemi shokë, prandaj është e nevojshme t'i sqarojmë. Ku dimë ne se çfarë i gënjen ai dhe na turpëron më keq kur ta zbulojnë.

– Nuk kemi nevojë të bëjmë këso sqarimesh meqë nuk na njohin. Të presim derisa të vijë ai. Për atë dhe për çështjen tonë kemi ardhur.

Jusufi, veprimtarisë se organizuar kombëtare, shpesh i thoshte shkurtimisht: Çështje.

Bardhi kishte filluar të bisedonte me gjermanin.

Në atë moment erdhi Ahmadi dhe u befasua kur pa Jusufin, Miranin e Bardhin. Menjëherë shfaqti mëdyshjen nëse duhej ose jo të gëzohej për ardhjen e tyre.

– Mirëdita shokë! – përshëndeti ai duke zgjatur dorën drejt Jusufit.

Mirëdita! – ia kthyen Jusufi e Bardhi në gjuhën shqipe, kurse Mirani në gjermanisht, i bindur se më praktike do ishte që të komunikonte gjermanisht, pasi ua dinte huçin gjermanëve të kësaj partie. Në prani të tyre ata dëshironin të flitej vetëm gjermanisht.

– Jemi duke të kërkuar qysh mbrëmë, – iu drejtua Mirani. – Në adresën që ia ke dhënë Bardhit na rezultoi se nuk je aty banues. Pyetëm edhe disa bashkatdhetarë që të njihnin, por as orientimet e tyre nuk na ndihmuan. Dëshëm të informohemi se si po shkon parapërgatitja e demonstratës, si të pritë policia?

Ahmadi u zu ngusht nga këto pyetje të menjëhershme dhe të drejtpërdrejta. Po përpëlitej për t'u arsyetuar për moskryerje të detyrave që kishte marrë përsipër vullnetarisht javën e kaluar, pasi përfundimit të demonstratës në Mynhen.

– Nuk e kam paraqitur fare, – tha ai. – E diskutova me shokët gjermanë dhe me Proletarin dhe më thanë se nuk duhej të angazhohesha, meqë karakteri i demonstratave që bëni ju është vetëm patriotik, kurse ne jemi të përcaktuar për luftë klasash dhe revolucion proletar kundër borgjezisë së këtushme dhe kundër borgjezisë së re jugosllave. U ndal i lehtësuar se kishte gjetur përgjigjen e qëlluar për t'u arsyetuar.

Kur dëgjuan përgjigjen Jusufi e Bardhi mbetën me gojë hapur, sepse nuk prisnin të ballafaqoheshin me këtë të patritur, pasojat e të cilës nuk mund t'i merrnin me mend menjëherë, por e dinin se ishte shumë keq. Mirani nuk pritë të merrte fjalën Bardhi, meqë ai po përktente për Jusufin.

– Ti e dije karakterin e demonstratës që në Mynhen, ku more pjesë

për herë të parë dhe e more përsipër të bëje paraqitjen e saj në polici. Pastaj, ke mundur të informosh menjëherë se ke hequr dorë nga angazhimi që more përsipër. Sa për karakterin e demonstratave tona nuk është vendi të diskutojmë këtu. Nuk kemi ardhur të marrim vlerësimet e miratimin tuaj...

– Pse jo, – ndërhyri gjermani, – edhe ne jemi të interesuar t’ju përkrahim, por do t’ju përkrahim dhe do ta lajmëronim demonstratën në emër të Partisë sonë, nëse karakteri i demonstratës suaj do të ishte siç sqaroi Shoku Ahmad. Ju duhet të kuptoni se duhet demonstruar së pari kundër borgjezisë gjermane, e cila po i përkrah konkretisht revizionistët jugosllavë për të shtypur revoltën e studentëve në Prishtinë. Sigurisht e dini se Ministri i Punëve të Brendshme, Zimmermann, që është një revanshistë i partisë djathtiste CSU, i ka dhënë mjete moderne policisë së Beogradit, në vlerë prej 120 milionë DM, si dhuratë për ta shtypur revoltën popullore në Kosovë...

Mirani, duke e ditur se komunistët gjermanë janë të prirur e të shkathtët për diskutime ideo-politike, mendoi të ndërhynte për ta ndërprerë diskutimin:

– Të lutem, nuk kemi kohë sot për diskutime, pasi bashkatdhetarët janë të informuar për demonstratën që duhet të mbahet nesër. Ata kanë marrë autobusë me qira dhe prej largësive të mëdha janë nisur për të arritur nesër në Frankfurt. Ne duhet të angazhohemi se si ta zgjidhim këtë sabotazh të këtij farë shoku!

– Vërtet, shoku Ahmad, përse nuk ke informuar me kohë për tërheqjen tënde? – iu drejtua gjermani. Ky zuri të belbëzonte për të gjetur ndonjë arsytim.

Mirani ia preu duke iu drejtuar gjermanëve:

– Ditën e mirë se na duhet të shkojmë! Se cili është ky psikopat, e njoh. Ç’të bëj se nuk është vendi, se do t’ia shtypja surratin këtij mashtruesi.

– Prit! – ndërhyri Jusufi duke hetuar që Mirani po e ngriste zërin. – Ky duhet të vijë që të sqarohemi.

– Nuk na duhet gjë, – tha Mirani.

– Eja të ulemi diku të pimë kafe dhe të sqarohemi! – ia bëri Jusufi Ahmadit.

– Na trego ku është kafeneja! – tha Bardhi.

Sapo zunë vend, Jusufi iu drejtua:

– Ahmad, a je i vetëdijshëm se para cilës përgjegjësi e vështirësi na ke vënë?

– E dëgjuat arsyetimin tim, filloi të shfajësohej tjetri i zënë ngusht. – Pasi e diskutuam me shokët gjermanë dhe sidomos me Proletarin vendosa të tërhiqem nga obligimet që mora në atmosferën euforike që ishte në Mynhen...

– Përse nuk telefonove? – e ndërpreu Bardhi pa e duruar krekosjen e tij.

– Të kam telefonuar...

– Kur, përse gënjen?

– Bardh, – ndërhyri Mirani, – mos u zemëro kaq shumë me këtë plehrë se po na shikojnë studentët gjermanë. Nuk ia vlen dhe nuk është vendi. I dëgjove mbrëmë bashkatdhetarët kur na thanë se ky është informator i konsullatës jugosllave këtu në Frankfurt. Ta injorojmë se na qenka më bërllok se Xhahili e Proletari...

– Qetësohu Miri! – tha Jusufi. – Ky duhet të japë llogari për këtë sabotim.

– Të lutem Bacalok, ne nuk kemi pse i kërkojmë llogari këtij plehu. Ky kapardisës i jep llogari vetëm konsullatës jugosllave. Të shkojmë se nuk ia shoh dot surratin dhe mjekrën si të cjamin!

Mirani bëri të ngrihej dhe menjëherë pas tij edhe Bardhi tepër i hidhëruar. Jusufi hodhi vështrimin dhe kur pa vendimin e Bardhit e të Miranit se nuk do ulëshin më edhe po t'i luste, u ngrit duke mallkuar

Ahmadin:

– Haram të qoftë gjiri i nënës shqiptare, or plangprishës!

Që andaj shkuan në polici për të bërë lajmërimin, por u refuzuan sepse duhej bërë të paktën 24 orë përpara.

Të nesërmën policia e Frankfurtit priti grumbullimin e shqiptarëve para stacionit hekurudhor, meqë kishte të dhëna për udhëtimet e tyre drejt Frankfurtit. Asaj po i vinte keq nga mospasja e lejes, prandaj ofroi një zgjidhje alternative. Të shkonin pas tyre drejt parkut pa brohoritur. Gjatë rrugës shqiptarët i nxorën bandarolat e parapërgatitura, shpërndanë trakte dhe filluan të brohorasin fuqishëm kërkesat kryesore: “Republik für Kosova” (Republikë për Kosovën) dhe “Freiheit für Kosova” (Liri për Kosovën). Për të gjitha këto policia u tregua tolerante, meqë kishte të dhënat se emigrantët shqiptarë po i bënin demonstratat tepër paqësore.

10.

Pas demonstratës në Frankfurt u diskutuan kërcënimet që ishin lëshuar në etër, se në demonstratën e Brukselit do të derdhet gjaku po u mbajt atje. Këto kërcënime ishin të koordinuara (siç i informoi Mirani, Jusufin dhe Kadriun), nga ambasada e atjeshme jugosllave dhe nga disa pseduopatriotë, gjoja antikomunistë, si Vebi Ibrahim, Musa Hoti, Reshit Sahataj, Galan Azapi dhe disa të tjerë që sillleshin rreth tyre. Në fund u vendos që për këtë të bëhej edhe një takim, ku do të analizoheshin të dhënat konkrete dhe do të merrej vendimi. Ky takim u mbajt në Felbert (Velbert), në banesë të Proletarit. Mirani e kishte të paqartë se përse takimi po mbahej pikërisht në banesë të tij, pasi prej kohësh ishte munduar ta diskreditonte e izolonte Proletarin. Në takim merrnin pjesë Jusufi, Kadriu, Bardhi, Mirani, Hajzeri, Proletari.

Që në hyrje të banesës Jusufi dhe të tjerët u habiten kur panë të shënuar në etiketë të zilës së Proletarit emrat “Proletar Pashtriku” e

“Shpati” (pseudonimi i Enver Hoxhës gjatë luftës). Kur hynë brenda, ata panë se njëra nga dyert e tre dhomave të banesës kishte etiketë të madhe me shënimin “Byro”. Këto Mirani i kishte parë prej kohësh, por disa që nuk kishin qenë ende në banesë të Proletarit, nuk i zinin besë kur u tregonte. Edhe kur hynë në “Byro” të Proletarit, këtij punëtori të shkretë fizik, panë tavolinën e madhe të punës, kulltuqe, karrige që gjasnin me ato të pashallarëve të kuq, të cilat Proletari kishte mundur t’i shihte në fotografi katalogësh të tyre, prandaj ishte mundur t’i imitonte me pajisje të ngjashme që i kishte vendosura në “Byronë” e tij.

– Shokë, jemi takuar për të diskutuar të dhënat që kemi grumbulluar për rrezikun që na kanoset, nëse e mbajmë demonstratën në Bruksel, – filloi Jusufi, si më i moshuari që ishte.

– E shihni në çfarë atmosfere po e mbajmë takimin? – foli menjëherë Mirani me mosdurim nga inati se përse ky takim po mbahej pikërisht në banesë të Proletarit. – Që në hyrje vërejtët të shënuar në zile dhe në derë pseudonimin “Shapti”. Në derë të kësaj dhome e patë etiketën “Byro”, edhe pse Proletari është vetëm një punëtor fizik. Orenditë që po shihni këtu, Proletari i ka blerë shtrejtë, me kredi, për të imituar zyrën e Enver Hoxhës. Gruja polake, që na solli kafe, bashkëjeton këtu me Proletarin. Ajo është ankuar në praninë time, kur isha për vizitë, se Proletari ia ka thyer kryqin dhe e ka rrahur, sepse ky është kuadër i lartë i Partisë së Punës dhe nuk ia lejon asaj të mbajë kryq në banesën e këtij ateisti. Tani, meqë të gjitha po i shihni vetë, mund të bindeni se ky farë kuadri i shpifur i Partisë së Punës është psikopat politik që do të mund të na shkaktojë dëme më të mëdha se sa të ishte udbash. Mendoj se udbashi punon për pagë dhe nuk rrezikon kokën, kurse ky është në gjendje të lerë edhe kokën për këto marrëzira. Një herë një gazetar gjerman më tha se ky Proletar i kishte thënë atij se ishte anëtar i Komitetit Qendror të PPSH-së! Ai kishte ndërmend ta botonte këtë sensacion në gazetë, por më pat telefonuar të më pyeste, se mos edhe unë mendoja

se Proletari është vërtet anëtar i KQ të PPSH-së. E luta të mos e ulte seriozitetin e profesionit të tij duke botuar shpifjet e këtij psikopati. Këso marrëzish ky nxjerr pafundësisht..

– Miran, të lutem, nuk jemi takuar këtu për të diskutuar inatët personale me Proletarin! – ndërhyri Jusufi. – Kemi informata se kërcënimet janë serioze, prandaj jam për anulim të demonstratës.

– Unë mendoj që së pari të paraqiten informata sa më të konkretizuara dhe në fund të marrim vendim, – tha Kadriu.

Pas një heshtjeje të shkurtër, kur askush nuk po merrte fjalën, u paraqir Hajzeri. Ai po priste Jusufin t'ia jepte fjalën, sado që takimi nuk e kishte atë karakter dhe atë nivel. Diskutimi po bëhej midis shokëve dhe jo nga ndonjë strukturë e drejtuese. Në fund, kur e pa se askush nuk po ia jepte fjalën, qiti e tha:

– Unë kam informata se këto kërcënime janë vetëm shantazh i kotë dhe nuk kemi nevojë ta anulojmë vendimin për demonstratën.

– Miran, urdhëro ç'mendim ke ti, meqë je më i informuar nga të gjithë ne! – iu drejtua Kadriu duke menduar se mos ai ishte hidhërua tej mase pse takimi po mbahej në banesë të Proletarit dhe nuk donte të fliste më.

– Unë kam kontaktuar bashkatdhetarët aktivistë në Bruksel, – tha Mirani duke e fshetur hidhërimin. – Ata patën bërë kërkesë për të mbajtur këtë demonstratë. Më kanë thënë përafërsisht ato që tha Hajzeri, por unë do të ndalem në konkretizime. Emigracioni i vjetër politik që përbëhet kryesisht nga të arratisurit nga Republika e Shqipërisë në Jugosllavi dhe prej andej, me ndihmë të UNHCR-it e të Kryqit të Kuq, pas rënies së Rankoviçit janë vendosur në Belgjikë. Ata janë tepër indiferentë dhe pothuajse vetëm ndonjërit i interson Kosova. Krerët e atij emigracioni nuk janë prononcuar pro as kundër, kurse disa nga individët e atij emigracioni duan të dalin në demonstratë. Kërcënimet i kanë lëshuar e po i përhapin diplomatët jugosllavë, që në fakt janë udbashë

dhe disa informatorë të tyre dhe disa të vetëquajtur patriotë. Do t'i veçoja nga këta të fundit Vebi Ibrahimin, Musa Hotin dhe të tjerët që rrinë rreth tyre. Këta kanë dalë hapur me kërcënime se do të derdhet gjaku po guxoi njeri të ngre flamurin shqiptar me yll komunist. Të tillët nuk e kanë shqetësimin fare të ylli, pasi ata lartësojnë flamurin jugosllav që ka yll më të madh se yni. Ata këtë e kanë sajuar si preteks për të konkretizuar kërcënimet pa mbulesë. Sigurisht, provokime mund të kemi, por nuk kemi nevojë ta anulojmë demonstratën vetëm për shkak të këtyre kërcënimeve. Demonstratat janë bërë në Prishtinë e qytete të tjera të Kosovës, duke u ndeshur ballë për ballë me policinë jugosllave. Dhjetëra veta kanë rënë dëshmorë, kurse neve në Bruksel na mbron policia belge dhe nuk kemi përse të frikësohemi.

– Nuk jemi duke u frikësuar, por nuk kemi arsye të rrezikojmë e të komprometohemi duke derdhur gjak mes vete në Bruksel, – reagoi Jusufi duke u ndier i vetmuar në vlerësim.

– Unë shpreha mendimin tim, – foli prapë Mirani.

Në fund të takimit, megjithatë, u vendos që demonstrata të anulohet dhe Mirani e Hajzeri të shkonin në Bruksel për t'i bindur aktivistët për këtë vendim.

11.

Në Bruksel Mirani dhe Hajzeri shkuan fillimisht te Bahriu, vëllai i Hajzerit. Aty ata thirren për bisedime bashkatdhetarët që kishin propozuar për t'u mbajtur demonstrata. Ata nuk ia dolën t'i bindnin për anulimin e demonstratës. Bashkatdhetarët këmbëngulën se do ta bënin demonstratën edhe po u tërhoqen organizuesit. Për këtë i informuan Jusufin e Kadriun. Ato ditë Kadriu gjendej te Jusufi dhe së bashku po përgatisnin organin *Liria*. Jusufi nuk nguroi të fajësonte Miranin:

– Po të donte ai bashkatdhetarët në Bruksel do të bindeshin për anulimin të demonstratës. Meqë ai edhe në takimin në Felbert ishte

kundër anulimit, nuk do të ketë provuar njëmendësisht t'i bindë ata.

Kadriu e Bardhi shkuan në Bruksel për të parë gjendjen në terren dhe pastaj edhe një herë të vendosej për demonstratën. Jusufi sërisht nuk mundi të shkonte për shkak të dokumentit të udhëtimit. Kështu atij po i zgjatej kufizimi i lirisë së lëvizjes nga një shtet demokratik, sado që kishte mbi një vit e gjysmë që kur kishte bërë kërkesën për njohje të strehimit politik. Mirani e kishte komentuar këtë si padrejtësi skandaloze që i bëhej Jusufit nga organet gjermane, të ndikuara prej Beogradit.

Edhe Kadriu e Bardhi u vendosën në banesë të Bahriut. Sado që banesa ishte e vogël, Bahriu dhe bashkëshortja e tij, Bujarja, kishin mikëpritje të atyre përmasave sa as ata me dy fëmijë të vegjël dhe as mysafirët nuk ndiheshin ngusht. Aty vinin edhe dhjetëra bashkatdhetarë për ta takuar Kadriun e Bardhin, pasi gjatë demonstratave nuk kishin mundur të çmalleshin me ta. Aty u rimor vendimi përfundimtar për mbajtje të demonstratës. Gjatë javës parapërgatitore aty u improvizua një si shtab organizativ ku bëheshin edhe bandarolat. Bahriu e Bujarja i prisnin dhe i përcillnin me dashamirësi gjithë ata njerëz që hynin e dilnin deri në orët e vona të natës.

Ditën e dytë të qëndrimit shkuan në banesë të Bahriut dy bashkatdhetarë. Ata dukeshin të alarmuar. Sapo hynë brenda, informuan se kishin parë Vehbi Ibrahimin duke tentuar t'i hidhte sheqer karburatorit të automobilin të Bardhit. Me atë rast ata i kishin bërtitur dhe ai kishte ikur. Shpjeguan se sheqeri në karburant prish motorin. Ky dëmtim i tij u vlerësua si simbolik, se ai me bashkëmendimtarë të tij donin t'i frikësonin organizatorët dhe pjesëmarrësit që të anulohet demonstrata. As ky veprim nuk lëkundti tashmë asnjërin.

Lajmërimin e demonstratës në policinë përkatëse e bëri bashkatdhetari Mehdi, me origjinë nga Loxha e Pejës, i shpërngulur në Turqi dhe prej andej i ardhur në Bruksel. U vendos që ai të bënte lajmërimin, meqë ndërkohë kishte marrë shtetësi belge.

Gjatë bisedave për organizim të demonstratës bashkatdhetarët e aty-shëm informuan se duhet pasur parasysh izolimin e Enver Hadrit, nëse ai do të merrte pjesë. Arsyetuan se muaj më parë ai kishte mbajtur konferencë shtypi në Bruksel dhe kishte thënë, pos të tjerash, se statutin e Republikës për Kosovën do ta fitonin edhe me ndihmë të Bashkimit Sovjetik. Këtë “argument” Stane Dollanci e kishte shpërdorur në konferencë shtypi, mbajtur me gazetarë të huaj në Beograd, për të akuzuar se në trazirat e Kosovës kishin gisht edhe shërbimet sovjetike. Prandaj Enver Hadrin, të cilin tashmë e njohin gazetarët belgë, nuk duhet lejuar të flasë atë ditë, sepse do të quhet organizatorë i demonstratës.

Të ejtën, nga dera e prapme e banesës, në kuzhinë, Bahriut i erdhi Sekretari i Parë e Ambasadës jugosllave, shqiptari Garip D. Ata kishin lidhje farefisnie. Garipi po ia tërhiqte vërejtjen Bahriut të mos udhëtonte më në Kosovë, pasi në ambasadë spiunët kishin dërguar informata se aty ishte vendosur shtabi organizues i demonstratës. Pastaj ai i kishte thënë Bahriut se kërcënimet me gjakderdhje ishin vetëm shantazh koti, me shpresë se do të funksiononte dhe se ai shantazh burimin e kishte në ambasadë. Bahriu e kishte pyetur Garipin, nëse dëshironte të bisedonte me Miranin, por ai kishte refuzuar me arsyetim se do të informohej ambasada, do ta humbte vendin e punës dhe pastaj do të përfundonte në burg. Pas pesëmbëdhjetë minutash bisedë Garipi iku. Bahriu menjëherë e informoi Miranin:

– Sapo shkoi Garipi, sekretari i parë i ambasadës jugosllave. Në vazhdim e informoi për detajet e bisedës.

– Si nuk më thirre ta bindja të dezertonte nga ajo përgjegjësi dhe këtë ai ta komunikonte në konferencë shtypit të shtunën? – tha Mirani.

– Ti them sonte, pasi mund ta takoj? – pyeti Bahriu, sado që e dinte se ai ishte frikacak i madh.

Një ditë para demonstratës, të premtën, grupi i Vebi Ibrahimit, Musa Hotit, Galan Azapit, Reshid Sahatajt e të tjerë bashkëmendimtarë të tyre, lëshuan njoftimin se shqiptarët patriotë të Brukselit do të demonstrosnin po të shtunën në Paris. Kjo ishte ndërhyrja e tyre e fundit për ta sabotuar daljen sa më numerike të bashkatdhetarëve në demonstratë në Bruksel. Ata gjetën vetëm rreth njëzetë veta. Shkuan dhe bënë një mini-demonstratë simbolike në Paris.

Në qendër të Brukselit, ndërkaq, në Plac Kleber, filluan të grumbulloheshin shumë bashkatdhetarë nga Gjermania, Zvicëra, Danimarka, Suedia, Franca e gjetiu. Pjesa më e madhe e bashkatdhetarëve të Brukselit hezitonin të dilnin të parët në shesh duke vrotuar rrethrotull, sepse kishin dëgjuar për kërcënimet. Kur panë grumbullimin aq numërik të demonstruesve edhe këta u bashkangjiten.

Mirani porositi patriotin e angazhuar preshevar, Hasan Kadria dhe një kujdestar tjetër të mbikëqyrnin Enver Hadrin, meqë edhe ai kishte dalë në shesh. Hasani fliste mirë frëngjishtën dhe iu dha kompetenca që t'i informonte gazetarët belgë, kurse Enverit iu tha se e kishte të ndaluar të fliste me gazetarë, për sa kohë do të qëndronte në radhë të demonstruesve.

Zëri kumbues i Kadriut filloi të oshëtinte në shesh, pikërisht sipas orarit të planifikuar për fillim të demonstratës. Demonstrata përfundoi me sukses dhe pa asnjë incident.

Vetëm Proletari më zëshëm, e ndonjë tjetër nën hundë, kishin kritikuar pse vajza e e një reaksionari, sipas tij, kishte përkthyer në konferencë me gazetarët belgë dhe të huaj të akredituar në Bruksel. Kjo kishte ndodhur pas konference kur ishin ulur në foajeun e Qendrës për shtyp për të biseduar për rrjedhën e demonstratës dhe të konferencës së shtypit. Mirani që akuzohej për fajtor u mbrojt duke sqaruar:

– Vërtet Miradia është vajzë e një të arratisuri nga Malësia e Gjakovës, që tani i thonë Malësia e Tropojës, por babai i saj, Ukshin N., arra-

tisur në vitet e 50-ta nga Shqipëria në Jugosllavi, nuk ka përse të etiketohet reaksionar nga një dogmat i sëmure siç është Proletari. Kur Ukshini u arratis në Kosovë, shërbimet sekrete jugosllave u munduan ta përvetësonin për ta angazhuar atë si diversant për të vrarë bashkëvendës të tij në Republikën Popullore të Shqipërisë. Ai nuk kishte pranuar, prandaj jugosllavët e kishin burgosur. Aty i kishin bërë lloj-lloj shantazhesh, deri edhe me vrasje të gruas e fëmijëve. Megjithatë, ai nuk u tund. Në burg të Gurakocit të Kosovës është detyruar ta presë barkun me xham të dritarës se burgut, vetëm që të mos e detyronin të bëhej diversant. Ka ndërhyrë pastaj Kryeqi i Kuq Ndërkombëtar dhe e ka sjellë në Belgjikë. Meqë këto i kam dëgjuar nga bashkëvendësi im, njëherit edhe bashkëveprimtar yni, por edhe nga bashkatdhetarë të tjerë, atëherë përse duhet të etiketohet ai patriot si reaksionar, në kuptimin dogmatik të Proletarit? Pastaj, edhe sikur Ukshini të kishte pranuar dhunshëm të bëhej diversant, përse do të duhej fajësuar tani fëmijët e tij. Miradia ka studiuar dhe është bërë pedagoge, rast ky i parë në emigracionin tonë në Belgjikë. Vëllai është pedagog i gazetarisë, që të dy janë tepër të angazhuar për Kosovën.

– Miran, mos lejo vetën të të provokojnë tipa si ky farë Proletari, të cilin unë po e shoh për herë të parë! – ndërhyri Muzaferi. Ne e njohim këtë familje të mrekullueshme e patriote prej vitesh, kurse ky nuk e njih fare, por dikush i këtushëm e paska dezinformuar. Po që nevoja mund ta nxjerrim forcërisht përjashta këtë farë mizeviri!

– Nuk kemi nevojë. Ky e ka nxjerrë vetën prej kohësh përjashta, por ja që ka pafytyrësi të asistojë në mjedise ku nuk i takon, me gjasë i dëshiruar për të provokuar ndonjërin që t'ia japë ndonjë flakaresh. Mendon, së paku kështu të bëhet personazh politik në radhët e mërgatës sonë.

Proletari u zvarrit që andej me bisht nën shalë dhe iku. Të tjerët vazhduan t'i gëzoheshin suksesit të demonstratës dhe konferencës së shty-

pit, të cilën e frekuentuan shumë gazetarë.

13.

Që kur kishin ndodhur demonstratat e marsit, Mirani e Renata ishin takuar vetëm në raste të rralla, shkurtazi, kur Miranit i duhej ndihma e saj për të korrigjuar traktet, thirrjet dhe fjalimet në gjuhën gjermane. Gjatë gjithë kohës Mirani kishte qëndruar te bashkatdhetarët, me bindjen se ata duheshin motivuar që të dilnin sa më shumë në demonstrata. Njëherit merrej me shtypjen dhe shpërndarjen e trakteve e thirrjeve në gjuhë gjermane dhe edhe në gjuhë të tjera. Takohej me gazetarë, mbante konferencave shtypi, bisedonte me pushtetarë perëndimorë. Një pjesë të madhe të kohës e kishte kaluar në shtëpi të Jusufit. Tani, pas demonstratës së Brukselit, ndërkohë që nuk kishte të tjera, Mirani u kthye në Bohum. Ai linte përshtypjen se gjatë gjithë kohës nuk i kishte rënë ndër mend për Renatën, por malli për të e gryete përherë. Edhe ajo ishte merakosur për të dhe habitej përse ai nuk paraqitej të paktën më telefon.

Banesën e tij Mirani e gjeti të pastruar e të rregulluar, si pas një ndërhyrjeje të dorës së veshme të gruas së përkushtuar. Dërgesat postare i gjeti të pahapura mbi tavolinë bashkë me shtypin që i vinte nga Republika e Shqipërisë. Renata kishte kopje të çelësave të banesës së Miranit dhe të kutisë postare. Kjo përkujdesje e Renatës e lumturoi Miranin, por u pendua përse nuk e kishte vizituar më shpesh gjatë këtyre tre muajve dhe as i kishte telefonuar.

Ishte kohë darke dhe asgjë nuk gjeti në banesë për të ngrënë. Fqinji dhe miku i tij, Mihaeli e ftoi për darkë. Mirani, duke e falenderuar i tha se do të shkonte për darkë të Renata. Mihaelit iu bë qejfi.

Renatën e gjeti duke shtruar darkën për vete. Ajo banonte në konvikt të studentëve në rrugën Markstrasse. Ky ishte konvikt shtetëror dhe

kishte liri më të madhe se sa në konviktin kishtar, ku banonte Mirani. Sapo iu afru, pa hetuar, nga mbrapa ia vuri duart mbi sy dhe priti nëse ajo ia qëllonte se cili ishte. Sapo ndjeu duart mbi fytyrën e saj, thirri me emocione të papërmbajtura: – Miraaaan! U kthye me hov dhe iu hodh në përçafim. E puthi disa herë, siç puth motra vëllanë dhe iu mbushën sytë me lot. Dridhej e tëra mbështetur mbi gjoksin e tij.

– Sa më ka marrë malli, Miran i dashur! Ku ishe gjatë gjithë kësaj kohe? Të paktën një telefonatë të ma bëje...

– Qetësohu një herë! – e ndërpreu tjetri. – Ti e dije se ku isha, me çfarë merresha, sa shqetësime e angazhime kisha, prandaj duhet ta kesh marrë me mend se përse nuk të kam vizituar dhe nuk të kam telefonuar.

– Më fal, por më ka marrë malli dhe gjithë kohën kam qenë e merakosur për ty dhe për shqetësimet e tua. Gjithandej i kam përcjellë lajmet se çfarë po ndodh në Kosovë. Madje kam përcjellë edhe shtypin botëror në bibliotekë të universitetit dhe t'i kam kopjuar gjithë artikujt që kishin të bënin me Kosovën.

– Të ham një herë darkë se jam i uritur. Tani po vij nga Brukseli. Isha pak në banesë dhe erdha tek ti të çmallem.

– Nuk e di përse ma tha truri të përgatis sonte darkë më të mirë se rëndom? Çfarë parandjenje dhe çfarë surprize e lumtur!

Pasi darkuan në kuzhinën e përbashkët, kaluan në dhomën e Renatës. Ajo e luti atë të shtrihej të pushonte, por tjetri tha se nuk ishte i lodhur.

Biseduan gjatë për ngjarjet: Renata duke treguar për ato që kishte mbajtur mend nga lajmet, komentët e analizat e mediave, Mirani duke plotësuar nga ato që kishte marrë vesh prej shokëve dhe nga shtypi shqiptar e jugosllav. Renata e informoi se e kishte marrë me rregull gjithë shtypin jugosllav që ai e kishte rezervuar në kiosk të stacionit të trenit dhe ia kishte lënë mbi tavolinë. Mirani llogariti në heshtje: “Renata

paskesh harxhuar mbi pesëqind marka për të paguar gazetat e revistat jugo-sllave!”

– Qenke harxhuar goxha. Të falënderoj, moj mike e shtrenjtë, – iu drejtua me dashamirësi e mirënjohje Renatës.

– Nuk ia vlen të më falenderosh. Në Kosovë po vritën njerëzit dhe mua më takon të paktën të jap një kontribut simbolik, – tha ajo me sinqeritet.

– Fatkeqësisht, nuk vijka liria pa u sakrifikuar njerëzit!

– Përse pothuajse të gjitha mediat e këtushme dhe strukturat politike e jo politike, Kosovën po e quajnë krahinë serbe? – pyeti Renata. – Unë kam lexuar një mori librash historikë, por nuk më është mbushur mendja ta cilësoj si krahinë serbe, kurse ata kështu po e cilësojnë dhe nuk po mund t’i arsyetoj. Mirani u habit nga kjo pyetje dhe vendosi t’i përgjigjej më gjerësisht.

– Dëgjo, Renatë e dashur, po deshe përgjigje pak më bindëse në këtë pyetje.

– Po të dëgjoj, por prit sa të sjell nga një pije.

– Aspektin historik, se si dhe kur Kosova është e pushtuar nga serbët ta kam treguar disa herë, madje duke të të bezdisur, por ishte një lloj terapie për të përballuar mërzinë e nostalgjinë për vendlindjen, për Nënë, për vëllezërit e motrat, për shokët dhe përgjithësisht për Kosovën. Kësaj radhe do të tregoj gjera të reja, më konkrete, që duhet të kem harruar herave të tjera se çfarë i ka bindur gjermanët që ta quajnë Kosovën krahinë serbe.

– Urdhëro, po të dëgjoj.

– Unë jam detyruar të arratisem nga vendlindja për shkak të angazhimit tim simbolik për më shumë të drejta demokratike. Në këtë fatkeqësi timën rastësisht më ka ndodhur një fat i madh dhe ky është njohja me ty dhe miq të tjerë. Një fat tjetër, por më me vlerë për interesin nacional serb, ka pasur në fatkeqësinë e tij personaliteti serb, Vuk Karaxhiqi.

Tani po të tregoj ato që kam dëgjuar nga Erih Frid (Erich Fried), i cili, siç e di është një poet markant. Si çifut që ishte, qe detyruar të arratiset në Londër gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai, pos poet i njohur, është edhe personalitet shumë i angazhuar. Ka pasur e ka ndikim të madh politik në lëvizjen e studentëve, jo vetëm në Gjermani. E ka afirmuar edhe qëndrimi i tij kundër pushtimeve të Palestinës nga Izraeli. Në vitin 1978 Erih Frid erdhi në universitetin tonë dhe mbajti një ligjeratë. Ishim mbi tre mijë pjesëmarrës. Pas ligjeratës u prit në Bashkësinë Evangeliste të studentëve, sepse edhe pastori i kësaj Bashkësie ishte ithtar i tij. Meqë isha anëtar i Kryesisë së Lidhjes së studentëve, më ftuan të marrja pjesë në atë pritje. Në një moment m'u dha shansi të bisedoj me Erih Fridin. Kur mori vesh që jam nga Kosova, në prani të të gjithëve, recitoi një fragment të këngës epike për Betejën e Kosovës, duke sqaruar pastaj se i është kushtuar betejës së famshme serbe në krahinën serbe të Kosovës. Unë e kundërshtova. Kosova, – thashë, gjithnjë ka qenë e banuar me shumicë absolute me shqiptarë etnikë, por që ka edhe minoritet serb, malazez, bosniak, turk, rom. Pastaj ai rrëfeu këtë histori:

“Vuk Karaxhiqi, mbledhësi i eposit popullor serb, detyrohet të arratiset, sepse kishte marrë pjesë në Kryengritjen serbe të vitit 1804, të cilën osmanlinjtë e shtypen. Vendoset në Vjenë. Aty njihet me personalitetin sloven Jerenej Kopitar, i cili ishte i afirmuar si linguisti i gjuhëve sllave dhe punonte si censor për librat sllavishtë në Komisionin mbretëror në Vjenë. Kopitari ishte anëtar i Rrethit vjenez të romantikëve. Ai u bë mentor i Karaxhiqit, të cilin e nxiti t'i mblidhte këngët e eposit serb. Pasi grumbulloi 108 këngë, në vitin 1813, Kopitar organizoi botimin e tyre në gjuhën serbe, më 1814 në Vjenë. Përkthimin e këtyre këngëve e organiyoj po Kopitari, ndërsa recensionin për këtë botim e shkroi Jakob Grim (Jackob Grimm). Këto këngë bëhen hit në Gjermani dhe në Evropë në vitët e 20-ta të shekullit të kaluar. Meqë për jehonën e tyre kon-

tribuoi me shkrime në revista të ndryshme vetë Gëte (Goethe) dhe të tjera personalitete të kohës, ajo përmbledhje u ribotua 54 herë. Kështu Kopitar e bëri Karaxhiqin mik personal me Gëten, Grim, Johan S. Fater (Johann Sevrin Vater), Vilhelm fon Humbold (Wilhelm von Humbold), Leopold von Ranke dhe të tjera personalitete gjermane, që ndikuan shumë në formimin e shpirtit kulturor kombëtar gjerman, në shekullin e 18-të e të 19-të. Bile Jakob Grim, për hirë të kësaj miqësie dhe Fridrih Engels (Friedrich Engels), për hirë të këngëve që mblodhi Karaxhiqi, provuan të mësonin gjuhën serbe, që t'i shijojnë ato në origjinal.

Që atëherë, përmes atij eposi serb, të shndërruar në modë letrare në Gjermani e në Evropë, Kosova u ngulit në mendjet intelektuale elitore gjermane dhe evropiane si krahinë serbe. Pas rreth 180 vjetëve edhe unë jam impresionuar nga ai epos, ndaj i di të paktën 30 këngë për mendsh.”
- pat shpjeguar Erih Frid.

Unë desha t'i hidhërohesha Erih Fridit, por meqë kisha respekt të madh për të, shumë vjersha të të cilit i dija për mendësh, u përmbajta sepse gjykova se ai ishte i influencuar nga klasikët e mendimit intelektual gjerman dhe jo nga inati për shqiptarët. U mundova të sqaroj, për aq sa dija, se këngët që kishin të bënin me ndërtimin e Kalasë së Rozafës në Shkodër dhe me Betejën e Kosovës, Karaxhiqi duhet t'i ketë falsifikuar si epos serb, sepse ato i takonin eposit shqiptar, se Heroi i Betejës që vrau Sulltan Muratin ishte shqiptar, ndaj serbët nuk i kanë kënduar atij. Kisha serbe, në fund të shekullit të 19-të e ka falsifikuar përkatësinë e tij shqiptare, duke e shndërruar në serb. Në kohën kur u bë Beteja e Kosovës serbët ishin të përçarë dhe një pjesë, proosmane, i printe Princi serb, Vuk Brankoviç, të cilin populli serb e quante Vuku i zi. Në betejë kanë marrë pjesë edhe shqiptarët me princat e tyre po edhe popuj të tjerë të asaj hapësire.

- Interesant, ka ndodhur dhe nuk korrigjohet dot, – tha Renata.
- Ngjan si me përkatësinë tonë fetare. Të ngulitet diç në mendësi dhe

nuk të shkulet pastaj. Paraadhësve tanë u është imponuar feja islame me dhunë nga pushtuesit otomanë. Ndoshta më përpara edhe besimi katolik e ortodoks nga të tjerë pushtues. Në atë kohë njerëzit besonin në fenë që sillnin sundimtarët. Sidoqoftë, mendoj se do të korrigohet ky mashtrim kur do të çlirohet Kosova.

– Të shpresojmë se do dalësh fitimtar, – miratoi me dashamirësi Renata.

– Nuk mjafton vetëm shpresa.

– Po të kuptoj, prandaj po përpiqem të të ndihmoj, për aq sa po kërkon ti ndihmë nga unë, – tha Renata.

Për disa çaste heshtën të dy. Renata ia mori duart dhe ia vuri ato mbi gjunjët e saj duke ia fërkuar me dhëmbshuri. Pas pak ajo prishi heshtjen:

– Sa jam hidhëruar në qeverinë tonë! Në vend që të përkrahte kërkesat tepër të arsyeshme të demonstruesve paqësorë, dërgoi ndihmë në pajisje për policinë jugosllave, në vlerë prej 120 milionë DM!

– Je hidhëruar, por nuk ke ç'bën, – tha tjetri. – Qeveria gjermane, si shumë qeveri të tjera, ndihet e obliguar ta mbështesë partneren e vet, Qeverinë e Beogradit.

– Dyshon edhe për qeverinë tonë, – ndërhyri Renata. – Unë kam votuar lirshëm për këtë qeveri...

– E cila tani, kundër dëshirës sate i dërgon ndihma në pajisje policore qeverisë se Beograd për të shtypur kolegët e tu studentë në Prishtinë, – ndërhyri Mirani duke e ndërprerë atë ta përfundonte mendimin. – Ca marka, nga ato 120 milionë, sigurisht janë edhe tuat.

Mirani u ndal për të hetuar nëse Renata e kishte kuptuar.

– Nuk po të kuptoj, a ke mundësi konkretizimi?

– Qeveria gjermane nuk ka pasuri të veten. Ajo është votuar nga ti, përkatësisht nga votuesit gjermanë për të administruar pasurinë tënde,

përkatësisht pasurinë e gjithë qytetarëve gjermanë. Por, ajo tani sillet me pasurinë tuaj si të ishte e saj. Njerëzore e logjike do të ishte që ti dhe bashkëqytetarët të mos dërgonit ndihmë nga pasuria juaj për policinë jugosllave, që shtyp kolegët e tu dhe kolegët e bashkëqytetarëve të tu, kur ata kërkojnë të drejta e liri elementare.

– Tani nuk po të përcjell dot... – ndërhyri Renata.

– Edhe unë nuk po e kuptoj dot Weber-in tuaj, sociologun e politologun e afirmuar, kur po i lexoj librat e tij, ndaj nuk po di të shpjegoj kuptueshëm.

– Domethënë, qeveria ime, së cilës unë ia kam dhënë votën sipas bindjeve e vullnetit tim, po keqadministruaka pasurinë time? – pyeti habitshëm Renata.

– Si ta marrësh. Në rastin konkret varet nga gjykimi yt, nëse e ka keqmenaxhuar ose jo. Unë mendoj se ti, markat e tua, më me dëshirë do t'juja kishe dërguar kolegëve tu që tani po terrorizohen nga policia jugosllave, tashmë e armatosur edhe me pajisje moderne nga qeveria jote. Pastaj vullneti yt për të dhënë votën nuk duhet të ketë qenë autentik, por i ndikueshëm, për të mos thënë i manipulueshëm. Këtu, si edhe në vende të tjera, janë konsoliduar prej kohësh forca qeverisëse, oligarki administruese shtetërore. Ti tani nuk ke alternativë tjetër për të votuar. A nuk patëm shëmbull interesant sesi shpërdorohet vota e qytetarëve, kur ajka elitare intelektuale gjermane u injorua nga votuesit gjermanë. Forcat konservative patën caktuar Straussin kandidat për kancelar. Ajka e inteligjencies gjermane, në krye me nobelistët Böll, formuan një listë zgjedhore për të evituar votimin e Straussit, i cili vlerësohej si revanshistë nga këta intelektualë gjermanë. Rezultati: Straussit fitoi rreth 37 për qind të votave, kurse lista e inteligjencies sipërore gjermane nuk mori as 4 për qind të votave. Pra nuk e kapërceu pragun për të hyrë në Bundestag, siç i thoni ju Parlamentit.

– Domethënë, unë nuk jam kompetente ta çmoj votën time, pran-

daj ia jap atij që ma keqmenaxhon pasurinë time? – ndërhyri Renata.

– Nuk e di, por shëmbulli mbase të bind.

– Tani po e tepron, – tha ajo me të qeshur.

– Ndoshta, – ia ktheu Mirani, i cili deshi ta ndërpriste diskutimin për këtë tematikë. – Megjithatë, ti je më e privilegjuar se unë. Ke të drejtë votimi për disa alternativa, ke të drejtë proteste, demonstrimi, arsimimi, punësimi, udhëtimi pothuajse në të gjitha vendet e botës. Unë nuk i kisha asnjërën dhe shumicën nga këto nuk i kam as tani. Mungesën e tyre e vuaja, gjegjësisht e vuaja diktaturën moniste. Tani po e vuaj diskriminimin e të qenit i huaj. Madje tani po e parandiej një rrezik konkret, të paralajmëruar nga shtypi i Beogradit. Ta zëmë, gazeta serbe, më e madhja dhe më nacionalistja, “Novosti”, në faqe të parë të saj, me titull të madh e bombastik ka shkruar: “Sa herë që terroristët Miran Bruçaj dhe Jusuf Gërvalla shkojnë në Bruksel, ndodhin akte terroriste”. Kjo dhe gazeta të tjera, po edhe “Rilindja” e Kosovës, që është bërë e ngjashme me gazetat e Beogradit, veçse e përkthyer në gjuhën shqipe, po shkruajnë fejtone për terrorizmin, ekstremizmin e stalinizmin tonë. Kjo është fazë e parapërgatitjes së terrenit, dhe mund të ndodh kërkesa e qeverisë së Beogradit, që qeveria jote të na dorëzoj ne si terroristë atje ose që Beogradit të organizojë atentate kundër nesh këtu. . .

– Mos më çmend! – thirri shpërthyeshem Renata.

– Nuk ke përse çmendesh. Gjëra të tilla ndodhin në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet qeverive..

– Ty kjo nuk guxon të të ndodhë! – bërtiti ajo.

– Se mos do të pyesin ty, mësa je pyetur kur janë dhënë ndihmat policore..

– Unë do të bëj vetëvrasje, nëse ndodh kjo!

– Edhe sikur të bëje diç kaq të tmerrshme nuk do të ndreqje gjë.

– Të lutem, mos fol më kështu se po më çmend! – tha përgjërueshem Renata.

– Në rregull, unë nuk po flas, por gjërat nuk ndryshohen me të heshtur. Ato kanë rrjedhën e tyre në kuadër të rrjedhës së përgjithëshme dhe ne jemi si dy pika uji në një lumë, të cilat vetvetiu bashkërrjedhin në shtratin e tij...

– Të dalim të shëtisim sepse është bërë kohë e gjatë që nuk kemi dalë dhe më ka marrë malli, – tha Renata.

– Dalim! – tha tjetri.

14.

Nata ishte më tepër se e bukur dhe shoqërohej me një fllad të lehtë. Të dy ndërruan rrobat, meqë ai kishte një pjesë të rrobave të Renata. Ajo ia pastronte e hekuroste me përkushtim. Veshën pantollona të shkurtëra sportive, bluza e atlete. Bluzat që të dy i kishin me krahë të ngushtë. Renata nuk vuri sutjena dhe gjoksi i saj i fryrë nën bluzën prej mendafshi shpërthente hovshëm e ngacmueshëm deri në përndezeje me thimthim që shquheshin përposh saj. Të dy ndërruan rrobat në dhomë duke u bërë sikur nuk e shihnin njëri-tjetrit. Ata zhvisheshin e visheshin pas rafit me libra në fund të krevatit, një metër larg lavamanit. Mirani bëhej sikur ia kishte kthyer shpinën Renatës kur po i ndërronte rrobat, por gjoksin e saj e vështronte në xham të dritares. Kjo pamje i dukej më tërheqëse se sa në pasqyrë. Përjashta kishte rënë terri dhe xhami i dritarës ishte shndërruar në pasqyrë romantike. Në ato çaste atij i iku mendja: “Sa afër e kam këtë kraharor kaq përvetësues për ta shtënë në dorë, për ta përjargur siç do të më komandonte epshi, këtë gjoks që askush deri tani s’e ka ndrydhur...”. Sesi iu kujtuan fjalët e plakut të familjes, Demirit: “Burrë i thonë atij që koka e epërme ia komandon kokën e poshtme!”. Ai edhe tani po i jepte të drejtë plakut Demir. “Po ta ndiqja qejfin e kokës së poshtme, tani do t’i hidhesha si luan dhe nuk do t’i dihej përfundimi...”

Renata, pasi u përgatit, nuk u përmbajt pa ia vënë duart mbi lëkurë

të kraharorit atij, duke i thënë: – Po vazhdon ta mbash me fanatizëm këtë konfiguracion kaq sportiv.

Po ecnin dora-dorës dhe kushdo t'i shihte do të mendonte: “Sa çift i dashuruar!”. Po këta ishin një çift i veçantë që nuk ngjanin as në vëlla e motër, as në çift të dashuruarish, as në kolegë, as në shokë. Mirani e definonte këtë lloj marrëdhënieje si të veçantë, marrëdhënie e ngushtë miqsh, të dashuruarish, por që frenonin ta materializonin këtë dashuri. Ndonjë kureshtar që kënaqet duke parë çiftet tek shëtisnin e putheshin në këtë mal kaq romantik, sonte sigurisht do t'u vëhej prapa t'i përcillte derisa të shtriheshin në tokën e vakët për të shfryrë epsheet e papërmbajtura seksuale. Në fund do të ndiheshin të zhgënjyer e të habitur se përse këta shëtisin e shëtisin e të paktën nuk puthen si çiftet e tjera!

– A s'më shpjegon edhe një herë për ato që shkruakan gazetat jugo-sllave? Vazhdoj të jem e frikësuar nëse mund të të ndodh ndonjë fatkeqësi. – rihapi sërish temën ajo.

– Me kusht, të ma japësh fjalën se nuk do të alarmohesh.

– Po ta jap fjalën! – tha Renata duke ia zgatur dorën.

– Shtypi jugo-sllav, veçanërisht ai i Beogradit...

– Më fal për ndërhyrje, por sa herë kam pasur ndër mend të të pyes, përse e ndan në rrokje këtë fjalë jugo-sllav dhe nuk thua siç e them unë?
– ndërhyri ajo.

– Sepse, po ta përkthejmë nga serbishtja në gjermanisht, do të thotë sllavë të jugut dhe Jugo-sllavi do të thotë shtet i sllavëve të Jugut. Edhe këto emërtime na përjashtojnë ne shqiptarëve të Kosovës që jemi kombi i tretë në Jugo-sllavi për nga numri, pasi ne nuk i takojmë grupimit të madh të popujve sllavë dhe as jugo-sllav.

– Tani të kuptova. Të lutëm, vazhdo aty ku ndërhyra. Edhe njëherë po të kërktoj falje për këtë ndërhyrje!

– Nuk prish punë. Ndonjëherë ndërhyrjet e gjallërojnë bashkëbise-

dimin. – Ku e pata lënë?... Ah po, sapo pata filluar të të shpjegoj për shtypin jugo-sllav. Ai ka filluar një fushatë marramendëse me shpifje e dezinformime tepër diskredituese kundër lëvizjes sonë patriotike çlirimtare, sidomos kundër Jusufit dhe kundër meje. Sesi mund të sajohen shpifjet e dezinformimet skandaloze, po të sjell një shëmbull tipik që ta kuptosh më lehtë: Jusufi asnjëherë në jetën e tij nuk ka qenë në Bruksel. Pra as në demonstratën e djeshme, sepse ende nuk i është lëshuar një dokument udhëtimi nga organet përkatëse gjermane, as pas një viti e gjysëm, që kur është këtu. Dhe, për mendimin tim, nuk po ia lëshojnë sepse duan t'ia kufizojnë lirinë e lëvizjes. Më konkretisht duan ta pengojnë në veprimtarinë e tij patriotike e politike, kundër Beogradit pushtues. Sikur Jusufi të ishte i arratisur nga Republika e Shqipërisë, do t'i kishte të miratuar statusin e të përndjekurit politik dhe dokumentin e udhëtimit brënda dy muajve. Pikërisht për këtë Jusuf, shtypi i Beogradit, me tituj të mëdhenj sensacional shpif se gjoja sa herë ai dhe unë shkojmë në Bruksel, atje ndodhin akte terroriste...

– ...dhe po të kisha ditur ta lexoja atë shtyp dhe të të mos njihja ty, do t'i kisha besuar edhe unë. . . – ndërhyri ajo.

– Ja, kështu spekulojnë mediat me opinionin e qytetarëve.

– Marramendëse, trishtuese! – shfryu Renata.

– Beogradi me këtë fushatë po mundohet të na detyrojë të merremi me veprime hakmarrëse, sepse e di se është mënyra më e suksesëshme për të na komprometuar dhe për të na luftuar. Meqë kjo taktikë nuk po i ka sukses, rrjedhimisht mund të pasojë rreziku i atentateve ndaj nesh...

– Vetëm atentatët mos m'i përmend, të lutem, se po më çmend!

– Po ti tani po kërkon sqarime dhe unë nuk kam sesi të mos i përmend, meqë mund të ndodhin edhe atentatët në kuadër të luftës bën Beogradi, nëse nuk i dalin me sukses metodat e tjera.

– Frikësohesh se mund të ndodhë dorëzimi yt në Beograd nga qeveria jonë? – pyeti prapë Renata.

– Sa për frikë, ta kam thënë sa herë, kur njeriu përcaktohet me vetëdije për këtë veprimtari, ai e ka vrarë frikën, siç shprehet figurativisht Jusufi. Ndërsa rreziku për ekstradim nuk përjashtohet. Ti nuk mund ta marrësh me mend se para se të marrë qeveria vendim, marrin vendim struktura të tjera, siç janë shërbimet inteligjente, që këtu quhen Enti Federativ për Mbrojtje të Kushtetutës (Bundesverfassungsschutz), Shërbimi Federativ Informativ (Bundes Nachrichten Dienst, shkurt BND), pastaj Enti Federativ për Kriminalistik (Bundeskriminalamt), Prokuroria Federative (Bundeststaatsanwaltschaft) etj. Në këto struktura punojnë nëpunës, të cilët në kuadër të bashkëpunimit me struktura analoge jugosllave, janë shoqëruar me kolegë jugo-sllavë, ose janë korruptuar prej tyre, siç po flitet për Shefin e BND-së. Pastaj, në kuadër të bashkëpunimit, ndodhin edhe kushtëzime reciproke. Dhe, nëse përgjegjësit e këtyre institucioneve vendosin për ekstradim, ata fabrikojnë prova arsyetimi, duke e vënë qeverinë para aktit të kryer për të miratuar vendimin e tyre...

– O bobo! – bëri tjetra, – qenkemi vërtet para një rreziku...!

– ...I cili nuk duhet të na shqetësojë kaq shumë. – ndërhyri Mirani.

Për disa momente nuk foli asnjëri. Pastaj u hap Renata:

– Mirani im i dashur, kur ndodhen demonstrat e para të studentëve në Prishtinë dhe pastaj ato të qytetarëve që iu bashkangjiten studentëve, që ngjanin me një rrebelim popullor, pata shpresuar se Kosova do t'i fitojë të drejtat që po kërkonte. Për këtë kisha arsye konkrete, sado tingëllojon paksa egoiste. Shpresova se do të zhbllokohej frenimi yt dhe do të bënim çfarë na diktojnë zemrat tona. Nuk ke nevojë të arsyetohesh, meqë e di tashmë. Tani po më vjen keq për popullin e Kosovës, ndaj të cilit po ushtrohet terror i madh, por njëherit po më vjen keq edhe për fatin tim të zi...

– Pa prit njëherë se fjalia e fundit po ngjan në dialogët e Zhulietës se

Shekpirit! – ndërhyri me të qeshur Mirani duke mbështetur në gjoksin e tij Renatën. Trupat u dridhen kur u takuan. Bluzat i kishin të holla dhe disa pjesë të trupit u puçën lëkurë me lëkurë, duke shkëmbyer energji eps. Mirani e puthi lehtë në ballë, kurse Renata në gjoks.

– Do të vish më mua të bëjmë një pushim dyjavor në bregdetin grek, që është vazhdim i bregdetit shqiptar? – tha ajo pas pak.

Mirani, në vend të përgjigjes filloi të mendonte. Pa dashur i erdhi një kujtim nga kohët e largëta.

– Hë, përse nuk po përgjigjesh, ku e ke mendjen? – pyeti Renata.

– Më fal, por sesi m'u kujtuan ca gjëra nga e kaluara që kishin të bënin me detin...

– Cilat?

Mirani po hezitonte t'i tregonte. Mendonte se do ta dëshpëronte...

– Pse heziton? Për gjëra të karakterit jopolitik nuk je hamendur ndonjëherë, apo ke edhe ndonjë të fshehtë që nuk ma beson, ose që ndruhesh se mos po ma prish qejfin? – tha ajo.

– Diçka e ngjashme, – u përgjigj më në fund ai.

– Po ti tashmë e di se unë nuk hidhërohëm për të kaluarën tënde.

Ai vendosi t'i tregonte.

– Habitëse, çfarë dhuntie ka truri i njeriut. Sapo përmende detin, pa dashur mendja më iku në Ulqini, një qytet i banuar me shqiptarë, tani nën pushtimin e Malit të Zi. Në vitin 1969, kur po mbushja 15 vjet, për herë të parë dola jashtë qytetit tim ku kam lindur. Isha në përfundim të vitit të dytë të shkollës se mesme, ose në klasë të dhjetë, siç i numëroni ju këtu. Mësuesin e fizikës e kishim kujdestar klase. Ai organizoi që klasa jonë të shkonte në shëtitje një fundjave në Ulqin. Daja m'i dha të hollat. Shkuam dhe u mahnita nga deti, nga shumësia e ujit të tij, nga horizonti i tij që bashkohej me qiellin. Ndenjëm dy ditë. Në të kthyer natën me autobus të gjithë nxënësit i kishte marrë gjumi nga lodhja. Edhe mësuesin po e merrte gjumi, ndaj më tha të ulesha në karrigë të parë,

pranë vozitësit, ku rrinte ai dhe të kisha kujdes atë se mos po e merrte gjumi. Rruga ishte me kthesa të mëdha përmes një kanjoni piktoresk. Në një çast autobusi mori në të djathtë për të dalë nga rruga. Ia ngjita timonit dhe i dhashë në të majtë. Shoferi u trand nga e kotura e tij dhe frenoi menjëherë. Të gjithë u zgjuan me të ulëritura. Besmira, shoqja e klasës, që ishte në karrigën prapa meje, m'u hodh në qafë me të puthura nga gëzimi që ua kisha shpëtuar jetën. Ishte vajza më e mirë në klasë, më e bukura në imagjinatën time shpirtërore, më e zgjuara. Për këtë e kishin zgjedhur kryetare të klasës. Si e tillë, ajo ndihej tepër përgjegjëse për mbarëvajtje të shëtijes sonë. Por edhe atë e kishte zënë gjumi. Kur ndaloi autobusin, dolëm të shihnim se ku kishte mundur të ndodhte rreziku vdekjeprurës për të gjithë. Hëna bënte dritë dhe të gjithë u lëmeritën kur panë honin ku do të binim, po të mos i kisha shpëtuar. Besmira prapë më puthi, tashmë me lot gëzimi. Unë, për shkak të dashurisë adoleshente ndaj saj, më shumë iu gëzova atyre puthjeve se shpëtimit nga vdekja. Në brendësi ndjeja dashuri të madhe për të, por nuk ia shfaqja dot sepse më dukej e paarritshme. Edhe ajo më donte si shok klase, veç nga të tjerët, por nuk më dashuronte. Kështu të paktën gjykoja unë. Shpesh më thoshte: “Sa të lezetshme i ke lazdrimin, humorin dhe sherret!” Dhe vërtet atëherë kam qenë i lazdruar, humorist e i përdrejtë. Dashuria e atëhershme me kohë u shndërrua në simpati për të, e cila nuk m'u tret asnjëherë...

Mirani u ndal për të menduar nëse duhej të vazhdonte. Renata e vështroi nëse do të vazhdonte rrëfimin e kujtimeve, apo e kishte përfunduar. Pa e ditur se çfarë po mendonte tani tjetri, ajo tha:

- Për këto që tregove doje të përmbaheshe!?
- Nuk u rashë deri në fund kujtimeve, – tha ai.
- Atëherë vazhdoje, ç'po pret, apo ndoshta dëshiron të më bësh kureshtare?
- Në vitët e mëvonshme shumë herë kam fjetur me të në ëndrra.

Edhe më shpesh kur u arratisa dhe u vendosa këtu. Këtu u mundova shpesh ta portretoja, por nuk më dilte siç e shihja në ëndërr. E shihja ëndërr dhe më bëhej se do të mund ta portretoja kur zgjohesha. Më bëhej sikur kisha fjetur gjithë natën me të, sikur disa herë gjatë të njëjtës natë kishim bërë marrëdhënie seksuale. Me kalimin e kohës edhe në ëndërra vendin e saj e zure ti. Për një kohë flija herë me të dhe herë më ty, duke ma përzënë ti gjithnjë e më shumë ate. Çarçafët nuk ia jepja kunatës Sabrush t'm'i lante. Sa herë i ke larë edhe ti dhe nuk të kam treguar se me cilën kisha fjetur në ëndërr. Pastaj mendoja, çfarë informatash bartnin qelizat e trurit që koordinojnë epsheet seksuale. Mrekulli më vete. Ma sillnin ate në ëndërr për të ma ruajtur kështu ekuilibrin biologjik.

Mirani pushoi se rrëfyeri dhe ndjeu se kishte marrë zjarrmi e po dje-sitej. Renata kishte filluar të qeshte dhe në të qeshur tha:

– Dora t'u ka bërë valë...

– Ti e kisha fajin, meqë më detyrove të tregoj...

– Gjithëçka ishte njerëzore dhe nuk ke përse hidhërohesh. Këtu nuk po na sheh njeri pos lisave dhe në ndonjë boshllëk të tyre edhe yjet e kristaltë në qiell.

Mirani nuk reagoi më, tërhoqi dorën e tij nga dorë e saj. Renata priste që Mirani t'i përgjigjej në pyetjen që ia kishte bërë po ai shtirej sikur kishte harruar.

– Gjithë këto emocione të bënë të harrosh të më përgjigjesh: pranon të vish me mua në pushime dyjavore në Greqi? – ia rikujtoi ajo.

– Nuk mundem, më duhet të punoj gjatë këtyre tre muaj të pushimeve në Fabrikë të Opelit, sepse aty më ka pëlqyer kur punova gjatë dimrit.

– Se mos po nguron për shkak të parave? Unë i kam paratë e kursyera nga puna që po bëj me ushtrimet në seminar gjuhësor. Pastaj edhe prindërit më kanë thënë se do të na japin të holla të bollshme për pu-

shime. Ti e di, ata edhe përpara të janë lutur që të mos punosh, po vetëm të studiosh. Po të erdhi keq të shkojmë me para të prindërve, i kam kursimet e mia. Ushtrimet e kursit po i mbaj që të pavarësohem financiarisht sa më shumë nga prindërit.

– Nuk më bëhet pushim tani kur mbretëron situatë kaq e rëndë në Kosovë, sado që do të vija me dëshirë me ty dhe për të parë bregdetin nga kufiri i Butrintit e deri në Pervezë. Pushim nuk kam bërë në jetën time, pos atij uikendi në Ulqin.

Në fakt ai po mendonte se dy javë edhe mund t'ia lejonte vetes, meqë ndonjë aktivitet nuk kishin planifikuar dhe tani Jusufi e Kadriu po merrshin me përgatitjen e botimit të *Lirisë*. Ndonjë ndihmë atij nuk ia kishin kërkuar. Por, hallin e kishte kryesisht te paratë që do t'i duheshin për vitin tjetër të studimeve, pasi me punën që bënte në pushime mban-te veten dhe financonte angazhimin e tij politik.

– Nuk po të ngushtoj, të kuptoj që nuk të pushohet në këto rrethana, – i foli Renata, duke menduar se e kishte vënë në pozitë të keqe.

Renata e Mirani shëtitën deri pas mesnate. Duhej shfrytëzuar një natë aq e mirë se nuk i dihet motit në Gjermani.

15.

Në mbarim të korrikut dy policë të kriminalistikës erdhën në konvikti të Mirani, pasi e paralajmëruan në telefon, duke i kërkuar leje për një bisedë.

– Je duke marrë postën me rregull? – e pyti njëri nga policët.

– Domethënë, ju ma merrkeni postën, meqë nuk po më vijnë dërgesat për gati një muaj? – u përgjigj me pyetje Mirani.

– Tash sa ditë nuk merrni postë?

– Them po bëhet muaji, sado që në fillim nuk qeshë i vëmendshëm.

– Jeni interesuar për të pyetur të paktën në postë?

– Jo, meqë janë pushimet. Pata menduar se duhet të më vijë vetëm

shtypi i abonuar nga Republika e Shqipërisë. Gjykova se ata ma kanë ndalur, prandaj i kam shkruar një letër Ndërmarrjes së Librit në Tiranë.

– E keni kopjen e asaj letre? – pyeti polici.

– Po.

– Mund ta shohim?

– Pse jo, por nuk e kuptoni. Është e shkruar në gjuhën shqipe.

– Nuk prish punë, vetëm ta shohim.

Mirani u ngrit nga vendi, sepse biseda po zhvillohej në kuzhinë, dhe shkoi në dhomë prej ku u kthye me letër në dorë.

– Polici e mori dhe kur pa edhe dëshminë që ishte dërguar rekomande, i tregoi kolegut të tij, i cili mbajti shënim.

– E paskeni dërguar rekomande, a mund të na e përktheni përmbajtjen?

– Po, – u përgjigj shkurt Mirani dhe ua përktheu fjalë për fjalë.

– E njihni njëfarë jugosllavi me emër Rezil Mejtepi?

– Kam dëgjuar për të, por ai nuk është jugo-sllav, është shqiptar nga Kosova.

– E njihni mirë?

– Jo, kam dëgjuar për të, – gënjeu Mirani.

– A mund të na tregoni, se çfarë keni dëgjuar, – pyeti polici me qetësi.

– Kam dëgjuar të jetë spiun i UDB-së, siç mund ta dini, por ju ata i toleroni...

– Kjo është në kompetencën tonë, nëse i tolerojmë ose jo! Ju pyetem çfarë keni dëgjuar konkretisht? – ndërhyri polici, kësaj radhe me paraqitje më serioze.

Mirani u tregoi për ato që kishin ndodhur midis Rezilit e kroatit, kur kroati e kishte thënë me thikë.

– Diçka tjetër keni dëgjuar? – pyeti polici duke mos u mjaftuar me këtë ngjarje.

– Se ka sajuar një grup me emrin *Grupi Komunist Zëri i Kosovës*, por ai

grup ka pushuar veprimtarinë e tij.

– A keni pasur korrespondencë me Rezil Mejtepin? – pyeti polici.

– Më falni, por këto pyetje janë tepër konkrete dhe dua të shfrytëzoj të drejtën për të mos u përgjigjur! – u përgjigj Mirani.

Polici tjetër nxori nga dosja ca letra dhe ia vuri përballë Miranit.

– I njihni këto letra, janë korrespondencë e zotëri Mejtepit? – pyeti polici i dytë duke ia vënë letrat mbi tavolinë.

– Po, më ka shkruar dy herë dhe iu kam përgjigjur. Tjetër korrespondencë nuk kemi pasur.

– Mirë, tani po ju informojmë se zotëri Rezil Mejtepi është kapur në flagrancë duke jua vjedhur postën juve dhe Jusuf Gërvallës. I njihni zotërinjtë Gërvalla?

– I njoh.

– Edhe atyre ua ka vjedhur postën zotëri Mejtepi.

– Si ka mundur të na e vjedh postën, nëse më lejohet t’ju pyes?

– Në postë të Shtutgartit ka hapur postlager, pastaj ka falsifikuar në emër tuaj kërkesë përkatëse, sikur ju për një kohë do të jeni në Shtutgart, ku duhej t’ju vinte posta. Nëpunësit e postës në Shtutgart janë bërë të dyshimtë, kur atij i është grumbulluar postë e shumë personave. Kanë informuar policinë, e cila ka shkuar dhe e ka pritur derisa ai ta merrte postën. E kanë kapur dhe pastaj ia kanë bastisur postlagerin dhe bane-sën. I kanë gjetur postimet në emër tuaj dhe të Gërvallajve, disa vula që përdoren për falsifikime, një ditar interesant dhe materiale të tjera. Jeni i kënaqur me informim? – pyeti në fund polici.

– Ju falenderoj, pasi keni të drejtë të mos më tregoni asgjë.

– Tani do t’ju tregojmë një kopje nga ditari, meqë sipas përmbajtjes së tij, ne po dyshojmë se zotëri Mejtepi është spiun i Sigurimit të Shqipërisë dhe jo i UDB-së së Jugosllavisë, siç e akuzuat ju.

Policët ia vunë kopjet e ditarit të Rezilit përpara dhe i thanë t’i lexonte pjesët e nënvizuara nga hetuesit, që tashmë e kishin përkthyer të tërin.

Mirani sapo e pa dorëshkrimin e Rezilit, iu kujtua gjysmanalfabetizmi i tij. Pastaj nisi ta lexonte tekstin. Hasi në vështirësi për të lexuar atë dorëshkrim të shëmtuar. U kërkoi falje policëve, me shpjegimin se është dorëshkrim i gjysmanalfabetit. Sapo lexoi shënimin:

“U takova me Drapërin e Çekani nga Republika e Shqipërisë në një vend konspirativ, më urdhëruan që ta survejoj Jusuf Gërvallën dhe Miran Bruçajn. Survejin e tyre ata e arsyetuan, se që të dy janë spiunë të rrezikshëm të UDB-së..”

Mirani ndërpreu leximin.

– Ju lutem, mos u bëni naivë të dyshoni se Rezil Mejtepi është spiun i Sigurimit të Republikës së Shqipërisë. Në fjali të parë, të nënvizuar nga ju, përforcova dyshimin se ai vërtet është spiun i sofistikuar i UDB-së, ose ndonjë psikopat. Ai ka bërë gjithë këtë aksion, vetëm që ju t’ia kapni rastësisht këtë ditar, pasi posta jonë nuk i ka hyrë në punë, sepse nuk është postë që meriton të survejohet.

– Ju lutem, lexoni edhe këtë pasus! – iu drejtua polici Miranit duke treguar pasusin në një fletë tjetër.

Mirani filloi ta lexonte tekstin e nënvizuar që ia ofroi polici:

“Me Miran Bruçajn jemi takuar për të biseduar për organizatat tona. Pasi konstatova se atë nuk e lejon UDB-ja, u binda se ai dubet luftuar. U binda se informatat e Sigurimit tonë kombëtar ishin të vërteta, sepse Sigurimi ynë kombëtar është vigjilent dhe nuk gabon, meqë drejtohet nga Partia jonë lavalimadhe, me Shokun e dashur Emver në krye...”

– Kjo është edhe një dëshmi më shumë, që ky njeri është vërtetë udbash dhe jo psikopat, siç improvizon ndonjëherë. Spiuni i Sigurimit nuk do të kishte guxuar të mbante këso shënimesh, sepse do ta paguante me kokë.

– Ju lutemi, lexojeni edhe këtë pasusin këtu! – iu drejtua polici. Polici tjetër mbante shënime.

Mirani zuri të lexonte:

“Sot u takova me dy bashkatdhetarë në stacion. U fola për rrezikun që paraqiste udhëbashi Jusuf Gërvalla. Ata m’u përgjigjen, se edhe në Kosovë iu kishin thënë po këtë gjë disa intelektualë që i kishin faretis, por që nuk pranuan t’i tregonin emrat e tyre. Bile, ata ishin informuar se Jusufi po përpiqej të vijej në shërbim të Sigurimit shqiptar, por nuk po i mashtronte dot, sepse Sigurimi e kishte marrë vesh, jo vetëm përmes meje, por edhe nga të tjerë agjentë të tij, se këtë detyrë UDB-ja Jusufit ia ka caktuar, pos që të identifikojë se cilët shqiptarë janë patriotë, të shpërbëjë edhe Grupin tonë famëmadh Komunist “Zëri i Kosovës”. Kjo është edhe një dëshmi më shumë, se askush, as i kamufluar Jusuf Gërvalla, nuk mund t’ia hedh Sigurimit tonë sishqiponjë dhe as mua, ushtarit të saj, gjegjësisht të Atdheut...”

– Ju lutem, mos më bezdisni me shkarravina të sajuara primitivisht nga Rezil Mejtepi! – iu drejtua Mirani policëve. – Ekspertët do t’jua vërtetojnë këtë që po jua them dhe mendoj se nuk keni nevojë të bëheni naivë duke informuar mediat se gjoja keni zbuluar një spiun të Sigurimit të Republikës së Shqipërisë.

– Ju falenderojmë për këshillë, por nuk jua kemi nevojën, sepse ne vendosim vetë se çka duhet të bëjmë, – ia tha polici që po ruante pakësa inatin nga fajësimi i mëhershëm dhe propozimi i tanishëm i Miranit.

– Të lutem, vetëm edhe këtë pasus dhe nuk do të të bezdisim më, – iu drejtua polici tjetër duke vënë gishtin tregues mbi pasusin që i sugjeronte ai Miranit ta lexonte.

“Sot u takova në të njëjtin vend konspirativ me shokët Drapër e Çekan dhe më përgëzuan në ndikimin që kisha në organizim të demonstratave në Kosovë. Më bënë me dije se edhe në Kosovë kishin angazhuar shumë spiunë që tani të përgatishnin kryengritje të armatosur, pasi protestat paqësore politike nuk dhanë rezultatin e planifikuar. Sa krenar që ndihem që po i shërbej kauzës sonë kombëtare, që do të konkretizohet me krijimin e Shqipërisë së Madhe...”

– Vërtet më mjafton, pasi montimi i tij duket aq transparent, sa nuk do mend të konstatohet edhe nga laikët, – ndërpreu leximin Mirani duke dhënë mendim plotësues, por tani dukej se po bëhej nevrrik nga

provokimi që i shkaktuan këto pjesë të ditarit të Rezil Mejtepit. – Termin *Shqipëri e madhe* e kanë shpikur serbët, por shqiptarët e arsyeshëm nuk e përdorin. Asnjëherë nuk kam dëgjuar të përdoret as në Republikën e Shqipërisë, meqë rregullisht po lexoj shtypin e saj dhe po dëgjoj Radio Tiranën. Bile, unë dyshoj se diktatura e Enver Hoxhës nuk e dëshiron as bashkimin e Kosovës me Republikën e Shqipërisë, pasi nuk do të mund të ushtrohej kjo diktaturë, të cilës në Tiranë zyrtarisht po i thonë *diktaturë e proletariatit*.

– Mbaroi biseda dhe ju këshillojmë që të tregoheni më të kujdesshëm gjatë këtyre ditëve! – iu drejtua polici tjetër Miranit. – Po na u deshe ose po patëm ndonjë informatë do t’ju kontaktojmë. Kjo është kartëvizita ime dhe mund të më telefononi, nëse dyshoni se po survejoheni nga ndokush, ose nëse dëshironi të na thoni diçka që u rezervuat ta thoni tani.

– Ju faleminderit! – tha Mirani.

– Mirëupafshim! – u përshëndetën policët duke paluar dokumentacionin.

Kur shkuan Mirani nisi t’i analizonte përjetimet duke thënë më vete: “Qeni, ia falem jetën, pasi vërtet do ta kishte vrarë Vasili! Tani sajuaka gjëra më të rrezikshme dhe sigurisht që do t’i avancojë e sforcojë.”

16.

Të nesërmen Mirani udhëtoi për Shtutgart. Shkoi të Jusufi e Bardhi. Aty gjeti edhe Kadriun. U mirëprit dhe i erdhi mirë që Jusufi e Kadriu nuk po e angazhonin për t’i ndihmuar në përgatitje të gazetës *Liria*. Përpara e vuante përgjegjësinë për botim të *Bashkimit*, meqë vlerësonte vetën se nuk ishte kompetent për t’i dalë zot asaj përgjegjësie.

Po bënte kohë e mirë. Jusufi propozoi të dilnin në natyrë, pasi në afërsi kishte livadhe e pyje që të hiqnin mallin e Rugovës piktoreske. Bashkë me Jusufin, Kadriun e Miranin, në shëtitje dolën edhe fëmijët e

Jusufit. Meqë në një rast u gjendën vetëm Mirani dhe Dardana, që ecnin më shpejt se të tjerët, ajo kureshtare dhe fascinante e pyeti Miranin:

– Axhi Miran, përse nuk po e përgatit bashkë me babin dhe Axhin Kadri edhe gazetën *Liria*, si dikur gazetën *Bashkimi*!?

– Sepse mjaft e kam nervozuar unë babin, tani ai ka Shokun Kadri, që është më i sjellshëm se unë. Shoku Kadri është edhe gazetar, si babi yt, prandaj bashkëpunojnë si kolegë. Mirani iu përgjigj kureshtjes se Dardanës, duke menduar më vete: “Sa e zgjuar që është, bëhet sikur nuk i intereson gjë nga punët tona, por sa mirë i ka kap syri i saj i vëmendshëm!”

– Mirë që më sqarove, sepse unë isha bërë merak, se mos babi është hidhëruar me ty dhe nuk dëshiron të bashkëpunojë më, – ia ktheu e gëzuar Dardana.

– Arsye konkrete nuk ka pasur, pos atyre nervozave që ia shkaktoja rastësisht e herë pas here. Pastaj, ndonjëherë edhe mund të jemi hidhëruar, siç hidhërohen shokët e vëllezërit, por jo më shumë. Ty sa herë po të ndodh të hidhërohesh me Premtimin.

– Po, po, por ai është fajtori, – u mbrojt Dardana.

– Të gjithë kështu thonë, askush nuk dëshiron ta pranojë fajin, prandaj as ti nuk ke nevojë, meqë ju kam përcjellë. Ndonjëherë edhe ti e ngacmon përpara ose nuk e dëgjon.

– Sepse ai do të keqpërdor faktin se është më i madh e unë nuk pranoj komandime të tij, – u arsyetua tjetra.

– Secili gjen arsyttime edhe kur është fajtor, përndryshe nuk do të kishin ndodhur zënkat.

– Domethënë, do të më bësh mua fajtor, Axhi Miran? – pyeti Dardana pakësa e hidhëruar.

– Jo, nuk thashë se je fajtorë. Kjo nuk do të thotë që Premtimi është fajtor përherë.

– Falimenderit! – u shpreh e lehtësuar Dardana.

Jusufi e thirri Miranin të mos nxitonte.

– Do të ulemi ne të rriturit, ndërsa fëmijët le të lozin! – tha ai. Fëmijët e kuptuan se duhej të largoheshin, pasi babi dhe xhaxhallarët Kadri e Miran donin të bisedonin pa prani të tyre.

– Tek unë ishte policia kriminalistike e Hailbronit, – nisi Jusufi. – Më informuan që Rezil Mejtepi kishte vjedhur postën time dhe tënden. Besoj edhe te ti, Miran, duhet të kenë qenë.

– Po, – miratoi shkurt Mirani.

Jusufi informoi se si kishte shkuar biseda me policë. Edhe atij i kishin ofruar pjesë të ditarit të Rezilit për të lexuar, por ishte përmbajtur për të dhënë komente, siç kishte vepruar Mirani. Tregoi se sa e kishte irrituar e hidhëruar kjo veprimtari e Rezilit, ndërsa Mirani informoi edhe për komentet që kishte bërë para policëve.

– Me sa kuptova, – nisi të sqarojë Mirani, – Rezili po e vazhduaka veprimtarinë e tij, vetëm se ka ndryshuar metodën dhe taktikën. Që kur na u burgos Vasili nuk po ka kush ta vrojtojë. Kurse Nuriu ua ka bërë çorape rrethin tuaj këndeje dhe angazhimi i mëhershëm i rrethit tuaj është dëmtuar. Edhe Sadi Bakaj po mban linjen Shtutgart – Sant Gallen, prandaj këta gjarpëririnj që ne po na duket se po lëvizin kot këtej e andej, mund edhe të na kafshojnë. Ti më pate thënë, Kadri, se bashkatdhetarët e kishin parë Sadiun në Sant Gallen, për të cilin ti kishe dëgjuar që moti se është i rrezikshëm.

– Shokë ju këndeje nuk po ruheni, nuk jeni konspirativë, – mori fjalën Kadriu. – Sidomos ti, Shoku Jusuf, vigjilencën e ke lëshuar përtoke. Shtëpia jote është bërë si të ishte stacion treni. Vijnë njerëz vetëm për të kaluar kohën, sepse mërziën për të ndenjur në banesat e tyre. Te ti ata kanë gjetur mirëpritje bujare dhe nuk duan t'ia dinë se kështu po konsumojnë ushqimin e familjes sate. Ti, me bujarinë e tepruar, e mirëpret secilin, sikur të të vinin si miq. Duke ardhur kaq shumë, të pengojnë në punë, në pushim, lexim e ndejë me familje. Kjo është një pjesë e dëmit.

Pjesa tjetër, e rrezikshmja, është se në mesin e gjithë këtyre njerëzve, vijnë të kamufluar edhe informues të UDB-së, pse jo edhe ndonjë që përgatitet për diçka më serioze në të ardhmen. Prandaj, meqë jemi shokë, kam të drejtën të propozoj që ti të ndyshosh këtë mirëpritje ndaj gjithë atyre njerëzve.

– Pjesërisht ke të drejtë, – tha Jusufi, – por këtë mënyrë po e shfrytëzoj për të edukuar disa të rinj dhe për të ndërgjegjësuar punëtorët e interesuar për veprimtari patriotike. Sikur të ishte ndonjëri informatorë e spiun i UDB-së, do të na tregonin nga Prishtina, sepse në hiarkinë e UDB-së në Kosovë kemi njeri që na informon se cilët njerëz këtej punojnë për UDB-në. Kështu, ne dimë pothuajse për çdo vikend, se cili udbash do të vijë nga Kosova në Mynhen, Shtutgart e gjetiu, të cilët mbledhin informata, dezinformojnë bashatdhetarët, udhëzojnë dhe u japin detyra informatorëve dhe kthehen. Ndër ta më aktivët janë Selim Brosha dhe M.H., për të cilët më është thënë se dyshohen që vetëm rrogat legale i marrin si të punësuar në UDB-në e Kosovës, por që komandohen nga UDB-ja e Beogradit. Këto lidhje që kemi nuk më kanë paralajmëruar se në mesin e atyre që vijnë ka informatorë të UDB-së...

– Domethënë njeriu juaj nuk paska informata të bollshme. Por, nga të tjera burime jemi informuar ne se kush hyn e del te ti, – ndërhyri Kadri, pa pritur nëse Jusufi kishte përfunduar përgjigjen e tij.

– Unë jam i bindur, se UDB-ja e Serbisë ka organizim paralel në Kosovë dhe në mërgatë, – shtoi Mirani. – Kam ardhur në përfundimin se që kur është menjëherë Rankoviçi, Beogradi serbomadhi, nuk u beson strukturave politike e policore të Kosovës, prandaj ka organizuar struktura të vetat paralele, sidomos sa i përketë shërbimeve të fshehta. Për një rast Jusufi e di, meqë e kemi diskutuar. Tani, sa për njoftim tëndin, Kadri, në Vjenë ishte një spiun i UDB-së së Serbisë. E quanin Fekir Dalana. Por, ai më nuk është dukur këtej. Tani, unë po dyshoj në njëfarë Xhafarin, të cilin ju e thërrisni me pseudonim “Skander”. Erdhi

verën e vitit të kaluar i kamufluar si student dhe u punësua pikërisht në afërsi të Ludwigsburgut. Rrinte haptazi, në prani të shumë vetave, me ty Jusuf dhe me Bardhin. U kthye dhe s'i ndodhi gjë. Prapë erdhi e shkoi dhe tani është këtu. Pra, ka ardhur disa herë, është kthyer dhe asnjëherë nuk i ndodhi gjë. E habitshme. Bile, nuk po pyesim se ku i merr të hollat për gjithë këto udhëtime, meqë thotë se është student. Kurse sa për të riun Hafif Gagaj, që është nga ana e juve, Kadri, kam pyetur dhe më është thënë se është rrugaç ordiner, degjenerik dhe me të vetëm se komprometohemi. Me tpa të tillë nuk kemi kohë të merremi dhe as të rrezikojmë, sepse kemi mërgimtarë të tjerë, tashmë edhe të interesuar për t'u angazhuar, ngase në Kosovë ata tashmë po frikësohen të shkojnë.

– Për Xhafarin garantoj unë, pasi atë ma ka sugjeruar Shoku Sabit, njëri nga udhëheqësit kryesor të organizatës sonë... – sqaroi Jusufi.

– Më në fund, të paska kontaktuar! – ndërhyri Mirani.

– Miran, e di që ti ke krijuar një mendim negativ për Shokun Sabit, por ta kam tërhequr disa herë vërejtjen se atë nuk guxon ta përgojosh! – ia tërheqi vërejtjen Jusufi me zë serioz duke menduar se Mirani do të fliste për Sabitin edhe para Kadriut.

– Se mos është profet, për të cilin nuk guxuakemi të shfaqim mendime kritike, edhe kur njerëzit na tregojnë se në ç'gjendje është katan-disur, – ia ktheu Mirani.

– Edhe ai ka informata të këqija për ty..

– Që mund t'i kenë shkuar që këtej nga të njëjtit që u munduan të të dezinformojnë edhe ty, por meqë nuk ia arritën, paskan gjetur formë të tërthortë, – e ndërpreu me hidhërim Mirani.

– Ne jemi sqaruar dhe nuk kemi nevojë t'u rikthehemi, sepse ti vetë i ke pranuar vërejtjet e mia... – reagoi Jusufi.

– Nuk kemi nevojë të bisedojmë në këtë nivel, – ndërhyri Kadriu. – Këto gjëra, shoku Jusuf, i kemi biseduar së bashku, edhe pse nuk ishte i pranishëm Mirani. Bisedën e kishim për rrezikun se si do të na infiltro-

hen shërbëtorët e UDB-së, pasi do të angazhohen më me përkushtim, për të na penguar...

– Ata veç janë infiltruar, përderisa në merremi me dezinformatat e tyre, edhe pse ne e njohim më mirë njëri-tjetrin. Të tillë tipa që përflasin herë për njërin e herë për tjetrin, varësisht nga mesi ku gjenden dhe me kë bisedojnë... – ia ndërpreu fjalën Mirani.

– ...Sepse organizimi juaj nuk i përgjigjet bllokimit të infiltrimit të udbashëve dhe informatorëve të tyre, – ndërhyri Kadriu, duke mos i ardhur mirë për ndërhyrjen e Miranit.

– Edhe këtë do ta ndryshojmë, – mori fjalën Jusufi, – sepse tani më ka udhëzuar Shoku Sabit, se si duhet të veprojmë...

– Se mos e keni ju të OMLK-së organizimin më të mirë, – ndërhyri Mirani, meqë i erdhi inat për zhvlerësimin që bëri Kadriu. – Ju jeni futur në ilegalitet aq të thellë, sa gati nuk jeni shndërruar në uritha. Megjithatë, burgosjet në Kosovë po dëshmojnë se edhe konspiracioni juaj komunist nuk duhet të ketë qenë i atij niveli sa shisni ju mend. Kurse në mërgatë, ti shoku Kadri ende nuk ke anëtarësuar njeri vetëm mban rreth vetës disa kandidatë simpatizantë që duhet ta plotësojnë stazhin para se t'i anëtarësoni.

– Miran, po më ndërhyr pa vend dhe po shpreh mendim për tema që nuk të përkasin dhe nuk je kompetent... – iu drejtu Kadriu, duke u mundur ta përmbante hidhërimin, sepse ai po e vuante rënd burgosjen e shumë anëtarëve të organizatës së tij në Kosovë.

– Është në natyrë të Miranit dhe prandaj ky ves i tij e ka një si lezet në vete, – tha Jusufi duke bërë një qeshje të lehtë.

– Pavarësisht, duhet të tregohet më i përmbajtur dhe më i vëmendshëm. Unë mendoj se ju ende nuk duhet të filloni me anëtarësime, sepse do të keni fërkime të simpatizantëve tuaj. Them, derisa të formalizohet marrëveshja për bashkim, meqë përmbajtësisht jemi dakorduar, të presim me anëtarësime. Kur bashkimi të shpallet, riorganizimi do të

nis në Kosovë, pastaj do të bëjmë riorganizim të përbashkët edhe në mërgatë, përshtatshëm me riorganizimin në Kosovë.

– Meqë ti, Kadri, i dhe të drejtë vetes të na kritikosh ne, përse nuk paskam të drejtë të shpreh mendime kritike edhe unë, ndaj jush...

Jusufit nuk i pëlqeu kundërvënia e Miranit ndaj ndërhyri:

– Sikur po vonohemi, sepse ky nivel i organizimit të tanishëm nuk mund të japë rendiment më të lartë se sa kemi arritur. Për hir të përpjekjeve që po bëjmë për bashkim, unë shtyva për më vonë nxjerrjen e një organi të organizatës sonë. Këtë ma kërkoi para ca kohe Shoku Sabit. Pastaj, them se tani nevojat tona po na i plotëson *Liria* që po e nxjerrim bashkarisht, por na duhet, gjithsesi, të ngutemi që t'i bashkojmë radhët në një organizim të vetëm, të disiplinuar dhe mirë të koordinuar e me udhëheqje të centralizuar.

Kadriu e shikoi Jusufin për ta sinjalizuar se nuk bëri mirë që tregoi se po e nxjerrnin bashkarisht *Lirinë*.

– Shoku Kadri, – u ngut Jusufi, – nga Mirani nuk kemi nevojë ta mbajmë të fshehtë këtë bashkëveprimtarë, pasi e kemi shok dhe përfaqëson organizatën e Frontit, pavarësisht se veprimtarinë e asaj organizate e kanë ngrirë për të pritur bashkimin dhe bashkorganizimin tonë.

– Mos u bëni merak, edhe Dardana shprehu shqetësimin, se përse nuk po angazhohesha për të përgatitur bashkarisht *Lirinë*, por e sqarova, se nuk isha i nevojshëm.

– Lëri bisedat me fëmijët, Miran, se nuk po na hyjnë në punë tani! – mori fjalën Kadriu. – Bashkimi po vonohet, Shoku Jusuf, sepse shokët tanë nuk po gjëjnë kontakt me Lëvizjen tuaj. Te Metush Krasniqi kanë shkuar shokët, meqë ua pata dërguar informatën që morëm nga ti, por ai nuk ka pranuar të jetë udhëheqës i organizatës suaj, bile ka thënë se me Rrobaqepësin, siç e quante ai Shokun Sabit, nuk dëshiron të ketë kurrfarë pune e lidhje. Për këtë shkak po ndodh vonesa dhe do të lutesha të kontaktosh Shokun Sabit që të na e mundësojë ndonjë kontakt

të ri në Kosovë.

Jusufi u befasua nga sqarimi i Kadriut dhe nuk i erdhi mirë përse foli në mënyrë aq konkrete në prani të Miranit, pasi ai i kishte thënë disa herë se Sabiti nuk po i duket gjekundi organizata e tij në Kosovë.

– Shoku Kadri, nuk bërë mirë që përmende emra konkretë në Kosovë, – iu drejtua Jusufi.

– Pak më parë the se nga Mirani nuk kemi asgjë të fshehtë dhe unë u ndjeva i detyruar të shpjegoj për vonesën që po ndodh në Kosovë, – u përgjigj Kadriu.

– Nuk e kisha për arsye të pranisë së Miranit, – filloi të mbrohet Jusufi, – por jemi përcaktuar që në prani të të tretit të mos përmenden emra konkretë në Kosovë. Njësoj do të kisha reaguar edhe po të ishte i pranishëm Bardhi.

– Të kuptoj, – miratoi Kadriu.

– Atëherë po shëtisim ca që të na lëviz gjaku më mirë, – iu drejtua Jusufi Kadriut.

– M'f falni ca minuta edhe mua! – i luti Mirani.

– Urdhëro, se nuk pate lënë gjë mëngut, – iu përgjigj Kadriu në të qeshur.

– Në ilegalitet të thellë dhe për shkak të konspiracionit, ndonjëherë edhe naiv, vështirë gjenden lidhjet. Pastaj, sikur hetoj një dukuri që ka të bëjë me pozimet tuaja, sikur keni kushedi çfarë organizime të shtrira dhe të fuqishme. Tani jemi të vonuar dhe po dëshmojmë parashikimet që patëm bërë në kryeartikull të *Bashkimit*. Bile Jusufi pat shtuar një citat të Leninit, që dikur e urrente për shkak të përkatësisë së tij sllave, se kur ndodhin shpërthimet, është e pamundur të organizohet forca udhëheqëse. Ajo duhet të jetë e formuar para shpërthimeve. Me këtë nuk desha të them se Jusufi ta ka kaluar ty, Kadri, me leninizëm. Desha të them që të mos stërzgjateni me bisedime në Kosovë, pasi sikur vjen erë e garës se kush duhet të ketë primatin në organizim të ri. Me rëndësi është që

të bëhet riorganizimi midis atyre që njihen dhe jo të vonohet duke prit-
ur gjetjen e lidhje me organizime që nuk mund të gjenden. Dhe, nëse
në Kosovë do të vonohen, e do të vonohen për shkak të arrestimeve e
përndjekjeve të mëdha, atëherë ne duhet të mendojmë konkretisht për
organizimin tonë në mërgatë, sepse kështu nuk mund të avancojmë gjë.
Bisedimet për bashkim, në parim, i kemi bërë duke marrë për bazë *Tezat*
e Frontit që na i ofrova ti.

– Si nuk e paske harruar qëndrimin tim për Leninin? – pyeti Jusufi,
duke shprehur pakënaqësinë pse Mirani po e thoshte këtë në prani të
Kadriut. – Vërtet unë isha vetëm enverist dhe nuk doja Lenin e Stalin,
meqë ishin sllavë. Por, për Stalinin më tregoi Mirani, se nuk ishte sllav,
por se ishte bërë më rus se sa Lenini, duke bërë krahasim me shqip-
folësit tanë të tipit të Sinan Hasanit, që mundohen të bëhen më jugosllav
se vetë Titoja. Ndërsa sa i përket mendimit tjetër, edhe unë përkrah atë
që shprehu Mirani. Edhe përpara, Shoku Kadri, të kam thënë që mbështete
platformën politike të shtruar në kryeartikull të *Bashkimit*, jo për
faktin se e kam redaktuar vetë dhe kam shtuar edhe unë ndonjë gjë, por
se më pat pëlqyer, prandaj u dakordova që ta botonim. Edhe *Tezat* tuaja
i pata vlerësuar se ishin të bazuara në atë kryeartikull, prandaj nuk patëm
vështirësi të mirëkuptohemi kur e diskutuam platformën që duhet të
ketë organizata që do të dalë nga bashkimi ynë.

– Mirë, a jeni dakord që të presim edhe ca ditë se çfarë përgjigje po
na japin shokët nga Kosova dhe pastaj të përfundojmë bisedat tona.
Nëse jeni të pajtimit, mendoj që të bëjmë parapërgatitjet, meqë nuk
mund të flasim spontanisht, si tani Mirani, edhe pse jam dakord me ato
që tha.

Pasi kreu propozimin Kadriu, Mirani u ngrit për të shëtitur. Pas tij
bënë të ngrihen edhe Jusufi e Kadriu. Mirani mori vrapin për te fëmijët
e Jusufit, të cilët po loznin e po mblidhnin lule.

17.

Në fundjavën e tretë të gushtit Kadriu i telefonoi Miranit për ta njoftuar se do të takoheshin të shtunën të Jusufi. Kur Mirani arriti të shtëpia e Jusufit, aty gjeti Kadriun. Tani po e radhisnin tekstin e platformës finale për bashkim me Jusufin. Në fund Jusufi shtypi tri kopje që ta kishin secili nga një gjatë diskutimit. Të gjithë ndiheshin të gëzuar se më në fund po bëhej diç konkrete për bashkim. Kadriu informoi se bisedimet për bashkim në Kosovë nuk kishin mund të përfundonin me bashkim, pasi këtë e kishte penguar burgosja e drejtuesve të OMLK-së dhe burgosjet e anëtarëve të organizimeve të tjera. Ai informoi Jusufin e Miranin se OMLK-ja e kishte autorizuar atë për të vazhduar bisedat në emigracion. Jusufi shfaqti qëndrimin se Lëvizja do të përfaqësohet nga Shoku Sabit dhe vetë ai. Mirani përsëriti qëndrimin se Fronti ka ngrirë organizimin dhe është dakord me vendimet që do të marrin përfaqësuesit e këtyre dy organizimeve.

Meqë *Tezat* ishin identike me idenë e shtruar në kryeartikull të *Bashkimit*, ato u miratuan si të tilla, duke mbetur hapur për të vendosur për përcaktimin politik të kërkesës Kosova–Republikë, vetëm për KSA të Kosovës apo me të gjitha viset shqiptare në Jugosllavi. Kadriu konkretizoi mendimet e tij:

– Kërkesa e deritanishme kombëtare për çlirim të Kosovës me të gjitha viset etnike shqiptare nën Jugosllavi dhe bashkimi i tyre me Republikën e Shqipërisë, tashmë vetvetiu është rrudhur në kërkesën *Kosova-Republikë!* Edhe përcaktimet ideore e politike nga ekstremi i majtë deri tek ekstremi i djathtë, tashmë kanë një karakter formal. Të gjitha organizimet janë përcaktuar vetëm për barazi nacionale në Jugosllavi, duke respektuar rendin kushtetues të saj. Kështu është e formuluar edhe në *Teza të Frontit*. Se si ndodhi ky transformim askush nuk po e shpjegon saktësisht. Mendohet se këtë tëkurrje e bëri populli, i cili në demonstrata të marsit e prillit doli vetëm me kërkesën *Kosova–Republikë*.

– Kjo, – shfaq mendimin Jusufi, – nuk mund të qëndrojë, sepse popullit nuk i ishte lejuar të bëjë referendum. Ky arsyetim vjen nga një praktikë, se populli i bën edhe ato që nuk i bën, sepse nuk mundet, ose nuk është i vetëdijshëm për t'i bërë. Po të ishte e vërtetë se kështu ka vendosur populli, atëherë organizimet e fshehta e të hapura, ilegale e legale, siç po praktikohen të quhen gabimisht në fjalorin e përditshmërisë, del se populli po i udhëheq edhe këto subjekte. Ndërsa këto subjekte nuk kanë si ta pranonojnë se po i udhëheq populli. Kjo do të ishte e ngjashme, sikur orkestra të dirigjonte dirigjentin. Prandaj, them se këto zhvillime na dalin si të ngatërruara.

– Po përpiqem të vazhdoj mendimet e Jusufit, – e mori fjalën Mirani. – Beogradi po dezinformon se shërbimet e fshehta po i organizojnë demonstratat e trazirat kundërrevolucionare dhe po i kanalizojnë kërkesat politike në Kosovë. Këto shërbime na qenkan sovjetike dhe shqiptare. Kjo u duhej pushtetarëve të Beogradit për të manipuluar opinionin dhe perëndimorët, duke synuar të paktën neutralizimin e tyre. Shërbimet sovjetike nuk kishin interes të nxisnin trazira në Kosovë, sepse kështu do të nxisnin importin e tyre në shtetet socialiste të Paktit të Varshavës, duke u treguar popujve se është e mundur të demonstrohet edhe nën këto diktatura moniste. Shërbimet e Republikës së Shqipërisë gjithashtu nuk kanë interes ideo-politik, edhe pse do të duhej të kishin interes kombëtar. Por intersi kombëtar për këtë diktaturë të proletariatit, siç po quhet zyrtarisht në Tiranë, është shndërruar në interes internacionalist. Udhëheqësit në Tiranë i ka përfshirë deliri i madhështisë së të qenit i vetmi vend socialist në botë. Këtë e dëshmon edhe fakti se ata po ndihmojnë financiarisht partitë komuniste në disa vende perëndimore, në Azi, në Amerikë Latine e në Afrikë. Ato parti po thonë, se Republika e Shqipërisë është i vetmi shtet socialist dhe udhëheqësi i këtij shteti, Enver Hoxha, është i vetmi klasik i gjallë i marksizëm-leninizmit. Kz pushtet nuk po ndihmojnë fare, të paktën financiarisht, organizimet

tonë në Kosovë dhe as në emigracionin shqiptar.

Sa i përket tkurrjes së kërkesave të mëparme kombëtare, në kërkesë për republikë e barazi nacionale, sipas asaj që di unë, rol kryesor ka luajtur grupi i studentëve që organizuan protestën e 25 Marsit në oborr të konvikteve të studentëve. Ata, me atë rast, për herë të parë, kanë paraqitur kërkesën për statut të republikës. Kjo kërkesë u përqaftua nga revolta masive e 1 dhe 2 prillit në Prishtinë. Në atë protestë, hipur në bli, para Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste, mbajti fjalim historik lideri i OMLK-së, duke potencuar edhe një herë kërkesën për statut të republikës për Kosovën dhe për barazi nacionale në kuadër të Jugosllavisë.

Kaq desha të them për momentin.

Kadriut i shndriti nuri, kur dëgjoi këtë vlerësim të Miranit, sidomos kur dëgjoi t'i përmendej udhëheqësi dhe shoku i tij, që dikur ia kishte kritikuar.

– Sipas mendimit të Miranit, – mori fjalën Jusufi, – nga grupi i paorganizuar i studentëve e paskemi tëkurrjen e kërkesave kombëtare në kërkesë për statut të Republikës për Kosovën. Kjo do të thotë se nuk qenka inicuar nga organizatat tona, aq më pak nga Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi (PKMLSHJ), udhëheqësi i së cilës është identifikuar një oficer i UDB-së në Prishtinë. Ata po rrahin gjoks se partia e tyre i ka organizuar demonstratat dhe ka orientuar kërkesat politike.

– Për të vërtetuar konstatimin tim, po ju sjell një dëshmi kokëfortë. Para dy javësh erdhi tek unë Abdullah Tahiri nga Malisheva e Gjilanit. Ai, pas daljes nga burgu i Gjilani, kishte ardhur te vëllai i tij në Berlin. Atje ai kishte lexuar gazetën *Bashkimi*. E kishte pyetur vëllanë nga e kishte dhe ai ia kishte dhënë adresën time. Prej andej Abdullahu vjen tek unë. Biseduam gjatë për ngjarjet, për gjendjen dhe për kërkesat. Meqë m'u duk interesant informimi i tij, e luta t'i shkruante, me arsytim, se nuk do t'i mbaja të gjitha në mend. Shkroi rreth 22 fletë të formatit A4.

M'u lut që ato shënime t'i mbaja hë për hë të fshehta dhe t'i publikoja kur do të më dukej e arsyeshme, sepse tani mund të dëmtohen shokët gjatë proceseve gjyqësore. Meqë ato shënime nuk i kam me vete, po mundohem t'i përmbledh siç i kam në kujtesë:

“Në mbrëmje të 11 marsit, ditë e merkurë, isha në mensë të studentëve. Rreshti ishte tepër i gjatë dhe m'u desh të pres të paktën gjysmë ore derisa të vija te pjata e fasules. Kur mora pjatën, m'u neverit pamja e saj. Futa gishtin në pjatë. Ishte krejtësisht e ftohtë. U revoltova dhe u bërtita me zë të lartë kuzhinierëve: Po na trajtoni si kafshë! Me atë rast përplasa pjatën për dysHEME, hipa mbi një tavolinë dhe thirra me sa zë që kisha: “Të dalim të protestojmë kundër trajtimit të keq që po na bëhet!” Të gjithë studentët mezi kishin pritur këtë thirrje, sepse të gjithë ishin të pakënaqur. Shpërthyen brohoritjet. Në mensë duhet të kenë qenë të paktën pesëqindë studentë. Ata nuk më lanë të flas më gjatë: “Urra – në protestë!” – thërrisnin. Po ndrydhnim njëri-tjetrin duke nxituar përjashta, në protestë. U nisëm drejtë qytetit. Erdhëm deri te përplasja me polici. Aty më ka ra në sy studenti Ali Lajçi, se si po kacafytej trimërisht me policë. E mbajta mend se kishte mjekër.

Të hënën, më 23 mars, rreth orës 15.00, isha duke luajtur top me ca kolegë në parkingun para barkës nr. 2, e cila është e para afër mensës, në lagjen ku janë konviktetët e barakat e studentëve. Në hyrje të barakës dy policë me rroba civile po tentonin ta arrestonin Ali Lajçin, i cili në ato memento donte të hynte në barakë. Aliu nuk po pranonte të shkonte me ta. Meqë e njoha, u thashë kolegëve: “Po duan ta arrestojnë Ali Lajçin, prandaj t'i përzmë ata qena.” Shkuam dhe i rrethuam. Policët shkuan duke e kërcënuar Aliun se do ta arrestonin herën tjetër. Duke parë rrezikun Aliu na u lut ta shoqëronim deri në konviktitin nr. 3, me shpjegim se atje kishte një shok. E shoqëruam dhe hymë në dhomë të Sylë Mujës. Në atë dhomë u grumbulluan edhe disa studentë të tjerë, ndër ta edhe Bajram Kosumi. Ia shtruam çajit. Nuk më kujtohet kush propo-

zoi që të organizonim protestë për ditën e nesërme. Ishim shumë studentë në dhomë të vogël. Vendosëm të shkruanim një letër me kërkesat tona. Me atë rast, pos kërkesave sociale për kushte më të mira për studentë, bëmë edhe kërkesën *Kosova-Republike*. Ndamë rrolet se kush në cilin konvikt duhej të shkonte që t'i bindnim studentët të dalin në mëngjes në oborr të konvikteve. Mua më ra t'i informoj studentet në konvikt të femrave, meqë aty kisha shumë shoqe. Në mëngjes u tubuam, fillimisht qindra veta, por nga minuta në minutë numri rritej. Erdhi Azem Vllasi me funksionarë të tjerë për të biseduar, sepse kishin frikë se mos po u prishej manifestimi i pritjes së Stafetës. Me gjasë donin të përfitonin në kohë që policia t'i rrethonte konviktët. Nuk donin të na lejonin të dilnim në protestë rrugëve. Gjatë bisedimeve Aliu nxori letrën që kishim hartuar dhe e lexoi. Azemi na akuzoi se po i shndërronim kërkesat sociale në kërkesa politike dhe kjo do të na dalë me rrezik. Aliu këmbënguli: "Këto janë kërkesat tona. Bisedat po acaroheshin. Një student u duk sikur po luante rolin e truprojes së Azem Vllasit, emrin ia thanë Xhafer Halimaj. Disa studentë të tjerë dyshuan dhe e rrahen. Ishte incidenti i parë që po ndodhte aty. Pastaj shkuan funksionarët, sepse u frikësuan se mos po i mbanim peng ose mos po i rrahnim edhe ata. Të pakënaqur nga bisedimet, u bë thirrja të nisemi drejt Fakultetit Filozofik dhe prej andej drejt Qendrës. Rrethimi policor ndërkohë ishte konsoliduar. Filluan përleshjet. Na erdhën në ndihmë punëtorët e Kombinatit Ndërtimor *Ramiz Sadiku*, të cilët u gjenden aty duke ndërtuar një konvikt të ri. Policisë së Kosovës i erdhën në ndihmë edhe forcat speciale nga Serbia. U bë masakër e madhe mbi protestues. Studentët iknin nga sheshi i konvikteve brenda në konvikte. Para hyrjes së konviktit nr. 1 kam parë një trimëri e shkathësi të rrallë. Karateisti Haki Ibërdemaj kishte bllokuar derën e këtij konvikti. E njihja dhe e adhuroja, sepse ishte kampion. Ai ringjalli Bruce Lee që e kishim parë në filma. Cilido polic që ia mësyente hyrjes, ai e shtrinte për tokë. U bënë dhjetëra policë që

shpurdhnin të plandosur në tokë. Dëgjova njërin të jepte urdhrin që ta vrisnin. U shashtisa dhe thirra: “Ik Haki se u dha urdhri për të të vrarë!”. Ai hyri në konvikt, theu derën e dhomës përballë dhe doli për dritare në anën e prapme. Sa më pat dhënë zemër që të godas edhe unë në fuqinë time dhe në fund arrita të iki. Në mbrëmje ikën nga lagjia e konvikteve të gjithë studentët, duke shkuar secili në rrethin e tij. Kështu u përhap gojarisht lajmi në gjithë Kosovën për masakrat dhe për kërkesën *Kosova-Republikë*. Secili student u thoshte fshatarëve e qytetarëve që të ishin në gjendje gatishmërie se do të plaste kryengritja.

Se si plasën protestat masive me 1 e 2 prill nuk e di, pasi unë isha vetëm një pjesëmarrës. Isha para Komitetit Krahinor. Pashë kur hipi Hydajet Hyseni në bli. Ai me megafon përsëriti kërkesat që kishim bërë më 25 mars.

Pastaj na arrestuan të gjithëve që kishim qenë në dhomë të Syle Mujës. Mua më merrte në pyetje Ali Vllasi, vëllai i Azemit. Kisha përshtypjen se i kishte marrë vesh të gjitha. Më tha të tregoj siç kishte ndodhur, me premtimin se do të më lironte nga burgu. Unë i tregova dhe ai mbajti fjalën e më liroi.”

Ja, ky është rrëfimi i përmbledhur i Avdullahut. Edhe pse nuk na hyn në punë në këtë bisedë, po shtoj se i pata thënë: “I paske tradhtuar shoqët”. Ai që hidhëruar. U arsyetua se policia i dinte të gjitha. E sqarova, se ashtu i duket të burgosurit që merret në pyetje, por dëshminë kundër të tjerëve e kanë kompletuar me protokollin që ke nënshkruar. Qe prekur e hidhëruar shumë. Për ta qetësuar pak, i thashë se atë e kishte bërë në mënyrë të pavetëdijshme.

– Informim shumë interesant e domethënës, – mor fjalën Kadriu. – Studentin Abdullah Tahiri e njoh, më kanë folur mirë për të, por kanë thënë se është patriotë që eksponohet. Kushëriri i tij është burgosur dhe po akuzohet si pjesëtarë i organizatës sonë.

– Interessant është fakti, se asnjëri nga studentët që ishte atë ditë e atë natë në dhomë të Sylë Mujës, nuk duhet të ketë qenë anëtar në ndonjë organizatë tonën të fshehtë, – plotësoi Mirani. – Këtë përshtypje krijova nga bisedat me Abdullahun. Dhe, prandaj mendoj, nuk ka përse rrah gjoks akcili, se është ideator i kërkesës *Kosova-Republikë* dhe nuk kemi pse të spekulojmë se këtë kërkesë e lansoi populli ose sigurimet e fshehta. Tubimi në dhomë të Sylë Mujës ishte i rastësishëm, sipas dëshmitarit që e citova.

– Megjithatë, – mori fjalën Jusufi, – unë mendoj se tani *Tezat* i kemi, duhet t'i diskutojmë seriozisht. Ne tani jemi të autorizuar për ta konkretizuar bashkimin e organizatave tona.

– Mos ta fryjmë misionin që kemi, sepse do ta kemi më të vështirë për t'i dalë zot, – mori fjalën Kadriu. – Duhet të ruhem nga kapërdisja në delirë madhështie. Gjërat janë të thjeshta: T'i miratojmë apo jo *Tezat*? Nëse ndonjëri është për ndryshim të ndonjë pike, le të propozojë, ta diskutojmë dhe në fund t'i miratojmë.

– Unë mendoj që në kuadër të Republikës së Kosovës të përfshihen të gjitha territoret tona etnike nën Jugosllavi, – u shpreh Jusufi.

– Argumentimi? – pyeti Kadriu.

– Mund të jetë më pragmatike ashtu siç e keni menduar ju të *OMLK-së*, por nuk duhet harruar maksimën se duhet kërkuar më shumë për të marrë të mundshmen, – argumentoi Jusufi. – Pastaj, kështu si propozoj unë, Fronti për Republikë të Kosovës nuk mund të akuzohet për separatizëm, pasi nuk po kërkojmë që kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë të ndryshohen.

– Këto argumentime qëndrojnë, por unë jam për variantin e formuluar në *Teza*, – u shpreh Kadriu.

– Sigurisht, ti nuk mendon ndryshe, sepse ju keni organizim hiarkik dhe disiplinë aq strikte, sa nuk guxonit ta vini në dyshim atë që ka formuluar udhëheqja, – iu kundërvu Mirani. – Edhe ti, Zeqë, do të duhej

të argumentosh, se përse je për të mbetur ashtu, nëse ke argument tjetër pos faktit që kështu ka vendosur udhëheqja e *OMLK-së*.

– Miran, të këshilloj të ruash nivelin e seriozitetit! – e qortoi Jusufi.

– Më fal, por meqë kërkoi nga ti argumentin, – iu drejtua Mirani Jusufit, – duhet edhe Shoku Zeqë ta argumentojë. Sa për mua, propozimi i Jusufit më duket më i dëshiruar, kurse propozimi në *Teza* më i mundshëm. Cilindo variant që ta vendosim nuk gabojmë. Më vonë mund të bëjmë ndryshime, varësisht nga rrjedhat. Tani nuk po miratojmë kuran për të mos guxuar ta ndryshojmë më. Pastaj kjo kërkesë nuk ishte jona, na u imponua, por jo nga populli siç e madhërojnë dogmatët e sektarët. As nga shërbimet, siç dezinformon Beogradi. Tani duhet ta pranojmë si të tillë, them unë.

– Edhe pse paraqitesh ahmak, ndonjëherë, për të mos thënë shpesh herë, ia qëllon, – miratoi Jusufi. – Unë po tërhiqem nga propozimi im dhe le të mbetet siç është, me kusht që për variantin përfundimtar do të vendosë Shoku Sabit..

– Më lejo të bëhem edhe një herë ahmak dhe të të qortoj se nuk ke përse bie në këtë nivel, – ndërhyri Mirani, duke mos e përmbajtur neverinë që kishte krijuar për Sabitin. – Lëre Rrobaqepsin ta vazhdojë jetën e tij prej anadollaku, sepse ai nuk kupton gjë nga këto që janë të shkruara këtu, pos nëse ti do ta këshillosh. Vazhdoj të të mos të kuptoj, – iu drejtua Jusufit, – si nuk po mund të lirohesh nga Sabiti, i cili nuk t'u paraqit gati një vit e gjysmë dhe tani që t'u ka lajmëruar, do ta lejosh të të udhëheqë, gjë që nuk e meriton. A nuk të mjaftoj argumenti që solli Kadriu se Metush Krasniqi nuk është fare në organizatën tuaj, e lëre më udhëheqës kryesor, siç të ka mashtruar udhëheqësi yt. Bile, tashmë mund të supozohet se ai e ka sajuar këtë organizatë, ta zëmë i shtyer nga ndjenja e tij patriotike, por meqë është i kompleksuar pse nuk është më i zgjuar se një rrobaqepës, ka mashtruar se atë e drejtojnë themelues të tjerë meritore. Dhe tani nuk kemi pse ta respektojmë si sulltan, le ta lëmë

si anadollak, meqë ashtu është duke i pëlqyer, që kur ka emigruar atje dhe atje tamam e ka gjetur veten. Propozoj që sot e këtu ta bëjmë bashkimin...

– E di çka, të lejoj të bëhesh ahmak, por edhe ahmaku duhet t'i dijë kufijtë e tolerancës, – e ndërpreu Jusufi i hidhëruar ndaj Miranit. – Që sa herë jam duke t'u hidhëruar për shkak të zhvlerësimit ofendues që po i bën ti Shokut Sabit dhe që sa herë ta kam tërhequr vërejtjen që të mos e përflasësh kaq ofendueshëm, por ti prapë nuk durohesh pa folur dhe pa shprehur edhe insinuata kundër tij.

– Sepse po më vjenë keq, që ai injorant të luajë me intelektualizmin tënd, për të cilin kam shumë respekt. Pastaj nuk po dëshiroj ta presim miratimin e tij për bashkim...

– Këtë gajle nuk ke pse e mban ti, – ndërhyri preras Bardhi.

– Ti Bardh mos u përzi në këtë bisedë, shko na sill diç të pimë, po dëshel! – iu drejtua Jusufi.

– Do t'ju lutësja ta ndërprisni këtë bisedë dhe t'i kthehemi çështjes për të cilën jemi mbledhur, – propozoi Kadriu, duke parë se zënka mund të marrë përmasa hidhërimi e prishjeje.

– Mos u shqetëso, Shoku Kadri, – iu drejtua Jusufi, – me Miranin e kemi pa teklif dhe pa tarifë. Sa herë i jam hidhëruar, por nuk mundem pa të, sepse e dua si ta kisha vëlla. Këtë ka të mirë, çfarë mendon, ta thotë, pastaj nuk përflet pas shpine, por respekton vendimet që marrim. Kurse sa për *Tezat*, jam dakord me këtë përmbajtje që kemi në duar, por këmbëngul që miratimin përfundimtar ta japë Shoku Sabit, edhe për shkak se është veteran i veprimtarisë së organizuar patriotike.

– Atëherë, meqë dashke të na marrësh në qafë, që bashkimi të varët nga Zotëri Katunriu, edhe unë po miratoj propozimin e Jusufit, – u shpreh Mirani.

– Mirë, edhe unë po e miratoj propozimin tuaj, – u prononcua gëzueshëm Kadriu.

Të katërt u ngritën në këmbë, ia dhanë dorën njëri-tjetrit duke u përçafuar e duke uruar për mirëkuptimin që u arrit, të bindur se ishte arritur edhe bashkimi, por që duhej bërë një takim formal me Sabitin. Pastaj vazhduan me shaka e të qeshura, si të mos kishte ndodhur asnjë bisedë tepër serioze, me rëndësi të madhe, por herë-herë edhe e tensionuar. U morën vesh që në tetor mund të shkojnë në Turqi, pasi shpresonin që deri atëherë organet gjermane do t'i lëshonin dokumentin e udhëtimit Jusufit. Kurse Mirani nuk duhej të shkonte, sepse mund të prishte punë, meqë Sabitin e urrente, edhe pse nuk e njihnte.

18.

Në tetor për në Turqi udhëtuan Kadriu e Bardhi, pasi Jusufit ende nuk iu lëshua dokumenti i udhëtimit. Atje takohen me Sabitin në prani të një diplomati të Republikës së Shqipërisë me origjinë nga Kosova. Madje hiç më pak se djali i Hoxhë Kadrisë, Bujari. Takimi zgjat vetëm disa minuta. Rezultati: prishje.

Jusufi urdhërohet menjëherë nga Sabiti të fillojë botimin e organit të Lëvizjes. Edhe emrin e organit *Zëri i Kosovës* e zgjodhi Jusufi. Ai kishte dëgjuar se në fillim të viteve të 80-ta, Grupi Revolucionar në Kosovë kishte botuar organin e tij me po këtë emër, prandaj e parapëlqeu këtë emërtim.

Numrin e parë Jusufi e botoi në nëntor, të dytin në dhjetor. Në numrin e parë Jusufi shkroi se bashkimi nuk u arrit për faj të Kadriut, pa ia përmendur emrin. Aty shprehet dëshpërim kundër Kadriut, pa qenë në gjendje të gjykojë se fajtori i vërtetë ishte komanduesi i tij, Sabiti.

Jusufi dhe Kadriu fillojnë anëtarësimin. Jusufi anëtarësonte në Lëvizje, ndërsa Kadriu në Frontin për Republikën e Kosovës. Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, por Mirani nuk pranoi me arsyetimin se dëshironte të priste edhe ca, pasi bisedimet duhet të rindodhnin shpejt dhe ato do të sillnin bashkimin. Kurse Jusufi nuk ia bëri Miranit asnjë

propozim, meqë ishte dezinformuar nga Nuriu se gjoja Miranin e kishte futur nën tutelë të tij Kadriu dhe po e manipulonte, duke e dezinformuar edhe për takimin në Turqi.

Edhe Kadriu botoi një numër të organit *Liria*. Por, cilësia e tij grafike ishte ku e ku më poshtë se sa dy numrat që i kishte përgatitur bashkë me Jusufin. Kurse *Zëri i Kosovës* kishte nivel më të lartë grafik, pasi Jusufi ishte usta. Të gjithë u angazhuan për shpërndarje të *Lirisë* dhe të *Zërit të Kosovës*, edhe pse gojëkëqinjte dhe përçarësit, përgojonin e dezinformonin se gjoja Kadriu e Mirani po sabotonin shpërndarjen e *Zërit të Kosovës*.

Festën e Pavarësisë kombëtare do ta festojnë të gjithë së bashku në Eslingen të Gjermanisë. Fjalime mbajtën Jusufi dhe Kadriu. Edhe në podium ishin së bashku Jusufi dhe Kadriu. Bashkatdhetarët, përgjithësisht, flisnin për bashkimin, e kërkonin atë, madje tashmë mbi platformën e *Frontit për Republikën e Kosovës*, që po e quanin *Program të Frontit*. Ata e dinin se *Tezat* ishin miratuar qysh në gusht dhe tashmë ishin program politik. Shumëzimi dhe shpërndarja e platformës së *Frontit* kishte nisur qysh në gusht dhe po shpërndahej me të madhe edhe duke u rikopjuar nga ata që u binte në dorë.

KAPITULLI VI

Viti i Ri 1982 do t'i gjejë të gëzuar Jusufin, Kadriun, Bardhin, Miranin dhe shumë të tjerë. Kadriun sepse ishte bashkuar me Bulen. Të tjerët sepse po u martohesh bashkëveprimtari dhe ishin ftuar në dasmën e tyre që do ta bënin, më 2 janar në Zvicër. Por, gëzimi i Jusufit kufizohet pothuajse vetëm në faktin se një shqiptar, i njohur i tij, po martohesh, ndërsa ishte në dilemë nëse do të merrte pjesë në dasmë. Më në fund gjykoj se duhet të merrte pjesë, më shumë për hatër të dasmorëve që ishin kryesisht aktivistë të të njëjtave radhë. Ata dëshironin t'i shihnin udhëheqësit e tyre të bashkuar. Sa për Kadriun, Jusufi nuk do të merrte pjesë. Me të ishte hidhëruar që nga tetori.

Miqtë zviceranë, për dasmë kishin rezervuar një shtëpi në male, sipër qytetit, i cili gjermanisht quhet Biel (Bil), ndërsa frëngjisht Bienne (Bien), meqë është qytet dygjuhësh. Në njëren anë, atë jugore, ai kufizohet me liqenin ku në sfond ka bjeshkë të larta, të veshura pjesërisht me pisha. Në brendësi të këtyre maleve, sipër qytetit, është shtëpia, pronë e Bashkisë së qytetit që shfrytëzohet për manifestime të qytetarëve.

Dasmorët vinin nga metropole të ndryshme evropiane. Kadriu ishte kujdesur të thërriste dy a tre veta nga secili metropol ku kishte shqiptarë të angazhuar për veprimtari çlirimtare. Vetëm nga Dyzeldorf ai kishte ftuar më së shumti, gjashtë veta, me Miranin shtatë.

Në dasmë erdhi edhe Jusufi, meqë në dhjetor organet gjermane, më në fund, ia njohën statusin e të strehuarit politik, duke i dhënë edhe dokument udhëtimi.

Shtëpia ishte nga ato malore, përdhese e modeste, që kur ishte ndërtonuar që menduar si shtëpi gjuetarësh. Mali dhe livadhet përreth saj ishin

të mbuluara me borë, mbi gjysmë metri trashësi, duke i shtuar një madhësi të bardhë kësaj dasme. Dasmorët vinin njëri pas tjetrit. Ata takoheshin në stacion të trenit në qytet (Kadriu për shkaqe sigurie nuk i kishte njoftuar për vendmbajtjen e dasmës). Prej atje dasmorët transportoheshin nga individë të caktuar.

Dasma po fillonte. Pas përshëndetjeve të ngrohta të dasmorëve me çiftin dhe midis tyre filloi kënga, vallëzimi dhe gëzimi. Mirani, që nuk ishte merakosur fare të vishej siç vishen dasmorët, kishte ardhur me xhinse të vjetëruara, flokë të gjata e kaçurela. Ai po i nxiste dasmorët për të qeshur me shakatë e tij, herë me e herë pa kripë. Vetëm Jusufi rrinte serioz, i vetëpërmbytur ulur në qoshën e poshtme të sallës për të mos rënë në sy. Bardhi, ndërkaq, po mudohej të integrohej në këtë atmosferë gëzimi. Duke parë Jusufin në këtë gjendje Mirani iu afrua.

– Shoku Jusuf, nuk të ka hije të rrih kaq i ngrysur, kur të gjithë dasmorët janë të angazhuar në argëtim. Nëse e ke inatin e sajuar nga shpifjet e dezinformatat, se Kadriu dhe unë kemi sabotuar shpërndarjen e *Zërit të Kosovës*, siç kam dëgjuar, atëherë këtu janë shumë aktivistë dhe mund t'i pyesësh vetë se cila është e vërteta.

Jusufi e shikoi ngultas Miranin sikur desh t'i thoshte: “Or ti, hiçmu qafe se kam ardhur vetëm sa për të bërë radhën!”. Por Mirani ia kishte vënë melhemin mbi plagë, meqë vërtet shpifjet dhe dezinformatat e kishin hidhëruar më shumë se dështimi i bisedës për bashkim, siç e vlerësonte ai. Pasi u mendua pakëz, ia ktheu:

– Vërtet janë në gjendje këta aktivistë të dëshmojnë se ju nuk e keni sabotuar shpërndarjen e *Zërit*?

– Sigurisht, thirr cilët të duash dhe pyeti vetël – tha Mirani me një zë që përmbante siguri të plotë. Ai ishte i sigurt se, jo vetëm që nuk e kishte sabotuar shpërndarjen e *Zërit*, por as që e kishte komentuar me ndonjërin shkakun e dështimit të takimit për bashkim.

Mirani nuk mund ta fshihte hidhërimin ndaj Jusufit se përse po u

besonte shpifësve e dezinformuesve për të e për Kadriun. Njëherazi po mendonte me vete: “Sa ashpër i flas Jusufit ndonjëherë dhe ky nuk më hidhërohet, ose më hidhërohet për pak kohë, derisa të sqarohemi. Për asgjë nuk i jam rezervuar dhe nuk do t’i rezervohesha as tani për t’i thënë se nuk do ta shpërndaja *Zërin e Kosovës* për këtë ose për atë arsye, po të ma thoshte truri. Kisha parandjenjë se Rrobaqepësi anadollak po e manipulonte Jusufin. Ai edhe në Kosovë e kishte shpërdorur ilegalitetin dhe konspiracionin që t’i imponohej këtij. Pastaj, mos vallë Jusufin po e shtynte të dyshonte se ne po e sabotojmë veprimtarinë e tij, meqë ai në numrin e parë të *Zërit të Kosovës* ka shkruar rrebtë kundër Kadriut!? Jo more, atë shkrim mund ta kishte bërë vetë Rrobaqepësi gjysmanalfabet dhe t’ia kishte redaktuar Jusufi...!”

– Më dëgjo me kujdes! Më është thënë se pos sabotimit gjatë shpërndarjes, ju po organizoni të kërkohen edhe ekzemplarë të tjerë të *Zërit*, që t’i hidhni pastaj në plehëra dhe kështu të mbarohen sa më shpejt, që ne të na mbesin sa më pak për t’i shpërndarë vetë, – ia ndërpreu Jusufi fillin mendimeve.

– Të kanë gënjyer vetë plehërat që po hedhin mish dhie midis. Disa nga gënjeshtarët po i shoh këtu dhe tani do të mund t’i ballafaqojmë me aktivistë patriotë, të angazhuar e të sinqertë. Kë dëshiron ta pyesësh nga aktivistët e Klubit *Emin Duraku*? Unë do të qëndroj pranë për të dëgjuar ose edhe mund të largohem, nëse dyshon se prania ime do t’i detyrojë ata të mos e thonë të vërtetën.

– Them të vij në pa rënë në sy vetëm Shoku Hajzer, Baca Avni e Baca Zymri, tha tjetri.

Mirani dërgoi Maksin t’i thërriste ata, me arsyetim se Jusufi donte t’i përshëndetste. Ata ishin vetëm disa metra larg dhe u habiten se përse Jusufi nuk po shkonte të ulej pranë tyre, meqë Baca Zymri dhe Baca Avni ishin më të moshuarit. Ata nderoheshin nga të gjithë, sado kohëve të fundit po dyshonin ndaj tyre se nuk ishin edhe aq sa ta meritonin

gjithë atë nderim. Në këtë rol atyre u ishte rritur mendja. Mirani nuk u ndie dhe aq mirë kur Jusufi propozoi bacallarët Avni e Zymri, sepse ndaj tyre kishte dyshimin se janë vetë dezinformatorët. Muaj më parë, për shkak se këta dy pleq kishin ndryshuar sjelljet e tyre nga ato patriotike, të urta e burrërore, në ato përgojuese e përcarëse, ai i kishte *scanuar* për t'ua bërë vlerësim. Rezultati: Anxhellkoviqi, oficeri i UDB-së në Konsullatën jugosllave në Düsseldorf, në bashkëpunim me UDB-në në Kosovë, kishte zbuluar se këta dy pleq kishin vetëm nga një djalë dëshiri, një pikë e dobët e tyre. Sa herë që këta flisnin për djemtë e tyre, goja u jargavitej duke i lavdëruar e madhëruar. Sa vuanin këta të shkretë se djemtë e tyre po u rriteshin në Kosovë, kurse këta po kurbetonin larg tyre, me mallë të madh për të shijuar nga afër rritën e trashëgimtarëve të tyre. Meqë këto informata Anxhellkoviqi i kishte grumbulluar, kishte thirrur pleqtë Avni e Zymri, veç e veç në konsullatë për t'i shantazhuar se do t'ua vriste djemtë në Kosovë po nuk i shërbyen atij. Për të përforcuar këtë shantazh, UDB-ja në Kosovë i kishte arrestuar për pak kohë që të dy djemtë, pa ndonjë arsye konkrete vetëm sa për t'i frikësuar baballarët e tyre.

Mirani kishte besim në vlerësimin e tij përtej mase. Lidhur me këtë vlerësim intuitiv për Bacën Zymri, atij iu kujtua edhe vizita e djalit të tij para katër muajve. Kishte qenë i pranishëm kur Baca Zymri e kishte qortuar djalin, student i shkëlqyeshëm në fakultetin e mjekësisë në Prishtinë për pjesëmarrje në demonstrata. Djali ishte mbrojtur se ndjenjat patriotike e kishin shtyrë të dilte përkrah kolegëve studentë, se ato ndjenja ia kishte ngritur edhe babai duke i dërguar literaturë të ndaluar nga Gjermania, se arrestimi kishte qenë tepër formal, meqë nuk ishte zbuluar pjesëmarrja e tij në demonstrata, se nuk e dinte arsyen konkrete përsese e kishin arrestuar, por nuk e kishin keqtrajtuar. Baca Zymri prapë kishte vazhduar me qortim e këshilla: "Të kam djalë hasreti dhe krejt jetën time e kam të lidhur me jetën tënde". Kurse djali ishte mbrojtur:

“Sesecili djalë është i hasretit për vete, pasi sekush ka vetëm nga një shpirt”. Edhe Baca Avni e kishte komentuar arrestimin e djalit të tij të dëshirrit. Që nga ato momente ata po merreshin me përgojime, shpifje e dezinformata, por me kamuflim të përsosur, meqë që të dy kishin një dhunti natyrore për të folur rrjedhshëm. Zotëronin për mrekulli filozofinë dhe traditat popullore. Veprimtaria e tyre e ndryshuar sillte dëm sidomos në frikësim të anëtarëve të Klubit, duke i këshilluar ata që të tërhiqeshin se do ta pësonin siç e kishin pësuar dhjetëra të tjerë deri atëherë kur kishin shkuar për pushime në Kosovë. Edhe të tjerë aktivistë kishin hetuar pak a shumë ndryshimin e tyre. Por, Miranin tani po e qetësonte prania e Hajzerit, meqë ata nuk do të mund ta gënjenin Jusufin në prani të tij, siç mund ta kishin dezinformuar po të ishin veç e veç.

Sapo iu afruan Jusufit e përqaftuan, e pyetën për shëndetin, punën e hallet jetësore. Pastaj Jusufi qiti e tha:

– Ju lutem, më tregoni si është pritur *Zëri i Kosovës* në Klubin tuaj?

– Shumë mirë, – nisi të përgjigjej Hajzeri, – e kemi lexuar e diskutuar disa herë publikisht në Klub, meqë shumica e bashkatdhetarëve janë gjysmanalfabetë. E kemi shpërndarë në rrethe, duke ua dhënë anëtarëve vetëm nga dy-tre kopje, pasi nuk kishim mjaft ekzemplarë. Ju patëm kërkuar të tjerë po ju na dërguat vetëm njëqind. Kërkuam prapë po na u tha se kishin mbaruar.

– Domethënë askush nuk ju ka urdhëruar që të sabotohet shpërndarja, ose që *Zëri* të hidhet në mbeturinal?

– Si, si? – ndërhyri Baca Avni. – Të lutem, djali i Bacës, pasi ju kam si djem, mos na provokoni kaq rënd se boll kemi hidhërimet që po na i shkakton pushtuesi!

– Më falni, por dëshirova të sqarohem, pasi më... kanë thënë se në Klubin tuaj Mirani ka urdhëruar që të sabotohet shpërndarja e *Zërit*, – u përgjigj tjetri duke bërë një pauzë të vogël për të menduar nëse ishte momenti të shpërthente, por ruajti qetësinë. Nuriu i kishte thënë se

informatat për sabotim të Miranit i kishte të sigurta, meqë burim i tyre ishte Baca Avni e Baca Zymri.

– Mos e thëntë Zoti, Klubi ynë e ka shpërndarë atë me kënaqësi e përpikëmeri, – iu përgjigj Baca Zymri, i inspiruar nga dinakëria e Bacës Avni.

Natyrshëm, Jusufi ndërroi vend, pasi mbaroi bisedën, që t'i lironte ata të shkonin prapë në vendet e tyre në krye të sallës. Se si ndjeu një keqardhje për bacallarët, por nuk i rrihej më gjatë ulur pranë tyre. Mirani e pyeti:

– Kë tjetër dëshiron ta pyesësh?

– Më mjafton përgjigja që mora nga aktivistët e Klubit *Emin Duraku*.

Mirani, megjithatë, propozoi Rexhep Halimin, që jetonte në Cyrih dhe Shukriun e Gjenevës. Edhe këta e sqaruan Jusufin për shpërndarje të suksesshme të *Zërit* në Zvicër.

– Miran, sa shumë isha hidhëruar ndaj teje këto ditë! Tani të jam shumë mirënjohës për këtë sqarim. Të kam pasur krah të djathtë çdo herë dhe vazhdoj të të kem.

Mirani heshti për një moment për të menduar se çfarë duhej t'i thoshte.

– Or Bacalok, – iu drejtua me dashamirësi e dhëmbshuri Jusufit, ndaj të cilit rrallëherë e përdorte këtë epitet. – Si këta që po të dezinformojnë e nxisin këtu, ka për të dalë edhe Rrobaqepësi. Kjo më është bërë më e qartë se kurdoherë nga sytë e Bardhit kur bisedova me të pasi u kthye nga takimi në Turqi. Më vjen shumë keq që do të zhgënjehesh rënd në momentin që ke për ta takuar personalisht, sepse ai nuk do të jetë më në gjendje të të manipulojë e të spekulojë në emër të ilegalitetit e konspiracionit, siç të ka manipuluar edhe në Kosovë, siç të ka injoruar për gati një vit e gjysmë pas arratisë sate dhe të tij. Ai të ka kontaktuar vetëm kur lëvizja jonë mori përmasa të mëdha. Ka sabotuar tërbueshëm bashkimin tonë në takimin e tetorit. Të dëshiroj forcë që të

mos thyhesh shpirtërisht e moralisht kur ta takosh dhe do të më vinte keq nëse vazhdon veprimtarinë nën komandim të tij!

– Uroj të mos kesh të drejtë! – u përgjigj Jusufi, por tashmë nuk e kundërshtoi dhe nuk iu hidhërua si herave të mëparme.

Kësaj radhe Mirani konstatoi në paraqitjen e Jusufit një si pakënaqësi ndaj Sabriut, ndryshe nga herat e tjera.

– Bacalok, do të ishte burrërore e shoqërore që ta thërrasim edhe Kadriun dhe t'i bëjmë tre-katër minuta bisedë, – shtoi Mirani.

– Por jo këtu, që të biem në sy, – miratoi Jusufi.

Mirani ftoi Kadriun dhe Jusufin që të ngjiteshin në çati të asaj pushimoreje ku gjendeshin dhomat e vogla të fjetjes.

– Edhe një herë urime të përzemërta dhe u trashëgofshil! – e mori ngrykë Jusufi Kadriun duke e shtrenguar për qafe. – Mirani më ndihmoi të këndellëm, sepse më kishin bombarduar nga shumë kënde dezinformuesit e shpifësit përçarës. Besoj shumë shpejt, pasi ta kesh kryer muajin e mjaltit, do të takohemi për të biseduar për bashkim të radhëve tona. Kështu nuk shkon më. Të kërkoj falje për shkrimin në gazetë.

– Për muaj të mjaltit nuk kemi kohë. Do të më mjaftonte po të kisha vetëm një javë, – u përgjigj me të qeshur e i gëzuar Kadriu.

– Atëherë, pas disa ditësh planifikoje kohën që të takohemi, – tha Jusufi.

– Po e miratoj unë, meqë dhëndrit të ri nuk i takon të flas kaq shumë, – u përgjigj me në të qeshur Mirani. – Tani të shkojmë tek dasmorët që të mos keqkuptohet mungesa jonë.

Të tre zbritën shkallëve. Jusuf e Kadriu zbrisnin krahas duke ia mbajtur dorën mbi supë njëri-tjetrit. Tashmë gëzimi që deri atëherë ishte i ndrydhur nga hidhërimi i Jusufit doli në sipërfaqe dhe po shëmbëllente tek dasmorët. Nuriu e nuhati kthesën dhe sytë zunë t'i vezullonin e lëviznin mu si një dhelpreje. Ai filloi të mos ndihej mirë, meqë i kishte përcjellë lëvizjet. Fillimisht të Miranit e pastaj edhe të Jusufit e të Kadriut.

Atij i kishte mbetur merak që nuk kishte mundur t'i dëgjonte edhe bisedat midis tyre, sidomos kur ata ishin ngjitur lart dhe nuk po i përcillte dot. Tani ndërroi vend që t'i ikte përballimit të shikimeve me Jusufin. Pas disa çasteve doli përjashta për të bërë telefonatë nga kabina që gjendej para pushimores. Për këtë telefonatë Mirani u njoftua nga Rexha, të cilin e kishte ngarkuar ta mbante nën vërtim Nuriun.

2.

Ditën e ejte të 14 janarit, Kadriu udhëtoi në Krahinë të Ruhrit në Gjermani. Të nesërmën në mesditë ishte në Düsseldorf i shoqëruar nga Mirani. U vendosën në banesë të Suliot e Vesmirë Nelajt. Kjo familje ishte bërë strehë e dytë, pas asaj të vëllait Mujë e Kunatës Sabrush, ku Mirani mund të kthehej në çdo kohë dhe të dërgonte mysafirë pa ndrojtje se nuk do të mirëpritëshin. Kadriu kishte dëshirë të vizitonte Klubin, të bisedonte me aktivistë të Klubit dhe aktivistë të këtij rrethi e të rrethëve të tjera në afërsi. Ai kishte planifikuar që këtë fundjavë ta kalonte në këto anë. Tani ai po merrej me propagandimin e *Tezave të Frontit për Republikën e Kosovës*, meqë mendonte se të gjithë aktivistët patriotë se shpejti duhej të përfshiheshin në këtë *Front*.

Vesmira, pasi u dëshiroi mirëseardhje, e qortoi Kadriun pse nuk e kishte marrë me vete nusën. Mirani ndërhyri:

– Siç e pashë në dasmë, nuk kishte nuse edhe aq të bukur, sado që përgjithësisht velloja i zbukuron nuset, prandaj ka pasë turp ta sjellë me vete që t'ia shohim. Fanatikë nuk duken të jenë asnjëri prej tyre.

Shpërtheu e qeshura.

– Prandaj të hidhërohen shokët, – iu përgjigj Kadriu me të qeshur, – sepse shakatë ndonjëherë i ke të rënda e të hidhura.

– Ne nuk i hidhërohem, e kemi në vend të vëllait, – foli Vesmira.

– Ju jo, por ka nga ata që nuk i durojnë dot shakatë e këtij malësori, – tha Kadriu.

– Se mos u hidhërove ti, – ndërhyri Mirani, – që të të kërkoj falje, pasi është fare lehtë kur njerëzit më hidhërohen nga shakatë që bëj, t’u kërkoj falje dhe prapë rikthehet gjenda para hidhërimit.

Prapë plasi e qeshura.

– Po, fort merakosesh ti që t’u kërkosh falje kur të hidhërohen njerëzit! – e mbylli Kadriu duke qeshur.

Pasditen dhe mbrëmjen, deri natën vonë, ata e kaluan duke vizituar aktivistët që banonin në afërsi të Klubit. Vonë u kthyen për të pushuar. Në mëngjes, meqë kishin fjetur pak, u zgjuan të lodhur. Aktivistët e kishin lutur Kadriun të qëndronte edhe të dielen mbrëma, sepse në Klub do të shfaqej një film shqiptar që do t’ua dërgonte Jusufi. Miranin s’kishin nevojë ta ftonin, meqë ai ishte anëtar Klubi. I kishin thënë Kadriut se shpallja për shfaqje të filmit ishte bërë dhe pritej të vinin qindra bashk-atdhetarë. Prandaj duhej të ndalej që t’u fliste për filmin dhe për gjendjen në Kosovë. Kadriu u kishte premtuar se do të ndalej, edhe pse i duhej të ishte të hënën në mëngjes në punë.

Sapo u pastruan, Sulioti mori aparatën e tij fotografik. Kadriu po edhe Mirani nuk i kishin qejf fotografimet, ndoshta pse ishin shpërfytyruar nga pagjumësia dhe lodhja e madhe gjatë gjithë muajve të fundit. Por, sado që Kadriu kundërshtoi, Sulioti shkrepiti aparatën dhe ia bëri një portret, duke thënë me të qeshur se nuk do t’ia jepte UDB-së. Ku ta dinte Sulioti se kjo do të ishte fotografia e fundit në jetën e Kadriut.

Vesëmira shtroi mëngjesin rreth orës 10.30. Ajo e kishte përgatitur me përkushtim. Ndërkohë Muja, vëllai i Miranit, bëri telefonatë dhe njoftoi se Jusufi i kishte thirrur Kadriun e Miranin të shkonin sonte tek ai, por pikëtakimi ishte te Murtez Kryebardhi në Bernhausen, afër aeroportit të Stuttgartit. Në banesën e tij do të shfaqeshin filmat, meqë Jusufit tashmë i kishin arritur videokasetat nga Tirana. Në rreth të Stuttgartit akoma nuk ishte formuar klub shqiptarësh ku do të bëheshin aktivitete,

siç ishte formuar në Dyzeldorf. Kadriu e Mirani po përgatiteshin të shkonin në stacion të trenit për t'i kapur lidhjet që do t'i çonin atje. Sulioti tha t'i voziste ai.

Rreth orës 16.00 u nisën për rrugë që të tre. Arritën në mbrëmje te Murtez Kryebardhi, meqë Mirani e kishte adresën e tij. Aty gjeten Jusufin, Bardhin dhe mbi dhjetë veta, aktivisë që po prisnin Kadriun e Miranin. Bardhi po merrej me instalimin e videorekorderit, që e kishte blerë enkas për atë natë dhe për përdorim të mëtejshëm për të shfaqur filma. Nuk po ia dilte dot ta akordonte videorekorderin me televizorin. Të tjerët, herë bënë biseda midis tyre, herë i bënë ndonjë propozim teknik Bardhit, herë e shpotitnin për pazotësi elektronike. Më në fund u shfaq tv-drama *Gërsheta lufte*, që i kushtohej lëvizjes kaçake në Kosovë, në krye me Azem e Shotë Galicën. Sa mbaroi shfaqja u hap diskutimi. Nuriu ndërhyri në bisedim me pyetje provokative:

– Përse ju, – i drejtuar nga Kadriu e Mirani, – po e sabotoni shpërndarjen e organit të Lëvizjes sonë, *Zëri i Kosovës*?

Kjo pyetje befasoi shumicën dhe e hidhëroi sidomos Jusufin.

– Më në fund, Qeros, nxore fytyrën e vërtetë prej shpifësi e dezinformuesi... – ia përplasi Mirani.

– Miran, nuk ke nevojë t'i përgjigjesh tani, sepse do të marrë përgjigjen e merituar në një rast më të përshtatshëm, – ndërhyri Jusufi. – Po shpërndahemi sepse iku mesnata.

Këtë propozim Jusufi e bëri për të ndërruar vend, meqë më nuk dëshironte të vazhdonte biseda aty, në prani të Nuriut e të ndonjë tjetri.

Të gjithë e miratuan propozimin e Jusufit, pos Murtezit, i cili i luti të rrinin, që ta kalonin natën aty. Kur dolën në oborr të shtëpisë panë se kishte rënë mjegull aq e dendur sa mezi shihnin njëri-tjetrin. Fahriu i luti Kadriun e Miranin të shkonin tek ai për të fjetur, por Jusufi propozoi:

– Sonte Kadriu e Mirani janë mysafirë tek unë.

Ai e këshilloi Bardhin që të ndizte automobilin e tij dhe i tha Kadriut

hynte bashkë me të në makinë, kurse Mirani ta shoqëronte Suliotin, që të mos voziste vetëm dhe që t'ia tregonte rrugën po të mos mundte ta përcillte automobilin e Bardhit. Nuriu po interesohej se ku po shkonin Jusufi, Kadriu, Mirani dhe të tjerët.

Pos mjegullës së dëndur zuri të binte borë. Rruga shihej me vështirësi, ndaj u detyruan të vozisnin shumë ngadalë. Udhëtimi prej rreth pesëdhjetë kilometrash zgjati dy orë. Rreth orës 03.00 të mëngjesit, të ditës së diel, të 17 janarit, arritën në shtëpinë e Jusufit e të Bardhit. Sapo Jusufi hapi derën dhe hyri brenda, pa një njeri të cilin ai menjëherë e njohu. Atë e kishte zënë gjumi mbështetur në shtrat në dhomë të pritjes. Sinjalizoi me gisht te hunda që të mos fliste njeri, duke bërë me shenjë që të ngjiteshin shkallëve lart pas tij. Por, mysafirit gjumëlehtë, të pafuar dhe të padëshiruar, i doli gjumi. Kështu, të gjithë u detyruan të rrinin në dhomë të ndenjës.

Sulioti kërkoi falje për të fjetur meqë ishte i lodhur nga vozitja. Bardhi e shoqëroi atë t'ia tregonte dhomën e Miranit, siç e quanin dhomën e vogël në krye të shkallëve, në shtëpi të tyre.

Në dhomë të ndenjës filloi biseda. Jusufi prezantoi musafirin, tani të zgjuar, që mori pamje të të zgjuarit jerm, pa ia thënë emrin. U mjaftua duke thënë se ishte nga Fshati Bllacë, Rrethi i Lumthetit dhe që ishte azilkërkues i vendosur në një qytezë në afërsi. Kurse musafiri zuri të tregonte arsyen përse ishte ardhur dhe kishte pritur aty, pa pranuar të shkonte të finte, siç i kishte propozuar bashkëshortja e Jusufit, Drita. Rrëfeu se prapë ishte frikësuar të flinte në strehimore të azilkërkuesve, pasi sërish i kishte ndodhur t'i trokiste dikush natën në dritare, t'ia gjuanin dritarën me guraleca dhe t'ia zinin pritën në terr njerëz të panjohur. Jusufi ia ndërpreu rrëfimin duke u thënë të tjerëve:

– Ka ardhur para disa ditësh dhe na ka treguar këto që po tregon se i ka ndodhur sërish. Na ka kërkuar ndihmë dhe pos të tjerash na ka kërkuar t'i gjenim revole që t'i qëllon për vetëmbrojtje...

– Të lutem, vëllai im, – foli Bardhi, – mos u merr me sajemat e tij, sepse ky është duke gënjyer që nga mënyra e arratisjes së tij e deri te këto të fundit, se gjoja është i rrezikuar. Kush e njeh këtë farë baloshi që ta kërcënojë...

– Bardh, mos fol kështu! – tha Jusufi me zë lutës.

– Jo, po nuk durohen më bezdisjet e tij të sajua. Dyshoj se ka ardhur të hetojë nëse ne mbajmë armë...

– Për kokë të fëmijëve nuk ju kam gënjyer dhe nuk po ju hetoj... – zuri të ulëriste mysafiri si i zënë në faj.

– Për kokë të vëllezërve, – ndërhyri Mirani i padurueshëm për të dëgjuar betimin e tij ulëristës, – mbrëmë kam ngrënë një pjatë me mut!

Të gjithë ia hapën sytë Miranit nga befasia për këtë lloj betimi kaq vulgar.

– Përse po betohesh kështu? – e pyeti Jusufi.

– Sepse gënjeshtarët e kanë shprehur të betohen në kokë të fëmijëve, pa i detyruar njeri, prandaj desha t'i tregoj se sa i zë besë betimit të këtij të shpifuri.

Mirani e kishte përvetësuar sqarimi i Bardhit, meqë vlerësonte shkathësinë e tij për t'i njohur njerëzit dhe, i irrituar, nuk po përmbahej karshi këtij mysafiri. Ai, meqë punonte si punëtor social, ishte mësuar të lexonte ata që i shkonin për këshillim se kur thoshin të vërtetën dhe kur gënjenin për ndonjë interes të vogël.

– Të shkojmë për të fjetur se është bërë vonë dhe jemi të lodhur! – tha Kadriu duke dashur ta mbyllte këtë bisedë.

– Bardh, sillja mysafirit një batanije që ta vazhdojë gjumin, – urdhëroi Jusufi të vëllanë ndërsa vetë u ngrit duke u thënë Kadriut e Miranit që ta ndiqnin.

Të tre u ngitën shkallëve dhe hynë në dhomën e punës së Jusufit. Aty zunë vend sipas kërkesës së të parit për të biseduar. Pas disa çasteve atyre iu bashkangjit edhe Bardhi.

– Shokë, – tha Jusufi, – ju kam thirrur që të rifillojmë bisedimet për bashkim, por më erdhi keq për provokimin që bëri Nuriu në banesë të Shokut Murtez. Në fakt, atje kisha mendimin të bisedonim dhe të vendosnim për bashkim, në prani të aktivistëve që kisha thirrur, por më pengoi provokimi i tij. Edhe këtu më erdhi keq që gjetëm mysafirin, vërtet të pafuar dhe të padëshiruar, por që Bardhi u desh të tregohej më i përmbajtur ndaj tij.

– Shoku Jusuf, – mori fjalën Kadriu, – edhe përpara kemi biseduar se në shtëpi po të vijmë shumë njerëz, edhe nga ata që nuk i njeh se kush janë dhe nuk e di se përse vërtet vijnë. Rasti i sontëm është tepër domethënës, siç është domethënës edhe reagimi i Bardhit, i cili për mendimin tim ishte reaktion meritues ndaj atij farë provokatori të panjohur nga asnjëri. E kam thënë edhe përpara, por po e përsërisë se të tillë njerëz jo vetëm që të pengojnë në punë dhe shkaktojnë harxhime e shqetësime, por ndër ta mund të kamuflohet ndonjë informator i UDB-së për të informuar për lëvizjet, takimet e aktivitetin tuaj, gjegjësisht tonin. Situata në Kosovë është ashpërsuar skajshmërisht, prandaj mund të merret me mend se UDB-ja edhe jashtë do të ndërmarrë hapa konkret ndaj nesh. Edhe provokimit të atij farë Nuriut nuk i vinte erë e mirë.

– Edhe unë po ia tërheq vërjetjen, – zuri të sqaroi Bardhi, – pasi që dy herë gjatë kësaj jave, kur kthehesha vonë në shtëpi, kam hetuar siluetat njerëzish të dyshimtë që silleshin rreth shtëpisë sonë, por Jusufit nuk i bëri përshtypje kur i tregova...

– Këto mendime e vërejtje i kam dëgjuar disa herë, – ndërhyri Jusufi, meqë nuk deshi ta linte Bardhin të zgjatej, – por ne nuk i përzëmë dot njerëzit që ia mësojnë shtëpisë sonë. Është traditë jonë bujaria dhe mikpritja edhe për ata që nuk e meritojnë. Sa i përket rrezikimit, këtë e kam menduar sa herë. Kam ardhur në përfundim se ne nuk mund të mbrohemi, sepse UDB-ja është në gjendje të bëjë çfarë të dojë edhe këndeje. Meqë ne jemi të strehuar këtu, ajo do të peshojë nëse vrasjet ndaj nesh

i sjellin më shumë dobi se sa dëm. Them se ne, tani për tani, nuk meritojmë atentate nga UDB-ja, pasi veprimtaria jonë kohëve të fundit nuk duhet të vlerësohet nga ana e saj si aq e rrezikshme. Nëse do ta bashkojmë veprimtarinë në një organizim të vetëm dhe nëse do ta forcojmë, siç duhet të ndodhë pas bashkimit, atëherë ne do të rrezikohemi. Por, mendoj, ne nuk kemi nevojë të ruhem aq shumë sa të pengohemi në veprimtarinë tonë sepse, që kur jemi përcaktuar për këtë mision, e kemi matur se mund të na ndodhin vrasje dhe shumëçka tjetër. Them se duhet t'ia shtrydhim sa më shumë vlerën jetës sonë.

– Nuk pajtohem me këto që the së fundi, – kundërshtoi Kadriu. – Nëse praktikojmë konspiracion të thellë edhe mund të ruhem nga shërbimet jugosllave, parandaj, si shumë përgjegjësi që kemi, natyrisht kemi përgjegjësi edhe që të ruhem sa më shumë. Jo për shkak të frikës, por për shkak se dëmtohen radhët dhe veprimtaria jonë. Sa i përket momentit kur UDB-ja vendos për të bërë atentat, unë do të shtoja se ajo do ta zgjedh momentin më të volitshëm për interesa të saja. Kjo do të ndodhë, them unë, pasi ajo të ketë infiltruar njerëz të saj në radhët tona që, pos eliminimit tonë fizik, të godasë rënd edhe radhët tona pastaj duke futur përçarje e dyshim, duke synuar që vendet tona t'i zënë njerëzit e saj.

– Sa i përket konspiracionit strikt, që thua, është e pamundur ta praktikojmë në rrethanat që veprojmë, sepse ne jemi të detyruar të kemi kontakte sa më të shpeshta me punëtorët tanë. Pastaj, ti mendon se praktikon konspiracion të thellë vetëm pse aktivistët tanë nuk e dinë se ku jeton ti. Por, siç kam mundur të informohem kohëve të fundit, Sadri Bakaj ka qenë në qytetin ku ti jeton dhe ka mundur të të survejojë.

– Unë mendoj, nëse me lejohet të inkuadrohem prapë në bisedë, – mori fjalën Bardhi, – se rreth nesh po sillen njerëz të dyshimtë. Shëmbulli më flagrant është ai njeriu poshtë, të cilin ne nuk e njohim dhe nuk e dimë nga e kishte adresën për të ardhur vetëm në shtëpinë tonë. Pastaj,

të infiltruar duhet të jenë të gjithë ata që po shpifin e po dezinformojnë kundër nesh, njerit ose tjetrit dhe ne po i dëgjojmë dhe po influencohemi prej tyre duke u mbushur pastaj me keqkuptime midis nesh. Problematike është se çfarë duhet të ndërmarrim që të rrisim sigurinë dhe t'i menjanojmë të infiltruarit. Nëse vendosim për bashkim në një organizatë të vetme, atëherë UDB-ja do të ndërmarrë masa të menjëherëshme që organizata e re e përbashkët të mos startojë me sukses. Dhe masa më e suksesshme, do gjykojë UDB-ja, është eliminimi ynë fizik.

– E para, – mori fjalën Mirani, – besoj se ju nuk po e abstrahoni mundësinë e bashkëpunimit të qeverisë së Beogradit me qeverinë e këtu. Tashmë dihet se sigurimet sekrete bashkëpunojnë midis tyre dhe secila ka për bazë interesat egocentrike të shtetit të vet. Në kuadër të bashkëpunimit ndodhin edhe kushtëzime e favorizime reciproke dhe mund të merret me mend se qeveritë e shteteve që na kanë strehuar nuk do të konfrontohen aq ashpër me atë të Beogradit për të na mbrojtur ne me çdo kusht. Në këtë drejtim, vizita e ministrit jugosllav të punëve të brendshme, Hërleviqit, në Bonn fare nuk më pëlqeu. Pastaj, vetë këto shërbime inteligjente, siç po i quajmë, në plan të parë i kanë interesat e tyre si struktura që i shpallin si interesa shtetërore, meqë ato janë bërë shtet në shtet dhe ca mekanizma të kontrollit nga ana e parlamenteve e qeverive përkatëse dominohen po nga njerëzit që selekcionojnë këto sigurime dhe prandaj kanë karakter formal, meqë politikanët e parlamentarët e votuar me mandat të caktuar nuk janë në gjendje t'i kontrollojnë specialistët e këtyre shërbimeve.

E dyta, edhe sikur të mos ishin njerëz të infiltruar nga UDB-ja, Nuriu, gjegjësisht Qerozi, atje dhe ky farë mysafiri këtu, që edhe emrin nuk po ia dimë, a nuk na penguan që të bisedojmë. Sigurisht na penguan. Pastaj, a nuk është e mundur që ky mysafiri që është këtu të ketë pajisje përgjimi me vete, ta zëmë një mikrofon të vogël spiunazhi? Të tjerët mund të bëjnë incizim jashtë, madje edhe nga një distancë e

madhe. Të gjitha këto ne po i neglizhojmë...

– Them, – u ngut Jusufi, – që të kalojmë në temën që na preokupon më shumë, atë për bashkim të radhëve tona, për çka ju kam ftuar, sepse për të tilla tematika Mirani mund të flasë gjatë, për aq sa do të kemi kohë ne ta dëgjojmë. Tani është vonë. Jemi edhe të lodhur kurse tema që kanë të bëjnë me mënyrën e mbrojtjes tonë nga infiltrimi i spiunëve dhe nga survejimet e UDB-së duhet të diskutojmë në mënyrë të përkushtuar. Ato na duhen në kuadër të përsosjes së veprimtarisë sonë.

– Urdhëro, po të dëgjojmë, – miratoi Kadriu.

– Në parim ne qemë marrë vesh qysh në muajin gusht që platformë e bashkimit të jenë *Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës*. Sipas meje, për bashkimin që ne u dakorduam atëherë duhej të jepte vetëm miratimin formal Sabiti, të cilin menduam ta nderojmë si veteran i lëvizjes patriotike. Por tashmë jemi sqaruar se ai jo vetëm që nuk dha miratimin formal, por na bllokoi fare duke mos marrë parasysh mendimin dhe vendimin tonë paraprak. Tani nuk kemi pse të marrim si shkak refuzimin bllokues të Sabitit që ne të mos merremi vesh se si dhe çka duhet të vendosim.

– Thënë të drejtën, – mori fjalën Bardhi, – pasi pa se asnjëri nuk po fliste për momentin, – mua më ka ardhur shumë keq që e kam njohur Sabitin. Edhe më keq më erdhi për rastin dhe mënyrën se si e njoha atë, pasi Jusufi dhe unë e kemi idealizuar deri në idhull. S’e peshoj me mall, siç praktikohet të thuhet, po të mund ta zhbëja shkuarjen tek ai në Turqi. Sidomos më ka ardhur keq për Kadriun se si u soll Sabiti ndaj tij. Po kështu edhe për diplomatën shqiptar, Shokun Bujar Hoxha, më erdhi keq sepse u zhgënjye nga harbutëria e destruktiviteti i Sabitit. Unë kam nguruar deri sonte t’ia them këto Jusufit, sepse më vinte keq ta zhgënjëja, por tani m’u duk momenti i duhur. Prandaj, koha prej atëherë e deri tani duhet të vlerësohet si kohë e humbur, krejtësisht për fajin e Sabitit, të cilin Mirani e kishte njohur mjaft mirë, po ne, jo vetëm që nuk e

dëgjonim, por edhe i hidhëroheshim kur ai na informonte dhe e vlerësonte si njeri negativ.

– Unë nuk e kam njohur personalisht, – shtoi Mirani. – Përpara kisha dëgjuar për emrin e tij dhe kisha respekt. Pa u zgjatur për folur për të kësaj radhe, meqë mund ta kem tepëruar herave të tjera, po shpreh një dilemë konkrete: Shoku Jusuf, ai t'u lajmërua vetëm kur ne e rritëm veprimtarinë, do thotë pas një viti e gjysmë që kur je arratisur. Edhe atëherë kur t'u lajmërua, dyshoj ta ketë bërë vetëm sa për ndërhyrje destruktive. Por, të shkauara e të harruara, siç thotë populli. Tani rëndësi ka se e kuptuam të gjithë që bashkimi jo vetëm që është i domosdoshëm, por është edhe i vonuar dhe për këtë bashkim, të paktën këndeje, mund të vendosim vetë ne. Prandaj, propozoj të bisedojmë vetëm për bashkimin sesi të bëhet ai konkretisht.

– E mbështes propozimin e Miranit, – miratoi Bardhi.

– Atëherë nuk kemi pse harxhojmë kohë, – u pozicionua Jusufi, duke bërë ndërrim të pozicionit të të ulurit në fotele për të marrë pozicion me serioz. – Besoj se të gjithë jemi që për platformë të organizatës që po krijojmë përmes bashkimit të organizimeve tona të deritanishme të jenë Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës, ashtu siç i patëm miratuar në fund të gushtit. Po i patëm harruar vendimet e atëhershme mund t'i gjej shënimet që kam mbajtur. Them që ti Kadri dhe ti Miran, të deklaroheni nëse jeni edhe ju për të njëjtat vendime që patëm marrë atëherë.

Kadriu dhe Mirani shprehën miratimin e tyre duke shfaqur gëzimin, sidomos për faktin që këtë propozim tani po e bënte vetë Jusufi.

– Tani ta ndërpresim bisedën pasi jemi të lodhur, – tha Kadriu. Pasi të flemë tre-katër orë, e hartojmë vendimin, të cilin propozoj ta nënshkruajmë dhe të bisedojmë për mënyrën e organizimit konkretisht. Por, paraprakisht them se *Tezat* mund t'i përshtasim edhe më shumë, sidomos sa i përketë formës organizative. Ne kemi ndryshuar përcak-

timet kombëtare e ideo-politike nga përcaktimi për çlirim e bashkim kombëtar me Republikën e Shqipërisë, në kërkesën për Statut të Republikës për Kosovën, gjegjësisht nga përcaktimi komunist, marksist-leninist, në respektim të sistemit kushtetues të RSFJ-së, e cila Kushtetutë duhet të modifikohet për ta njohur Republikën e Kosovës. Prandaj, edhe më të lehtë do ta kemi që ta përshtasim edhe formën e organizimit. Ta zëmë se organizatën e masave duhet ta udhëheqë pararoja marksiste-leniniste. Në rrethana të reja nuk ka nevojë të jetë kështu, nga se përvoja na ka treguar se ne kemi funksionuar shumë mirë së bashku, edhe kur u takonim organizimeve të ndryshme. Që kur janë hartuar janë quajtur Teza, që të diskutohen dhe të modifikohen, duke u zgjedhur varianti më i përshtatshëm sipas gjykimit tonë.

– Tani e tutje nuk janë më Teza, por Program i Frontit për Republikën e Kosovës, derisa ta mbajmë Kuvendin e Parë, – konkludoi Jusufi.

– Urime për Bashkimin! – u ngrit në këmbë Bardhi duke ia zgjatur dorën Kadriut, meqë e dinte se këtë lloj prononcimi përrurues po e priste secili, por ja që secili nga të tre po ngurronte ta thoshte i pari. Pas tij u ngritën edhe Mirani, Kadriu e Jusufi, duke uruar e përçafuar njëri-tjetrin me gëzim. Jusufit e Miranit iu mbushën sytë me lot.

– Dalshim faqebardhë dhe fitues! – uroi Jusufi gjithënjë në këmbë.

– Të lumtë goja! – thanë njëzëri Kadriu e Mirani.

– Të flemë pak dhe kur të zgjohemi e konkretizojmë këtë bashkim historik edhe me formulim me shkrim dhe me nënshkrimet tona! – tha Kadriu pasi përfunduan me përrurime entuziaste të njëri-tjetrit.

Ranë të flinin rreth orës pesë të mëngjesit.

3.

Rreth orës 12.00, kush më herët e kush më vonë, u zgjuan njëri pas tjetrit. Të gjithë po i habiste vazhdimi i qëndrimit të mysafirit aty. Ai nuk ishte shkuar se nuk ishte shkuar. Ishte aq injorant sa të mos e kuptonte

se ishte i tepërt aty, apo luante rrolin e injorantit për të qëndruar sa më gjatë?

Deri rreth orës 13.30 ndenjën duke pirë kafe dhe duke pritur drekën. Pasi drekuan, rreth orës 14.00, Sulioti kërkoi leje të udhëtonte sepse i duhej të dërgonte në Klub videokasetat e filmave. Jusufi i propozoi Kadriut e Miranit që të ngjiteshin lart në dhomë të punës.

– Sulioti nuk duhet të shkojë vetëm, – tha Jusufi. – Është i lodhur dhe dikush nga ne patjetër duhet ta shoqërojë. Gjithashtu, patjetër duhet të jetë njëri nga ne në Klub për të bërë prezantimin e tv-dramës *Gërsbeta lufte* dhe për të diskutuar për të. Njëherit duke shfrytëzuar rastin për të folur edhe për gjendjen në Kosovë, pasi të jetë shfaqur tv-drama, meqë është moment i volitshëm që të pranishmit të dëgjojnë me vemendje të përqëndruar. Mendoj se asnjërit nga ne nuk i takon para Miranit, pasi ai me këtë rast do t'i afrohet edhe vendbanimit të tij. Kurse Kadriu dhe unë mbetemi për të finalizuar me shkrim në letër vendimin që morëm. E di se Mirani do ta miratojë punën tonë dhe do firmosë pastaj formulimin që do ta përpilojmë Shoku Kadri dhe unë.

Mirani e pranoi me përtesë këtë propozim të Jusufit, pasi dëshironte të ishte i pranishëm gjatë hartimit të dokumenteve të bashkimit dhe të merrte pjesë në marrje të vendimit edhe për formë të organizimit të Organizatës së përbashkët, që tashmë gojarisht e kishin themeluar. Por, e kuptoi Jusufin se vërtet nuk ishte e arsyeshme që Sulioti të lihej vetëm dhe tani nuk duhej të shfaqte dilemë pse dokumentet do t'i përpilonin vetëm Jusufi e Kadriu.

– Mirë, unë po e pranoj propozimin e Shokut Jusuf, sado që kisha dëshirë të ishim bashkë gjatë përpilimit e firmosjes së dokumentacionit përkatës për bashkim. Për mua ky është moment historik. Megjithatë, po shkoj me qejf se bashkimin e bëmë dhe kam besim të plotë në vendimet konkretizuese që do t'i hartoni ju. Nuk më mbetet tjetër pos t'ju uroj sukses, sepse nuk duhet të vonohemi dhe t'i lëmë duke na prit-

ur qindra bashkatdhetarë në Klub. Unë do të firmos pastaj çdo dokument që keni firmosur edhe ju.

Pas u krye ky diskutim i shkurtër që të tre zbritën në dhomë të ndënjës. Bardhi akoma po flinte dhe nuk e zgjuan që ta përcillte Miranin e Suliotin. U ndanë duke u përçafur. Mirani e Sulioti udhëtuan. Në shtëpi ngelën Jusufi, Kadriu e Bardhi, mysafiri i padëshiruar, Drita, bashkëshortja e Jusufit, Tina, bashkëshortja e Bardhit dhe fëmijët.

4.

Gjatë rrugës, sipas propozimit të Suliotit, u kthyen te bashkatdhetari Ryslan B., sepse deshën ta merrnin me vete në Klub.

Sipas paralajmërimit, drama televizive *Gërsbeta lufte*, filloi së shfaquri në orën 20.00, sipas orarit të paralajmëruar. Mirani bëri prezantimin. Pas mbarimit të dramës Mirani bëri një diskutim të shkurtër, duke ua lënë radhën të tjerëve që të shprehnin mendimet e mbresat e tyre. Rreth orës 22.40 Mirani dhe Hajzeri, me dy bashkatdhetarë të tjerë shkuan në banesë të Hajzerit për të pushuar, sepse të tjerët, me përjashtim të Miranit, të nesërmën në mëngjes duhej të punonin. Sapo u rehatuan për të fjetur erdhi lajmi se kishte ndodhur hataja. Lajmin e kobshëm e solli Halim B, të cilit i kishte telefonuar Muja, vëllai i Miranit. I mbushur frymë e me vaj në buzë, pasi u hap dera, mezi tha:

– Miran, është bërë atentat ndaj shokëve Jusuf, Kadri e Bardhosh!

Halimi ishte zverdhur i tëri, pasi shokët nuk i shihnte si liderë të largët, por si shokë të afërt. Sa e sa herë kishte bashkëbiseduar me ta.

Lajm tepër tronditës për ta mbajtur shpatullat e Miranit. Shumë herë kishin biseduar për rrezikun, për atentatet. Edhe para rreth njëzetë orësh kishin biseduar, pa e ditur se vdekjen e kishin kaq pranë jetës së tyre. Ishte lajm për atentat, por nuk po i dinin akoma përmasat. Mirani po klithte:

– Fatziu unë, pse u bëra i dëgjueshëm dhe nuk ndenja me ta, të isha

përkrah tyre edhe në vdekje!

Nuk po kuptonte se nga i vinin klithmat, nga se njëkohësisht mendonte: nuk duhet t'i turpëroj duke bërë vaj e gjëmë, po duhet t'i vë gjoksin goditjes kaq të rëndë.

Ai udhëtoi bashkë me kunatën, Sabrushin, dhe axhën e saj, që bashkatdhetarët e quanin Bajraktar. Udhëtuan në natën sterrë të zezë, mbi asfalt të mbuluar me shtresë akulli e bore, e cila po vazhdonte të reshte duke mbuluar rrugën që të mos shihnin nga duhej të shkonin.

Te familja e Vëllezërve Gërvalla arritën tek rreth orës shtatë të mëngjesit, edhe pse Bajraktari ngiste automobilin me guxim të tepërt. Akoma nuk kishte ikur errësira e asaj nate të rëndë dimri. Në shtëpi gjetën vetëm Tinën, bashkshortën e Bardhit me fëmijët. Të tjerët ishin në spital të Hajlbronit. Tina dhe fëmijët nuk po qanin, sepse ashtu kishte porositur Jusufi.

– Na i vranë të tre, – foli ngadalë-ngadalë Dardana, si të ishte vajzë që vinte nga legjendat. Qerpiku nuk i lëvizte. Ajo iu hodh në përqaqim Miranit duke i thënë:

– Shyqyr që na shpëtove ti, xhaxhi Miran!

Dhe ec e guxo Mirani të shkrehej në vaj para saj, sado që zemra e shpirti sa nuk po i pëlçisnin. Por, porosia e Jusufit, që ia kumtoi e bija, Dardana, ishte mesazh, ishte fuqi, ishte vetëpërmbytje, ishte moral e forcë për të vazhduar veprimtarinë.

Policia që ndodhej para dere, e legjitimoi dhe e luti Miranin të shkonte bashkë me të në Hajlbron, atje ku po kujdestaronte SOKO (Sonderkommission, Komisioni i Veçantë), i ngritur enkas për këtë vrasje. Shefi i SOKO-s po e priste Miranin të vinte nga çasti në çast. Vetë ai e mori Miranin në pyetje që më shumë ngjante në një bashkëbisedim. U morën vesh që Mirani të rrëfente fillimisht për orët e fundit të kaluara së bashku me Jusufin, Kadriun e Bardhoshin, tashmë të shndërruar në përjetësi.

Kryehetuesi Mayer (Majer), e pyeti Miranin pastaj se në ke dyshonte për vrasës të mundshëm.

– Gjithsesi atentatin e ka bërë UDB-ja, - u përgjigj me qetësi Mirani.

– Dorasi ka domethënie vetëm figurative në këtë atentat të rëndë politik, por kapja e tij është me rëndësi, pasi ju gjermanët doni prova faktike. Dhe, besoj se po patët vendosmërinë do t'i kapni atentatorët. Ju keni shtet të fortë dhe organe të profesionalizuara.

– A keni mundësi të na tregoni për organizimet tuaja dhe të na ofroni programet politike dhe statutet si edhe listat e anëtarësisë? – pyeti kryehetuesi.

– Organizimet tona kanë karakter popullor, siç i quajmë ne, kurse ju i quani organizime qytetare. Programet politike të organizimeve tona kanë ndryshuar që kur kanë shpërthyer demonstratat politike të marsit e të prillit të vitit të kaluar. Përpara këto programe kishin kryesisht karakter kombëtar, të çlirimit të territoreve tona etnike shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre në një Shqipëri etnike. Por ato i përvijonte edhe ideologjia komuniste dhe revolucionare. Pas shpërthimit të demonstratave këto përcaktime u tkurrën në kërkesa politike për barazi nacionale në kuadër të Jugosllavisë, duke njohur rendin kushtetues të saj. Anëtarësim nuk kemi praktikuar, sepse nuk dëshironim t'i rrezikonim emigrantët tanë, që ju i quani Gastarbeiter.

– A keni pasur rivalitet dhe fërkime ndërmjet organizatave tuaja?

– Jo, tri organizimet ku bënin pjesë Vëllezërit Gërvalla, Kadri Zeka dhe unë, nuk kemi pasur rivalitet dhe as fërkime. Kemi bashkëvepruar që nga kontaktet e para e deri në moment të atentatit si të ishim një organizatë e vetme. Ndonjë divergjencë të rastit edhe kemi pasur, pasi këto ndodhin edhe në organizimet pluraliste. Gjithsesi ato kanë qenë brenda normave të organizimit pluralist demokratik. Fjalën e kam për organizimet që ju tashmë i dini: Organizata e Marksiste-Leniniste e Kosovës, shkurtimisht OMLK, se cilës i përkiste tashmë i ndjeri Kadri Zeka,

Lëvizja Nacional-çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi, shkurtimisht LNÇKVSHJ, që i përkisnin tashmë të ndjerët Vëllezërit Gërvalla dhe Fronti i Kuq Popullor, shkurtimisht FKP, të cilit i përkisja unë. Me organizime të tjera politike të shqiptarëve jashtë Kosovës nuk kemi pasur bashkëpunim, rrjedhimisht as fërkime. U kemi ndenjuar në distancë.

– A keni diskutuar ndonjëherë për bashkim të këtyre organizatave meqë, sipas asaj që thatë, kanë pasur përcaktime identike politike?

– Po, kemi biseduar. Lëvizja dhe Fronti kishin përcaktime ideore e politike pluraliste, duke inkuadruar në radhë të tyre çdo emigrant shqiptar, pavarësisht bindjeve ideore, politike e fetare. Pas demonstratave të marsit e prillit të vitit të kaluar, ne pranuan turrjen e përcaktimit tonë politik në kërkesë për Republikë të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. OMLK-ja kishte përcaktim komunist. Jashtë Kosovës nuk besoj të ketë pasur anëtarë, pos Kadri Zekës, ndërsa sa u përket simpatizantëve, ai ka afruar edhe bashkatdhetarë që nuk kanë qenë komunistë. Bisedimet për bashkim të këtyre subjekteve filluan në Kosovë në maj të vitit të kaluar. Për shkak të arrestimeve të mëdha këto bisedime u vazhduan nga qershori deri në gusht në emigracion dhe i kemi bërë Jusufi, Kadriu dhe unë. Platformën politike, të hartuar në Kosovë, e kemi diskutuar dhe e kemi miratuar versionin përfundimtar, të cilën ju duhet ta keni tani në dosjen tuaj, meqë tashmë i keni marrë materialet në shtëpi të Jusufit e Bardhit. Edhe pse ne patëm miratuar platformën dhe bashkimin, me kërkesë të Jusufit kemi pranuar që bashkimin ta shpallë një veteran i lëvizjes patriotike në Kosovë, i cili tani gjendet i strehuar në Turqi. Në tetor u takuan ai, Kadriu e Bardhi, por ai refuzoi të bëhet bashkimi sipas asaj platforme që kishim miratuar ne. Kështu vazhdoi forma e përparme e organizimit. Parëmbremë, me ftesë të Jusufit, u takuam përsëri. Fillimisht në Bernhausen e pastaj, pas mesnate, erdhëm në shtëpi të Vëllezërve Gërvalla. Rreth orës pesë të mëngjesit të ditës së djeshme

vendosëm definitivisht për t'u bashkuar në bazë të vendimeve të mëparme. Gjithashtu u vendos që dje, pasdite, t'i konkretizonim formën e organizimit dhe platformën politike, gjegjësisht programin deri në kuvend të parë që synonim ta mbanim sa më shpejt. Rreth orës pesëmbëdhjetë u vendos që unë të udhëtoja bashkë me Suliot Nelën, sepse kishin paralajmëruar shfaqje të një filmi shqiptar në Klubin tonë në Dzyeldorf. Për detajet e rrejdhës konkrete pas udhëtimit tim nuk di t'ju rrëfej. Besoj se do t'i gjeni shënimet për konkretizimin e vendimit që morëm, meqë Kadriu e Jusufi ndenjën për atë qëllim.

– Kë dyshoni se mund të ketë bërë atentatin e trefishtë? – pyeti kryehetuesi.

– Zotëri, ju përgjigja një herë. Atentatin e ka bërë UDB-ja ose ndo një shërbim tjetër përkatës jugosllav. – u përgjigj Mirani.

– Ne duhet të zbulojmë atentatorët që të mund t'i akuzojmë pastaj zyrtarisht këto shërbime dhe qeverinë jugosllave. Prandaj pyetja ime konkrete është: Në kë dyshoni ju konkretisht si atentatorë të mundshëm? Siç ju sqarova, ju keni të drejtë të mos përgjigjeni në pyetjet e mia.

Mirani u zu ngusht. Kishte mëdyshje nëse duhej ose jo ta konkretizonte ndokënd për të dyshimtë. Përfundimisht vendosi të përgjigjej:

– Mendoj se shërbimet jugosllave duhet të kenë përgatitur e urdhëruar atentatorë shqiptarë. Kështu mendoj sepse ato mund të kenë menduar se ju mund t'i kapni atentatorët dhe pastaj Beogradi do të dezinformonte se janë vrarë shqiptarët ndërmjet tyre për të qëruar hesapet e tyre mafioze e kriminale.

Mirani u ndal për të hetuar përshtypjen e kryehetuesit. Ai mendoi se Mirani nuk po vazhdonte më me këtë përgjigje, prandaj hapi dosjen dhe nxori një fletë ku ishin skicuar dy persona që kishin kryer atentatin.

– Zotëri Bruçaj, këtu është një skicim, që do të përpunohet në fotografi fantom. Është bërë nga specialisti në bazë të dëshmisë të fqinjit të Vëllezërve Gërvalla. Në kë të ngjajnë këto dy skicime, – pyeti krye-

hetuesi Mayer.

– Për këtë të gjatën besoj e dini, sepse e keni zënë në vepër duke vjedhur postën e Vëllezërve Gërvalla dhe timën. Mendoj se po më kuptoni që fjalën e kam për Rezil Mejtepin, me banim në Stuttgart. Skica i ngjan shumë atij, kurse ky tjetri nuk di kujt i ngjan.

– Përse dyshoni në Rezil Mejtepin, dini gjë tjetër pos atyre që mendoni se i dimë ne, – ndërhyri kryehetuesi Mayer.

– Unë supozoj se ju dini shumë për të, siç mund të dini se ai që shumë vite është rekrutuar e stërvitur nga UDB-ja për t'u atashuar këtu, në mesin e emigrantëve shqiptarë që t'i survejojë ata. Pos detyrës së survejimit, ju duhet të dini zënkën e tij me emigrantë politikë kroatë, plagosjen e tij në këtë zënkë, qëndrimin e tij në spital dhe vizitat e shpeshta që i ka bërë atij konsulli jugosllav për ta përgëzuar për meritat e tij patriotike jugosllave. Gjithashtu dini se ai ka vjedhur postën tonë. Nuk mund ta di se përse e keni toleruar kaq shumë e kaq gjatë. Pos këtyre që ju duhet t'i dini, ai pat urdhëruar të bëhej atentat ndaj Jusufit disa muaj pas ardhjes së Jusufit këtu, por e zbuluam dhe e evituam...

– Ai ka urdhëruar atentat, thoni ju?

– Po.

– Dhe ju nuk e keni denoncuar ose nuk u hakmorët në asnjë formë kundër tij? – ndërhyri me habi Shefi.

– Jo, nuk pranoi Jusufi. Edhe ne të tjerët gjykuam se nuk është në kompetencën tonë për të marrë vendim kapital për dënim të tij. Kurse, sa për denoncim, nuk e kemi bërë, meqë do të involvoheshim në mekanizmat tuaj që ndonjëherë vetëm sa krijojnë telashe.

– Si ka ndodhur?

Mirani rrëfej rastin me të gjitha detajet e tij.

– Domethënë, ju dyshoni në Rezil Mejtepin? – pyeti Shefi.

– Mendoni se nuk kam arsye!? Nëse ai ka alibi do të gëzohesha, sepse nuk dëshiroj që dorasi të dalë shqiptar, sado që kjo nuk e shkarkon

UDB-në nga përgjegjësia. Ndërsa dikush nga pjesëmarrësit e takimit të parëmbremshëm në Bernhausen duhet të ketë qenë informues për lëvizjet tona.

– Në cilin dyshoni? – pyeti Shefi.

– E kam piketuar njërin, por s’e them dot. Druhem se mos dyshimi im ndaj tij nis nga urrejtja subjektive që ndiej. Pastaj, kur patëm shkuar në shtëpi të Jusufit, gjetëm aty një mysafir të paftuar dhe të padëshiruar, siç e karakterizoi atë Jusufi...

Edhe për të Mirani i rrëfeu kryehetuesit Mayer gjerësisht.

– Përse nuk e thoni emrin e të dyshuarit nga takimi në Bernhausen, pavarësisht arsytimit që bëtë. Atij nuk i bëni ndonjë padrejtësi të madhe, sepse ne do të hulumtojmë dhe, nëse del i pafajshëm, nuk do t’i ndodhë asgjë. Kështu ju kontribuoni në zbulim të dorasëve dhe njerëzve të prapavijës, që i kanë ndihmuar ata për të bërë këtë krim.

– Atëherë, ai është Nuri Syleviqi. Ia patëm vënë nofkën Qerosi, me që është pa flokë. Banon në Sindelfingen.

– Mbi ç’bazë dyshoni në Nuriun?

– Që kur e kam njohur, besoj në tetor të viti 1978, më është dukur i dyshimtë, fillimisht në bazë të intuitës, pastaj të sjelljeve. Kishte një paraqitje të shtirur prej patrioti të flakët. Pastaj vëreja se atij po i frikësoheshin emigrantët që bashkëbanonin në hajme të punëtorëve të Fabrikës *Mercedes*. Ai ishte usta për të përhapur dezinformata dhe për të nxitur urrejtje e grindje. Parëmbremë ishim në Bernhausen, të paktën dhjetë veta, në banesë të Murtezë Kryebardhit. Pos Jusufit, Kadriut, Bardhit e meje, ishte edhe Nuriu, Fahriu, Nazimi, Shabani dhe të tjerë. Pasi pamë një tv-dramë filluam diskutimin. Nuriu menjëherë bëri një pyetje provokative që na e drejtoi mua dhe Kadriut se përse po sabotonim shpërndarjen e organit të tyre, “Zëri i Kosovës”. Kjo pyetje kishte për qëllim që të dezorientonte bisedën për të cilën ishim mbledhur. Ai duhet të ishte informuar nga Jusufi se ne do të mblidheshim për të biseduar e për të

vendosur për bashkim tonin. Menjëherë Jusufi reagoi, meqë iu duk provokative pyetja e tij. Reagimi i Jusufit ishte që në të shpërndaheshim që andej. Kur dolëm nga banesa e Murtezit, vonë pas mesnate, kishte rënë mjegull e dendur. Ai po interesohej të dinte se ku po shkonim ne me Jusufin, Kadriun e Bardhin. Jusufi në prani të tij tha se Kadriu, Sulioti dhe unë do të shkonim në shtëpi të Jusufit. Në bazë të kësaj rrjedhe po dyshoj se ai duhet të jetë informuesi i lëvizjeve tona fizike. Pastaj edhe Bardhi na informoi se gjatë javës së fundit kishte parë njerëz të dyshimtë që silleshin rreth shtëpisë, kur kthehej natën.

– Ju falenderoj për këtë sqarim, – tha kryehetuesi. Pas pak ai vazhdoi: – Të rikthehem edhe një herë te Rezili. Cilin pat urdhëruar Rezil Mejtepi për të bërë atentatin ndaj viktimës, Jusuf Gërvalla?

– Ju lutem, nuk është viktimë, është dëshmorë, – u përgjigj Mirani duke e paraqitur në mënyrë naive vlerësimin e tij personal karshi një polici gjerman.

– Varet nga këndvështrimi dhe pozicioni. Por, ju lutem, përgjigjuni në pyetje, nëse doni.

– Ai pat urdhëruar një bashkatdhetar me emrin Hysni G., të cilin ne e thërrisnim Vasil. Dhe, për shkak se Vasili ka refuzuar ta zbatojë urdhërin, UDB-ja ka organizuar hakmarrjen kundër Hysniut. Ajo ka dërguar një tjetër UDB-ash me emrin Sadi Bakaj, i cili e ka dërguar Hysniun në Kosovë. Tani Hysniu gjendet në burg në Kosovë dhe është dënuar me dymbëdhjetë vjet heqje lirie.

– Ne tashmë, në bazë të të dhënave tona, kemi marrë urdhërin për arrestim të Rezil Mejtepit dhe gjatë ditës do të publikohet në mediat elektronike portreti i tij, meqë deri tani nuk e kemi gjetur. Edhe këtë skicë do ta përpunojmë në fotografi fantom (fotorobot) e pastaj do ta shtypim si trakt, të cilin do ta shpërndajë policia. Të shohim nëse ka apo jo alibi.

Pas një pauze të shkurtër, të cilën kryehetuesi e shfrytëzoi për të

menduar nëse duhej ose jo të vazhdonte me marrje në pyetje të Miranit, ai sqaroi se kësaj radhe kaq mjafton. Mirani ndërkaq po mendonte se, pavarësisht aftësisë profesionale të kryehetuesit, nuk duhet të jetë përkushtimi i nivelit për t'i kapur atentatorët. Kishte rezerva se mos ishte thurur ndonjë komplot në nivelet më të larta, meqë për vizitë në Bonn ishte Ministri i Brendshëm jugosllav, Hërleviq. Këtë dyshim ia kishin përforcuar edhe lajmet se policia nuk i kishte bllokuar shpejt të gjitha rrugët që lidhnin këtë fshat me rrugët kryesore, siç di dhe mundet të veprojë rëndom policia gjermane.

5.

Miranin e kthyen policët në shtëpi të Jusufit, meqë Heilbronni ishte rreth 15 km., larg dhe lidhjet e komunikacionit publik nuk ishin aq të shpeshta.

Në shtëpi mbretëronte atmosferë vetëpërmbytjeje. Të gjithë tashmë kishin dëgjuar porosinë e Jusufit që të mos i qanin e vajtonin, pasi kishin rënë për atdheun. Kjo porosi përcillej nga njëri te tjetri, duke pasur burim të vetëm bashkëshortën e Jusufit, Dritën dhe vetëkuptohej që porosia duhej të zbatohet si urdhër i prerë. Ajo porosi vetëvetiu po shndërrohej në qëndrimin: kushdo që qan nuk duhet të rrijë aty, sepse shkilej porosia që kishte lënë Jusufi. Tashmë, sikur po bëhej garë se cili është më i fortë për të respektuar porosinë.

– Dardana, je mërziur shumë? – e pyeti Rrahimi që mezi po përmbahej për të mos shpërthyer në vaj.

– Mërzitem, por meqë ka shpëtuar xhaxhi Miran, jo edhe aq shumë. Ky do të vazhdojë rrugën e babit dhe të xhaxhallarëve, – u përgjigj ajo duke mbajtur vështrimin keqardhës drejt Miranit.

– Mbylle gojën edepsëze dhe mos të ta dëgjoj më këtë përgjigje! – ulëriti Nuriu, të cilit po i puliteshin sytë nga sikleti që i shkaktoi përgjigjja e Dardanës. Ajo u habit nga kjo ulërimë e tij, por syri nuk i bëri vër. E

vështronte pa lëvizur qepallat, sikur desh t'i thoshte: “Cili je ti që ndër-hyn në mesin tonë në këtë mënyrë kaq vulgare e hileçare!?”.

Mirani, i cili qëlloi pranë, u përmbajt pa shfaqur asnjë reagim, sado që një mendje e urdhëronte që ta nxirrte Nuriun zvarrë përjashta. Vësh-troi Dritën për të hetuar reagimin e saj. Ajo nuk shfaqti ndonjë reagim. Bëri sikur nuk e dëgjo. Drita e thirri me zë të ulët Miranin që të shkonte në kuzhinë.

– Miran, vëllai ynë i dashur, edhe një herë ngushëllimet e mia më të thella për shokët që na lanë!

– Edhe juve ngushëllime dhe shokëve lavdi të përjetshme! Unë sapo erdha nga policia, ku u intervistova. Nuk pata rast të shiheshim për-para...

– Isha në spital, te Jusufi im i shtrenjtë, që nuk e kam më, – ndërhyri Drita.

– Po ndihem krenar për ty që po mbahesh kaq e fortë.

– Jusufi këshillo: “Në shtëpinë tonë të mos derdhë askush lot, pasi kemi rënë për atdheun!” Unë ia dhashë fjalën. Që atëherë jam ngurtë-suar...

– Qofshi të fortë e faqebardhë gjithë jetën! – bekoj Mirani.

– Vëlla Miran, më fal që heshta kur Shoku Nuri i bërtiti ashtu Darda-nës, por nga ai Udhëheqësi në Turqi kam urdhër që Nuriut t'ia besoj drejtimin e ceremonisë mortore në shtëpinë tonë, – sqaroi Drita me zërin që mezi i dëgjohej.

– Domethënë kështu qenka puna! – foli Mirani pa ditur se çfarë duhej t'i thoshte. – Më gjasë mua nuk më paska mbetur vend këtu... – shtoi Mirani duke u përmbajtur që të mos ia rëndonte gjendjen Dritës.

– Mos e thuaj këtë fjalë, të lutem, nga se je në shtëpinë tënde, – sqaroi ajo me keqardhje.

– Do të përpiqem të mos i koris shokët tanë, – tha tjetri me zë të zvargur duke i shtrënguar nofullat, – por edhe atij maskarai duhet t'i tre-

gohet kufiri deri ku mund të harbutërohet.

– Ç’i bëj urdhërit të Shokut Sabit, përndryshe do ta kisha nxjerrë jashtë. Më erdhi rënd kur i bërtiti gocës sime të vetme, që e kam yll. Kurse ty po të lutem si vëllait që të durosh edhe ato që nuk durohen për hirë të shokëve.

Drita nuk mundi të vazhdojë më. Piu një gotë ujë pastaj pyeti:

– Si e kalove në polici?

– Më mori në pyetje vetë kryehetuesi Majer. Krijova përshtypjen sikur nuk janë gjithaq të interesuar për të kryer detyrën siç janë korrekt e preciz gjermanët.

– Edhe unë atë përshtypje kam krijuar që kur u vonuan aq shumë për të ardhur në vend të ngjarjes policia dhe ndihma e shpejt, meqë komshiu u ka telefonuar menjëherë. Mendoj se Jusufi do ta mbijetonte atentatin sikur në spital të mos kishte qenë kujdestar një mjek serb. Ai u tregua tepër neglizhent dhe nuk thirri as përforcime për ndërhyrje serioze që të na e shpëtonte atë.

– Dyshon se edhe ai ka qenë pjesë e kësaj makinerie vrasare? – pyeti Mirani.

– Them se po, meqë Jusufi ishte i fortë. Vetë iu përgjigj policëve, se ishte UDB-ja ajo që i vrau. Pastaj gjatë gjithë rrugës për në spital kemi biseduar. Pos të tjerave më tha: “Nëse dorasit janë shqiptarë, mos u zbulofshin kurrë!”. Më porositi që të kem kujdes për mirërritje dhe mirëdukim patriotik të fëmijëve...

– Atëherë unë paskam gabuar, – e ndërpreu Mirani, meqë ajo po fliste ngadalë dhe nuk e dinte nëse e kishte ndër mend të vazhdonte. – Në polici deponova dyshimin për Rezil Mejtepin si doras, duke ua treguar gjithë veprimtarinë e tij të mëhershme. Kryehetuesi më njoftoi se e kishin lëshuar urdhër-arrestin për të, duke u mbështetur në rastin e kapjes së Rezilit duke vjedhur postën tonë. Edhe skicimi që kishin bërë specialistët i ngjante atij. E kishin punuar në bazë të dëshmisë së komshi-

ut tuaj.

– Nuk di si ta kuptoj thënien e Jusufit: “Nëse dorasit janë shqiptarë, mos u zbulofshin kurrë!”, si amanet apo si dëshirë!?

– As unë nuk po e di edhe pse, sapo më tregove, për këtë po mendohesha. Gjithsesi, nëse duhet vlerësuar si amanet, atëherë unë nuk e kam shkelur, nëse doras është vërtet Rezili, siç po dyshoj unë tani konkretisht dhe nëse e vërteton hetuesia. U tregova gjermanëve para se të informohesha nga ti për dëshirën e Jusufit, e cila tingëllon si porosi ose si amanet.

– Nuk gjykoj dot në këtë gjendje të kobshme nëse ke vepruar drejt.

– Po komshiu a ju tregoi për ato që kishte parë, pasi kryehetuesi nuk më tregoi detaje nga rrëfimi i tij?

– Vetëm ai e ka parë ngjarjen. Në atë kohë kishte qenë duke bërë gjimnastikë në ballkon para se të flinte, meqë e kishte shprehi si mësues i sportit që ishte. Por, shikimin e tij prej rreth njëzetë metrave largësi e kishte penguar errësira, ndriçimi i dobët i vendit dhe sidomos reshja e dëndur e borës.

– Nuk ndihesh e bezdisur nëse më tregon se përse dolën shokët në atë kohë përjashta? – pyeti Mirani.

– Pasi shkuat ju, – filloi Drita, – Jusufi e shoku Kadri u ngjjuan në dhomë të punës. Nuk kanë dalë derisa i kam thirrur të hanë darkë. Jusufi më porosi që ta vonoj darkën. Disa herë kam hyrë sa për t’u çuar çaja, por, siç e di edhe ti, në praninë time nuk flisnin gjë. Në tavolinë kishin fletë shënimesh, por ato tani i ka marrë policia. Rreth orës nëntë kam shtruar darkën. Pas darke shoku Kadri filloi të pinte çaj, siç e kishte shprehi. Jusufi im i dashur i propozoi të shkonin në kabinë telefonike të fshatit për t’i telefonuar shoqes Sarandë. Kadriu iu përgjigj se nuk ishte e domosdoshme. Jusufi këmbënguli se ajo do të shqetësohej për mosshkuarje të Kadriut, meqë ai duhej të dilte në punë në mëngjes. Sa keq që nuk na qëlloi telefoni në shtëpi! Dolën të tre pas orës dhjetë, këtej nga

dera e tarasës që të shkonin më trup te garazhi. Bora binte e dëndur. Ne nuk ditëm gjë. Erdhi komshiu i alarmuar dhe na tregoi. Dolëm. Shokun Kadri e gjetëm të shtrirë në tokë pranë derës se hapur të automobilin, në krahun e djathtë. Fatziu ishte përpjekur të dilte nga makina. Bardhi kishte rënë pa shpirt mbi timon. Jusufi ishte i ulur mbrapa dhe po gjëmonte me zë të përmbajtur. Tina solli një batanije dhe e mbuloi shokun Kadri, meqë mendonte se kishte të ftohtë mbi borë. Unë u ula pranë Jusufit dhe e mbështeta mbi gjoksin tim. Plasa në vaj. Ai më pyeti për shokun Kadri e Bardhin nëse ishin gjallë. Pastaj më tha preraz: “Të mos jua dëgjojë kush vajin sepse e kemi për krenari të flijohemi për Kosovën!” Rreth gjysmë ore u vonuan policia dhe ndihma e shpejtë. Në spital mjeku kujdestar qëllloi serb. U tregua tepër neglizhent. Me vonesë bëri operacionin, pa thirrur ndonjë përforsim. Rreth orës tre të mëngjesit duhet të ketë ndërruar jetë Jusufi...

Drita u ndal për të marrë frymë dhe nxori një ofshamë të thellë.

– Tani ti seriozisht po mendon se kujdestaria e mjekut serb ishte pjesë e skenarit për të realizuar vrasjen, nëse ndokush do t’i shpëtonte atentatit? – ndërhyri Mirani duke menduar se ashtu do t’ia spostonte vëmendjen asaj nga goditja dhe përjetimet kaq të rënda.

– Ashtu mendoj sepse edhe surrati i tij m’u duk serrat kriminel. Neglizhenca e tij më iritoi. Më ka habitur vonesa aq e madhe e ndihmës së shpejtë dhe e policisë, pavarësisht se që kohë shumë e keqe dhe rrugët i kishte zënë bora. Më dukej sikur edhe zoti në ato çaste të kobshme për ne ishte në anën e krimit.

– Uroj të të rritën fëmijët dhe të bëhen siç i dëshironte Jusufi! – foli Mirani me bindjen se po i jepte forcë morale. Drita u përgjegj me një zë që mezi dëgjohej:

– Faleminderit!

Për një çast ra heshtja. Minutë pas minute cingëronte zilja e derës. Nga anë e anës vinin bashkatdhetarë duke ngushëlluar njëri-tjetrin me

shprehjen: “Lavdi!” Drita dhe Mirani vazhdonin të rrinin ulur në kuzhinën e vogël, pa ditur nëse duhej të vazhdonin të rrinin si të nemitur aty apo të dilnin për të pritur njerëzit. Miranit nuk po i dillej, meqë ende nuk i kishte kaluar hidhërimi nga reagimi arrogant i Nuriut. Në këtë gjendje, megjithatë, vendosi ta pyeste Dritën:

– Si mundi të të urdhërojë kaq shpejt ai udhëheqësi nga Turqia, kur ju nuk keni telefon!?

– Ai nuk më telefanoi mua, por kur erdhi Nuriu më tha se e kishte urdhëruar udhëheqësi ynë që ai ta drejtonte ceremoninë mortore derisa të vijë një shok nga Kosova. Pastaj ai do ta zëvendësojë Jusufin. Drita shpjegonte duke i tërhequr fjalët zvarrë ngase po i mungonte vullneti përkatës.

– Po sikur të dalë se Nuri Syleviqi ka gënjyer, të cilin me gjasë ti nuk po e njeh, siç nuk duhet ta njohësh as udhëheqësin Sabit?

– Çka të them unë e shkreta? Jusufi atë kishte udhëheqës, prandaj tani më duhet ta dëgjoj...

– Po nëse del se vërtet Sabiti e ka urdhëruar Qerosin Nuri kaq shpejt pa e njohur ai këtë maskara, atëherë mundet që kemi të bëjmë me diçka krejt tjetër, do të thosha tepër të dyshimtë, sepse për Nuriun kam shfaqur dyshim në polici se ka qenë informator i dorasëve për ardhjen tonë këtu... Mirani u ndal për të hetuar reagimin e Dritës nëse po e kuptonte.

– Të paça vëlla, mos u nxito me të tilla dyshime, pasi unë nuk jam në dijeni të formave tuaja të organizimit dhe nuk jua njoh mirë as bashkëveprimtarët! Ti e di më së miri se sa është rezervuar shoku Jusuf ndaj meje. Më ka angazhuar kryesisht në punë praktike për ta ndihmuar atë, por nuk më ka informuar për çështje të tjera.

– Më fal, më vjen keq, por ne duhet të gjejmë forcë për të përballuar pasojat dhe ndërhyrjet pas këtyre atentateve kaq goditëse për luftën tonë çlirimtare! – tha tjetri.

– Mua më duhet të merrem me rritjen e fëmijëve. Nuk jam e për-

gatitur për t'u ballafaquar me të tilla goditje e pasoja.

– Të kuptoj, por vura re sesi Nuriu tani dhe ndonjëri më vonë nuk do të rezervohen për të keqpërdorur gjendjen tënde.

– Unë do t'i nënshtrohem vendimeve të organizatës, sepse kështu besoj do t'i mbetem besnike shokut tim të jetës.

– Kjo nuk do të thotë që në emër të organizatës të keqpërdoret ajo për të shkatërruar atë që e kemi formuar dje. Nuriu është shëmbulli më skandaloz që është angazhuar kundër të gjithë neve dhe nuk janë të pakët ata që kanë dyshuar se ai është një informator i armikut, i infiltruar në radhët tona.

– Atëherë do të përpiqem të jem më vigjilente ndaj sjelljeve të tij, – tha Drita me një lodhje që nuk jepte asnjë mundësi për të vazhduar diskutimin.

– Do të shohim si do të rrjedhin ngjarjet dhe besoj se një angazhim yti për të përballuar goditjet e tjera që vijnë rëndom pas atentatit politik do të të ndihmojë për të përballuar edhe dhimbjen e madhe dhe vazhdimin me sukses të rrugës së dëshmorëve tanë.

Të dy dolën heshturazi nga kuzhina, sepse Sabrushu dhe gratë e tjera donin të fillonin përgatitjen e ushqimit për njerëzit e shumtë që po vinin nga anët e anëve, nga Gjermania, Zvicëra, Belgjika, Franca e shtete të tjera.

6.

Të mërkurën nga Kosova erdhi Xhalat D., i cili njihet vetëm me emrin Xhafari. Ishte njeriu të cilin me padurim po e prisnin Drita dhe disa të tjerë. Atë po e prisnin që të zinte vendin e Jusufit në organizatë. Ardhja dhe paraqitja e parë e tij qe tepër zhgënjyese, sepse ai stononte gjithanshëm sa të bënte të ndiheshë i neveritur nga paraqitjet e tij, sidomos nga zëri i tij shterrak.

Xhafari, duke qenë i kompleksuar për të metat e tij natyrore, ndjeu

eufori për rolin që po merrte. Parapëlqeu të rrëfente se sa rënd e kishin goditur atentatet e shokëve.

– Isha në ëmbëltore në fillim të shëtitores në Prishtinë, në afërsi të Hotelit *Grand*, – filloi të rrëfente ai me zë të gërvishtur e të shterrur. – Aty po haja akullore. Papritmas erdhi një polic që e njihja dhe më dha lajmin për atentatet. . .

– Si, po haje akullore në mes të janarit në një ëmbëltore në Prishtinë? – ndërhyri i padurueshmi Miran, duke u habitur se si hahej akullorja dhe po mendonte se në kohë të tillë në Prishtinë nuk bëhet fare akullore. Ndaj këtij farë Xhafarit edhe më herët kishte shprehur dyshime, por të përmbajtura meqë akoma nuk e kishte kategorizuar në skedarin e tij as si shërbëtor të UDB-së, as si patriot të vërtetë, siç i kategorizonte ai njerëzit me të cilët kishin të bënin.

Xhafari gjatë vitit 1981 ishte shpesh te Jusufi dhe ishte angazhuar për ta ndihmuar atë në përgatitje të *Zërit të Kosovës*. Pastaj shkante në Kosovë dhe atje nuk i ndodhte asgjë, sado që nuk kishte praktikuar ndonjë konspiracion për të qenë. Dhe tani rrëfente se për atentatin ishte informuar nga një polic duke qenë në një ëmbëltore në Prishtinë. Prej atje vinte pa ndonjë pengesë për të trashëguar vendin e Jusufit, sepse kështu duhej të kishte vendosur udhëheqësi Sabit. Miranin e provokoi mënyra se si e filloi Xhafari fjalën e tij, që më se paku i shkante një trashëgimtari të Jusufit në atë moment, prandaj nuk mundi të përmbahej pa ndërhyrë. Disave, sidomos Nuriut, nuk u pëlqeu ndërhyrja e Miranit, kurse Xhafari ia hedhi një vështrim të egërsuar, por me vetëpërmbajtje për të mos reaguuar hapur aty për aty. Xhafari vazhdoi rrëfimin e tij me zërin që mezi i dilte nga gryka dhe mezi dëgjohej:

– Unë jam i kooptuar nga Udhëheqësi për të drejtuar organizatën në Evropën Perëndimore duke e zënë kështu vendin e shokut Jusuf. Tani e tutje do t'i nënshtroheni udhëheqjes sime...

– Si urdhëroni! – ndërhyri përshejtueshëm Nuriu.

Të tjerë si Hafifi, Fahriu, Nazimi, Naili e Goni, që ishin të painformuar dhe të papërvojë organizative e pa ndonjë përgatitje politike, vetëm po vështronin si të huatuar pa ditur se çfarë qëndrimi duhej të mbanin. Ata po i zgurdullonin sytë të ulur rreth Xhafarit që po u imponohej si udhëheqës në vend të Jusufit, pa qenë në gjendje të vlerësonin se çfarë po nxirrte nga goja ai. Kurse, ujqër të regjur si tullaci Nuriu, Xhehili dhe ndonjë tjetër e dinin se cilin rrol duhej të luanin në kuadër të lëvizjes çlirimtare, pas goditjes së rëndë nga atentatet. Disa punëtorë që nuk po e kuptonin rrjedhën e ngjarjeve, i ishin nënshtruar inercisë. Drita në ato çaste po bisedonte me ca gra, të cilave u tregonte për ngjarjen e kobshme. Ajo nuk po e dëgjonte Xhafarin, po edhe sikur ta dëgjonte, ishte përcaktuar t'i përmbahej hierarkisë organizative që po kurdiste Sabiti nga Stambolli. Ajo po mendonte të nxirrte veten në pah.

– Mos u ngutni! – mori fjalën Mirani pasi nëpër kokë po i kalonin një mori mendimesh, – sepse në orët e fundit para atentatit ndaj dëshmorëve tanë, ne kemi marrë vendime me rëndësi dhe na duhet t'i konkretizojmë pasi të kemi kryer ceremoninë e varrimit..

– Mirë thotë Mirani, - ndërhyri Xhafari hileçar, i frikësuar se po ta lejonte atë, do ndodhte ta komunikonte vendimin, të cilin veç atij nuk e dinte njeri, ndërsa më vete thoshte: “Ç’kërkon këtu ky njeri, tashmë i mundur, të cilit së shpejti do t’ia tregojmë vendin ku e ka.”

7.

Nga mesdita organet përkatëse shtetërore sollën trupat e pajetë të Jusufit, Kadriut e Bardhit të shtrirë në arkivole. I vendosën midis dhome tre heronjtë. U hapen arkivolet që familjarët e shokët t’i shihnin. Fytyrat e tyre ëngjëllore sikur po zbeheshin nga ledhatimet e atyre që s’u takonte të ishin fare aty. Secili sikur po bënte garë për të mos qarë, pasi Jusufi kishte lënë amanet që të mos i qanin. Nënëmadhja Ajshe pyeti:

– Më tregoni, cili është Djali i Nënës, Kadriu, pasi jam plakë e nuk

po shoh mirë? Nëna dëshiron t'i flas së pari atij.

Mirani e mori për krahu dhe e afroi te koka e Kadriut.

– Djali i Nënës! – nisi prajshëm Nënëmadhja, – ti tani vërtet u bërë vëllai i djemve të mi, i bijve të nënës, pasi e dhe jetën bashkë me ta për Kosovën. Nëna nuk të ndan asnjëherë nga djemtë, bir i Nënës! Sa nur i bukur të paska rënë!

Nënëmadhja po ia ledhatonte lehtas faqet dhe u përkul e puthi në ballë. Pastaj me radhë përkëdheli e puthi në ballë Bardhin dhe u ul te koka e Jusufit.

– Bir i Nënës! Sot po më dukesh më i bukur se kurrë, sepse për të vdekur për Kosovën të pata lindur. Shiko, Biri i Nënës! Nuk po të qajnë as fëmijët, pasi duan ta respektojnë amanetin tënd. Të pastë Nëna! E pruar u bëftë Kosova që ka trima si ju!

Nënëmadhja heshti meqë buzët e saj i vendosi mbi ballë të Jusufit dhe të dy duar i mbante mbi faqe të tij. Fjalët prekëse, po nga ato që ishin dëgjuar nga epi legjendar, bënë që të pranishmit të përmbaheshin, edhe pse shpirti përbrenda u ziente për t'u shkrehur në vaj e dënesje. Mirani po shtrëngonte nofullat duke shikuar sa shokët e shtrirë sa Nënëmadhen. Ai po e ndrydhte vajin që e kishte në grykë. Duhej respektuar porosia e Jusufit dhe kërkesat e Nënëmadhes. Pasi i ledhatoi fytyrat e shokëve dhe i puthi në ballë u ngrit dhe po qëndronte pa lëvizur si një statujë.

Pas pak te koka e Jusufit, Kadriut e Bardhit u afrua Xhafari. Mori pozicionin e gatit dhe ngriti grushtin te koka e tij dhe me gjithë fuqinë e zërit, por që mezi e dëgjuan të tjerët, deklaroi:

– Sa të dalë pranvera, me armë në dorë do të dalim maleve dhe do t'ju marrim hakun. Lavdi!

– Lavdi! – thirrën të pranishmit me zë të përmbajtur, pa pasur kohë të mendonin për llafet që kishte thënë Xhafari.

Mirani, që ishte tepër i vëmendshëm për gjithëçka që bënte e thoshte

Xhafari, mendoi me vete: “Si ia futka kot ky satrap!? Kush do të dalë në male në pranverë nëse njerëzit tani po frikësoheshin të vinin për vizitë ngushëlluese?” Nuk i bëhej t’u besonte veshëve se kishte dëgjuar trashëgimtarin politik të Jusufit... U mundua ta zhvendoste vëmendjen por, siç ndodh rëndom, kur nuk e bën zap trurin prapë të ikën mendja: “Sikur më bëjnë mirë shfaqje të tilla prej budallënjve, pasi ma shkundin vëmendjen nga dhimbjet e shkaktuar nga vrasja e shokëve të idealit!”

8.

Si me zor Mirani kishte shtypur e shumëzuar një informatë nekrologjike për Heronjtë e rënë. Kundër kësaj ishin Nuriu dhe disa të tjerë. Por, meqë ata vetë nuk dinin të shkruanin, u detyruan ta pranonin sepse edhe ata mendonin se duhej të kishin diçka të shkruar për t’ua shpërndarë bashkatdhetarëve. Për këtë punë u informa udhëheqësi i ri Xhafar, alias Skënderi, të cilit nuk i erdhi mirë pse e kishte bërë Mirani dhe urdhëroi që herave të tjera gjithëçka duhet të bëhej vetëm me leje të tij. Miranit sesi po i vinte ta kundërshtonte brutalisht, por përmbahej se ishte në ceremoni mortore.

Të enjtën paradite postieri solli një letër rekomande. Drita e mori dhe menjëherë informoi Miranin:

– Vëlla Miran, kjo duhet të jetë letra e fundit që ka shkruar Shoku Jusuf në jetën e tij dhe ta ka dërguar ty rekomande. Meqë ti nuk ke qenë në banesë, ja, u ktheje prapa. Nëse më lejon, dëshiroj ta hap dhe ta lexoj. Po kështu do dëshiroja ta kisha një kopje për kujtim, meqë gjithë të tjerat i ka marrë policia dhe nuk di kur do t’i kthejë!

Të pranishmit në dhomë të ndenjës u befasuan për të mirë, kurse ata që tashmë nuk merakoseshin gjithaq për të kamufluar hilen, zgurdulluan sytë nga smira.

– Dakord. Po prisja që kjo letër do të kthehej këtu, pasi për të më pat

informuar Jusufi. Por, nëse të pritet, dëshiroj ta lexoj njëherë vetë.

Mirani e mori letrën në dorë dhe si të ishte pergamenë e vjetër, e hapi me kujdes. U nis drejt kuzhinës meqë nuk i pëlqente ta vështronin gjithë ato shikime kureshtare e hileçare. Drita i shkoi pas dhe po përcillte lëvizjet e kujdesshme të duarve të Miranit, duke ndier diçka si zili se përse vetëm Mirani kishte tani në duar një letër origjinale të Jusufit. Sapo Mirani e hapi, filloi ta lexonte në heshtje:

I dashur shok Miran!

Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, dubet ta kesh kuptuar që gjaknxehtësinë time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufji. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë mbase nuk kam pasur (...)

E premte, më 15 janar 1982

Jusuf Gërvalla

Mirani nuk e zgjati më tej leximin, meqë pa se po fillonin arsyetimet e Jusufit, të bazuara në hidhërimin e tij ndaj Kadriut. Shikoi Dritën dhe bëri t'ia zgjaste letrën, duke e sqaruar:

– Drita, urdhëro lexoje! Edhe kopje mund të bësh, nëse më premtton se nuk do të flasësh me askënd për përmbajtjen dhe as t'ia japësh ndokujt pa pëlqimin tim. Kjo është letër që Jusufit ma ka dërguar mua dhe prandaj është pronë imja personale. Besoj e kupton, nuk ke përse hynë midis shokëve. Po kërkoj të mos ia japësh askujt, sepse këtu ka pjesë të përmbajtjes, e cila është e kapërcyer, sidomos sa i përket hidhërimit të Jusufit ndaj Kadriut. Kjo do të mund të keqpërdorej po t'u binte në dorë dashakëqinjve. Shumëçka kemi sqaruar në dasmën e Kadriut e Sarandës, gjithëçka sqaruam të dielen në mëngjes, para agimit dhe shumëçka tjetër duhet të kenë sqaruar vetë Jusufi e Kadriu të dielen pasdite. Kurse këtë letër Jusufi e ka shkruar, parandej, të premtën, prandaj përmbajtja e saj është e kapërcyer. Ata kanë vazhduar së bashku të hartonin

e konkretizonin vendimin që morëm për bashkim. Në këtë mision kanë vazhduar të jenë Kadriu bashkë me Jusufin, për të rënë po së bashku në krye të këtij angazhimi.

– Të falenderoj që po ma jep, pasi kjo është vërtet pasuri jotja. Njëherit të falenderoj për besimin që po tregon, sado që nuk pate nevojë të më këshillosh që të mos ia jap askujt. Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush midis jush. Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtar më të afërt se ty.

Dritës i mbaroi fuqia për të vazhduar bisedën, ngriti letren me të dy duart dhe e puthi prajshëm, pastaj e shtrëngoi për gjoks duke përsëritur: – Loçka ime!, dhe doli në drejtim të dhomës së gjumit. Në mbrëmje, pasi e kishte kopjuar, ia ktheu Miranit origjinalin.

9.

Në shtëpi erdhi për një vizitë kryehetuesi Wolfgang Majer (Wofgang Mayer), i shoqëruar me dy hetues të tjerë.

– Jemi për vizitë të shkurtër, për të dëgjuar nga ju, nëse keni ndonjë informatë ose ndonjë shqetësim, – tha ai.

Kur bënë të iknin, Ermiri, djali i vogël i Jusufit, që ishte rreth katër vjeçar, duke mbajtur një revole loje në dorë, iu drejtua Kryehetuesit:

– Më dëgjoni Zotëri! O do zbulosh vrasësit e babit dhe të xhaxhallarëve, o do marrë hak në ty!

Ermiri ishte shumë i zgjuar për moshën që kishte. Fliste rrjedhshëm gjermanisht, reflektonte një simpati të shkëlqyer, gjithnjë i qeshur. Këtë moment ai kishte marrë pamje e qëndrim tepër serioz, pikërisht si një burrë.

Kryehetuesi Majer zuri të qeshte me mendimin se fëmijës duhet bërë qejfin. Por, atij ia ngriu të qeshurën Ermiri:

– Po ta jap besën e shqiptarit, po nuk kapët vrasësit, kam për të marrë

hak ndaj Jush! Këtë merreni seriozisht, pa pasur nevojë të ma bëni qejfin mua, si fëmijë që po më trajtoni!

Kryehetuesit i shkuan mornica nëpër trup e sytë iu mbushën me lot. Nuk mundi të mbante më qëndrim përballës me sytë e Ermirit që nuk po i lëvizte as çepalla. Ai vetëtimthi u drejtua të dilte nga shtëpia. Pas rreth një ore u kthye sërish, por tani, për herë të parë ishte pa shoqërues. Sapo hyri sinjalizoi Miranin t'i shkonte pas në kuzhinë. Mirani nuk po e kuptonte gjestin e tij dhe as përse duhej të shkonte pikërisht në kuzhinë.

– Këtu nuk kemi instaluar përgjues. Mos më keqkuptoni, Zotëri Bruçaj. Ermiri më ka vënë në dilemë të madhe: Të mbaj përgjegjësinë që kam ose të jap dorëheqje. Unë kam udhëzimit nga eproi im që të përqëndrohem në hulumtimin e organizimit dhe veprimtarisë suaj...

Majer ndali fjalinë në gjysmë, sa s'e tha shkoqur se nuk duhej të angazhohej për të zbuluar vrasësit. Mirani e dëgjoi me vëmendje sqarimin e tij. Po mendohej të gjente fjalët që duhej t'i thoshte, pasi paraqitja e tij iu duk tepër njerëzore. Ai po shkonte drejt rrezikimit të karrierës së tij, por edhe më tepër shokante i tingëlloi urdhëri i eprorëve.

– Më kuptoni, zotëri Majer, vërtet nuk kemi çka të fshehim para jush. Gjithë veprimtarinë karshi jush e kemi legale. Të fshehtë e kemi vetëm karshi survejuesve të UDB-së, sepse rrezikojmë bashkatdhetarët. Ju e dini sa bashkatdhetarë janë arrestuar kur kanë shkuar që këtej për pushime në Kosovë dhe akoma më shumë nuk po guxojnë të shkojnë fare. Jam i gatshëm t'ju jap të gjitha shpjegimet që ju interesojnë për veprimtarinë tonë. Sa për kërkesën e Ermirit, po besoj se nuk e keni vlerësuar si kërcënim. Atë nuk e ka mësuar njeri. Ai ka një dhunti natyrore të pje-kurisë së parakohshme, prandaj i ka thënë truri i tij ato që jua tha juve. Ai shfaq atë kërkesë, në dukje kërcënuese, i shtyrë nga tronditja e tij e momentit, por do të bindeni edhe ju se ne nuk jemi hakmarrës, pasi këto janë atentate politike dhe hakmarrja që do të pretendonim është çlirimi i popullit nga ata që kanë dhënë urdhër për këto atentate. Kështu që ne

vetëm luftën çlirimtare të popullit tonë do të mundohemi ta organizojmë, meqë vetëm kështu do të marrim hak për shokët tanë.

– Ju kuptoj, ju kuptoj. I kam parasysh të gjitha. Prandaj po vijmë disa herë në ditë, jo që t’ju shqetësojmë, por të informohemi nëse ndokush ju shqetëson. Jeni të lirë të më telefononi në çdo kohë edhe për dyshimin më të vogël. Do t’ju lutesha të mos e bëni publik urdhërin e eprrorit tim dhe as të mos e komentoni, pasi do të më dëmtoni rënd. Në fund edhe një herë ju shpreh ngushëllime të përzemërta të gjithëve dhe do t’ju lutesha të bisedoni me takt me Ermirin, që ta ndihmoni për ta kapërcyer tronditjen që e ka goditur. Ja edhe këtë çokollatë për të si shënjë e mirëkuptimit tim. Mirupafshim!

Kryehetuesi Mayer gjykoi të mos rrinte më gjatë aty.

– Mirupafshim dhe ju jemi mirënjohës për përkushtimin tuaj njerëzor dhe profesional, – u përgjigj Mirani duke ia zgjatur dorën për t’u përshëndetur. I shtrënguan duart njëri-tjetrit më fortë se çdo herë tjetër. U ndanë. Kryehetuesi doli prajshëm përjashta, ndërsa Mirani e përcolli deri te dera kryesore.

10.

Atmosfera në shtëpi të Familjes Gërvalla është e shumëllojshme. Për të goditurit rënd nga atentatet kjo atmosferë është shumëfish e rënduar. Për “trashëgimtarët” politikë të Jusufit e Bardhit, ishte tepër ngazëllyese si të jetonin në ekstazë. Zgërdhirjet, vetëkënaqësitë dhe vetëbënisjet i kishin të metalta, të përhimta, të uthulluara, sado që përpiqeshin t’i fshihnin. Atentatet e bërë ndaj tre personaliteteve tashmë po jepnin pasojat konkrete në mënyrën më të vrazhdtë. Sjelljet dhe inskenimet e Nuriut, Xhafarit dhe ndonjë tjetri afër tyre, të komanduar nga Sabiti, po rivrisnin shpirtin e atyre që kishin dhimbje të madhe, që qanin e krenoheshin në heshtje. Përditë po ndodhnin atentate ndaj shpirtit të tyre të plagosur. “Trashëgimtarët” vazhdonin të rrinin kokë me kokë, në mënyrë

demonstrative e provokative, duke pëshpëritur se si do të duhej të vinin në skenë prapësitë e tyre të radhës. Nënëmadhja e nemitur neveritej nga sjelljet e tyre. Edhe më shumë neveriteshin Saranda, nusja e Kadriut, Hakani, bashkëvendësi dhe miku i afërt i Kadriut, Mirani, shoku e bashkëveprimtari më i ngushtë i tre personaliteteve, tashmë dëshmorë, që vazhdonin të qëndronin në morgun e spitalit në Hajlbron, në pritje të lejes nga vrasësit jugosllavë për t'u bartur e varrosur në Kosovë. Drita dukej e mpirë dhe e hutuar nga mizanskenat që po i ndodhnin para syve të saj, të kurditura nga “trashëgimtarët” politikë. Ajo ndinte keqardhjet për vjehrrën, për nusen e Kadriut dhe për gjithë të tjerët që vërtet këto vrasje i kishin goditur, por ishte e detyruar t'i përmbahej hierarkisë dhe disiplinës organizative, meqë po synonte të bëhej kuadër në organizatë. Babai i Kadriut mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit. Ndonjëherë, si për inat të “trashëgimtarëve”, bënte shaka në dukje marrashe.

– Isha fare i panjohur, – tha ai kur i kërkuan të fliste. – Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë fajin UDB-së...

Kur e dëgjuan “trashëgimtarët”, gati sa nuk pëlcitën nga inati. Xhafari nuk u përmbajt pa thënë:

– Qenka manjak e i matufosur! Po zëri i tij i gërvishtur nuk i shkoi në vesh Hakanit. Ndërsa Mirani sa nuk u ngrit ta nxirrte atë zvarrë përjashta.

Të goditurit mundoheshin të gjenin ndonjë rast për të ndenjur larg pranisë së “trashëgimtarëve”, por këta shpirtkatranë vigjilonin gjithandej. Nënëmadhja fliste tepër rrallë, më shumë si rrjedhojë e neverisë që po i shkaktonin “trashëgimtarët”, se sa nga goditja. Ajo po mbahej si të ishte Ajkuna e legjendave. Kur gjente ndonjë rast të përshtatshëm, sido-

mos kur aty nuk ishin “trashëgimtarët”, ajo thërriste Miranin pranë saj për të qarë halle, siç bën rëndom nëna me të birin në këso raste të rënda. Ajo i rrëfente për jetën e Jusufit e të Bardhit, për peripecitë e saja jetësore që kur ishte martuar dhe sidomos pasi ia kishin vrarë bashkëshortin, Bardhoshin famëmadh. Rrëfente për meritat e vëllait të saj në Pejë që e kishte rritur e shkolluar Jusufin. Rrëfente për jetën e rëndë të saj dhe të fëmijëve të tjerë në Slloveni, për mallin e madh që ndjente për Jusufin, që e kishte lënë tek i vëllai i saj në Pejë që të shkollohej. Bile, nuk nguronte t’i rrëfente edhe për mërzinë e tmerrin që kishte ndier kur, pas vdekjes së Bardhoshit, e kishin detyruar të martohej me një kushëri të burrit..

Nënëmadhja kishte krijuar besim e konfidencë ndaj Miranit duke u mbështetur në intuitën dhe sensin e saj të rryer jetësor. Ndaj nuk hezitonte që ta pyeste se kush ishin këta të pacipë që ia kishin uzurpuar shtëpinë e bijve të saj. Gjatë këtyre bisedave, si mes nënës e të birit, ajo ia merrte duart Miranit në duart e saja të regjura e të rrudhura. Kështu bëjnë nënën kur ndjejnë dhimbje të madhe për të birin e cflitur. Mirani kursehej t’i rrëfente Nënëmadhës për të gjitha, sepse dronte se mos po ia rëndonte më shumë gjendjen. Nënëmadhja po i lëxonte vetë pothuajse të gjitha prapësitë që inskenonin “trashëgimtarët”. I lexonte ajo në sytë, tkurrjet dhe dronë e fëmijëve të Jusufit, në cflitjen dërrmuese të Miranit, në strukjet e Sarandës, babait të Kadriut, në tërheqjen e nemitur të të resë, Tinës, bashkëshortes engjëll të Bardhit, i cili kishte lindur pasi ia kishin vrarë babain. Prandaj Nënëmadhja e kishte pagëzuar me të njëjtin emër. I vështronte dhe ofshante, por edhe ofshamat i kishte të fshehta. Nuk dëshironte t’i kënaqte “trashëgimtarët” kopukë.

11.

Në fundjavë vërshuan qindra bashkatdhetarë për të shprehur ngushëllimet dhe admirimin për heronjtë. Nuk erdhën sa parashikoheshin,

pasi kishte dalë fjala se në Familje të Gërvallajve ku mbahej ceremonia mortore ishin ca njerëz që mbanin evidencë për vizitorët. Edhe kur nuk i njihnin i pyesnin për emër e mbiemër, për vendlindjen dhe i regjistronin ose i detyronin të shënoheshin në libër të zisë me të dhëna të plota personale. Bashkatdhetarët kishin filluar të frikësoheshin se do ta pësonin kur të shkonin për pushime në Kosovë, prandaj një numër i madh i tyre hezitonin të vinin për vizitë ngushëlluese.

Po në fundjavë erdhën edhe shumë bashkatdhetarë nga Dyzeldorfi e rrethina. Klubi shqiptar *Emin Duraku* kishte organizuar udhëtimin e tyre me autobus. Në fund të vizitës, kryetari i Klubit, Hajzer Lumi, iu drejtua Miranit:

– Urdhëro, merri të hollat që kemi grumbulluar për ndihmë famijeve të shokëve të rënë.

– Të lutem, ua jep grave të shokëve të rënë, sepse do të jetë një përforcim moral për to kjo gatishmëri juaja për t'i ndihmuar.

Pasi i propozoi Hajzerit kështu, Mirani thirri Dritën dhe Sarandën të pranonin ndihmat.

– Ja, këtu i keni ca ndihma simbolike që i grumbulluam për ju shpejt e shpejt, – iu drejtua me dhembshuri kryetari Hajzer, Dritës dhe Sarandës. – Do të grumbullojmë prapë. Mos ngurroni, kërkoni si nga vëllezërit, se çfarë ndihme tjetër ju duhet.

– Ju falenderojmë nga zemra, – i ktheu Drita me zë të ngjirur si e zënë ngusht. – Ju dimë si vëllezër të gjithëve, por mos u harxhoni, sepse secili keni hallet tuaja.

Nuriu po vështronte vëngër e me hatërmbetje se përse nuk po ia dorëzonte Hajzeri atij ndihmat financiare, meqë ai tashmë kishte uzurpuar plotësisht rrolin e bosit. Ai e dinte se Hajzeri ishte bashkëveprimtar i Miranit.

Drita, sapo e pa Nuriun që po shikonte vëngër, menjëherë ia dorëzoi të hollat. Ai ndjeu ekzaltim kur i pranoi të hollat, por nuk u për-

bajt pa shfaqur cinizmin dhe harbutërinë e tij:

– Sa pak paskan grumbulluar, fëlliqanat!

Në buzëmëmbremje të asaj dite, Nuriu mendoj me vete: “Më erdhi në kuti t’ia bëj një kurth Miranit që ta përzëmë që këtej.” Ai mori të hollat që Hajzeri ia kishte dorëzuar Dritës, i futi në pal të jorganit në dhomën që e quanin *dhoma e Miranit*. Jorganin Pastaj Nuriu urdhëroi djelmoshat e rinj të moshës 17 e 19-vjeçare, Gonin e Nailin që t’i shkonin prapa. U ngjit shkallëve drejt dhomës së Miranit. Kur hynë brenda, mbylli me kujdes dhomën, sikur kishte të bisedonte me ta diç tepër serioze. I urdhëroi të uleshin në dyshek. Me djallëzi bëri sikur dëshironte t’i rehatonte duke ua vënë jorganin që ata të mos mbështeteshin në mur. Kapi jorganin shkujdesshëm dhe sapo e ngriti, nga palët e tij ra grumbulli i markave. U shtir si i befasuar.

– O bobo, ç’janë këto të holla këtu, në dhomë të hajdutit Mirani!? I paska fshehur në palë të jorganit të tij!

Naili dhe Goni, të papërvojë, zgurdulluan sytë kur panë të hollat që pikuan nga pala e jorganit.

– Baci Nuri, – iu drejtuar Goni i shqetësuar, – kush i paska fshehur aty!?

– E thashë, Miran hajduti, – tha tjetri që po shtrej sikur po befasohej. – Kjo dhomë dhe ky shtrat janë të Miranit. Në këtë shtrat fle vetëm ai. Po si ia kanë dorëzuar këto të holla? – i shikoi dhe nuk nguroi të konstatonte sikur fliste me vete: – Po këto që kanë sjellë bashkatdhetarët e Dyzeldorfit qenkan! I ka fshehur këtu për të ikur me këto të holla kur do të errësohet. Paska dashur t’i vjedhë!

– Ruajna zot, edhe kjo na ka munguar! – thirri Naili i befasuar dhe i egërsuar.

– Mirë të na e bëjë, meqë e tolerojmë atë kriminel të na sillt këtu nëpër këmbë! – thirri Nuriu.

– Patjetër do ta përzëmë dhe them se është pak ta përzëmë. – shtoi

Naili.

Nuriu po e vështronte dibranin Goni, duke i lënë atij të kuptonte se e kishte radhën për t'u pozicionuar. Por Goni u përmbajt, ndoshta jo vetëm për shkak se ndinte admirim të madh për Miranin. Atë e karakterizonte vetëpërmbajtja dhe një inteligjencë e theksuar për moshën prej 18-vjeçari. Kishte kohë që ishte tërhequr në vete, meqë shumë paraqitje, sidomos të Nuriut e Xhafarit, e neverisnin. Por, as ndaj tyre nuk reagoonte. Nuriu grumbulloi të hollat, i shtrëngoi në grusht dhe pastaj, duke dalë nga dhoma, i futi me kujdes në xhepin e brendshëm të xhaketës. Këtë veprim e shoqëroi me të folur, gjoja vetëmevete:

– Këtu jeni të sigurt nga ai hajdut!

– Baca Nuri, harrove për çka na thirre, – iu drejtua Goni.

– Djali i Bacës, nuk harrova, por është bërë e tepërt të flitet. Pikërisht për të biseduar për sjelljet prej kriminelit të hajduti Miran ju thirra. Tani e patë vetë dhe mendoj se është e tepërt të bisedojmë vetëm ne. Më vonë do ta thërrasim një mbledhje të celulës, ku do të diskutojmë e do të marrim vendime.

Pa mbaruar mirë fjalët, Nuriu doli duke përplasur derën me hidhërim të shpifur. Naili e Goni mbetën ulur dhe po shikonin njëri-tjetrin.

– Nail, vërtet duhet ta ketë bërë këtë axha Miran!? – iu drejtua Goni.

– Edhe po dyshon, more hajvan. Kjo është dhoma e Miranit, ky është shtrati i tij. Baca Nuri e njeh prej kohëve Miranin, prandaj kishte ndërmend të bisedonte me ne për keqsjelljet e tij. Tani Miranin e kapëm me pelë për dore, siç shprehet populli.

– Po përse na thirri për bisedë pikërisht neve më të rinjve nga të gjithë shokët? – pyeti tjetri me habi.

– Sepse na do si të na kishte djem të tij dhe ne po na vlerëson më së shumti.

– Ose sepse do të na keqpërdorë, – ndërhyri Goni. – Nuk më duket edhe aq burrë i ndershëm. Shumë sjellje të tij po më neverisin.

– Mos ia le seri, shoku Gon! Për mua nuk ka vend për dyshim. Miranin i ka fshehur të hollat në palë të jorganit të tij që t'i merrte sapo të errësohej dhe të ikte që këtej.

– Atëherë po dalim nga kjo dhomë dhe po e vrojtojmë Miranin nëse do të vijë këtu për t'i marrë të hollat. Nëse e zëmë në vepër unë do ta godas me thikë. Por, kujdes, të mos na hetojë.

Agroni dhe Naili dolën ngadalë nga dhoma. U ndanë për të mos zbritur së bashku shkallëve dhe pastaj në dhomë të ndenjës u ulën larg njëri-tjetrit. Miranin e gjeten të ulur afër babait të Kadriut.

Nuriu iu afrua Xhafarit që po rrinte ulur në kënd të dhomës. I tha me zë të ulët:

– Shoku Skënder, po të thërrasin përjashta.

Xhafari menjëherë u ngrit. Dolën së bashku përjashta që të mos i dëgjonte njeri.

– Shoku Skënder, të thirra për të njoftuar se Miran kriminelin e zëmë në flagrancë. Qetë-qetë po i tregonte për rastin që kishte sajuar dhe në fund i propozoi: – Të thërrasim më vonë, kur të shkojnë vizitorët, një mbledhje të celulës.

– Të cilës celule? – e pyeti Xhafari.

– Celulën se organizatës sonë, – u përgjigj Qerosi Nuri.

– I paskeni ndryshuar emërtimet e hallkave të organizimit? Përpara flitej për komitete.

– Edhe ashtu e thërrasim, por mua më pëlqen më shumë emërtimi celule dhe në një bisedë me udhëheqësin tonë të lavdishëm, shokun Jusuf, këtë emërtim e pata propozuar dhe ai më qe përgjigjur: “Shoku Nuri, vendos vetë, pasi ti do të bëhesh kryetar i organizimit të bashkatdhetarëve patriotë të rrethit të Shtutgartit.”

– Atëherë, informoji vetëm anëtarët e kësaj celule, siç po e quan ti, që të takohemi në orën 22.00. Por, mos harro të më prezentosh si kryetar të komitetit të organizatës për Gjermani, pasi në këtë post më

ka kooptuar Kryetari i Organizatës sonë.

– E ke fjalën për Shokun Sabit Katunriu që gjendet në Turqi? – pyeti Nuriu duke dëshiruar t’i tregonte se kishte vënë lidhje të drejtpërdrejta me të.

– E njihke Shokun Sabit? – pyeti me habi tjetri duke e ndalur të ecurit e ngadalshëm për t’u drejtuar nga Nuriu që ta shihte në fytyrë.

– Si jo, më ka telefonuar të hënën në mëngjes dhe më ka urdhëruar që ta drejtoj ceremoninë mortore, derisa të vije ti nga Kosova.

– Nga e gjetë lidhjen? – pyeti Xhafari.

– Menjëherë pas takimit të tetorit, kur Kadriu sabotoi bashkimin. Që atëherë më telefonon rregullisht për t’i raportuar për veprimtarinë tonë. Njëherit më ka udhëzuar çfarë duhet të bëj. – u përgjigj Nuriu me vetëkënaqësi se kishte gjetur mënyrën për të reklamuar e imponuar veten para udhëheqësit Skënder.

– Në rregull, po më gëzon fakti se do të bashkëpunoj me një kuadër të devotshëm, meqë njerëzit që kontakton drejtpërsëdrejti Kryetari ynë janë sagllam. Atëherë, siç e lamë, thirri shokët që të mbajmë mbledhjet!

– Besoj nuk kam nevojë ta them se duhet të tregohemi revolucionarë gjatë marrjes së vendimit për Miran kriminelin, i cili na është bërë the rrë në këtë ceremoni mortore. Për këtë i kam telefonuar sot Shokut Sabit dhe ai ka miratuar idenë time, duke më këshilluar që të tregohemi vigjilentë, pasi ai kishte të dhëna se Mirani është i rrezikshëm.

12.

Mirani gjatë gjithë kohës nuk lëvizi nga vendi, me përjashtim të një rasti kur shkoi deri në kuzhinë për të pyetur kunatën, Sabrushin dhe Vesmirën, nëse e kishin përgatitur darkën. Në fakt, Mirani ndinte keqardhje për to, sepse ato nuk po i lodhte angazhimi i madh për të përgatitur ushqimin për shumë njerëz që vinin dhe për bjerrakohës që rrinin aty sa për t’u ushqyer e për të bërë prapësira, por më shumë i lodhnin

prapësitë që po i vërenin. U dhimbsej sidomos Nëna Ajshe, Saranda, Tina dhe Mirani. Njëherë i thanë Miranit se do të iknin, pasi nuk po mund ta përballonin gjendjen, por ai i këshilloi të qëndronin dhe të duronin, për hirë të shokëve të rënë, të Nënëmadhes dhe të tjerëve që vrasjet i kishin goditur rëndë, por edhe për inat të keqbërësve. Dhe ato e dëgjuan meqë e donin si ta kishin vëlla e shkuar vëllait.

Sapo qe ngritur Mirani, Naili e Goni u shikuar mes vete, u ngritën pa rënë në sy për t'i shkruar prapa. Kur Mirani u fut në kuzhinë, ata, për të mos rënë në sy, bënë sikur ishin ngritur për t'u marrë me përgatitje të tavolinës së ushqimit që ishte afër derës së kuzhinës, në aneksin e dhomës së ndenjës. Mirani u kishte thënë Sabrushit e Vesmirës që të fillonin ta shtronin darkën, pastaj ishte kthyer sërish në vendin ku kishte qëndruar i ulur më parë. Naili e Goni u panë sërish mes tyre dhe mbetën afër tavolinë, tani duke u marrë me shtrimin e saj për ta bërë gati që të darkonin të pranishmit sipas radhës, së pari ata që ishin më të moshuar. Ata po habiteshin se përse Mirani nuk po shkonte në dhomën e tij, meqë ishte bërë natë dhe, sipas Nuriut, ai duhej të ngjitej lart, t'i merrte të hollat dhe të ikte që andej.

Kur u krye darka pjesa më e madhe e njerëzve u shpërndanë. Ata që gjendeshin në afërsi merrnin me vete mysafirë, njerëz të ardhura nga anë të largëta të Gjermanisë dhe nga shtete të tjera, por që dëshironin të ishin sërish nesër aty. Disa të tjerë nuk po iknin si herave të tjera. Kjo i bëri përshtypje Miranit. Në orën dhjetë disa bashaktdhetarë të rrethinës së Shtutgartit u ngjitën lart në dhomë të Miranit, për të mbajtur mbledhje. Përzgjedhjen e tyre e kishte bërë Nuriu. Merrnin pjesë vetë Nuriu e Xhafari, Fahriu, Nazimi, Shabani, Hafifi, Faziti, Naili dhe Goni. Nuriu e hapi mbledhjen:

– Po e hap mbledhjen e celulës së Shtutgartit me rrethinë. Në mbledhje na nderon me prezencë të tij shoku Skënder, udhëheqësi i Komitetit për Gjermani, i të cilin na e ka dërguar Kryetari i Organizatës sonë

nga Kosova.

– Me falni, unë po dal jashtë, pasi nuk jam anëtar i kurrëfarë celule, – ndërhyri Goni që ishte më i riu nga të gjithë, por edhe më i zgjuari.

Për Xhafarin asnjëri nuk dinte se cili ishte ai në të vërtetë. Të gjithë u panë me njëri-tjetrin. Reagan edhe Nazimi e Fahriu. As ata nuk ishin anëtarë të një celule, kryetar i së cilës na qenkësh Nuriu. Duke e parë gjendjen, ndërhyri Xhafari:

– Shokë, ndoshta nuk diti të shprehet shoku Nuri, por unë i thashë që të thërrasë shokët veprimtarë të rrethinës së Shtutgartit që të takohemi për të biseduar për gjendjen dhe për detyrat që na dalin. Dhe, meqë është takim i lirë, mund të propozoni secili se çfarë do të bisedojmë, që të kemi kështu një rend për diskutim.

Goni, meqë ishte ngritur për të dalë, u ul sërisht duke thënë:

– Meqë është takim i lirë po rri nëse mendoni se ju duhem gjë, përndryshe shkoj, sepse unë nuk i takoj këtij rrethi. Kam ardhur vetëm për ca ditë, derisa të më vijnë dokumentet që të shkoj te kushërinjtë në Amerikë. Dhe, nëse mund të asistoj unë, pse të mos asistojnë edhe të tjerë bashkatdhetarë që i lamë poshtë, e që sigurisht janë më të merituar se unë për të asistuar në këtë takim të lirë.

Nuriu, duke ndier rrezikun se mos po fillonte një diskutim që mund t'ia prishte planin, menjëherë e mori fjalën:

– Shoku Kryetar, – nisi ai duke iu drejtuar Xhafarit, – të propozova që të mbajmë këtë takim, sepse para katër orëve zbuluam një hajdut që kishte ndërmend të vidhte të hollat që kanë dhuruar bashkatdhetarët e Klubit *Emin Duraku* për familjet e dëshmorëve. Prandaj e lus Nailin të na rrëfejë se si është zbuluar hajduti.

Nuriu u ngut t'ia jepte fjalën Nailit, ngase nuk ishte i sigurt se mos po degjeneronte tubimi në diskutimet për përmbajtje të tubimit dhe për kompetencën e tij.

– Trego vetë, Baca Nuri! – u përgjigj Naili.

– Fol ti Shoku Nail, pasi të gjithë të njohin se je djali i shokut Isfort, i cili ishte shok i ngushtë i dëshmorit Jusuf, – iu drejtua Nuriu marifetshëm Nailit.

– Atëherë po flas, meqë nuk po më pritet, sepse na ka ndodhur një turp i rëndë..

– Prit një herë shoku Nail, pasi këtu duhet të jetë Axhi Miran! – ndërhyri Goni.

– Xhafari urdhëroi Hafifin të zbriste poshtë ta thërriste Miranin.

Mirani bëri të zinte një vend në radhët e të pranishmëve, të cilët ishin ulur duke u mbështetur për muri, por Xhafari i bëri me shenjë të ulej përballë.

– Të ulëm përballë të gjithëve!? Se mos keni ndërmend të më bëni ndonjë gjyq, – u shpreh me të tallur Mirani.

– Zër vendin ku të caktohet! – urdhëroi preras Xhafari me zë të gërvishtur.

– Kush je ti të më urdhërosh mua? Më sqaro, përndryshe të nxora përjashta! Këtu je në dhomën time! – ia ktheu preras dhe duke shtrënguar nofullat Mirani, meqë gjatë gjithë kohës po ruante një urrejtje të theksuar ndaj Xhafarit.

– Shoku Miran, ulu të lutëm, se shokë jemi dhe të dëgjojmë çfarë ka për të na thënë ky jabanxhiu që ende nuk po e njohim, – iu drejtua Fahriu.

– Atëherë po ulem, por të keni kujdes në sjellje, sepse ka rrezik të zbrazët kupa që është mbushur! – bubulloi Mirani.

– Ky është kërcënim, – u përgjigj Xhafari.

– Si ta marrësh, nëse të shkon për shtati, ta mbash me shëndet! – ia ktheu Mirani.

– Ju lutemi, lerini grindjet se mjaft na ka goditur armiku, përndryshe po çohemi! – foli Shabani.

– Fol Nail, se ti e kishe fjalën! – iu drejtua Nuriu.

– Shokë, sot kemi zbuluar një krim të rëndë që e ka bërë ky farë kapadaiu që po na shet tani këtu trimëri, por që nuk i frikësohemi fare. – Nisi fjalën Naili me zë më të ngritur seç e kishte shtatin duke drejtuar shikimin drejt Miranit. – Rreth orës gjashtë, para katër orëve, Baca Nuri na thirri në këtë dhomë mua dhe Gonin për të biseduar. Ai kapi jorganin për të na e vënë pas shpine mua dhe Gonit, që të mos mbështeteshim në mur. Kur e ngriti jorganin, nga palët e tij ra dëngu i të hollave që bashkatdhetarët e Klubit *Emin Duraku* ia kishin dorëzuar atij që t’ua përcillte familjeve të dëshmorëve. Bashkatdhetarët e atij Klubi nuk e dinin se kompetent për të pranuar të hollat është caktuar vetëm Baca Nuri, kurse ky hajdut qëllimisht nuk u ka treguar, se nuk është kompetent për të pranuar ndihma financiare. Kjo dhomë është e këtij kapadaiu, ky shtrat dhe jorgani gjithashtu. Ai, në vend që ato të holla t’ia dorëzonte Bacit Nuri, i ka fshehur në palë të këtij jorganit këtu, që t’i vjedhë më vonë. Kaq kisha, urdhëroni e gjykojeni.

Në dhomë u dëgjuan ca klithma habie. Të gjithë ia kishin drejtuar shikimin Miranit, ca me keqardhe pasi e njihnin si shok prej kohësh, kurse ca me inat. Edhe Mirani po e përballonte shikimin e tyre duke i shikuar me radhë.

– Meqë po insistohet të më bëhet gjyq i montuar, të paktën do të më lejohet të flas për t’u mbrojtur, para se të shqiptohet dënimi... – nisi fjalën e tij Mirani me qetësi të habitshme.

– Edhe ke fytyrë të mbrohesh? – ndërhyri Xhafari.

– Mos më ndërhyr mor fytyrë bajgë, se nuk të kërkova ty leje të flas!

– Vazhdoi fjalën Mirani duke shprehur kërcënimin drejt Xhafarit. – Po flas vetëm për hirë të disa shokëve që njihemi një kohë të gjatë. Prandaj, kini durim e më dëgjoni.

E para, sot nuk i kam pranuar unë të hollat e askujt. Të hollat e bashkatdhetarëve të Dyzeldorfit, kryetari Hajzer ia ka dorëzuar Dritës dhe ajo pastaj ia ka dorëzuar këtij farë Nuriut, që ju po i thoni baca dhe

shoku Nuri. Për këtë le të thirret të dëshmojë vetë Drita.

E dyta, Nuriu i ka futur vetë ato të holla në palë të jorganit tim dhe pastaj ka thirrur Nailin e Gonin, gjoja për të biseduar me ta në këtë dhomë, me bindjen se të dy respektohen si djemë të padjallëzuar dhe si trimma adoloshentë. Kur i ka urdhëruar të ulën, Nuriu, gjoja për respekt ndaj tyre, ka kapur jorganin që t'ua qes atyre prapa shpine që të mos mbeshtetën në mur. Por, nuk e ka kapur të paluar siç do të duhej, por për një cepi që të bien të hollat nga pala e tij, ku i ka futur vetë ky dinak. Dhe, natyrisht, duhet të ketë bërë koment: “E shihi djema, këto janë të hollat që bashkatdhetarët e Dyzeldorfit ia kanë dorëzuar Miranit. Ai i ka fshehur në palë të jorganit të tij që t'i vjedhë kur të bëhet terr.” Tani Qerosi maskara e dinak, kur keni ardhur këtu për të më bërë gjyq të montuar, jorganin nuk ia ka dhënë askujt, por e ka mbajtur për vete që të mbështetet, i kënaqur se ka kurdisur skenar të zgjuar. Kaq sa për fillim, pastaj varet nga biseda. Shoku Fahri, shko thirrë Dritën të dëshmojë për të hollat e bashkatdhetarëve të Dyzeldorfit.

Fahriu u ngrit menjëherë, i gëzuar se shoku i tij i kahmotshëm, Mirani, po mbrohej logjikshëm. Xhafarit iu nxiros akoma më shumë fytyra e tij bajgë, ndërsa Nuriut po i lëviznin sytë sa andej këndeje dhe kishte filluar së dridhuri. Heshtja ishte e rëndë tunxh. Të gjithë, herë shikonin Mirani e herë nga dera kur do të vinte Drita. Xhafari e Nuriu ulën sytë përtokë, meqë e dinin se do t'u zbulohet komploti. Goni ishte skuqur dhe vetëm herë pas here ia hedhte sytë Miranit.

– Vëllezër ju paça, mos më bezdisni për të marrë pjesë në bisedimet tuaja, pasi jam e dërrmuar nga mërzia e lodhja, – u drejtua përgjërueshëm Drita, sapo u paraqit në derë.

– Na fal, nuk të thirrëm për të marrë pjesë në këto bisedime, por vetëm të na tregosh se kujt ia dorëzuan të hollat bashkatdhetarët e Klubit *Emin Duraku*, pasi na ka lindur një keqkuptim i vogël, – iu drejtua Mirani.

– Po ti vëlla Miran e di. Kryetari i Klubit t’i zgjati ty. Ti i the që është me njerëzore t’ua dorëzosh bashkëshorteve të shokëve. Pastaj Kryetari i Klubit m’i dorëzoi mua. Ato menjëherë ia dhashë në dorë shokut Nuri, duke e porositur që t’i regjistronte si ndihma nga Klubi shqiptar *Emin Duraku*. A është kështu shoku Nuri? – pyeti Drita. Nuriu kishte ulur kokën dhe nuk po i bëhej ta ngriste, meqë e kishte futur ngusht. – Përse nuk po përgjigjesh, shoku Nuri? Aman, më tregoni çfarë po ndodh këtu! Mos na bëni kahre, se mjaft na ka goditur Serbia! – përfundoi përgjërueshëm Drita.

– Të lutem, na fal se të shqetësuam, kaq patëm! – iu drejtua Mirani.

Drita mbeti mbështetur në derë duke vështruar pjesëmarrësit e tubimit, të cilët, kush duke e shikuar atë me dhëmshuri, kush duke mbajtur kokën poshtë, po heshtnin.

– Shojja Drita, kemi urdhër nga udhëheqsi i Organizatës për ta përzënë Miranin që këtej, meqë është element destruktiv, – iu drejtua me zë, të cilin pos që e kishte të gërvishtur e të shterrur nga natyra, tani po i përdridhej nga frika dhe mezi po kuptohej.

– Të lutëm, shoku Skënder, mos na turpëroni. Miranin e kam në vend të vëllait. Këtu ku jeni, i kemi thënë dhe do t’i themi dhoma e Miranit. Ka qenë shoku e bashkëpunëtori më i ngushtë i Jusufit, prandaj mos bëni gabime që do të na turpërojnë.

Pasi shqiptoi këto fjalë duke iu dridhur zëri gati si në vaj, Drita u largua. Për një çast ra heshtje e rëndë.

– Ti, komplotist mashtrues, deshe të më shpërdorosh duke më marrë në qafë e duke me turpëruar për jetë të jetëve? – Iu drejtua kërcënueshëm Goni Nuriut, i cili po vazhdonte të mbante kokën ulur. – Urdhëro, jep tani sqarime! Përndryshe...

– Do të kalojmë në një pikë tjetër... – e ndërpreu Xhafari Gonin, me taktikë që të kapërcente këtë zënkë, meqë u kuptua se Nuriu u zbulua katërcipërisht si inskenues i këtij komploti.

– Prit zotërrote, se nuk mund të kalosh kaq lehtë në pikë tjetër, pasi kjo pikë që po provon ta kapërcesh duhet t'i bie dikujt në kokë, apo ndoshta je edhe ti bashkëkomplotistë!? – iu drejtua vendosmërisht Mirani Xhafarit.

– Në praninë tënde nuk kemi pse të diskutojmë më për këtë pikë. Ti dëgjove vendimin e Organizatës sonë, prandaj mund të na lirosh tubimin, – u përgjigj Xhafari.

– Unë zotërrote nuk do të dal, sepse kësaj dhome i thonë akoma *dhoma e Miranit*. Dhe, dëgjo mirë, do t'ju duroj derisa të kryhet varrimi, pastaj do të flasim siç do ta meritoni. Kurse sa për atë vendim, nëse vërtet nuk është marrë nga ti, u thuaj urdhërdhënësve të shkojnë në pidh të samës bashkë me ty dhe ata që të mbështesin ty, mor surrat kriminel! Mos u bëni kaq të pacipë duke keqpërdorur gjendjen e morrit që e kemi!

Mirani mori frymë thellë për të pritur reagimin. Kishte frikë mos po e humbiste durimin, pasi ishte bindur se shtabi i UDB-së që kishte urdhëruar atentatet, tani kishte dhënë urdhër që të provokohej Mirani për të bërë ndonjë hata ndaj provokuesve.

– Jo vetëm ti, por as ajo kurva, që ju po i thoni Bule, nuk jeni të dëshiruar të qëndroni më këtu, – foli Xhafari.

Të gjithë të pranishmit hapen sytë në drejtim të Xhafarit, pos Nuriut që vazhdonte të mbante kokën ulur, pothuajse midis këmbëve. Sikur pjesëmarrësit nuk po u zënin besë veshëve çfarë dëgjuan.

– Përse është kurvë bashkëshortja e nderuar e Kadriut? – ia drejtoi Mirani Xhafarit, duke ruajtur qetësinë e jashtme, të cilën përbrenda pothuajse e kishte humbur. Sa s'po eksplodonte.

– Ajo kurvë e dërguar nga UDB-ja i ka qitur shokët në pritë, – u përgjigj Xhafari, që po ngjante me shumë në një kërmë se sa në njeri.

– Pa na e zbërthe edhe këtë komplot, se si i keni sajuar detajet!?

– Nuk jam këtu para UDB-së që të përgjigjem në pyetjet e tua, – tha

Xhafari.

– Mor kriminel i dërguar, do të sqarosh apo do të ta dredh qafën si të gjelit!? – e kërcënoi Mirani, i cili po shtrëngohej për t'ia mbërthyer fytin. Tashmë Mirani kishte fituar siguri se pos ndërhyrjes për t'i ndarë nuk do t'i hidhëshin të tjerët.

– Dihet, – nisi të përgjigjet Xhafari, që kishte humbur davanë, – Kadriu ka lënë orarin kur do t'i telefonojë kurvës së tij. Ajo ka informuar vrasësit për orar dhe pastaj vrasësit kanë zënë pritë.

– Dëgjo, kriminel i shpifur, po flas për hirë të pjesëmarrësve të tjerë, të cilët i ke mashtruar duke uzurpuar rrolin prej trashëgimtari të Jusufit, përndryshe me ty do të kisha komunikuar ndryshe, – nisi fjalën e tij Mirani i cili u ndal për të hetuar mendimet e pjesëmarrësve. – E para, ti nuk duhet të ofendosh dëshmorët tanë duke i quajtur shokë, pasi ata nuk kanë qenë asnjëherë shokët e tu. E dyta, Kadriu i ka telefonuar Bulës për herë të fundit të shtunën në mesditë nga Düsseldorf. Kemi udhëtuar me automobil te banesa e Murtez Kryebardhit, ku kanë qenë duke pritur Jusufi, Bardhi dhe disa që janë këtu e të tjerë që nuk janë këtu. Nga banesa e Murtezit, ku kemi ndejur deri pas mesnate, Kadriu nuk ka telefonuar. Meqë aty e prishi ndejën ky komplotisti që nuk po ka fytyrë ta ngre më kokën (Mirani drejtoi gishtin drejt Nuriut), kemi udhëtuar me dy makina nga Bernhauzeni deri këtu. Këtu nuk ka pas telefon. Kadriu, normalisht, është dashur të ishte në Zvicër të dielen në mbrëmje, pasi të hënën në mëngjes është dashur të dalë në punë. Meqë kanë vendosur ta konkretizojnë vendimin që morëm për bashkim, ka anuluar udhëtimin. Nga që nuk kanë pasur telefon në shtëpi, siç ka informuar Drita, me insistim të Jusufit kanë vendosur të shkojnë në kabinë telefonike të fshatit për ta informuar shoqen Sarandë për mosshkuarje të Kadriut. Si jua thotë truri, sa është logjike që burri t'i tregojë gruas se në cilën orë fikse do t'ia bëjë telefonatën tjetër, kur telefonin e kanë në banesë të tyre? Ja, mor kriminel, sa primitiv të doli edhe ky skenar që keni sajuar për të

bërë atentat moral e politik ndaj shokëve që e pësuan me jetë të tyre në atentatet fizike dhe jo vetëm ndaj tre shokëve, tashmë heronj kombëtarë, por edhe ndaj pasuesve të tyre të vërtetë. Pastaj, ti mor fytyrë bajge e tharë, ke akuzuar Kadriun se ka faj në këtë vrasje, pse ai ka ardhur këtu. Këtë fajësim ia ke shfaqur disave që janë këtu dhe kanë kurajo të dëshmojnë tani, po që nevoja. Po të logjikoja me mendësinë tënde perverse, atëherë do duhej fajësuar Jusufin, pse na ka ftuar dhe Kadriu është vrarë në bukë të tij. Mjaft me këto krime tuat se të bëjë që të mos ketë mundësi të të lajë as hoxha! Tani këtë lloj takimi e shpall të mbyllur dhe ti, kriminel, dhe Nuriu maskara m'u shporrni nga sytë se do t'ju nxjerr zvarrë nga dhoma ime! Po ua tërheq edhe një herë vërejtjen, që të mos ofendoni e provokoni derisa ta kemi bërë varrimin.

– As Jusufi nuk të ka pasë shok e as bashkëveprimtar ty, siç më kanë informuar shokët. Bile pat ndërprerë marrëdhëniet me ty, por kur ai të përzinte nga dera, ti i hyje me zor nga dritarja, siç po vepron tani, pasi nuk po respekton vendimin e Organizatës sonë që të ikesh prej këtu! – Iu kundërvu Xhafari me mendim se kishte gjetur argument të fortë për t'ju kundërvënë suksesshëm Miranit.

– Edhe këto spekulime i keni përtypur dhe jam i informuar. Mund që Jusufi nuk më ka ndier për shok dhe ajo ka qenë e drejta e tij. Mua nuk më ka interesuar shumë të gjurmoj këtë ndjesi konkrete të tij. Më ka mjaftuar ndjesia ime ndaj tij dhe bashkëpunimi ynë i ngushtë. Unë atë e kam ndier për shok. Mendoj se nuk mund ta çmosh për shok dike që nuk e ndjen, gjegjësisht që nuk të jep dashuri reciproke shoqërore. Por, e gjithë kjo nuk ka rëndësi për momentin. Ne na kanë njohur e lidhur angazhimi ynë patriotik. Unë nuk e kam filluar veprimtarinë patriotike pasi jam njohur me Jusufin dhe për hatër të Jusufit, por pse të tillë ndërjegje kam pasë. Sigurisht as ai. Keqkuptimet e rastit dhe ndërprerjet e bashkëpunimit kanë qenë në natyrë të punës, pasi ne nuk kemi pasur mendësi moniste, që njëri-tjetrit vetëm t'ia miratonim mendimet,

propozimet e veprimet, siç ndodh në organizimet homogjene, njëmendësore, që është karektistikë e sekteve dhe e partive komuniste, të cilat ndrydhn pluralizmin e mendimit. Se nuk ka pasur bashkëveprimtarë dhe bashkëpunëtorë me të ngushtë se mua, që kur ai është detyruar të arratiset, këtë mund ta dëshmojnë disa të pranishëm këtu, që i kemi pasë bashkëveprimtarë që në fillim. Sigurisht, nuk po e mendoj Qeros maskarain, i cili na është qasur me hile, fillimisht mua, por e refuzova, pastaj Jusufit. Ai e qasi këtë farë satrapi në mungesë të përvojës praktike politike e organizative dhe në mungesë të përvojës për të njohur informatorët e UDB-së. Dhe, si rrjedhojë e dezinformimeve që i bënin kategoria e këtij dhe jotja, ka ndodhur që ai të më keqkuptojë dhe të ndër-presë bashkëpunimin përkohësisht, por sërish i kemi rikthyer marrëdhëniet e ngushta, kur jemi sqaruar se të tretët po na përçajnë. Kështu i ndodhi edhe me Kadriun, për shkak të Rrobaqepës anadollakut, të cilin ju po e fryni si Kryetar të Organizatës suaj. Por, ja që ne u sqaruar për një mori të inflituarish, prandaj Jusufi na thirri që të takohemi të shtunën dhe të marrim vendime, për të cilat ti, soji dhe seymenët tu, as që dëshironi të informoheni, e lëre më t'i respektoni. Zaten, kjo ka qenë arsyeja kryesore për atentatet ndaj shokëve, tashmë dëshmorë, që të pasojnë me këto atentate që po bëni tani ti dhe Rrobaqepësi me seymenë të komanduar e të mashtruar, gjoja në emër të organizatës që e udhëhiqni, por që nuk po duket gjëkund se ekziston. Dhe kam parandjeje se do të bëni atentate edhe më të rënda, pasi UDB-ja do t'ju dërgojë përforcime.

Besoje se të shpjegova mjaft, nëse dëshiron të kuptosh. Urdhëro, po pate fytyrë të flasësh! – iu drejtua Mirani Xhafarit, i cili kishte ulur kokën pothuajse deri të herdhët.

– O unë, o ti, në këtë shtëpi! – pëshpëriti duke u ngritur Xhafari.

– Unë po se po, nëse do të mund të mbrohem nga atentati që ju mund të më kurdisni, pasi ju ka ardhur keq, pse kam shpëtuar. Këtu do

të jem derisa të bëjmë varrimin, pastaj do të shohim. Ti, po pate fytyrë, shporru që këtej se vërtet nuk e ke vendin këtu! – ia përplasi Mirani i lehtësuar. U ngrit brof në këmbë dhe shkoi poshtë në dhomë të ndënjës, duke lënë të tjerët që po ngriheshin zvarrë zvarrë, si gjysmëkufo-ma. Atyre tashmë nuk po u flitej.

13.

Nënëmadhja e thirri Miranin t'i ulej pranë.

– Pse më dukesh kaq i egërsuar, bir i nënës?

– Asgjë, Nënëmadhe, nuk kam asgjë, – u përgjigj Mirani.

– Edhe pse jam plakur, nënën s'e mashtron dot dhe nuk duhet të më mashtrosh, as edhe kur mendon se ma shton dhimtën, – tha Nënëmadhja.

– Patëm një kuvendim me disa kopukë që po i thonë vetës “trashëgimtarë” të Jusufit. Më thanë se duhet të iki nga kjo shtëpi, – u përgjigj shkurtimisht Mirani, i detyruar t'ia tregonte të vërtetën.

– Ti si u përgjigje, djali i nënës?

– U thashë, për të gjallë, derisa t'i varros shokët, nuk iki.

– Të pastë nëna, mirë qenke përgjigjur! Po të kishe pranuar të zhburroheshe nga të paburrat dhe nga të panjerëzit, atëherë do të duhej të më merrje me vete, sepse nga dita në ditë po bëhem edhe unë më e huaj në shtëpi të djemëve të mi. Tani nëna po e merr vesh se pas vrasjes së djemve të nënës, po duan të vrasin edhe luftën për liri, po duan ta vrasin Kosovën, por nuk kanë për ta vrarë, sepse nëna ka me mijëra djem e çika, jashtë e në Kosovë, që do ta vazhdojnë rrugën e djemve të nënës, Kadrisë, Jusufit e Bardhit. Mbahu djali nënës, mbahu se ta kanë tha kra-hun shokët që t'i vranë!

Miranit iu mbushën sytë me lot. Nuk po u zinte besë veshëve nëse po dëgjonte këngë nga epi i kreshnikëve apo nga një Nënëmadhe reale që pushtuesi ia kishte vrarë dikur bashkëshortin dhe tani të dy djemtë.

– Shko flij, bir i nënës! Po më duken sikur sytë e tu po lotojnë. Unë nuk dëshiroj të të shoh të ligështuar, bir i nënës..

Mirani u ngrit duke i tërhequr duart prajshëm nga duart e saj, meqë po i vinte keq të qante para saj. Shkoi në tualet dhe qau me dënësë. Pastaj u ngjit në dhomën e tij për të fjetur. Kishte kaluar përplasje të rënda, më të rënda sesa ishin në gjendje të bartnin shpatullat e tij.

Të nesërmen, (e hënë, 25 janar), pasdite erdhi për vizitë të shkurtër kryehetuesi. Ai takoi Miranin.

– Jemi të shqetësuar për një bisedë që keni pasur mbrëmë në dhomën tuaj, prandaj na duhet të caktojmë roje për të ty, ose të të strehojmë në një vend të sigurt. Sili është mendimi juaj?

– Unë do të qëndroj këtu pa truproje derisa të kryhet varrimi, edhe sikur kiameti të bëhet. Nga këta komplotistë e provokatorë që ishin mbrëmë në atë bisedë nuk kam frikë, kurse ju, besoj, do kujdeseni të na ruani përjashta.

– Atëherë nuk po marrë ndonjë vendim konkret, por kini kujdes, sepse biseda e mbrëmshme ishte alarmante, sado që akoma nuk e kemi analizuar tamam.

– Ju falënderoj për përkujdesjen tuaj.

– Si urdhëroni, këtë e kemi për detyrë. Tani kam një vështirësi për t'ia kontestuar para gjyqit alibinë zotëri Rezil Mejtepit, – vazhdoi kryehetuesi. – Kam vizituar familjen e motrës së tij, ku ai pretendon të ketë qenë gjatë natës së krimit. Dhëndri dhe motra janë përgatitë mirë për të dëshmuar se atë natë Rezili e ka kaluar natën aty, por nga biseda që bëra më fëmijët e motrës së tij, mësova se ata nuk e kishin parë Rezilin pothuajse një vit. Tani më lind vështirësia, meqë fëmijët nuk i lejon ligji si dëshmitarë. Do duhej të gjenim bashkautorin e krimit..

– Gjithë kohën kam menduar, – ndërhyri Mirani i padurueshëm, – se cili duhet të ketë qenë shoqëruesi i Rezilit, por nuk po e gjej dot. E kam diskutuar këtë edhe me bashatdhetarë. Po më vijka keq që nuk

paske mundësi të sigurosh prova për Rezilin, sado që e paske krijuar bindjen përmes nipave të tij se ai nuk ka alibi, por që ata nuk i lejuaka ligji të dëshmojnë, edhe kur fëmijët janë shumë herë më të sinqertë se të rriturit.

– Zotëri Bruçaj, a keni edhe ndonjë shqetësim konkret gjatë ceremonisë mortore?

– Jo aq serioz sa për të kërkuar ndihmën tuaj, – tha Mirani.

Sapo kryehetuesi shkoi, nëna Ajshe e thirri Miranin t'i ulej pranë.

– Hë loke, pat naj lajm gjermani? – pyeti ajo.

Mirani i tregoi nënës Ajshe për bisedën që kishte pasur me kryehetuesin.

– Edhe unë, moj loke, jam me mendim të Jusufit. Nana nuk ka qejf, bile për t'gjallë tim, me u zbulue, se dorasi asht shqiptar, se ja qet një marre t'madhe popullit tonë.

– Jo loke, të gjithë popujt e robëruar kanë mercenarë, shërbëtorë e spiunë që i shërbëjnë pushtuesit. Por, të vjen turp kur dëgjon të lavdërohen shërbëtorët e pushtuesve, siç po flasin e shkruajnë me krenari historianët tanë, se kaq e aq vezirë, sadriazemë e pashallarë i ka dhënë populli shqiptar imperatorisë otomane.

– U të pastë lokja, sa larg të paska shkue mendja, po na i kemi tani në Kosovë pushtetarët që bajnë gara mes vedit se kush po i shërben ma mirë Beogradit. Bile Jusufi më thojke se ka shkrimtarë, poetë, gazetarë që bajnë gara midis tyre se kush po shkruen ma mirë për Titë qenin dhe për sundues tjerë të Beogradit. “Dro më na lëshue toka”, i pata thanë Djalit t'Nanës e ai m'u gjegj se “shpejt po na vjen liria”.

14.

Të premtën e 29 janarit, avokati i angazhuar njoftoi se kishte marrë refuzimin definitiv nga konsullata jugosllave për kërkesën e tij që Jusufi, Kadriu e Bardhi të varroseshin në Kosovë. Mirani dhe bashkatdhetarë

të tjerë bënë takim dhe vendosën ta bënin varrimin në Shtutgart, më 5 shkurt. Gjendja ishte rënduar dhe organizimi rreth varrimit ishte vështirësuar. Megjithatë, ia dolën të bënin takim të shtunën, më 30 janar. Ata që ishin të pranishëm tashmë kishin filluar të klasifikoheshin vetvetiu si të krahut të Jusufit, të krahut të Kadriut dhe të Miranit me shokë të tij që trajtoheshin si të asnjërit krah. Në takim po diskutohej për të lëshuar njoftimin për varrim dhe për të caktuar se kush duhej kë të njoftonte edhe gojarisht. Mirani u ngarkua të informonte bashkatdhetarët në Gjermaninë Perëndimore e Veriore, në Belgjikë, në Francë e në shtetet skandinave, meqë secili e dinte se ai kishte më së shumti kontakte. Pastaj Xhafari shtroi pyetjen konkrete: “Kush do të mund të gjente lidhje për të informuar Njerkun e Jusufit e të Bardhit, Galipin në Suedi?” Asnjëri nuk u përgjigj, meqë u mungonin kontaktet e njohjet. Mirani shprehu gatishmërinë e tij, sepse donte të mos e informonte atë, i cili që gjithë atyre ditëve nuk kishte ardhur për ngushëllim, sado që duhej të kishte dëgjuar, si të gjithë shqiptarët.

Në vazhdim filloi të diskutohej se kush do të bënte fjalimin përmortës që do të lexohej te varrezat. Të gjithë u shikuan mes tyre për të pritur se cili do të paraqitej vullnetarisht. Mirani po vetëpërmbahej për të vënë në sprovë se cili nga të pranishmit do të dinte ta shkruante atë fjalim. Meqë u vërejt se nuk po paraqitej askush dhe nuk po bëhej nga asnjëri propozimi për ndonjërin, Mirani shfaqti gatishmërinë. As Xhafari nuk kundërshtoi, sado që talenti për të shkruar nuk i mungonte, por për biografi të dëshmorëve nuk ishte i informuar. Ai tashmë nuk po e merrte guximin për të kundërshtuar Miranin, meqë e shihnte se ai po mbannte hidhërim të theksuar ndaj tij dhe kishte frikë se mos rastësisht po e pësonte ndonjë të rrahur nga ai.

Në vazhdim u shtrua çështja se kush duhej ta lexonte fjalimin përmortës. Sërish ra heshtja. Fahriu propozoi Gonin, me mendimin se ai po mbante qëndrim neutral dhe nuk do të kontestohet nga asnjëri. Ha-

kani, bashkëvendës dhe ithtar i Kadriut, që kishte statusin e kandidatit në OMLK, me profesion traktoristi në Kosovë, ndërsa në Zvicër punëtor – vozitës, ia bëri pyetjen domethënëse Fahriut:

– A nuk po të duket tepër i ri Goni dhe më duket se edhe zërin e ka si zë fëmijë? Nuriu propozoi ta lexonte Xhafari, por ai vetë nuk pranoi me arsyetim se nuk i shkonte oratoria për fjalime. Ai nuk deshi të thoshte se zëri i tij ishte tepër defektoz. Përfundimisht u pajtuan që ta lexonte Goni. Pasi i biseduan edhe ca detaje teknike e përfunduan takimin.

Mirani me ndihmën e Sarandës të dielen e përpiloi fjalën përmortëse dhe ia dha Gonit. Me atë rast e këshilloi ta ushtronte leximin dhe vetëpërmbytjen gjatë deklamimit të asaj fjale gjatë varrimit.

Pas takimit Nënëmadhja thirri Miranin t'i ulej pranë.

– Ju dëgjova gjatë mbledhjes. Gati të gjitha punët të mbetën ty. Por pse e more përsipër të informosh Galipin në Suedi?

– Nënëmadhe, e mora përsipër që ta thërras, pasi nuk e kisha ndër mend ta thërrisja, – tha ai.

– E pse nuk do që ta thërrasësh?

– Sepse nuk duhet thirrur ai faqezi që nuk ka ardhur tash e dy javë për ngushëllime, edhe pse ka marrë vesh për vrasje të Jusufit e Bardhoshit, siç kanë dëgjuar gjithë shqiptarët e kësaj bote.

– Të pastë Nana, ma preu menja se ti e more përsipër për të mos e thirrë...

15.

Të hënë pasdite Mirani vendosi të shkonte në Bochum. Ngjarja e kishte rënduar së tepërmi dhe e kishte të domosdoshme një shkëputje nga ajo atmosferë e ngarkuar. Më vete kishte romanin *Prisja e komitëve* të Sulejman Krasniqit, të cilin ia dha të dilen Fahriu. Vendosi të udhëtonte vetëm me tren, se po të udhëtonte me ndonjë bashkatdhetarë me makinë do t'i duhej të bisedonte gjatë rrugës dhe kështu nuk do të shkëputej

nga atmosfera e fjalët e atyre ditëve.

Në trenin komod mendohej t'i shpëreëndronte mendimet nga ato që kishte përjetuar e dëgjuar gjatë gjithë atyre ditëve të llahtarshme. E kishte të vështirë. Nxori nga çanta romanin që të lexonte.

Romani kishte përmbajtje të përafërt me tv-dramën *Gërsheta luftë*, prandaj po e lexonte aty-këtu. Ndalonte te fragmentet që ia tërhiqnin vëmendjen, ku kishin të bënin me skenarët e xhandarmërisë serbe kundër Azem e Shotë Galicës. Në ato skenare xhandarmëria kishte angazhuar edhe njerëz të afirmuar shqiptarë, si ndonjë hoxhë, kryeplak e të ngjashëm. Bile kishte manipuluar edhe ndonjë bashkëlufëtare të tyre. Mirani po mendonte se serbët vetëm sa e paskan përsosur veprimtarinë, meqë skenarët e atëhershëm me të tanishmit po i dukeshin pothuajse të ngjashëm. Në fund të romanit, me përmbajtje goxha romantike, heronjtë dilnin fitimtarë edhe kundër atyre skenarëve të përkryer të xhandarmërisë, sado që përjetonin goditje të rënda. Pasi e mbaroi shfryu me vete: "Falemnderit Sulejman, po më duket sikur këtë roman e paske shkruar enkas për mua, që në këto çaste të bëhem i fortë dhe i zgjuar për të përballuar goditjet që po m'i bën Beogradi përmes shqipfolësve që po imponohen si patriotë e si trashëgimtarë politikë të Jusufit."

Kur arriti në stacionin e Bohumit, rreth orës 22.00, i telefonoi Renatës, i bindur se tek ajo do të pushonte më mirë, do të darkonte, të lahej e ndërrohej. U gëzua kur e gjeti në banesë. Vendosi që para saj të tregojë sa më i përmbajtur, meqë ajo ishte shumë sentimentale.

– Ngushëllime nga thellësia e shpirtit tim! – iu drejtua ajo duke e shtrenguar fort në kraharor. – U informova nga mediat gjermane për vrasjet e kobshme të shokëve tu. T'u kam hidhëruar pse nuk më ke telefonuar, kurse unë nuk dija ku të të gjeja. Doja të të ngushëlloja dhe të informohesha për gjendjen tënde shpirtërore. Kam telefonuar te familja e vëllait tënd dhe mora vesh se edhe kunata Sabrush ka qenë gjithë kohën atje. Ti, si gjithnjë, më anashkalon e më injoron, shpërfill ndjesitë

e mia, prandaj nuk të bie ndër mend të më telefonosh.

– Erdha për të pushuar dhe jo për të dhënë llogari për keqsjelljet e mia ndaj teje, – e ndërpreu Miranu.

– Më fal, nuk dështa të të kërkoj llogari. Desha të të qortoj për injorimin që po më bën. Edhe unë kam të drejtë të ndaj me ty vuajtjet e hidhërimet e tua. Kur ti më privon nga kjo e drejtë sigurisht që hidhërohëm. Thua ti që nuk kam të drejtë ta shfaq hidhërimin tim?

– Të lutem, lermë të qetël! Ndihem i sflitur, – tha tjetri lodhshëm.

– Të kuptoj, e shoh si je katandisur.

Ra heshtja. Renata po ia fërkonte duart me dhimbshuri. Asaj tashmë po i rrokulliseshin kokërra të mëdha lotësh nëpër faqe.

– A po zbulohet se kush e ka bërë këtë vrasje kriminale?

– Policia ka bërë një arrestim për të cilin duhet të kesh dëgjuar në lajme. Por, sikur kam një si shqetësim se pushteti i këtushëm nuk është i përkushtuar vendosmërisht për të kapur vrasësit. Ndoshta për shkak të ndonjë marrëveshjeje ndërinstitucionale me strukturat përkatëse policore të Beogradit.

– Mos more, dyshon që qeveria jonë bëka edhe të tilla marrëveshje kriminale? Më bëhet se ndonjëherë e tepëron me dyshime nga më të llojlojshmet, edhe të atilla që nuk duket të kenë logjikë brenda. Këto dyshime ndaj strukturave tona shtetërore nuk mund të qëndrojnë. Përndryshe, unë do të revoltohesha...

– Revoltohu, po deshe. Kot. Mundet që këtu qeveria nuk i kontrollon plotësisht shërbimet e ashtuquajtura sekrete, meqë ato fuqizohen në aso përmasash, sa të manipulojnë edhe me qeverinë. Ato shërbime bëjnë marrëdhënie me struktura të ngjashme të Beogradit. Shefat e tyre shoqërohen, korruptojnë e dezinformojnë njëri-tjetrin dhe prandaj, në situata të tilla mund të tolerojnë edhe atentate të këtij niveli. Është për folur se pjesarë të RAF-it po strehohen në Jugosllavi dhe ata kanë gjetur përkrahje atje. Bonnit mund t'i interesojë bashkëpunimi me Beogra-

din për t'i kapur ose për t'i vrarë ata. Që ta përfitojë Beogradin për këtë, mbase i kanë bërë ndonjë kundërshërbim! Sapo bëri vizitë Ministri i Brendshëm i Jugosllavisë...

– Të lutem, mos u zgjat në këtë drejtim se nuk po të përcjell dot. Janë frekuenca që antenat e mia nuk i njohin. Unë do të thosha se ju si emigracion po gaboni që po bëni jetë të izoluar. Sikur i ndjeri Jusuf të ishte shoqëruar me kolegë gjermanë të profesionit, me shkrimtarë, me këngëtarë, me gazetarë atëherë ata do të kishin protestuar tani kundër kësaj vrasjeje makabre. Ky aktivizim e shoqërim do të ishte masë preventive që shërbimet sekrete të mos merrnin vendim për ta vrarë, pasi edhe shteti ynë do ta kishte mbrojtur më seriozisht, në mos për tjetër, për të evituar kritikën që do të pasonin. Tani askush nuk po proteston, meqë askush nuk po e di se ç'personalitete janë vrarë. Asnjë gazetar këtu e në Zvicër nuk e di se janë vrarë kolegë të tyre. Edhe mediat kanë informuar shkurtimisht, duke ngritur shumë dilema. Vetëm gazetari i TAZ-it, që ti e ke mik, ka shkruar më gjerësisht e më objektivisht.

Renata u ndal pakësa e vetëkënaqur se kështu po zhvillonte bashkëbisedim të nivelizuar. Tani po priste përgjigjen e radhës nga Mirani.

– Them të drejtën më duhet të pranojë se shfaq mendime interesante. Por, ç'e do që ne nuk i kemi nga dy energji dhe nga dy kohë që të angazhohemi për çlirimin e popullit tonë dhe njëkohësisht edhe në jetën mediatike, kulturore e politike këtu. Ne nuk po kemi energji të mjaftueshme që t'ju dalim zot angazhimeve tona kombëtare, prandaj nuk po na tepron kohë për të tjera angazhime. E sheh, unë që nga marsi nuk kam mundur t'i dal zot përgjegjësisë sime në Lidhjen e Studentëve dhe jam shkëputur pothuajse tërësisht nga jeta studentore.

– Do të pranosh lutjen time që këto bisedime t'i vazhdojmë nesër, pasi sonte të duhet pushimi?

– Nesër më duhet të shkojë në Untergruppenbach, meqë vazhdojnë ceremonitë e ngushëllimeve derisa t'i varrosim shokët.

– Them të pushoje nja dy-tre ditë!?

– S’e bëj dot, meqë nuk mund t’i lë vetëm nënën dhe fëmijët e Jusufit, babain e Kadriut, miqtë e bashkëveprimtarët...

– Të kuptoj, prandaj nuk ke nevojë të arsyetohesh më gjatë. Tani një pyetje të drejtpërdrejtë: Ku po e gjen gjithë energjinë e nevojshme që t’i përballosh goditjet dhe tronditjet kaq të rënda?

– Hëëëëëëm, po pësoj goditje të njëpasnjëshme, sa po më bëhet t’i harroj goditjet e tronditjet që pësova me rastin e humbjes së shokëve. Ndonjëherë po rëndohem aq shumë sa po e ndhem fatkeq përse nuk jam vrarë edhe unë bashkë me shokët. UDB-ja nuk e ka pasur për synim vetëm mënjanimin e tyre fizik, sepse atë mund ta bënte edhe më herët. Ajo ka përgatitur terrenin që, pas atentateve fizike ndaj shokëve, të bëjë atentate të njëpasnjëshme politike ndaj lëvizjes sonë patriotike. Sa për konkretizim, që të kuptosh më lehtë, ta zëmë, ka pasur raste kur kanë ardhur bashkatdhetarë nga Kosova dhe kanë shprehur habinë kur më kanë parë aty. Ata kanë treguar se në Kosovë UDB-ja ka përhapur dezinformata për gjoja karakterin tim të ulët, duke prekur nervin e ndjeshëm të popullit tonë. Paskan thënë se unë gjoja kam bërë atentatin për t’ia marrë gruan Kadriut dhe tani qenkam zhdukur diku me të. Pastaj, në ceremoninë mortore na janë imponuar individë që vetën e quajnë trashëgimtarë politikë të Jusufit. Ata po sajojnë skena e po bëjnë provokime aq banale e aq skandaloze, sa po më mërzhisin që kam shpëtuar nga atentati fizik.

Gati sa nuk harrova të të shpjegoj se ti më pate bërë një shërbim të madh kur ma pate dhuruar, kujtoj në fillim të vitit 1978, dramën *Jeta e Galile Galileut*, të Bertolt Brehtit. Kur e lexova më përvetësoi tej mase. Pastaj e rilexova disa herë, sa që shumë pjesë i dija për mendsh dhe të bezdisja duke t’i recituar, duke improvizuar talent prej aktori. Siç e di, unë i detyruar ta përktheja në shqip, me bindjen se nuk ishte përkthyer deri atëherë. E postova në adresë të Ndërmarrjes për përhapje të

Librit në Tiranë. Meqë nuk mora përgjigje, droja se ka përfunduarnë dosjen që duhet të kenë formuar për mua Sigurimi, siç i thonë policisë politike në Republikën e Shqipërisë.

Mirani ndaloi për të hetuar nëse Renata po vazhdonte të shfaqte interesim për të dëgjuar, apo po shtirej sikur është e interesuar.

– Mos qofsha në lëkurën tënde! Sa po më vjen keq për ty! Uroj të gjesh forcë shpirtërore e mendore për të përballuar këtë gjendje kaq të rënduar! Uroj të kesh sukses si Galile Galileu dhe të mos e pësosh si Xhordano Bruno!

– Të falënderoj!

Mirani mendoi se më nuk duhej të vazhdonte me diskutime rreth atentateve. Në këtë përfundim erdhi duke menduar se të tillë mesazh transmetoi Renata me përrurimin që i bëri.

16.

Më 5 shkurt, në varrezat e qytetit të Stuttgartit po vinin shqiptarë nga të gjitha anët. Në vendtubimin ku ishin edhe arkivolet e Jusufit, Kadriut e Bardhit po formohej kortezhi dhe po radhiteshin kurorat. Në ballë doli Bajraktari, veshur me rroba kombëtare të Rugovës së Pejës. Ai mbante në gjysmështizë flamurin kombëtar. Numri i pjesëmarrësve duhej të ishte vetëm rreth 600 vetave, meqë të tjerët ishin frikësuar të merrnin pjesë. Gjatë atyre ditëve UDB-ja kishte lëshuar njerëzit e vet për të përhapur frikësim për ata që do të merrnin pjesë.

Mirani sinjalizoi Bajraktarin që të nisej drejt varreve të hapura. Rrugicat dhe rregullimi i varrezave ishin mrekulli më vete, sa të bënin ta dëshiroje vdekjen sa më parë midis atij rregulli, harmonie e gjelbrimi aq përvetësues. Kortezhi i gjatë, radhitur tre nga tre e diku edhe katër nga katër veta, lëvizi pas Bajraktarit dhe pas Jusufit, Kadriut e Bardhit në arkivole, të mbuluar me flamuj. Vetëm individë të autorizuar mund të fotografonin e incizonin kortezhin.

Pasi arritën në vendvarrim, Mirani sinjalizoi Gonin se e kishte radhën për të lexuar fjalën përmortëse. Ai iu afrua dhe po i rrinte pranë. Goni filloi së lexuari. Mezi po dëgjohej vetëm nga ata që ishin më afër. Pasi lexoi ca rreshta ia plasi vajit. Të gjithëve po u vinte keq për të dhe të shumtit filluan të qanin bashkë me të. Mirani fillimisht hezitoi ta deklamonte fjalimin, por nuk e zgjati, meqë mendoi se duhej të kapërcehej ajo gjendje. Shrëngoi nofullat për t'u zotuar se do t'ia dilte ta deklamonte deri në fund.

– Bashkatdhetarë të dashur, – nisi ai fillimisht pa e shikuar tekstin e shkruar, – Jusufi ynë i dashur ka lënë porosi që të mos i qajmë, sepse kanë rënë për Kosovën.

Në vazhdim filloi të deklamonte fjalimin e shkruar, por jo me gjithë zërin e fuqishëm që kishte ai, pasi mendoi se nuk po i shkonte rastit e vendit. Me të përfunduar filloi t'i dridhej zëri, por mori frymë thellë dhe u zotuar se nuk do të shfaqte ligështim para armiqve që i mendonte se ishin të pranishëm. Kjo i dha atij forcë që t'i dilte në fund.

Pas mbarimit të fjalës, stafi teknik gjermanë bëri varrosjen. Shumë të pranishëm filluan të ngushëllonin Miranin. Ndonjëri me zë të ulët i thoshte gjatë përçafimit: “Të lumtë që na nxore faqebardhë!

Nënë Ajshen po e mbante Mirani për krahu dhe po ktheheshin me hapa që i tërhiqnin zvarrë-zvarrë drejt daljes nga varrezat.

– Ku do shkosh tani, djali i nanës? Mezi e shqiptoi pyetjen Nëna Ajshë.

– Përse po ma bën këtë pyetje, Nënëmadhe? – ia bëri ai.

– Hëëëëëm, mor djali i nanës, mos kujto se pleqnia më ka matufosun. Të gjitha i kam pa n'sytë e tu. E di nana. Ti nuk ki ma vend në shtëpinë e bijve të mi, që tani i rehatova nën tokën gjermane. Aty po komandojnë kopukët e hileçarët. Por, ti e di gjithashtu se tani as nana nuk ka ma vend aty. Ishalla vijnë kohë ma të mira për ne!..

Të dy iu hodhën në përçafim njëri-tjetrit dhe mbetën ashtu për disa çaste, si të ishin shndërruar në statujë.

Mirani shkoi në ish-shtëpinë e Vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvala, paktoi plaçkat që kishte në ish-dhomën e tij, u përshëndet me fëmijët dhe gratë e shokëve me keqardhje të madhe dhe iku që andej duke mbajtur kokën prapa për të parë shtëpinë derisa i humbi nga shikimi.

Ditëve në vazhdim Mirani nuk u kthye më në atë shtëpi dhe as mori vesh se kur dhe si e lëshuan Gjermaninë dhe ku shkuan gratë dhe fëmijët e Jusufit dhe Bardhoshit. “Trashëgimtarët politikë” të Jusufit, Xhafari me sejmenë, kishin vendosur t’i izolonin ata nga Mirani. Atë e digite malli sidomos për fëmijët e Jusufit, me të cilët kishte pasur një afërsi të madhe.

KAPITULLI VII

E diel, 16 maj 1982.

Mirani sapo u takua me Xhabir Shatorin. Vendtakimi: Parku buzë Liqenit piktoresk të Gjenevës. Ai për Miranin mbante pseudonimin “Bacaloku”, kurse për ndonjë tjetër Halili. Më të tillë pseudonim ia kishte prezantuar javë më parë Hakani. Mirani dëshironte të dinte se cili ishte ai me të vërtetë, meqë tashmë po luante rol të madh në Lëvizje. Gjatë prezantimit Hakani i kishte thënë se këtë shok e kishte dërguar OMLK-ja nga Kosova për të drejtuar OMLK-në në Perëndim (e cila as që ekzistonte, po të kihet parasysh fakti se simpatizantët dhe kandidatët për anëtarësim nuk mund të quhen organizatë). Pas atentatit Hakani po përpicej të luante rolin e trashëgimtarit politik të Kadriut, për afërsisht siç po bënte Xhafari që uzurpoi vrazhdësisht rolin e trashëgimtarit politik të Jusufit. Këta të dy dukeshin krijesa qesharake, meqë kostumet e Jusufit dhe të Kadriut u binin tepër të mëdha. Këtë përgjegjësi Hakani e ushtroi derisa erdhi Xhabiri.

Mirani që habitur kur dëgjoi Hakanin ta thërriste atë Bacalok, meqë vetë Hakani ishte ku e ku më i moshuar se tjetri. Në Kosovë ky epitë rëndom përdoret nga vëllai i vogël kur i drejtohet me nderim vëllait më të moshuar.

– Të kam thirrur në këtë takim, – filloi bisedën Xhabiri, – të të informoj se dje bëmë marrëveshje për bashkim. Në bisedime unë përfaqësova OMLK-në, ndërsa Xhafari përfaqësoi Lëvizjen që e kanë themeluar më 17 shkurt. Me këtë rast themelua Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ). Pata dëshirë të ta uroj këtë fitore së pari ty, si veteran i veprimtarisë patriotike e çlirimtare në mërgatë.

Xhabiri pushoi duke ia zgatur dorën dhe duke e vrojtuar reagimin e Miranit. Edhe ai bëri t'ia zgjaste dorën, por iu duk sikur dora nuk po ia dëgjonte komandën, ndaj u detyrua ta rikomandonte dhunshëm.

– Urime këtë fitore dhe dalshim faqebardhë! – tha Xhabiri duke ia shtrënguar fortë dorën tjetrit. Dora e Miranit nuk iu përgjigj me të njëjtin shtrëngim dorës entuziaste të të parit. Ajo tani po i gjasonte një gjymtyre të shkëputur nga trupi.

– Falemnderit, urime edhe ty! – përshëndeti Mirani me gjysmëzëri dhe vazhdoi: – Nuk mund të quhet bashkim, por bashkëngjitje OMLK-së, pseudobashkimit të 17 shkurtit në Stamboll. Megjithatë, a mund t'i di detajet e këtij bashkimi?

– Kemi përgatitur komunikatë dhe sot do ta bëjmë publike.

– Domethënë, për detajet e bashkimit unë duhet të informohem si gjithë të tjerët, sado që në fillim the se më ke thirrur në takim për të ma uruar mua të parit, si veteran që më çmuake!?

– Më dëshirë do të të informoja, por u morëm vesh që të mos informojmë asnjërin më shumë sesa thotë komunikata.

– E kuptoj... Mirani nisi të mendojë nëse duhej të shtonte gjë tjetër në këtë drejtim. Xhabiri e hetoi hezitimin e Miranit, ndaj shtoi:

– Të kuptoj. Që nga vrasja e shokëve ti ke qenë i persekutuuar nga Xhafari me sejmënët e tij. Bile, patën shkuar aq larg, sa fillimisht të akuzuan edhe ty për bashkautor të vrasjes. Këtu e tutje nuk ke përse shqetësohesh, meqë të kam marrë unë në mbrojtje. Dhe njëra nga pikat e marrëveshjes së bashkimit të djeshëm thotë që asnjëri nga anëtarët e subjekteve të tjera nuk guxon të shpifë e të përflasë më kundër teje.

Xhabiri u ndal për të bërë rivlerësimin e Miranit nëse e kishte kënaqur me këto sqarime. Tjetri ishte pa asnjë shprehje dhe dukej sikur nuk kuptonte gjë nga ato që po i thoshte ai. Pikërisht si një torollak.

– Hë, he burrë, thuaj diçka! – iu drejtua Xhabiri.

– Ç'të them, mor Bacalok? Jam bërë të ma çajë hallin Rahoveci, siç thonë nga ana jonë. Vërtet paskeni marrë vendim të favorshëm për mua, nëse e keni marrë, por dyshoj në keni marrë vendim të mirë për Lëvizjen tonë. Nuk ke përse mban sekrete ndaj meje. Unë i di se si dhe çfarë vendimi është marrë në Turqi, më 17 shkurt dhe kush e ka marrë atë vendim. Gjithashtu, po rezul-

ton se ti vetëm sa ia paske bashkëngjitur OMLK–në asaj, i thënçin organiza-të, që është formuar në Stamboll.

Mirani u zu në mendime nëse duhej të vazhdonte të konkretizonte gjithç-ka që kishte të bënte me këto komplete, apo të taktizonte edhe kësaj radhe. Vendosi të mbante qëndrim taktik prej naivi për të pritur kohë më të favor-shme që t’u kundërvihej më hapur komplotistëve Sabit, Avdyll, Xhabir e Xhafar, siç po i vlerësonte për momentin.

– Thuaji të gjitha, pse ngurron? Fundja, jemi shokë të idealit, – ia preu dilemat i pari.

– Çfarë të them, unë që e humba këtë betejë. Më anashkaluat fare ju që nuk kishit të bënit aspak me organizimet tona në Perëndim. Është hera e katërt që takohemi dhe bisedojmë. Të kam informuar për të kaluarën tonë dhe sidomos për bisedimet dhe vendimet për bashkim. Po e stërpërsëris në mënyrë telegrafike: Të pata informuar se në muajin gusht të vitit të kaluar Jusufi, Kadriu dhe unë patëm vendosur t’i bashkonim të tri organizatat në Frontin për Republikën e Kosovës. Atë vendim na e dhjeu Rrobaqepësi në tetor. Me atë rast ai qe sjellë në mënyrë barbare ndaj Kadriut. Gjatë muajve në vazhdim Jusufi e Kadriu ndërprejnë bashkëpunimin, madje Jusufi i qe hidhëruar aq shumë Kadriut, saqë për këtë shkroi edhe në *Zëri të Kosovës*. Në dasmë të Kadriut e Sarandës u sqaruam. Me nismën e Jusufit u takuam më 16 janar, një ditë para atentateve të kobshme. Në agun e 17 Janarit riven-dosëm themelimin e Lëvizjes për Republikën e Kosovës. Ndodhën atentatet. Na u vranë shokët në krye të detyrës, siç praktikohet të thuhet. Pasuan kom-plotet njëri pas tjetrit, duke kulmuar me vendimin që morën ata në Turqi, u thënçin përfaqësues, më 17 shkurt. Erdhe ti nga Kosova si përfaqësues i OMLK–së dhe ia bashkëngjite organizatën tënde asaj që qe formuar në Turqi.

Mirani pushoi për të vëzhguar Xhabirin nëse i kishte folur shumë dhe mund t’i hidhërohej. Meqë ai po priste duke u shtirur se po dëgjonte me vëmendje, ky e pyeti:

– Janë të vërteta këto që t’i thashë?

– Po, kështu më ke informuar. Po pastaj?

– Si, “po pastaj”?! Të duket se e ke përfaqësuar denjësisht OMLK–në?

– Domethënë kaq ngushtësisht menduake ti?

– Ngushtësisht po të duket? Erdhi nga Prishtina oficeri i UDB–së, Avdyl Prapashpina, u takua me Rrobaqepësin e Xhafarin në Turqi dhe formuan organizatë sipas shijes se tyre për të mos thënë sipas ndonjë porosisë. Asaj organizate ti ia bashkëngjite OMLK–në pa marrë parasysh të kaluarën, për të cilën duhet të të kenë informuar edhe Hakani e Saranda, siç të kam informuar edhe unë.

– Domethënë, ti je kundër vendimeve që morëm dje?

Mirani këtë e kuptoi si kërcënim. Kur Xhabini e informoi për vendimet e djeshme, edhe për vendimin për të mos shpifur më kundër tij, që i qe dukur më i favorshmi, tani nuk po e besonte më. Mendoi se Xhabini mund ta kishte sajuar për të qenë më autoritar ndaj Miranit. E pa se kishte shkuar larg dhe duhej të korigjonte taktikën.

– Nuk thashë se jam kundër, por nuk mund të jem as pro, meqë do të na duhet të bisedojmë edhe ne të Frontit se çfarë qëndrimi të mbajmë. Sa për mua, unë kam interes që ta tejkalojmë këtë situatë as luftë as paqe dhe të bashkërendisim veprimtarinë e lëvizjes sonë. Emri i organizatës së re sesi m’u duk i stërzgjatur dhe i koklavitur. Do të mjaftonte ta emërtonit ta zëmë vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës. Por kjo nuk ka qenë në dorën tënde, meqë të tjerët e kanë themeluar atë organizatë, kurse ti vetëm ia ke bashkëngjitur organizatën që përfaqësove.

Mirani ndaloi i vetëkënaqur me përshtatjen e taktikës që për momentin iu duk e suksesshme dhe tani po prishte reagimin e të parit.

– Kështu pra, – filloi se krekosuri Xhabini, – kurdoherë u kam thënë të tjerëve sa herë që diskutohej për ty se je i përgatitur, i guximshëm dhe i arsyeshëm. E pra, edhe njëherë, dalshim faqebardhë, meqë që tani jam i bindur se atë që mendon ti do ta miratojnë edhe aktivistët e Frontit.

– Ndoshta! – dha komentin e hamendësuar Mirani. – Se mos po nisesh nga vetja. Ke bërë si ta ka thënë truri dhe duhet të heshtë OMLK–ja, meqë

e ke vënë para faktit të kryer. Apo ndoshta burgosjet e kanë goditur aq rëndë, saqë ka humbur funksionalitetin e saj për të reaguuar. Tani vjen ti, shpërdoron Hakanin, një ish-traktorist, punëtor krahu këtu. Ai të legjitimoi ty shpërdorueshëm si të dërguar të organizatës. Tani ti me Xhafarin bëni një bashkim të shpifur bashkë me shpërdoruesit që bënë bashkimin më 17 shkurt. Gjithë kësaj nuk i vjen erë e mirë.

– E di çka, – ndërhyri Xhabiri duke e humbur durimin, – të këshilloj që të mos sajosh këso deklasimesh kaq të rënda. Shkurt e shqip: Je dakord për bashkimin që arritëm dje, siç e miratove më herët, apo jo?

– Nuk kam alternativë tjetër, meqë jam i mundur, – miratoi Mirani.

Pas një pauze të vogël ai qiti e i tha Xhabirit:

– Bacalok, besoj e konsumuam këtë tematikë. Tani dua të sqaroj një gjë tjetër: Hakani dhe ti sa herë më keni premtuar se do të më takoni me Xhabir Shatorin i cili, sipas jush, ka kërkuar strehim në Francë dhe se shpejt do të bëhet me pasaportë. Madje më keni thënë se edhe ai mezi po pritka të më takojë mua. Përse duhet të presim derisa ai të marrë pasaportë? Unë mund të shkoj që sot tek ai në Francë ngase këtu afër e kemi, po ma dhatë adresën e tij. Qysh në vitin 1975 kam krijuar respekt të madh për të. Atëherë isha me studime në Prishtinë, gjendesha në konvikt kur dëgjova për dënimin e tij. Kur muzgu po e mundte ditën, ndeza çarshafin në dritare të konviktit dhe hapa një protestë simbolike. Edhe të tjerë studentë dogjën tekstile të ndryshme në dritaret e tyre duke lëshuar të shara ndaj pushtetit. Tani po më bëhet e padrejtë që nuk po më mundësohet ta takoj atë sa më parë.

– Mjaft! Nuk e duroj më këtë taktikën tënde të sofistikuar. Ti shtiresh sikur nuk e di se unë vetë jam Xhabir Shatori.

– Ti je Xhabir Shatori? – ndërhyri Mirani duke zgurdulluar sytë e duke shtrënguar nofullat. Një çast i thirri mendjes: “Ruaje qetësinë!”

– Kot e ke më këtë shtirje prej aktori. Ti e ke ditur që në takimin e parë.

– Në të vërtetë nuk e kam ditur dhe mirë që nuk e kam ditur. Po ta kisha ditur, nga respekti i madh për Xhabir Shatorin do t'i kisha gëlltëtur të gjitha

matrapazllëqet që ke bërë, që kur ke ardhur dhe të ka prezantuar Hakani si Bacalok dhe udhëheqës të OMLK-së jashtë Kosovës. Respekti i madh për Xhabirin do të më kishte penguar që veprimet e tua të mos i vlerësoj në mënyrë kritike.

– Pusho! Nuk të duroj më.

– Mos ulërit se po ta shkërdhej surratin grushta! A more vesh?! U lodha me banditizmat tuaj. Shporrmmu nga sytë sa nuk të kam bërë për spital!

– Do të ma paguash shtrenjtë këtë poshtërim e kërcënim! – mermëriti i pari duke u larguar. Mirani nuk i dëgjoji fjalët e mëpastajme.

Xhabiri u largua në drejtim të qendrës së qytetit duke kaluar këmbë mbi urën e gjatë dhe të gjerë, ndërtuar në vendin ku lumi zgjerohej në liqe. Mirani vendosi të pushonte edhe ca aty.

Duke qenë naivisht i gëzuar që i kishte mbijetuar fizikisht një beteje sfilitëse, por të humbur, ai nxori fletoren për të shënuar për zhvillimin e ngjarjeve që kur ia kishin vranë shokët e deri në këtë moment tepër tronditës. Pa menduar gjatë, qëndrimin për të bërë këto shënime e arsyetoi me konstatimin e tij: “Këta kriminelë do të më vrasin dhe bashkë me mua do ta varrosin edhe të vërtetën. Këto shënime do t’ia besoj kunatës Sabrush, me porosi që t’i ruajë derisa të mos jem më mbi faqe të sheut. Do t’ia kërkoj besën që, vetëm kur të më vrasin, t’ia dorëzojë në fotokopje policisë gjermane, nëse atentati ndodh në Gjermani, ose policisë së shtetit ku mund të më ndodhë atentati. Bile, do ta mësoj që kopjen ta postojë pa adresë të dërguesit, nga se policia përkatëse do t’ia kërkojë edhe origjinalin. Nuk i dihet nëse origjinali vetëm arkivohet. Në rast se do t’i arkivonin për hir të interesave madhore shtetërore, siç veprohet ndonjëherë, atëherë kunatën do ta porosisë që ta gjejë një shok timin të guximshëm që t’i publikojë...”

Mjaft më me këso mendime ogurzeza prej frikamani! – urdhëroi veten ai me zë të ulët, por jo edhe aq të ulët sa të mos e kthente kokën një qytetar që po kalonte atypani, për të vërejtur se përse ky njeri flitka me veten e tij. Mirani e pa dhe u skuq. U ngrit në këmbë duke marrë frymë thellë dhe zuri të

shëtiste. Duke u endur poshtë e lart zuri të mendojë: “Duhet të qetësohem një herë dhe pastaj të nis me shënimet”.

2.

Freskia dhe bukuria e liqenit po e ndihmonin të qetësohej, meqë vetëm urdhëri që i dha vetes nuk do t'i mjaftonte. Ai po mendonte se këto rrethana do t'ia nxisnin maksimalisht mbamendjen për të bërë shënime sa më të kompletuara. Pas rreth dhjetë minutash shëtiteje u ul sërish në bankë të parkut, por jo në atë që ishte i ulur më herët kur bisedoi dhe u zu me Xhabirin. Sapo u ul nga çanta nxori një fletore të formatit A4, nga xhepi nxori stilolapsin. Papritmas e bezdisi një çift që po i kalonte pranë duke i hedhur vështrimin kureshtar se ç'po bënte ai. Qytetarët ishin mësuar të shihnin piktorë që bënin peizazhe e portrete buzë liqenit, duke ua shitur ato të interesuarve. Rreth tyre mbledheshin qytetarë kureshtarë, të interesuar për të parë mjeshhtërinë e tyre. Në fund ndonjëri blinte ndonjë nga ato punime. Miranit për një çast iu duk vetja si ata. Kjo nuk i pëlqeu ndaj vështroi anash për të parë një mundësi më të përshtatshme ku do të shkruante i papenguar nga shëtitësit kureshtarë. Në anën e majtë, në breg të liqenit, afër urës ai pa anijen e ankoruar, të adaptuar si restorant. Ngaqë iu duk tërheqës vendosi të shkonte aty. Zgjodhi tavolinën që iu duk në vendin më të përshtatshëm, nxori fletoren dhe nisi:

SHËNIME TË VETIMPONUARË

Vështroi titullin. Sikur nuk iu duk i qëlluar. Mendoi për ndonjë titull tjetër. “Pse duhet të mendohem për të gjetur titull më artistik?”, – tha me vete ai i impresionuar edhe nga valët e lehta të liqenit që e kishte nën këmbë. “Që në start më duket se shënimet do të jenë subjektive, meqë edhe për titullin po brengosem që të jetë sa më poetik. Pamundësia për t'u mbrojtur nga subjektivizmi më ka lënë pa ditar. Më mirë do të kishte qenë të kisha një ditar subjektiv se sa të mos kem fare dhe tani ta shalakat mbamendjen. Tani do të nis me shënimet, sado që njeriu s'u liroka dot nga subjektivizmi...”. Mendja tjetër

i tha: “Mjaft më, fillo e shkruaj! Ke kohë e mundësi t’i rishkruash duke u përpjekur të bësh saktësime sa më objektive. Kohën për të cilën do të shkruash nuk e ke të largët dhe mbamendjen e ke të freskët. Shëno ato që të janë dukur më të besueshme për të bërë një tablo sa më të kompletuar të ngjarjeve e zhvillimeve. Vlerësimet nuk mund t’i mbrosh nga subjektivizmi. E ardhmja do t’i verifikojë se sa janë subjektive dhe sa do të jenë të vërteta”. Mirani u shkund pa vendosur ende se cilën mendje ta përfillte. Këtu ndërhyri kamerieri:

– Mirë se erdhët, zotëri! Ju lutem, çfarë dëshironi?

Ardhësi porositi një lëngë portokalli dhe zuri të shkruante:

“Në agim e 17 Janarit 1982, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla dhe unë bëmë bashkëimin. Në natën e asaj dite ndodhën atentatet ndaj Jusufit, Kadriut e Bardhoshit.

Më 17 shkurt 1982, në Turqi u takuan Sabit Katunriu, alias Rrobaqepësi, i shoqëruar nga Xhafar Durdeli, alias Skënderi, me Anxhyl Prupashpinën. Në takim asistoi edhe diplomati i Republikës së Shqipërisë, Bujar Haxha, siç e dekonspiruan pastaj sejmënët e Xhafarit. I njëjti pat marrë pjesë edhe në takimin e tetorit 1981, po në Turqi, midis Kadri Zeqës e Bardhosh Gërvallës me Sabit Katunriun.

Sabiti dhe Xhafari u prezantuan si përfaqësues të Lëvizjes Nacional–Çlirimtare të Kosovës dhe të Visëve Tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVTSHJ). Anxhyl Prupashpina u prezantua si Kryetar dhe si përfaqësues i Partisë Komuniste Marksiste–Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi (shkurtimisht: PKMLSHJ). Këta përfaqësues të katëyre dy organizimeve formuan Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (duke shënuar në marrëveshje edhe shkurtasën: LRSSHJ). Ata injoruan bashkëimin e 17 Janarit që e bënë Jusufi, Kadriu, Bardhi e Mirani.

Anxhyl ishte oficer i lartë i SDB–së në Prishtinë, riemërtim ky i tanishëm zyrtar i ish–UDB–së. Duke qenë në përgjegjësi prej oficeri të lartë të këtij shërbimi polior, ai themeloi Partinë e tij, ose e urdhëruan eprorët ta themelonte atë. Kjo parti mori përsipër organizimin e demonstratave të marsit e të prillit 1981 në Kosovë. Zbulohen dhjetëra anëtarë të saj, arrestohen disa nga ata dhe dënohen me shumë vite heqje lirie. Anxhyl dhe disa sejmënë të tij arratisen. Edhe Anxhyl, si dikur Rrobaqepësi, arratiset së pari në Republikën e Shqipërisë dhe

prej andej në Turqi.

Kush e përgatiti këtë takim në Turqi, ndërmjet këtyre përfaqësuesve dhe kush i bëri lidhjet nuk kam mundur ta marr vesh. Po shpresoj se do të jetoj aq gjatë sa për të pritur hapjen e arkivave të Jugosllavisë e të Republikës së Shqipërisë që të informohem, meqë këta vetë nuk po tregojnë dhe as që do ta tregojnë ndonjëherë të vërtetën.

Sqarim teknik: Bazuar në vëzhgimet e mia të mbledhura nga bashkëpunëtorët si trobat e bukës në sofër, do të më dubej që emërtimin përfaqësues, emërtimet e organizimeve të tyre dhe ndonjë gjë tjetër t'i vë në thonjëza ose të përdor prefiksën pseudo, meqë më rezultoi se këta janë përfaqësues në thonjëza ose pseudopërfaqësues si edhe emrat e organizimeve të tyre gëthashtu. Por, për lehtësim të shënimeve, nuk do t'i përdor thonjëzat dhe prefiksën pseudo.

Marrëveshjen e tyre me shkrim për themelimin të organizatës së re dhe as nënshkrimet e tyre ende nuk kam arritur t'i shoh. Jam kërkueshtar për t'i parë.

Kur shkruan në Turqi Kadri Zeka e Bardh Gërvalla për t'u takuar me Sabitin, në tetorin e vitit të kaluar, në vend të përshëndetjes mirëseardhëse, Sabiti dëbete të ketë thirrur me histerizëm në drejtim të Kadriut: "Nuk pranohet të bisedoj me një komunist si ju të OMLK-së!" Nuk e kam kuptuar atëherë, po as tani, përse në atë takim kishte asistuar diplomati shqiptar Bijar Haxha. Më shumën detaje rreth atij takimi nuk më kanë interesuar. Mundësitë i kisha për të pyetur Kadriun, Bardhoshin e Jusufin, por nuk kam dëshiruar t'ua shtoj hidhërimet e tyre të shkaketuara nga ai dëshitim. Për mua që tepër dëshpëruese dhe zhgënjyese pse ai takim dështoi. E parandjeja dështimin e tij, meqë kisha informata të bollshme për karakterin e Sabitit. Këtë parandje nuk ma hoqi as propozimi i Jusufit, i bërë në gusht të vitit të kaluar, që bashkëmin tonë formalisht ta shpallte Sabiti, si veterani i veprimtarisë së fshehtë patriotike për çlirimin e Kosovës. Atëherë Jusufi, Kadriu e unë u dakorduam për platformë të organizatës që themelohet, duke u bazuar në Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës. Ato OMLK-ja na i pat dërguar nga Kosova, përmes Kadriut. Jusufi, Kadriu dhe unë qemë marrë vesh që t'i bashkojmë tri organizimet në këtë organizatë.

Tani më janë ngatërruar vlerësimet, më janë bërë lesh arapi. Nuk po kuptoj përse Sabiti atëherë nuk kishte pranuar të bisedonte me Komunistin Kadri Zeka, kurse më 17 shkurt të këtij viti firmosi marrëveshje me Avxhyl Prapashpinën, i cili veten po e deklaroi si kryekomunist duke qenë, veç kësaj edhe oficer i lartë i UDB-së. Nga kjo marrëveshje e tyre doli Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (shkurtimisht: LRSSHJ), siç do

ta publikojnë zyrtarisht, tek më 16 maj. Për këtë më informoi sot Xhabiri, alias Bacaloku, siç ma prezantoi Hakan Mali, alias Plaku.

Xhafari që shoqëronte zyrtarisht Sabitin në atë takim, e dinte se më 17 janar, në orët e para të agimit, Jusufi, Kadriu, Barilboshi dhe unë patëm marrë një vendim madhor për bashkim në organizatën: Lëvizja/Fronti për Republikën e Kosovës. Kur ia thashë këtë, nuk i interesoi t'i përmbahet vendimeve të 17 Janarit. Duke dëshiruar të mos u imponohem ose të keqkuptohem, u pata thënë se vendimi që kemi marrë do të dëshmohet edhe kur policia t'i kethejë materialet e Jusufit që i pat konfiskuar pas atentateve. Akoma nuk e di nëse Xhafari e kishte informuar udhëheqësin e tij, Sabitin, për vendimin e 17 Janarit. Po ta ketë informuar, atëherë rezulton se edhe ai nuk ka denjuar ta respektojë atë vendim.

Sa për qëndrimin e Xhafari, i cili nuk u interesua fare të informohet nga unë për orët e fundit të jetës dhe reprimtarisë, të paketën të Jusufit, nuk jam befasuar dhe nuk po befasohem as tani. Ai dubet të jetë ndër më shumë i shqetësuar për fatkeqësinë ose për fatin, varësisht nga këndvështrimi se përse edhe unë nuk jam vrarë bashkë me Jusufin, Kadriun e Barilboshin, siç dubet të ketë qenë planifikuar. Përkundrazi, Xhafari, por edhe Sabiti kishin preokupim kryesor komplotet, mizanskenat, sabotimet kundër meje qysh gjatë natës së 17 janarit kur kanë marrë lajmin e hidhur se unë kam shpëtuar.

Edhe pse më 17 shkurt Sabiti, Xhafari e Avxhili themeluan LRSSHJ-në, në mars, një muaj më vonë, në banesë të Halim Berbatit formohet "Komiteti i Vëllezërve Gërvalla". Pjesëmarrës: Xhafar Durdeli, alias Skenderi, Drita Gërvalla, Halim Berbati, Nail Harabadaçi, Fabri Tafaleku, Osalan Osforti, Hafif Gagaj, Nuri Sylviqi—Qerosi. Kopjen e protokollit themelues, të firmosur nga emrat e sipërsbënuar e kam parë dhe habitem si kam mundur t'i mbaj mend gjithë këta emra. Ndoshta dubet të kem harruar edhe emrin e një ose dy pjesëmarrësve: Fazrit Melaj dhe Xhabil Rambeja, alias Xhaniti.

Themelimi i LRSSHJ-së ndodhi më 17 shkurt, por nuk po e publikonim themeluesit. Publik u bë vetëm themelimi i "Komitetit të Vëllezërve Gërvalla". Përse nuk u bë publike deri sot se ishte themeluar ajo organizatë? Më rezulton se binjakët komplotistë, Sabit Katunriu dhe Avxhyl Prupashpina po prisnin të tretin që do të duhej të përfaqësonte OMLK-në, për t'u shndërruar pastaj në trenjakë. Po përse po vonohet i treti? Tani mendoj se po e teproj nëse shfaq supozimin tim se UDB-ja ishte vonuar për të gjetur përfaqësuesin adapt të OMLK-së, për t'ju bashkangjitur binjakëve Sabit e Avxhyl. Dhe vetëm në

mbarim të muajt shkurt e gjeti të tretin: Xhabir Shatorin. Për këtë qëllim atij ia sajoi arratisjen nga burgu i Prishtinës. Sapo erdhi në Zvicër, Hakani ia vuri pseudonimin Bacaloku, kur në të vërtetë ai ishte më i ri se Hakani, alias Plaku.

Në muajt mars Xhafari nxori Zërin e Kosovës.

Më 31 mars, Nuri Syleviqi, alias Qerosi, në shtëpi të Vëllezërve Gërvalla, ia dorëzon, kundër vullnetit të tij, arkën e LNÇKVTSHJ-së, arkëtarit të ri të Komitetit të Vëllezërve Gërvalla, Fabri Tafalekut, alias Taksisit. Shuma: 500 DM, 5.500 lireta italiane, 70 shilinga austriak. Atëherë nuk më pat interesuar të informohesha, kur pasbë kotjen e pranimit-dorëzimit, përse ai ka dorëzuar kaq pak të holla, sado që gjatë ceremonisë mortore tre javore u grumbulluan ndihma të shumta nga bashkatdhetarët. I pranonte dhe i evidentonte Nuri Suleviqi. Nuk besoj t'ia ketë dorëzuar Nënës Ajshe dhe bashkëshorteve të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit. Sarandë Istrefajn, alias Bulen, bashkëshortën e Kadrit, e kam pyetur nëse Nurin i ka dhënë gjë nga ato ndihma. Ajo e ka mohuar.

Më 3 prill organizuam demonstratë në Bonn. Formalisht isha bashkorganizues. Trashëgimtarëve të Jusufit, ndërkohe edhe trashëgimtarëve të Kadriut, po u dukesha vetëm si argat, megjë ata nuk dinin si organizohej demonstrata.

Më 24 prill patëm demonstratë në Vjenë. Isha i pranishëm kur u mor vendimi për të bërë këtë demonstratë. Halim Berhati, si përfaqësues i "Komitetit Vëllezërit Gërvallaj" mori përsipër të paraqesë kërkesën tek organet përkatëse në Vjenë. U tubuam para Westbahnhof-it. Policia ndërhyri: "Nuk e keni paraqitur demonstratën, prandaj ju ndalohet të demonstrosni!" Doli se Halimi nuk e kishte paraqitur kërkesën, gëgjësisht nuk kishte marrë leje. Ishin tubuar rreth njëmijë veta. Unë iu afrova policit kryesor, i kërkoja falje pse kishte ndodhur ai lëshim i rëndë dhe në vazhdim e luta për një kompromis, për hir të gjithë atyre njerëzve që kishin ardhur nga largësitë e mëdha. "Keni ju ndonjë propozim?" – më pyeti kryepolici. "Të na lejoni të shkojmë te Muzeu Mbretëror për të parë Përkrenarën dhe Shpatën e Gjergj Kastriotit!" – iu përgjigja. E bisedoi me kolegë, bisedoi edhe me eprorin e tij përmes radiolëdhjes. Më njoftoi se duhej të prisja disa çaste derisa t'i kethebej përgjigja. Në atë moment sejmënët e Xhafarit e Halimit po bëheshin trima. Ata po thërrisnin: "Nuk do pyesim policinë, do demonstrosim edhe pa leje!" "Urta!" – thirrën ata që u eksituan. Duke u frikësuar se po eskalonte gjendja, luta tre bashkatdhetarë që të formonin një si skele trekëndëshe, të lidhur sup me sup, që të hip sipër supëve të tyre për t'ju drejtuar bashkatdhetarëve, tashmë të revoltu-

ar, shumica pse nuk ishte nxjerrë leja. Disa donin të demonstroinin përdhunshëm. Sapo hipa mbi supet e tyre, nisa të thërrisja me gjuhë zërin tim të fuqishëm: "Bashkëatdhetarë, vëllezër e motra, ju lutem të mbani qetësi!" Të gjuhë heshtën. Unë vazhdova: "Gabimi është yni dhe jo i policisë austriake. Ne nuk kemi bërë kërkesë, prandaj nuk kemi leje. Tani sapo bisedova me kryepolicin. E luta të na mundësojë të shkojmë rresht për të vizituar Përkerenarën dhe Shpatën e Gjergj Kastriotit tonë të madh në Muzeun e këtushëm. Ai e përvolli lutjen tek eprori i tij dhe, për pak çaste, do të na kthehet përgjigja. Ia lexova në fytyrë kryepolicit me të cilin bisedova se do të na mundësohet të shkojmë rresht deri te Muzeu. Kjo do të jetë demonstrata më origjinale, pasi do kalojmë rrugës më të frekuentuar më këmbësorë në Vjenë. Sigurisht, jeni të vetëdijshëm, se ne nuk guxojmë asesi të demonstrojmë dhunshëm ose të përleshemi me policinë, sepse do ta komprometojmë lëvizjen dhe popullin tonë, sepse do të dalim humbës e me tur. A jeni të mendimit se do të rreshtoheni qetësisht gjatë shkuarjes dhe do të jeni të disiplinuar?" Pothuajse të gjuhë duartrokritën duke prodhuar një jehonë të fuqishme. Pastaj na qetësia. Qëllimisht nuk i pyeta pjesëmarrësit nëse do ta miratonin propozimin tim për të shkuar. Kështu do t'i jepej shansi ndonjërit të kundërshtonte. Kryepolici, kur pa këtë vetëpërmbytje të disiplinuar, përdori prapë radiolidhjen për të informuar eprorin në qendër: "Janë shumë të disiplinuar dhe të qetë. Do t'ju lutesha t'ua mundësojmë që të shkojmë në rresht te Muzeu, pasi nuk do të krijojnë shqetësime." Pas disa çasteve u miratua lutja. Them se me këtë gjatë e shkathësi evitova përleshjen e mundshme, gjuhësi të turpshme, me policinë vjenze, të cilën po e provokonin Xhafari dhe sejmënët e tij. Sigurisht, edhe tani ndihem i kënaqur si atëherë. Me atë rast shumica e pjesëmarrësve panë Përkerenarën dhe Shpatën e Gjergj tonë të madh. Kur u kthyem në Westbahnhof, në vendtakimin e nisjes, ndodhën përleshje të përgjakshme midis të disa demonstruesve tanë dhe "diplomatëve" jugosllavë. Ata kështu dalë për të na fotografuar e provokuar. Ndihma e shpejtë mori dy "diplomatë" të përgjakur, pasi i identifikoi policia. Njëherë, policia arrestoi edhe katër demonstrues, kurse të tjerët u shpërndanë. Unë mbeta, i shoqëruar më pesë bashkëveprimtarë që punonin në Vjenë. Isha gjatë gjuhë kohës në kontakt me policinë. Ju shpjegoja se po të ishin të përgjakurit vërtet diplomatë, nuk do fotografonin dhe të provokonin demonstruesit. Ju propozova që t'i lirorin demonstruesit dhe të më arrestonin mua. Pas katër orëve i liruan ata, kurse mua nuk më arrestuan.

Në fund të shkurtit më telefonoi Enis Mitrovica, veprimtar shumë i angazhuar në Bruksel.

Enisi më komunikoi ftesën e motrës së tij, Fëllanzës për një vizitë në Suedi. Dëshironin të shkonin një grup veprimtarësh për të vizituar bashkatdhetarët në Suedi. E pranova ftesën. Udhëtova me Hakanin,, alias Plakun dhe Sarandën, alias Bulen. Në Suedi na pritën bujarisht. Fëllanxa me bashkëshortin dhe patriotin e devotsbëm, Nexhip Toskën na dhanë pesëdhjetë mijë korona suedeze ndihma. Ishte rasti i parë që po na jepej një ndihmë kaq e madhe. Atje qëndruam një javë. Donim të qëndronim edhe më gjatë, por Hakanit i telefonuan. Ai u njoftua se nga burgu i Prishtinës ishte arratisur Xhabir Shatori. Ai tashmë kishte arritur në Zvicër. Sa nuk u çmend nga gëzimi. Xhabiri ishte arrestuar e dënuar bashkë me të vëllanë e Hakanit. Ai nuk po përmbahet së shfaquri gëzimin: “Na ka ardhur një lekadër shumë i zoti dhe tani ka kusht të na udhëbejë.” Kur u kthyem nga Suedia në Zvicër takuam Xhabirin. Paraprakisht Hakanin e takoi atë vetëm, pastaj më tha mua: “Xhabiri është në Francë, atje ka kërkuar strehim politik. Do ta takosh më vonë. Tani do të të njoftoj me një lekadër të OMLK-së, i cili ka ardhur për të na udhëbejë. Pseudonimin e ka Bacalok. Të më mashtronte kështu e kishte mësuar Xhabiri. Kur u takova herën e parë me Xhabirin, alias Bacalokun, nëse nuk gabohem më 6 mars, më la përshtypje fascinuese. Edhe unë iu gëzoja ardhjes së tij megjë shpresoja se do të mund ta bindnim kerahun e Sabitit dhe Xhafarit që të vënë në jetë vendimin që morën më 17 janar. Pa e pyetur ai më sqaroi se Xhabir Shatori është në Francë dhe dëshiron të më takojë në rastin e parë të mundshëm. Nuk insistova më shumë. Më shumë kisha nevojë ta informoja dhe ta përfitoja Bacalokun, sepse kerahu i Sabitit e Xhafarit më kishte mbështetur për muri. I tregova se edhe Hakanin nuk ishte anëtarësuar akoma në OMLK, pasi Kadriu thoshte për të se nuk e ka plotësuar stafin e kandidatit. Këtë ia thashë për ta sqaruar se edhe Hakanin nuk është i informuar për vendimet që kishim marrë Jusufi, Kadriu, Bardhoshi dhe unë. Por Xhabirin e luta që ta respektojë e dëgjojë Hakanin me takt, pasi është punëtor i moshuar, megjithëse tani ka begenisur vetën si udhëbejë në vend të Kadriut.

Më Xhabirin jam takuar edhe dy herë të tjera dhe prapë kemi biseduar se si janë zhvilluar deri atëherë aktivitetet e veprimtaria jonë patriotike, por kemi biseduar edhe për tema të lura. Xhabiri dëshironte të më imponohej si intelektual me njohuri enciklopedike dhe me talent prej udhëbejësi. Edhe në të dy takimet e tjera i kam kërkuar që të ma mundësojë takimin me Xhabir Shatorin. Prapë u arsyetua se sapo ai të rregullojë dokumentin e udhëtimit do të kem mundësi ta takoj. Nuk insistova me këmbëngulje, pasi edhe arsyetimet e përsëritura të Xhabirit

po më bindnin. Ai tashmë po më imponohet si udhëbëqës.

Sot, kur u informova se Bacaloku paska qenë vetë Xhabir Shatori sa nuk ndodhi batakja mes nesh. Po gëzohem që munda të vetëpërmblahesha pa e bërë për spital. Por edhe atij ia shfaqta mendimin se ai manipulim që më kishte bërë, duke mos më treguar se ishte Xhabiri dhe jo Bacaloku, më kishte ndihmuar meqë si Xhabir Shatori dotë më ishte imponuar akoma më udhëbëqës dhe kështu do të më pamundësohej më shumë që të polemizoj me të më çlirshëm dhe ta kundërshtoja. Mendoj se akoma nuk jam çliruar plotësisht nga mendësia që më është injektuar në sistemin monist në Kosovë që të mos guxoj t'i kundërshtoj udhëbëqësit.

Kur Xhabiri më informoi se janë bashkuar tri organizatat në LRSSHJ, unë polemizova me të. Më është dashur të taktozohj për të mos shprehur gjithë mendimin tim kritik. Ia thashë troç se ata nuk ishin bashkuar, por Xhabiri ia kishte bashkëingjatur OMLK-në surrogatit që formuan Sabiti, Xhafari dhe Arxhli, më 17 shkurt në Stamboll. Për mendime më të kompletuara i thashë se do t'ia shfaq pasi të kam parë gjithë dokumentacionin e themelimit të asaj organizate. Taktozova dhe u vetëpërmblajta edhe për shkak se ai më informoi për vendimin që Xhafari dhe sejmienët e tij nuk do të më terrorizonin më. Bile, Xhabiri më dha falën se do ta kishte mbrojtjen e tij personale. Në fakt nuk i besova, por dëshirova t'i besoj. E gjitha u dhi në fund, kur doli se Bacaloku nuk ishte i dërguari i OMLK-së, siç më patën mashtruar vetë Xhabiri dhe Hakani i shkeretë, të cilin tashmë po e manipulon Xhabiri në mënyrë të pastërpullt. Ky që sot nuk është më Bacaloku, siç i kishta besuar këtyj dhe Hakanit, por vetë Xhabiri.

Vlerësoj se organizata e themeluar më 17 shkurt e 15 maj nuk është krijesë autentike e tre përfaqësuesve, por skenar i dikujt tjetër. Momentalisht nuk jam në gjendje të gjykoj nëse është krijesë e diplomatit shqiptar Bujar Haxha, që do të thotë krijesë e Sigurimit shqiptar, apo urdhër i UDB-së që e sollë dhe e jetësoi oficeri i saj Arxhyl Prupashpina, me bekim të Sabitit, Xhafarit dhe diplomatit Bujar Haxha. Edhe pse është e tillë, vlerësoj se është zgjedhja që do të më ndihmojë për të kapërcyer krizën time. Për momentin dëshiroj të spekuloj se arratisja e Xhabir Shatorit nga burgu i Prishtinës, përkëmbet në këtë situatë kur i kishim mbetur vetëm edhe disa muaj për të vuajtur dënimin, është skenar i UDB-së. Dëshja Sabit Katunriu dhe Arxhyl Prupashpina nuk i ka njaftuar asaj për të bërë atentat të suksesshëm politik kundër lëvizjes sonë çlirimtare në Perëndim pas atentateve fizike ndaj Jusufit, Kadriut

e Bardhoshit. UDB-ja duhet të ketë menduar se unë këtë detyrë do ta përballoj, prandaj ka dërguar të tretin që atentati politik të bëhet sa më goditës.

Vlerësim përmblyllës: Trenjakët Ardyll Prapashpina, Xhabir Shatori dhe Sabit Katunriu, por momentin janë goditja më e rëndë politike ndaj lëvizjes sonë çlirimtare në Perëndim. Njëherë këta do të jenë goditje tepër e rëndë edhe për lëvizjen tonë çlirimtare në Kosovë. Po nuk dëta t'i përballoj me mjeshteri, gjegjësisht t'i mund, atëherë këta duhet të jenë kompetentë për të marrë vendimin për vrasjen time. Tani e tutje duhet të zgjedh taktikë shumë mjeshterore se si të dal ndaj tyre fitues politikisht dhe organizativisht. Fillimisht më duhet të shtirë se po bëhem bashkëveprimtar i tyre i ngushtë, me arsyetimin se këta kanë bërë veprë të madhe patriotike. Duke e perfeksionuar këtë taktikë, unë do përpiqem të kundërshtoj vetëm për aq sa të mos i shijoj që të marrin vendim për likuidimin tim. Që sot e tutje që të tre do t'i vrojtoj me përkushtim dhe për këtë do të angazhoj edhe bashkëveprimtarë të sprovuar. Do të organizoj, pa u hetuar nga ata, fruksion që t'ua imponoj mbajtjen sa më parë të kuvendit ku kerahu im duhet të dalë fitues, meqë do të votohen vlerat.

Kam parasysh edhe mendimin e Jusufit: "Ndonjëherë UDB-ja ka formuar organizata gjoja patriotike e revolucionare për të zbuluar patriotët e vërtetë shqiptarë, të interesuar për t'u angazhuar konkretisht. Ata i ka anëtarësuar dhe në momentin e dubur për UDB-në, janë burgosur duke i akuzuar se janë organizuar për të bërë veprimtari armiqësore. Kështu UDB-ja ka krijuar përshtypjen se nuk shpëton asnjë organizim i fshehtë pa u zbuluar prej saj. Kështu ajo i ka frikësuar patriotët. Kështu ajo e ka dëmtuar rëndë kauzën tonë kombëtare, gjegjësisht e ka vonuar çlirimin tonë. Por, si çdo e keqe që ka një të mirë brenda, ajo me këtë taktikë ka mbajtur të gjallë idenë se shqiptarët patriotë duhet të organizohen, përndryshe nuk do të çlirohen asnjëherë. Në fund të fundit, sa më shumë që mbushën burgjet e pushtuesve serbomëdhenj me të burgosur politikë shqiptarë, aq më afër lirisë do të jemi." (Përfryzimi i lirë sipas mbamendjes nga bisedat me Jusufin).

Përplasjen e sotme me Xhabirin, që ai të mos detyrohet menjëherë të marrë vendim duke i bindur edhe dy të tjerët për likuidim timin do ta kompiloj si vijon: Do ta përveçtoj Hakani, i cili po më do shumë, që të na pajtojë. Para tij do të bëj autokritikë të rrehtë dhe do ta madhëroj Xhabirin duke bërë vetëm vetën fajtor. Në fund do t'i kërkoj falje po qe nevoja edhe me shkrim. Këtë do ta hanë së pari Hakani, pastaj edhe Xhabiri.

Parashikimi: Shumë shpejt Ardyll, Xhabiri e Sabiti do të përçahen midis tyre. Fillimisht

do të mbledhin informata se sa është numri i veprimtarëve në Perëndim duke i manipuluar ata që të organizohen në krabë të veçantë të secilit prej tyre. Pastaj do të përçaben që t'i demoralizojnë përfundimisht bashkatdhetarët. Kjo strategji e tyre do të ketë synim shkatërrimin përfundimtar të lëvizjes sonë patriotike e çlirimtare që inician dbe drejtuam Jusufi, Kadriu, Bardhoshi, Hysni G., alias Vasili, Maksim Saraçaj, alias Maksi, Hysen Kalishti, Muzafer Besfortaj, Enis Mitrovica, Hysen e Suljman Uça, Suliot, Nazmi e Besmirë Nelaj, Hajzer Lumi, Rexhep Halimi, Fabri Tafaleku, alias Takësi, Nazim Tetova, Saimir Perca, e shumë të tjerë, aktivistë e bashkëveprimtarë.

Dëshira: Mos dalshin të vërteta vlerësimet e parashikimet e mia ogurëza që bëra në këto shënime të vetimponuara.

Gjenevë, më 16 maj 1982
Bruçaj

Miran

PS. Këto shënime dubet të publikohen vetëm atëherë kur nuk do të dëmtobet lufta jonë çlirimtare!

Sapo përfundoi shënimet ai hetoi se ishte djersitur dhe e zuri droja se mos freskia e liqenit do ta ftohte. Vendosi të futej në ambient të mbyllur të restorantit anije. Vështroi shënimet. Ato i krijuan një ndjesi shplodhjeje. I palosi me kujdes dhe i futi në çantë duke i bërë porosi vetes: “Duhet t’i ruaj mirë derisa t’ia jap kunatës Sabrush. Do të kem kohë gjatë udhëtimit me tren t’i lexoj me qetësi, me syrin kritik si t’i kishte shkruar një tjetër. Po qe nevoja do i rishkruaj.”

Kamarieni sapo e pa që Mirani po i mbledhte gjërat mbi tavolinë ia ofroi faturën për të paguar. Ai i sqaroi se do të futej brenda për të ngrënë.

Me të mbaruar ushqimin Mirani shkoi në stacion të trenit, mori trenin e parë për në Biel/Bienne. Atje gjeti Hakanin dhe i tregoi çfarë i kishte ndodhur. Fajësoi vetën e tij, shfajësoi Xhabirin, bëri autokritikë, i kërkoi atij falje dhe e luti ta ndihmonte që të pajtoheshin me Xhabirin. Ai i premtoi se do ta ndihmonte duke e këshilluar që të jetë më i kujdesshëm në të ardhmen.

Taktika e menduar i pati sukses. Jo vetëm se u pajtuan, por ditën vijuese ai dhe Xhabiri u bënë bashkëveprimtarë të ngushtë. U mor vesh, secili duke taktizuar për t'i dhënë goditje sa më të rëndë tjetrit.

3.

Pas shpalljes së formimit të LRSSHJ-së Xhabiri u tregua shumë operativ. Ai thirri mbledhjen më 29 maj, për të formuar organin drejtues. Mbledhja u mbajt në Biel/Bienne, në banesë të Hakanit dhe Sarandës. Në mbledhje morën pjesë Xhabir Shatori, alias Bacaloku ose Halili, Xharar Durdeli, alias Skenderi, Hakan Mali, alias Plaku, Fahri Tafaleku, alias Taksisti, Sarandë Istrefaj, alias Bulja dhe Miran Bruçaj i papseudonim publik ndonjëherë. Xhabiri uzurpoi imponueshëm drejtimin e mbledhjes.

– Fillimisht po ju informoj se në mbledhje nuk është i pranishëm asnjë përfaqësues i krahut të Avdyl Prapashpinës. Këtë mungesë të tyre po e arsyetojnë se kinse ata janë penduar pse janë bashkuar me ne. Tani propozoj që organi drejtues i organizatës të quhet Komiteti qendror, i cili do të përbëhet nga 15 anëtarë, 6 në Kosovë dhe 7 jashtë Kosove, në Perëndim.

– Kush është për dhe kush kundër? – pyeti Xhabiri duke vështruar zhbirueshëm me radhë pjesëmarrësit. Propozimet e tij u miratuan njëzëri pa asnjë diskutim e kundërshtim.

Prapë Xhabiri: – Konstatim: Propozimi u votua njëzëri dhe duhet ta protokolloj.

Tashmë Xhabiri jo vetëm që po e drejtonte Komitetin Qendror, por po e komandonte atë dhe njëherit po luante rolin edhe të procesmbajtësit.

Prapë Xhabiri: – Propozoj që tre anëtarë në Kosovë t'i caktojnë Shoku Sabit ose Shoku Xhafar, kurse tre të tjerë do t'i caktoj unë. Jashtë Kosove, këtu në mërgatë, këto dy organizata që u bashkuan do t'i caktojnë nga tre veta, i shtati do të jetë Mirani. Emrat e anëtarëve në Kosovë do të mbahen të fshehtë. Vendimet e tyre në Komitetin Qendror në Zvicër do t'i komunikojmë unë dhe Sabiti ose Xhafari. Emrat e anëtarëve në mërgatë do të jenë: Nga

OMLK–ja: Unë, Hakani dhe Saranda. Nga LNÇKVTSHJ–a: Sabiti, Xhabiri dhe Fahri. Sabiti do të vijë së shpejti nga Turqia dhe do të vendoset në Zvicër. I shtati, siç thashë më parë, do të jetë Mirani.

Prapë Xhabiri: – Kush është për këto propozime?

Edhe këto u miratuan njëzëri. Xhabiri dhe as ndonjëri nga të pranishmit nuk e diskutoi nëse do të ketë ky Komitet kryetar. Vetvetiu po imponohej Xhabiri për Kryetar.

Mirani gjykoj të bënte një shaka, por që përmbante në vete një të vërtetë:

– Kur Komiteti Qendror të mbajë mbledhje do të jemi 7 anëtarë, tre prej të cilëve të krahut tënd, Xhabiri, dhe tre të krahut të Sabitit. Atëherë vendimet u varkan nga vota ime, e shtata.

– E meriton, – ndërhyri Xhabiri, – je veteran i lëvizjes sonë patriotike në mërgatë dhe vota jote përcaktuese do të na bëjë mirë derisa të jenë menjanuar krahët e dy ish-organizatave tona. Ne ende nuk po e kuptojmë se jemi bashkuar.

Këtë mendim ai e formuloi me perfiditet, duke menduar se votën e Miranit do ta kishte të sigurt, meqë ai tani po e trajtonte atë si të zënë peng.

4.

Në Bruksel Musa Hoti vret një punonjës të ambasadës jugosllave. Vrasja ndodh rreth orës tre të mëngjesit në një bar–lokal. Si motive të kësaj vrasjeje përfliteshin dy variante: E para, konflikt i çastit gjatë ndarjes së përfitimeve financiare nga veprimtaria e tyre e përbashkët kriminale. E dyta, vrasje e komanduar nga UDB–ja, që të inkriminohet e kriminalizohet emigracioni shqiptar në Belgjikë. Nga vendvrasja Musa strehohet në shtëpinë e Mentor Krimbnajes. Mentori ishte arratisur në vitët e 60–ta nga Republika e Shqipërisë në Kosovë. Ishte rekrutuar pastaj nga UDB–ja, së cilës i kishte shërbyer me përkushtim edhe pasi ishte vendosur në Bruksel. Ai e çmonte për meritë që në shtëpi të tij shkonte shpesh për vizitë vetë ambasadori jugosllav. Për këto të gjitha Mirani ishte informuar nga bashkatdhetarët që

jetonin në Bruksel.

Në agun e ditës vijuese Enis Mitrovica, shqiptar nga Kosova, dikur me shtetësi turke, tani me shtetësi belge dhe Hysen Kalishti, një patriot i moshuar e me famë që nga Lufta e 2-të Botërore, arritën te Mirani. Që të dy aktivistë të dalluar. Sapo hynë në banesë, veç shqetësimit që sollën iu drejtuan atij:

– Miran, ti ke dëgjuar për aktin patriotik të Musa Hotit. Ai ka vra një shka të ambasadës jugosllave. Tani ti duhet të na ndihmosh.

– E dini motivin e vrasjes? – pyeti tjetri.

– Nuk e dimë, por ka vra një shka.

– E dini ku është i strehuar?

– Te Mentor Krimbnaja.

– E dini se Mentori është udbash apo më keni gënjyer kur më keni thënë disa herë, me sugjerim që ne duhet të ruhem nga ai?

– E vërtetë, por Musa tani ka vra një shka të ambasadës jugosllave dhe ne duhet ta ndihmojmë.

– Çfarë mendoni, si mund të ndihmoj unë?

– Të shkosh në Ambasadën Shqiptare në Paris që të ndërvenosh për t'ia bërë një pasaportë false. Me atë pasaportë ai do të arratiset në Shqipëri.

– Është ide juaja apo jua ka propozuar dikush?

– Mentor Krimbnaja na e ka propozuar dhe na është lutur që të bëjmë këtë ndihmë patriotike.

– Atëherë dëgjoni me vëmendje: E para, mua po më vjen keq që keni bërë mundin të vini kaq herët nga Brukseli. Gjithashtu po më vjen keq që më shqetësuat mua në këtë kohë. E dyta, për Mentorin dhe për Musën çdo herë keni thënë se janë të UDB-së, prandaj për ta nuk do ta luaj prapancën vendit. Madje as ju nuk duhet ta ndihmoni tani udbashin Musa Hoti dhe nuk duhet të manipuloheni nga Mentor Krimbnaja, po ashtu udbash. E treta, nëse vërtet doni ta ndihmoni Musën, ju personelin e Ambasadës Shqiptare e njihni më mirë se unë. Unë ju kam shoqëruar dy herë kur më keni marrë me vete, meqë ishit të ftuar për Festa të Nëntorit. Shkoni vetë dhe do të shi-

hni se si do t'ju tallin e qortojnë. E katërta, me sa di unë viktima nuk është serb dhe ju assesi nuk keni pse e përdorni termin pezhorativ "shka". E pesta, Mentori si njeri njëdimensional që është ka menduar se ne vërtet do t'i sigurojmë pasaportë shqiptare false. Me të ka shpresuar ta nisë Musën drejt Tiranë dhe, në momentin e volitshëm sipas tij, do të informonte policinë belge. Kështu ai ka shpresuar që pos inkriminimit e kriminalizimit të emigracionit tonë, të komprometojë edhe Republikën e Shqipërisë si të implikuar në këtë kriminalitet.

– Nuk ke nevojë të na flasësh më gjatë, – ndërhyri Enisi, – pasi me kaq u bindem se ne paskemi gabuar që jemi angazhuar për ta ndihmuar.

Pas gjashtë ditëve strehimi, Mentori e bind Musën që të dorëzohet në polici, e cila e burgos. Sapo burgoset Musa, Xhabiri thërret mbledhjen urgjente të Komitetit Qendror. Çështje akute e rendit të punës: "Angazhimi i Lëvizjes për lirim nga burgu të patriotit Musa Hoti".

– Duhet të angazhohemi që të ndihmojmë për lirimin e patriotit trim Musa Hoti nga burgu belge! – filloi diskutimin Xhabiri.

– Kush duhet të angazhohet? – ndërhyri Mirani.

– Mos më ndërprit kur të diskutoj! – iu drejtua Xhabiri me zë autoritativ.

– Se mos të kemi kryetar që të thërrasësh mbledhje me këtë rend akut të punës dhe pastaj ta hapësh e drejtosh mbledhjen t'u? – ia bëri flakë për flakë Mirani duke vazhduar: – Me këtë rend pune dhe me këtë urdhër që po provon të na imponosh, ti dëshiron të inkriminosh e kriminalizosh Lëvizjen tonë.

– Akuzë e rëndë! – ndërhyri Xhabiri.

– Ta mbash me shëndet! – ia ktheu tjetri.

– Unë fillova mbledhjen dhe duhet të arsyetoj propozimin tim. Do t'i thërrasim të gjithë mërgimtarët që t'i dërgojnë mijëra telegrame Qeverisë së Belgjikës ku do të kërkohet lirim i patriotit trim, Musa Hoti. Ai në mendësinë e mërgimtarëve është shndërruar në Avni Rrustem dhe me telegrame duhet ta lirojmë, siç u lirua atëherë Avni Rrustemi. Jeni dakord me propoz-

imin tim?

– Edhe pse këta po e ngrisin dorën, – vazhdoi kundërshtimin e tij Mirani, tashmë i hidhëruar, – meqë nuk kanë vetëdije e kurajo të të kundërshtojnë ty, diktator i shpirtit dhe mendësisë së tyre, unë jam kundër dhe këtë duhet ta protokolloshe në procesverbal të mbledhjes, meqë pos imponimit si kryetar po na imponohesh edhe si procesmbajtës.

5.

Sabiti i shkruan letër Musa Hotit në burg ku e gënjen se Komiteti Qendror i LRSSHJ-së, për ta shpërblyer atë për veprimtarinë patriotike dhe aktin heroik të vrasjes së një shkau të ambasadës jugosllave, e koopton si anëtar në Komitetin Qendror.

Disa veprimtarë të Lëvizjes angazhohen t'i dërgojnë telegrame Qeverisë belge. Musa shumëzoi letrën e Sabitit në qindra kopje dhe ua bashkangjete përgjigjeve falënderuese. Mirani e kishte parë këtë fotokopje. Për herë të parë po shihte dorëshkrimin e gjysmanalfabetit Sabit. Ai u hidhërua për këtë komplot komprometues që po i bënte edhe tjetri Lëvizjes.

6.

Në qershor 1982 Mirani shkoi në ShBA. Shkuarjen e tij e arsyetoi me nevojën që Lëvizja të shtrinte aktivitetet e saja, meqë mërgata e atjeshme po angazhohej fare pak për Kosovën. Ai njëherit kishte nevojë të madhe që të arritisej nga Evropa, larg individëve që ia kishin nxirë jetën dhe tani po detyrohej t'i akceptonte si bashkëveprimtarë. Këtë udhëtim ia miratoi edhe Xhabiri meqë, sidoqoftë e dinte se nuk e ndalonte dot. Ai kishte menduar me vete: “Më mirë është të më hiqet qafesh që këtë ky rebel destruktiv?”

Në aeroport të Brukselit, në zonën e lirë doganore, Mirani po shëtiste nëpër dyqane tax-free duke pritur fluturimin e aeroplanit. Kur u afrua për të paguar një çokollatë, pa dashur shikoi sesi një vajzë po nënshkruante çekun me emrin “Drilonë Tanasi”. Supozoi se edhe ajo po shkonte për New York, ndaj

mori guximin që ta përshëndeste kur u largua nga banaku i dyqanit.

– Mirëdita, zonjë!

Vajza ia ktheu në gjuhën frënge: – Më falni, nuk ju kuptova.

– Mirëdita! – përshëndeti sërisht Mirani më me zë dhe më artikulueshëm.

– Mirëdita, mirëdita! Shqiptar qenkeni!? Më falni, nuk ju kuptova që më përshëndetët në gjuhë shqipe, meqë nuk po prisja të takoja këtu shqiptar! Ju, ndoshta më njihni?

– Jo, por nga pamja m'u dukët shqiptare, ndaj thashë t'ju përshëndes. Mirani e heshti faktin se e kishte parë duke firmosur çekun.

– Sa po më behet qejfi që paskam dukje shqiptare edhe nga paraqitja. Përndryshe, jam e lindur në New York dhe asnjëherë nuk kam qenë, madje as për vizitë në troje shqiptare.

– Sa rrjedhshëm e flisni gjuhën shqipe! – tha Mirani.

– Edhe ju nuk e flisni keq, – u përgjigj me sarkazmë Drilona duke mos i ardhur mirë për komplimentin.

– Më falni, por vërtet desha t'ju bëja kompliment, meqë është surprizë për mua që një shqiptare e New Yorkut flet një shqipe me artikulim e intonacion kaq të mrekullueshëm!

– Mirë që e kuptuat se nuk më erdhi mirë për komplimentin, sepse nuk mund t'i bëhet shqiptarit kompliment se e flet mirë gjuhën shqipe.

– Unë jam Martin Guçia, malësor nga rrethina e Plavës, – u prezantua Mirani duke ia zgjatur asaj dorën me dëshirën që ta zgjaste sa më shumë bisedën. Atij po i kënaqeshin syri e shpirti duke parë një vajzë të bukur shqiptare. Kishte vite pa takuar vajzë shqiptare.

– Drilonë Tanasi, malësore nga New Yorku. Dhe, që të kurseheni për të gjetur taktikën nëse jam e martuar apo beçare, po ju informoj se jam beçare.

– Hajde, hajde, nuk e paskam ditur se edhe New Yorku paska malësi! – tha ai me një të qeshur të lehtë.

– Nuk ka malësi, por ka se të duash malësorë shqiptarë.

– Domethënë, qenkeni nga raca jonë!

– Sigurisht, malësore. Rrafshjanja nuk do t’ju fliste kaq lirshëm.

– Po këto, nga i ditkeni ju në New York!?

– Sepse atje ka edhe rrafshjanë. Pastaj di gjithçka për Malësinë e Tropojës. Më kanë treguar prindërit të cilët kanë lindur atje.

– Por nuk e ditke se Malësia e Tropojës, deri në vitet e 60-ta është quajtur Malësi e Gjakovës.

– Një me zero për juve, qenkeni të vëmendshëm kur bëhet garë në bisedë. Së bashku shkuan drejt sektorit të daljes për New York. Kur hynë në aeroplan Drilona e luti personin që e kishte numrin e vendin në afërsi të saj që ta ndërronte me Miranin.

Sapo u ulën, Mirani e falënderoi për këtë mirësjellje duke menduar se çfarë duhej të fliste.

– Nëse më lejohet të di, përse ishit në Belgjikë?

– Në Paris po bëj magistraturë në shkencat politike. Në të kthyer për New York thashë ta vizitoj Brukselin. Po ju, që jetoni në Bruksel, përse po vini në New York, nëse edhe mua më lejohet ta di?

– Jetoj në Gjermani, dëshirojë të vizitoj ca miq që më kanë ftuar. Mua po më bëhet qejfi për ju që, edhe shqiptare, edhe malësore po bëkeni studime pasuniversitare në Paris.

– Falemnderit!

– Besoj të jeni e informuar për emigracion shqiptar në ShBA. A mund të më tregoni sidomos për emigracionin politik? – pyeti Mirani me shpresë se do të merrte informacion, meqë për atë qëllim po udhëtonte dhe po mendonte se kishte takuar një vajzë kompetente për t’iu përgjigjur.

– Pavarësisht faktit se nuk e di përse ju duhet ky informim?

– Mos u merakos. Jemi bërë si hije me dyshimet e shumta që kemi. Them që, sikur edhe dele të ishim, do të duhej të na interesonte se ku dhe si jemi. Në malësitë tona ndodh që bariu t’i shpërndajë delet në dimër nëpër farefis e miq kur nuk ka ushqim për to deri në pranverë. Por ama e di se ku i ka shpërndarë që t’i grumbullojë sërish në pranverë dhe sigurisht që i intereson

të pyes herë pas here gjatë dimrit nëse i ka mirë. Kurse kombit tonë i dalin jashtë qindra mijë veta dhe askujt nuk i intereson sesi i kanë hallet ata, a po asimilohen, a po merren edhe me veprimtari politike patriotike. Besoj duhet ta dini se si e kemi gjendjen në atdheun tonë.

– Nejtë, nejtë, – ndërhyri Drilona me ton hakmarrës për ndërhyrjen që i bëri Mirani, por gjithnjë me finesë, – ju kuptoj çfarë ju intereson të dini. Ndërkaq, se përse ju intereson mua nuk po më shqetëson. Ai shëmbulli me delet nuk më pëlqeu se ne nuk jemi dele.

– As unë nuk jam dash, – ndërhyri me të qeshur Mirani duke vazhduar, – unë nuk e kuptoj përse duhet të prekeni kur nuk e meritojnë kafshët t'i paragjykojmë kaq shumë. Sidomos ne malësorët meqë për kafshët shtëpiake kemi respekt të admirueshëm, u jemi mirënjohës që kemi mundur të mbijetojmë duke i shfrytëzuar ato.

– Ok. Në rregull, desha të them, por sesi na është bërë shprehja ta themi në anglisht. Tani dëgjojeni mendimin tim lidhur me komunitetin tonë atje. Jemi komuniteti më i paorganizuar, për të mos thënë më për faqe të zezë. Do thosha se ngjajmë me një turmë sklevërish që vetëm punojmë dhe nuk bëjmë fare jetë qytetare. Sa i përket organizimeve patriotike jemi edhe më keq. Babën e kam intelektual të angazhuar që redakton një gazetë tradicionale shqiptare. Shpesh debatojmë. Ai hidhërohet kur shqiptarët nuk kanë interesim që ta lexojnë atë gazetë. Pra, që të jem sa më konkrete, në Amerikë është një emigracion i vjetër politik, i përbërë kryesisht nga të arratisurit nga Shqipëria. Tani ata janë aq të moshuar sa që nuk janë në gjendje t'i mbajnë takimet e tyre në kat të dytë se nuk i ngjesin dot shkallët. Pikërisht ata e kanë përçarë emigracionin. Janë të organizuar në dhjetëra grupime që vetën e quajnë parti politike nacionaliste, djathtiste, zogiste, balliste e të ngjashme. Edhe pse kanë përcaktime ideo-politike tepër të ngjashme mes vete, nuk ishin e nuk janë në gjendje të bashkohen qoftë edhe për të festuar bashkërisht Festën e Flamurit. Që ta dini, ne fëmijët e tyre, brezi i dytë, ndihemi të neveritur nga patriotizmi arkaik i tyre, prandaj e shikojmë jetën tonë individuale. Shumica e

brezit të dytë tashmë nuk flet fare shqip, me ndonjë përjashtim të vogël si rasti im që kemi prindër vërtet patriotë. Emigrantët më të moshuar ekonomikë janë fare të painteresuar për çështje kombëtare. Emigrantët ekonomikë, ata të moshës më të re që kanë ardhur nga pjesët e robëruara të Shqipërisë etnike janë më të ndërgjegjësuar dhe më të interesuar për të bërë tani diç për Kosovën, por pengohen brutalisht nga emigracioni i vjetër politik, për të cilin ju fola. Sa për konkretizim po ju sjell një shembull që tregon më së miri vetëdijen dhe kulturën tonë kombëtare e qytetare. Në prill të vitit 1981 u organizua një protestë për Kosovën para Selisë së OKB-së në New York. Nuk morën pjesë as treqind veta. Pse, mund të pyesni ju. Sapo ndodhën demonstratat në Kosovë, mërgata e vjetër politike, siç e quan baba im, me ndonjë përjashtim simbolik nisi të përfliste se në Kosovë janë ngritur kuqaloshët e Eventit, se ata nuk e dinë se e kanë më mirë të jetojnë në Jugosllavi e të tjera. Pastaj qenë aktivizuar ca të tjerë nën dirigjim të diplomatëve jugosllavë për të përhapur frikë se do të përndiqen gjithë ata që marrin pjesë, kur do të shkonin për vizitë në vendlindje. Edhe vetë organizuesit e protestës u shamatuan mes tyre se në emër të kujt do të bëhej protesta, se cili do të mbante fjalim e të tjera si këto. Përfundimisht dolën më pak se treqind veta, shumica të ardhur nga të gjitha anët e Amerikës. Ndërsa vetëm në New York duhet të ketë mbi 50 mijë shqiptarë. A s'mund të themi se ky emigracion është për faqe të zezë?

Drilona bëri një pauzë të vogël për të menduar nëse duhej ta vazhdonte apo ndoshta e kishte tepruar. Mirani hetoi dilemën e saj dhe gjykoi se duhej të fliste, por pa ditur çfarë të thoshte. Nuk kishte pritur se krejt rastësisht, gjatë një fluturimi do të dëgjonte shpjegim kaq analitik nga një bukuroshe shqiptare. Sikur të mos shqiptohej kjo analizë nga goja e saj e bukur mbase do t'i kundërvihej. Megjithatë, foli.

– Ju falenderoj për këtë shpjegim kaq analitik! Pak a shumë kisha informim. Shpesh kam marrë letra e telefonata nga bashkatdhetarët tanë. Madje tani më kanë ftuar që t'u shkoj në ndihmë.

– Domethënë, ju jeni të angazhuar politikisht. A mund të më thoni më

konkretisht, meqë nuk ju pyeta në fillim se më erdhi keq, me se merreni? Mos më keqkuptoni, edhe emrin jua harrova!

– Jam veprimtar i Lëvizjes për Republikë të Kosovës dhe aktualisht vetëm kësaj veprimtarie iu kam kushtuar. Emrin e kam Miran Bruçaj. Fillimish qeshë prezantuar me emrin Martin Gucia, meqë nuk ju njihja.

– Mos e zgjatni! Ju të ilegales e keni shprehi të përdorni pseudonime për shkak të konspiracionit. Kërkoj falje që po jua them kaq shkoqur. Ju shpesh panevojshëm e teproni me pseudonime deri në banalitet. Njoh ca nga aktivistët tuaj në New York që ende edhe në familje të tyre i thërrasin me emrat që i kanë përdorur gjatë ilegalitetit në Kosovë. Tani do të më dilni i njohur, meqë kemi ca Bruçaj në New York. Ata të restorantit të madh ku i bëjnë dasmat shqiptarët dhe ku kemi mundësi të dëgjojmë muzikë të mirë shqipe. Një kushërinjë imja i ka dajë. Domethënë, Ju tek ata shkuakeni për vizitë?

– Jo, shkoj te disa patriotë të Malësisë së Madhe. Ata më kanë ftuar. Kushërinjtë frikësohen të angazhohen hapur. Edhe fshehurazi nuk po na ndihmojnë gjë se kanë vendosur të pasurohen për vete.

– E pra, ju uroj suksese dhe besoj se do të na nderoni me vizitën tuaj. Babait tim do t'i bëhet qejfi të njihet e të bisedoj me juve. Edhe unë ju mirëpres dhe, po s'doli ndokush t'ju presë në aeroport, ju ftoj të vini në shtëpinë tonë, meqë mua më presin. Që andej do t'ju çojmë tek ata malësorët, të cilët baba duhet t'i njohë.

– Ju falenderoj për ftesën, por do të marrë taksì dhe do të shkoj te një mik. Mirani e kuptoi se bëri lajthitjen e dytë. Ai kishte ndër mend të shkonte te kushërinjtë, por mendoi se nuk duhej t'i tregonte asaj në kaudër të vigjilencës së tepruar të shndërruar pothuajse në mani.

Tutje biseduan për shumëçka, për lëvizjen studentore në Evropë që nuk ekziston në Amerikë, për filozofë e politologë, për letërsinë. Në aeroportin Kenedi u ndanë pa shkëmbyer adresa e numra telefoni, sado që nëna e Drilonës si dhe e bija insistuan ta merrnin Miranin me vete.

7.

Në New York ditëve të para Mirani u vendos te patrioti tashmë i afirmuar, Ahmet Zherka. Atë e pandehte si dhëndër, meqë bashkëshortën e tij, Diellzën, e kishte si kushërinë, sado që të brezit të pestë. Një ditë Diellëza e pyeti:

– A ma tregon historinë e familjes sonë se ku puqemi ne?

Mirani sa nuk e keqkuptoi, se mos ajo dëshironte ta përzinte mjeshtrësisht nga shtëpia. Ndoshta i erdhi ky mendim meqë familja e Diellzës dhe Ahmetit mezi po e përballonin shkollimin e fëmijëve të tyre: vajzës së madhe që e kishin në Akademi ushtarake dhe të tre djemve që shkonin në fakultet dhe shkolla të mesme e fillore. Megjithatë vendosi t'i tregonte, meqë një mendje i thoshte se shqiptarët e kanë kujtesën e shkurtër historike edhe për prejardhjen e tyre familjare. Asnjëherë nuk kishte mundur ta kuptonte se përse shumica e shqiptarëve nuk e dinin emrin e të parit të tyre të brezit të tretë e lëre më të të katërit e tutje. Ndoshta kjo vinte nga muzgu i kohërave kur pushtuesit osmanlinj donin që shqiptarët të harronin se sa shpejt ishin konvertuar nga besimi katolik e ortodoks në besimin mysliman, apo për shkak se shqiptarët ndiheshin si t'i kishin lindur zotit me zor.

– Istrefi ka qenë i pari ynë i përbashkët. Ate, bashkë me 300 burra të fshatit, që ndonjëherë gabimisht po praktikohet të thuhet se ishin më të mirët, pushtuesi malazez i lidhi dorë për dorë, i dërgoi në vendekzekutim, i detyroi të hapnin varret e tyre, i theri me bajoneta dhe i groposi pa u dalë akoma shpirti. Djali i tij, Kadriu, shkon te vëllai i nënës, Rexhë Avdia, në Rugovë të Pejës. Ky, Rexhë Avdia, tashmë është figurë historike dhe një këngë folklorike që i është kushtuar atij nga rapsodi popullor i kohës, përmban vargjet:

*Rexhë Avdia zog i atit,
fyt për fyt me t'bitë e Markut...*

Kur jemi këtu po të tregoj një shaka të zezë. Më rastisi ta qortoj vëllanë tim më të vogël, Qerkinin, të cilin nuk e kam parë prej vitesh. Ai ma ktheu: “Nuk prish punë pse po më qorton duke më thënë kalë, meqë kemi një lidhje me

të në prejardhjen tonë familjare. Daja i katragjyshit tonë, Rexhë Avdia, paskësh qenë “zog i atit”, sipas këngës që ende këndohet e që do thotë “mëz i kalit..”

Dhëndri, Ahmeti, qeshi papërmbajtshëm dhe Miranit i erdhi inat ndaj iu drejtua:

– Po ti dhëndër, ç’ke që tallesh me të parët e mi të largët? Ti përditë babën tënd, që e kemi të pranishëm, vazhdon ta thërrasësh kriminel dhe jo babë.

– I tillë është. Na arratisi nga Malësia e Tropojës në Kosovë sepse nuk i pëlqente regjimi komunist shqiptar. I manipuluar, mendonte se regjimi komunist serb ishte më i mirë. Vetë pastaj u vu në shërbim të detyrueshëm të UDB-së dhe sa herë ka dalë diversant në Shqipëri për interesa të pushtuesit serb. Ai më arsyetohet se ka dalë për të luftuar komunistët e Enver Hoxhës. Por, kur i kundërvihem se a nuk ishte komunist edhe kriminelin Rankoviç, atëherë ministër i brendshëm i Jugosllavisë, ai hesht i zënë në faj, duke u arsyetuar se nuk dinte shumëçka në atë kohë.

Miranit i erdhi keq për babanë e Ahmetit dhe e ndërpreu:

– Të shkuara, të harruara, thotë populli. Le të orientohemi nga e ardhmja duke qortuar të shkuarat e hidhura, por jo duke i sharë e duke i ofenduar viktimat e shpërdoruar! Ato nuk kanë qenë të vetëdijshme për veprimet e tyre. Janë shpërdoruar nga të tjerët dhe si të tilla kanë qenë edhe vetë viktima.

Pushoi një hop duke menduar se kishte thënë diç të zgjuar për momentin, por iu ngatërrua ke mendimi labirinteve të kujtesës.

– Harrova ku e lashë?

– Të Rexhë Avdia që paska qenë zog i atit dhe prandaj vëllai të ka tallur se origjina juaj u lidhka me kuaj nga ana e katragjyshës.

– Prit dhëndër se Malësia nuk e ka pasur traditë që ta ofendojë kaq rënd mysafirin!

– Më fal, ishte shaka e rastit e pamenduar mirë! Një bisedë e lirë e shoqëruar edhe me pak humor të zi.

– Edhe unë si humor e kuptova dhe nuk u preka, – e ndërpreu Mirani. –

E po, isha te Rexhë Avdia. Desha të tregoj edhe një si legjendë të dëgjuar nga baba im. I paskësh falur Rexha nipit të tij, Kadriu, një livadh të madh në formë të një lugine. Kadriu i thotë: “Dajë, të falenderoj që po më fale kaq shumë tokë për të filluar këtu jetën time të pavarur, por urdhëro një cigare dhe thuaj që nuk ma fale, por ma dhe për një cigare, meqë pasardhësit e tu mund t’i bien pishman se gjërat e dhuruara edhe mund të merren”. Që atëherë ato livadhe quhen “Gropa e Kadrisë”. Kadriu, katragjyshi im, ka lindur vetëm një djalë, Ramën, Gjyshin tim. Ai kishte tre djem: Shabanin, Cenën dhe Haxhiun. Shabani vdiq. Në vitet e 20-ta familja jonë kishte vetëm gjashtë anëtarë. Tani jemi rreth 70, meqë për lindjet e viteve të fundit nuk jam i informuar. Jam detyruar t’i shkëpus lidhjet me familje për ta zbutur terrorin që po i bën UDB-ja asaj shkaku i angazhimit tim.

Ja kjo është historia e lidhjes sonë familjare, kushërinë e dashur.

Pas një heshtjeje të vogël, Mirani gjykoj se ishte momenti të bënte edhe një shpjegim:

– Edhe diçka që të kuptosh përse jam në shtëpi të dhëndrit dhe jo te babai dhe vëllezërit e tu, ku është dashur të shkoj së pari. Kur erdha në aeroport telefonova tek ata. Zymryti, vëllai yt, të cilin në Prishtinë gjatë studimeve e kisha edhe shok, u befasua për ardhjen time, meqë unë nuk paralajmëroj njerëzit për vizitat që u bëj. Më tha ta merrja taksinë, t’ia jepja adresën dhe ai do të priste para dere që ta paguante. Kur arrita aty më tha: “Më vjen keq, por babai po frikësohet që ti të hysh në shtëpinë tonë, sado që të gjithë jemi gëzuar për ardhjen tënde. Ai po frikësohet për shkak të vëllait Shabiut që është Sekretar i Kuvendit të Kosovës, se mos UDB-ja po e merr vesh që ti je te ne dhe do ta nxjerrë atë nga puna e ta burgosë. Prandaj po shkojmë te dhëndri, meqë ai nuk i frikësohet UDB-së”.

– Mirë se na ke ardhur! – ndërhyri Ahmeti. Në vazhdim ai u mundua ta arsyetojë vjehërin, me gjasë për hir të gruas. – UDB-ja, vërtet bën edhe këso përndjekjesh kolektive që janë të ndaluara madje edhe me ligjet jugosllave.

– Do të shkojmë sonte për vizitë kur të errësohet se kështu me ka porosi-

tur, – tha Djellëza kokë më vete sa për ta shfajësuar babanë e saj.

– Do të shkojmë, – miratoi Mirani.

8.

– Shpresoj nuk më ke keqkuptue e nuk më je idhnu që nuk të pranova në shpi, pasi rendi e donte të vish këtu se pari, – foli Binaku pasi u përçafuan përmallshëm dhe pasi u përshëndetën.

– Jo xhaxha, gjithçka është njerëzore, edhe frika e kujdesi. Ti ke të drejtë. Edhe vëllanë tim, Mujën, kur shkoi për pushime me familje në vitin 1979 në Kosovë, UDB-ja e persekutoi pse po më linte të shkoja në shtëpi tek ai. Ia morën pasaportën dhe nuk e lanë të kthehej në punë në Gjermani për gati dy vjet. Kështu po veprohet në Kosovë. Prandaj ti ke arsye që frikësohesh e ruhesh. Edhe Shabiut mund t'i ndodhin të këqija po nuk e ruajtëm edhe ne.

– Djali i mixhës, unë po frigohem edhe për ardhjen tane këtu, pasi kemi shumë mizevira, që janë rrogëtarë të shkjaut dhe tutem se të bajnë noj t'ke-çe. Ti do ta ngosh mixhën tand, do të vendosesh fillimisht në një katund turistik këtu afer. Unë do ta paguaj hotelin...

– Axhë, mos u merakos për mua, – ndërhyri Mirani. – Nuk kam ardhur këtu të pushoj në hotele, por të takoj shqiptarë. Me Ahmetin po takojmë përditë dhe shpejt do të shkojmë në qytete të tjera, meqë po na zgjerohet rrethi i atyre që po shfaqin dëshirën që t'i vizitojmë.

Në vazhdim plaku Binak po rrëfente për gjendjen në Kosovë, për nënën e Miranit, për hallet në familje të saj, meqë para katër muajve ai kishte qenë atje për vizitë dhe për t'ia sjellë nusen djalit të parafundit, Zymriut. Të pesë djemtë i kishte në punë në New York, kurse Shabiun në Prishtinë. Tri rejat dhe vajza po dëgjonin, kurse nusja shërbente. Në një moment të papritur nusja Mirëvetja ndërhyri:

– Baba, nuk po je i saktë, pasi gjendja është shumë më e rëndë dhe më e tensionuar se sa e si i tregove ti Miranit. Ky më njeh mua nga koha e studimeve, atëherë kur u njoha me Zymriun dhe këta ishin shokë të ngushtë.

Ky e di se unë gjatë demonstratave të '81-shit punoja në klinikë, si infermiere. Gjatë atij rebelimi popullor kam parë tmerr me sy. Gati sa nuk na e nxori shpirtin profesoresha Sadete Mekuli që ishte drejtoreshë reparti. Na urdhëroi të bënim të pamundurën që t'i shpëtojmim demonstruesi e plagosur. Shumë veta vdiqën në duart tona. Erdha këtu dhe pashë se si shqiptarët po bënin vetëm llafe, po punonin si sklevër për të paluar sa më shumë dollarë dhe i kishte mbërthyer vesi i babëzisë për të hëngër tri herë në ditë steka. Unë nuk po mundem ta duroj këtë gjendje. Ja ku i ke bizhuteritë e mia, – foli Mirëvetja në drejtim të Miranit, – sepse nuk po mund t'i mbaj në qafë mbi 100 tonelata miell, kur në Prishtinë vëllezërit e motrat tona që po përzihen nga puna për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata nuk kanë bukë të hanë, nuk kanë as armë të vetëmbrohen nga kriminelët serbë.

Vaji me dënësë ia ndërpreu fjalën emocionuese. I hoqi bizhuteritë e shumta nga qafa dhe i vendosi mbi tavolinë. Iku për të vazhduar vajin gjëmë në dhomën tjetër. Kunatat i shkuan prapa dhe po e lagnin me ujë duke menduar se e kishte humbur vetëdijen kur u përplas në shtrat në dhomën ku rrinte familja me mysafirët. Binaku dhe Mirani mbeten të heshtur pa ditur çfarë të flisnin. Nuk po lëviznin vendit dhe dukeshin në gjendje prej të nemiturve. Mirani po mendonte me vete: “Hera e pestë që gratë po shfaqin gatishmëri për të ndihmuar veprimtarinë çlirimtare në mënyrë konkrete. Hera parë me ka ndodhur në vitin 1978, në Düsseldorf. Malësorja nga Tetova, emri i së cilës tani nuk po më kujtohej, por di që është bashkëshortja e bashkëveprimtarit Saimir Përca, kishte ofruar gjithashtu bizhuteritë e saja për të financuar botimin më të shpeshtë të gazetës *Bashkimi*. Ajo tani nuk është në Gjermani, pasi UDB-ja pat arrestuar Saimirin kur shkoi për pushime në Tetovë. Herën e dytë, Fatushi, vajza e veteranit Hysen Kalishta që kishte lindur në kampe të refugjatëve të luftës në Greqi, ishte organizuar në Bruksel bashkë me tri shoqe të saja që t'u trokisnin derë më derë shqiptarëve duke u kërkuar atyre ndihma financiare për Kosovën. Gojëkëqijtë ishin përpjekur ta sabotonin këtë aksion duke i përgojuar ato se gjoja po mbledhnin të holla për vete. Herën

e tretë, Malësorja e Gostivarit, Hana, me shami të havalesë në kokë, gjatë vitit 1981, mbloodhi ndihma simbolike në tubimet e gjermanëve, pasi u kishte folur atyre për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe për domosdoshmërinë e çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb dhe nga diktatura komuniste. Herën e katërt, Flanza, bashkëshortja e patriotit veteran Nexhip Pogradeci dhe motra e Enis Mitrovicës, e cila bashkë me të Shoqin dha ndihmë pesëdhjetë mijë korona suedeze kur ishim gjatë vizitës në Suedi në fund të shkurtit të vitit 1982. Tani edhe Mirëvetja po i ofronte bizhutenitë e veta në këtë mënyrë kaq demonstrative dhe dramatike. Se mos është kjo dhunti e mendësi, – po rezy-monte Mirani, – që ka për bazë ndjeshmërinë më të theksuar të gruas, për dallim nga burrat, meqë nuk kam përjetuar ndonjëherë që burrat, madje as bashkëveprimtarët, të shprehin gatishmëri kaq konkrete dhe kaq me vlerë për të ndihmuar veprimtarinë çlirimtare!?”.

– Fola diçka, Miran burri! – ia këputi fillin Binaku.

– Çka të them, axha Binak? Mirëvetja ia vuri kapakun bisedës tonë dhe mua më la pa tekst, siç thonë intelektualët. Do të thotë me la pa fjalë, siç thotë populli.

– Qe besa edhe mua më preku në zemër, por nuk kemi çka me ba, se shkau ashtë i fortë e ne kemi qëllua xhahila për njani-tjetrin.

– Mos axhë, mos fol ashtu! E kam me të dëgjuar, kur janë çue në revoltë populli, më 1 e 2 Prill, në Prishtinë i ka ndodhur ndonjërit t'i thotë të njohurit të tij: “A edhe ti paske dalë në protestë? Unë të ruhësja me mendimin se spiunon për pushtuesit.” Prandaj nuk jemi xhahila për njëri-tjetrin, por na ka lodhur pushtimi, na kanë shtypur që të mos kemi vetëdije sociale, qytetare e patriotike. Tani po ngjallemi dhe me ndihmë edhe të zotit do të fitojmë.

– Të lumtë goja! – ndërhyri Binaku meqë i erdhi mirë që tjetri përmendi edhe ndihmën e zotit. – Kemi me fitua, por kemi me u damtua shumë pasi Serbia nuk e lëshon kollaj Kosovën.

Të nesërmen Ahmeti e njoftoi Miranin se Hasmi Terpeza kishte filluar të përfliste sipas mesit ku gjendej se UDB-ja ka dërguar spiunin Miran Bruçaj për të përçarë shqiptarët në Amerikë dhe për të përhapur ideologji komuniste, ose se e ka dërguar Sigurimi për të përhapur ideologji enveriste. Kjo fushatë e tij e kishte hidhëruar së tepërmi Ahmetin, prandaj i propozoi Miranit ta takonin dhe të sqaroheshin. E gjetën në restorantin e malësorit Feroviq nga rrethi i Plavës, i cili veten e ndjente për shqiptar, por nuk dinte shqip. Fliste serbish si rrjedhojë e asimilimit serb të shqiptarëve të Plavës. Aty gjeten Hasmiun dhe iu ulën në tavolinë pa e pyetur nëse ishte e lirë të uletshin.

– Nga e more vesh që po vija unë dhe që jam spiun i UDB-së, ose i Sigurimit shqiptar? – pyeti prerat Mirani.

– Kush jeni ju, nuk po ju njoh? – pyeti Hasmiu me një zë që nuk ia fshihte frikën nga Ahmeti.

Ahmeti para ca viteve kishte pasur një incident të rëndë. Firma e madhe ku punonte ai ishte e një amerikani me origjinë ruse. Kur pronari i kishte hyrë për vizitë të rastit në zyrë të punës Ahmetit, e kishte parë flamurin shqiptar në tavolinë të punës dhe e kishte pyetur: I cilit shtet është ky flamur? Ahmeti i kishte thënë se është flamur kombëtar shqiptar. Pronari e kishte hedhur flamurin përdhe dhe e kishte shkelur me këmbë duke i thënë se nuk guxonte më ta vendoste atë flamur të urryer mbi tavolinë të punës në firmën e tij. Ahmeti, i prekur në sedrën e tij patriotike, si malësor që ishte, menjëherë kishte nxjerrë revolverin nga sirtari i tavolinës dhe ia kishte zbratur në gjoks përdhunesit të flamurit. Kjo trimëri dhe qëndrimi serioz i tij bën që Hasmiu tani të kishte frikë nga Ahmeti.

– Jam vetë Miran Bruçaj!

– A, ti qenke? – pyeti Hasmiu i befasuar dhe tashmë edhe më i frikësuar. – Kështu na kanë informuar nga Gjermania individët që i keni në krye të Lëvizjes suaj.

– Ka emër ai që të ka dezinformuar?

– Nuk ia di, meqë mua më ka treguar O. G., konsulli shqiptar në konsul-

latën jugosllave.

– Domethënë, ti u informoke nga konsulli jugosllav? A po të duket e logjikshme që konsulli jugosllav t'i dekonspirojë spiunet e UDB-së së tij? Ai shqipfolës kështu do t'i kompromentojë patriotët e angazhuar shqiptarë si spiunë të UDB-së, që pastaj patriotët këtu të frikësohen që t'i takojnë. Kurse ti, kriminel i urryer, je vetë spiun i UDB-së. A nuk të ka dërguar UDB-ja ty disa herë si diversant në Republikën e Shqipërisë që atje të bësh krime? Të qenit tënd diversant ua tregon me krenari njerëzve këtu. Përgjigju, pusht!

– Jo, më ka rekrutuar kushërinë im, patrioti veteran Hysen Tërpeza.

– Gënjen, ai vetë më ka thënë se nuk të ka dërguar. Por as ai satrap nuk është më i mirë se ti. Të një loze jeni. Për poshtërsitë e tij kundër kombit shqiptar me ka folur në Bruksel gjerë e gjatë, në mënyrë tepër bindëse, patrioti i vërtetë, luftëtari i shquar, veterani Gjellë Kalishta. Edhe një herë: A ke qenë diversant në Shqipëri?

– Po, jam kanë, unë ia qi nanën Shipnisë.

– Shqipërisë ia qi nënën ti!

– Po, asht shtet komunist.

– Shave Shqipërinë apo komunizmin?

– Shipninë komuniste, – u përgjigj duke u dridhur si pulë e lagur.

– Kërko falje që shave Shqipërinë, kurse komunizmin shaje sa të duash, këlysh i komunistëve serbë! Kurse për shpifjet kundër meje do të ma paguash! Mirani u ngrit nga karriga dhe ia ngjiti për gërklani. Hidhërimi i tij mori përmasa egërsimi. Ndërhynë ca të pranishëm dhe iu lutën që ta lironte. Disa emigrantë të rinj filluan të gajasëshin. Njëri nga ata, i mllëfosur, por edhe i ngazëlluar nga ky gjest i Miranit foli zëshëm:

– Tregoje tani trimërinë, qen serbil! Kështu na kanë terrorizuar këta mercenarë të UDB-së, lumë trimi që ende nuk po ju njoh, – dhe kështu duhet t'ua bëjmë sa herë që të na dalin përpara.

– A ta vrasë, – e pyeti Ahmeti Miranin.

– Jo, e ka vrrarë Zoti. E shoh se është bërë kufomë e gjallë. Lëre të vuajë kjo

qelbësirë, – tha ai.

10.

Malësoni Non C. kishte përgatitur darkë për nder të Miranit. Me këtë rast ai fton miq e bashkëveprimtarë të tij. Ky grupim i malësorëve nga Malësia e Madhe, pjesa e pushtuar nga Jugosllavia, me kryeqendër urbane Tuzin, përbehej nga burra të gjatë e të pashëm, gojtarë e me plot humor, kryesisht të besimit katolikë, po edhe ithtarë të ateistit Enver Hoxha. Sapo Mirani hyri në banesë të Nonit bashkë me Ahmetin, i ranë në sy simbolet e besimit katolik dhe fotografia e Enverit të varura në muret e dhomës së miqve.

Kur u përshëndeten, Mirani me humor u thotë se tani e tutje do të më thërrisni Palokë, meqë gjendem midis shqiptarëve katolikë. Dhe ashtu ndodhi. Të gjithë vazhduan ta thërrisnin Palokë. Pastaj bëri humorin e dytë:

– Nuk po kuptoj si mund të qëndruakan të varur në mur pranë e pranë, Profeti Jezu Krisht në kryq dhe ateisti Enver Hoxha.

– Janë që të dy profetë, – u përgjigj nikoqiri, – Edhe Enver Hoxha po banë në Shqipni, ato qi bante Jezu Krishti, kjoftë i lavduem!

Kur hetoi se të pranishmit e nderonin Enverin si profet, frenoi veten që të mos bënte më shumë humor.

Ndërkohë, Gjergj K. pyet Miranin:

– Si po ecën aksioni për lirin e trimit Musa Hoti në Evropë?

– Për cilin aksion e ke fjalën?

– Dërgimi i telegrameve dhe mbledhja e ndihmave financiare për t'ia paguar avokatët.

– Nuk jemi duke i dhënë shumë zor, – tha ky.

– Çfarë po thua? A je ti në kryesi të Lëvizjes ku është marrë vendimi për këtë aksion? Pastaj Sabit Katunriu, në emër të kryesisë së Lëvizje e ka kooptuar Musën në atë kryesi për merita patriotike që ka për vrasjen e atij shkau të ambasadës jugosllave. Ne e kemi kopjen e letres që e ka shkruar me dorën e tij Shoku Sabit. Këtu ne kemi filluar të mbledhim ndihma financiare dhe

gatishmëria e patriotëve është e madhe.

– Besoj keni durim të dëgjoni sqarime më të zgjeruara, sepse ju këtej jeni larg dhe nuk kemi mundur t'ju informojmë, siç i informojmë bashkatdhetarët në Evropë Perëndimore. Njëherit nuk keni qenë në rrjedhë të ngjarjeve. Që në fillim po ju tregoj edhe një fakt që nuk e dini. Musa, kur u shkruan disave në Evropën Perëndimore i porosit që të ruhen nga unë, të mos më tregojnë asgjë, të më izolojnë se gjoja jam element destruktiv. E tregova këtë që të mos më hidhëroheni kur të merrni vesh më vonë. Kurdoherë do të bindeni se nuk po flas i nxitur nga inati personal.

Unë vërtetë jam anëtar i Komitetit Qendror të Lëvizjes, ku është anëtar edhe zotëri Katunriu. Në atë Komitet jemi anëtarë të barabartë. Por, e keqja qëndron se që kur është formuar Komiteti Qendror, zotëri Katunriu nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje. Ai jeton në Turqi dhe nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet që bën Komiteti ynë në Zvicër e në Gjermani. Për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë në mbledhje, ai, si gjysmanalfabet që është, dhe këtë ju duhet ta keni parë nga shkrimi i tij, Komitetin Qendror e quan kryesi, sado që Lëvizja nuk ka organ me këtë emër. Në këtë Komitet Qendror që e drejton Lëvizjen nuk është marrë vendim për ta kooptuar Musa Hotin dhe as për ta ndihmuar financiarisht. Zotëri Katunriu e ka bërë këtë veprim, do të thosha naiv, ndoshta edhe hileçar, krye më vete, pa qenë fare i autorizuar nga organi i vetëm drejtues që ka tani Lëvizja. Pastaj, sipas mendimit tim, Musa Hoti nuk ka bërë veprë patriotike, por akt kriminal. Ai vërtet ka vrarë një nëpunës të Ambasadës Jugosllave. Por, shtrohet pyetja: përse e ka vrarë?

Në vazhdim Mirani rrëfeu vendndodhjen, motivin dhe bëri vlerësimet duke e përbyllur me konstatimin që dilte sipas rrjedhës së ngjarjes.

– Tani jam i mendimit se Musa po përdoret nga organet belge të hetuesisë, që si duket bashkëpunojnë me ekspertë të strukturave përkatëse të Beogradit, për të mbledhur informata për gjithë veprimtarinë e Lëvizjes. Them kështu sepse Musës në burg, ndoshta edhe në ndonjë kabinet pune, i është dhënë

mundësia të shkruajë qindra letra me makinë shkrimi, të fotokopjojë qindra herë letren e zotëri Katunriut dhe të gjitha këto t'ua dërgojë veprimtarëve të Lëvizjeve. Pastaj atij i vihen në dispozicion kopjet e telegrameve e letrave që patriotët e painformuar, romantikë e naivë ia drejojnë qeverisë belge. Bashkatdhetarëve ai ua kthen falenderime, u kërkon informata për aktivitetet në rrethe të tyre, u jep udhëzime..

– Siç po të kuptoj unë, paskemi bërë punë mutil – ndërhyri nikoqiri Noni.

– Diç të përfaqëton, – tha Mirani dhe shtoi: – Por, ju e keni bërë duke u nisur nga qëllimi dhe dëshira e mirë.

– Po çka duhet të bëjmë me ndihmat financiare që i kemi mbledhur? – pyeti Gjergji.

– Për të mos i rënë shumë rrotull, më mirë është t'i shkërdheni vetë sesa t'ia dërgonin vëllait të Musës në Bruksel që t'jua shkërdhejë ai. Sa për informim, ai gjithë kohën e kalon duke luajtur bixhoz, duke u marrë me veprimtari të gjithëllojshme kriminale dhe duke shkërdhyer prostituta.

– Shoku Gjergj, – mori fjalën Prela, – të mos e zgjasim, ndihmat financiare që i kemi mbledhur do t'ua kthejmë atyre që i kanë dhënë sipas listës.

Mirani hetoi se ishte djersitur, meqë kishte folur në gjendje prej të mllëfosuri. Ai tani po mundohej ta fshihnte edhe vetëkënaqësinë se të pranishmit i kuptuan drejt këshillat e tij. Papritmas mendja i shkoi te vëllai i Musës, Istrefi: “Sikur ai të marrë vesh se po ia boshatis grazhdin, sigurisht që do të përpiqet të marrë hak. Bëra apo nuk bëra mirë që isha tepër i drejtpërdrejtë? Le të bëhet çfarë të bëhet! Nuk i duroj më këta gangsterë që po ua sheh sherrin gjithë emigracioni, populli ynë dhe sidomos Lëvizja”. Mendimin ia preu nikoqiri Noni:

– Bujrum, he malësor se ky hell në sofër nuk është gic, por qingj.

– E po, kur po pimë raki e verë, atëherë më mirë do kishte qenë që helli të ishte gic se do të na shijonte më shumë. Kurse ti, gjithmonë paç e shtrofsh sofra kaq të begata për miq pa hile! Ali Pashë Gucia ka pas thënë: “Bani ner, kush ashtë për ner.”

11.

Në gusht Shoqata e *Vatërës* do të mbante kuvend. Për këtë Mirani e informoi Xhabirin. Ai vazhdonte ta respektonte formalisht si udhëheqës. Pas dy ditëve Xhabiri i telefonoi që ta njoftonte se Vatra kishte dërguar ftesë. Ai e luti Miranin që t'ia jepte një numër faxi se kishte ndër mend të dërgonte një fjalë përshëndetëse të cilin do ta lexonte Mirani.

Në kuvend u mblodhën mbi njëqind veta. Shkoi edhe Mirani bashkë me dy malësorë. Qysh në fillim të Kuvendit, kur po zgjidhej kryesia, disa persona që ai nuk i njohte, u ngritën për ta propozuar veten. Ata po vetëreklamoheshin. Madje edhe se kush kishte takuar më shpesh Millosh Miniqin e Josip Verhovecin, njëri ish dhe tjetri ministër aktual i jashtëm i Jugosllavisë. Mirani humbi durimin. Ngriti dorën dhe mori fjalën. Kryesuesi i Kuvendit e prezantoi:

– Është Miran Bruçaj, anëtarë i Kryesisë së Lëvizjes për Republikë të Kosovës. Ka ardhur mysafir për të përshëndetur Kuvendin. Urdhëroni, zotëri Bruçaj.

Mirani doli në foltore:

– Ju falenderojmë për ftesën, zotëri kryetar. Vërtet kam ardhur mysafir për të përshëndetur Kuvendin e Vatërës, por të Vatërës se Nolit dhe jo të ithtarëve të Beogradit. Po më vjen keq nga Noli i respektuar se ku qenka katandisur Vatra. Kuvendit i dëshiroj mossukses. Unë po iki me keqardhje që kam humbur kohë për të ardhur në këtë Kuvend. Për këtë veprim u kërkoj falje vatanëve të vjetër, të cilët, mendoj unë, nuk duhet të marrin pjesë në kuvende të këtilla ku dominojnë pro–jugo–sllavët.

Salla zuri të gumëzhinte. Malësorët shkuan me vrap që ta fusnin Miranin në mes të merakosur se mos e sulmonte ndonjëri. U drejtuan kah dalja. Vatanët e vjetër dolën pas tyre duke uruar: “Sa mirë ua punove, turp të kemi ne që vijmë dhe nuk guxojmë t’ua themi dot fjalët që meritojnë...” Kështu kuvend u shpërnda.

Ditëve në vazhdim ky eksces u komentua më të madhe. Dush thoshte, sa mirë ua punoi krerëve të Legalitetit, që me komandim të UDB-së kanë uzurpuar Vatrën e Nolit, dikush thoshte se e ka dërguar Enver Hoxha e të tjera. Ndërkohë Xhabiri i telefonoi Miranit:

– Ke gabuar që e ke bërë atë skandal...

– Njësoj do të kishe vepruar edhe ti, po të ishte në vendin tim.

Kështu i tha Mirani, edhe pse ishte i bindur se Xhabiri do të ndihej mirë në atë Kuvend.

12.

Qelmani, kushëriri i Miranit, i propozoi atij ta vizitonin Misionin Shqiptar pranë OKB-së në New York. Mirani e pyeti atë nëse ia kishte thënë ndokush, apo ishte propozim i tij. Kushëriri sqaroi se është ide e tij, duke arsyetuar se Ambasadori A. B. është një patriot i mirë. Mirani hezitoi t'ia miratonte propozimin. Atij iu kujtua skandali që i kishte ndodhur në Ambasadën Shqiptare në Vjenë në prillin e vitit të kaluar dhe tani ndiente një si ngërç.

Ambasadori i mirëpriti duke u dëshiruar mirëseardhje të përzemërt. Ai iu drejtua Miranit:

– Po ku je mor Malësor që nuk vjen për vizitë te ne!? U bënë kaç ditë që ke ardhur. Malësorët e këtushëm më kanë folur vetëm fjalë miradie për ty.

Mirani po përmbahej që të mos fliste. Më në fund u detyruar t'ia kthente:

– Edhe unë kam dëgjuar lëvdata për ju. Malësorët i kishe indoktrinuuar e bërë më enverista se vetë Shoku Enver.

– Tamam, më kanë thënë se ke humor, bile se ndonjëherë e tepron.

Mirani hetoi se nuk ia kishte qëlluar, prandaj ia lëshoi radhën e bisedës kushëriri dhe bashkëshortes së tij.

Ndërkohë në dhomë të pritjes hyri një zotëri. Mirani e njohu menjëherë. E kishte takuar në Ambasadë në Vjenë. Ai ishte pothuajse qeros, thatim, fytyrë sigurimi. Edhe ai e njohu Miranin, por bëri sikur nuk duhej t'i fliste në atë takim me ambasadorin. Pas pak erdhi një tjetër dhe i tha ambasadorit:

– Po ju kërkojnë në telefon.

– Më falni, do të kthehem menjëherë!

Kur kaloi në dhomën tjetër, sigurimsi i tha:

– Miran Bruçajn nuk duhej ta linit brenda. Shporreni menjëherë.

Ambasadori nuk guxoi ta kundërshtonte:

– Nuk e dija që është ai. Na telefonoi Zotëri Qelman Bruçaj dhe lajmëroi se po vinte për vizitë. Kur pashë se edhe Mirani ishte me të me erdhi keq t'i përzi, meqë Qelmani, që fatkeqësisht është kushëri me Miranin, kishte marrë edhe bashkëshorten me vete.

– Ka qenë taktikë e Miranit. Diskutimi mbaroi. Nxirri përjashta! – urdhëroi sigurimsi.

Ambasadori u kthye prapë të mysafirët, por tani jo i hareshëm si përpara.

– Nuk jeni të mirëseardhur, – tha shkurt. – Mund të shkoni. Takimi mbaroi.

– Nuk shkojmë, – ia ktheu Mirani prerë pa e menduar fare përgjigjen. –

Nuk jemi në shtëpinë private të atij sigurimsit, as në shtëpinë tuaj, zoti ambasador. Kjo është shtëpi e shtetit shqiptar.

Ambasadori po dëgjonte me pamje prej të befasuarit nga kjo arrogancë e Miranit. Ai u ngrit të ikte, por kushëri ia stopoi ikjen duke ndërhyrë:

– Marre ju kjoftë! Qou të shkojmë vëllau jem, se këta nuk e meritojnë vizitën tonë.

Në ditët e pastajme Mirani takoi ambasadorin në disa vizita që u bëri ai malësorëve enveristë. Gjithsesi ndiente keqardhje e dhëmshuri për të.

13.

Në muajin korrik erdhi nga Detroiti malësori Kolë G., enkas për ta marrë Miranin, musafir. Por, edhe pse e thërriste me të qeshur lehtë Palokë, ai e dinte se ishte Miran Bruçaj. Kur hyri në shtëpi të Kolës, Mirani përjetoi një surprizë të veçantë. Për herë të parë po shihte sesi një emigrant shqiptar kishte një vilë luksoze në mes të një gjelbërimi hapësinor. I impresionuar nga mirëpritja e bujaria e tij dhe nga ambientet përreth, Mirani nuk u përmbajt pa i thënë

Kolës:

– Këtu edhe nëse me del shpirti s'brengosem. Është hera e parë që po e shoh një emigrant që i ka krijuar familjes këtë standard jetese. Ta gëzoni, me shëndet e me faqe të bardhë!

Miranit i bëri përshtypje sidomos mirëpritja bujare e bashkëshortes dhe së resë së Kolës. Po mendonte më vete: “Vërtet unë e kam origjinën nga Malësia e Plavës dhe Gucisë dhe malësor dëshiroj të ndihem, por lindja dhe jeta në Rrafshin e Dukagjinit të Kosovës ma kanë stërkequr gjenin e origjinës. Lumë si këta që kanë ruajtur traditat iliro-shqiptare, mjerë shqiptarët e rrafsheve që u është imponuar mënyra e jetesës sipas kulturës së pushtuesve osmanlinj!”. Si për ta ngushëlluar veten mendoi: “Pse nuk thua lumë si kombi ynë që ka mundur të përballojë asimilimin e plotë, meqë nuk ishin as pesë, as pesëdhjetë vjet, por pesëqindë vjet të pushtimit turko – osmano, i cili zëvendësoi njëmij e pesëqindë vjet pushtim romak, bizantin, bullgar dhe serb”.

Pasi pinë nga një gotë, Kola dhe Mirani shkuan të vizitonin restorantin e familjes. Aty gjeten Lenën, vajzën e Kolës.

– Kjo është varza ime simpatike, zonjusha Lenë, – tha Kola.

– Mirë se ju ka pru zoti dhe ju falenderojmë për këtë vizitë. Po i bani ner familjes sonë! – përshëndeti Lena duke ia zgjatur dorën Miranit si të përshëndeste një mik të saj. – Baba ka folë fjalë shumë të mira për ju. Urdhëroni, zini vend këtu!

– Mirë se ju gjeta, – tha tjetri. – Shpresoj të mos e ketë tepruar Kola, pasi ishte propagandist markant, me talent për të bërë marketing të mrekulueshëm. Por, marketing shpesh i bëhet mallit që nuk është i mirë.

– Po taman, baba na tha se je hokatar, si malësorët e anëve tona!

Po shtrohej darka e begatë, siç u shkon përdore malësorëve bujarë. U ulën që të gjithë anëtarët e familjes për të ngrënë. Po bisedohej e po bëhej humor nga të gjithë, pa asnjëlloj rezerve e frenimi, kurse Mirani po vetëpërmbahej. Ky qëndrim i tij e shtyri Kolën t'i thoshte:

– Mos u ngushto, mor mik, se po i thua vetës malësor! As gruan, as renë, as varzën nuk i kam arusha malit dhe nuk të hanë. Mos më turpno, por kthejua shpotitë flakë për flakë. Mirë se të ka pru zoti, pasi kur e fusim mikun në shtëpi, dëshirojmë të mos ngurojë, por të sillet si në shtëpinë e tij.

– Mirë se ju gjeta, gjithmonë paçi e shtrofshi për miq! Po unë si në shtëpi time po sillem, – uroi Mirani, – por ti e di se kam lindur e rritur në Rrafsh të Dukagjinit dhe aty edhe në familje njerëzit bëjnë pavetëdijshëm jetë të ndrydhur. Ushqehen ndaras burrat nga gratë, nuk bëjnë shaka e shpotitje në familje, i zoti i shtëpisë urdhëron dhe kontrollon sjelljet e anëtarëve të tjerë.

Pas një jave Mirani dhe Kola shkuan në Çikago. Kola kishte paralajmëruar Agim Gashin e Mentor IL për këtë vizitë. Kur dolën në magjistrale, Kola i tha Miranit të voziste makinën. Ai para dy ditëve e kishte dërguar Miranin të bënte provimin teorik për patentë shoferi. Mirani kishte dhënë provimin teorik në gjuhën gjermane, tani duhej të voziste makinë një muaj, i shoqëruar nga një shofer dhe pastaj të paraqitej për provim praktik. Dhe gjithë ky shpenzim kushtonte vetëm nëntë dollarë. Në Evropë të rjepin për një patentë shoferi.

Kola dhe Mirani arritën rreth orës 15.00 te dibrani Mentor në periferi të Çikagos. Ai shquhej për angazhimin patriotik. Mentori kishte ftuar shokë të tij, por deri në atë moment kishin ardhur vetëm katër veta. Agim Gashi, prishtinas, një patriot ekstremist, siç e vlerësonin, ngaqë ishte afirmuar për ballafaqime brutale fizike me nacionalistët serbomëdhenj në Çikago, të cilët vepronin të organizuar në lëvizje çetnike. Ndërkohë erdhën edhe të tjerë. Ndenjën duke biseduar deri në orët e vona të natës. Të nesërmen pasdite Agimi me shokë organizuan një tubim informativ në restorantin e Kurtish Zajazit. Në këtë rrethinë më të numërt ishin shqiptarët nga Kërçova, gjegjësisht nga Malësia e Zajazit. Organizuesit kishin ftuar edhe Mulla Istref Azalin me origjinë nga rrethina e Tetovës, udhëheqës i Lidhjes Kosovare për Shtetin Illinois, nënorganizim ky i Ballit Kombëtar. Tubimi po shtyhej nga orari i plan-

ifikuar, meqë e prisnin Mulla Istrefin. Pas pritjes prej çerek ore u vendos t'i telefononin që ta pyesnin për vonesën. Aparatit të telefonit ia hapën parlofonin që ta dëgjonin edhe të tjerët përgjigjen e tij.

– Nuk vij që të dëgjoj atë komunist me yll në ballë, – tha tjetri përtej telit.

Mentori nuk priti:

– Edhe nëse është komunist nuk mund të na përvetësojë me një bashkëbisedim. Ju mund ta kundërshtoni. Kjo nuk është arsye që ju të mos vini, pasi do të diskutohet për gjendjen në Kosovë. Jemi rreth 70 burra që po ju presim.

– Atë e pashë mbrëmë kur i kishte rënë terri tokës duke hyrë në konsullatën jugosllave për të marrë udhëzimet sesi duhet të na përçajë, – tha Mulla.

– S'është e vërtetë... – kundërshtoi Mentori, po tjetri e këputi linjën.

Në restorant u krijua gjendje keqardhëse e shqetësuese. Mulla kishte aty shumë ithtarë të tij.

– Ju lutem, bashkëpatriotë të nderuar, – ndërhyri Agimi me një zë burri, – më dëgjoni se dua të bëjë një sqarim: Zotënt Kolë G. dhe Miran Bruçaj kanë ardhur dje rreth orës 15.00. Jemi shumë burra këtu që mund të dëshmojmë se që nga ajo orë e deri pas mesnate kemi qenë së bashku në shtëpi të Mentorit. Kjo është një shpifje skandaloze. Unë do të shkoj me dy veta që ta lusim Mullan edhe një herë të vijë, kurse ju fillojeni tubimin.

Sapo Agimi përfundoi fjalën e tij filluan të uleshin edhe ata që ishin ngritur nga shqetësimi. Gafurri, që ishte më autoritativ në këtë komunitet, doli në tavolinën e vendosur për mysafirë në krye të sallës së restorantit. Ai ftoi Miranin e Kolën të zinin vend pranë tij.

Agimi bashkë me Kurtishin dhe Mentorin shkuan të Mulla.

– Mulla i nderuar, erdhëm t'ju lutemi edhe një herë që të vini në tubim.

– Nuk vij. Ja tregova në telefon përse refuzova thirrjen tuaj.

– Ne dëshmojmë që zotëri Miran Bruçaj nuk ishte mbrëmë në konsullatë jugosllave.

– Si, gënjejë unë? – ndërhyri Mulla duke u betuar: – Për Allah e pashë me

sy të mi.

– A mund të bëni be me dorë mbi Kuran? – iu drejtua Agimi.

– Sigurisht, – dhe zgjati dorën për të marrë Kuranin në raft, pasi aty po e mbante sa për t’u kamufluar se është besimtar dhe për t’i qëlluar në betime të gënjeshtërtë. Vuri dorën mbi të dhe zuri të betohej:

– Bismilaha..

Agimi e ndërpreu: – Do të marrësh përpara abdes, pasi betimi me dorë mbi Kuran, pa abdes është gjynah dhe nuk ka vlerë.

– Atëherë po marrë abdes, – u përgjigj Mullai, i gëzuar se edhe kësaj radhe po ua hidhte me trukun mashtrues që kishte përdorur disa herë kur e kishin zënë të gënjente për interesa të tij politike dhe për përfitime financiare.

Gjatë marrjes së abdesit filloi të thotë ca lutje me zë pothuajse pëshpëritës, pasi dëshironte ta dëgjonin dhe të bindeshin se ishte besimtar i vërtetë. Mbaroi abdesin, fshiu ujin me peshqir, mori sërish Kuranin dhe e vuri dorën mbi të:

– Bismilaha Rrahmane Rahim. Betohem me dorë mbi Kuranin e Pejgamberit alej salatu ve salam, se mbrëmë e pashë Miran Bruçaj duke hyrë në konsullatën jugosllave!

Mori frymë thellë dhe e la sërish Kuranin ku e kishte marrë.

– Çfarë kërkove ti, zotërote, në atë kohë te konsullata jugosllave? – e pyeti Agimi.

– Po kaloja rastësisht, – tha Mullai.

– Si e njohë ti Miran Bruçajn?

– E kam parë në fotografi.

– Dëgjo këtu mor Mulla shejtan! Unë, Mentori e Kurtishi bashkë me shtatë të tjerë të betohemi shqiptarisht se zotëri Miran Bruçaj dhe Kolë G. kanë qenë mysafirë te ne prej orës 15.00 të ditës. Vetëm kur ka shkuar për nevojë në WC ka dalë nga dhoma e miqve. Pas mesnate është shtrirë për të fjetur në krevat në shtëpi të Mentorit.

Agimi humbi vetëpërmbajtjen dhe e pështyu në surrat duke i thënë:

– Mor surrat shejtani, ti vazhdimisht na paske mashtruar duke na u shitur për hoxhë dhe patriot dhe duke na u betuar rrejtshëm në Allah e në Kuran! Më këtë fytyrë të pasha dhe mos më dil më përpara se do të bëj troshë–troshë! Këtë herë kaq se nuk dëshiroj t’i trazoj mysafirët me ndërhyrje të policëve.

Agimi, Mentori e Kurtishi u kthyen sërish në restorant. Kurtishi i informoi të pranishmit çfarë kishte ndodhur, duke u rezervuar të tregonte se si e kishte sharë e kërcënuar Agimi. Të pranishmit u hidhëruan. Gafurri mori fjalën:

– Qetësohuni burra, he medet për ne! Do të bisedojmë një herë tjetër për këtë marre, tani po vazhdojmë bisedën ku e lamë.

Pas përfundimit të tubimit Kurtishi shtroi darkë për pjesëmarrësit. Atmosfera u bë vëllazërore. Agimi i shpjegoi Miranit traditën bujare të emigrantëve të Malësisë së Zajazit të Kërçovës:

– Në restorantet e tyre asnjëherë nuk na lënë të paguajmë. Janë shumë miqpritës. I kanë të paktën 80 restorante. Janë të organizuar si jahuditë. E ndihmojnë njëri–tjetrin në biznes. Kanë krijuar fond të përbashkët. Kur u vjen ndonjë i ri nga vendlindja, Këshilli i Fondit ia cakton restorantin ku do të punojë, derisa ta mësojë zanatin. Pastaj, me dollarë të fondit ia blejnë restorantin. E mbikëqyrin që restoranti të ecën mirë dhe t’ia kthejë Fondit borxhin pa kamatë. Kështu kanë krijuar gjendje të mirë ekonomike dhe prandaj na ndihmojnë financiarisht sa herë u drejtohem, meqë edhe patriotizmin e kanë traditë. Ne emigrantët nga Kosova dhe nga viset tona në Maqedoni dhe në Mal të Zi nuk jemi në gjendje të organizohemi në këtë mënyrë.

– Me fjalinë e fundit dëshirove të na prishësh oreksin, – ndërhyri Mirani.

– Le të na prishet, – reagoi Kola, – sepse duhet të na vijë keq që nuk po marrim mësim nga kjo formë e organizimit, kaq vëllazërore dhe kaq me interes reciprok dhe atdhetar.

14.

Numri i simpatizantëve të Lëvizjes në ShBA nga dita në ditë po rritej.

Gjithashtu edhe aktivitetet. Ata u përcaktuan të presin në mënyrë të organizuar Ditën e Flamurit. Mirani po përgatiste thirrjen, skenarin për një manifestim të madh, fjalimet dhe fëmijët që dëshironin të recitonin. Flinte te Ahmeti në Bronx, kurse ditën shkonte te Gjergj K. në Manhatan, meqë aty kishte një makinë shkrimi. Për të mos humbur kohë, Gjergji i tha pothuajse në formë urdhëruese:

– Do të flesh te ne, pasi po humb kohë në udhëtime dhe po lodhesh.

– Si të fle te ju, kur ti dhe bashkëshortja jote keni apartament të vogël?

– Nuk na ngushton. Shojja ka çelësa të zyrave që pastron, prandaj mund t'i fotokopjoni natën materialet. Kot kundërshton. Na vjen keq nga ti që kemi apartament të vogël, por punën e kemi në Manhatan dhe këtu nuk mund të paguash qira për banesë më të madhe.

Disa net Mirani i kaloi aty. Çifti i malësorëve flinin në krevatin e tyre, në qoshe të apartamentit njëdhomësh me një kuzhinë të vockël si aneks, kurse Miranit i shtronin rehatoshëm. Atij i vinte keq që po i ngushtone, por edhe mrekullohej nga sakrificat e tyre.

Krerët e mërgatës pseudonacionaliste lëshuan në qarkullimet kërcënime të tyre: “Do t’ua çojmë në ajër sallën kuqaloshëve të Enverit, do t’i vrasim këta zagarë të kuq,” e të tjera. Mirani i këshillonte bashkëveprimtarët të përmbaheshin se ato s’ishin tjetër veçse kërcënime boshe.

– Palokë, – kështu vazhdonte ta thërriste Noni, – po do me ardhë konsulli jugosllav, shqipfolësi O. G. Duhet t’i çojmë fjalë të mos vijë.

– Edhe unë pajtohem, – tha Gjeta S., redaktori e folësi i radioprogramit “Zani i Malësisë”, një program cilësor që dëgjohej nga shumica e shqiptarëve në New York.

– Unë jam i mendimit të vijë, – tha Mirani. – Ku i dihet, ndoshta është shqiptarë i mirë ose ka kohë të bëhet i mirë. Sa patriotë të mëdhenj si Ismail Qemali e Hasan Prishtina kanë qenë në shërbim të pushtuesve turq. Edhe ky i shkretë, mbase kur të ndërjegjësohet populli dhe të vijë dita, kalon në anën e popullit. Ky krahasim siguri që çalon, por ka gjasa.

– Nuk na prish punë, – nisi të përkrahte mendimin e tij Agimi, – sepse e kemi peng për siguri të pjesëmarrësve në manifestim. Ndoshta edhe për atë qëllim vjen, meqë krerët e mërgatës politike nuk ndërmarrin gjë kur ta dinë se konsulli jugosllav është në sallë!

– Sa hollë ta pret menja, or Toskë! – miratoi Preka, – Të lumtë ne që të kemi! Kështu e thërrisnin Agim Z., meqë vinte nga rrethi i Strugës dhe fliste në dialektin e toskërishtes.

Salla kishte dy mijë vende, kurse në të hynë pesëqindë veta më shumë. Do të hynin edhe qindra të tjerë, por ndërhyne zjarrfikësit dhe firma që bënte sigurimin, se nuk mund të garantonin siguri. Programi dhe atmosfera e manifestimit po i kënaqte pjesëmarrësit. Grupi muzikor që kishte ardhur nga Detroiti shkëlqeu si edhe recitatorët. Fjalimi patriotik u dëgjua me qetësi të madhe dhe duartrokite të gjata. Salla shpeshherë shpërtheu me të thirrura të fuqishme si në kor: “Kosova–Republikë! Kosova–Republikë!”.

Mirani po e kërkonte në holl të sallës korrespondentin e “Rilindjes”, A. S. Ishin njohur që nga koha e studimeve dhe dëshironte ta takonte. Edhe A. S., po e kërkonte tjetrin. U takuan në një kënd. Pasi u përshëndetën, Mirani i tha:

– Kalo në anën tonë dhe mos u kthe më në Kosovë, derisa ta çlirojmë.

– Po të rimë të gjithë këtej, kush do t’i dalë zot Kosovës atje? –tha ai me një qeshje të lehtë e miqësore.

– Si njalat jeni ju titistët, – ia ktheu po me humor Mirani.

Kur përfundoi manifestimi pjesëmarrësit po shpërndaheshin të gëzuar, duke i thënë njëri–tjetrit: “Hera e parë që në Amerikë bëhet një manifestim kaq madhështor?”. Në parking trimat frikacakë kishin shpërthyer gomat e dymbëdhjetë makinave. Njëri nga pronarët e makinave u shpreh: “Na e marrshin të keqën, se tani e tutje nuk ua kemi më frikën!”. Organizuesit shkuan në restorant për t’ju gëzuar së bashku suksesit.

15.

Në fillim të dhjetorit Mirani vendosi të kthehej sepse po i afrohej afati i pasaportës jugosllave. Të rrinte aty, nuk i rrihej. Nuk i pëlqeu mënyra e jetesës në Amerikë. Tani ai dhe bashkëveprimtarët kishin një shqetësim. Mos do të ketë probleme në aeroport, Mirani! Ky shqetësim bazohej në informimin e një nëpunësi të lartë shqiptaro-amerikan që punonte në FBI. Ai kishte informuar se shumë veta kishin spiunuar, kush duke thënë se Miranin e ka dërguar Sigurimi shqiptar për të përhapur ideologjinë enveriste, kush duke thënë se e kishte dërguar UDB-ja për të përçarë mërgatën. Një i afërm ia kërkoi ndihmën nëpunësit të lartë.

Në aeroport Mirani pa një peshore në derë të një barnatoreje. Hipi. 98 kilogramë.

– E shihni, – iu drejtua me humor Mirani bashkëveprimtarëve që po e përcillnin, – keni dashur të më plasni me steka. Erdha 76, po kthehem 98 kilogramë. Edhe derri që theret për Krishtlindje nuk majmet kaq shpejt. Juve po ju terrorizua industria ushqimore dhe gastronomia. Kujdes!

Ai kaloi kontrollin kufitar pa telashe dhe iku për Bruksel.

16.

Ditën e parafundit të vitit 1982 Mirani udhëtoi drejt Zvicrës. Pasaporta jugosllave i kishte skaduar para gjashtë ditëve. Bisedoi në telefon me një aktivist në Lindau për mundësinë e kalimit ilegal të kufirit. Ai e dinte se pa pasaportë nuk do të mund të lëvizte si përpara, ndërsa po të kërkonte strehim politik në Gjermani, do t'i vonohej dokumenti i udhëtimit, siç ia kishin vonuar Jusufit. Donte të ishte në Zvicër që të merrte pjesë në mbledhjen e Komitetit Qëndror në janar dhe, ndoshta atje mund të kërkonte strehim, që të prezantonte rregullisht në mbledhjet e këtij Komiteti, i cili tubimet i mbante kryesisht në Zvicër, meqë në Gjenevë jetonte Xhabiri.

Kur arriti me tren në Lindau, bashkatdhetari Dren T. i premtoi se do ta nxirrte në Zvicër pa problem. U nisen sapo u errësua. Në kufirin gjerman

Miranin e kapi policia dhe e burgosi. Gjatë marrjes në pyetje nuk pranoi të përgjigjej fare pa kontaktuar me avokatin. Policia ia mundësoi. I telefonoi avokatit Karl E., mikut nga koha e studimeve. Ai u alarmua:

– Është kohë e festave. Ka rrezik të të ekstradojnë në Beograd. Po nisem menjëherë me motorin tim sportiv.

Rreth 550 km., i bëri për katër orë. Arriti pak para mesnatës. Më vete solli kërkesën për azil politik, të cilën e kishte shkruar në byro në të nisur. Para se ta dorëzonte kërkoi nga personeli i burgut që ta takonte Miranin, meqë i duhej autorizimi i tij për t'ia bashkëngitur kërkesës.

– Të jam shumë mirënjohës, mik i dashur! – i foli Mirani duke e përqafuar.

– Qetësohu tani, sepse mënjanoam rrezikun e ekstradimit tënd në Beograd. Sa për mirënjohje që po më shpreh, po ta kthej me proverbin shqiptar që ma ke thënë sa herë: “Miku i mirë në ditë të vështirë”.

– Nuk po frikësohem, – u përgjigj Mirani duke e keqkuptuar siku avokati Karl e bëri frikaman.

– Ta njoh kokën tënde, nuk të thashë mos u frikëso, por qetësohu! Shqetësimi dhe frika nuk janë njësoj.

– Shko tani fli në hotel, ndoshta ndonjëherë ta paguaj këtë mund! – tha Mirani.

– Po ta dija se do të më përmendje pagesën nuk do të vija. Nuk bëhet gjithë kjo rrugë në këtë kohë të acartë për para. Sikur nuk po e kupton çfarë do të thotë të kesh një mik të vërtetë gjerman.

– Më fal, nuk qeshë i vëmendshëm sa duhet!

Të martën, më katër janar 1983, Mirani u lirua nga burgu. Kërkesa për strehim do të shqyrtohej në Lindau dhe aty duhej të mbetej derisa të vendosej nëse do t'i njihet statusi i azilantit.

Po atë ditë udhëtoi për Bochum meqë duhej ta dorëzonte dhomën në konviktin e studentëve, të paketonte bibliotekën dhe plaçkat e tij.

Sapo arriti takoi Renatën dhe i rrëfeu për ato që i kishin ndodhur. Ajo çau,

edhe nga inati se nuk e kishte ditur ku e kishte kaluar tjetri Vitin e Ri. Akoma më shumë u mërziu kur u informua se tani e tutje ai duhej të jetonte në Lindau.

– Si mendon, do të pranosh të bëjmë martesë formale? Kështu mund të të tërheq prapë në Bochum, – pyeti ajo me dashamirësi.

– Në asnjë mënyrë. Martesa është diç madhore dhe nuk bëhet vetëm sa për të rregulluar statusin e qëndrimit.

– Më fal, nuk di si të të ndihmoj ndryshe. Pastaj, nuk ke nevojë ta ngrisësh zërin se të propozova martesë formale dhe jo vetëvrasje.

– Edhe po tallesh më mua, a?

– Nuk po tallem, por po dëshiroj t'i ndaj me ty shqetësimet dhe vështirësitë.

– Të jam mirënjohës, mos m'u hidhëro nëse më mungon mirësjellja e duhur! – e luti duke ia zgjatur dorën drejt faqes të cilën ia fërkoj prajshëm.

Në mëngjes Mirani shkoi për të vizituar familjen e vëllait në Mülheim/Ruhr. Aty gjeti edhe miqtë, bashkëshortët Hana e Zymryt B, të rrethit të Gostivanit, që jetonin në Bremen. Kishin ardhur për ta vizituar atë, pasi ishin mërziutur kur kishin dëgjuar për burgosjen e tij. Hana s'u durua pa e pyetur:

– A pranon të vish te ne në Bremen?

– Nuk më lejohet. Kërkesa për azil do të shqyrtohet në Lindau dhe aty më duhet të banoj.

– Kam konsultuar një avokat dhe më ka thënë se mund të ndërrosh vendbanimin. Pastaj kam pyetur një mike gjermane, të cilën e kam mjeke të familjes. Ajo është konsultuar me bashkëshortin e saj, po ashtu mjek, dhe më ka thënë se mund të banosh në shtëpinë e tyre, derisa të gjesh zgjidhje të përshatshme. Shtëpinë e kanë të madhe dhe të mirë. Mua më ke afër që të t'i pas-troj rrobat.

– Hë, se mos dashkeni të më çoni edhe në Çabel? Oferta nuk qenka edhe aq e keqe!

– Që sot mund të vish me ne, – shtoi Zymryti. Gjatë rrugës do ta mbushim makinën me plaçka. Pastaj marrim një mikrobus që t'i transportojmë të tjer-

at.

– Po vij njëherë të bisedoj me miqtë tuaj gjermanë dhe me atë avokatin, pastaj shohim e bëjmë.

– Në rregull.

17.

Avokati i sqaroi Miranit se mund ta tërhiqte kërkesën për strehim me arsyetim se do të shihte ndonjë mundësi tjetër jashtë Gjermanisë. Pastaj paraqet kërkesë këtu në Bremen ose në ndonjë qytet që preferon ti.

– Mëk i dashur, je i mirëseardhur në familjen tonë, tamam si pjesëtar i familjes, – thanë njëzëri Johani dhe Hellga S. Për ty na ka folur Hana shpesh me një dashamirësi e admirim të theksuar. Që të kesh më shumë të ardhura financiare, të cilat të duhen për veprimtarinë tënde patriotike, do të bëjmë formalisht një kontratë qiraje në lartësinë maksimale që e pranon enti social. Qiranë që do të na paguajë sociali në xhirollogarinë tonë, do të ta japim ty. Do t'i marrësh edhe ndihmat sociale për ushqim e veshmbathje, sipas normave. Ushqimin dhe të gjitha gjerat që të duhen në shtëpinë tonë i ke falas nga ne. Edhe një herë: Je i mirëseardhur për hir të miqësisë që kemi me Hanen e Zymrytin.

Mirani po befasohej nga kjo lloj gatishmëria për ndihmë e përkrahje.

– Ju falënderoj përzemërsisht dhe jua paça borxh gjithë jetën!

– Edhe unë dua t'ju falënderoj për këtë shpirtmadhësi tuajën, – shtoi Hana.

– Mos e zgjatni se ndihmën e përkrahjen tonë e keni merituar, pasi na keni përvetësuar që të bëhemi miqtë tuaj.

18.

Përkundër rrezikut, Mirani studioi mundësinë e kalimit ilegal për në Zvicër, meqë ishte i vendosur të merrte pjesë në mbledhje të janarit të organit drejtues të Lëvizjes. “Nuk thotë kot populli, nevoja e mëson njeriun” – mendoi me vete ai. Ishte bërë specialist i trenave, se ku ndërrohej turni i konduk-

torëve dhe si mund të bënte pjesën më të madhe të rrugëtimit pa biletë. Udhëtoi me tren IC (InterCyt), nga Bremeri në Feiburg (Frajburg). Aty ndërroi trenin dhe mori lokalin që shkonte deri në stacion të fundit në Lörach, duke kaluar nëpër stacionin në Basel/Badische Bahnhof e tutje. Ky stacion gjerman gjendet në qytetin Basel, brenda në Zvicër. Treni lokal nuk kontrollohej nga asnjëra polici kufitare. Ai ishte informuar se atë stacion e kishte blerë para një shekulli Mbretëria e Badenit. Që atëherë ishte marrëveshja që garantonte qytetarët, të cilët udhëtonin për në Lörach, se nuk do të kontrolloheshin nga kufitarët e doganierët gjermanë dhe as nga ata zviceranë. Mirani hyri në Zvicër. Prej aty mori trenin për në Biel/Bienne ku do të mbahej mbledhja e radhës e Komitetit Qendror të Lëvizjes.

19.

Mbledhja po mbahej në banesë të Hakanit dhe Sarandës. Në mbledhje ishin të pranishëm vetëm Xhabiri, Hakani, Saranda, Fahriu dhe Mirani. Tre të parët ende po vazhdonin të ndiheshin si krah i Xhabirit, kurse Fahriu ishte shabllonizuar si krah i Sabitit. Kjo doli nga sqarimet që bëri Xhabiri kur hapi mbledhjen dhe shpjegoi se Xhafari kishte arsyetuar pamundësinë e pjesëmarrjes me mungesë të dokumentit të udhëtimit. Sapo Xhabiri bëri këtë sqarim, Mirani si në humor tha:

– E po, e ka prapancën e madhe dhe nuk ia mban të kalojë ilegalisht kufirin. Edhe unë nuk kam dokument udhëtimi, por erdha. Megjithatë, e quaj të arsyeshme frikën dhe mosardhjen e tij. Tani më lejoni të shpreh keqardhje për diç më të rëndësishme. Ju ende po vazhduakeni me krahë, edhe pse po bëhet viti që kur u themelua Lëvizja. Ndërsa ty Fahri, sa për humor, po të pyes: kur dhe si u bërë pjesëtar i krahut të Sabitit e Xhafarit?

– Mos shprush se i vjen era! – filloi të përgjigjet Fahriu i zënë ngusht, – unë nuk jam pjesëtar i asnjërit krah, por vetëm i Lëvizjes.

– Kjo do thotë se qenke bërë me mua, pasi që kur themeluan këtë organ, Xhabiri më definoi si të asnjanshëm.

– Nuk ta paska lënë fare as Amerika, – tha Xhabiri.

– Përkundrazi, Amerika më ka impresionuar për liritë e mëdha demokratike dhe ne nuk kemi nevojë as arsye që aktivistët e Lëvizjes t'i mbajmë në këtë pozitë. Ata nuk po e dinë se kush dhe si po i udhëheq, prandaj ata se shpejti duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në një kuvend të gjerë, ku do të duhej të diskutohej platforma dhe mënyra e organizimit, gjegjësisht të miratohet një program politik dhe një statut. Njëkohësisht ai kuvend duhet të zgjedhë strukturat drejtuese të Lëvizjes, duke i dhënë fund krahëve, kooptimeve dhe shpërdorimeve në emër të këtij ilegaliteti të shpifur. Këtu jemi në botë të lirë dhe nuk kemi pse të simulojmë një këso ilegaliteti. Sa i përket kooptimeve, unë kam marrë vesh se Sabiti, në emër të organit tonë, ka kooptuar aventurierin Musa Hoti duke na e inkriminuar e kriminalizuar Lëvizjen me aktin e tij.

– Paske ardhur me hu në krah nga Amerika! – ndërhyri Xhabiri, të cilit i humbi durimi duke dëgjuar Miranin.

– Keni pasur mjaft kohë të mbusheni mend. – iu kundërvu Mirani.

– Po kthehemi te rendi i punës, – ndërhyri Xhabiri.

– Mos u tall, për çfarë rendi të punës mund të flitet në këtë organ, ku vetëm ti dhe unë po dialogojmë mujshëm, ndërsa këta të tre po dëgjojnë hutueshëm. Lëvizja na doli nga bashkimi që sajuat ju. Atëherë ku janë anëtarët e tjerë, pse nuk vijnë?

– Ata të Avdul Prapashpinës, – zuri të përgjigjet Xhabiri, – gjegjësisht të Partisë Komuniste, janë prononcuar se nuk e kanë firmosur bashkimin që e kemi proklamuar. Kështu po shkruajnë në pamfletin e tyre që e kanë emërtuar ‘Punëtorët’. Por, për qëndrimin tonë ndaj tyre do të diskutojmë në mbledhjen e ardhshme që do ta mbajmë në Gjermani për t'i knjuar Xhafarit mundësi të marrë pjesë.

– Ne nuk kemi proklamuar asfarë bashkimi më 16 maj, – tha Mirani. – Këtë e ke bërë ti. Sa për rend të punës, propozoj që organit tonë t'i ndryshohet emri, meqë këtë që ia ke vënë ti është tepër bombastik dhe, meqë jemi në Perëndim, po ngjall asociacione negative. Këtë ma thanë edhe disa patriotë

në Amerikë, të cilët këtë organ po e thërrisnin kryesi. Pastaj, siç e thashë, unë në çdo mbledhje do të vazhdoj të kërkoj mbajtje të një kuvendi të gjerë.

– Ne ende nuk kemi filluar me anëtarësim të rregull, prandaj si do të kemi mundësi të mbajmë kuvend kur nuk kemi si i caktojmë delegatët? – ndërhyri Xhabiri.

– Nuk kemi nevojë të anëtarësojmë, sepse organizata jonë është Lëvizje dhe jo parti. Pastaj, ata i frikësohen anëtarësimit. Mjafton të mblidhen aktivistët e simpatizantët në rrethe, të zgjedhin nga dy–tre përfaqësues të tyre, varësisht se sa veta do të marrin pjesë në ato tubime. Kaq një herë. Të shoh se çfarë rendi të punës do të propozosh ti.

Xhabiri zuri të tregojë se teknika e *Zërit të Kosovës* do të kalojë në Zvicër, pa precizuar se do të vendosej në banesën e tij, duke paralajmëruar vetëlavdërueshëm se këtë e tutje *Zëri* do të dalë më cilësor. Bëhej fjalë për një makinë të markës “Olivetti”, me të cilën mund të radhiteshin e faqoseshin tekstet e *Zërit*. Atë e kishte blerë Jusufi me dhjetë mijë dollarë që ia kishte dërguar si ndihmë Enver Hoxha. Kaq i kishte kërkuar Jusufi në letërën që i kishte dërguar Enverit. Edhe propozimi i Miranit për të ndryshuar emrin e organit drejtues u miratua me propozimin e emrit të ri që bëri Xhabiri: Qendra Ekzekutive (shkurt: QE). Në fund Xhabiri foli edhe për vështirësitë financiare duke bërë apel që të angazhohej secili për të mbledhur ndihma nga bashkatdhetarët. Ai po mendonte se mos Miranit i kishin dhënë ndihma në Amerikë dhe nuk po i dorëzonte. Kështu e nënkuptoi Mirani, ndaj mori fjalën:

– Në Amerikë as nuk lypa, as nuk më dhanë ndihma. Ti dhe Sabiti kishit bërë apel që atje të mblidheshin ndihma financiare për aventurierin Musa Hoti. Aty ku arrita i binda që të mos mblidhnin ndihma për të. Meqë ndodhi kështu, nuk ngjante që unë t’u lutesha që ta ndihmonin Lëvizjen. Ja, edhe në këtë aspekt sa e keni dëmtuar Lëvizjen.

Xhabiri u gjend i zënë në faj nga mënyra si iu kundërvu Mirani, ngase po bëhej fjalë për mungesë të financave, prandaj e shpalli të përfunduar mbledhjen.

Mirani tani po pendohej pse kishte rrezikuar të kalonte ilegalisht kufirin që të vinte në këtë farë mbledhje duke bërë rreth 750 km., rrugëtim.

20.

Në mbledhjen e radhës të organit drejtues të Lëvizjes, tani riemërtuar Qendër Ekzekutive, që u mbajt në banesë të Fahriut, në fund të marsit 1983, Xhafani bëri sqarime:

– Avdyl Prapashpina po gënjen për të arsyetuar përçarjen që ka shkaktuar. Propozoj të organizojmë tubim informativ me aktivistët tanë. Tubimin ta mbajmë në korrik. Në këtë tubim unë do të paraqes referatin kryesor. A pajtoheni?

Mirani mori fjalën, sado të tjerët ngritën duart për miratim:

– Si është e mundur të vlerësosh se po përçaheni kur ju, de facto nuk jeni bashkuar fare. Akoma nuk është tharë ngjyra e nënshkrimeve tuaja dhe ju po na impononi mjeshhtërisht atmosferë e veprime përçarëse. Me këtë ju po synoni demoralizimin e përgjithshëm të patriotëve. Ky ka qenë qëllimi juaj kryesor pas atentateve. Ju jeni bashkuar sa për të komplotuar vendimin që morëm Jusufi, Kadriu, Bardhoshi dhe unë, më 17 Janar 1982. Tani po synoni ta shpartallonit gjithë lëvizjen tonë patriotike edhe me këso farë përçarjesh të sajuara e të shpifura.

– Miran, – ndërhyri Xhabini, – nuk është momenti e vendi të na rikthesh në atë kohë, sado që e kuptoj se nuk je liruar nga subjektivizmi yt.

– Nuk jam subjektiv, por fakt është se nuk është bërë bashkimi më 17 shkurt dhe aq me pak ka ndodhur përçarja. Së pari do të duhej të kishim bashkim e bashkëveprim, që pastaj të mund të ndodhte përçarja. Unë ende nuk ia kam parë surratin Avdylit, edhe pse banon afër Fahriut. Pra, as ata e as ju, qoftë edhe formalisht nuk keni dëshiruar, përndryshe do ta kishit bërë bashkimin e mirëfilltë. Edhe bashkimit të 15 majit ka për t'i dalë tymi. Ju tani jeni bashkë vetëm sa për ta mundur Avdyl Prapashpinën dhe të përforconi secili pozicionet tuaja. Shumë shpejt do të grindeni edhe mes vete. Bile, për t'u bërë fare

provokativ, siç po më akuzoni shpesh, ju sikur merreni vesh natën se si të përçaheni ditën, që ne pastaj të mos kemi tjetër preokupim, veçse të merremi me skenarët tuaj të përçarjes. Tani po dëgjoj versione se në emërtim është ose nuk është vendosur mbiemri cilësues *Socialiste* për Lëvizjen. Nuk besoj të ketë ndodhur gabim teknik. Në numrin e fundit të *Zërit*, ti Xhabir ke shënuar në ballinë: *Organ i Lëvizjes për një Republikë Shqiptare në Jugosllavi*, ndërsa deri tani ishte: *Organ i Lëvizjes për një Republikë Socialiste të Shqiptarëve në Jugosllavi*.

– Është e vërtetë kjo? – pyeti me habi Xhafari.

– Nëse nuk e paske parë këtë që është e shkruar në ballinë, si paske ditur të lexosh vendimin e organizatës, e cila gjoja të paska ngarkuar si përfaqësues të saj në takimin e Stambollit ku duhet të jeni marrë vesh për t’u bashkuar?

– A ka mundësi të mos ironizosh më, sepse po e tepron? – ndërhyri Xhabiri. Shokë, vërtet unë e kam bërë këtë ndryshim që e paska vërejtur Mirani, por e kam bërë duke qenë i bindur se do të ma miratoni në këtë mbledhje. Më falni për harresën, sepse e kisha ndërmend ta paraqes në rend të punës për miratim. Tani do t’ju lutesha ta miratoni këtë ndryshim.

– Së pari, – mori sërisht fjalën Mirani pa e pyetur Xhabirin, drejtuesin e tubimit, – të konstatohet se ke vepruar kokë më vete dhe tani po na vë para faktit të kryer. E them këtë, pasi çfarëdo që të bësh e të veprosh ti, këta vetëm miratojnë. Së dyti, ti nuk ke pasur ndër mend ta paraqesësh në rend dite këtë ndryshim, por vetëm ta protokollosh rrejshëm në procesverbal, pa e ditur ne. As procesverbalet nuk jemi duke i parë se çfarë po shënon ne to. Pastaj, edhe sikur të mos e miratojmë ne këtu, ti ke mundësi të thirresh rrejshëm në emër të anëtarëve në Kosovë. Së treti, sa i përket këtij ndryshim, për mua është krejt e njëjtë, sado më duket emërtim më i qëlluar sesa ai i miratuar në Stamboll, më 17 shkurt të vitit të kaluar. Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim. Unë po kërkoj që të mbajmë kuvendin e parë, i cili do të vendosë për emrin, për programin e për statutin dhe për propozimet e tjera që do të bëhen aty.

– Me këtë kuvend, të cilin shpesh po e përmend, sikur po na kërcënohesh, – ia pati Xhabiri. – Sigurisht që edhe kuvendi do të mbahet kur do vendosim në këtu dhe, besoj, edhe atëherë do të dal fitues kundër teje.

– Mua po më duket se ju vetëm po shtyheni mes vete, – mori fjalën Hakani.

– Do të më falni se unë jam punëtor dhe nuk po ju kuptoj, por nëse po grindeni do t’ju lutesha të mos na maltretoni në punëtorëve.

– Plak, me këtë “unë punëtori”, e ke gjetur një si marifet për t’u imponuar. Ishe ti, punëtori, kur na e imponove Xhabirin si të dërguar nga Kosova për të përfaqësuar OMLK-në. Ky uzurpoi rolin e trashëgimtarit të Kadriut. Sigurisht, nuk ta ka pre mendja, si punëtor që ish. OMLK-ja në Kosovë, të cilës policia ia pamundësoi funksionimin përmes arrestimeve të shumta, nuk e ka gjetur pikërisht Xhabirin në burg për ta përfaqësuar. Po ta kishte ngarkuar ajo që ta përfaqësonte, atëherë Xhabiri do të ngarkohej të bazohej në Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës, siç qe ngarkuar Kadriun. Bile, sikur të kishte OMLK-ja funksionalitet në Kosovë, atëherë ti, Plak, do të duhej ta informoje atë për bashkimin e 17 Janarit të ‘82-shit. Ajo do ta kishte parë të udhës të dërgonte zëvendësin e Kadriut, por jo të na imponohej ky Xhabir si përfaqësues i OMLK-së. Dhe erdhi pa ditur gjë OMLK-ja të të shpërdorojë ty, punëtor i nderuar, dhe ia bashkëngjiti OMLK-në atij farë bashkim-it të 17 shkurtit, i cili nga njëra palë pjesëmarrëse tashmë po kontestohet. Besoj, ndonjëherë do të informohesh nga Kosova dhe do të kesh kurajon që të më japësh të drejtë për këto që thashë.

– A di çka, – ndërhyri Xhabiri, të cilit i humbi durimi, – po t’u ndejtë në këtë organizatë, rri. Jo-jo, lirisht mund të dalësh. A more vesh?!

– Nuk ke nevojë të thërrasësh se nuk jam këtu në firmën tënde private, – iu përgjigj Mirani me zë të sforcuar.

Hakani ndërhyri:

– Aman bre shokë, mos i nxeni gjakrat!

– Propozoj një pauzë, – tha Fahriu.

Xhabiri nuk u kthye më në mbledhje, iku në Gjenevë. Mbledhja u ndërpre

me kaq.

Nga kjo mbledhje e dështuar Xhabiri mori vendimin: Miranin duhet mënjanuar, por pa e hetuar ai, meqë ka shumë ithtarë në bazë të Lëvizjes, siç i quante ai bashkatdhetarët aktivistë. Akoma më shumë ai po i frikësohej Muharremit, djalit të axhës së Miranit, i cili ndërkohë ishte arratisur nga Kosova dhe kishte kërkuar strehim në Gjermani. Muharremin tani Xhabiri po e klasifikonte si përforsim të Miranit. Ai kishte arsimim profesional superior, i pari i kategorisë së tij në Lëvizje. Xhabiri po e hetonte guximin e hovshëm të Miranit dhe këtë e arsyetonte me këshillimet e trimërimet që po i bënte Muharremi.

21.

Në qershor Xhabiri dhe Mirani u grinden deri në egërsim reciprok. Zanafillën kjo grindje e kishte te kërkesa e Miranit:

– Të organizojmë sa më parë kuvendi e Lëvizjes. Mundësisht, tubimin me aktivistët ta shndërrojmë në kuvend, i cili do të mbahet, siç është planifikuar, në korrik.

Xhabiri kundërshtoi:

– I kam pyetur anëtarët e Qendrës Ekzekutive në Kosovë dhe ata kanë kundërshtuar. Ata mendojnë se akoma është herët për ta legalizuar Lëvizjen në Perëndim.

– Mos gënje! – ndërhyri Mirani duke mos pasur durim ta dëgjonte. – Ata as që ekzistojnë si anëtarë të QE-së sonë, por i ke të sajuar që të na imponohesh ne në emër të tyre. Unë nuk besoj se në Kosovë janë zgjedhur tre të krahut të Sabitit dhe tre të krahut tënd në një forum të përbashkët. Përndryshe, ndonjë propozim ose urdhër nga ata do të na e prezantonin edhe shokët e krahut të Sabitit që i kemi anëtarë në këtë organ. Bile, kam dyshimin se ti në Kosovë po imponon hutë e anarki për të mos thënë katrahurë. Atyre po iu imponohesh me destruktivitetin tënd në emër të organit tonë, kurse neve po na komandon gjoja në emër të gjashtë anëtarëve

të po kësaj qendre, por që na qenka në Kosovë. Kështu ky organ yni më nuk mund të funksionojë.

– Pusho! – ndërhyri Xhabiri i egërsuar. – Nuk të duroj të më bësh edhe gënjeshtar.

– Mua po guxon të më urdhërosh, mor maskaral? – tha tjetri i egërsuar. – Përmbahu sa s'e kam humbur durimin. Unë nuk po të bëj gënjeshtar, meqë ti je gënjeshtar. Urdhëro, paraqit ndonjë dokument që të dëshmosh të kundërtën e akuzës sime, se ata të kanë dërguar ndonjë vendim të tyre! Po e paraqite do të jap llogari unë.

– Aman! – nisi të lutura Hakani, – po jua bëjë rixhanë e zotit që të mos zihen se po na çmendni.

Xhafari vetëm heshtte. Ai i gëzohej kësaj zënke duke menduar se cilido që të humbte, ai do të dilte fitues. Xhabiri vendosi të mos e acaronte më shumë Miranin, meqë po mendonte ta mënjanonte ndryshe, duke u munduar t'i bindë anëtarët e tjerë të Qendrës Ekzekutive për ta përjashtuar nga Lëvizja. Sa për ta kapërcyer gjendjen propozoi:

– Shokë, po u dakorduat, bëjmë një orë pushim që unë të sjell dokumentin që kërkoi shoku Miran.

Këtë propozim Xhabiri e bëri me bindjen se shumica do t'i thoshte se nuk kishte nevojë ta sillte. Përndryshe, po e kërkuan, do ta falsifikonte. Mirani, duke u ngritur në këmbë miratoi propozimin e tjetrit.

Xhabiri doli në korridor dhe prej andej u fut në kuzhinë. Sarandës i tha që të mos e pengonte njeni, meqë dëshironte të përpilonte një propozim për mbledhje. Sapo hyri dhe mbylli derën, ai nxori qumështin nga frigoriferi. Pastaj nxori stilografin nga xhepi dhe ia derdhi ngjyrën në lavaman. E shpëlau me ujë dhe e mbushi me qumësht. Hapi furnelën që të ngrohej. Nxori një letër të bardhë dhe filloi të shkruante me stilograf të mbushur me qumësht. Sapo iu duke se kishte shkruar që duhej e vuri me kujdes letrën mbi furnelë. Nga temperatura qumështi u skuq menjëherë dhe i doli teksti i shkruar. U

gëzua që ia doli të prodhojë provë të suksesshme për t'iu kundërvënë Miranin, duke menduar se do ta shfrytëzonte për t'i kërkuar llogari atij. Sigurisht përjashtim nga Qendra Ekzekutive.

Fiku fumelën dhe vendosi qumështin në frigorifer. Hapi derën dhe e pyeti Sarandën nëse kishte një gotë qumësht për të pirë. Këtë truk e bëri për të kamufluar më mirë falsifikimin. Vazhdoi të qëndronte ulur pranë tavolinës së kuzhinës, tani me derë të hapur, që të shihej nga dhoma e ndenjës dhe nisi të përpilojë propozimin për përjashtim të Miranit. Pasi mbaroi së shkruari, që andej u fut në dhomën e gjumit të Hakanit duke e porositur atë:

– Kam nevojë për pushim prej gjysmë ore. Po nuk përtove ma gjej që tani çelësin e sejit se më duhet ta gjej dokumentin që na e kanë dërguar shokët nga Kosova.

Hakani ia dha çelësin ku po ruheshin dokumentet e Qendrës Ekzekutive dhe dokumentet e tjera të Lëvizjes dhe e la Xhabirin në dhomë të gjumit. Tamam kur u rumbullaksua një orë ai u fut në dhomë të ndenjës ku po rrinin të tjerët.

– Shokë, – nisi të flas me zë të qetë e të sigurt Xhabiri, – po vazhdojmë me mbledhjen. Më parë mendova se dokumentin nga Kosova e kisha në arkiv të mikut vicëran Benedickti dhe po përtoja të shkoja ta merrja. Gjatë pauzës thashë të shoh se mos e kam sjellë këtu. Hakani ma dha çelësin e sejit të dokumentave sekrete. I kontrollova dokumentet dhe për fat e gjeta. Ja, urdhëro e shikoje, shoku Miran.

Xhabiri vendosi letrën mbi tavolinë. Shkrimi kishte ngjyrë të kaftë. Mirani po e vështronte, njëherit po ndihej i zënë ngusht. Po mendonte çfarë propozimi duhej të bënte për llogaridhënien që e kish premtuar. Iu afrua letrës duke e parë me kureshtje për ngjyrën që kishte.

– A ke mundësi, shoku Xhabiri, të na e dekonspirosh, me çfarë ngjyre është shkruar? – pyeti Mirani për të fituar kohë për të menduar se si duhej të vepronte dhe për ta shuar kureshtjen për ngjyrën e shkrimit që nuk e kishte parë asnjëherë.

– Shokët në Kosovë, – filloi të përgjigjej me qetësi Xhabiri, – e kanë shkruar me qumësht dhe mua më ka ardhur si letër e bardhë. Ishim marrë vesh më herët se unë duhej ta nxeja me kujdes mbi furnelë. Duke u nxe, qumështi piqet dhe del teksti. Këtë teknikë e dimë vetëm ne dhe është tepër e sigurt, pasi policët serbë nuk hetojnë gjë, kur ia shohin letrën e bardhë korrient që bart postën tonë sekrete.

Vende–vende ngjyra ishte tepër e zbehtë, sa mezi lexohej. Ndërkohë dorëshkrimi po i dukej i njohur. Hodhi vështrim mbi fletoren që e përdorte Xhabiri për të mbajtur procesverbalet, të cilën Xhabiri e kishte vendosur mbi tavolinë, sapo nisi vazhdimi i tubimit. Pa se dorëshkrimi ishte i njëjtë. Vështroi të gjithë të pranishmit me radhë. Ata po prisnin në heshtje përgjigjen e Miranit. E mori letrën në dorë dhe filloi ta lexonte:

*Të dashur shokë të QE–së në mërgatë,
Kërkesa juaj për të mbajtur kasend të LRSHJ–së në mërgatë nuk miratohet nga ana
jonë, sepse...*

– Shokë, – nisi të flas Mirani, pasi u bind edhe nga stili, se dokumentin e kishte shkruar vetë Xhabiri, – ky dokument është i falsifikuar. Ky dorëshkrim është i Xhabirit. Ja, urdhëroni e shihne, është krejtësisht identik me dorëshkrimin e procesverbalit.

Mirani vendosi letrën mbi tavolinë pranë fletores se procesverbaleve. Xhabiri bëri ta grabiste:

– Është dokument sekret dhe nuk ju lejohet ta lexoni.

– Mos e prek se të prek damllla! – e kërcënoi Mirani duke vënë dorën me shpejtësi mbi letër.

Menjëherë Xhafari, pastaj Saranda, pastaj Fahriu u ngritën dhe u zgjatën mbi tavolinë. Hakani nuk po lëvizte vendit.

– Vërtet, dorëshkrimi i Xhabirit qenka! – miratoi Xhafari duke u shtrërrur se po i vinte keq.

Të tjerët mbetet duke bërë o bo bo, edhe kjo na u desh!

– Jam i sigurt, shokë, se Xhabiri më parë e falsifikoi në kuzhinë. Në xhep duhet ta ketë stilografin të mbushur ende me qumësht.

– Nuk është e vërtetë, – ndërhyri Xhabiri i zënë në flagrancë, – ky kriminel vetëm shpif.

– Kriminel e shkuar kriminelit, – ndërhyri Mirani i përmbajtur. – Hape setrën se ke stilografin në xhep të mbushur me qumësht! Të mos shkoj në kuzhinë për ta gjetur në lavaman gjurmën e tintës së stilografit që e ke zbrazur.

– Pa më dëgjoni mua më plakun në këtë dhomë! – ndërhyri Hakani si gjithnjë me zë lutës, – të bëjmë një pauzë të shkurtër. Saranda do të na sjellë kafe, pastaj bëjmë vlerësime e mbajmë qëndrime për këtë letër. Unë po e mbaj letrën gjatë pauzës.

– Jo, Plak i dashur, po e ruaj vetë, – kundërshtoi Mirani duke e marrë letrën nga tavolina dhe e vuri në prehër.

– Mirë, mirë, mbaje, por po bëjmë pauzë, – tha tjetri.

– Dakord, unë dua një gotë qumësht nëse i ka tepruar Xhabirit, meqë kafën nuk e pi, – foli Mirani.

Saranda u ngirt dhe shkoi në kuzhinë për të bërë kafe. Të tjerët po qëndronin të heshtur e të nemitur, meqë i kishte zënë halli nga ky falsifikim dhe nuk po dinin si t’ia bënin. Mirani po mendonte të mos e dramatizonte falsifikimin më shumë, meqë mund të prisheshin dhe të përçaheshin me pasoja të rënda për Lëvizjen.

Sapo mbaruan kafet ai e mori fjalën:

– Shokë dhe ti shoqja Sarandë, jam i mendimit ta vlerësojmë të pandodhur këtë falsifikim të shokut Xhabir, gjegjësisht të Bacalokut, siç e emërtoi për kamuflim Hakani. Njerëz jemi dhe prandaj ndonjëherë gabojmë. Unë po ia shtri dorën shokut Xhabir t’ia fal këtë gabim të rëndë, i bindur se tani e tutje do të na e shpërblejë me veprimtari konstruktive. Kurse juvu do t’ju lutesha ta miratoni propozimin tim dhe ta heshtim këtë incident të rastit. Ndërsa letrën, mendoj ta zhdukim se asnjërin nuk na nderon, nëse e ruajmë.

– Të lumtë! – foli Hakani. – Kështu i ka hije revolucionarit që di të falë burrërisht.

Të tjerët miratuan zvarrë–zvarrë, ndërsa Xhafarit po i lexohej në fytyrë dëshpërimi. Mirani ia zgjati dorën Xhabirit duke i thënë:

– Mos u ngushto, shok i dashur, se ta fala meqë jam i bindur se tani e tutje do të jemi më të vëmendshëm, më të sinqertë ndaj njëri–tjetrit dhe më konstruktivë e më të bashkuar.

– Të falenderoj, – u përgjigj Xhabiri me një zë që mezi u dëgjua dhe me kokën varur turpshëm.

– Atëherë shokë, – mori fjalën Mirani, – gjykoj se sot nuk mund ta vazhdojmë këtë mbledhje. Shihemi nesër meqë kemi nevojë të qetësohemi se njerëz jemi. Atmosfera është e ngarkuar dhe e papërshtatshme për të qenë të ekuilibruar dhe konstruktivë.

Të gjithë miratuan propozimin e Miranit, sekush duke ndërruar vend, sekush duke pastruar tavolinën, i dhanë fund mbledhjes tejet skandaloze. Xhabiri menjëherë iku për në Gjenevë, Xhafari e Fahriu po e komentonin sjelljen e Miranit sesi nuk e shfrytëzoi shansin e tij deri në fund për t'iu hakmarrë Xhabirit, kurse Hakani e Saranda po merreshin me rregullim të banesës. Mirani nuk luajti vendit. Ai po mendonte me vete: “Bëra mirë që nuk i shkova deri në fund. Për momentin kisha favorin të dilja fitues, por përçarja që do të shkaktohej do ta vriste Lëvizjen. Ndikimi i Xhabirit në këtë organ është ende i madh, siç janë edhe mundësitë e tij të mëdha. Ai pas disa ditëve do ta kishte sërish në anën e tij Hakanin, Saradën dhe Xhafarin. Fahriu ndoshta do të mbante qëndrim neutral ose në anën time, por çfarë sukseesi do kisha me këtë gjysmanalfabet, pavarësisht se është i ndershëm dhe patriot i angazhuar. Gjithsesi më duhet të pres duke punuar që të mbahet kuvendi. Më këtë qëndrim që mbajta, mbase do të kem shanse më të mëdha për të imponuar mbajtjen e kuvendit në afat sa më të shpejtë. Nga anarkia e turbulencat që po i imponon Xhabiri në radhët e organizuara në Kosovë do të ndodhin goditje të rënda edhe nga ana e policisë. Disa do të detyrohen të

arratisen për t'u ikur arrestimeve, torturave e dënimeve të rënda. Në këtë fatkeqësi të madhe unë do të kem shansin e përforcimit, pasi ata që do të vijnë këtej do t'i kem në anën time. Unë kam përcaktime e angazhime më konstruktive për Lëvizjen...”

– Shoku Miran, do të ecim apo do të presim deri nesër? – ia ndërpreu mendimet Fahriu. – Nuk besoj se do të mund të mbajmë mbledhje nesër, pasi ai nuk do të vijë më nga Gjeneva.

– E di çka, them të dalim një herë buzë liqenit për të ngrënë akullore, pastaj, me trurin e freskuar atje do të vendosim më mirë se si ia bëjmë.

Mirani e Fahriu vendosen të shkonin këmbë. Gjatë rrugës Fahriu nisi të komentonte skandalin, por Mirani i tha se atë tematikë e quaj të përfunduar në mbledhje. Kështu veptoi, meqë ia dinte dobësitë Fahriut. Ai ua tregonte pa nevojë dhe pa dashur të tjerëve bisedat që bënte me ndonjërin prej shokëve. Kjo e dëshpëroi Fahriun.

– Miran, – foli pas pak ai, – ti e meriton të të informoj se Xhabini na ka dërguar një letër të gjithë neve, anëtarëve të Qendrës Ekzekutive, pos teje. Në atë letër ai kërkonte që ne të të mënjanonim ty heshturazi. Këtë propozim që ngjante në urdhër e kishte arsyetuar me disa shpifje tepër skandaloze. Ai shkruante se ti po i dekonspiron vendimet e QE-së në mënyrë imorale, se gjoja me ty bëka marrëdhënie seksuale Fëllanza. Pastaj ajo ia përcillte njeriut të Sigurimit që është i kamufluar si diplomat në Ambasadën Shqiptare në Stockholm. Prej andej u përcillkan në Tiranë. Xhabini gjoja i merrte vesh këto nga kushëriri i tij, Salë Shatori, që është oficerë i lartë i Sigurimit, sektori për kosovarët që arratisen në Shqipëri. I kishte shkruar edhe ca shpifje të tjera, por kjo më është dukur më skandaloze. Më keq më erdhi për Fëllanzën sesa për ty, sepse është grua plakë, nënë e dy fëmijëve, një patriote e ndershme, e zgjuar dhe shumë e angazhuar. Më fal që nuk të kam treguar deri sot ngase na kishte urdhëruar ta mbanim sekret. Por, falsifikimi që bëri ai sot, dhe ty të lumtë që e zbulove, po më shtyn të mos e mbaj sekret atë letër.

– Jo, nuk e gjykoj si skandaloze, – zuri të përgjigjej Mirani pas ca çastësh. –

Përmbajtja e asaj letre më dëmton mua, fyen Fëllanzën, dëmton edhe Lëvizjen në Perëndim. Por, skandali i falsifikimit që bëri ai sot për të na manipuluar i ka pasojat më të rënda në Kosovë. Ashtu siç na ka manipuluar ne në emër të drejtuesve të Lëvizjes në Kosovë, po kështu i ka manipuluar ata, në emër të Qendrës sonë Ekzekutive, sigurisht me letra të shkruara po me qumësht. Për sa kam dëgjuar nga ca bashkatdhetarë që kanë ardhur nga Kosova, por ende nuk i kam të verifikuara, ai po urdhëron grupime të patriotëve në Kosovë që të formojnë parti lufte, parti komuniste dhe të ngjashme, duke krijuar amulli e anarki atje. Nëse kjo del e vërtetë pasojat do të jenë të mëdha për të mos thënë tragjike. Besoj, tashmë, – vazhdoi ai, – edhe ty të është mbushur mendja se ne duhet të mbajmë sa më parë kuvendin e Lëvizjes në Perëndim. Na duhet organizimi i mirëfilltë që të minimizohen veprimet anarkike më pasoja të rënda për konsolidimin dhe forcimin e Lëvizjes. Veprimtaria e këtyre të katërve, pas atentateve, është goditje e rëndë për ne. Ne duhet të gjejmë forma ta disiplinojmë e kontrollojmë Xhabirin, sidomos sa i përket manipulimeve që po u bën radhëve tona në Kosovë.

– Vetëm më udhëzo se si duhet të punoj se tani e tutje do të jem në anën tënde dhe do të më falësh për padrejtësitë që të kam bërë në të kaluarën! – u përgjigj Fahriu.

– Nuk është zgjidhje të ndërrosh krahët, por të përpiqesh të përkrahësh të drejtën rast për rast, – shtoi Mirani.

22.

Në korrik u organizua tubimi informativ me aktivistët e Lëvizjes. Vend-tubimi: Shtëpia ku ishte bërë dasma e Kadriut dhe Sarandës, alias Bules, në periferi të Bien-Bein në Zvicërs. Referuesit Xhafari e Xhabiri nuk lanë gjë pa thënë kundër Avdyll Prapashpinës dhe përkrahësve të tij. Shumica e pjesëmarrësve në tubim u ekzaltuan. Asnjëri nuk doli në mbrojtje të Avdyllit, i cili tashmë po prononcohej se nuk e njihnte LRSFJ-në, por ruante vazhdimë-

sinë e organizimit të para 17 shurtit. Nuriu, alias Qerosi, i cili para disa muajve fshehurazi kishte kaluar në krahun e Avdyllit, nga pakënaqësia se nuk ishte më arkëtar i Komitetit të Vëllezërve Gërvalla, ishte aty për të përcjellë tubimin dhe për të informuar padronin e tij të ri. Ai vlerësoi si hap taktik që të diskutonte:

– Mos u nxitoni, vëllezër, me gjykime kaq të rrepta të krahut të shokut Avdyll Prapashpina, sepse edhe ata vëllezër tanë janë dhe një ditë do të sqarohemi e do të bashkohemi.

Diskutimin ia ndërpreu e qeshura ironike e mbi 100 pjesëmarrësve.

Qendra Ekzekutive vazhdonte të mbante mbledhje herë pas here, edhe pse fillimisht ishte vendosur të bëheshin një herë në muaj. Në mbledhje të radhës mungonte Sadriu, alias Rrobaqepësi, meqë ai vazhdonte të qëndronte në Turqi. Në atë mbledhje mungonte edhe Mirani, meqë Xhabiri nuk e kishte informuar. Xhabiri, përmes letrave që u kishte shkruar anëtarëve të tjerë të Qendrës, pas letrës për të cilën Fahriu e kishte informuar Miranin, i kishte urdhëruar anëtarët e tjerë që të mos e informonin Miranin, por t'i thoshin se nuk po mbahen mbledhje të rregullta. Fahriu e kishte informuar Miranin për këtë veprim të Xhabirit. Ndërkohë ia kishte dhënë në konfidencë kopjet e këtyre letrave. Mirani u kishte shkruar pastaj Xhabirit dhe anëtarëve të tjerë të QE një letër si përgjigja ndaj letrave të Xhabirit. Sigurisht që nuk i kishte informuar se cili ia kishte dhënë kopjet e letrave, por ia kishte demantuar shpifjet.

Pas kësaj letre të Miranit, Xhabiri u detyrua të bënte autokritikë në mbledhjen e radhës. Tani e tutje Mirani ishte përcaktuar për një luftë më intensive kundër Xhabirit.

Më 28 tetor 1983 mbahet demonstratë në Strasburg. Demonstrata që e fuqishme, por e shoqëruar me një incident. Në flagrancë u kapën duke fotografuar fshehtas nga makina, pjesëtarë të policisë sekrete franceze. Demonstruesit, duke menduar se janë spiunë jugosllavë, i sulmuan. Ata provuan të

iknin duke rrezikuar t'i shkilnin me makinë demonstruesit. U konfiskohet aparati fotografik dhe një çantë e gruas që po ngiste makinën. Në të gjendet letërnjoftimin zyrtar lëshuar nga Ministria e Brendshme franceze. Bisedimet për të kthyer këtë dokument i zhvilloi Mirani. Francezët ofruan dhjetë mijë DM, por Mirani nuk i pranoi, me shpjegimin se nuk e kishte letërnjoftimin zyrtar, pos çantës me dokumente të tjera personale. Mirani u premtoi atyre se do t'ua kthente letërnjoftimin zyrtar kur t'ia dorëzonte ai që e kishte marrë nga çanta, pa pasur nevojë të paguanin.

Në nëntor të '83–shit vjen nga Turqia Sadri Katunriu, alias Rrobaqepësi. Ai fillimisht vendoset në Gjenevë, te Xhabiri. Pas dy ditësh qëndrimi aty, ata zihen brutalisht mes vete në banesë të Xhabirit. Xhabiri ndihet i detyruar ta thërrasë në ndihmë Miranin. – Të lutem, eja e ma hiq nga banesa këtë skizofren anadollak! – i thotë në telefon.

Kur shkon në Gjenevë, Mirani konstaton se zënka midis tyre kishte qenë tepër skandaloze dhe e egërsuar. Në banesë të Xhabirit ishte një gjendje as luftë as paqe. Akoma më pervers ishte fakti se Sadriu nuk kishte pranuar të dilte nga banesa e tjetrit. Ai, kur erdhi Mirani zuri të arsyetohej: – Jam frikësuar nga udhëbashi Xhabir të iki nga banesa e tij. Ai kishte në plan të më nxirrte përjashta dhe të më vriste në rrugë. Prandaj më i sigurt ndihesha në banesë të tij sesa përjashta.

– Qetsohu, nuk ke nevojë të frikësohesh më. Tani unë jam këtu. Erdha të të marrë, – i tha Mirani me ndjenjë keqardhjeje.

– Si të qe... qetësohem? – zuri të përgjigjej Sadriu në gjendje prej të sëmuri, – kur ky UDB–ash, duke qenë unë këtu, zhvilloi bisedë telefonike me UDB–në dhe foli në gjuhën serbe. Nga përmbajta e bisedës më rezultoi se ky kriminel po fliste me eprorin e tij të UDB–ës.

Mirani po shikonte në drejtim të Xhabirit. Tjetri e kuptoi dhe filloi të përgjigjej me zë të përmbajtur.

– Shoku Miran, unë bisedova me një emigrant politik bullgar. Ai më tele-

fanoi për bashkëpunim. Papritmas, duke biseduar unë, filloi të ulërijë ky maskara, taman si i çmendur. U ndjeva keq, meqë bashkëbiseduesi po e dëgjonte ulërimën e këtij kokëkrisurit. Sigurisht se m'u tmerrua edhe gruaja.

– Me një emigrant politik bullgar!? – shfaqti habinë Mirani! – Po ti nuk na ke folur ndonjëherë për të. Ma shkruaj emrin dhe numrin e telefonit bullgarit që ta verifikoj nëse vërtet ekziston ky individ.

– Ai më telefoni dhe nuk ia mbajta në mend emrin e nuk ia di as numrin.

– Nuk po të kuptoj, si bisedove për bashkëpunim me njeriun që nuk ia dije as emrin dhe as numrin e telefonit? Mirë, këtë do ta sqarojmë në mbledhje, të shtunën.

– Me emigrantin bullgar e kemi lënë të takohemi, pasi ai do vijë enkas nga Franca, – u përgjigj Xhabiri i rrëshqitshëm si njalë.

Sadriu i qetësuar tashmë po shfaqte kënaqësi fëmijërore kur pa sesi Mirani e mori në pyetje tjetrin.

– Do të na japësh leje? – iu drejtua Mirani Xhabirit, – ne po shkojmë dhe do të takohemi nesër në orën 10.00, në banesë të Hakanit. Të lutem, porosit një taksì të na çojë në stacion të trenit!

Xhabiri u gëzuar që ai ia nxori Sadriu nga banesa, por këtë gëzim ia ndrydhi dyshimi.

Në stacion Mirani dhe Sadriu morën trenin për në Bil/Bien. Gjatë rrugës Sadriu po mundohej ta bindte Miranin:

– Xhabirin e ka dërguar UDB-ja që ta shpartallojë Lëvizjen tonë. Për këtë qëllim e kanë sajuar arratisjen e tij nga burgu i Prishtinës. E si mund të quhet arratisje vetanake, kur Xhabirin e kanë vozitur me mercedes të zi të Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës nga burgu i Prishtinës e deri në Slloveni, te kufiri me Italinë!? A ke besuar ti se vërtet Xhabiri është arratisur nga burgu dhe se atë vërtet e ka ngarkuar OMLK-ja për ta përfaqësuar në bisedimet për bashkim?

– Sadri, të lutem mos nxito, – ia ktheu Mirani, – sepse Xhabirin e kemi shok, bashkëveprimtar e tashmë edhe udhëheqës. Edhe unë kam dëgjuar përgo-

jime të ngjashme nga më të llojlojshmet për të, për ty, për mua dhe për të tjerët. UDB-ja është e specializuar në luftë speciale të dezinformimit. Ne duhet të flasim vetëm me fakte dhe të mbrojmë njëri-tjetrin nga dezinformatat.

– Pse, nuk t’u duk fakt biseda telefonike e Xhabirit me UDB-në? Ti me dy proteza ia bërë mat.

– Thamë, për këtë rast do të bisedojmë nesër në mbledhje, sepse nuk sqarohen këto gjëra duke biseduar në dyshe, siç na është bërë shprehi, – mbajti qëndrim Mirani duke mos dashur ta vazhdojë më gjatë këtë bisedë, meqë ndaj Sadriut kishte dyshime akoma më të mëdha sesa ndaj Xhabirit.

Pastaj ra një heshnje e nderë. Pauza i dha Sadriu favor të mendonte sesi duhej ta përvetësonte Miranin në këtë betejë kundër Xhabirit, që pas eliminimit të tij t’i kthehej të parit.

– Mbase je informuar, shoku Sadri, se unë kam folur vetëm keq për ty, kam pasur shumë paragjykime – i tha Mirani.

– Kam dëgjuar, por ti ke folur vetëm para Jusufit dhe jo para të tjerëve. Atë je munduar ta bindësh që të mos më dëgjojë mua, por ai ishte tamam burrë, tani hero dhe prandaj nuk ke mundur t’ia lëkundesh besimin ndaj meje, si veteran i kauzës kombëtare që jam.

– Sepse ishte idealist dhe t’i e ke shpërdoruar idealizmin e tij në emër të ilegalitetit e konspiracionit. Shpeshherë, në emër të ilegalitetit e të konspiracionit bëhen shpërdorime të mëdha, pasi në këtë gjendje është vështirë të verifikohet e të kundërshtohet udhëheqësi. Kurse ti vazhdon të besosh se ai të kishte idhull ngase e meritoje, se akoma të ushqen deliri i madhështisë prej veterani, – ia priti Mirani duke ironizuar pozën prej veterani fodull. (Këtë gjendje duhet shfrytëzuar pasi e kam në dorë deri nesër këtë satrap! – mendoi Mirani). – Atëherë, përse nuk e kontaktove Jusufin për më shumë se një vit e gjysmë?

– Isha i demoralizuar dhe doja t’i kthehesha jetës private.

– Nuk gjykoje se ia kishe borxh që ta kontaktoje dhe ta njoftoje, qoftë edhe për këtë vendim tëndin? Ai priste me padurim kontaktimin me ty.

– Nuk kisha vullnet ta kontaktoja më.

- Dhe të erdhi ky vullnet në qershor të ‘81–shit?
- Atëherë më erdhi morali, ngase populli ynë heroik e tregoi veten.
- Si shumë të paska vonuar vullneti që të vijë nga Kosova deri në Stamboll, pasi populli e tregoi veten gjatë marsit dhe në fillim të prillit!
- Sa i karrabytht qenke, si gjyqtar hetues! – e ndërpreu Sadriu.
- Ne bisedë të lirë po bëjmë dhe nëse ndihesh i bezdisur mund të hesht. Jam i ri dhe po dëshiroj të informohem e të mësoj prej teje, se të kemi veteran me përvojë të madhe patriotike! – ironizoi tjetri.
- Po më vjen mirë që ti, si i ri e i papërvojë dëshiron të mësosh nga përvoja ime e madhe, si veteran që jam, – u krekos akoma më shumë Sadriu.
- Sapo kontaktove me Jusufin, ia sugjerove Xhafar Durdelin, alias Skenderin dhe Nuri Syleviqin, alias Qerosin. I njihje ti ata?
- Personalisht nuk i njihja, por kisha porosi nga udhëheqësi i organizatës sonë.
- Kë keni udhëheqës?
- Shkove larg. Kemi disiplinë konspirative strikte. Pastaj nuk do të mbëtet të mësosh asgjë nga historia.
- Tani jemi bashkuar dhe jemi anëtarë të të njëjtit organ udhëheqës. Vërtet edhe tani më duhet të pres të informohem nga historia për njerëzit që na i keni sjellë në udhëheqje të Lëvizjes?
- Bashkim i thua ti këtij tonit? – pyeti Sadriu. – A po sheh çka po shkruan Avdyl Prapashpina, oficeri i qelbur i UDB-së!? A u binde kush është Xhabir Shatori, edhe ky udbash i kamufluar!? Me këta të bashkohemi? Kurrë. Kur u grindta me Xhabirin, mendova se vetëm me ju të Frontit duhet ta vazhdojmë Lëvizjen, pasi ata janë komunistë dhe në bisedime për bashkim përfaqësonin organizime komuniste. Komunistët gjithëherë na e kanë ngulur.
- Po edhe në radhë të Frontit kishim komunistë dhe antikomunistë. Unë kisha qejf të bëhesha komunist, por ma vunë kusht që t’i shkurtoj flokët, të mos vesh xhinse, të disiplinohem...
- Ku i dihet, ndoshta edhe ti do të bëhesh komunist!

– Jo, shpëtova, se tani të kam ty udhërrëfyes, – ironizoj Mirani pa kuptuar gjë tjetri.

– Ashtu pra, je djalë i mbarë dhe di të më respektosh mua, veteranin.

– Kur ishim te udhëheqësi i organizatës suaj, po të informoj se Jusufi na pat thënë se Metush Krasniqin e kishit udhëheqës kryesor të organizatës. Për këtë ai ishte i sigurt, meqë ia kishe thënë ti në besë. Këtë informim e kërkonin në Kosovë, meqë atje gjatë muajve qershor e korrik po diskutohej për bashkim të organizatave të fshehta, por nuk po e gjenin udhëheqësin tuaj. Kur i shkuan Metushit ata të OMLK-së që të bisedonin për bashkim, ai pranoi të jetë udhëheqës i organizatës. Bile pat thënë se ajo organizatë ekziston vetëm në kokën e Sadri rrobaqepësit defektoz.

– Janë spekulime të atyre komunistëve qelbanikë.

– Komunistë janë edhe Nuriu, Xhafari dhe këta përfaqësuesit me të cilët ti krijove LRSIJ–në ose LRSSHJ–në. Pastaj edhe Jusufi ishte enverist i flakët.

– Por, Jusufi nuk ka qenë komunist. Enverin e ka dashur vetëm si burrështetas shqiptar, – ndërhyri Sadriu duke e lënë qëllimisht si të harruar Nuriun, Xhafarin, Avdylin e Xhabirin.

– A e ngarkove ti Nuriun përmes telefonit, në mëngjesin e 18 janarit, që të drejtonte ceremoninë mortore?

– Po, edhe ai është veteran i çështjes kombëtare, kurse ti je akoma i ri e i papërvojë.

– Po Dritës, bashkëshortës së Jusufit, i ke dhënë ndonjë urdhër?

– Sigurisht, por ato i përkasin tashmë historisë dhe kishin të bënin me ish–organizatën tonë, e cila është bashkuar në Lëvizjen për Republikë.

– Pak më parë nuk e njohe këtë bashkim.

– E njoh vetëm hisen time të këtij bashkimi.

– E si u ndaka në pjesë ky bashkim?

– Do ta mësosh shpejt, pasi krahu ynë dhe juaji do ta fusin në dorë Lëvizjen që e kam formuar unë. Avdyll udbashin e mënjanoam, nesër po e menjanojmë edhe Xhabir udbashin.

– E dije ti se Avdyli ishte oficer i lartë dhe legal i UDB-së dhe njëherit edhe komunist, bile edhe Kryetar i Partisë Komuniste dhe pranove të bashkohe-she me të?

– Po, e dija, por organizata më detyroi që ta bëjë bashkimin me të.

– Organizata që nuk po e njihje askush në Kosovë, as edhe Baca Metush. Mirani mendoi të vazhdonte avazin e deklasimit të tij, por u frenua meqë kishte dëshirë të informohej sa më shumë, sado që biseda po i dukej më shumë e lezetshme sesa informuese.

– Organizatën tonë do ta njohë historia. Kjo është merita jonë, sepse kemi zgjedhur konspiracionin më të sofistikuar. Të tjerët përditë po i zbulon e burgos UDB-ja.

– Se mos po mbeten si shumë gjëra për t'i treguar historia dhe nuk ia del dot, – tha duke qeshur Mirani. – A i ke caktuar ti tre veta dhe Xhabiri tre veta në Kosovë, të cilët i kemi anëtarë të organit tonë udhëheqës dhe nëse po, si funksionojnë ata, pasi nga krahu yt asnjëherë nuk na ka ardhur gjë nga ata tre?

– Gënjen ai udbash, as unë e as ai nuk i kemi emëruar nga tre veta, në pjesën e organit tonë udhëheqës brenda në Kosovë. Ai vetëm po e manipulon gatishmërinë e patriotëve të dëshmuar duke i viktimizuar ata.

– Pothuajse harrova të të pyes për rastin e Musa Hotit. Vërtet, pse e kooptove atë në organin tonë drejtues?

– Sepse bëri akt të madh patriotik kur vrau një shka.

– Në organ nuk morëm vendim të tillë. Atëherë nga i more ti kompetencat që të thirrësh në emër të organit tonë kur e kooptove atë?

– Sepse unë jam themelues i Lëvizjes dhe kam të drejtë të kooptoj këdo që e meriton.

– Kështu mbase të është lejuar në ish-organizatën tënde, por kështu nuk ke të drejtë dhe nuk do të lejojmë të shpërdorosh organizatën. Këtu vendimet duhet t'i marrim kolegjisht dhe asnjërit nuk na lejohet të bëjmë këso shpërdorimesh.

– Unë jam lider dhe më lejohet. Nuk është logjike që unë dhe ti të kemi përgjegjësi të njëjta, – ndërhyri Sadriu.

– Kjo formë nuk i takon liderit, por bajraktarit.

– Shumë më mirë i kemi pasur punët kur jemi udhëhequr nga bajraktarët.

– Të pëlqyeka bajraktarizmi sepse këtë institucion e patën themeluar pushtuesit turq për të mbajtur nën kontrollë rebelimin e popullit tonë të push-tuar. Vetë fjala bajraktar dëshmon se është institucion i themeluar nga turqit, meqë në shqip do të thotë flamurtar.

– Mos e zgjat, se veç hajrin ia kemi pa Turqisë që na pat myslimanizuar, përndryshe do të ishim bërë shkie.

– Na pat myslimanizuar me dhunë. E pse nuk u bënë shkie shqiptarët katolikë e ortodoks? – iu kundërvu Mirani, por duke menduar se nuk ia vlente ta vazhdonte bisedën me këtë turkoshak, vendosi t'i rikthehej kooptimit të Musa Hotit. – A je vetëdijësuar tani se ke gabuar që e pate kooptuar Musa Hotin? Ai, deri në momentin kur vrau bashkëveprimtarin e tij, nuk ishte anëtar, por kundërshtar i Lëvizjes. Me krimin që bëri dhe përmes kooptimit që i bëre, ti inkriminove e komprometove Lëvizjen. Pastaj ai, duke shpërdoruar kooptimin nga ti, na ka shkaktuar dëme e përçarje të mëdha, duke i urdhëruar se si të veprojnë aktivistët tanë naivë, përmes letrave që ua dërgonte.

– Ngadalë he burrë, ai është patriot dhe kuadër meritore në organin tonë dhe për këtë ne duhet të krenohemi...

– Sipas kutit tënd të vlerësimit naiv dhe sipas shijes e përcaktimit tënd.

Lajmërimi që u bë përmes altoparllantit shënoi arrijtjen e trenit në stacion të Bil/Bienit, duke ia ndërprerë fjalën Miranit.

Caku i fundit për ta ishte banesa e Hakanit dhe Sarandës, alias Bules.

Pas përshëndetjeve, Hakani iu drejtua Miranit me të qeshur:

– Të lumtë, Miran! Ia hoqe belanë Bacalokut nga shtëpia dhe ma solle mua.

– Mendova se këtu do ta ketë më së miri, pasi jeni të të njëjtës moshë dhe do të mirëkuptoheni. Pastaj ky është rrobaqepës dhe ndoshta ta pret edhe ty ndonjë kostum.

– Të lumtë, i ke llafet si të ishe plak me mjekër! – ia pati Hakani.

23.

Një ditë pas zënkës së madhe, më 13 nëntor, mbahet mbledhje e QE. Pjesëmarrës: Xhabiri, Sadriu, Mirani, Xhafari, Hakani, Saranda dhe Fahriu. Sërisht plas shamatë e madhe ndërmjet Xhabirit e Sadriut. Mbledhjen po e drejtonte Mirani, meqë të gjithë ishin pajtuar se ai do ta pleqëronte drejtësisht këtë zënkë, në dukje aksidentale. Dëgjohen të dy. Meqë Sadriu e Xhabiri nuk po ofronin fakte të reja, pos akuzave reciproke që diheshin, Mirani tha:

– Do t’ju lutesha të dëgjoni me vëmendje, sepse ju po mendoni se ne jemi naivë dhe mund të vazhdoni të talleni me ne, siç jeni tallur deri tani. Ju këto përçarje i keni të inskenuara, të shpifura dhe tani vetëm po aktroni që ne vazhdimisht të merremi vetëm me përçarjet që po i impononi artificialisht. Këtë skenar nuk e di se kush e ka bërë dhe cili prej jush është regjisor. Ndoshta është Avdyli, si oficer i UDB-së, i cili nuk e sheh të nevojshme të marrë pjesë këtu. Ju sajuat bashkimin për të plagosur vendimet që patëm marrë në agun e 17 Janarit, Jusufi, Kadriu, Bardhoshi dhe unë. E bëtë këtë në kuadër të një makroskenari: Të vriten liderët e lëvizjes që po lindte në momentin kur ata nuk po mund të manipuloheshin më nga dezinformatorët që na kishin rrethuar, në momentin kur ata po bënin bashkimin në një organizatë me perspektivë. Ju mundët të depërtonit, sepse na u vranë liderët dhe ne ishim të pafuqishëm e naivë për t’u mbrojtur nga depërtimi juaj. Juve, të katërve, ju bashkoi dikush dhe ju urdhëroi të sajoni bashkimin në LRSSHJ. Ishit gjoja përfaqësues, ju kishin ngarkuar gjoja organizatat që ju u shtrirë se i përfaqësonit. Ju depërtuat duke shpërdoruar fatkeqësinë e rëndë të bashkëshorteve të Jusufit e Kadriut. Ju depërtuat duke shpërdoruar goditjen e rëndë dhe naivitetin e hilen e Nuriut, Hakanit, Fahriut. Ju depërtuat duke shfrytëzuar pafuqinë time për t’u mbrojtur, sadoqë që nga momenti i parë kam qenë i vetëdijshëm për rolin tuaj. Ju vepruar në bazë të megaskenarit që të fillonit menjëherë të përçaheshit, sapo shpallët publikisht bashkimin e shpifur, për t’i

dhënë kështu goditjen përfundimtare patriotëve që u shkonin mbrapa Jusufit e Kadriut. Sepse donit të impononit vetëm grindje e vëllavrasje midis nesh.

Këto të gjitha po jua them një çikë më shkoqur në këtë mbledhje, meqë më caktuat si pleqnar të grindjes suaj të fundit që po më duket fragment i megaskenarit tuaj komplotist. Këto po jua them sepse tani jam kaq i fortë sa t'ju kundërvihem, meqë janë ndërgjegjësuar edhe Hakani, edhe Saranda, edhe Fahriu dhe shumë të tjerë. Këtë po jua them, sepse nuk po mund ta duroj talljen që po na bëni, as bindjen që keni se mund të na manipuloni pafundësisht, si naivë që na pandehni. Këtë po jua them tani që t'jua japim shansin e fundit: o do të bëheni bashkëveprimtarë konstruktivë, o më nuk keni përse vini në mbledhje të organit tonë! Këtë po jua them tani, pasi jam i bindur se edhe në këtë mbledhje shumica e votave janë në anë time. Këtu e tutje nuk do ta pleqërojmë grindjen tuaj, sepse jemi të mbisunduar nga mllefi e hidhërimi që kemi karshi jush. Pleqërimin do ta bëjmë në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme, kur ju të jeni përgatitur për akuzat e rënda që jua bëra. Do t'ju bëja padrejtësi të kërkoja që të mbroheni nga kjo akuzë, të cilën unë kam filluar ta përpiloj që nga mëngjesi i 18 janrit të '82–shit e deri tani që e shfaqta.

Me kaq përfundon ky rend i punës. Kush është dakord që pleqërimin dhe marrjen e vendimeve për këtë pikë ta shtyjmë për mbledhjen tjetër?

Sapo bëri këtë pyetje ai e drejtoi shikimin kah Fahriu, Saranda e Hakani, që ata të mos e zhgënjenin. Fatmirësisht Saranda ngriti dorën e para, të cilën e shikoi me habi Hakani. Menjëherë pas saj e ngriti Fahriu dhe me zvarritje e ngriti edhe Hakani. Që të tre komplotistët, siç i akuzoi Mirani, u shokuan nga votimi i tyre, por nuk bënë zë.

– Shoqja Sarandë, shëno në procesverbal: “Me shumicë votash u vendos që pleqërimi dhe marrja e vendimit për grindjet midis Xhabirit e Sadriut të shtyhet për mbledhjet e ardhshme”.

Po në këtë mbledhje u mor vendimi për demonstratë në Bruksel, më 10 dhjetor, Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriu. Mirani u ngarkua përgjegjës organizativ, sepse ai e njihnte më së miri emigracionin në Belgjikë.

Pastaj u mor vendimi për të organizuar vizitë me rastin e përvjetorit të 2-të në varrezat e Stutgartit (organizimi iu besua Fahriut), si dhe mbajtja e akademive përkujtimore në shumë kryeqendra.

24.

Mirani shkoi në Bruksel për të organizuar demonstratën. Këshilli i Lëvizjes në Bruksel cakton dy veta, Muzaferin dhe Tahirin, që të bënin paraqitjen e demonstratës në polici. Kur shkuan, policia i informoi se një demonstratë e kishite paraqitur Enver Hadri bashkë me një parlamentar belg, emrin e të cilit nuk e kishin mbajtur mend Muzaferi dhe Tahiri. Mirani kontaktoi me Enver Hadrin për t'u informuar se në emër të kujt e kishite paraqitur demonstratën. Mori përgjigjen se e kishite paraqitur në emër të Lëvizjes dhe të Komitetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për këtë, kishite sqaruar Enveri, kishite një shkresë nga Xhabiri, përmes të cilës e kishite ngarkuar të bënte paraqitjen e demonstratës. Enveri me atë rast ia dha letrën Miranit, i cili sapo e lexoi mendoi me vete: “Çka bën kështu ky farë pushti? Në mbledhje ngarkohem unë për organizim të demonstratës, kurse ky në prapashpinë ngarkon Enver Hadrin”.

– Në rregull, – tumiri Mirani, – meqë të paska ngarkuar Xhabiri, por kij kujdes që të mos bësh ndonjë aventurë kompromentuese.

– E di platformën e Lëvizjes, e pranoj atë, kam shprehur dëshirën për t'u anëtarësuar, por Këshilli i Lëvizjes në Bruksel nuk po më pranon, – u përgjigj Enveri. – Pastaj edhe Komitetin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e ka themeluar në Kosovë Xhabiri dhe mua më ka emëruar për kryetar të tij këtu në Bruksel.

Të premten në mbrëmje Mirani bashkë me Enisin dhe Islam Uçën shkuan për të takuar sënish Enver Hadrin, për të diskutuar nëse gjithçka ishte në rregull me demonstratën që duhej të mbahej të premten. Takimi u caktua në banesë të Relat Satatajt. Aty ishin të pranishëm edhe pesë veta, që veten e quanin bashkëveprimtarë të Enver Hadrit. Gjatë bisedimit, Mirani i kërkoi

Enverit ta shihnte lejen e demonstratës. Ai nxori nga çanta kopjen. Mirani hetoi se fotokopja kishte montime falsifikuese, prandaj iu drejtua Enverit:

– Ma jep origjinalin, sepse kjo kopje, siç po shihet është e falsifikuar.

– E kam në banesë, – tha tjetri.

– Shko merre! – e urdhëroi Mirani.

Të tjerët thanë se nuk ishte e nevojshme, pasi kopja mjaftonte. Në këtë moment Miranit ia mori mendja se Enveri duhej ta kishte në çantë origjinalin, ndaj i tha:

– Ma jep çantën! – dhe me një të zgjatur dore ia rrëmbeu atë.

– Nuk ke të drejtë të ma kontrollosh çantën, është personale! – kundërshtoi Enveri.

– Ke ardhur me këtë çantë në bisedë sqaruese, prandaj edhe çanta i takon këtij bashkorganizim! – ia preu tjetri.

Më në fund e gjeti origjinalin.

– E shih mor maskara, origjinali është në emër të belgut Michel R. dhe tëndin. Lëvizja nuk përmendet fare këtu. Kush është ky belgu?

– Parlamentar, – tha Enveri.

– I cilës parti? – pyet Mirani.

– I Partisë Komuniste Belge, – u përgjigj duke belbëzuar ai.

– I Partisë Komuniste Belge, i partisë që akuzohet nga shteti i këtushëm dhe nga mediat se financohet nga Bashkimi Sovjetik? – pyeti dhe konstatoi Mirani, duke u habitur për këtë veprim të Enverit, i cili tani po heshtte i zënë me pelë për dore.

– Dëgjo këtu, maskara! – foli Mirani i revoltuar, – tani është vonë ta anulohet demonstratën, meqë autobusët me bashkatdhetarë janë për rrugë. Nesër ti do të sillesh disiplinueshëm, pa folur me asnjë gazetarë. Do t'i caktojme dy veta, midis të cilëve duhet të qëndrosh gjatë gjithë demonstratës. Kurse për këtë komprometim që na ke bërë duhet të japësh një shpjegim pas demonstratë. Ndoshta të kujtohet se një veprim të ngjashëm ke bërë edhe në prill të '81-shit. Atëherë, dy ditë para se Stane Dollanci në Beograd të mbante kon-

ferencë shtypi me gazetarë të huaj, ti ke mbajtur këtu në Bruksel një konferencë shtypi. Stane Dollanci u tha gazetarëve në atë konferencë se në trazirat e Kosovës është i involvuar edhe Bashkimi Sovjetik. Në pyetje të gazetarëve për argumente, ai tha se mund të informohen për konferencën e shtypit në Bruksel, që e ka mbajtur para dy ditëve nacionalisti shqiptar Enver Hadri, i cili ka thënë se statusin e Republikës do ta fitojmë me ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Edhe tani po të njëjtën metodë ke përdorur për ta komprometuar veprimtarinë tonë çlirimtare. Si mund ta shpjegosh që ti në opinion, përmes shkresurave e llafomanisë sate paraqitesh si nacionalist antikomunist, kurse në praktikë bashkëpunon me struktura komuniste ose thua se do ta fitojmë Republikën me ndihmën e Bashkimit Sovjetik? Kështu po jep prova që Përrëndimi të mos e përkrahë kërkesën e drejtë të popullit tonë për status të Republikës. Sigurisht, përgjigje nga ti nuk dua të dëgjoj tani, sepse jam shumë i irrituar dhe i revoltuar.

Të gjithë heshtën.

– Natën e mirë jua dëshiroj juve të tjerëve, kurse këtë maskara e zëntë mallkimi i popullit, –përrshëndeti e mallkoi Mirani.

Kur dolën jashtë, Islami i propozoi atij të shkonte tek ai për të fjetur se kishte më shumë dhoma se Muzafëri. Pas plot njëzetë minutave, rreth orës 22.30, sulmuesit e paidentifikuar cingëruan në derën e shtëpisë së Muzafërit. Ai doli ta hapte derën duke menduar se po kthehej Mirani. Sulmuesit nga makina shtinë me rafale revoleje drejt tij, por plumbat nuk e qëlluan. Menjëherë u mblodhën anëtarët e Këshillit të Lëvizjes dhe vendosën të mos e bënin të madhe dhe as të mos e informonin policinë. Gjykuan se situata do të tensionohej para demonstratave dhe policia mund të merrte vendim për anulimin e saj.

SINOPSIS NË FORMË MOZAIKU

*

Më 18 dhjetor mbahet mbledhja e radhës e QE të LRSHJ-së. Në mbledhje Komisioni për analizë të shkrimeve të Xhabirit në *Zërin e Kosovës*, të cilin e kryeson Mirani, paraqet raportin. Xhabiri nuk i pranon kritikën që i bëhen. Gjithashtu ai kundërshton edhe referimin e Miranit për rrjedhën e demonstratës në Bruksel. Për grindjen ndërmjet Sadriut dhe Xhabirit nuk diskutohet fare, meqë Sadriu nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

*

Më 11 janar 1984 në Prishtinë policia vret veprimtarët Rexhep Malaj e Nuhi Berisha. Miranit i tregon një bashkatdhetar, i cili sapo që kthyer nga pushimi në Kosovë, se skuadronet speciale të policisë i kishte komanduar oficeri Tahir Zemaj. Ai ishte kritikuar nga eproret e tij për joprofesionalizëm dhe për këtë arsye ishte degraduar në pozitë më të ulët të përgjegjësive. Ky vendim ishte arsyetuar me inatin e tepruar të oficerit Tahir Zemaj, që të vriste kundërshtarë të pushtetit, përndryshe ai kishte mundësi t'i arrestonte të gjallë Nuhiun e Rexhepin, pasi po u mbarohej municioni. Në pamundësi të verifikimit të këtij informimi, Mirani e arkivoi atë në mbamendje të tij. Në të njëjtën kohë ai po e akuzonte Xhabirin se kishte faj të tërthortë në këtë vrasje, meqë këta dy veprimtarë të shquar si duket i kishte irrituar me urdhrat kontradiktore e konfuzë që ua jepte rrejshëm në emër të Qendrës Ekzekutive të Lëvizjes, deri edhe të atillë që ata të formonin parti komuniste ose parti lufte. Këto fajësime Mirani i mbështeste në (dez)informatat që i bënte gjoja rastësisht Xhabiri. Në fakt ai u tregonte Miranit, Hakanit dhe të tjerëve, që të vetëlavdërohet për sukseset udhëheqëse të tij të ilegales në Kosovë. Në të njëjtën kohë në Kosovë arrestohen Kader Osamani dhe dhjetëra të tjerë. Disa veprimtarë të dekonspiruar kalojnë në ilegalitet të thellë dhe vendosin të arratisen në Perëndim.

Edhe për këto arrestime dhe vendime për arratisje jashtë Kosove, Mirani më shumë po i hidhërohej Xhabirit sesa policisë, me arsyetim se policia atë punë kishte, kurse Xhabiri nuk duhej të impononte gjendje irrituese në radhët e organizuara në Kosovë, që kishin për pasojë gjithë këto goditje të rënda.

*

Në janar u organizua vizita te varret e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, në varrezat e Shtugartit. Mirani nuk e mbajti fjalën e rastit, pasi akoma nuk ishin ndërprerë përgojimet, shpifjet e akuzat ndaj tij lidhur me atentatet, nga krahu i Sabitit e Xhafarit.

*

Më 21 janar mbahet tubim komemorativ për Rexhep Malajn, Nuh Berishën, Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën dhe Bardhosh Gërvallën. Tubimi mbahet në Sant Gallen të Zvicrës. Sejmenët e Xhafarit e të Sabitit sulmojnë fizikisht në tubim ihtarë të Xhabirit. Pasoje: një i plagosur.

*

Më 8 shkurt në Prishtinë policia vret veprimtarin Bajram Bahtiri. Flitej se në këtë vrasje kishte dorë kushërii i Xhahilit, i cili duhej të kishte informuar policinë për vendndodhjen e Bajramit, që kishte kaluar në ilegalitet.

*

Më 2 mars organizohet demonstratë e fuqishme në Gjenevë, pastaj mbledhja e QE të LRSHJ-së. Kjo mbledhje u mbajt në situatë të tensionuar, meqë Mirani fajësoi Xhabirin për vrasjet dhe arrestimet në Kosovë, me arsyetimin se ai kishte provokuar anarki organizative, i kishte futur organizimet ilegale në kundërrthënie organizative e ideo-politike midis tyre. Gjitha këto po ndodhnin, – siç e akuzonte Mirani Xhabirin, si rrjedhojë e urdhrave dhe udhëzimeve që Xhabiri i përcillte në Kosovë përmes letrave të shkruara me qu-

mëshjt, gjithëherë në emër të QE të LRSHJ-së, sado që ky organ nuk dinte gjë për këtë lloj veprimtarie destruktive të Xhabirit.

*

Po në mars arratisen nga Kosova në Zvicër disa veprimtarëve të organizimeve të fshehta. Kësaj fatkeqësie të tyre po u gëzohej Mirani, me shpresë se me ndihmë të tyre do t'i jipej mundësia t'i mundte përfundimisht Xhabirin, Sabitin, Xhafarin dhe sejmënët e tyre. Ndër këta të arratisur ishin A. A., alias Abazi, E. Xh, alias Muhameti, M. Sh., alias Samiu, B. B., alias Bajrami, B. Ll., alias Bexheti dhe më vonë edhe M. Xh., alias Rrusta e të tjerë.

Kur ata vijnë në Zvicër, takojnë së pari Xhabirin. Nga ai kërkojnë që ta takojnë Miranin, por Xhabiri përpiqet t'i izolojë nga Mirani. Njëherit përpiqet t'i bindë se Mirani është destruktiv e anarkist. Ai veptoi kështu meqë frikësohej se ata do ta përkrahnin Miranin pasi t'i dëgjonin shpjegimet e tij për gjithë rrjedhat jashtë dhe për rolin e Xhabirit në goditjet e rënda të organizimeve të fshehta në Kosovë. Shumë shpejt çlirohen nga izolimi që ua kishte montuar Xhabiri, takojnë Miranin, dëgjojnë shpjegimet e tij dhe vendosin të pozicionohen pa u deklaruar formalisht në anën e tij. Këtë e kuptoi Mirani dhe zuri të ndihej i përforcuar në betejën kundër Xhabirit, Sadriut, Avdylit, Xhafarit dhe sejmënëve të tyre.

*

Më 7 prill organizohet tubim i madh në Düsseldorf. Sejmënët e Sabitit dhe të Xhafarit, ndër të cilët Xhahili, M.Z., M. D., Baca Zymeri, e Faziti provokojnë gjakderdhje, të bindur se do t'i japin goditjen e fundit Miranit dhe bashkëveprimtarëve të tij. M. D., godet me thikë prapa shpine Suliot Nelajn, kur ai ishte angazhuar të qetësonte zënkat që po ndodhnin në skenë, prapa perde për të dalë në mikrofon ose jo M. Z. Sapo Sulioti merr goditjen e rëndë, shkon qetësisht deri te Mirani që gjendej në fund të sallës.

– Më dërgo shpejt në spital se më është ngulur thika prapa shpine!, – i thotë ai pa bujë e zhurmë, pikërisht si një trim i vërtetë.

– Di gjë, cili të plagosi, se do t'ia bëj në vend dekën? – e pyet Mirani egërshah deri në tërbim.

– Mos e humb kontrollin! – foli Sulioti duke e mbajtur tjetrin për xhakete, – sepse këtu kemi gratë e fëmijët. Janë rreth 700 veta në sallë. Aktivistët janë të përmdezur dhe po morën vesh për plagosjen time do të shpërthejnë përleshjet e përgjakshme.

Mirani e dëgjoi me vëmendje dhe mendoi me vete: “Çfarë trimërie e urtësie prej kreshniku!”.

Mendimet ia ndërpreu Sulioti:

– Thirri mendjes dhe ec të shkojmë me taksi në spital! Nuk duhet të thërrasim ndihmën e shpejtë sepse do të vijë edhe policia. Duhet të ruajmë imazhin e mirë që kemi tek organet gjermane, si njerëz të urtë e paqësorë.

– Të lumtë, or trim për këtë urtësi! – tha Mirani duke zhveshur xhaketen të cilën ia vuri mbi supë që të tjerët të mos ia shihnin gjakun që nxirrte plaga.

Gjatë daljes u ballafaquan me kushëririn e Suliotit. Ai u shqetësua kur i pa në atë gjendje dhe pyeti:

– Suliot, vëlla, mos të plagosi ndokush në skenë?

– Jo, jo, – e ndërpreu Mirani, – vetëm po dalim përjashta që të ajrosemi.

Vazhduan drejt daljes, por Murtezani u shkoi mbrapa, meqë përgjigja e Miranit nuk e bindi. Kur dolën jashtë morën taksinë që po priste para sallës.

– Prit, ku po doni, më tregoni të vërtetën? – pyeti i alarmuar Murtezani.

– Ec, futu me ne në taksi, do të bisedojmë gjatë rrugës! – urdhëroi Mirani.

Sapo u futën në taksi, Mirani i tha të voziste shpejt për në klinikë.

– Pse në klinikë? – pyeti Murtezani i alarmuar.

– Qetësohu, e kanë plagos Suliotin me thikë pas shpine! – i tha ai.

– Ndalo! – urdhëroi Murtezani taksistin duke iu drejtua Suliotit: – Kush të plagosi, vëllai im se do të shkoj t'ia zbraz në gjoks?

– Mos ndalo, më shpejt në klinikë! – urdhëroi Mirani.

Në sallë, pasi M. Z., ia dhanë përdhunshëm mikrofonin sejmënët e Xhafarit, Xhabili, M. D., Faziti dhe të tjerë, ai foli kundër Xhabirit e Miranit, duke i akuzuar ata për banditë dhe armiq të Lëvizjes. Të pranishmit në sallë e keqpritën këtë paraqitje të tij, prandaj si në kor u ngritën vetvetiu për ta lëshuar sallën, duke protestuar kundër huliganizmit që e uzurpoi skenën.

Nga salla aktivistët shkuan në Klubin *Emin Duraku* dhe aty mësuan për thikën prapa shpine dhe për gjendjen e shëndetësore të Suliotit. Me maturi diskutuan gjithë ngjarjen dhe, meqë merrnin pjesë shumë veprimtarë nga të gjitha rrethet, jo vetëm të Gjermanisë, formuan një komision në krye të të cilit zgjodhën Fahriun.

Analizat, konkluzionet dhe propozimet e komisionit u përgatitën brenda pak ditëve, duke dënuar keqsjelljen e keqbërësve të asaj mbrëmjeje, në krye me Xhafarin. Xhabiri shfaqti kritika të shkruara ndaj këtij komisioni se përse nuk e kishte vlerësuar edhe Miranin si bashkëfajtor.

*

Fundjavës vijuese Lëvizja organizoi demonstratë në Bernë. Pas demonstratë u bë edhe mbledhja e QE-së. Në demonstratë dhe në mbledhje nuk morën pjesë Sadriu, Xhafari dhe sejmënët e tyre. Në vend që të merrte pjesë në demonstratë dhe mbledhje, Xhafari shkroi një letër publike prej 12 faqesh dhe ua drejtoi shokëve të Stuttgartit me rrethinë. Në letër ai komunikonte daljen nga Lëvizja e uzurpuar nga banditët si Mirani e Xhabiri dhe formimin e Lëvizjes së vërtetë. Prapa tij dhe Sadriut, në këtë lëvizje shkuan edhe shtatë-tetë sejmënë të tyre dhe epiqendrën e këtij fraksioni e ngritën në Suedi, ku tashmë kishte kërkuar strehim politik Sadriu e M. Z., duke shkuar atje edhe Xhafari.

*

Veprimtarët e rinj që u detyruan të arratisen nga Kosova u bënë krah i fortë për të vënë Lëvizjen në binarët e saj konstruktivë. Disa nga ata u kooptuan

në organin drejtues dhe në redaksi të *Zërit të Kosovës*. Tashmë Mirani ndihej akoma më i përforcuar dhe parashikonte avancim të madh të veprimtarisë dhe riorganizim të Lëvizjes. Xhabiri nuk ishte më në gjendje të frenonte insistimin e kamotshëm të tij për mbajtje të një kuvendi të gjërë. Këtë rritje dhe këtë avancim konstruktiv të Lëvizjes Mirani e vlerësonte edhe si fitore hakmarrëse për atentatet ndaj bashkëveprimtarëve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka, edhe si hakmarrje për atentatet e komplotet e mëpastajme politike e organizative. Mirani gëzohej si fëmijë për këto fitore, meqë parandjente se së shpejti do të mundej edhe Xhabiri, siç ishin mundur e dekluar Avdyll Prapashpina, Sabit Katunriu, Xhafar Durdeli dhe sejmënët e pakët të tyre. Ky përforcim i Lëvizjes çoi drejt marrjes së vendimit për të formuar komisionin që do të hartonte projekt-programin dhe projekt-statutin e Lëvizjes. Këto dokumente komisioni ua shpërndau aktivistëve të Lëvizjes që të jepnin mendimin për to. Në bazë të atyre komisioni ripunoi edhe një herë projekt-programin dhe projekt-statutin, të cilët do t'i paraqiteshin kuvendit për miratim.

25.

Në prag të Vitit të Ri 1985 Mirani i dërgoi nga Brema një kartolinë urimi Renatës. Katolinës ia bashkëngjiti edhe letrën:

E shtrenjta Renatë,

Vërtet më ka marrë malli për ty. Mungesën tënde, në njëfarë mënyre, po ma kompensojnë miqtë Johan dhe Helga S.

Dy zgjedhje të përdhunshme, por domethënëse, në jetë më kanë dalë të mbara: ajo që më detyruan të arratisem nga atdheu dhe kejo që të vendosem te kejo familje e mrekullueshme.

Zgjedhja e parë, e imponuar, më ndihmoi të jetoj dhe përjetoj zhvillimin e qytetërimit perëndimor; të iki nga diktaturo moniste dhe të jetoj në demokraci, do të thotë, në liri pluraliste; të iki nga prapambetja zhvillimore e kulturore dhe të jetoj në zhvillim të lartë e të gjithanshëm; të iki nga përndjekja dhe të filloj me veprimtari të angazhuar patriotike, e cila më bëri

bashkëëxprimtar e shok me Jusufin, Kadriun, Bardboshin dhe shumë të tjerë. Por, një nga fatet domethënëse që edhe njihja dhe miqësia me ty. Vërtet ti ke qenë akumulator i fuqishëm i shpirtit tim. Gjatë këtyre gjashtë viteve farkuam një lidhje e miqësi të veçantë, të cilën ti dhe unë e kemi të vështirë ta shpjegojmë. Por, nuk kemi nevojë t'i shpjegojmë ndjesitë tona, pothuajse të pashpjegueshme me fjalë e me shkrim...

Zgjedhja e dytë e imponuar u shoqërua me përparësi të shumta që gjeta në bashkëjetesë në këtë familje. Tashmë po e ndjeje si familje timën.

Të kam folur për ta në vizitat e rralla që t'i kam bërë gjatë këtyre dy viteve, por nuk po përmbahem pa të shkruar edhe tani. Në gjirin e familjes së këtij çifti të mrekullueshëm jam duke i ndier mrekullitë.

Po mbushen dy vjet që kur unë po jetoj në gjirin e kësaj familjeje. Tani që po mendoj për miqësinë e tyre, po më duket si një ëndërr.

Po të shkruaj fillimisht për aspektin material të kësaj bashkëjetese. Tash dy vjet nuk më është lejuar të blej me para të mia asgjë për të ngrenë e për të parë. Sa kohë që isha në shtëpi të tyre, vërtet u bë edhe shtëpia ime. Gjuhëberë jam ushqyer në të njëjtën tavolinë familjare dhe me të njëjtën ushqim familjar. Mëngjesin dhe drekën, gjatë ditëve të punës, i përkatit dhe i ser-von shërbëtorja, kurse darkën e për gatimim së bashku. Qiranë, që ua paguante shteti për mua, ma jepnin e ma japin që t'i kem për të zhvilluar aktivitete. Dhe, qiraja ishte më e madhe se ndihmat sociale që m'i jepte mua shteti. Kështu m'u rritën mundësitë financiare për të udhëtuar, m'u rrit mundësia që të paguaj më shpesh bileta dhe jo si përpara kur dërmohesha duke udhëtuar pa bileta në tren, në të zezë, siç thoni ju gjermanët. Vetëm kur doja, shkoja në dhomën time. Shtratin shpesh ma rregullonte shërbëtorja, ndonjëherë edhe Helga e Jochani. Më ndodhte të më zinte gjumi në dhomë të ndenjes, kur kishte në televizion ndonjë film të mirë. Kur zgjohesha për t'u bërë gatë për punë, më gjenin aty dhe qeshnin më mua, duke me qortuar se nuk duhej të flija aty, por të bëja gjumë të rregullt në shtrat. Kur nuk zgjohesha në të njëjtën kohë me ta, më zgjonin vetëm kur shtronin tavolinën, pasi arsyetoheshin se po u shijonte kaffjalli më shumë, kur banim së bashku.

Tani, besoj nuk po të bezdis, nëse të shkruaj edhe për aspektin shoqëror e shpirtëror. Përkrahësi shoqëror i Jochanit dhe Helgas ka qenë një ndihmë e madhe për mua, për të përballuar gjendjen e rëndë pas atentateve dhe goditjeve të pastajme. Këta, jo vetëm që janë shumë njerëz të mirë, por janë shumë me kulturë, prandaj janë të angazhuar politikisht dhe sidomos

në aktivitetet qytetare në lagje dhe në qytet. Kjo përvojë e tyre më ndihmonte, megjë ata nuk përtonin të bisedonin më mua, gjatë dhe shtruar, për të gjitha peripecitë e mia në veprimtarinë tonë kombëtare. Këshillat e tyre po i çmoj, po i ndiej të pazëvendësueshme. Megjë janë mjekë të mirë, ata shpesh më kanë bërë terapi, kur kisha kriza psikike e strese nga lodhja dhe mërzitë gjatë veprimtarisë sime. O Zot, ti nuk mund ta marrësh me mend, megjë edhe unë nuk kam mundur e nuk mundem të të shpjegoj se çfarë goditjesh e vuajtjesh kam pësuar nga ca, u thëngën bashkëveprimtarë, me të cilët isha i detyruar të bashkudhëhoja Lëvizjen tonë. Dhe, sikur të mos i kisha këta këtu, që të ma kompensojnë përkujdesjen tënde, do të kisha përfunduar në çmendinë ose do të kisha bërë vetëvrasje. Prandaj, shikuar në këtë aspekt, unë jua kam borxh juve jetën, sepse ndihma e përkujdesi juaj më kanë ndihmuar shumë që unë të mbijetoj tmerret që përjetova, që nga momenti kur ndodhën atentatet ndaj shokëve të mi, Jusufit, Kadrinit e Bardhoshit.

Bashkëjetesa aktive, dy-vjeçare, në këtë familje të mrekullueshme më ka ndihmuar shumë për ndërgjegjësim social e politik. Nuk më vjen turp ta them se më ka ndihmuar shumë edhe në emancipimin tim kulturor e qytetar.

Një ndihmë e madhe shpirtërore për mua ishte dhe është, dashuria e madhe dhe reciproke që krijova me tre fëmijët e tyre. Nga fëmijët krijova siguri më të madhe, që të zihem gjatë bisedimeve dhe debateve politike, sociologjike, filozofike, jetësore, shpesh edhe të nxehita, me Johanin e Helgën, pa pasur frikë se mund të priseshim dhe ata të më përçinin nga shtëpia, megjë nuk do t'i lejonin fëmijët. Siguria rrut edhe lirinë e mendimit e të zhvillimit.

Pos këtij çifti prej miqve të ngushtë, këtu kisha dhe kam edhe një çift të mrekullueshëm shqiptar. Ata përkujdesën për mua, me përkrahin e ndihmojnë, si të më kishin vëlla të mirë të tyre. Ky çift, siç të kam treguar, ma ka mundësuar strehimin dhe bashkëjetesën në këtë familje të mrekullueshme gjermane. Edhe pesë fëmijët e këtij çifti ishin dhe janë një kënaqësi e madhe për mua, për të ekuilibruar mallin për vendlindje e për familjen time. Pastaj, Hana, që ti e ke takuar, kishte rreth të madh shoqëror gjerman dhe në fillim më detyroi, e më vonë m'u bë nevojë e kënaqësi, që të merrja pjesë bashkë me të në takimet e rregullta të qytetarëve këtu në Bremen. Këtu mësona për angazhim të drejtpërdrejtë të qytetarëve në jetën politike, sociale, kulturore e sportive.

Nuk po e zgjas më shumë, sado që kisha dëshiruar të të shkruaj shumë gjatë, për të shpjeguar përinitësisht për bashkëjetesën në këtë familje dhe në këtë rreth shoqëror. Tani po përçen-

drohem te marrëdhëniet tona.

Me kalimin e kobës, meqë po takobeshim rrallë, sikur më ndodhte shpërbujta shpirtërore nga ti, e cila vetëvetiu ndajka shpërbujten fizike. Por, akoma e kam të fuqishme këtë lidhje. Tani, për hir të interesit tënd dhe timin, të sugjeroj e të lutem, që ti të provosh të çlirobesh nga marrëdhëniet tona. Nëse vazhdojmë të ruajmë lidhjet e mëbershme, do të vazhdojmë të ngelemi peng i njëri-tjetrit. Dhe, meqë edhe ti tasomë e di se bashkëjetesa jonë bashkëshortore nuk mund të realizohet, atëherë të sugjeroj e të lus, për hir tëndin dhe timin, që të orientobesh për të gjetur një fat tjetër; përkatësisht për të gjetur shokë tjetër me të cilin do ta lidhësh dashurinë dhe jetën tënde bashkëshortore, duke pasur që tani përrurimin tim të dhimbshëm, por të arsyeshëm, që të kesh fat e lumturi, bashkardhmëri e shëndet.

Nuk jem adoleshentë që të bëbemi robër të ndjenjave, pasioneve, epsheve e dashurisë që ndjenim e ndiejmë për njëri-tjetrin, dhe tani të ulërijmë: u bë keameti. Sa herë ta kam shprehur mendimin tim se arsyen e favorizoj më shumë se sa ndjenjat e pasionet. Dhe kjo arsyë po më bind që ne duhet të shpërbujmë avash-avash lidhjet tona shpirtërore dhe të orientobemi drejt realitetit funksional, pa dramatisim e gjëmi, me kurajo, energji, e orientim të ri.

Besoj, nuk do të dëshosh, se unë, ndërkohe të kam zëvendësuar me ndonjë tjetër. Tani arsyja po më këshillon që të gjykoj e veproj këshitu, meqë nuk po ndihem mirë kur po mendoj se po të mbaj peng ty. Gjithë këtë rrugë jetësore, nga çasti kur u ndjeva i detyruar të arratisëm, pastaj ardhja në Gjermani dhe njohja me ty ka qenë rrugë jetësore e imponuar nga roberia nacionale dhe përcaktimi për t'u çliruar prej saj. Dhe, meqë këtë rrugë më duhet ta vazhdoj derisa të jem gjallë, e shpresoj se çlirimin do ta përjetoj, gjykoj se bashkëjetesa jonë është e pamundur. Prandaj ti duhet ta nisësh jetën tënde të re, të ndarë nga jeta ime. Këtë propozim që ti duhet të fillosh ta jetësosh, ta bëjë duke u mbështetur në dashurinë e respektin e thellë që ndiej për ty.

Nuk po e zgjas, pasi ti tani e ke lexuar aq mirë mënyrën e të menduarit e të logikuarit tim, konceptet e përcaktimet e mia, sa do të kishte mjaftuar të nisja fillin e këtyre mendimeve, sugjerimeve, propozimeve e qëndrimeve, që ti të vazhdoje t'i formuloje deri në fund, ngjashëm siç po i formuloj unë.

Për ndonjë keqkuptim, paqartësi e pakënaqësi që padashur mund ta kem shkaktuar do ta sqarojmë herë pas here, pasi unë nuk po sugjeroj shpërbujtje të menjëhershme, mekanike dhe as prishje e armiqësim, por të fillojmë ta realizojmë këtë proces bashkërisht, natyrisht me sa

më pak dhimbje e më sa më shumë mirëkuptim.

Do të kishja dëshiruar që Vitin e Ri 1985 ta kalojmë së bashku këtu, në këtë familje që po e ndiej si familjen time. Ti e di se si të kanë mirëpritur dhe të mirëpresin Helga, Jochani dhe fëmijët, pasi sa herë që ke ardhur këtu, të gjuhë jemi gëzuar.

Nëse nuk e ke mundësinë, ose nuk dëshiron të vish të festojmë së bashku, atëherë edhe një herë:

Gëzuar Vitin e Ri 1985, shëndet, suksese e fat!

Të përqafo për zemërsisht e shpirtërisht

Mirani

26.

Në përvjetorin e 3-të të atentatit të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, Mirani u caktua të mbajë fjalën e rastit para varreve të tyre në Shtutgart. Këtë nder e përgjegjësi ia kishin privuar në dy përvjetorët paraprak komplotistët, siç i quante ai Xhabirin dhe Xhafarin. Tani, këtë Mirani e kuptoi si nder që po i bënte Lëvizja, e cila tashmë dukshëm ishte konsoliduar në binarë të saj konstruktivë. Ajo po zgjerohej e forcohej me hov. Por, pos nderit e përgjegjësisë, Mirani këtë e kuptoi edhe si fitore ndaj kundërshtarëve të jashtëm dhe të brendshëm të tij dhe të Lëvizjes.

Ditëve vijuese po mendohej se si ta përpilonte fjalën e rastit, çfarë përmbajtje duhej të kishte ajo. Përfundimisht vendosi për bashkëbisedim me shokët e bashkëveprimtarët e tij, prandaj shkroi:

Shumë të dashur shokë e bashkëveprimtarë, Jusuf, Kadri e Bardhosh!

Sot, në përvjetorin tuaj të 3-të, kam ardhur këtu të bashkëbisedoj me ju pa rezerva, hapur, shoqërisht, siç kemi bashkëbiseduar gjithëherë, që kur jemi njohur. Dhe, sesi m'u krijua bindja se shpirti juaj vërtet do të më dëgjojë.

Jusuf, Kadri e Bardhosh!

Deri në këtë përvjetor të 3-të, mua më qe privuar mundësia dhe e drejta të mbaja para jush fjalë rasti. Sigurisht, ju dëshironi të dini se cilët më privuan nga kjo mundësi dhe e drejtë. Po ju tregoj. Ata kriminelët që ju vdiqën juve fizikisht dhe bashkëpunëtorët e tyre

që mua më vrisnin përditë për se gjalli, sepse fati ose fatkeqësia deshi që unë të mos jem pranë jush, nën këtë tokë mike gjermane. Dhe meqë rastësia dëshi që unë të mos vritem bashkë me ju, armiqtë tuaj dhe të mitë, u egërsuan kundër meje pse mbeta gjallë. Më besoni, siç më keni besuar çdo herë, sa herë më kanë detyruar ta ndiej për fatkeqësi pse kisha mbetur i gjallë dhe nuk isha këtu, pranë jush.

Jusuf, sa herë të jam hidhëruar pse më detyrove pasditën e ditës se kobshme të 17 janarit të shkoja për të bërë aktivitet patriotik, duke më shpëtuar nga vdekja e përbashkët. Dhe të hidhërohesha sidomos kur në shtëpinë tënde, gjatë ceremonisë mortore, uzurpuesit e zotshpillekut të shtëpisë sate, u imponuan si trashëgimtarët e tu politikë. Ata u përpoqen të më përzinin nga shtëpia jote dhe nga ceremonia mortore, por nuk po e di as vetë se si i përballova.

Jusuf, Kadri, Bardhosh!

Në shpirtin tuaj po ju betohem! Vendosa të mos iki i gjallë prej shtëpisë, në të cilën kishim marrë vendimin për bashkim në Organizatën tonë të përbashkët.

Në shpirtin tuaj po ju betohem, vendosa ta mbroj derisa të jem gjallë vendimin që morëm se bashku dhe ta jetësoja atë, edhe pse na e kishin plagosur rënd vrasësit tuaj dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Jusuf, Kadri, Bardhosh!

Vetëm tani, bashkë me ju, po ndihem fitues ndaj urdhërdhënësve e dorasëve vrasarë, ndaj armiqtë tanë të jashtëm, por edhe të brendshëm, që na u imponuan në radhët tona para vrasjes suaj si të kamufluar, pas vrasjes suaj fare hapur, për të vrarë edhe kauzën dhe rugën tonë patriotike e çlirimtare.

Jusuf, Kadri, Bardhosh!

Më falni, ata më munden atëherë, sepse nuk isha i përgatitur për t'i përballuar. Gëzohuni, kisha pasur nëntë shpirtra dhe prandaj, tani dola fitues. Kjo ndodhi sepse u nrit e u forcua Organizata që donim ne, për çka qenë të domosdoshme shumë mund e sakrifica. Për këtë u flijuan edhe shumë bashkidealistë tanë. Pra, vetëm tani po e jetësojmë vendimin për bashkim që e morëm së bashku në agun e 17 Janarit. Atëherë ai vendim na qe plagosur rënd, kur kriminelët ju vranë juve, në natën sterrë e të acartë, të po asaj dite. Ne patëm marrë vendim për bashkim, nga i cili donim të bënim organizatë të mirë, të fortë, patriotike e çlirimtare. Na e plagosen rënd atë natë të kobshme, por vendimi dhe qëllimi ynë i përbashkët i mbijetoi plagët e rënda dhe vetëm tani organizata jonë po ngrihet në këmbët e veta.

E gëzofshim bashkërishtë këtë fitore!

Jusuf, Kadri e Bardhosh!

Dëshiroj t'ju informoj shkurtimisht për Kosovën, për gjendjen, ngjarjet dhe zhvillimet atje.

Pushtimi atje është thelluar akoma më shumë, është bërë i tmershëm dhe, prandaj, i padurueshëm. Në tabor të pushtuesve kanë dalë hapur edhe disa intelektualë të profesionit tuaj. Shpresonim e mendonim se ata nuk do t'i shërbenin asnjëherë pushtuesit. Kishim qenë idealistë naivë. Ata kishin qenë shërbëtorë të kamufluar të pushtuesit për interesa të tyre të ngushta. Tani pushtuesi i detyroi të dalin hapur kundër popullit tonë. Dhe ky veprim i tyre po hidhëron popullin tonë më shumë sesa terrori i pushtuesit. Edhe populli, naiv si ne, mendonte se i ka shkolluar me djersë të ballit për t'u bërë shkrimtarë e gazetarë të mirë, patriotë, siç ishit ju, por ata u bënë mercenarë të pushtuesit.

Sigurisht, ky informim po jua plagos tani shpirtin, por më mirë të shëtit shpirti juaj i plagosur tek ata që po dëshirojnë të angazhohen për ta çliruar Kosovën, sesa shpirti i mashtruar, sepse ithtarët tuaj do të vetëdijesohen më shpejt e më ndërgjegjshëm, për të dalluar më mirë intelektualët patriotë, nga intelektualët mercenarë.

Jusuf, Kadri e Bardhosh!

Burgosjet dhe vrasjet kanë marrë përmasa të mëdha. Vjet na i vranë bashkëveprimtarët tanë, Rexhepin, Nuhiun, Bajramin, Zijanë. Urdhërdhënësit, si në rastin tuaj, qenë pushtuesit, kurse dorasit, shqipfolës të uniformuar me uniforma të pushtuesit. Por, siç thoshe ti Jusuf, sa më shumë që të mbushen burgjet e të shtohen vrasjet e patriotëve çlirimtarë, aq më afër lirisë jemi. Prandaj radhët e organizatës sonë të përbashkët, brenda e jashtë, po marrin veten, po rriten e forcohen, sado me vonesë e me dhimbje, të kushtëzuar nga vrasja juaj dhe e shokëve që po na vritën.

Jusuf, Kadri, Bardh!

Dikur bisedimet për platformë të organizatës që dotë dilte nga bashkimi, i bënim në reth të ngushtë, prandaj vendimet që merrim mund të na i stoponin e të na i plagosnin armiqtë e kamufluar. Tani për platformë të Lëvizjes janë aftësuar e po diskutojnë qindra, për ta miratuar në kuvend të gjerë, vërtet demokratik, siç jemi duke e përgatitur që ta mbajmë. Kjo fitore, dalja nga vendimet që merreshin në dyshe e treshe, nga kooptimet, nga mënyra e të urdhëruarit prej njëshiti që impononte ilegaliteti, për të vendosur në kuvend demokratik për platformë, për të votuar vlerat, vërtet është një hap i madh që Lëvizjes po i garanton ardhmëri të suksesshme.

Jusuf, Kadri, Bardhosh!

Për fund të bashkëbisedimit tonë të sotëm, na lejoni të betohemi edhe një herë para jush, se rugën tonë të përbashkët do ta ndjekim deri në çlirim të Kosovës! Do të na falni

për gabimet e paqëllimshme që do t'i bëjmë gjatë këtij rrugëtimi, sepse lëvizjet e mëdha paevitueshëm shoqërohen edhe me gabime! Ne jemi përcaktuar që t'i minimizojmë ato dhe çdo përvjetor, kur do vijmë që të japim llogari para jush, do t'ju gëzojmë me suksese të reja.

Jusuf, Kadri e Bardhosh!

Shumë të dashur e shumë të respektuar nga të gjithë shqiptarët patriotë,

Ju e pëmbyllët jetën tuaj fizike faqebardhë. Edhe ne do të përpiqemi ta përfundojmë faqebardhë, jo vetëm për hir tonin, por edhe për të mos ju koritur juve, sepse populli e ka për traditë t'i masë vlerat tuaja edhe me ata që latë prapa, për të vazhduar rrugën dhe amanetin tuaj.

Mirupjekshim dhe pushofshi të qetë, me premtim se së shpejti do t'ju bartim në Kosovën e çliruar.

– Lavdi jetës dhe veprës suaj madhore!

– Lavdi jetës dhe veprës së të gjithë dëshmorëve!

Me të përfunduar bashkëbisedimin, Mirani dhe qindra pjesëmarrës para-kaluan duke nderuar heronjtë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla. Shumë nga pjesëmarrësit po e përshëndetnin Miranin, i cili me qetësi po ruante ekuilibrin, as të mos krekosej për nderin që pat për të mbajtur fjalën e rastit, as të mos shfaqte mendjemadhësi pse bashkëbisedoi kaq çiltërsisht me shokët e tij, as të mos shfaqej si lider i imponuar. Ai tashmë kishte propozuar të merrej vendim që në Kryesi të Lëvizjes të mos jenë dy e më shumë veta të të njëjtës familje. Dhe këtë propozim e kishte bërë duke dhënë shembull nga vetja e tij. Ai kishte vendosur të tërhiqej nga kandidimi për në Kryesi, për t'ia lëshuar vendin djalit të axhës, Muharremit, meqë e dinte se që të dy do të votoheshin. Këtë shembull e ndoqën edhe vëllezërit Xhemshiri, kur u tërhoq vëllai i madh, Mujota.

Xhabiri po priste ta takonte Miranin.

– Nuk më pëlqeu bashkëbisedimi yt, qe skandaloz, – tha me inat.

– Sigurisht, qe skandaloz për ty, meqë ti ende nuk po kupton se duhet t'u bashkëngjitesh partnerëve të tu, Sabitit, Avdyllit e Xhafanit, siç iu bashkëngjite më 15 maj të '82–shit.

– Akoma nuk e ke fituar betejën kundër meje. – tha Xhabiri gjithnjë me hidhërim dhe i inatosur.

– Nuk e kam fituar krejtësisht, – ndërhyri me qetësi Mirani, – dhe nuk jam i interesuar tashmë të harxhoj energji të të përzë ty nga Lëvizja, meqë ajo energji më duhet për punë më të mëdha kundër pushtuesit. Ti do të largohesh vetë, sapo të gësh ofertë tjetër, për të mos thënë sapo të të komandojnë. Megjithatë, tani e këtu, po të jap shansin që të bashkëveprojmë në Lëvizje, po dëshirove të bësh kthesën e madhe, duke respektuar demokracinë pluraliste që po sanksionohet e po jetësohet tani dhe konkretisht në Lëvizje. Nëse je i gatshëm të respektosh konkurrimin e vlerave këtej e tutje do të vendosë demokracia e bazuar në votim të lirë në organizatën time, po deshe, edhe në organizatën tonë. Mirëupafshim! – e përshëndeti duke u larguar, meqë po e prisnin një grup shokësh.

Untergruppenbach (Gjermani), janar 1982 – Prishtinë, janar 2007

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18–31

Kelmendi, Ibrahim

ATENTATET (Roman) / Ibrahim Kelmendi.–
Prishtinë, 2007, Shypshkronja: Blini, Gjakovë, 472 faqe, 21 cm

ISBN 987-9951-8583-9-7

Tirazhi: 3.000 kopje

Botimin e ndihmuan:

(Lutja për ndihma për botim të këtij romani, - drejtuar shokëve, miqve dhe dashamirëve të librit, - është botuar në gazetat ditore "Epoka e re" dhe "Info-Press", është shpërndarë me postë elektronike në 800 adresa. Deri më 12.01.2007 ndihma kanë dhënë):

Rinor Cara	Tetovë	Një Laptop
Sahit Krasniqi	CH-Biel/Bienne	150 Euro
Muamet Ameti	Tetovë	200 Euro
Fanol Bardhaj	D - Bochum	100 Euro
Ramiz Lladrovci	Prishtinë	20 Euro
Muharrem Berisha dhe miqtë në Bruxelles		600 Euro
Isuf Idrizi / Uglari	CH-Cyrih	500 SFr
Një grup miqësh	Oslo/Norvegji	1000 Euro
Blerim Muriqi	CH-Cyrih	300 SFr
Miku NN	Dyzeldorf/Gjermani	500 Euro

Kopërtinën e librit e punoi dhe e shtypi falas Ngadhnjim Memeti.

Kërkoj falje nga ata që kanë dërguar ndihma në xhirollogaritë bankare, por që ende nuk janë regjistruar si të hyra, për shkak të transferit të ngadalshëm bankar. Për këtë arsye nuk kam mundur t'i evidentoj emrat e tyre kësaj radhe.

Për ata që dëshirojnë të ndihmojnë këtë botim dhe ribotimin që parashikohet të ndodh se shpejti, si dhe botimet tjera të përgatitura, po i publikojë xhirollagaritë bankare:

Reiffeisen BANK në Prishtinë (Kosovë)
Pranues: Ibrahim Kelmendi, Konto-Nr.: 1501030000582464
Swift Code: RBKOC22

dhe

ProCredit Bank Tetovë (Maqedoni)
Pranues: Ibrahim Kelmendi, Konto-Nr. (Euro): MK037216294400279
Swift Code: PRBUMK22XX

Ju falënderoj për ndihmën.

Ibrahim Kelmendi

E-Mail: ibrahim_kelmendi@yahoo.de
i.kelmendi@gmx.de